



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
Akademia e Drejtësisë / Akademija Pravde / Academy of Justice

**PRAKTIKA E GJYKATËS SË APELIT  
E FOKUSUAR NË ÇËSHTJET E KTHYERA  
NË RISHQYRTIM**

## **I publikuar nga**

Akademia e Drejtësisë dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkëpunim (UNDP) përmes projektit “Përmirësimi i qasjes në drejtësi dhe reforma e sundimit të ligjit”.

### **Autorët:**

Puna e gjykatave themelore në lidhje me zbatimin adekuat të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

**Gëzim Lulluni**

**Ramë Hysenaj**

**Albert Zogaj**

Puna e gjykatave themelore në lidhje me zbatimin adekuat të institutit të parashkrimit, pengimin e posedimit dhe kontestet e punës.

**Kujtim Pasuli**

**Makifete Saliuka**

**Nenad Llazic**

Puna e gjykatave themelore në lidhje me pronësinë (fitimi me mbajtje) servitutet, shpronësimin, rastet e dhunës në familje dhe ato trashëgimore.

**Gani Avdiu**

**Isa Kelmendi**

**Qerim Ademaj**

**Rafet Haxhaj**

Puna e gjykatave themelore në lidhje me kontratat, kompensimin e dëmit etj.

**Hasan Shala**

**Fejzullah Rexhepi**

Puna e gjykatave themelore në lidhje me çështjet përmbarimore.

**Isa Shala**

Puna e gjykatave themelore në lidhje me çështjet ekonomike.

**Mahir Tutuli**

Puna e gjykatave themelore në lidhje me konfliktin administrativ.

**Ramiz Kuqi**

**Ragip Namani**

### **Kontribuesit:**

Valon Kurtaj - Drejtor i Akademisë së Drejtësisë

### **Lektor:**

Anyla Zajmi

### **Mohim:**

Akademia e Drejtësisë nuk pranon kurrfarë përgjegjësie për përmbajtjen e pasqyruar dhe nuk është përgjegjëse për aktualitetet, korrektesinë, tërësinë apo cilësinë e informacioneve të paraqitura nga hartuesit e materialit. Prandaj do të refuzohen të gjitha pretendimet rreth dëmit të shkaktuar nga shfrytëzimi i informatave të dhëna, përfshirë edhe informatat të cilat janë të pakompletuara apo të pasakta.

### **Të drejtat e autorit**

Të drejtat e autorit për materialet e krijuara nga autorët janë të rezervuara. Nuk lejohet kopjimi/dyfishimi i materialit pa pëlqimin e Akademisë së Drejtësisë dhe autorëve. Nëse ndonjë pjesë apo shprehje individuale në tekst nuk është e ligjshme apo korrekte, përmbajtja apo vlefshmëria e pjesëve të tjera mbetet e paprekur nga ky fakt. Akademia e Drejtësisë mund ta bëjë kopjimin e materialit për nevojat e zbatimit të mandatit të vet ligjor, pa e marrë pëlqimin e autorëve.

### **Mars 2019**

Shtypur në Prishtinë

Hartimi dhe botimi i materialit udhëzues: "Praktika e Gjykatës së Apelit e fokusuar në çështjet e kthyer në rishqyrtim" është mundësuar nga Projekti "Përmirësimi i qasjes në drejtësi dhe reforma e sundimit të ligjit" i UNDP-së, me mbështetje financiare nga Ministria e punëve të jashtme e Norvegjisë dhe Akademia e Drejtësisë.



## Tabela e përmbajtjes

Parathënie .....	13
Hyrje .....	14
Qëllimi .....	15
1. PROCEDURA KONTESTIMORE .....	17
1.1 SHQYRTIMI PARAPRAK PËR RREGULLSINË FORMALE TË PADISË .....	17
1.1.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave për rregullsinë formale të padisë .....	17
1.1.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	21
1.1.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	22
1.2 VLERËSIMI I KOMPETENCËS TERRITORIALE NGA GJYKATA E SHKALLËS SË PARË .....	24
1.2.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave, lidhur me jokompetencën territoriale të gjykatës së shkallës së parë .....	24
1.2.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	24
1.2.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	25
1.3 PARAQITJA E AUTORIZIMIT PËR PËRFAQËSIM .....	26
1.3.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave për detyrimin e përfaqësuesit për ta paraqitur prokurën .....	27
1.3.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	27
1.3.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	28
1.4 CAKTIMI I PËRFAQËSUESIT TË PËRKOHSHËM .....	29
1.4.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm .....	31
1.4.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	31
1.4.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	33
1.5 NDRYSHIMI I PADISË .....	34
1.5.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave për ndryshimin dhe lejimin e ndryshimit të padisë .....	35
1.5.2 Lejimi i ndryshimit të padisë pa pëlqimin e të paditurit .....	37
1.5.3 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	37
1.5.4 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	37
1.6 AKTGJYKIMI PËR SHKAK TË MOSBINDJES .....	38
1.6.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes .....	39
1.6.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	40
1.6.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	41
1.7 AKTGJYKIMI PËR SHKAK TË MUNGESËS .....	43
1.7.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave të sipër cituara .....	44
1.7.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	45
1.7.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	46
1.8 ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT .....	47
1.8.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave lidhur me arsyetimin e aktgjykimit .....	47
1.8.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	53
1.8.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	55
1.9 PROCEDURA SIPAS ANKESËS .....	58
1.9.1 Koment i shkurtër .....	59

1.9.2	Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit .....	62
1.9.3	Referenca në aktet për kthimin e lëndëve në gjykatën e shkallë së parë .....	63
1.10	<b>SIGURIMI I KËRKESË-PADISË</b> .....	66
1.10.1	Koment i shkurtër .....	66
1.10.2	Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit .....	67
1.10.3	Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit.....	68
2.	<b>PROCEDURA PËRMBARIMORE</b> .....	71
2.1	<b>PROPOZIMI PËR PËRMBARIM</b> .....	71
2.1.1	Koment i shkurtër .....	71
2.1.2	Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës se Apelit .....	72
2.1.3	Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit.....	73
2.2	<b>BAZAT JURIDIKE PËR CAKTIMIN E PËRMBARIMIT</b> .....	74
2.2.1	Koment i shkurtër .....	74
2.2.2	Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit .....	74
2.2.3	Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit.....	76
2.3	<b>KUFIJTË E PËRMBARIMIT</b> .....	78
2.3.1	Koment i shkurtër .....	78
2.3.2	Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit .....	78
2.3.3	Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit.....	79
2.4	<b>PROCEDURA SIPAS PROPOZIMIT PËR KUNDËR-PËRMBARIM</b> .....	80
2.4.1	Koment i shkurtër .....	81
2.4.2	Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit .....	81
2.4.3	Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit.....	82
2.5	<b>DETYRIMI I VEPRIMIT QË MUND TË KRYHET VETËM NGA DEBITORI</b> ....	82
2.5.1	Koment i shkurtër .....	83
2.5.2	Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit .....	83
2.5.3	Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit.....	83
2.6	<b>SEANCA PËR SHITJEN DHE SHITJA E PALUAJTSHMËRISË</b> .....	85
2.6.1	Koment i shkurtër .....	85
2.6.2	Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit .....	85
2.6.3	Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit.....	86
2.7	<b>PARASHTRESAT, SEANCAT DHE DOSJET</b> .....	86
2.7.1	Koment i shkurtër .....	87
2.7.2	Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit .....	87
2.7.3	Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit.....	87
2.8	<b>PEZULLIMI I PROCEDURËS PËRMBARIMORE</b> .....	88
2.8.1	Koment i shkurtër .....	88
2.8.2	Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit .....	89
2.8.3	Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit.....	89
2.9	<b>RI-PENGIMI I POSEDIMIT</b> .....	90
2.9.1	Koment i shkurtër .....	90
2.9.2	Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit .....	91
2.9.3	Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit.....	91
2.10	<b>MËNYRA E ZBATIMIT TË PËRMBARIMIT ME RASTIN E DORËZIMIT TË FËMIJËS</b> .....	92
2.10.1	Koment i shkurtër .....	92
2.10.2	Të gjeturat nga praktika gjyqësore.....	93
3.	<b>DHUNA NË FAMILJE</b> .....	94
3.1	<b>DHUNA NË FAMILJE</b> .....	94

3.1.1	Përmbledhje e shkurtër nga të gjeturat e përgjithshme nga praktika e Gjykatës së Apelit të Kosovës .....	94
3.1.2	Komente lidhur me zbatimin e dispozitave të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje .....	96
3.1.3	Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës së nenit 2 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, pika 1.1.1-1.1.7 dhe nën paragrafi 1.2, pika 1.2.1-1.2.12 të LMDHF .....	97
3.1.4	Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit të Kosovës .....	97
3.1.5	Referencë nga arsyetimi i aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës .....	98
3.2	NENI 4 I LMDHF - MASA MBROJTËSE E TRAJTIMIT PSIKOSOCIAL .....	100
3.2.1	Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës së nenit 4 të LMDHF .....	100
3.2.2	Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit të Kosovës .....	101
3.2.3	Referencë nga arsyetimi i aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës .....	102
3.2.4	Neni 6 i LMDHF .....	104
3.2.5	Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës së nenit 6 të LMDHF .....	105
3.2.6	Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit të Kosovës .....	106
3.2.7	Referencë nga arsyetimi i Aktvendimit të Gjykatës së Apelit .....	107
3.2.8	Referencë nga arsyetimi i aktvendimit të Gjykatës së Apelit .....	109
4.	KONTESTET FAMILJARE .....	111
4.1	VENDIMI I GJYKATËS PËR USHTRIMIN E TË DREJTAVE DHE DETYRAVE PRINDËRORE .....	111
4.1.1	Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me besimin e fëmijëve në kujdes prindëror me rastin e zgjidhjes ose anulimit të martesës .....	111
4.1.2	Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	112
4.2	MBAJTJA FINANCIARE E FËMIJËVE .....	113
4.2.1	Koment i shkurtër i dispozitave ligjore të nenit 290 të LFK .....	113
4.2.2	Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	114
4.2.3	Kontakti i fëmijës me prindin të cilit nuk i është besuar kujdesi prindëror ....	114
4.2.4	Koment i shkurtër i dispozitave ligjore për rregullimin e kontakteve personale të fëmijës .....	114
4.2.5	Gjetjet nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit .....	115
4.2.6	Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	116
4.3	NDARJA E PASURISË SË PËRBASHKËT TË BASHKËSHORTËVE .....	119
4.3.1	Koment i shkurtër .....	119
4.3.2	Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	120
4.3.3	Referenca nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	121
5.	KONTESTET E PUNËS .....	131
5.1	LLOGARITJA E AFATEVE PËR PARASHTRIMIN E PADISË KUNDËR VENDIMEVE NGA MARRËDHËNIA E PUNËS DHE KËRKESAVE NË PARA .....	131
5.1.1	Komenti i shkurtër për zbatimin e dispozitave për mbrojtjen e të drejtave për të punësuarit, mbrojtjen e të punësuarit në gjykatë dhe afatin e parashkrimit për kërkesat nga marrëdhënia e punës në para .....	131
5.1.2	Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	133
5.1.3	Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	134
5.2	PARASHKRIMI NË KONTESTET NGA MARRËDHËNJA E PUNËS .....	135
5.2.1	Komenti i shkurtër për dispozitat e lartcekura .....	136
5.2.2	Të gjeturat e Gjykatës së Apelit .....	137

5.2.3 Referencat nga arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Apelit.....	138
5.2.4 Afati për padi dhe vlerësimi i afatit si prezumin procedural.....	139
5.2.5 Komenti i shkurtër për zbatimin e dispozitave të lartcekura.....	140
5.2.6 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit.....	143
5.2.7 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit.....	144
5.3 DISKRIMINIMI.....	144
5.3.1 Koment i shkurtër i dispozitave të lartcekura.....	145
5.3.2 Të gjeturat nga praktika e gjykatës së Apelit të Kosovës.....	147
5.3.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit.....	147
6. PENGIM POSEDIMI.....	149
6.1 PENGIM POSEDIMI.....	149
6.1.1 Komenti i shkurtër për zbatimin e dispozitave për pengim posedim.....	151
6.1.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit.....	154
6.1.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit.....	154
7. SHPRONËSIMI DHE KOMPENSIMI I PRONËS SË SHPRONËSUAR.....	157
7.1 SHPRONËSIMI DHE KOMPENSIMI I PRONËS SË SHPRONËSUAR.....	157
7.1.1 Përmbledhje e shkurtër nga të gjeturat e përgjithshme nga praktika e Gjykatës së Apelit të Kosovës.....	158
7.1.2 Komente lidhur me zbatimin e disa prej dispozitave të Ligjit nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-205.....	159
7.1.3 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës ligjore lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar nga punët përgatitore.....	160
7.1.4 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës ligjore lidhur me rregullat themelore për përcaktimin e shumës së kompensimit.....	162
7.1.5 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit.....	164
7.1.6 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës.....	166
7.1.7 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës lidhur me ankesat mbi shumën e kompensimit.....	169
7.1.8 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit.....	171
7.1.9 Referencë nga arsyetimi i aktvendimit të Gjykatës së Apelit.....	172
8. KOMPENSIMI I DËMIT.....	175
8.1 AKTGJYKIMET NË RASTET E SHPËRBLIMIT TË DËMIT MATERIAL DHE JO MATERIAL.....	175
8.2 SHPËRBLIMI I DËMIT MATERIAL.....	176
8.2.1 Dëmi.....	176
8.2.2 Ekzistimi i fajësisë.....	177
8.2.3 Përgjegjësia në rast aksidenti të shkaktuar nga mjetet motorike në lëvizje....	177
8.2.4 Shpërblimi i dëmit material - Rivendosja e gjendjes së mëparshme dhe shpërblimi në të holla.....	178
8.2.5 Kur arrin për pagesë detyrimi i shpërblimit.....	178
8.2.6 Shpërblimi në formë të rentës në të holla.....	179
8.2.7 Dëmi real dhe fitimi i humbur.....	180
8.2.8 Shpërblimi i plotë.....	180
8.2.9 Përgjegjësia e ndarë.....	181
8.2.10 Humbja e fitimit dhe shpenzimet e mjekimit dhe të varrosjes.....	181
8.2.11 E drejta e personit të cilin e ka ushqyer i vdekuri.....	182
8.2.12 Shpërblimi i dëmit në rast të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit ...	182
8.2.13 Ndryshimi i shpërblimit të gjykuar.....	183



8.3 SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL .....	183
8.3.1 Shpërblimi në të holla .....	183
8.3.2 Personat që kanë të drejtë shpërblimi në të holla në rast vdekjeje ose invaliditeti të rëndë .....	184
8.3.3 Trashëgimi dhe cedimi i kërkesës së shpërblimit të dëmit jo material .....	185
8.3.4 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit në zbatimin e dispozitave për nxjerrjen e aktgjykimeve për shpërblimin e dëmit material dhe jo material... ..	185
8.3.5 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	186
8.3.6 Caktimi i lartësisë së dëmit material .....	193
8.3.7 Caktimi i lartësisë së dëmit jo material .....	202
9. FITIMI I PRONËSISË ME MBAJTJE .....	211
9.1 FITIMI I PRONËSISË ME MBAJTJE .....	211
9.2 KOMENT I SHKURTËR I ZBATIMIT TË DISPOZITAVE LIGJORE TË NENEVE 28 DHE 40 TË LPDS .....	213
9.3 GJETJET E GJYKATËS SË APELIT, ME RASTIN E EKZAMINIMIT TË VENDIMEVE TË GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË NË PROCEDURË SIPAS ANKESËS (SHKAQET E ANULIMIT TË AKTGJYKIMEVE) .....	216
9.3.1 Gjykatat e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të këtyre kontesteve, nuk vendosin brenda kërkesë-padisë .....	216
9.3.2 Gjykatat e shkallës së parë vërtetojnë faktet e pohuara nga palët dhe konstatojnë gjendje tjetër faktike .....	216
9.3.3 Gjykatat e shkallës së parë nuk vërtetojnë drejtë dhe plotësisht ekzistimin e mirëbesimit si njërin prej kushteve ligjore për fitimin e pronësisë me mbajtje .....	217
10. KONFLIKTI ADMINISTRATIV .....	221
10.1 VLERËSIMI I RREGULLSISË SË PADISË .....	221
10.1.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës së nenit 33 par.2 të LKA-së .....	221
10.1.2 Të gjetura nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	221
10.1.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	222
10.2 HYRJA E PALIGJSHME DHE QËNDRIMI I PALIGJSHËM NË REPUBLIKËN E KOSOVËS .....	223
10.2.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës së nenit 33 par. 1 nenpar.1.4 dhe neni 95 par.2 i Ligjit për të Huaj .....	224
10.2.2 Të gjetura nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	224
10.2.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	225
10.3 PERSONI I INTERESUAR .....	228
10.3.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës së nenit 21 të LKA-së .....	228
10.3.2 Të gjetura nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	228
10.3.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	229
10.4 EFEKTI SHTYRËS I PADISË .....	231
10.4.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës së nenit 22 par.2 dhe 6 të LKA-së .....	231
10.4.2 Të gjetura nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	232
10.4.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	232
10.5 GJUHA NË PROCEDURË .....	234
10.5.1 Procedura në konfliktin administrativ zhvillohet në gjuhën që është në përdorim zyrtar në gjykatë .....	234
10.5.2 Koment i shkurtër për përdorimin e gjuhës në procedurën administrative-gjyqësore .....	235

10.5.3	Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	235
10.5.4	Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	235
10.6	<b>NDRYSHIMI DHE ANULIMI I AKTIT ADMINISTRATIV NGA ANA E ORGANIT TË PADITUR .....</b>	<b>236</b>
10.6.1	Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës së nenit 36 të LKA-së.....	237
10.6.2	Të gjetura nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	237
10.6.3	Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	238
10.7	<b>DISPOZITIVI I PAKUPTUESHËM I AKTGJYKIMIT DHE EKSPERTIZA NË PROCEDURËN PËR KONFLIKTET ADMINISTRATIVE.....</b>	<b>239</b>
10.7.1	Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës së nenit 369 par.2 të LPK-së.....	239
10.7.2	Të gjetura nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	239
10.7.3	Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit.....	240
10.8	<b>OBJEKTI I KONFLIKTIT ADMINISTRATIV .....</b>	<b>243</b>
10.8.1	Shqyrtimi i ligjshmërisë së aktit përfundimtar administrativ nga gjykata në procedurë të konfliktit administrativ .....	243
10.8.2	Koment i shkurtër lidhur me zbatimin e dispozitave të lartë cekura gjatë shqyrtimit dhe vendosjes për ligjshmërinë e aktit përfundimtar administrativ .....	244
10.8.3	Koment i shkurtër lidhur me rastet kur Gjykata e Apelit ka vendosur në mënyrë meritore .....	246
10.8.4	Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit.....	246
10.8.5	Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit.....	247
11	<b>E DREJTA EKONOMIKE .....</b>	<b>255</b>
11.1	<b>DISPOZITIVI I AKTGJYKIMIT NË KONTESTET EKONOMIKE.....</b>	<b>255</b>
11.1.1	Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave për përpilimin e aktgjykimit me theks të veçantë në dispozitivin e aktgjykimit si pjesa kryesore e tij.....	255
11.2	<b>FORMA ME SHKRIM E KONTRATËS SË NDËRTIMIT (Punët urgjente, punimet shtesë/të ndryshuara) .....</b>	<b>265</b>
11.2.1	Forma e shkruar .....	265
11.2.2	Largimi nga projekti – punët shtese .....	267
11.2.3	Punimet urgjente të paparashikuara .....	268
11.2.4	Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	268
11.2.5	Referenca nga arsyetimet e vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	270
11.3	<b>MBROJTJA GJYQËSORE E MARKAVE TREGTARE .....</b>	<b>275</b>
11.3.1	Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore për mbrojtjen e markave tregtare në rast të shkeljes së tyre dhe kriteret e vlerësimit.....	277
11.3.2	Karakteristikat Themelore të Markave Tregtare .....	278
11.3.3	Shkelja e Markave Tregtare dhe Kriteret e Vlerësimit .....	279
11.3.4	Mundësia e shkaktimit të konfuzionit.....	279
11.3.5	Vlerësimi i mundësisë për konfuzion .....	279
11.3.6	Mbrojtja juridike e markave tregtare .....	280
11.3.7	Mjetet Juridike për Mbrojtjen e Markave Tregtare.....	281
11.3.8	Mbrojtja civilo - juridike, palët, mjetet juridike dhe procedurat .....	281
11.3.9	Kërkesë-padia e palës dhe mbrojtja gjyqësore.....	282
11.3.10	Afati për paraqitjen e padisë .....	283
11.3.11	Masat e përkohshme në rast të shkeljes së markës tregtare .....	283
11.3.12	Masat e përkohshme për ruajtjen dhe sigurimin e dëshmive .....	284
11.3.13	Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit .....	284
11.3.14	Referenca nga arsyetimet e vendimeve të Gjykatës së Apelit .....	285

11.4 KOMPETENCAT E GJYKATAVE PËR SHQYRTIMIN E VENDIMEVE TË ARBITRAZHIT .....	290
11.4.1 Kontestimi i vendimeve të Tribunalit të Arbitrazhit në procedurën e njohjes dhe ekzekutimit .....	291
11.4.2 Kontestimi i vendimeve të Tribunalit të Arbitrazhit dhe kërkesa për anulimin e tyre në procedurë gjyqësore .....	292
11.4.3 Kompetencat e gjykatës për shqyrtimin e vlefshmërisë së marrëveshjes së arbitrazhit .....	293
11.4.4 Kompetencat e gjykatës për shqyrtimin e ekzistencës së marrëveshjes së arbitrazhit .....	293
11.4.5 Të gjeturat nga Praktika e Gjykatës së Apelit.....	295



## Parathënie

Akademia e Drejtësisë në përmbushje të mandatit të saj për zhvillimin e kapaciteteve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, përveç trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme ka në mandat edhe kryerjen e veprimtarive tjera si institucion profesional-kërkimor, për zhvillimin e gjyqësisë në Kosovë në përputhje me standardet evropiane.

Bazuar në këtë mandat, me këtë projekt është bërë hulumtimi i praktikës gjyqësore të Gjykatave Themelore, përkatësisht të Divizionit Civil, Departamentit për Çështje Administrative dhe Departamentit për Çështje Ekonomike për shkak të shkeljeve më të shpeshta, veçanërisht në çështjet civile të natyrës procedurale dhe materiale me ç'rast gjykatat e shkallës së parë dështojnë në nxjerrjen e një vendimi të drejtë dhe të ligjshëm, e po ashtu lëndët iu kthehen në rishqyrtim.

Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, të angazhuar nga Akademia e Drejtësisë në këtë hulumtim, e kanë marrë përsipër identifikimin e shkeljeve më të shpeshta në praktikë dhe ofrimin e zgjidhjeve përmes praktikës së Gjykatës së Apelit në të cilin i japin edhe udhëzimet adekuate për veprimet procedurale që duhet të ndërmerren, për ta zvogëluar trendin e lëndëve që kthehen në rishqyrtim si dhe për të ndikuar në rritjen e efikasitetit në zgjidhjen e rasteve gjyqësore.

Ky material përmban rekomandimet për çështjet e identifikuar nga procedurat kontestimore lidhur me institutin e parashkrimit, pengimin e posedimit dhe kontestet e punës, lidhur me pronësinë (*fitimi me mbajtje*), servitutet, shpronësimin, rastet e dhunës në familje, çështjet familjare dhe ato trashëgimore, si dhe rekomandimet për çështjet e identifikuar nga kontratat, kompensimin e dëmit, çështjet përbarimore, dhe për çështjet lidhur me konfliktin administrativ.

Duke vlerësuar se praktika e Gjykatës së Apelit do ta shmangë trendin e lëndëve që kthehen në rigjykim dhe do ta rrisë cilësinë e punës në gjykata, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim dhe me mbështetje të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – UNDP në Kosovë - Projekti “Përmirësimi i qasjes në drejtësi dhe reforma e sundimit të ligjit” dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë e kanë mundësuar hartimin e këtij udhëzuesi, i cili do të jetë në dispozicion të gjyqtarëve që punojnë në këto çështje, dhe profesionistëve tjerë të sistemit gjyqësor në Kosovë.

Akademia e Drejtësisë, është mirënjohëse dhe falënderuese ndaj UNDP-së dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë, të cilët kanë mundësuar realizimin dhe publikimin e këtij udhëzuesi dhe veçanërisht ndaj autorëve, të cilët kontribuan në identifikimin e shkaqeve procedurale dhe materiale dhe në dhënien e udhëzimeve adekuate përmes këtij publikimi.

## Hyrje

Një prej faktorëve kryesor që ka ndikuar në rritjen e numrit të lëndëve nëpër Gjykatat e Kosovës është pikërisht edhe numri i madh i lëndëve që kthehen në rigjykim. Me këtë trend të lëndëve që kthehen në rishqyrtim është duke u krijuar një pasiguri dhe në të njëjtën kohë dukshëm është duke rënë besueshmëria e publikut në gjykata, me ç'rast po cenohet themeli i performancës së sistemit gjyqësor në përgjithësi dhe gjyqtarëve në veçanti.

Në disa raste kësaj gjendjeje i kontribuon edhe moskoordinimi i kolegjeve në Gjykatën e Apelit, me sjelljen e vendimeve të ndryshme për çështje të njëjta dhe kjo sigurisht ka ndikuar që praktika gjyqësore në nivelin e parë të jetë me divergjenca të theksuara.

Në funksion të përmirësimit të gjendjes, Akademia e Drejtësisë duke u bazuar në mandatin e saj ligjor, e ka zhvilluar procesin e hulumtimit, duke angazhuar një grup të caktuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, të cilët kanë përvojë në këtë drejtim për identifikimin e rasteve më të shpeshta nga praktika gjyqësore, dhe në vijim me konkludimet e përbashkëta për çështje konkrete të japin udhëzimet përmes Praktikës së Gjykatës së Apelit.

Me rastin e këtij procesi të hulumtimit janë realizuar dy tryeza dy-ditore. E para e ka pasur në fokus identifikimin e çështjeve më të rëndësishme të cilat përbëjnë sfidë për praktikën gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë, dhe për të ndarë temat ku do të hulumtohen me hollësi të gjitha problemet, dilemat/paqartësitë, format e ndryshme të veprimit për secilën çështje të identifikuar, që më pastaj, mbi këto të gjetura të jepen udhëzimet adekuate duke i marrë parasysh njohuritë specifike që i kanë gjyqtarët.

Pas punës individuale të secilit gjyqtar, e cila ka qenë e koordinuar me koordinatorin e grupit është mbajtur tryeza e dytë, ku secili gjyqtar i ka prezantuar rekomandimet dhe udhëzimet adekuate për çështjet të cilat i ka pasur në përgjegjësi.

Si rezultat i diskutimeve dhe arritjes së konkludimeve të përbashkëta është hartuar ky dokument, i cili e përmban praktikën e Gjykatës së Apelit për lëndët që kthehen në rishqyrtim në të cilën janë përfshirë udhëzimet adekuate për fushat si në vijim:

- çështje procedurale (kryesisht kontestimore)
- çështje nga procedura përmbartimore
- çështje pronësore
- çështje nga marrëdhëniet e detyrimeve
- çështje nga e drejta familjare
- çështje nga e drejta trashëgimore
- çështje nga marrëdhëniet e punës, dhe
- çështje nga e drejta ekomomike/afariste

Me rastin e përmbledhjes së çështjeve dhe rasteve me komente dhe udhëzime nga praktika e Gjykatës së Apelit, vëmendje të veçantë kanë pasur edhe qëndrimet e Gjykatës Supreme; ndërkaq për çështjet në të cilat ka pasur vetë dilema Gjykata e Apelit është vendosur që t'i drejtohen Gjykatës Supreme.

## Qëllimi

Qëllimi kryesor i këtij materiali udhëzues është që të ndryshohet trendi i lëndëve të cilat kthehen në rishqyrtim, duke synuar që përqindja e lëndëve që kthehen në rishqyrtim të jetë sa më e vogël përmes:

- udhëzimeve për mënyrën e zbatimit të dispozitave procedurale dhe materialeve të cilat nga gjykatat e shkallës së parë zbatohen në mënyra të ndryshme;
- udhëzimeve për mënyrën se si duhet të demonstrohen shkathhtësitë gjykuese në shqyrtim gjyqësor;
- udhëzimeve dhe paraqitjes së referencave në vendime të ndryshme të cilat mund të jenë të disponueshme për të gjithë gjyqtarët; si dhe
- udhëzimeve për menaxhimin e rasteve nga udhëzimet teknike, administrative e deri tek udhëzimet procedurale që i referohen përgjegjësisë së gjyqtarit për menaxhimin e dosjes.

Gjykatat themelore do të përfitojnë nga shfrytëzimi i këtij udhëzuesi, i cili do ta lehtësojë punën e gjyqtarëve në zgjidhjen e rasteve gjyqësore në mënyrë më profesionale dhe më të drejtë, veçanërisht gjyqtarëve nga Departamenti i Përgjithshëm-divizioni civil, Departamenti për Çështje Administrative dhe Departamenti për Çështje Ekonomike.

Akademia e Drejtësisë është mirënjohëse dhe falënderuese ndaj grupit të gjyqtarëve dhe UNDP-së të cilët e kanë mundësuar hartimin dhe botimin e kësaj përmbledhjeje, e cila do të kontribuojë në realizimin e këtij qëllimi.





## 1. PROCEDURA KONTESTIMORE

### 1.1 SHQYRTIMI PARAPRAK PËR RREGULLSINË FORMALE TË PADISË

Padia është veprimi i parë procedural i paditësit, përmes së cilit paditësi e parashtron kërkesën për ta realizuar një të drejtë të tij, me të cilën iniciohet fillimi i procedurës kontestimore dhe si e tillë është parashtrësë mjaft formale, elementet/përmbajtja e së cilës është e përcaktuar nga ligji. Ligji për Procedurën Kontestimore me dispozitën e nenit 253 paragrafi 1, pika a), b), c), d), e) dhe f), e ka përcaktuar përmbajtjen e padisë.

Padia duhet të përmbajë:

- a. kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore;
- b. faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën;
- c. provat me të cilat vërtetohen faktet e tilla;
- d. vlerën e kontestit;
- e. bazën juridike; dhe
- f. të dhënat e tjera që duhet t'i ketë çdo parashtrësë (neni 99 i këtij ligji);

#### 1.1.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave për rregullsinë formale të padisë

Shqyrtimi paraprak i padisë është nën-fazë e detyrueshme e përgatitjes së shqyrtimit kryesor të çështjes juridike. Ky aktivitet procedural duhet të kryhet menjëherë posa paditësi ta paraqesë padinë në gjykatë. Sipas dispozitës së nenit 386 par. 1 parashihet që: “gjykata menjëherë pasi të arrijë padia, i fillon përgatitjet për shqyrtim kryesor të çështjes”, ndërsa me paragrafin 2 të nenit 386 parashihet që: “përgatitjet e tilla përfshijnë ekzaminimin paraprak të padisë, dërgimin e padisë palës së paditur për përgjigje të domosdoshme, mbajtjen e seancës përgatitore dhe caktimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes”. Ky aktivitet përbëhet nga verifikimi se a janë përmbushur prezumimet procedurale, në qoftë se ato mund të konstatohen me vetë leximin e padisë.

Ligji i Procedurës Kontestimore në mënyrë specifike ka përcaktuar me dispozitat e nenit 391 se, pas shqyrtimit paraprak të padisë, gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme nëse konstaton që:

- a. çështja e ngritur me padi nuk hynë në kompetencën gjyqësore;
- b. palët kanë lidhur kontratë për zgjidhjen e kontestit të tyre nga arbitrazhi;
- c. për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyq-varësia (litispendenca);
- d. çështja është gjë e gjykuar (res iudicata);
- e. për objektin e kontestit është lidhur ujdja gjyqësore (pajtimi gjyqësor), se paditësi në gjykatë ka hequr dorë nga kërkesë-padia, se nuk ekziston interesi juridik i paditësit për padi vërtetimi;
- f. padia është paraqitur pas skadimit të afatit, nëse me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj;
- g. paditësi brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk i ka hequr mungesat nga neni 79 dhe 102 të këtij ligji.

Ashtu siç është përshkruar edhe më parë, sipas dispozitës së nenit 253 paragrafi 1 i LPK-së, padia duhet të përmbajë:

- a) kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore;

- b) faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën;
- c) provat me të cilat vërtetohen faktet e tilla;
- d) vlerën e kontestit;
- e) bazën juridike; dhe
- f) të dhënat e tjera që duhet t'i ketë çdo parashtrësë (neni 99 i këtij ligji);

Të dhënat tjera që duhet t'i ketë çdo parashtrësë sipas dispozitës së nenit 99 paragrafi 2, të LPK-së, janë:

- Emrin e gjykatës (përfshirë edhe departamentin përkatës, përveç kur padia dorëzohet në degën e ndonjë gjykatë me ç' rast në vend të departamentit shënohet emri i degës së gjykatës themelore),
- Emrin dhe mbiemrin (për personin fizik), ndërsa për personin juridik emërtimin e personit juridik,
- Vendbanimin apo vendqëndrimin (për personin fizik, ndërsa për personin juridik selinë e personit juridik) e palëve,
- Vendbanimin apo vendqëndrimin e përfaqësuesve ligjor apo me prokurë, (në qoftë se palët kanë përfaqësues),
- Objektin e kontestit,
- Përmbajtjen e deklaratës dhe
- Firmën e parashtruesit.

Sa i përket prezumimeve për rregullsinë e padisë, gjykata në kuptimin formal duhet ta vlerësojë padinë sipas elementeve që kërkohen për çdo parashtrësë, por edhe sipas elementeve specifike që parashihen për padinë.

Në rastet kur parashtrësja nuk i përmban elementet e përcaktuara me ligj, atëherë neni 102 paragrafi 1, i LPK-së përcakton se: *“Kur një parashtrësë nuk është e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do të kërkojë nga dërguesi që ta korrigjojë ose ta plotësojë. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për kryerjen e korrigjimeve dhe plotësimeve duke i caktuar një afat prej tre (3) ditësh për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtrësës”.*

Edhe dispozita e nenit 390 e LPK-së, parasheh se: *“Nëse gjykata konstaton se padia është e pakuptueshme apo jo e plotë, apo se ekzistojnë mungesa që kanë të bëjnë me zotësinë e paditësit apo të paditurit që të bëhet palë ndërgjyqëse, apo me përfaqësimin ligjor të tyre, apo mungesa që i përkasin autorizimit të përfaqësuesit që ta iniciojë procedurën kontestimore, kur autorizimi i tillë kërkohet me ligj, gjykata me qëllim të heqjes së mungesave të tilla i ndërmer masat e nevojshme të përcaktuara me këtë ligj (neni 79 dhe 102 i këtij ligji)”.*

Për mosveprim sipas detyrimit nga dispozita e cituar për palën parashihet pasoja juridike me dispozitën e nenit 102.3 të LPK-së, ku përcaktohet se: *“Parashtrësja do të konsiderohet e tërhequr nëse nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar në par. 1 të këtij neni, e nëse i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, e njëjta do të hidhet poshtë”.*

Vlerësojmë se edhe taksa gjyqësore e përmbush kriterin për t'u trajtuar si prezumim procedural, pasi që me dispozitat e nenit 253.4 dhe 253.5, përcaktohet pasoja në rast të mospagesës së taksës gjyqësore.

Për cilat të meta formale padia kthehet në plotësim/korrigjim?

LPK-ja dhe praktika gjyqësore janë mjaft të qarta dhe pa dilema, se padia duhet të kthehet në plotësim gjithmonë kur asaj i mungojnë elementet që duhet t'i përmbajë padia si çdo parashtrësë (dispozita e nenit 99 paragrafi 2, i LPK-së).

Përkitazi me elementet tjera që duhet t'i përmbajë padia sipas dispozitave nga neni 253 paragrafi 1, pika a), b), c), d), dhe e) e LPK-së, praktika gjyqësore dhe LPK-ja, nuk janë në koherencë, përkatësisht ekzistojnë dallime nëse padia duhet të kthehet në plotësim/korrigjim për të gjitha elementet. Përderisa LPK-ja i trajton si të domosdoshme të gjitha elementet e padisë të përcaktuara me dispozitat e nenit 253 paragrafi 1, për të cilat padia duhet të kthehet në plotësim/korrigjim, në pajtim me dispozitën e nenit 102 paragrafi 1, e në lidhshmëri me këtë edhe në pajtim me dispozitën e nenit 390, praktika gjyqësore ka dallim dhe nuk i trajton të gjitha elementet e padisë sipas dispozitave nga neni 253 paragrafi 1, si elemente të domosdoshme për të cilat padia kthehet në plotësim/korrigjim.

Për arsye praktike në vijim do t'i trajtojmë të gjitha elementet e padisë veç e veç.

Sa i përket kërkesës/ave të caktuar/a në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore, edhe LPK-ja, edhe praktika gjyqësore janë në harmoni të plotë, duke e trajtuar si pengesë formale mospërcaktimin e kërkesave në padi.

Në këtë kontekst, duhet theksuar së në çdo rast gjyqtari i çështjes nëse konstaton se padisë i mungon elementi i përcaktimit të kërkesës/ave duhet ta kthejë padinë në plotësim/korrigjim, sipas dispozitës së nenit 102 paragrafi 1 i LPK-së.<sup>1</sup>

Kjo mënyrë e veprimit në praktikën gjyqësore është në pajtim me logjikën e një procesi gjyqësor civil, sepse nuk është kontestuese, se procesi kontestimor inicohet me qëllim që gjykata t'i japë paditësit mbrojtje gjyqësore të përmbajtjes së caktuar. Aq më tepër, kjo ka kuptim nëse ndërlihet edhe detyrimin e gjykatës që të vendosë brenda kufijve të kërkesave, që janë parashtruar nga palët ndërgjyqësore, (neni 2, paragrafi 1, i LPK-së).

Sipas dispozitës së nenit 253 paragrafi 1, pika b) e LPK-së, del se faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën, paraqesin njërin prej elementeve të domosdoshme të padisë. Në fakt nëse i referohemi dispozitës së nenit 102 paragrafi 1, i LPK-së, del se gjykata do ta kthejë padinë në plotësim për të dhënat që padia duhet t'i përmbajë si parashtrësë, përmbajtja e të cilës është përcaktuar me dispozitën e nenit 99 paragrafi 2, të LPK-së. Në dispozitën e nenit 99 paragrafi 2, përveç të tjerave përcaktohet se parashtrësja duhet ta ketë edhe përmbajtjen e deklaratës, ndërsa në paragrafin 3 të nenit 99, përcaktohet se: *”në qoftë së deklarata përmban ndonjë kërkesë, pala duhet në parashtrësë t'i tregojë faktet mbi të cilat e bazon kërkesën, si dhe provat kur është nevoja për një gjë të tillë”*.

---

<sup>1</sup> Është me rëndësi të theksohet, se praktika gjyqësore sa i përket këtij elementi të padisë është më formale se vet LPK-ja, pasi që LPK-ja, formalisht nuk e përcakton se kërkesa e padisë duhet të formulohet në një formë të caktuar, ndërsa praktika gjyqësore këtë element të padisë e kërkon të jetë i formuluar në formën e një “petitiumi” i cili në fakt është propozim për përmbajtjen e dispozitivit të vendimit meritore.

Nga dispozita e cituar rezulton se faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën, përbëjnë një element të domosdoshëm të padisë, në mungesë të të cilit gjykata duhet ta kthejë padinë në plotësim duke kërkuar nga paditësi prezantimin e fakteve.

Sipas dispozitës së nenit 253 paragrafi 1, pika c) e LPK-së, del se provat mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën, paraqesin njërin prej elementeve të domosdoshme të padisë, megjithatë në praktikën gjyqësore gjykatat janë mjaft të kujdesshme për ta konsideruar paraqitjen e provave si element të domosdoshëm të padisë.

Edhe për provat si element i padisë, nëse u referohemi dispozitave të LPK-së nga neni 102 paragrafi 1, 99 paragrafi 2 dhe 3, do të mund të konstatojmë se paditësi është i detyruar që në padi t'i paraqesë provat, megjithatë në praktikën gjyqësore paraqitja e provave nuk konsiderohet si kusht i domosdoshëm, prandaj gjykata nuk mund ta kthejë padinë në plotësim, me detyrim për paditësin që i njëjti ta plotësojë padinë, duke i paraqitur provat me të cilat vërtetohen faktet e paraqitura në padi.

Praktika gjyqësore është mjaft e qartë për këtë situatë, ashtu që mbizotëron mendimi se edhe nëse në padi nuk janë propozuar provat, e njëjta duhet të konsiderohet e rregullt dhe të vazhdohet me procesin e vendosjes meritore. Kjo për faktin se edhe në mungesë të provave mund të nxirret aktgjykimi në bazë të pohimit, por në fund të fundit mund të vendoset në mënyrë meritore, duke e refuzuar kërkesë-padinë si të pabazuar.

Pra, thënë thjeshtë, gjykata nuk duhet ta zhvillojë procedurën e përmirësimit të padisë, për shkak të mungesës së provave.

Me dispozitën e nenit 253 paragrafi 1, pika d) e LPK-së, është paraparë që padia duhet ta përmbajë edhe vlerën e objektit të kontestit, por në praktikën gjyqësore nuk konsiderohet element i domosdoshëm pa të cilin nuk mund të zhvillohet procesi gjyqësor.

Nëse paditësi nuk e ka përmendur fare vlerën e objektit të kontestit në padi, apo në qoftë se ai vlerën e tillë e ka përcaktuar tepër të lartë apo shumë të vogël, atëherë gjykata sipas detyrës zyrtare apo sipas prapësimit të palës së paditur, më së voni në seancën përgatitore, e në qoftë se kjo nuk është mbajtur, atëherë në seancën për shqyrtim kryesor, por para se të fillojë shqyrtimi shpejt dhe në mënyrë të përshtatshme do ta caktojë vlerën e objektit të kontestit.

Duhet theksuar se gjykata nuk do të nxjerrë ndonjë ekspertizë për ta caktuar vlerën e objektit të kontestit, por varësisht nga ajo se çfarë është objekt kontesti do ta caktojë edhe vlerën.

Vlera e objektit të kontestit ka rëndësi, sepse në bazë të vlerës, përcaktohet nëse pala do të mund ta paraqesë revizionin kundër aktgjykimit/aktvendimit. Sipas vlerës përcaktohet edhe detyrimi për taksën gjyqësore, dhe lartësia e shpenzimeve të përfaqësimit për përfaqësuesin që është avokat.

Me dispozitën e nenit 253 paragrafi 3, të LPK-së, përcaktohet se: *“gjykata do të vendosë sipas padisë edhe kur paditësi nuk e ka treguar bazën juridike të kërkesë-padisë”*.

Nga kjo dispozitë rrjedh se baza juridike është element fakultativ i padisë, edhe pa të cilën procesi gjyqësor zhvillohet.

Rëndësia e bazës juridike si element i padisë është evidente, sepse po të jetë e caktuar baza juridike sipas së cilës paditësi e ka bërë kualifikimin juridik të fakteve, do ta ndihmojë gjykatën në orientimin e procesit të të provuarit.

### **1.1.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Lidhur me shqyrtimin paraprak të padisë, vetëm sa i përket rregullsisë formale, në praktikën gjyqësore hasen probleme të shumta, dhe mënyra të ndryshme të veprimit në mes të gjykatave themelore në Kosovë.

Jo gjithmonë gjykatat i eliminojnë të metat formale të padisë, duke e kërkuar plotësimin/korrigjimin në fazën e shqyrtimit paraprak të padisë. Ka raste kur lënda është në shqyrtim sipas ankesës dhe nga gjykata e shkallës së dytë konstatohen të meta formale të padisë, të cilat është dashur të eliminohen në fazën e shqyrtimit paraprak. Përveç kësaj vërehen mangësi në zbatimin e dispozitave për kthimin e padisë në plotësim. Disa gjykata dështojnë që në aktvendimin me të cilin kthehet padia në plotësim, të përcaktojnë në mënyrë të qartë detyrimin e plotësimit për të metën e identifikuar dhe të njoftojnë për pasojat në rast të mosveprimit. Pra, ka raste kur padia kthehet në plotësim për ta saktësuar kërkesë-padinë por pa e përcaktuar në mënyrë të qartë se cilat plotësime duhet të zënë vend.

Në rastet kur padia nuk është kthyer në plotësim në fazën e shqyrtimit paraprak, por gjatë fazave tjera të procedurës, atëherë na paraqitet edhe një mënyrë e kthimit të padisë në plotësim e cila nuk është konform dispozitave ligjore. Gjykatat zakonisht shënojnë në procesverbal se padia kthehet në plotësim, pa e përcaktuar me saktësi se çka duhet të plotësohet dhe rrjedhimisht pa njoftuar për pasojat e mosplotësimit. Një formë e tillë e kthimit të padisë në plotësim, vetëm duke konstatuar në procesverbal nuk mund të pranohet si e rregullt. Detyrimi i gjykatës është të përpilojë aktvendim të veçantë me të cilin kërkohet evitimi i të metës formale.

Situata jo të pranueshme në praktikë, janë edhe veprimet e gjykatës së shkallës së parë, për ta kërkuar plotësimin e padisë me propozime për prova dhe bashkëngjitje të provave të cilat pala fare nuk i ka theksuar në referatin e padisë. Një veprim i tillë nuk mund të pranohet si i rregullt për disa arsye: fillimisht është në diskrecionin e palëve t'i paraqesin propozimet për provat lidhur me vërtetimin e fakteve vendimtare, pastaj palët kanë të drejtë ligjërisht t'i japin propozimet e tyre për marrjen e provave edhe në seancën përgatitore. Përveç kësaj procedura mund të përfundojë në mënyrë meritore, edhe nëse palët nuk i japin propozimet e duhura për marrjen e provave. Në një rast të tillë kur nuk jepen propozimet për prova, gjykata do ta refuzojë kërkesë-padinë si të pathemeltë, por edhe mund të ndodhë që nga ana e palës së kundërt, faktet e çështjes të bëhen jokontestuese, gjë që jep mundësinë e marrjes së vendimit merititor për themelësinë e kërkesë-padisë.

### 1.1.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit

**Aktvendimi AC.nr.1591/17, i datës 10.07.2017**

#### **Arsyetimi**

*“Përveç shkeljeve të sipër theksuara aktvendimi i atakuar është i përfshirë edhe në shkeljet e nenit 182, lidhur me nenin 102 paragrafi 1 të LPK-së, për shkak se në çdo rast kur një çështje ngritet para gjykatës është detyrim ligjor i gjykatës ta vlerësojë në shqyrtimin paraprak, nëse parashtrësja në këtë rast padia është e kuptueshme dhe e plotë siç kërkohet me dispozitat e LPK-së.*

*Në çdo rast kur një parashtrësja nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë siç kërkohet me dispozitat e nenit 99 paragrafi 2 të LPK-së, atëherë gjykata duhet ta kërkojë plotësimin respektivisht korrigjimin e parashtrësës dhe ta udhëzojë palën për korrigjimin dhe plotësimin që do të zënë vend. Në këtë rast përmbajtja e padisë nga neni 253 paragrafi 1 pika a) e LPK-së, që i referohet kërkesës së caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore është ekuivalente me përmbajtjen e deklaratës së përcaktuar me nenin 99 paragrafi 2 të LPK-së, që nënkupton se kur kërkesë-padia është e paqartë gjykata paraprakisht duhet ta thërrasë palën paditëse që ta saktësojë kërkesë-padinë në mënyrë që procesi të zhvillohet pa pengesa.*

*Në rastin konkret gjykata e ka zhvilluar tërë procedurën pa e pasur të qartë se a bëhet fjalë për procedurën e pengimit të procedimit apo për procedurë tjetër që i referohet formave tjera të mbrojtjes së pronësisë. Kjo provohet nga padia ku pala paditëse ka kërkuar që gjykata të vendosë me aktgjykim dhe nga parashtrësja e datës 20.05.2016, ku pala paditëse me parashtrësën mbi precizimin e kërkesë-padisë, prapë ka kërkuar që gjykata të vendosë me aktgjykim, ndërsa gjykata ka vendosur me aktvendim duke trajtuar kërkesë-padinë si kërkesë për zhvillimin e procedurës së pengimit të posedimit.*

*Në mungesë të një kërkesë të qartë dhe për shkak të të metave me të cilat është identifikuar ky proces gjyqësor, rezulton se edhe gjendja faktike nuk është e konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të gabuar.*

*Në kuptim të të cekurave Gjykata e Apelit, e udhëzon gjykatën e shkallës së parë, që në riprocedurë ta bëjë eliminimin e shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, në atë mënyrë që fillimisht ta bëjë shqyrtimin paraprak të padisë, t'i vlerësojë prezumimet procedurale lidhur me gjykatën, palët, objektin e kontestit dhe rregullsinë formale të padisë, duke vlerësuar nëse e njëjta i plotëson kushtet që gjykata të lëshohet në shqyrtim të çështjes. Nëse gjykata konstaton se padia përmban të meta të tilla që e pengojnë shqyrtimin e çështjes e të cilat mund të eliminohen, atëherë ajo duhet të veprojë në kuptim të dispozitave të LPK-së, me të cilat përcaktohet detyrimi i gjykatës që t'i ftojë palët për plotësimin-korrigjimin e padisë.*

*Nëse gjykata konstaton që padia është e rregullt në pikëpamje formale, por është e palejueshme për shkak të afatit, atëherë ajo duhet të vendosë për lejueshmërinë e saj.*

*Nëse kërkesa për mbrojtje gjyqësore është e paqartë, gjykata duhet të kërkojë nga pala që të përcaktohet se cila është mbrojtja gjyqësore e propozuar/e kërkuar, dhe nëse konstaton se kërkesë-padia ka të bëjë me pengimin e posedimit, atëherë gjykata duhet t'i vlerësojë kërkesat e veçanta që i dikton kjo procedurë, siç janë afati për paraqitjen e padisë dhe kufizimet tjera që kanë të bëjnë me shqyrtimin e çështjes duke u kufizuar në konstatimin e rrethanave për posedimin e fundit dhe pengimin e bërë.*

*Nëse kërkesë-padia i referohet formave të tjera të mbrojtjes së pronësisë, atëherë gjykata duhet ta zhvillojë procedurën e rregullt për konstatimin e fakteve vendimtare mbi bazën e të cilave do të vendosë për themelësinë e kërkesë-padisë.*

*Procedura e iniciuar për pengimin e posedimit gjatë procedurës, nuk mund të ndryshohet në ndonjë bazë apo kërkesë tjetër”.*

### **Aktvendimi AC.nr.1764/13, i datës 20.02.2017**

#### **Arsyetimi**

*“Aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, dhe neni 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 102 paragrafi 1 dhe 99 paragrafi 2 të LPK-së.*

*Gjykata e Apelit gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (n) e LPK-së, sepse dispozitivi është i pakuptueshëm e rrjedhimisht edhe i pa përmbarueshëm. Mënyra se si është formuluar dispozitivi i aktgjykimit duke ia njohur paditësit të drejtën e pronësisë sipas bazës së mbajtjes në një pjesë të ngastrës/pronës kontestuese pa i përshkruar të dhënat përkufizuese, e bëjnë dispozitivin të paqartë e rrjedhimisht edhe të pa përmbarueshëm. Në çdo rast kur gjykata vendos për të drejtën e pronësisë në një pjesë të pronës kontestuese është i domosdoshëm përshkrimi i të dhënave që e identifikojnë pronën me saktësi. Gjykata mund të vendosë pa i përshkruar të dhënat e pjesës së pronës/ngastrës, pa i përshkruar të dhënat për përkufizimin në qoftë se ka vendosur për bashkëpronësinë në pjesë ideale, por jo kur të vendosë për pronësinë në pjesë konkrete-reale.*

*Aktgjykimi është i përfshirë edhe në shkelje nga neni 182 paragrafi 1 i lidhur me nenin 102 paragrafi 1, 99 paragrafi 2 dhe 253 paragrafi 1, pika (a) të LPK-së, sepse në çdo rast kur gjykata konstaton se një parashtrësë nuk është e plotë përkatësisht nuk i përmban të dhënat e kërkuara siç përcaktohet me dispozitën e nenit 99 paragrafi 2, i LPK-së, të njëjtën duhet ta kthejë në plotësim. Në çdo rast, elementet përbërëse të parashtrësës sipas nenit 99 paragrafi 2, janë objekt i kontestit dhe përmbajtjes së deklaratës, të cilat elemente për padinë si parashtrësë janë ekuivalente me kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore, për të cilat elemente nëse mungojnë, padia duhet të kthehet në plotësim. Pra, në këtë rast kur para gjykatës së shkallës së parë është paraqitur padia pa e specifikuar me saktësi kërkesën, gjykata është dashur ta kërkojë plotësimin.*

*Gjykata e Apelit pasi që i ka konstatuar shkeljet e sipër theksuara nuk është lëshuar në shqyrtimet të mëtejme për pretendimet dhe bazat tjera ankimore sepse shkeljet në të cilat është i përfshirë aktgjykimi në këtë fazë të procedurës përbëjnë bazë për rishqyrtimin e çështjes”.*

## **1.2 VLERËSIMI I KOMPETENCËS TERRITORIALE NGA GJYKATA E SHKALLËS SË PARË**

Me dispozitat e nenit 22 dhe 23 të LPK-së, është përcaktuar mënyra e veprimit të gjykatës lidhur me kompetencën territoriale.

“Neni 22

- 22.1 *Gjykata mund të shpallet jokompetente në pikëpamje territoriale vetëm sipas prapësimit të palës së paditur të parashtruar me anë të përgjigjes në padi.*
- 22.2 *Mbi prapësimin nga paragrafi 22.1 gjykata vendos më së voni në seancën përgatitore, përkatësisht në seancën e parë për shqyrtimin kryesor, nëse seanca përgatitore nuk është mbajtur.*
- 22.3 *Gjykata mund të shpallet jokompetente në pikëpamje territoriale sipas detyrës zyrtare vetëm kur ekziston kompetenca territoriale ekskluzive e ndonjë gjykate tjetër, por më së voni deri në momentin e paraqitjes së përgjigjes në padi”.*

### **1.2.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave, lidhur me jokompetencën territoriale të gjykatës së shkallës së parë**

Dispozitat e cituara më lartë, lidhur me jokompetencën territoriale të gjykatës, përcaktojnë se gjykata mund të shpallet jokompetente territoriale, nëse plotësohet kushti i prapësimit të kompetencës. Pra, gjykata do të mund të shpallet jokompetente territoriale vetëm nëse jepet prapësimi i kompetencës territoriale nga ana e palës së paditur. Përveç kësaj, dispozitat përcaktojnë se gjykata do të mund të vendosë për prapësimin e kompetencës më së voni deri në seancën përgatitore dhe nëse nuk është mbajtur seanca përgatitore atëherë në seancën e parë të shqyrtimit kryesor. Përjashtim nga mundësia që gjykata të shpallet jokompetente vetëm me prapësim të palës së paditur, bën kompetenca territoriale ekskluzive, për të cilën gjykata mund të shpallet jokompetente territoriale edhe pa prapësim.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, nga referati i padisë mund të kuptojë se gjykata nuk është kompetente territoriale për ta vendosur çështjen e paraqitur para saj. Por, nuk mund të shpallet jokompetente dhe mbi këtë bazë duhet t’i ndërmarrë veprimet tjera për përgatitjen e shqyrtimit kryesor, ku përfshihet edhe dërgimi i padisë për përgjigje tek pala e paditur, e cila pastaj mund ta japë prapësimin e kompetencës territoriale.

Nëse pala e paditur nuk e jep prapësimin e kompetencës, atëherë themelohet kompetenca e gjykatës dhe procedura vazhdon sikur në mënyrë të rregullt.

### **1.2.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore hasen gabime të shpeshta lidhur me zbatimin e dispozitave të sipër cituara, ngase gjykata në shumë raste pas vlerësimit të kompetencës në shqyrtimin paraprak shpallet jokompetente territoriale pa prapësimin e palës së paditur. Një mënyrë të tillë të veprimit nga ana e gjykatave të shkallës së parë nuk e pranon Gjykata e Apelit, sepse prapësimi është kusht për jokompetencën territoriale, me përjashtim të kompetencës territoriale ekskluzive. Vërehet një tendencë e vlerësimit sipas detyrës zyrtare të kompetencës territoriale, sidomos kur ekziston kompetenca territoriale e zgjedhur si në



çështje të kompensimit të dëmit nga auto përgjegjësia, në çështje familjare etj. Po ashtu e njëjta situatë në përmasa pothuajse të njëjta është e shprehur edhe në hapjen e konfliktit të kompetencës. Rekomandohet që gjykatat t'i zbatojnë me korrektësi dispozitat e LPK-së, dhe veçanërisht ato për shqyrtimin paraprak duke u kufizuar në veprime të cilat nuk mund të ndërmerren zyrtarisht.

### **1.2.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

**Aktvendimi Cn.nr.26/17, i datës 19.01.2017**

#### **Arsyetimi**

*“Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 22 paragrafi 1, 66 paragrafi 5 dhe 392 pika b) e LPK-së.*

*Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes për jokompetencën e saj ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e sipër cituara, duke u shpallur jokompetente territoriale pa pasur prapësim të palës së paditur për kompetencën, prandaj Gjykata e Apelit e ka pranuar si të bazuar ankesën e të autorizuarit të paditësit.*

*Me dispozitën e neni 66 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, është përcaktuar mundësia që palët të merren vesh për kompetencën territoriale të gjykatës, vlefshmëria e së cilës përcaktohet me dispozitën e neni 63 paragrafi 3 dhe 4 të LPK-së, mirëpo me dispozitën e neni 22 paragrafi 1 dhe 66 paragrafi 5 dhe 6 të LPK-së, i pamundësohet gjykatës që të shpallet jokompetente zyrtarisht dhe lënda t'i dërgohet gjykatës me kompetencë të kontraktuar. Me dispozitën e neni 22 paragrafi 1 të LPK-së përcaktohet se: “Gjykata mund të shpallet jokompetente në pikëpamje territoriale vetëm sipas prapësimi të palës së paditur të parashtruar me anë të përgjigjes në padi”, ndërsa me dispozitat e neni 66 paragrafi 5 përcaktohet se: “Nëse padia nuk i është paraqitur gjykatës së caktuar me anë të marrëveshjes, i padituri mund të kërkojë që padia t'i dërgohet gjykatës së kontraktuar”. Në kontekstin e këtyre dy dispozitave rezulton se gjykata nuk mund të shpallet jokompetente territoriale pa pasur prapësim të palës së paditur, as kur bëhet fjalë për kompetencën e kontraktuar territoriale.*

*Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të sipër cituara, të cilat në riprocedurë duhet të eliminohen në atë mënyrë që udhëzohet gjykata që me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë t'i vlerësojë kushtet tjera nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësorë, dhe nëse vlerëson se plotësohen kushtet atëherë ta bëjë përgatitjen për shqyrtimin kryesor në mënyrë që pastaj të mund të vendosë në mënyrë meritore për themelësinë e kërkesë-padisë duke e nxjerrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm”.*

## **Aktvendimi Cn.nr.64, i datës 27.07.2017**

### **Arsyetimi**

*“Gjykata e Apelit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës lidhur me konfliktin e kompetencës në mes të dy gjykatave themelore, gjeti se kompetente territoriale dhe lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike kontestuese është Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, pasi që:*

*Gjykata e Apelit duke vendosur në lidhje me konfliktin e kompetencës të shkaktuar në mes të dy gjykatave themelore, gjen se Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, nuk ka mundur që të shpallet jokompetente në këtë çështje juridike kontestimore pa prapësimin e palës së paditur.*

*Sipas dispozitës së nenit 22 paragrafi 1, i LPK-së përcaktohet se: “Gjykata mund të shpallet jokompetente në pikëpamje territoriale vetëm sipas prapësimit të palës së paditur, të parashtruar me anë të përgjigjes në padi”.*

*Në këtë rast Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me datën 17.09.2013, ka nxjerrë aktvendim për plotësimin e padisë, të cilin aktvendim e ka pranuar paditësja në mënyrë të rregullt me datën 20.09.2013, dhe pas këtij veprimi gjykata pa prapësimin e të paditurit ka vendosur që të shpallet jokompetente territoriale, duke vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 22 paragrafi 1, të LPK-së.*

*Në kuptim të arsyeve të sipër theksuara, Gjykata e Apelit vlerëson se: Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me të drejtë e ka hapur konfliktin e kompetencës në këtë çështje juridike kontestuese, por nuk është pranuar sugjerimi i të njëjtës që lënda t'i dërgohet Degës së Gjykatës Themelore të Prishtinës në Lipjan, sepse padia nuk ishte dorëzuar në Degën e Gjykatës Themelore, por ishte dorëzuar në Gjykatën Themelore”.*

### **1.3 PARAQITJA E AUTORIZIMIT PËR PËRFAQËSIM**

Ligji për Procedurën Kontestimore, me dispozitat e nenit 93 e ka përcaktuar detyrimin e paraqitjes së prokurës për përfaqësim dhe detyrimin e gjykatës që të ndërmarrë veprime, nëse përfaqësuesi nuk e prezanton prokurën.

“Neni 93

- 93.1 *I autorizuari për përfaqësim ka për detyrë që me rastin e kryerjes së veprimit të parë në procedurë ta paraqesë prokurën.*
- 93.2 *Gjykata mund të lejojë që veprimet në procedurë për palën, përkohësisht t'i kryejë personi që nuk e ka paraqitur prokurën, por njëkohësisht do ta urdhërojë atë që brenda afatit të caktuar ta paraqesë prokurën ose aprovimin e palës për veprimet procedurale të kryera.*
- 93.3 *Përderisa të mos kalojë afati për paraqitjen e prokurës, gjykata do ta shtyjë marrjen e vendimit përfundimtar. Nëse ky afat kalon pa sukses, gjykata do t'i anulojë veprimet procedurale të kryera nga personi pa prokurë, dhe do të vazhdojë ta procedojë çështjen pa i marrë në konsideratë veprimet e kryera nga ai”.*

### **1.3.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave për detyrimin e përfaqësuesit për ta paraqitur prokurën**

I autorizuari i palës është i detyruar që me rastin e kryerjes së veprimit të parë në procedurë, ta paraqesë autorizimin (me rastin e parashtrimit të padisë, përgjigjes në padi etj.). Gjykata mund t'ia lejojë personit të tillë përfaqësimin e palës edhe pa parashtrimin e autorizimit, mirëpo do t'ia caktojë atij një afat të caktuar që ta parashtrrojë autorizimin.

Nëse ky person nuk vepron sipas urdhërit të gjykatës, procedura do të vazhdojë sikurse ai fare të mos ishte paraqitur para gjykatës në cilësinë e të autorizuarit të palës, dhe pa i marrë në konsideratë veprimet e kryera nga ai.

Veprimet të cilat i ka ndërmarrë ky person në procedurë gjykata do t'i anulojë, me përjashtim të atyre për të cilat pala më vonë e jep pëlqimin.

Shkelja e këtyre rregullave paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika k të LPK, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe si pasojë e të cilave shkelje do të duhet që të priset vendimi i gjykatës së shkallës së parë. Po ashtu për shkak të kësaj shkeljeje mund të paraqitet edhe mjeti i jashtëzakonshëm juridik – revizioni.

### **1.3.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Duket e pazakontë që gjykatat të lejojnë përfaqësues të palëve pa pasur, respektivisht pa prezantuar prokurë. Në praktikën gjyqësore shfaqen edhe raste të tilla, kur gjykatat nuk kanë qenë të kujdesshme dhe kanë lejuar që të përfaqësohen palët ndërgjyqësore, pa e paraqitur përfaqësuesi prokurën e përfaqësimit. Është krejt e zakonshme që gjykata ta lejojë përfaqësuesin të ndërmarrë veprime të caktuara në procedurë edhe pa e prezantuar prokurën, por njëkohësisht gjykata duhet ta japë urdhërin që përfaqësuesi brenda një afati të caktuar ta paraqesë prokurën, në të kundërtën duhet të anulohen të gjitha veprimet, dhe procedura të vazhdojë sikur në procedurë nuk është paraqitur fare përfaqësuesi.

Është në kundërshtim të plotë me dispozitat e LPK-së, lejimi i përfaqësuesve pa prezantuar prokurën, dhe sigurisht që në procedurën e ankesës në asnjë mënyrë nuk mund të kalojë si i rregullt një vendim gjyqësor ku ka marrë pjesë një përfaqësues pa pasur prokurë. Përveç se është e kundërligjshme, lejimi i përfaqësuesve pa pasur prokurë, në një situatë të tillë cenon edhe parimet tjera të procedurës kontestimore, si parimi i efikasitetit, shfrytëzimi i të drejtave me ndërgjegje, ekonomizimi, ligjshmëria, etj.

Gjykatat duhet ta kenë kujdesin e duhur qysh në shqyrtimin paraprak në mënyrë që t'i evitojnë si të metat e përfaqësimit ashtu edhe të metat tjera, por edhe në fazat e mëvonshme të procedurës, nëse përfaqësuesi paraqitet në fazat tjera të procedurës.

Është me rëndësi të theksohet se në raste kur gjykata konstaton se përfaqësuesi nuk ka paraqitur prokurë, atëherë gjykata duhet ta thërrasë përfaqësuesin që ta prezantojë prokurën, por duhet pasur kujdes sepse nuk mund që autorizimi të konsiderohet si element i parashtrësës dhe rrjedhimisht nuk mund që të përdoret afati ligjor për dorëzimin e autorizimit. Në praktikën gjyqësore paraqiten disa mënyra se si veprojnë gjykatat kur e kërkojnë dorëzimin e prokurës. Në disa raste gjykatat i referohen afatit ligjor nga dispozita

e nenit 102 paragrafi 1, të LPK-së, dhe në disa raste gjykatat caktojnë një afat gjyqësor. Në një situatë të tillë afati është gjyqësor dhe kohëzgjatja brenda së cilës duhet të kryhet veprimi i dorëzimit të prokurës varet nga vlerësimi që ka gjykata. Pra, gjykata do ta marrë parasysh kohën e nevojshme për të paraqitur përfaqësuesi prokurën dhe do ta caktojë afatin.

Nëse gjykata konstaton se në seancë gjyqësore ka prezantuar përfaqësuesi pa pasur prokurë dhe nëse gjykata ka vendosur që ta lejojë përfaqësuesin pa prokurë ta përfaqësojë palën, atëherë urdhëri për dorëzimin e prokurës bëhet në procesverbal dhe nuk nevojitet një vendim i veçantë, ndërsa nëse gjykata e konstaton në shqyrtimin paraprak mungesën e prokurës, atëherë urdhërin për dorëzimin e prokurës do ta japë përmes një aktvendimi të veçantë.

Nëse përfaqësuesi i palës ka dështuar ta prezantojë prokurën edhe pas urdhërit të gjykatës, atëherë gjykata do ta ftojë palën për procedurë të mëtejme sipas dispozitave të LPK-së, e nëse përfaqësuesi pa prokurë është lejuar të ndërmarë veprime, atëherë do të anulohen veprimet e ndërmarra nga përfaqësuesi dhe procedura do të rikthehet në stadin fillestar. Nëse paraqitet nevoja e anulimit të veprimeve të ndërmarra nga përfaqësuesi pa prokurë nën supozimin që jemi në shqyrtim gjyqësor, atëherë veprimet mund të anulohen me aktvendim procedural i cili konstatohet në procesverbalin e seancës.

Për shembull nëse në seancën përgatitore ka marrë pjesë përfaqësuesi pa prokurë dhe gjykata e ka lejuar duke e urdhëruar njëkohësisht që deri në seancën e radhës ta paraqesë prokurën, atëherë nëse supozimin që në seancën e radhës përfaqësuesi ka dështuar ta paraqesë prokurën, në këtë rast gjykata në procesverbalin e seancës e konstaton anulimin e veprimeve të ndërmarra nga përfaqësuesi pa prokurë, nëse ka mundësi procedurale i përsërit veprimet e seancës përgatitore dhe nëse nuk ka mundësi e shtyen seancën dhe konstaton se do të mbahet përsëri seanca përgatitore.

### **1.3.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

#### **Aktvendimi AC.nr.158/13, i datës 25.03.2016**

##### **Arsyetimi**

*“Gjykata e Apelit e Kosovës, pas shqyrtimit dhe ekzaminimit të aktgjykimit të atakuar në kuptim të dispozitës së nenit 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), pa u lëshuar fare në vlerësimin e ankesës së ushtruar dhe pretendimeve ankimore, ka gjetur dhe konstatuar se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës nga 182.2 pika k) të LPK, për të cilën shkelje gjykata e ankimit çdoherë duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare.*

*Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika k) të LPK, qëndron për faktin se në bazë të shkresave të lëndës rezulton se padinë në gjykatën e shkallës së parë e ka ushtruar dhe nënshkruar avokati Z. I. nga Prishtina, duke u paraqitur në cilësinë e të autorizuarit të paditësit, ku i njëjti avokat paditësin e ka përfaqësuar edhe në seancën e shqyrtimit kryesor dhe ka ushtruar edhe ankesë kundër aktgjykimit të nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë. Mirëpo në shkresa të lëndës mungon autorizimi i paditësit dhënë të njëjtit avokat që ta përfaqësojë në këtë lëndë kontestimore, me çka në një situatë të tillë del se avokati Z. I. nga Prishtina nuk ka pasur autorizim që ta ushtrojë padinë në emër*

*të paditësit, si dhe të njëjtin ta përfaqësojë gjatë procedurës kontestimore të zhvilluar tek gjykata e shkallës së parë.*

*Në shkresa të lëndës gjendet autorizimi i datës 29.04.2010, i cili është në dy kopje, njëra në origjinal dhe tjetra fotokopje, dhënë të njëjtit avokat nga personi me emrin Sh. B, për ta përfaqësuar lidhur me realizimin e dëmshpërblimit kundër këtu të paditurës, „Insig” lidhur me aksidentin e datës 05.09.2008, mirëpo i njëjti autorizim rezulton se nuk ka të bëjë asgjë me këtë lëndë kontestimore, pasi që pala paditëse sipas padisë së ushtruar në rastin konkret është I. M. nga fshati Akrahticë Komuna e Vushtrrisë, e jo personi Sh. B.*

*Po ashtu në shkresa të lëndës, përkundër faktit se nga gjykata e shkallës së parë në procesverbalin e seancës së datës 06.12.2012 figuron konstatimi se për të paditurën prezanton e autorizuar E. B-S. S, mungon autorizimi i të paditurës dhënë të njëjtës për ta përfaqësuar në këtë lëndë kontestimore.*

*Me dispozitën e nenit 93.1 të LPK shprehimisht parashihet "I autorizuari për përfaqësim ka për detyrë që me rastin e kryerjes së veprimit të parë në procedurë ta paraqesë prokurën". Ndërsa me dispozitën e nenit 93.4 të të njëjtit ligj shprehimisht parashihet "Gjykata ka për detyrë që gjatë gjithë procedurës të kujdeset nëse personi që prezantohet si përfaqësues është i autorizuar për përfaqësim. Po qe se gjykata konstaton se personi që prezantohet si përfaqësues, nuk është i autorizuar nga pala për një gjë të tillë, do t'i anulojë veprimet procedurale të kryera nga personi i tillë, po qe se veprimet e tij nuk i ka pranuar më vonë".*

*Gjykata e shkallës së parë udhëzohet që në riprocedurë, fillimisht ta urdhërojë avokatin Z. I. nga Prishtina dhe përfaqësuesen e së paditurës E. B\_S. që brenda afatit të caktuar të paraqesin prokurën (autorizimin) e dhënë nga ana e paditësit dhe të paditurës ose aprovimin e tyre për veprimet procedurale të kryera, dhe pastaj varësisht prej asaj se të njëjtës gjykatë do t'i prezantohen apo jo autorizimet e kërkuara apo do të paraqitet aprovimi i palëve të cilat i kanë përfaqësuar, gjykata t'i ndërmarrë hapat tjerë procedural të paraparë me dispozitat ligjore në fuqi, duke pasur parasysh të gjitha veprimet që janë ndërmarrë nga momenti i paraqitjes së padisë e tutje".*

## **1.4 CAKTIMI I PËRFAQËSUESIT TË PËRKOHSHËM**

Ligji për Procedurën Kontestimore me dispozitat e neneve 79, 80, 81, 82, 83 dhe 84 e ka rregulluar mundësinë e caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm duke i saktësuar edhe rastet kur mund të caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, kushtet dhe procedurën.

*"Neni 79*

*79.1 Nëse gjatë zhvillimit të procedurës në gjykatën e shkallës së parë tregohet se procedura e zakonshme rreth caktimit të përfaqësuesit ligjor për të paditurin do të zgjaste shumë, kështu që për këtë arsye do të mund të lindnin pasoja të dëmshme për njërin apo për të dyja palët, gjykata do t'i caktojë të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm.*

*79.2 Nën kushtet nga paragrafi 79.1, gjykata do t'i caktojë të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm sidomos në këto raste:*

- a) nëse i padituri nuk e ka zotësinë procedurale, ndërsa nuk ka përfaqësuesin ligjor;
  - b) nëse ekzistojnë interesat e kundërta të të paditurit dhe të përfaqësuesit ligjor të tij;
  - c) nëse të dyja palët ndërgjyqëse kanë të njëjtin përfaqësues ligjor;
- 79.3 Gjykata do t'i caktojë palës së paditur përfaqësuesin e përkohshëm edhe në këto raste:
- a) nëse vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kurse i padituri nuk ka përfaqësues me prokurë;
  - b) nëse i padituri ose përfaqësuesi ligjor i tij, nuk kanë përfaqësues me prokurë, ndodhen jashtë shtetit, kurse dërgimi i shkresave nuk ka mundur t'u bëhet.
- 79.4 Për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm gjykata do ta njoftojë pa shtyerje organin e kujdestarisë, si dhe palën kur kjo është e mundshme.

#### Neni 80

Gjykata ia cakton përfaqësuesin e përkohshëm edhe personit juridik duke i zbatuar në mënyrë adekuate dispozitat e nenit 79 të këtij ligji.

#### Neni 81

- 81.1 Gjykata e cakton përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e avokatëve.
- 81.2 Në rastet nga paragrafi 2 i nenit 79 të këtij ligji, i padituri ka për detyrë ta deponojë shumën e të hollave për pagesën e shpenzimeve të përfaqësuesit të përkohshëm, kurse në rastet nga paragrafi 3 i të njëjtit nen shpenzimet i deponon paditësi.

#### Neni 82

- 82.1 Përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor në procedurën, për të cilën është caktuar.
- 82.2 Përfaqësuesi i përkohshëm i ushtron të drejtat dhe detyrat e përmendura derisa të paraqiten në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi i tij me prokurë, gjegjësisht derisa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

#### Neni 83

Në qoftë se përfaqësuesi i përkohshëm i është caktuar të paditurit për shkaqe të treguara në nenin 79 paragrafi 3 pika a) dhe b) të këtij ligji, gjykata brenda afatit prej shtatë ditësh do të japë shpallje e cila do të botohet në gazetën zyrtare dhe do të afishohet në tabelën e gjykatës së çështjes, sipas nevojës edhe në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme.

#### Neni 84

Zotësia procedurale e palëve ndërgjyqëse në gjykatat tona vlerësohet sipas dispozitave ligjore të vendit tonë”.

### **1.4.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm**

Nëse procedura rreth caktimit të përfaqësuesit ligjor për personin (të paditurin) me pazotësi të veprimit (pazotësi procedurale) nga ana e organit të kujdestarisë do të zgjaste shumë dhe do të mund të prodhonte pasoja të dëmshme për cilëndo palë, LPK ka paraparë mundësinë që gjykata e shkallës së parë t'ia caktojë atij (të paditurit pra) përfaqësuesin e përkohshëm.

Përfaqësuesi i përkohshëm në procedurë i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit ligjor, dhe këto të drejta dhe detyrime i ushtron derisa i padituri apo i autorizuari i tij nuk paraqiten në gjykatë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë nuk e informon gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Gjykata do t'ia caktojë të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm në rastet të cilat janë të saktësuara me ligj dhe për këtë do ta njoftojë menjëherë organin kompetent të kujdestarisë si dhe palët kur një gjë e tillë është e mundshme.

Nëse të paditurit i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm nga arsyeya se vendbanimin e ka të panjohur, kurse nuk ka të autorizuar, si dhe nëse ai dhe përfaqësuesi i tij ligjor ndodhen në botën e jashtme kurse nuk kanë të autorizuar në territorin e Republikës së Kosovës, si dhe nëse dorëzimi nuk ka mundur të kryhet, gjykata brenda afatit prej shtatë (7) ditësh do të japë shpallje e cila do të botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa që shpallja do të afishohet edhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës së çështjes, e sipas nevojës edhe në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme. Në këtë rast procedura do të vazhdojë, deri sa i padituri nuk lajmërohet në gjykatë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë nuk e informon gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Gjykata e cakton përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e avokatëve.

Shpenzimet e shpalljes për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm në rastet e parapara sikurse në nenin 79.3 të LPK-së, (shpenzimet e botimit të shpalljes në ndonjë gazetë), duhet t'i deponojë paditësi.

Në këtë rast, paditësi duhet t'i deponojë edhe shpenzimet për pagesën e përfaqësuesit të përkohshëm për pjesëmarrje në seancat gjyqësore, të llogaritura sipas tarifës zyrtare të Odës së Avokatëve të Kosovës, për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatëve, përkatësisht nr. tarifor 7, të ekstraktit që i është bashkëngjitur kësaj tarife.

Caktimi i përfaqësuesit të përkohshëm në cilëndo situatë është detyrim që gjykata duhet ta përmbushë sipas detyrës zyrtare, por që nevojitet edhe plotësimi i kushteve tjera nga palët siç është deponimi i shpenzimeve për përfaqësuesin e përkohshëm.

### **1.4.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit, hasen mangësi në zbatimin e dispozitave të LPK-së, rreth caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm nga gjykatat e shkallës së parë, veçanërisht rreth detyrimit ligjor që vendimi mbi caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të botohet në gazetën zyrtare.

Në lidhje me caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm ka dilemë në praktikën e gjykatave të shkallës së parë edhe lidhur me atë se a duhet të caktohet zyrtarisht, apo vetëm me propozimin e palës e cila ka interes juridik për zhvillimin e procedurës.

Problemet në zbatimin e dispozitave të LPK-së, rreth caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm në mënyrë të përmbledhur mund të identifikohen si katër më kryesoret: Si caktohet përfaqësuesi i përkohshëm? Cila është procedura pas nxjerrjes së aktvendimit për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm? Si përzgjidhet përfaqësuesi i përkohshëm? dhe Si bëhet pagesa?

Në lidhje më atë se si duhet të caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, në praktikën gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë vërehen dy mënyra të veprimit dhe atë: disa gjykata e caktojnë përfaqësuesin e përkohshëm zyrtarisht dhe disa nuk e caktojnë nëse nuk ka propozim. Gjykata e Apelit ka një praktikë të unifikuar sa i përket kësaj çështjeje nga e cila rrjedhë se zbatimi i dispozitave për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm duhet të bëhet zyrtarisht, pra gjykata do ta caktojë përfaqësuesin e përkohshëm kur plotësohen kushtet edhe pa pasur propozim. Në këtë kuptim u rekomandohet gjykatave të shkallës së parë që në momentin kur plotësohen kushtet për përfaqësues të përkohshëm, të njëjtat ta caktojnë atë zyrtarisht edhe nëse nuk ka propozim.

Për përfaqësuesit e përkohshëm gjykata duhet ta urdhërojë palën që ka interes juridik për zhvillimin e procedurës, që t'i deponojë shpenzimet e përfaqësuesit paraprakisht.

Nëse pala nuk i deponon shpenzimet e përfaqësuesit brenda afatit të caktuar nga gjykata në xhirollogarinë e caktuar nga gjykata, atëherë mund të revokohet aktvendimi mbi caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm. Nëse pala vepron sipas vendimit të gjykatës për deponimin e shpenzimeve për përfaqësuesin e përkohshëm, atëherë gjykata aktvendimin mbi caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm në tri gjuhë duhet ta dërgojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës për botim dhe duhet ta presë konfirmimin e botimit të vendimit. Vendimi i njëjtë i dërgohet edhe organit të kujdestarisë dhe njëkohësisht afishohet edhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës. Ka mundësi që vendimi mbi përfaqësuesin e përkohshëm të botohet edhe në ndonjë gazetë ditore me tirazh të madh, por nuk është kusht.

Gjykata duhet ta presë botimin e vendimit për përfaqësuesin e përkohshëm në gazetën zyrtare dhe pastaj përfaqësuesi i përkohshëm të ndër marrë veprime në procedurë.

Sa i përket përzgjedhjes së avokatit si përfaqësues, rekomandohet që gjykata ta shfrytëzojë komunikimin zyrtar me Odën e Avokatëve të Kosovës, në atë mënyrë që të përzgjedhet avokati i cili është në pritje sipas listës. Kjo do të ndikonte në objektivitetin e procedurave.

Në shumë raste të cilat vijnë sipas propozimit për përsëritjen e procedurës, vërehen mangësi nga ana e gjykatave të shkallës së parë sa i përket mënyrës dhe procedurës së caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm.

Edhe mënyra e pagesës së përfaqësuesit të përkohshëm duhet të bëhet krejtësisht në procedurë zyrtare me urdhër të gjykatës, nga xhirollogaria zyrtare ku deponohen shpenzimet në xhirollogarinë e përfaqësuesit, varësisht nga veprimet të cilat i ka ndër marrë. Duhet të eliminohen metodat që e cenojnë objektivitetin dhe ligjshmërinë e procedurës.



### 1.4.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit

**Aktvendimi AC.nr.2105/16, i datës 24.10.2016**

#### **Arsyetimi**

*“Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1, e lidhur me nenin 83 të LPK-së.*

*Aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkeljen e sipër cituar, pasi që gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurin nuk e ka zbatuar procedurën e kërkuar me dispozitat e LPK-së, nga neni 83.*

*Sipas dispozitës së nenit 83, të LPK-së përcaktohet se: “Në qoftë se përfaqësuesi i përkohshëm i është caktuar të paditurit për shkaqet e treguara në nenin 79 paragrafi 1 pika a) dhe b) të këtij ligji, gjykata brenda afatit prej 7 ditësh do ta japë shpalljen e cila do të botohet në gazetën zyrtare dhe afishohet në tabelën e gjykatës së çështjes, sipas nevojës edhe në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme”. Në këtë rast konstatohet nga shkresat e lëndës se gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.260/15, i datës 11.01.2016, të padituri N. M. M, nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, me banim të përkohshëm në Zvicër, i ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm, në përputhje me dispozitën e nenit 79 paragrafi 3 pika a) e LPK-së, por nuk ka vepruar pastaj siç kërkohet me dispozitën e nenit 83 të LPK-së, e cila siç u citua më lartë përcakton detyrimin që gjykata ta japë shpalljen e cila duhet të botohet në gazetën zyrtare, e po ashtu të afishohet në tabelën e gjykatës së çështjes. Gjykata e shkallës së parë nuk i ka ndërmarrë fare këto veprime dhe menjëherë pasi që e ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm për të paditurin, e ka caktuar shqyrtimin kryesor duke vendosur në mënyrë meritore për themelësinë e kërkesë-padisë.*

*Procedura për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm nuk duhet të kuptohet vetëm si kusht për zhvillimin e procedurës kontestimore, por duhet të kuptohet edhe si garancion se interesat e palës për të cilën caktohet përfaqësuesi do të përfaqësohen në mënyrë proporcionale dhe me etikë, prandaj kërkohet që dispozitat e sipër cituara të zbatohen me korrektësi në mënyrë që të plotësohen kushtet për nxjerrjen e një vendimi të drejtë dhe të ligjshëm.*

*Përveç kësaj në shkresat e lëndës nuk vërehet fare se si ka vepruar gjykata për çështjen e shpenzimeve të përfaqësuesit të përkohshëm, pasi që me dispozitën e nenit 81 paragrafi 2, i LPK-së, përcaktohet detyrimi i gjykatës që për rastet kur përfaqësuesi caktohet në kuptim të dispozitës së nenit 79 paragrafi 3, paditësi do të detyrohet ta deponojë shumën e të hollave për pagesën e shpenzimeve të përfaqësuesit të përkohshëm.*

*Meqenëse aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkeljet e sipër cituara të cilat sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, kualifikohen, në grupin e shkeljeve për të cilat çështja duhet të kthehet në rishqyrtim, kjo gjykatë nuk është lëshuar në arsyetim të mëtejme të pretendimeve ankimore për bazat tjera, sepse pa u eliminuar shkeljet e sipër cituara nuk plotësohen kushtet për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm, prandaj është vendosur që çështja të kthehet në rishqyrtim.*

*Në rishqyrtim udhëzohet gjykata që t'i eliminojë shkeljet e theksuara më lartë, duke provuar që në mënyrë të rregullt t'i dorëzohen shkresat e lëndës të paditurit, e në pamundësi që të njëjtit t'i dorëzohen në mënyrë të rregullt shkresat e lëndës për shkak të adresës, atëherë të zbatohet procedurën për përfaqësuesin e përkohshëm siç kërkohet me dispozitat e LPK-së, dhe pas përfundimit të procedurës për përfaqësuesin e përkohshëm t'i ndër marrë veprimet për përgatitjen e shqyrtimit kryesor dhe në procedurën e shqyrtimit t'i administrojë provat e nevojshme për vërtetimin e fakteve vendimtare, mbi bazën e të cilave do ta marrë vendimin e drejtë dhe të ligjshëm”.*

## **1.5 NDRYSHIMI I PADISË**

Ligji për Procedurën Kontestimore me dispozitat e neneve 257, 258, 259 dhe 260 e ka rregulluar mënyrën e ndryshimit dhe lejimit të ndryshimit të padisë.

*“Neni 257*

*257.1 Ndryshim të padisë përbën ndryshimi i njëjtësisë së kërkesë-padisë, zmadhimi i kërkesë-padisë apo parashtrimi edhe i një kërkesë tjetër krahas asaj ekzistueses.*

*257.2 Padia nuk quhet e ndryshuar nëse paditësi e ka ndryshuar bazën juridike të kërkesë-padisë, nëse e ka zvogëluar kërkesë-padinë, apo nëse i ka ndryshuar, plotësuar apo përmirësuar, thëniet e caktuara në padi.*

*Neni 258*

*258.1 Paditësi mund ta ndryshojë padinë më së voni deri në përfundimin e seancës përgatitore apo deri në fillimin e seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes, nëse seanca përgatitore nuk është caktuar fare. Në rast të këtillë gjykata të paditurit duhet t'i japë kohë të nevojshme që të përgatitet për shqyrtim të padisë së ndryshuar.*

*258.2 Pas përfundimit të seancës përgatitore, e më së voni deri në mbylljen e seancës për shqyrtim kryesor, gjykata mund ta lejojë ndryshimin e padisë vetëm nëse konstaton se ndryshimi nuk ka për qëllim zvarritjen e gjykimit dhe nëse i padituri pajtohet me ndryshimin e padisë.*

*258.3 Konsiderohet se ekziston pëlqimi i të paditurit për ndryshimin e padisë nëse ai fillon të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes së padisë së ndryshuar, pa e kundërshtuar më parë ndryshimin.*

*258.4 Gjkata në rastin e paragrafit 2 të këtij neni e lejon ndryshimin e padisë edhe nëse i padituri e kundërshton ndryshimin nëse plotësohen këto kushte:*

*a) paditësi, pa fajin e tij, nuk ka mundur më parë ta ndryshojë padinë;*

*b) i padituri ka mundësi të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes së ngritur me padinë e ndryshuar pa u shtyrë seanca kryesore.*

*258.5 Nëse padia është ndryshuar në seancën në të cilën i padituri nuk është i pranishëm, gjykata duhet ta shtyjë seancën dhe t'ia dërgojë të paditurit kopjen e procesverbalit nga seanca e këtillë.*

*258.6 Kundër aktvendimit me të cilin lejohet apo refuzohet ndryshimi i padisë nuk lejohet ankimi i veçantë.*

*Neni 259*

*Nëse paditësi e ndryshon padinë duke kërkuar nga e njëjta bazë faktike sendin tjetër apo një shumë të hollash, i padituri nuk mund ta kundërshtojë atë nëse ndryshimi është pasojë e rrethanave të krijuara pas ngritjes së padisë.*

*Neni 260*

*260.1 Nëse plotësohen konditat e përcaktuara në nenin 258 paditësi mund ta ndryshojë padinë edhe ashtu që në vend të të paditurit të parë ta padisë një person tjetër.*

*260.2 Për ndryshimin e padisë në mënyrën e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni është i nevojshëm pëlqimi i personit që duhet të hyjë në gjykim në vend të të paditurit, e nëse i padituri ka filluar të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore, nevojitet edhe pëlqimi i tij.*

*260.3 Personi i cili hynë në gjykim në vend të palës së paditur duhet ta pranojë atë në gjendjen në të cilën ndodhet në momentin kur hyn në të”.*

### **1.5.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave për ndryshimin dhe lejimin e ndryshimit të padisë**

Ndryshimi i padisë gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor civil është çështje shumë e rëndësishme procedurale dhe si e tillë haset shpesh në praktikë.

Padia konsiderohet e ndryshuar nëse në të ndryshohen elementet esenciale të saj, ashtu që padia e ndryshuar nuk është më e njëjtë me atë të parën. Elementet nga të cilat varet ndryshimi i padisë janë: Kërkesë-padia dhe ndryshimi i të paditurit.

Ndryshimi i njëjtësisë së kërkesë-padisë - ekziston atëherë kur ndryshohet baza e padisë, përkatësisht gjendja faktike ose faktet në të cilat bazohet kërkesa e palës paditëse.

Zmadhimi i kërkesë-padisë - nënkupton zgjerimin e kërkesë-padisë në kuptimin kuantitativ dhe kualitativ.

Zvogëlimi i kërkesë-padisë - nuk konsiderohet ndryshim i padisë, dhe rrjedhimisht gjykata nuk ka nevojë ta lejojë ndryshimin.

Parashtrimi edhe i një kërkesë krahas kërkesës ekzistuese - kur paditësi gjatë procedurës krahas kërkesës ekzistuese parashtron edhe kërkesa të tjera.

Ndryshimi i padisë në kuptimin subjektiv - deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes juridike paditësi mund ta ndryshojë padinë e vet duke e paditur personin tjetër në vend të të paditurit të parë. Kjo ndodh për arsye se zhvillimi i procesit kontestimor mund ta sjellë në pyetje saktësinë e legjitimitetit pasiv të palës së paditur më parë.

Kushti i parë dhe kryesor që të lejohet ndryshimi i padisë në kuptimin subjektiv është që të pajtohet pala që do të hyjë në proces, përkatësisht në gjykim në vend të të paditurit, ndërsa nëse i padituri ka filluar të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore, nevojitet edhe pëlqimi i tij.

Personi i cili hyn në gjykim në vend të palës së paditur, duhet ta pranojë atë në gjendjen në të cilën ndodhet në momentin kur hyn në të.

Pëlqimi i të paditurit për ndryshimin e padisë është i nevojshëm në rastet kur ndryshimi bëhet pas përfundimit të seancës përgatitore, ose më së voni në fillim të seancës për shqyrtim kryesor, nëse seanca përgatitore nuk është mbajtur fare.

Në raste të tilla pëlqimi i të paditurit justifikohet me faktin se i padituri mund të ketë interes juridik që çështjen e filluar ta përfundojë me vendim meritor, dhe paditësi mos të ketë mundësi që ta iniciojë prapë procesin e njëjtë kundër tij.

Praktikisht mund të ndodhë që i padituri e jep pëlqimin për ndryshimin e padisë në kuptimin subjektiv, por ka të drejtë t'i kërkojë shpenzimet e procedurës të krijuara deri në momentin kur gjykata vendos për ndryshimin e padisë. Në këtë rast, gjykata duhet me aktvendim të veçantë, ndaj të cilit lejohet ankesë e veçantë, t'ia bëjë me dije të paditurit shpenzimet e procedurës.

Ndryshimi i padisë si çështje e natyrës procedurale mund të paraqitet praktikisht në dy faza të procesit gjyqësor, dhe atë ndryshimi i padisë deri në seancën përgatitore/të shqyrtimit kryesor (kur nuk mbahet seanca përgatitore), dhe ndryshimi i padisë pas përfundimit të seancës përgatitore apo fillimit të seancës për shqyrtim kryesor.

Ndryshimi i padisë deri në seancën përgatitore, seancën e shqyrtimit kryesor - paditësi mund ta ndryshojë pa pëlqimin e të paditurit padinë deri në përfundimin e seancës përgatitore, apo deri në fillimin e seancës për shqyrtim kryesor, në qoftë se nuk është caktuar fare seanca përgatitore.

Ndryshimi i padisë pas përfundimit të seancës përgatitore apo fillimit të seancës për shqyrtim kryesor - paditësi mund ta ndryshojë padinë pas përfundimit të seancës përgatitore ose fillimit të seancës për shqyrtim kryesor, por vetëm me pëlqimin e palës së paditur.

Në raste të tilla gjykata do ta lejojë ndryshimin e padisë, vetëm nëse e konstaton se ndryshimi nuk ka për qëllim zvarritjen e gjykimit.

Konsiderohet se ekziston pëlqimi i të paditurit për ndryshimin e padisë nëse ai fillon të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes sipas padisë së ndryshuar, pa e kundërshtuar më parë ndryshimin.

Nëse paditësi e ndryshon padinë duke kërkuar nga e njëjta bazë faktike sendin tjetër apo një shumë të hollash, i padituri nuk mund ta kundërshtojë atë nëse ndryshimi është pasojë e rrethanave të krijuara pas ngritjes së padisë.

Përshkimi i një situate praktike: rast tipik është kur pala paditëse, në vend të sendit borxh kërkon një send tjetër ose kërkon shpërblimin e dëmit, për shkak të humbjes ose shkatërrimit të sendit i cili ka qenë objekt i kërkesë-padisë dhe i cili është shkatërruar apo është humbur, pas ngritjes së padisë.

Nëse padia është ndryshuar në seancën në të cilën nuk ka qenë prezente pala e paditur atëherë gjykata duhet ta shtyjë seancën dhe t'ia dërgojë palës së paditur një kopje të procesverbalit të seancës.

### **1.5.2 Lejimi i ndryshimit të padisë pa pëlqimin e të paditurit**

Në situata të caktuara gjykata do ta lejojë ndryshimin e padisë, edhe nëse pala e paditur nuk e ka dhënë pëlqimin, me kusht që në mënyrë kumulative të plotësohen këto kushte:

- Që pala paditëse pa fajin e saj nuk ka pasur mundësi ta ndryshojë padinë më parë, dhe
- Që i padituri ka mundësi të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes sipas padisë së ndryshuar pa e shtyrë seancën kryesore.

Në praktikën gjyqësore ka shumë raste kur gjykata lejon ndryshimin e padisë pa e marrë pëlqimin e të paditurit.

Në të gjitha rastet e ndryshimit të padisë si në kuptimin objektiv ashtu edhe në atë subjektiv, gjykata vendos me aktvendim me të cilin e lejon ose e refuzon ndryshimin e padisë. Varësisht nga faza e procedurës në të cilën bëhet ndryshimi i padisë, gjykata mund të vendosë në seancë dhe jashtë seancës gjyqësore. Kundër një aktvendimi të tillë nuk lejohet ankesë e veçantë.

### **1.5.3 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore në shumë raste vërehet mosrespektim i dispozitave për ndryshimin e padisë dhe lejimin e ndryshimit të padisë. Ka një përzierje se çka është saktësim i kërkesë-padisë - precizim dhe çka është ndryshim i padisë. Për shembull tek kompensimet e dëmeve zakonisht pas administrimit të ekspertizave të ndryshme në cilësinë e provës materiale paraqitet edhe parashtresa për ndryshimin e padisë, por që gjykatat e kalojnë këtë ndryshim vetëm duke ia dorëzuar palës së kundërt parashtresën mbi ndryshimin e padisë, pa vendosur formalisht me aktvendim mbi lejimin e ndryshimit të padisë. Është shumë me rëndësi lejimi i ndryshimit të padisë, sidomos kur ndryshimi bëhet në seancën e shqyrtimit kryesor, sepse aktvendimi mbi lejimin e ndryshimit të padisë e konfirmon se gjykata i ka vlerësuar edhe kushtet sipas të cilave rezulton se ndryshimi i padisë është i lejueshëm.

### **1.5.4 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

**Aktvendimi AC.nr.3297/14, i datës 05.06.2018**

#### **Arsyetimi**

*“Me shikim në procesverbalin e seancës se shqyrtimit kryesor të mbajtur me datën 19.06.2014, konstatohet se i autorizuari i paditësit kishte bërë ndryshim të padisë duke kërkuar borxhin edhe sa i përket periudhës kohore nga data 01.12.2010 e gjer me datën 24.05.2013, e cila nuk ka qenë e përfshirë me rastin e ushtrimit të propozimit për përmbarim, pasi që me rastin e ushtrimit të propozimit për përmbarim paditësi kishte kërkuar borxhin e krijuar gjer me datën 01.12.2010, me çka nën rrethanën e tillë gjykata e shkallës së parë në kuptim të nenit 258.1 të LPK, ka pasur për detyrim ligjor që seancën ta*

*shtynte për një ditë tjetër më qëllim që të paditurit t'i jepte kohë të nevojshme që të përgatitej për shqyrtim sipas padisë së ndryshuar.*

*Përveç kësaj gjykata e shkallës së parë pas deklarimit të të paditurit rreth ndryshimit të padisë bërë nga paditësi, ka pasur për detyrim që përmes vendimit të veçantë të vendoste rreth lejimit apo moslejimit të ndryshimit të padisë, pasi që në situatën e tillë duke marrë për bazë shumën e borxhit të kërkuar nga paditësi me rastin e ushtrimit të propozimit për përmbardim dhe periudhën kohore të borxhit të kërkuar, si dhe shumën e borxhit dhe periudhën kohore të borxhit të kërkuar me rastin e ndryshimit të padisë bërë nga paditësi në seancën e shqyrtimit kryesor, ligjërisht i bie që në rastin konkret kemi të bëjmë edhe me tejkalim të kërkesë-padisë, shkelje kjo thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika o) të LPK-së”.*

## **1.6 AKTGJYKIMI PËR SHKAK TË MOSBINDJES**

Ligji për Procedurën Kontestimore (LPK) me dispozitat e nenit 150, e ka rregulluar mënyrën dhe kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, me përmbajtje si në vijim:

*“Aktgjykimi për shkak të mosbindjes*

*Neni 150*

- 150.1 Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesë-padinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) nëse janë plotësuar këto kushte:*
- a) nëse të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjigjes në padi;*
  - b) nëse themelësia e kërkesë-padisë del nga faktet e treguara në padi;*
  - c) nëse faktet mbi të cilat mbështetet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht.*
- 150.2 Nuk do të jepet aktgjykimi për shkak të mosbindjes përkundrejt plotësimit të kushteve nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse gjykata konstaton se është fjala për kërkesën me të cilën palët nuk kanë të drejtë të disponojnë lirisht (paragrafi 3 i nenit 3 të këtij ligji).*
- 150.3 Dhënia e aktgjykimit kontumacional do të shtyhet, në qoftë se ka nevojë që për rrethanat nga paragrafi 2 i këtij neni të merren njoftime të duhura.*
- 150.4 Në qoftë se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesë-padisë, gjykata cakton seancë përgatitore dhe nëse në seancën e këtillë paditësi nuk e ndryshon padinë, jep aktgjykim me të cilin e refuzon kërkesë-padinë.*
- 150.5 Kundër aktvendimit të gjykatës me të cilin refuzohet propozimi i paditësit që të jepet aktgjykimi kontumacional, nuk lejohet ankimi.*
- 150.6 Në rastet nga paragrafi 3 i këtij neni, aktgjykimi kontumacional mund të jepet edhe pa u dëgjuar palët”.*

### **1.6.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes**

Aktgjykimi për shkak të mosbindjes është risi të cilën e ka sjellë LPK që është në fuqi. Aktgjykimi për shkak të mosbindjes është në funksion të efikasitetit të procedurave gjyqësore dhe shtimit të masave në funksion të parimit të ekonomizimit. LPK me dispozitën e nenit 150 në mënyrë specifike e ka rregulluar mundësinë e marrjes së këtij aktgjykimi.

Është me rëndësi të theksohet për praktikën gjyqësore, se ky lloj i aktgjykimit mund të merret vetëm jashtë seancës gjyqësore dhe asnjëherë në seancë gjyqësore.

Sipas dispozitës së nenit 150.1 të LKP-së përcaktohet se: “në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk paraqet në gjykatë përgjigje në padi, gjykata jep aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë me të cilën aprovon kërkesë-padinë”.

Aktgjykimin për shkak të mosbindjes do të mund ta nxjerrë gjykata, në qoftë se plotësohen disa kushte kumulative:

- Nëse të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjigjes në padi,
- Nëse themelësia e kërkesë-padisë del nga faktet e treguara në padi,
- Nëse faktet mbi të cilat mbështetet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Kushtet e lartë cituara nga ana e gjykatës duhet të vlerësohen në mënyrë kumulative dhe në mënyrë që e njëjta të mund të nxjerrë vendim për shkak të mosbindjes dhe atë jashtë seancës dhe pa propozimin e palës paditëse. Nga kjo rrjedhë se gjykata kryesisht vlerëson nëse plotësohen kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes. Është me rëndësi të theksohet se gjykata përveç kushtit që ndërlihet me përgjigjen në padi, duhet ta bëjë një vlerësim objektiv të themelësisë së kërkesë-padisë, e cila gjithsesi duhet të rezultojë si e bazuar, duke u mbështetur në faktet e treguara në padi, të cilat duhet të jenë të provuara me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Kur analizohen me kujdes kushtet kumulative që duhet të plotësohen për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, rezulton se praktika gjyqësore do të jetë e kufizuar në shumë raste për nxjerrjen e këtij aktgjykimi, pasi që në të gjitha rastet nga të cilat rrjedh se faktet do të provohen me prova të cilat nuk mund të deponohen së bashku me padinë me rastin e punimit të padisë në gjykatë, ky aktgjykim do të jetë i pamundur të nxirret.

Për shembull, në qoftë se një fakt do të provohet me dëgjimin e dëshmitarëve, ky aktgjykim nuk mund të nxirret, pastaj në qoftë se një fakt do të provohet me nxjerrjen e ekspertizës, ky aktgjykim gjithashtu nuk mund të nxirret etj.

Mosdhënia e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë - Gjykata nuk do ta nxjerrë aktgjykimin për shkak të mosbindjes pavarësisht se plotësohen kushtet, nëse konstaton se është fjala për kërkesën me të cilën palët nuk kanë të drejtë të disponojnë lirisht.

Kjo situatë është identike me të gjitha rastet në të cilat gjykata do të veprojë kryesisht kur konstaton se palët kanë pretendime të disponojnë me kërkesa të cilat nuk mund t'i disponojnë (neni 3.3 i LPK).

Shtyrja e dhënies së aktgjykimit për shkak të mosbindjes – Gjykata mund ta shtyjë dhënien e aktgjykimit për shkak të mosbindjes në qoftë se ka nevojë t'i marrë njoftimet e duhura lidhur me rrethanën nëse kërkesa e palëve është kërkesë e disponueshme për palët. Gjithmonë kjo shtyrje duhet të ndodhë në periudhën deri sa gjykata nuk u ka dërguar palëve ftesat për seancën përgatitore apo të shqyrtimit kryesor, në qoftë se nuk cakton seancë përgatitore. Kjo për arsye se siç u theksua gjykata mund ta japë këtë aktgjykim vetëm jashtë seancës.

Në çdo rast kur i padituri nuk ka dhënë përgjigje në padi, dhe që nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesë-padisë, gjykata cakton seancën përgatitore, dhe nëse në seancën e këtillë paditësi nuk e ndryshon padinë, jepet aktgjykim me të cilin refuzohet kërkesë-padia. Kjo situatë ka nevojë të sqarohet për praktikën gjyqësore, pasi që në seancën e shqyrtimit kryesor gjykata do të nxjerrë edhe prova tjera me të cilat provohen faktet e padisë e të cilat nuk i ka pasur në disponim gjykata me rastin e vlerësimit të kushteve për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë. Pra në shqyrtimin gjyqësor kërkesë-padia nga provat e administruara mund të dalë si e bazuar.

Kundër aktvendimit të gjykatës me të cilin refuzohet propozimi i paditësit që t'i jepet aktgjykimi për shkak të mosbindjes nuk lejohet ankimi. Ky përcaktim ligjor mund të krijojë hamendje në praktikën gjyqësore, pasi që mund të interpretohet se është kusht propozimi i palës paditëse për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes. Vlerësojmë se nuk është kusht propozimi i palës paditëse për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes.

### **1.6.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit janë paraqitur raste kur dispozitat e LPK-së, nga neni 150, për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes nuk janë zbatuar në mënyrë të drejtë.

Në disa raste vërehet se gjykatat nuk i kanë kushtuar vëmendjen e duhur kushteve të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për nxjerrjen e një aktgjykimi të tillë. Pra, gjykata nuk duhet të mjaftohet vetëm me rrethanën se pala e paditur nuk ka paraqitur përgjigje në padi, sepse mosdhënia e përgjigjes në padi është vetëm njëri nga kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes. Në këtë kontekst Gjykata e Apelit vlerëson se më së shumti probleme për nxjerrjen e këtij aktgjykimi janë paraqitur tek plotësimi i kushteve që kanë të bëjnë me themelësinë e kërkesës (neni 150 paragrafi 1, pika b), i LPK-së), sepse gjykatat nuk kanë vlerësuar në mënyrë të drejtë nëse themelësia e kërkesë-padisë del nga faktet e treguara në padi.

Gjykatat e shkallës së parë, duhet që në çdo rast pa përjashtim të kujdesen nëse themelësia e kërkesë-padisë del nga faktet e treguara në padi. Nga kjo rrjedh se faktet e treguara në padi duhet ta konfirmojnë themelësinë e kërkesë-padisë, e gjithashtu ato fakte duhet të jenë në harmoni me provat në shkresat e lëndës dhe të mos jenë në kundërshtim me faktet e ditura botërisht.



Për ta zhvilluar edhe më tutje idenë, mund të theksohet ose duhet të kuptohet që themelësia e kërkesë-padisë duhet të dalë nga faktet e treguara në padi të cilat duhet të provohen me provat që gjenden në shkresat e lëndës, apo faktet të jenë të ditura botërisht. Në këtë aspekt pashmangshëm del se nëse për vërtetimin e fakteve vendimtare janë propozuar mjetet provuese si: këqyrja e gjykatës në vend, nxjerrja e ekspertizës, dëgjimi i dëshmitarëve apo dëgjimi i palëve, atëherë nuk mund të nxjerret aktgjykimi për shkak të mosbindjes. Pra, si përfundim mund të theksohet se faktet vendimtare duhet të konfirmohen nga provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, të cilat gjithashtu duhet të jenë në harmoni të plotë në mes tyre.

Në proceset gjyqësore bashkëkohore, shkresat janë me rëndësi të madhe dhe kanë përdorim më të shpeshtë si mjet provues. Dokumentet ose shkresat zakonisht i kanë këto cilësi: e kanë një përmbajtje të kuptueshme lidhur me një fakt, rrethanë apo ngjarje, që kanë rëndësi për procesin gjyqësor; i kanë shenjat e shkrimit nëpërmjet të cilave është shprehur mendimi dhe, objektin mbi të cilin janë fiksuar shenjat e shkrimit që e shprehin mendimin për faktin, rrethanën apo ngjarjen. Kryesorja është përmbajtja e mendimit, nga i cili gjykata mund ta nxjerrë përfundimin për ekzistimin apo mosekzistimin e fakteve, rrethanave ose ngjarjeve.

Varësisht se cili kriter merret për bazë provat shkresore në përgjithësi ndahen në dokumente publike dhe jopublike (private), në dokumente vendore dhe të huaja, dhe sipas teorisë ndahen edhe në dispozitive dhe dokumentuese.

Dokument publik apo zyrtar, konsiderohet ai dokument shkresor i cili sipas nenit 329.1 të LPK-së, është hartuar nga organi shtetëror, në formën e caktuar, brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike.

Dokument jopublik, është çdo shkresë tjetër, e cila nuk mund të përfshihet me definicionin e dokumenti publik, siç e parasheh dispozita e nenit 329.1 e LPK-së.

LPK me dispozitën e nenit 101.1, i jep mundësi palës që dokumentin e bashkëngjitur ta paraqes në mënyrë alternative në origjinal, ose të përshkruar apo fotokopje, por aktgjykimi për shkak të mosbindjes mund të merret vetëm nëse dokumentet (provat) janë në origjinal, sepse në këtë fazë të procedurës gjykata nuk e ka deklarimin e palës së kundërt.

### **1.6.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

**Aktvendimi AC.nr.2827/16, i datës 14.09.2017**

#### **Arsyetim**

*“Gjykata e Apelit duke e ekzaminuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të ankesës, gjen se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë në këtë çështje juridike kontestuese nuk është i pranueshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika h) e LPK-së.*

*Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (h) e LPK-së, sepse në kundërshtim me dispozitat e LPK-së, gjykata ka nxjerrë aktgjykimin për shkak të mosbindjes. Aktgjykimi i atakuar është marrë në kundërshtim me dispozitat e LPK-së nga neni 150 paragrafi 1 pika (b) dhe (c).*

*Aktgjykimi për shkak të mosbindjes, mund të nxjerret në rastet kur i padituri brenda afatit të përcaktuar me ligj nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, me kusht që në mënyrë kumulative të plotësohen edhe kushtet e përcaktuara me pikën (a), (b) dhe (c) të paragrafit 1 të nenit 150 të LPK-së.*

*Në rastin konkret nuk është plotësuar kushti i përcaktuar me dispozitën e nenit 150 paragrafi 1 pika (b), prej nga rrjedh se themelësia e kërkesë-padisë duhet të dalë nga faktet e treguara në padi, ndërsa me pikën (c) përcaktohet se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesë-padia nuk duhet të jenë në kundërshtim me provat të cilat i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi në cilësinë e provës e ka propozuar dëgjimin e paditësit për ta vërtetuar faktin që i referohet, sipas paditësit diferencës prej 75kg të duhanit të dorëzuar. Nga ky propozim rrjedh se në momentin kur gjykata e ka nxjerrë aktgjykimin për shkak të mosbindjes nuk e ka pasur të provuar faktin që i referohet diferencës së duhanit të dorëzuar nga e paditura tek paditësi sepse dëgjimi i palës apo palëve mund të bëhet vetëm në seancën e shqyrtimit kryesor. Nga kjo rrjedh se, gjykata ka nxjerrë aktgjykim për shkak të mosbindjes në kundërshtim me dispozitat e sipër cituara, e për arsye të theksuara më lartë.*

*Meqenëse aktgjykimi për shkak të mosbindjes është marrë pa u plotësuar kushtet e kërkuara, Gjykata e Apelit është mjaftuar me shkeljet në të cilat është përfshirë ky aktgjykim për ta kthyer çështjen në rishqyrtim, andaj nuk është lëshuar në vlerësimet e tjera për gjendjen faktike apo të drejtën materiale”.*

## **Aktvendimi AC.nr. 3674/13 i datës 12.05.2016**

### **Arsyetimi**

*“Gjykata e Apelit e ka pranuar pretendimin ankimor të paditësit se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (h) e LPK-së, pasi që në këtë çështje sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk janë plotësuar kushtet që gjykata e shkallës së parë ta nxjerrë aktgjykimin për shkak të mungesës”.*

*Sipas dispozitës së nenit 151 paragrafi 1 i LPK-së, përcaktohet se: “Kur të paditurit padia nuk i është dorëzuar për përgjigje, por vetëm bashkë me letërthirrje për seancë përgatitore, e ai nuk vjen në seancë deri në përfundimin e saj, apo në seancën e parë për shqyrtim kryesor, nëse seanca përgatitore nuk është caktuar fare, gjykata me propozimin e paditësit apo sipas detyrës zyrtare e jep aktgjykimin me të cilin aprovohet kërkesë-padia (aktgjykimi për shkak të mungesës) nëse plotësohen këto kushte:*

*a). Nëse i padituri është thirrur rregullisht për në seancë; b). Nëse i padituri nuk e ka kontestuar kërkesë-padinë me anë të parashtrësës; c). Nëse themelësia e kërkesë-padisë del nga faktet e treguara në padi; d). Nëse faktet në të cilat bazohet kërkesë-padia nuk janë në*

*kundërshtim me provat e paraqitura nga vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht; e). Nëse nuk ekzistojnë rrethana notore nga të cilat del përfundimi i arsyeshëm se e kanë penguar të paditurin shkaqe të arsyeshme që të vijë në seancë”.*

*Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të sipër cituara, pasi që nuk ka vlerësuar në mënyrën e duhur se a plotësohen kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës. Kushtet e përcaktuara me dispozitën e nenit 151 paragrafi 1 të LPK-së duhet të plotësohen në mënyrë kumulative në mënyrë që gjykata të mund ta nxjerrë aktgjykimin për shkak të mungesës. Sipas dispozitës së nenit 151 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, përcaktohet se njëri prej kushteve është që i padituri të mos e ketë kontestuar kërkesë-padinë me anë të parashtrësës. Në këtë rast nuk është plotësuar ky kusht i cili duhet të plotësohet kumulativisht me kushtet tjera, pasi që i padituri me parashtrësën e datës 08.06.2011, në gjykatën e shkallës së parë, e ka paraqitur kundërshtimin kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarrimit Ekz.nr.704/08, të datës 13.10.2008. Kundërshtimin e paraqitur nga ana e debitorit, gjykata e shkallës së parë është dashur ta trajtojë si kundërshtim të kërkesë-padisë nga ana e të paditurit, sepse procesi gjyqësor në këtë çështje është unik pavarësisht se është filluar sipas propozimit për përmbarrim.*

*Përveç të cekurave, edhe po të plotësohej ky kusht, gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme edhe për kushtet e tjera, sidomos për themelësinë e kërkesë-padisë dhe përputhshmërinë e fakteve me provat në shkresat e lëndës”.*

## **1.7 AKTGJYKIMI PËR SHKAK TË MUNGESËS**

Ligji për Procedurën Kontestimore, me dispozitat e nenit 151, e ka rregulluar nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës me përmbajtje si në vijim:

“Neni 151

*151.1 Kur të paditurit padia nuk i është dërguar për përgjigje, por vetëm bashkë me letërthirrje për në seancë përgatitore, e ai nuk vjen në seancë deri në përfundimin e saj, apo në seancën e parë për shqyrtim kryesor, nëse seanca përgatitore nuk është caktuar fare, gjykata, me propozimin e paditësit apo sipas detyrës zyrtare e jep aktgjykimin me të cilin aprovohet kërkesë-padia (aktgjykimin për shkak të mungesës) Nëse plotësohen këto kushte:*

- a) nëse i padituri është thirrur rregullisht për në seancë;*
- b) nëse i padituri nuk e ka kontestuar kërkesë-padinë me anë të parashtrësës;*
- c) nëse themelësia e kërkesë-padisë del nga faktet e treguara në padi;*
- d) nëse faktet në të cilat bazohet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat e paraqitura nga vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht;*
- e) nëse nuk ekzistojnë rrethana notore nga të cilat del përfundimi se e kanë penguar të paditurin shkaqe të arsyeshme që të vijë në seancë.*

*151.2 Nuk do të jepet aktgjykimin për shkak të mungesës përkundrejt plotësimin të kushteve nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse gjykata konstaton se është fjala për kërkesën me të cilën palët nuk kanë të drejtë të disponojnë lirish (paragrafi 3 neni 3 i këtij ligji).*

151.3 Dhënia e aktgjykimit për shkak të mungesës shtyhet nëse ka nevojë që për rrethanat e paragrafit 2 të këtij neni të merren njoftimet e duhura.

151.4 Nëse nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesë-padisë, kurse padia në seancën gjyqësore nuk është ndryshuar nga pala paditëse, gjykata do ta japë aktgjykimin me të cilin refuzohet kërkesë-padia si e pa themeltë.

151.5 Kundër aktvendimit me të cilin refuzohet propozimi i paditësit për dhënien e aktgjykimit për shkak të mungesës nuk lejohet ankimi.

151.6 Në rastet e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni aktgjykimin për shkak të mungesës gjykata mund ta japë pa dëgjimin e palëve”.

### 1.7.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave të sipër cituara

Me aktgjykim për shkak të mungesës kuptojmë atë aktgjykim me të cilin pranohet si e themeltë kërkesë-padia e përmbajtur në padinë e ngritur kundër të paditurit i cili nuk mbrohet nga ajo, nuk e kundërshton kërkesë-padinë me veprim të shkruar dhe mungon në seancën përgatitore, apo në qoftë se nuk është mbajtur kjo, nga seanca e parë për shqyrtim kryesor, e paditësi i pranishëm e propozon dhënien e tij apo gjykata sipas detyrës zyrtare e jep këtë aktgjykim. Aktgjykimi për shkak të mungesës është paraparë me dispozitat e nenit 151 të LPK-së. Në qoftë se krahasohen kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës dhe aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë do të vërehet se ekzistojnë disa ngjashmëri por edhe disa dallime esenciale.

Kështu gjykata do të nxjerrë aktgjykim për shkak të mungesës, kur të paditurit nuk i është dërguar padia për përgjigje, por vetëm bashkë me letërthirrje për seancë përgatitore apo në seancën e parë të shqyrtimit kryesor, në qoftë se seanca përgatitore nuk është caktuar fare, ndërsa i padituri nuk vjen deri në përfundimin e seancës, atëherë gjykata me propozimin e paditësit apo sipas detyrës zyrtare e jep aktgjykimin me të cilin e aprovon kërkesë-padinë nëse plotësohen edhe këto kushte:

- nëse i padituri është thirrë rregullisht në seancë;
- nëse i padituri nuk e ka kontestuar kërkesë-padinë me anë të parashtresës,
- nëse themelësia e kërkesë-padisë del nga faktet e treguara në padi,
- nëse faktet në të cilat bazohet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat e paraqitura nga vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht,
- nëse nuk ekzistojnë rrethana notore nga të cilat del përfundimi se e kanë penguar të paditurin shkaqe të arsyeshme që të vijë në seancë.

Kushtet për dhënien e aktgjykimit për shkak të mungesës, duhet të kuptohen si prezumime procedurale dhe materiale, që duhet të plotësohen përveç prezumimeve që duhet të plotësohen për çdo aktgjykim.

Është me rëndësi të theksohet se, gjykata duhet t’ia kushtojë vëmendjen e duhur plotësimin të kushteve siç kërkohen, e veçanërisht gjykata duhet ta bëjë një vlerësim objektiv të themelësisë së kërkesë-padisë e cila gjithsesi duhet të rezultojë si e bazuar, duke u mbështetur në faktet e treguara në padi të cilat duhet të jenë të provuara me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Në këtë pikë vërehen zakonisht dobësitë e vendimeve të cilat merren për shkak të mungesës.

Mosdhënia e aktgjykimit për shkak të mungesës - Gjykata nuk do ta nxjerrë aktgjykimin për shkak të mungesës pavarësisht se plotësohen kushtet, nëse konstatohet se është fjala për kërkesën me të cilën palët nuk kanë të drejtë të disponojnë lirisht. Kjo situatë është identike me të gjitha rastet në të cilat gjykata do të veprojë kryesisht kur konstaton se palët kanë pretendime të disponojnë me kërkesa që nuk mund t'i disponojnë.

Shtyrja e dhënies së aktgjykimit për shkak të mungesës – Gjykata mund ta shtyjë dhënien e aktgjykimit për shkak të mungesës, në qoftë se ka nevojë t'i marrë njoftimet e duhura lidhur me rrethanën nëse kërkesa e palëve është kërkesë e disponueshme për palët.

Gjykata me aktvendim e refuzon propozimin e palës për dhënien e aktgjykimit për shkak të mungesës, kundër të cilit nuk lejohet ankesë.

Duhet theksuar se dispozita e nenit 151 të LPK-së, të cilat e parashohin mundësinë e marrjes së aktgjykimit për shkak të mungesës, nuk janë duke e gjetur zbatimin e duhur, pasi që njëri ndër kushtet për dhënien e këtij aktgjykimi është që gjykata fare mos t'i ketë dërguar të paditurit aktvendim për përgjigje në padi, ndërsa LPK-ja, në anën tjetër parashih detyrimin e gjykatës që palës së paditur t'ia dërgojë aktvendimin për përgjigje në padi. LPK-ja nuk ka dispozita me të cilat e qartëson saktësisht se në cilat raste gjykata mund fare mos t'ia dërgojë palës së paditur aktvendimin për përgjigje në padi.

Vlerësojmë se, aktgjykimi për shkak të mungesës më së shumti mund të gjejë zbatim të kontestet me vlerë të vogël.

### **1.7.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit pavarësisht se numri i rasteve me ankesa kundër aktgjykimit për shkak të mungesës është i vogël, vërehen gabime në zbatimin e dispozitave ligjore të sipër cituara. Disa nga gabimet në zbatimin e dispozitave për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës kanë të bëjnë me momentin kur mund të konstatohet nxjerrja e këtij aktgjykimi nga ana e gjykatës, pastaj me rrethanën se duhet apo nuk duhet të mbahet seancë në mungesë e pastaj të konstatohet nxjerrja e aktgjykimit në mungesë, si dhe nevoja që provat të administrohen dhe të konstatohen në procesverbal.

Është me rëndësi të theksohet se, në rastet kur i padituri nuk prezanton në seancë dhe gjykata konstaton se plotësohen kushtet nga neni 151 paragrafi 1, pika a) *nëse i padituri është thirrur rregullisht për në seancë; b) nëse i padituri nuk e ka kontestuar kërkesë-padinë me anë të parashtresës; c) nëse themelësia e kërkesë-padisë del nga faktet e treguara në padi; d) nëse faktet në të cilat bazohet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat e paraqitura nga vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht; e) nëse nuk ekzistojnë rrethana notore nga të cilat del përfundimi se e kanë penguar të paditurin shkaqë të arsyeshme që të vijë në seancë*, atëherë gjykata me propozimin e palës paditëse apo edhe zyrtarisht, pasi konstaton prezencën e palëve, respektivisht mosprezencën e të paditurit me shpjegimin se i është dërguar padia së bashku me ftesë për seancë dhe mungesën nuk e ka arsyetuar (*pasi vlerëson edhe kushtet tjera*), në procesverbal konstaton drejtpërdrejt nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës.

Nga kjo rrjedh se, gjykata nuk duhet të vendosë që seancën ta mbajë në mungesë sepse po vendosi që seancën ta mbajë në mungesë atëherë është e pamundur nxjerrja e aktgjykimit për shkak të mungesës.

Gjykata nuk duhet t'i lexojë-administrojë provat sepse pamundësohet nxjerrja e aktgjykimit për shkak të mungesës.

Nëse shikohen me hollësi kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës, rezulton se gjykata për kushtet nga neni 151 paragrafi 1, pika c) *nëse themelësia e kërkesë-padisë del nga faktet e treguara në padi;* d) *nëse faktet në të cilat bazohet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat e paraqitura nga vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht;* e) *nëse nuk ekzistojnë rrethana notore nga të cilat del përfundimi se e kanë penguar të paditurin shkaqe të arsyeshme që të vijë në seancë,* duhet të ketë vlerësim konkludent se plotësohen kushtet, sepse rëndom nuk konstatohen në procesverbal arsye për mënyrën e plotësimit të kushteve. Arsyetimi pastaj pason në vendimin e veçantë i cili duhet të arsyetohet sikurse çdo aktgjykim tjetër por duke dhënë arsye shtesë për kushtet procedurale që lidhen me nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

### 1.7.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit

**Aktvendimi AC.nr. 3674/13, i datës 12.05.2016**

#### **Arsyetimi**

*“Gjykata e Apelit e ka pranuar pretendimin ankimor të paditësit se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (h) e LPK-së, pasi që në këtë çështje sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk janë plotësuar kushtet që gjykata e shkallës së parë të nxjerrë aktgjykim për shkak të mungesës.*

Sipas dispozitës së nenit 151 paragrafi 1 i LPK-së përcaktohet se: *“Kur të paditurit padia nuk i është dorëzuar për përgjigje, por vetëm bashkë me letërthirrje për seancë përgatitore e ai nuk vjen në seancë deri në përfundimin e saj, apo në seancën e parë për shqyrtim kryesor, nëse seanca përgatitore nuk është caktuar fare, gjykata me propozimin e paditësit apo sipas detyrës zyrtare e jep aktgjykimin me të cilin aprovohet kërkesë-padia (aktgjykimi për shkak të mungesës) nëse plotësohen këto kushte:*

*a). Nëse i padituri është thirrur rregullisht për në seancë; b). Nëse i padituri nuk e ka kontestuar kërkesë-padinë me anë të parashtrësës; c). Nëse themelësia e kërkesë-padisë del nga faktet e treguara në padi; d). Nëse faktet në të cilat bazohet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat e paraqitura nga vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht; e). Nëse nuk ekzistojnë rrethana notore nga të cilat del përfundimi i arsyeshëm se e kanë penguar të paditurin shkaqe të arsyeshme që të vijë në seancë”.*

*Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të sipër cituara, pasi që nuk ka vlerësuar në mënyrën e duhur se a plotësohen kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës. Kushtet e përcaktuara me dispozitën e nenit 151 paragrafi 1 të LPK-së duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, në mënyrë që gjykata të mund ta nxjerrë aktgjykimin për shkak të mungesës. Sipas dispozitës*

së nenit 151 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, përcaktohet se njëri prej kushteve është që i padituri të mos e ketë kontestuar kërkesë-padinë me anë të parashtresës. Në këtë rast nuk është plotësuar ky kusht i cili duhet të plotësohet kumulativisht me kushtet tjera, pasi që i padituri me parashtresën e datës 08.06.2011, në gjykatën e shkallës së parë e ka paraqitur kundërshtimin kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarrimit Ekz.nr.704/08, të datës 13.10.2008. Kundërshtimin e paraqitur nga ana e debitorit gjykata e shkallës së parë është dashur ta trajtojë si kundërshtim të kërkesë-padisë nga ana e të paditurit, sepse procesi gjyqësor në këtë çështje është unik pavarësisht se është filluar sipas propozimit për përmbarrim.

Përveç të cekurave, edhe po të plotësohej ky kusht gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme edhe për kushtet e tjera sidomos për themelësinë e kërkesë-padisë dhe përputhshmërinë e fakteve me provat në shkresat e lëndës.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të sipër cituara, të cilat në riprocedurë duhet të eliminohen në atë mënyrë që udhëzohet gjykata e shkallës së parë, që me rastin e shqyrtimit të çështjes ta caktojë shqyrtimin gjyqësorë, t'i vlerësojë të gjitha faktet me rëndësi vendimtare sipas kërkesave dhe kundërshtimeve të palëve, me prova përkatëse dhe pas administrimit dhe vlerësimit të tyre të vendosë në mënyrë meritore për themelësinë e kërkesë-padisë duke nxjerrë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë”.

## 1.8 ARSYETIMI I AKTGJYKIMIT

Ligji për Procedurën Kontestimore me dispozitat e nenit 164 paragrafi 4 dhe 5 ka përcaktuar se arsyetimi i aktgjykimit përmban (160.4): “Kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar palët, provat që i kanë propozuar palët, cilat fakte i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, cilat prova i ka shfrytëzuar gjykata, dhe si i ka vlerësuar ato, dhe nëse i ka vërtetuar faktet me anë të provave”, ndërsa (160.5):” Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë më herët gjatë procesit gjyqësor”.

### 1.8.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave lidhur me arsyetimin e aktgjykimit

Përmbajtjen materiale të aktgjykimit e përbëjnë pjesët përbërëse të aktgjykimit të përpiluar me shkrim. Përmbajtjen materiale e përbën përmbajtja e vendimit me të cilin pranohet apo refuzohet kërkesë-padia.

Çdo gjyqtar duhet të ketë pikësynim që me rastin e vendosjes në një çështje juridike civile, përveç se të vendosë drejtë dhe ligjshëm vendimi i gjykatës të jetë edhe bindës. Komponent e padiskutueshme për të krijuar besueshmëri në objektivitetin e gjykatës dhe ligjshmërinë e vendimeve të gjykatës është arsyetimi i aktgjykimit. Përmes arsyetimit të aktgjykimit duhet të prezantohet në mënyrë të besueshme një pamje e gjithë procesit gjyqësor, duke përfshirë edhe konkludimet e gjykatës.

LPK, me dispozitën e nenit 160 paragrafi 4, përcakton se: *“Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato”*, ndërsa në paragrafin 5 të nenit të njëjtë përcaktohet se:

*“Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë më herët gjatë procesit gjyqësor”*.

Duke iu referuar dispozitës së cituar për arsyetimin e aktgjykimit mund të konkludojmë se, ligjdhënësi përveç strukturës së aktgjykimit apo pjesës formale, ka përcaktuar edhe kornizat e përmbajtjes së aktgjykimit, veçanërisht të arsyetimit të aktgjykimit.

Përmes përmbajtjes së përcaktuar janë saktësuar hapa që duhet të ndjekë gjykata gjatë arsyetimit të aktgjykimit në mënyrë që të sigurohemi se përmes aktgjykimit përveç se do të vendoset drejtë dhe ligjshëm një çështje kontestuese, të sigurohet edhe besimi se gjykata ka vendosur drejtë dhe ligjshëm.

Hapat që duhet ndjekur gjatë arsyetimit të aktgjykimit janë të renditur sipas një kronologjie logjike dhe juridike, në mënyrë që përmes arsyetimit të prezantohet figura e plotë e çështjes kontestuese dhe vlerësimi respektivisht përfundimi i gjykatës.

Praktika gjyqësore është e prerë sa i përket arsyetimit të aktgjykimit, respektivisht përmbajtjes që duhet të ketë arsyetimi i aktgjykimit, sipas dispozitave të cituara nga neni 160 paragrafi 4 dhe 5 i LPK-së.

Dispozitat e LPK-së, për përmbajtjen e arsyetimit të aktgjykimit në fakt vendosin kornizat, respektivisht hapat që duhet ndjekur gjatë arsyetimit të aktgjykimit, mirëpo është po ashtu me rëndësi të merret në konsideratë fakti se arsyetimi i aktgjykimit diktohet në një farë mase edhe nga kërkesat dhe pretendimet e palëve ndërgjyqësore. Prandaj, gjykata në arsyetimin e aktgjykimit përveç se duhet të ndjekë secilin hap në procesin e arsyetimit, ajo duhet ta japë arsyetimin e saj edhe duke u fokusuar në kërkesat respektivisht pretendimet e palëve ndërgjyqësore.

Hapi i parë me të cilin tregohet objektiviteti i gjykatës lidhur me vendosjen e çështjes kontestuese në një farë mënyre është paraqitja e kërkesave të palëve. Në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit që i referohet paraqitjes së kërkesave të palëve, gjykata duhet të paraqesë në mënyrë objektive kërkesat e palëve, realisht secilën kërkesë dhe secilin pretendim, sepse nga kërkesat dhe pretendimet e palëve ndërgjyqësore rrjedhë pastaj edhe epilogu i arsyetimit të aktgjykimit.

Paraqitja e fakteve dhe provave që i kanë propozuar palët: në arsyetimin e aktgjykimit i referohet fakteve që palët i kanë parashtruar, dhe provat që i kanë propozuar palët për vërtetimin e fakteve të propozuara.



Me dispozitën e nenit 7 paragrafi 1, i LPK-së, është përcaktuar se: “*Palët kanë për detyrë t’i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*”, ndërsa me dispozitën e nenit 319 paragrafi 1, të LPK-së, është përcaktuar se: “*Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë t’i provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*”. Nga këto dy dispozita rrjedh se, në sistemin tonë të procedurës kontestimore dominon sistemi i bazuar në parimin e shqyrtimit, sepse palëve u takon e drejta ekskluzive që t’i parashtrorjnë faktet të cilat gjykata do t’i marrë për në themel të vendimit të saj.<sup>2</sup>

Ky hap i arsyetimit të aktgjykimit është tejet me rëndësi, sepse mbi bazën e fakteve dhe provave të paraqitura nga palët ndërgjyqësore, gjykata do ta japë edhe vlerësimin për themelësinë e kërkesë-padisë. Është po ashtu me rëndësi paraqitja e besueshme e fakteve dhe provave të propozuara nga palët ndërgjyqësore, sepse nëse gjykata nuk i përshkruan të gjitha faktet e paraqitura nga palët, ka gjasa që aktgjykimi të jetë i përfshirë në kontradikcion të fshehtë, çka ndikon drejtpërdrejt në ligjshmërinë e aktgjykimit.

Paraqitja e fakteve me korrektësi nga ana e gjykatës në këtë pjesë të arsyetimit të aktgjykimit, pikërisht ashtu siç palët i kanë parashtruar, jep një mundësi që lehtësisht të vlerësohet ligjshmëria dhe besueshmëria e aktgjykimit. Kjo për faktin se mbi bazën e fakteve dhe provave të paraqitura nga palët do të pasojnë hapat tjerë të vërtetimit të fakteve vendimtare dhe pastaj të kualifikimit të fakteve vendimtare në raport me normat materialo-juridike të cilat e japin e përfundimin për themelësinë e kërkesë-padisë.

Specifikimi se cilat nga faktet e tilla janë vërtetuar, dhe arsyet përse janë vërtetuar ato fakte: Ka një diferencë në mes të fakteve të paraqitura respektivisht të propozuara nga palët ndërgjyqësore dhe fakteve të vërtetuara, sepse është në diskrecionin e gjykatës të vendosë se cilat nga faktet e propozuara kanë peshën e “fakteve vendimtare” e të cilat duhet të vërtetohen.

Gjatë shqyrtimit gjykata varësisht nga vlerësimi i saj bën një lloj “*klasifikimi*” të fakteve në mes të atyre që kanë rëndësi për t’u provuar dhe atyre jo vendimtare.

Në këtë hap të arsyetimit të aktgjykimit, gjykata specifikon se cilat fakte janë vërtetuar dhe rrjedhimisht jep arsyetimin se përse janë vërtetuar ato fakte. Sigurisht për të vlerësuar se cilat fakte duhet të vërtetohen gjykata mbështetet në disa rrethana që kanë të bëjnë me natyrën e çështjes kontestuese, bazës juridike të cilës i është referuar pala, rrethanave kontestuese, etj.<sup>3</sup>

---

<sup>2</sup> Siç vërehet nga dispozita e cituar lidhur me paraqitjen e fakteve të çështjes mund të konkludojmë se parimisht vlen parimi i shqyrtimit, që nënkupton se përgjegjësia për prezantimin e fakteve u takon palëve, ndërsa si përjashtim gjykatës i është dhënë mundësia e konstatimit të fakteve, nëse palët provojnë të disponojnë me kërkesa që nuk mund t’i disponojnë. Ndryshe qëndron situata sa i përket marrjes së provave për vërtetimin e fakteve, sepse edhe marrja e provave do të duhet të jetë analoge me mënyrën e paraqitjes së fakteve, por ligjdhënësi ka bërë një përjashtim të dispozita e nenit 356 kur ka përcaktuar marrjen e provës me ekspertizë edhe ex officio, pa e kufizuar marrjen e kësaj prove vetëm për vërtetimin e fakteve që kanë të bëjnë me kërkesat e padisponueshme.

<sup>3</sup> Objekt i të provuarit mund të jetë një fakt ose tërësia e fakteve juridike që janë vendimtare për pranimin e padisë, të prapësimeve ose të kundërpadisë dhe për zgjidhjen e çështjes nga gjykata. Objekti i të provuarit nuk është çdo fakt që pretendohet nga palët, por vetëm ato fakte juridike që janë të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes nga gjykata.

Sipas dispozitës së nenit 319.2 të LPK, duhet të provohen të gjitha faktet të cilat janë të rëndësishme për dhënien e vendimit. Është detyrë e gjyqtarit apo e trupit gjykues që nga një numër i madh i fakteve, të cilat i kanë theksuar

Përshkrimin se si janë vërtetuar ato fakte, nëse faktet janë vërtetuar me anë të provave, duhet të saktësohet se cilat prova i ka shfrytëzuar gjykata dhe si i ka vlerësuar ato.

Edhe pse në disa raste e përbëjnë thelbin e padisë, të kundërpadisë apo të prapësimeve, disa fakte nuk ka nevojë të provohen, dhe atë: *Faktet e ditura botërisht dhe ato të vërtetuara nga gjykata në gjykimin e mëhershëm, faktet e pranuar (pohuara) dhe faktet e prezumuara me ligj.*

Faktet e njohura botërisht nuk kanë nevojë të provohen, për shkak se ato njihen prej një rrethi të gjerë personash.

Pohimi i fakteve është veprim procedural i njëanshëm me të cilin pala deklaron se janë të vërteta për disa apo tërë faktet në të cilat kundërshtari i saj e bazon kërkesën e tij. Sipas nenit 321 paragrafi 2 të LPK nuk duhet të provohen faktet të cilat i ka pranuar pala para gjykatës gjatë procesit gjyqësor. Motivi i pranimit të fakteve zakonisht është relevant dhe gjykata nuk është e detyruar ta vërtetojë saktësinë e atij fakti, përveç në rastet kur bindet se pranimi i fakteve bëhet me qëllim të disponimit të palejueshëm – zbatimi i nenit 3 paragrafi 3 të LPK. Në këtë rast gjykata vërtetësinë e tyre e bën me mjetet provuese që i ka në dispozicion.

Objekt i të provuarit nuk mund të jetë as fakti, ekzistimin e të cilit ligji e prezumon. Prezumimi ligjor i fakteve përfaqëson rregullin sipas të cilit gjykata është e detyruar që ta marrë si ekzistues një fakt (fakt i prezumuar) nëse vërtetohet se ekziston një fakt tjetër i përcaktuar nga ligji. Ekzistojnë ligje përkatëse që përmbajnë dispozita për faktet e prezumuara. *P.sh., Ligji për Familjen (neni 99)* prezumon se i ati i fëmijës është personi i cili është në martesë me nënën e fëmijës 300 ditë para lindjes së fëmijës.

Në faktet e prezumuara nga ligji, barra e të provuarit bie në palën e cila e konteston ekzistimin e fakteve të tilla.

Marrja e provave është veprim procedural i gjykatës me anën e së cilit ajo merr dijeni për bazat e të provuarit nga mjetet provuese. Gjykata cakton rrethin e fakteve që duhet të provohen, lloji i provave që do të lejohen për vërtetimin e tyre, caktohet mënyra, koha dhe vendi i marrjes së provave.

---

palët, t'i ndajë ato të cilat janë të rëndësishme për të vendosur lidhur me çështjen juridike kontestimore. Nga faktet relevante, për të cilat ligji e lidhë pasojën juridike, objekt i të provuarit bëhen vetëm ato që janë kontestuese midis palëve.

Gjykata është ajo që vendos se cilat fakte duhet provuar dhe cilat prova do të merren për vërtetimin e tyre. Kjo i jep mundësinë gjykatës që sipas bindjes së lirë ta caktojë rrethin e fakteve juridike të cilat i konsideron të rëndësishme për marrjen e vendimit dhe të përqendrohet në provimin e tyre. Sipas kësaj gjykata ka mundësi që mos t'i marrë për bazë faktet që nuk kanë ndonjë rëndësi për çështjen dhe me atë rast t'i refuzojë propozimet e palëve me të cilat kërkojnë vërtetimin e këtyre fakteve.

Ekzistojnë raste kur objekt i të provuarit nuk janë drejtpërdrejtë faktet, por janë pretendimet e palëve për ekzistimin apo mosekzistimin e fakteve juridike, nga të cilat varet zbatimi i normave të së drejtës materiale në procesin kontestimor gjyqësor. Ky është quajtur fakt negativ. Vërtetimi i vërtetësisë së pretendimit mohues negativ, mund të bëhet vetëm në mënyrë të tërthortë, me anë të konstatimit të ekzistimit të faktit që e përjashton ekzistimin e përnjëhershëm të faktit të kontestuar.

Pra duke i pasur parasysh të gjitha këto rrethana gjykata gjatë gjykimin ka vlerësuar se cilat fakte duhet të provohen dhe ato fakte i paraqet në arsyetimin e vendimit. Natyrisht gjykata duhet të ketë edhe një arsyetim të veçantë pse disa fakte të paraqitura nga palët ka refuzuar t'i provojë.

Vërtetimin e fakteve kontestuese gjykata e bën përmes mjeteve provuese. Mjet provues (provë) quhet çdo burim, nga i cili me anë të organeve të shqisave nxjerrim njohuri për vërtetësinë e thënies se ekziston apo nuk ekziston një fakt për të cilin lidhet pasoja e caktuar juridike.

Mjetet provuese janë të parashikuara në dispozita të veçanta të LPK sipas llojit të tyre. Këto mjete janë: Këqyrja në vend, shkresat, dëshmitarët, ekspertët dhe dëgjimi i palëve. Siç shihet lloji i provave varet nga lloji i burimeve të parashikuara në ligj.

Varësisht nga mënyra se si janë vërtetuar faktet do të jetë edhe arsyetimi i aktgjykimit. Posaçërisht tek faktet kontestuese të cilat rëndom vërtetohen përmes mjeteve provuese gjykata duhet të ketë një arsyetim të zgjeruar dhe atë duke arsyetuar specifikisht secilin fakt kontestues dhe provën e administruar, me të cilën është vërtetuar secili fakt. Gjykata në këtë hap të arsyetimit duhet ta ketë edhe një vlerësim/arsyetim për vlerën provuese/fuqinë provuese të secilës provë të administruar, dhe rrjedhimisht besueshmërinë e saj.

Sistemi ynë i procedurës kontestimore i përket sistemeve që çmuarjen e provave e bënë në bazë të bindjes së lirë. Në sistemin e vlerësimit lirisht të provave nuk parashikohen rregulla procedurale për zgjedhjen, shfrytëzimin dhe fuqinë provuese të mjeteve provuese. Gjykata, sipas këtij sistemi, nuk është e lidhur e as e kufizuar me rregulla të posaçme formale për të provuarit. Pretendimin e caktuar gjykata e merr si të provuar vetëm pasi të jetë bindur në saktësinë e tij (në bazë të provave të shfrytëzuara dhe të vlerësuara).

Gjykata është e lirë ta vlerësojë rezultatin e hetimit gjyqësor, dhe të vendos për themelin e çështjes. Vlerësimi i lirë i provave nga gjykata, kërkon një kujdes të veçantë në respektimin e rregullave dhe kufijve të caktuar për këtë qëllim, si dhe përdorimi me efektivitet i eksperiencës. Gjykatësi duhet të ruhet nga ajo që quhet interpretim personal i tij, në drejtim të vlerësimit subjektiv e të njëanshëm të provave dhe të pranimit të konkluzioneve të nxjerra nën influencën e të dhënave të marra privatisht prej tij ose të ofruara nga palët, e që nuk i janë nënshtruar debatit gjyqësor. Del i domosdoshëm formimi i një disipline të fortë juridike në vlerësimin e provave, ku si çështje bazë duhet të jetë formimi dhe konsolidimi i provës në procesin e përpjekjes së dy të kundërtave. Çdo cenim i këtyre rregullave shpie në varfërimin e vlerës ligjor të gjykimit.

Përshkrimet e dëshmive duhet të jenë të arsyetuara dhe të strukturuara në mënyrë që të tregojnë se gjykata i konsideron ato bindëse, bashkë me arsyet për një përfundim të tillë. Për shembull, kur gjykata të konstatojë se pretendimi i një pale nuk është i pranueshëm, ajo duhet të arsyetojë vendimin duke cituar dëshmi konkrete, duke paraqitur referenca për kundërthëniet në mes të dëshmitarëve dhe dëshmitë e tjera materiale të cilat e kanë çuar gjykatën deri tek një përfundim i caktuar. Në këtë mënyrë, gjykata po ashtu bënë një vlerësim të dëshmive të pranuar. Gjykata po ashtu, në mënyrë të veçantë do ta vlerësojë besueshmërinë e dëshmive kundërthënëse, arsyet për mosaprovimin e kërkesave individuale të palëve dhe arsyet me të cilat është udhëhequr gjykata në përcaktimin e pikave të ligjit e veçanërisht, në përcaktimin se a ekziston detyrimi ligjor.

Gjykata nuk do ta krijojë besimin thjeshtë duke e përshkruar arsyetimin e saj për pranimin e dëshmive ose argumenteve pa sqaruar se pse dëshmitë ose argumentet kundërthënëse nuk kanë qenë bindëse. Arsyetimi i vendimit duhet ta pasqyrojë në mënyrë të qartë paanshmërinë e gjykatës kur ajo i sjellë përfundimet e veta. Një prej standardeve të procesit

racional ligjor përfshinë respektimin e parimit të barazisë që aplikohet për të dyja palët në një kontest. Rrjedhimisht, ky standard është i lidhur ngushtë me paanshmërinë dhe objektivitetin e gjykatës, dhe duhet të pasqyrohet jo vetëm në procedurat gjyqësore por edhe në arsyetimin e vendimit përfundimtar të gjykatës.

Dispozitat e së drejtës materiale të cilat janë zbatuar në nxjerrjen e aktgjykimit: Në pjesën e analizës për përfundimin e gjykatës lidhur me themelin e kërkesë-padisë përveç hapave tjerë të arsyetimit të përshkruar më lartë, pjesa e përshkrimit të dispozitave materialo-juridike për rastin konkret është tejet e rëndësishme, sepse përmes zbatimit të normës materiale do të përcaktohet, nëse rrethanat faktike të çështjes kontestuese konsumojnë elementet e normës juridike për mbrojtjen gjyqësore të kërkuar.

Praktika gjyqësore është mjaft rigoroze në këtë pikë dhe realisht e konsideron si pjesë qenësore të arsyetimit të aktgjykimit referencën e gjykatës në normën materialo-juridike, në të kundërtën aktgjykimit do ta kualifikojë në shkelje për të cilat çështja kthehet në rishqyrtim.

Është e domosdoshme referenca në normën materialo-juridike, sepse në këtë mënyrë tregohet burimi i së drejtës dhe rrjedhimisht se si gjendja e fakteve të çështjes konkrete i ka përmbushur konditat ligjore që gjykata të vendosë për mbrojtjen gjyqësore të kërkuar.

Gjykata duhet t'i marrë parasysh disa karakteristika të caktuara që kanë të bëjnë me llojin e kërkesës e cila po gjykohet, pastaj edhe natyrën e raportit ligjor që ka të bëjë me kontestin. Aktgjykimi duhet të jetë specifik sa i përket analizës ligjore që bëhet për normën ligjore si pjesë e së drejtës objektive në të cilën bazohet pretendimi për të drejtën subjektive të parashtruesit të kërkesës. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Argumentet dhe pjesa arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht duke i respektuar rregullat dhe ligjet.

Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit i cili e përjashton çdo kundërthënie apo kontradiksion të hapur apo të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë të mjaftueshme për ta mbështetur dispozitivin e aktgjykimit.

Aktgjykimi i shkruar duhet t'i citojë dhe t'i interpretojë normat ligjore të aplikuara në zgjidhjen e kundërthënieve që janë ngritur në një rast të caktuar. Kur e bën këtë, gjykata duhet të marrë parasysh disa karakteristika të caktuara që kanë të bëjnë me llojin e kërkesës e cila po gjykohet, e pastaj edhe natyrën e raportit ligjor që ka të bëjë me kontestin. Në këtë aspekt, aktgjykimi duhet të jetë specifik sa i përket analizës ligjore që bëhet për normën ligjore si pjesë e së drejtës objektive në të cilën bazohet pretendimi për të drejtat subjektive të parashtruesit të kërkesës. Arsyetimi i aktgjykimit lidhur me aplikimin e ndonjë norme të veçantë, duhet të shërbejë si argument i fuqishëm dhe bindës se vendimi i gjykatës është i drejtë, sepse do të jetë e qartë se ai është i bazuar në ligj.

Vendimi i gjykatës në çdo rast duhet të jetë logjik, me formë të duhur dhe me përmbajtje të qartë. Argumentet dhe pjesët e arsyetimit duhet të jenë të bazuara dhe të kenë lidhje logjike dhe në të njëjtën kohë t'i respektojnë rregullat dhe ligjet. Ato duhet të krijojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, e cila përjashton çdo mospërputhje ose kundërthënie të drejtpërdrejtë apo të nënkuptuar. Këto argumente duhet të jenë të mjaftueshme në mënyrë që ta mbështesin dispozitivin e aktgjykimit të shkruar.

Deklarimi për pretendimet e palëve lidhur me bazën juridike të kontestit, si dhe propozimet dhe kundërshtimet e tyre për të cilat gjykata nuk i ka arsyetuar vendimet e nxjerra më parë në procedurë: Duhet theksuar se gjatë zhvillimit të procedurës gjykata si subjekt kryesor i procedurës e ushtron diskrecionin e saj për zhvillimin e procesit gjyqësor duke marrë një sërë veprimesh procedurale, për të cilat nuk jep sqarime gjatë shqyrtimit, por është detyrim i gjykatës që në arsyetimin e aktgjykimit t'i arsyetojë disa nga veprimet e saj procedurale.

Sigurisht gjykata nuk do ta arsyetojë çdo veprim procedural, sepse vetë zhvillimi i procesit gjyqësor dhe mënyra e vendosjes me vendimin meritore e konsumon nevojën që të arsyetohet çdo veprim procedural, por sigurisht gjykata duhet t'i arsyetojë ato veprime procedurale në frymën e përfundimit të saj meritore për çështjen.

Aktgjykimi duhet t'i përshkruajë veprimet procedurale të ndërmarra gjatë gjykimit, qëndrimet dhe vendimet procedurale lidhur me çështjet paraprake dhe procedurale, mocionet (kërkesat) e aprovuara dhe të refuzuara të palëve, përfshirë edhe sqarimet se cilat rrethana kanë ndikuar në aprovimin apo refuzimin e kërkesave të tilla. Gjykata duhet t'i sqarojë rrethanat e rastit ashtu siç janë pranuar (në proces kronologjik) dhe bazuar në rrethana, gjykata duhet ta sqarojë përfundimin (konkluzionin) që e ka sjellë ajo. Përveç kësaj, gjykata duhet ta demonstrojë saktësinë faktike me referenca në dëshmitë që ajo i ka pranuar gjatë gjykimit. Gjatë tërë kohës gjykata duhet të shmangë arsyetimin jo të plotë dhe të pabazuar.

Për shembull, duhet të shmangen deklaratat si më poshtë: “nga ajo që u tha më lartë rezultojnë se..., pastaj bazuar në deklaratat e dëshmitarëve..., pa sqaruar, analizuar dhe dëshmuar saktësinë e deklaratave...,” e kështu me radhë).

Argumentet dhe pjesa arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke i respektuar rregullat dhe ligjet. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradiksion të hapur apo të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë të mjaftueshme për ta mbështetur dispozitivin e aktgjykimit.

### **1.8.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Arsyetimi i aktgjykimit-aktvendimit (të veçantë) është pjesë përbërëse e çdo vendimi për përfundimin e procedurës qoftë në mënyrë meritore, qoftë procedurale dhe rrjedhimisht pretendimet ankimore për arsyetimin e vendimit gjyqësor janë prezente në pothuajse të gjitha ankesat kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë.

Nga praktika e Gjykatës së Apelit na rezultojnë se, janë të shpeshta rastet kur konstatohen shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika, (n) e cila përcakton se: *“nëse aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos nëse dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktore me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye, apo në të nuk janë treguar fare arsye për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit, për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit”*.

Me dispozitën e sipër cituar përfshihen disa rrethana të cilat potencialisht mund të përbëjnë shkak për ta kualifikuar vendimin si të përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, siç janë: dispozitivi i pakuptueshëm, dispozitivi kontradiktor me vetveten dhe arsyet e vendimit, nëse nuk janë dhënë arsye fare për faktet vendimtare, ose nëse arsyet janë të paqarta, apo kontradiktore, ose për faktet vendimtare ekziston kundërtënie në mes të asaj që thuhet në arsyetimin e vendimit dhe asaj që mund të konstatohet nga shkresat e lëndës qoftë nga procesverbalet, apo edhe nga dokumentet tjera.

Në praktikën gjyqësore hasen raste kur dispozitivi është i paqartë dhe kjo na shfaqet kryesisht për dy arsye. E para, pala mund ta ketë paraqitur një kërkesë e cila nuk është konkrete, dhe e qartë, dhe e dyta gjykata mund ta ketë përshkruar kërkesë-padinë në dispozitiv në mënyrë të pakuptueshme, pavarësisht se pala mund ta ketë paraqitur në mënyrë të qartë. Në qoftë se pala ka parashtuar një kërkesë për mbrojtje gjyqësore të paqartë dhe jo konkrete, atëherë realisht nuk plotësohen kushtet për lejueshmërinë e procesit gjyqësor, që nënkupton se gjykata duhet të ndërmarrë veprime në shqyrtimin paraprak për t'i evituar të metat nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor. Në këtë kontekst rezulton se gjykata duhet ta thërrasë palën paditëse që ta përcaktojë në mënyrë të qartë dhe konkrete kërkesë-padinë.

Situatë më e shpeshtë në praktikë na paraqitet kur dispozitivi është në kundërshtim me arsyetimin, apo kur në arsyetim nuk janë paraqitur farë arsyes për faktet vendimtare. Të meta të tilla nuk mund të tejkalohen sepse përveç të tjerave është garancion kushtetues dhe ligjor për çdo subjekt, jo vetëm e drejta e qasjes në gjykatë, por edhe e drejta në një vendim gjyqësor të arsyetuar. Nga kjo rrjedhë se nuk mund të konsiderohet se është plotësuar kushti i gjykimit të drejtë vetëm nga fakti se është zhvilluar procedura gjyqësore në mënyrë të rregullt, sipas së cilës gjykata ka arritur në përfundimin e duhur, por duhet që përfundimi i gjykatës të jetë i arsyetuar.

Gjykata e Apelit në çdo rast që është pretendim ankimor shkelja e dispozitës së nenit 182 paragrafi 2, pika n), e LPK-së, kujdeset që nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor ka ndjekur kërkesat e LPK-së, nga neni 160, dhe në çdo rast kur gjen se ekzistojnë të meta të cilat kanë të bëjnë me përmbajtjen e vendimit gjyqësor e urdhëron rishqyrtimin. Vërehet në praktikë se në disa raste gjykatat e shkallës së parë i konsumojnë kërkesat e LPK-së, për përmbajtjen e arsyetimit të vendimit duke dhënë formulime të përgjithësuara si për faktet, ashtu edhe për besueshmërinë e provave, e rrjedhimisht edhe për kualifikimin e fakteve në raport me normat materialo-juridike. Një prej të metave kryesore të identifikuar është mos specifikimi i mënyrës së vërtetimit të secilit fakt vendimtar dhe mosdhënia e vlerësimeve për mënyrën se si janë vërtetuar faktet në kuptimin e besueshmërisë së mjetit provues të përdorur.

Përveç pjesës që ka të bëjë me faktet e çështjes, provat e administruara, vlerësimin për faktet dhe provat, në praktikën gjyqësore vërehen të meta edhe sa i përket tregimit se cilat norma materialo-juridike janë përdorur për ta nxjerrë gjykata përfundimin e caktuar. Ekzistojnë të meta që lidhen me arsyetimin e tregimit se si norma e caktuar materialo-juridike është zbatuar në kuptim të fakteve konkrete të çështjes kontestuese.

Në mënyrë të përmblodhur mund të themi se arsyetimi i vendimeve gjyqësore vazhdon të jetë një sfidë për gjykata dhe se kërkohet reflektim dhe ngritje e kapaciteteve profesionale dhe kujdes i duhur sa i përket arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

### 1.8.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit

**Aktvendimi AC.nr.3732/13, i datës 16.12.2016**

#### **Arsyetimi**

*“Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) dhe 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 2 të LPK-së.*

*Aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, në kundërshtim me arsyet e aktgjykimit, e po ashtu arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare të çështjes janë të mangëta dhe të paqarta.*

*Dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me arsyet e aktgjykimit, e rrjedhimisht për faktet vendimtare nuk janë paraqitur arsye ose arsyet e paraqitura janë të paqarta. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë përkritazi me arsyetimin e aktgjykimit, është dashur t'i përmbahet dispozitave të nenit 160 paragrafi 3 dhe 4 të LPK-së, të cilat përcaktojnë se arsyetimi i aktgjykimit përmban kërkesat e palëve, faktet e parashtruara dhe provat e propozuara, cilat fakte janë vërtetuar, pse dhe si janë vërtetuar, e në qoftë se janë vërtetuar me prova, cilat prova i ka shfrytëzuar gjykata dhe si i ka vlerësuar ato.*

*Nga arsyet e aktgjykimit nuk mund të kuptohet se mbi bazën e të cilave prova dhe cilave fakte, gjykata ka arritur në përfundimin se paditësi është ngarkuar me borxh sipas faturave pa harxhuar energji elektrike. Gjykata e shkallës së parë është mjaftuar me një përshkrim përmbledhës duke specifikuar se cilat prova i ka administruar, por pa dhënë arsye se cilat fakte i ka provuar me provat e tilla, dhe si pastaj gjendjen faktike të konstatuar e ka kualifikuar në raport me të drejtën materiale. Referencën në dispozitën e nenit 378 të LMD-së, në kontekstin e rrethanave të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, nuk rezulton se është dispozita materiale e cila do të mund të aplikohet në këtë çështje kontestuese nga arsyeja se baza juridike e kërkesë-padisë është në këtë rast sipas paditësit pasurim i pabazë, ndërsa parashkrimi është prapësim i natyrës materiale që do të kishte kuptim si institut në qoftë se do të zbatohet në kërkesat e kreditorit për detyrimet aktive të debitorit”.*

*Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të sipër cituara, të cilat në riprocedurë duhet të eliminohen nga gjykata e shkallës së parë, në atë mënyrë që gjykata fillimisht duhet ta bëjë shqyrtimin paraprak të padisë, të konstatojë nëse plotësohen kushtet për lejueshmërinë e procesit gjyqësor, duke pasur në konsideratë prapësimet e të paditurës për kompetencën e gjykatës dhe pas shqyrtimit paraprak të padisë nëse konstaton se plotësohen kushtet (sidomos kushti i kompetencës lëndore) nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor, atëherë ta caktojë shqyrtimin gjyqësor.*

*Në shqyrtim gjyqësor duhet t'i vlerësojë të gjitha faktet me rëndësi vendimtare sipas kërkesave dhe kundërshtimeve të palëve me prova përkatëse, dhe pas administrimit dhe vlerësimit të tyre të vendosë në mënyrë meritore për themelësinë e kërkesë-padisë, duke nxjerrë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë. Me rastin e përpilimit të vendimit gjyqësor*

*gjykata e shkallës së parë duhet t'i përmbahet kërkesave të LPK-së të përcaktuara me dispozitat e nenit 160”.*

#### **Aktvendimi AC.nr.3990/14, i datës 13.03.2017**

##### **Arsyetimi**

*“Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) të LPK-së.*

*Aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, sepse dispozitivi i aktgjykimit nuk është në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin e aktgjykimit, respektivisht në arsyetimin e aktgjykimit nuk janë dhënë arsye për mënyrën se si gjykata i ka kualifikuar faktet vendimtare në raport me normat materialo-juridike.*

*Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk i është përmbajtur kërkesave të LPK-së nga neni 160 paragrafi 4 dhe 5, të cilat specifikisht i referohen detyrimit që gjykata përveç tjerave në arsyetimin e aktgjykimit të japë shpjegime se si i ka vërtetuar faktet, nëse i ka vërtetuar me prova, cilat prova i ka shfrytëzuar, si i ka vlerësuar ato dhe si i ka kualifikuar faktet, gjegjësisht cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Sa i përket dispozitave materialo-juridike, arsyetimi i aktgjykimit është i mangët ngase gjykata e shkallës së parë specifikisht nuk i është referuar asnjë norme, respektivisht dispozite mbi bazën e së cilës do ta arsyetonte qëndrimin dhe përfundimin e saj.*

*Në mungesë të dispozitave të referuara materialo-juridike, Gjykata e Apelit nuk ka mundur ta pranojë si të rregullt përfundimin e gjykatës së shkallës së parë mbi themelësinë e kërkesë-padisë, sepse për ta vlerësuar zbatimin e së drejtës materiale është e domosdoshme që aktgjykimi i atakuar të përmbajë arsyetim se si gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar të drejtën materiale. Në këtë pjesë janë pranuar pretendimet ankimore”.*

#### **Aktvendimi AC.nr.2017/17, i datës 17.07.2017**

##### **Arsyetimi**

*“Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se, përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkeljet e sipër theksuara sepse dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm.*

*Gjykata e Apelit e ka pranuar pretendimin ankimor se dispozitivi i aktvendimit të atakuar është i pakuptueshëm. Në lidhje me këtë gjykata e ka pranuar pretendimin se ekzistojnë shpërputhje në mes të përshkrimit në dispozitiv të aktvendimit për pjesën e patundshmërisë*



*kontestuese në të cilin pretendohet se është kryer akti i pengimit të posedimit dhe skicës së matjeve të paraqitur nga ekspertët.*

*Në skicën e matjeve dhe me raportin përshkrues të datës 26.02.2014, ekspertët kanë përshkruar në detaje përkufizimin e pjesës së patundshmërisë kontestuese në të cilin pretendohet se është kryer akti i pengim-posedimit, me të cilin përshkrim dhe konstatim nuk përputhet përshkrimi në dispozitivin e aktvendimit.*

*Në çdo rast kur kërkesa për mbrojtjen gjyqësore nuk është konkrete dhe e përmbarueshme, gjykata ka për detyrë ta ftojë palën paditëse që ta plotësojë-korrigjojë parashtrësën me të dhënat që do të zënë vend. Padija si parashtrësë përveç të tjerave përmban kërkesën kryesore dhe atë aksesore nëse do të ketë, e cila para gjykatës duhet të paraqitet në formën e propozimit për mbrojtjen gjyqësore të kërkuar nga ana e gjykatës. Në çdo rast kur kërkesa nuk është e artikuluar në mënyrë të qartë dhe konkrete, atëherë gjykata duhet të veprojë në kuptim të dispozitës së nenit 102 paragrafi 1, i LPK-së, sepse kërkesa kryesore dhe ajo aksesore si elemente përbërëse të padisë janë ekuivalenti i përmbajtjes së deklaratës për parashtrësën, neni 99 paragrafi 2, i LPK-së. Pra, nëse paditësit as pas marrjes së ekspertizës, nuk kanë paraqitur në mënyrë konkrete kërkesën për mbrojtjen gjyqësore, në këtë rast lidhur me precizimin e pjesës së ngastrës ku pretendohet se është kryer akti i pengimit të posedimit, atëherë ka qenë detyrë e gjykatës që t'i ftojë ata në kuptim të dispozitës së nenit 102 paragrafi 1 të LPK-së.*

*Përveç kësaj dispozitivit të aktvendimit i mungon edhe pjesa detyruese e vendimit me të cilën do të parandalohet akti i përsëritur i pengimit të posedimit, sigurisht nëse gjykata bindet dhe vlerëson se ekziston akti i pengimit të posedimit.*

*Gjykata e Apelit, duke vlerësuar se shkëlja e sipër theksuar është shkak i domosdoshëm për kthimin e çështjes në rishqyrtim, nuk është lëshuar në vlerësime të mëtejme të pretendimeve ankimore lidhur me gjendjen faktike dhe të drejtën materiale, por rekomandon që përveç të tjerave në rishqyrtim të merren në vlerësim edhe udhëzimet e dhëna me aktvendimin e Gjykatës së Apelit AC.nr 1717/2014, i datës 22.02.2016.*

*Në riprocedurë udhëzohet gjykata e shkallës së parë që t'i eliminojë shkeljet e sipër theksuara, në atë mënyrë që fillimisht ta bëjë shqyrtimin e rregullsisë formale të padisë dhe të vlerësojë nëse e njëjta është e rregullt dhe varësisht nga vlerësimi të ndërmarre veprime për evitimin e të metave formale, apo nëse një veprim i tillë do të merrej nga paditësit pa nxjerrë gjykata një vendim formal për detyrimin e plotësimit-korrigjimit, atëherë gjykata ta përgatisë shqyrtimin dhe të vendosë në mënyrë meritore për themelësinë e padisë.*

*Është e rëndësishme që gjykata t'i përmbahet dispozitës ligjore të nenit 480 të LPK-së, por po ashtu është e rëndësishme që nëse konstatohet akti i pengimit të posedimit, edhe të ofrohet mbrojtja gjyqësore nga pengimi i bërë duke vendosur urdhërin e ndalesës së pengimit të posedimit.*

*Varësisht nga vendimi i gjykatës për themelësinë e padisë edhe arsyetimi i vendimit duhet të jetë në një rrjedhë logjike dhe koherente me dispozitivin e vendimit, duke i përfillur me saktësi kërkesat e LPK-së nga neni 160 për arsyetimin e vendimit”.*

## 1.9 PROCEDURA SIPAS ANKESËS

Ligji për Procedurën Kontestimore me dispozitat e neneve 185, 186, 187 dhe 188 e ka rregulluar procedurën sipas ankesës, e cila ndiqet nga gjykata e shkallës së parë me përmbajtje si në vijim:

*“Neni 185*

*Ankesa i paraqitet gjykatës e cila e ka dhënë aktgjykimin e shkallës së parë, në një numër të mjaftueshëm ekzemplarësh për gjykatën dhe palën kundërshtare.*

*Neni 186*

*186.1 Ankesën e paraqitur jashtë afatit të parashikuar me ligj, apo jo të plotë, apo të palejueshme, gjykata e shkallës së parë e hedhë me aktvendim pa caktuar fare seancë gjyqësore.*

*186.2 Ankesa është e pa afatshme nëse është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj.*

*186.3 Ankesa është e palejueshme nëse e ka paraqitur personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj, apo personi që ka hequr dorë nga e drejta e ankimit apo që e ka tërhequr ankesën e paraqitur, apo nëse personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës.*

*Neni 187*

*187.1 Një ekzemplar të ankesës së paraqitur me kohë, të lejueshme dhe të plotë, gjykata e shkallës së parë ia dërgon palës kundërshtare, e cila mund, brenda afatit prej shtatë ditësh, të paraqesë po në këtë gjykatë përgjigje në ankesë.*

*187.2 Një ekzemplar të përgjigjes në ankesë gjykata e shkallës së parë ia dërgon ankuesit menjëherë, ose më së voni brenda afatit shtatë ditor nga arritja e saj në gjykatë.*

*187.3 Përgjigja në ankesë e paraqitur pas afatit nuk do të merret në shqyrtim nga gjykata e shkallës së dytë.*

*187.4 Parashtrësat që mbërrijnë në gjykatë pas arritjes së përgjigjes në ankesë, apo pas skadimit të afatit për përgjigje në ankesë nuk do të merren në shqyrtim, përpos kur gjykata nga pala shprehimisht kërkon deklarata plotësuese.*

*Neni 188*

*188.1 Pas pranimit të përgjigjes në ankesë, apo pas skadimit të afatit për përgjigje në ankesë, gjykata e shkallës së parë ankesën dhe përgjigjen në ankesë, nëse është paraqitur me të gjitha shkresat e lëndës ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë në afat prej më së shumti shtatë ditësh.*

*188.2 Nëse ankuesi pretendon se në procedurën e shkallës së parë janë shkelur dispozitat e procedurës kontestimore, gjykata e shkallës së parë mund të japë shpjegime lidhur me thëniet në ankesë që i përkasin shkeljeve të tilla, e sipas nevojës mund të bëjë hetime me qëllim të verifikimit të saktësisë së thënieve përkatëse në ankesë”.*

### 1.9.1 Koment i shkurtër

Në procedurën e vënë në veprim me anë të ankesës kundër aktgjykimit, vepron sikurse gjykata e shkallës së parë e cila e ka dhënë aktgjykimin e atakuar, ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë, kompetente për vendosjen meritore për ankesën.

Ankesa i paraqitet gjykatës e cila e ka dhënë aktgjykimin e shkallës së parë, në një numër të mjaftueshëm ekzemplarësh për gjykatën dhe palën kundërshtare (neni 185 i LPK-së).

Veprimet që duhet t'i ndërmarrë gjykata e shkallës së parë në rast të paraqitjes së ankesës jashtë afatit, jo të plotë apo të palejueshme janë të përcaktuara në nenin 186.1 të LPK-së, me të cilën përcaktohet se: *“Ankesën e paraqitur jashtë afatit të parashikuar me ligj, apo jo të plotë, apo të palejueshme, gjykata e shkallës së parë e hedhë me aktvendim pa caktuar fare seancë gjyqësore”*.

Është detyrë e gjykatës së shkallës së parë, që në çdo rast kur gjen se ankesa është e pa afatshme, jo e plotë, apo e palejueshme ta hedhë poshtë me aktvendim, ndaj të cilit lejohet ankesa pa caktuar fare seancë gjyqësore.

Duhet sqaruar se ankesën jo të plotë, gjykata e shkallës së parë mund ta hedhë poshtë si jo të plotë, pasi që paraprakisht ta ketë konsumuar procedurën e kthimit të ankesës në plotësim (nenin 179 paragrafi1, i LPK-së), dhe nën supozimin se ankuesi nuk e plotëson ankesën, atëherë duhet ta hedhë poshtë.

Ankesa është e pa afatshme në rast se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj, (neni 186 paragrafi2, i LPK-së).

Sipas dispozitës së nenit 186 paragrafi 3, i LPK-së, përcaktohet se: *“Ankesa është e palejueshme nëse e ka paraqitur personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj, apo personi që ka hequr dorë nga e drejta e ankimit apo që e ka tërhequr ankesën e paraqitur, apo nëse personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës”*.

Në praktikën gjyqësore nuk paraqitet ndonjë sfidë për rastet kur kemi të bëjmë me ankesën e paraqitur nga personi që ka heqë dorë nga e drejta e ankimit, apo personi që e ka tërhequr ankesën, apo kur personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës, por ka një mënyrë veprimi jo unike sa i përket ankesës së paraqitur nga personi i paautorizuar.

Në praktikën gjyqësore shfaqen disa situata kur ankesën e paraqet personi i paautorizuar, por që dallon situata/rasti nga situata/rasti. LPK-ja, është mjaftueshëm e qartë për zgjidhjen juridike që duhet ta bëjë gjykata për ankesën e paraqitur nga personi i paautorizuar duke saktësuar se ankesa është e palejuar, por në jetën praktike krijohen disa situata qoftë edhe me gabimet e gjykatës së shkallës së parë të cilat krijojnë dilemë se si të veprohet.

LPK-ja, saktëson se ankesa e paraqitur nga personi i paautorizuar është e palejueshme, por nuk jep zgjidhje në pyetjet:

- a). Nëse ankesën e ka paraqitur personi që nuk ka prezantuar autorizim, a duhet paraprakisht gjykata t'ia kërkojë autorizimin apo menjëherë ta hedhë ankesën si të palejuar?
- b). Si të konsiderohet ankesa e lejueshme apo jo, në rast se gjatë shqyrtimit kryesor në seancë e ka prezantuar edhe pala edhe përfaqësuesi i palës, por që nuk ka dorëzuar fare autorizim në shkresat e lëndës dhe ankesën e nënshkruan pikërisht përfaqësuesi që nuk ka autorizim në shkresat e lëndës?
- c). Si të veprohet, nëse padinë e ka nënshkruar përfaqësuesi i palës, në shqyrtim përgatitor dhe kryesor ku ka marrë pjesë përfaqësuesi i palës dhe i pakënaqur me vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ka paraqitur pikërisht përfaqësuesi, por i njëjti nuk ka prezantuar asnjëherë autorizim në shkresat e lëndës dhe gjykata e pakujdesshme e ka toleruar një rast të tillë?

Në vazhdim do të bëhet përpjekje për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të ngritura.

### ***Përgjigje në pyetjen e parë:***

Për pyetjen e parë praktikisht mund të na paraqiten dy situata të ndryshme.

**Situata e parë** kur ankesën e ka paraqitur personi i paautorizuar, dhe i njëjti nuk pretendon se paraqitet në cilësinë e përfaqësuesit të palës ankuese. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë duhet që ta hedhë ankesën si të palejuar, sepse e njëjta është paraqitur nga personi i paautorizuar.

**Situata e dytë** kur ankesën e paraqet personi i paautorizuar, dhe i njëjti pretendon se e ka cilësinë e përfaqësuesit të palës. Në këtë rast gjykata duhet t'ia kërkojë personit që e ka paraqitur ankesën në cilësinë e përfaqësuesit, që i njëjti ta paraqesë në gjykatë autorizimin/prokurën. Gjukata duhet t'ia kërkojë autorizimin/prokurën me aktvendim të veçantë, ndaj të cilit nuk lejohet e drejta e ankesës, dhe me të cilin njoftohet se në rast të mosprezantimit të autorizimit/prokurës cila është pasoja juridike.

Në lidhje me afatin që duhet t'ia japë gjykata për dorëzimin e autorizimit/prokurës nuk ka një dispozitë specifike që e rregullon këtë situatë. Në analogji mund të merret afati për plotësimin e ankesës afati 7 (shtatë) ditor, por në parim një afat i tillë për dorëzimin e autorizimit/prokurës është afat gjyqësor. Edhe në rastin kur përfaqësuesi në shqyrtim gjyqësor nuk prezanton autorizim/prokurë, gjykata e urdhëron të njëjtin që ta dorëzojë autorizimin/prokurën brenda një afati të caktuar nga gjykata (afati gjyqësor).

Në përcaktimin e afatit gjyqësor në çdo rast gjykata duhet të veprojë pa e prejudikuar pamundësinë që pala ta ndër marrë veprimin e caktuar. Pra, duhet të jepet afati i mjaftueshëm gjyqësor brenda të cilit normalisht pala ose përfaqësuesi mund ta kryejnë veprimin e kërkuar.

Nën supozimin se edhe pas kërimit të prokurës, gjykatës nuk i është dorëzuar autorizimi/prokura, atëherë gjykata duhet ta hedhë ankesën poshtë si të palejuar.

### ***Përgjigje në pyetjen e dytë:***

Cilësia e përfaqësuesit në gjykim konfirmohet në dy mënyra formale, përmes dorëzimit të autorizimit/prokurës, dhe përmes konfirmimit të autorizimit/prokurës nga vetë pala për përfaqësuesin në shqyrtim përgatitor/kryesor, duke e konstatuar gjykata në procesverbal autorizimin dhe vëllimin e autorizimit. Në të kundërtën, fakti se përfaqësuesi i palës, i cili nuk ka prezantuar autorizim/prokurë pasi që me të njëjtin në shqyrtim ka prezantuar edhe pala, në asnjë mënyrë nuk e konsumon nevojën për prezantimin e autorizimit/prokurës. Në këtë kontekst, ankesa e paraqitur nga ky person në cilësinë e përfaqësuesit të palës, është e paraqitur nga personi i paautorizuar, por gjykata nuk do të duhet ta hedhë ankesën si të palejuar pa i kërkuar paraprakisht përfaqësuesit autorizimin/prokurën.

### ***Përgjigje në pyetjen e tretë:***

Përgjigja që i korrespondon pyetjes së tretë në praktikën gjyqësore paraqitet me shumë dilema dhe rrjedhimisht edhe veprimet jo unike të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë.

Duhet qartësuar një gjë, se e vërtetë është se në gjykatat tona na paraqiten raste të tilla kur padinë e ka nënshkruar përfaqësuesi, në gjykim ka marrë pjesë përfaqësuesi dhe ankesën e paraqet përfaqësuesi, i cili në fakt asnjëherë nuk ka prezantuar autorizim/prokurë. Në pyetjen logjike se a do të duhej të ndodhte një situatë e tillë? Përgjigja është prapë logjike, JO, nuk do të duhej të ndodhë. Në pyetjen vijuese pse ndodhë një situatë e tillë? Përgjigja është prapë logjike dhe e thjeshtë, sepse gjykatat në disa raste janë të pakujdesshme.

Në këtë rast paraqiten dilemat dhe mënyrat jo unike të veprimit, ndoshta edhe në gjykatën e shkallës së dytë, sepse nuk është një situatë e zakonshme, por është një situatë e jashtëzakonshme.

Nga këndvështrimi i gjykatës së shkallës së dytë, ideja apo vlerësimi fillestar do të ishte se ankesa është e palejuar, sepse është paraqitur nga personi i paautorizuar. Kësaj ideje apo vlerësimi fillestar i kundërvihet pasoja jologjore dhe jo logjike që do të krijohet nëse ankesa hedhet si e palejuar për shkak se është paraqitur nga personi i paautorizuar. Pasoja jo logjike është se në momentin që hedhet ankesa, vendimi i gjykatës së shkallës së parë bëhet i formës së prerë, për palën e cila në fakt asnjëherë nuk ka paraqitur kërkesë në gjykatë.

Nëse e përjashtojmë këtë mundësi të hedhjes së ankesës për shkak të pasojës që krijon, atëherë duhet shikuar zgjidhja tjetër si alternativë e të parës, e që do të ishte pranimi i ankesës dhe anulimi/prishja e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me udhëzim që gjykata në riprocedurë t'i evitojë të metat që lidhen me përfaqësimin. Por edhe qasja në këtë mënyrë, apo alternativë të trajtimit të ankesës, i kundërvihet faktit se gjykatat do ta pranojnë një ankesë të palejuar për të evituar një ankesë të palejuar.

Do të ishte e thjeshtë për gjykatën e shkallës së dytë nëse ankesën do ta paraqiste pala tjetër sepse zgjidhjen për këtë rast e ofron dispozita e nenit 198 paragrafi 2, që e përcakton mundësinë që gjykata e shkallës së dytë ta pranojë ankesën, ta prishë aktgjykimin e atakuar dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim, apo ta pranojë ankesën, ta prishë aktgjykimin e atakuar dhe ta hedhë poshtë padinë.

Sipas dispozitës së nenit 182, paragrafi 2, pika k), e LPK-së, gjykata kujdeset ex-officio për shkeljet në procedurë, që i referohen palës dhe përfaqësimit të palës. Gjykata për të vlerësuar ex-officio këtë shkak ankimor, duhet të ketë ankesë të lejueshme, megjithatë praktika gjyqësore e gjendur në këtë situatë të pakuptimtë ligjore, duket se ka bërë një zgjidhje që është me më pak pasoja ligjore për palët. Kështu në praktikën gjyqësore dominon mendimi se, duhet anuluar vendimi i gjykatës së shkallës së parë sipas ankesës që në fakt është e paraqitur nga personi i paautorizuar.

Kjo mënyrë e veprimit nga gjykata e shkallës së dytë duket se është analogjike me mënyrën e veprimit të gjykatës së shkallës së parë, kur lejon përfaqësuesin e palës t'i kryejë disa veprime, pa e prezantuar paraprakisht autorizimin/prokurën, natyrisht me urdhër që të njëjtën ta paraqesë, por në rast se përfaqësuesi dështon të prezantojë autorizimin/prokurën brenda aftit, atëherë gjykata i anulon të gjitha veprimet të cilat i ka ndërmarrë përfaqësuesi pa prokurë.

Ju sugjerohet gjykatave të shkallës së parë, që të kenë kujdesin e duhur në lidhje me përfaqësuesit e palëve, sepse nga moskujdesi i gjykatave mund të krijohen pasoja juridike për vetë palët. Është e njohur se në disa raste kur autorizimi/prokura i është bashkangjitur padisë, gjykata e shkallës së parë nga moskujdesi, gabimisht kopjen e padisë që është për gjykatën, e ku është i bashkangjitur autorizimi/prokura ia dërgon palës së paditur duke mbetur kështu shkresat e lëndës pa autorizim/prokurën e përfaqësuesit, edhe pse përfaqësuesi e ka dorëzuar në mënyrë të rregullt.

#### *Veprimi i gjykatës së shkallës së parë kur ankesa është e rregullt*

Në qoftë se ankesa është paraqitur me kohë, është e lejueshme dhe e plotë, atëherë gjykata e shkallës së parë ia dërgon palës kundërshtare, e cila ka të drejtë që në afat prej shtatë (7) ditësh të paraqesë përgjigje në ankesë. Në qoftë se pala e kundërt e shfrytëzon mundësinë që i ka dhënë ligji dhe paraqet përgjigje në ankesë, atëherë gjykata e shkallës së parë ia dërgon ankuesit menjëherë përgjigjen ose më së voni brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e arrijtes së përgjigjes në gjykatë.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë, apo pas skadimit të afatit për përgjigje në ankesë, gjykata e shkallës së parë, ankesën dhe përgjigjen në ankesë me të gjitha shkresat e lëndës ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë në afat prej shtatë (7) ditësh më së shumti.

#### **1.9.2 Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore paraqiten raste të shpeshta, kur gjykatat e shkallës së parë nuk veprojnë në kuadër të përgjegjësive ligjore për ta vlerësuar lejueshmërinë e ankesës dhe për të ndërmarrë të gjitha veprimet që janë përgjegjësi e gjykatës së shkallës së parë. Në këtë kontekst rezulton se, në gjykatën e shkallës së dytë pranohen ankesa për shqyrtim të cilat nuk i plotësojnë kushtet formale për t'u proceduar në gjykatën e shkallës së dytë, pastaj paraqiten raste kur fare nuk i dërgohet palës së kundërt ankesa për përgjigje, dhe gjithashtu raste kur ankesa është e palejuar në kuptim të dispozitave të LPK-së.

Në të gjitha këto raste, gjykatat nuk i ndërmarrin veprimet e duhura varësisht nga e meta me të cilën identifikohen ankesat, por ashtu rastet me të meta dërgohen në gjykatën e shkallës së dytë për vendosje.

Vlerësimi i lejueshmërisë së ankesës nga gjykatat e shkallës së parë duhet të shikohet jo vetëm si përgjegjësi ligjore për procedurë, por edhe si kriter i vlerësimit të performancës së gjyqtarëve. Qëllimi i shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës nga gjykata në shkallë të parë ka të bëjë me evitimin e pranimit të rasteve në gjykatën e shkallës së dytë kur ato raste nuk i plotësojnë kushtet për t'u dërguar në gjykatën e shkallës së dytë, e gjithashtu qëllimi është edhe të evitohen shpenzimet dhe procedurat e panevojshme si dhe ngarkesa me raste që s'mund të vendosen meritorisht. Prandaj u sugjerohet të gjithë gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë, që t'i ushtrojnë kompetencat me përgjegjësi sa i përket procedurës së ankesës në gjykatën e shkallës së parë, duke u kujdesur dhe vlerësuar vet gjyqtari/ja i/e çështjes nëse ankesa është e lejueshme dhe nëse janë ndërmarrë të gjitha veprimet për dërgimin e përgjigjes tek pala e kundërt, e pastaj përmes nënshkrimit të aktit duke i respektuar afatet ligjore lënda t'i dërgohet gjykatës së shkallës së dytë.

Vërehet përmes rasteve të ndryshme se është ekskluzivisht administrata e gjykatave të shkallës së parë që merret me veprimet nga pranimi i ankesës në gjykatë e deri tek dërgimi në gjykatën e shkallës së dytë, dhe se në shumë raste gjyqtarët e çështjes nuk e vlerësojnë fare lejueshmërinë e ankesës dhe rregullsinë e veprimeve të ndërmarra nga administrata e gjykatës. Për këtë arsye të gjitha rastet kur gjykata e shkallës së dytë i ka hedhur ankesat për cilindo shkak, konfirmojnë se gjykatat e shkallës së parë nuk kanë vepruar në përputhje me dispozitat ligjore.

Për të konfirmuar këto të gjetura, këtij materiali i janë bashkangjitur edhe referenca me akte për kthimin e lëndës në gjykatën e shkallës së parë si dhe vendimet gjyqësore.

### **1.9.3 Referenca në aktet për kthimin e lëndëve në gjykatën e shkallës së parë**

#### **Akt për kthimin e lëndës, A.C.nr.2148/17, i datës 10.07.2017**

##### **Arsyetimi**

*Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë nga Gjykata Themelore e Gjilanit-Dega në Kamenicë, me datë 18.05.2017, ka pranuar lëndën C.nr.157/16, tani AC.nr.2148/17, për të vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditësit R. (B). K, nga fshati Ragoçicë, Komuna e Kamenicës, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë, C.nr.157/16, i datës 05.12.2016.*

*Gjykata e Apelit, pas shikimit të shkresave të lëndës, gjen se ankesën e paraqitur nga i autorizuari i paditësit, gjykata e shkallës së parë nuk ia ka dërguar fare të paditurit për përgjigje, dhe pa u plotësuar kushtet ligjore lëndën ia ka dërguar gjykatës së shkallës së dytë që të vendoset sipas ankesës.*

*Sipas dispozitës së nenit 187 paragrafi 1, i LPK-së, përcaktohet se: "Një ekzemplar të ankesës së paraqitur me kohë, të lejueshme dhe të plotë, gjykata e shkallës së parë ia dërgon palës kundërshtare, e cila mund që brenda afatit prej shtatë ditësh, të paraqesë përgjigje në ankesë po në këtë gjykatë".*

*Gjykata e Apelit, nuk ka mundur të vendosë për ankesën e të autorizuarit të palës paditëse, sepse e njëjta nuk i është dërguar të paditurit për përgjigje, dhe derisa nuk i dërgohet nuk plotësohet kushti që të shqyrtohet ankesa nga gjykata e shkallës së dytë.*

*Gjykata e Apelit, kthimin e shkresave të lëndës në gjykatën e shkallës së parë e bën në kuptim të dispozitës së nenit 189 paragrafi 2, i LPK-së, me udhëzim që gjykata e shkallës së parë pas pranimit të shkresave të lëndës të veprojë në kuptim të dispozitave nga neni 187 i LPK-së, e pastaj lënda t'i kthehet Gjykatës së Apelit që të vendoset sipas ankesave.*

### **Akt për kthimin e lëndës, AC.nr.841/15, i datës 20.12.2016**

#### **Arsyetimi**

*Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, nga Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, me datë 12.03.2015, ka pranuar lëndën C.nr.184/11, tani AC.nr.841/15.*

*Gjykata e Apelit, pas shikimit të shkresave të lëndës gjen se në cilësinë e të autorizuarit për paraqitjen e ankesës për palën paditëse paraqitet avokati \_\_\_\_\_, për të cilin në shkresat e lëndës nuk ekziston autorizimi.*

*Sipas dispozitës së nenit 93 paragrafi 1 LPK-së përcaktohet se: “I autorizuari për përfaqësim ka për detyrë, që me rastin e kryerjes së veprimit të parë në procedurë të paraqes prokurën”, ndërsa në paragrafin 2, parashihet se: “Gjykata mund të lejojë që veprimet në procedurë për palën përkohësisht t'i kryejë personi që nuk e ka paraqitur prokurën, por njëkohësisht do ta urdhërojë atë që brenda afatit të caktuar ta paraqesë prokurën ose aprovimin e palës për veprimet procedurale të kryera”.*

*Në kuptim të dispozitave të cituara e duke iu referuar edhe dispozitave nga neni 179 paragrafi 1, të LPK-së, gjykata e shkallës së parë është dashur që ta kthejë ankesën në plotësim duke e kërkuar autorizimin nga avokati \_\_\_\_\_, dhe pastaj nëse i njëjti e dorëzon autorizimin brenda afatit të caktuar, lënda t'i përcillet për vendosje gjykatës së shkallës së dytë, e nëse nuk e dorëzon autorizimin atëherë të veprojë në kuptim të dispozitës së nenit 186 paragrafi 1, i LPK-së, me të cilën përcaktohet se: “ankesën e paraqitur tej afatit të parashikuar me ligj, atë jo të plotë, apo të palejuar e hedhë poshtë me aktvendim gjykata e shkallës së parë pa caktuar fare seancë gjyqësore”.*

*Gjykata e Apelit, kthimin e shkresave të lëndës në gjykatën e shkallës së parë e bën në kuptim të dispozitës së nenit 189 paragrafi 2, i LPK-së, ndërsa gjykata e shkallës së parë udhëzohet që t'i ndërmarrë veprimet e sipër cekura, e pastaj nëse plotësohen kushtet lëndën t'ia dërgojë gjykatës së shkallës së dytë.*

### **Akt për kthimin e lëndës, AC.nr.2243/13, i datës 12.01.2017**

#### **Arsyetimi**

*Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, nga Gjykata Themelore e Mitrovicës-Dega në Vushtrri, me datë 30.07.2013, ka pranuar lëndën C.nr.298/13, tani AC.nr.2243/13, për të vendosur sipas ankesës së paditëses Kompania e Ujësjellësit Rajonal nga Mitrovica dhe ankesës së të autorizuarit të të paditurit F.T., nga Vushtrria, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.298/13, i datës 11.07.2013.*



*Gjykata e Apelit gjen se ankesa e paditëses si pretendim të vetëm ankimor e ka paraqitur mosvendosjen e kërkesës së saj për kamatë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, me rastin e vendosjes meritorë të çështjes juridike kontestuese.*

*Me dispozitën e nenit 164 paragrafi 3 të LPK-së, përcaktohet se: “Në qoftë se aktgjykimi goditet me ankesë vetëm nga shkak se gjykata nuk ka vendosur me të për të gjitha kërkesat e palëve të cilat janë objekt i procesit gjyqësor, ankesa do të konsiderohet si propozim për dhënien e aktgjykimit plotësues”.*

*Në këtë rast meqenëse ankesa është ngritur vetëm për çështjen e kamatës me pretendim se gjykata nuk ka vendosur për një kërkesë të tillë, Gjykata e Apelit me referencë në dispozitën e sipër cituar vendosi që nëpërmes këtij akti t’ia kthejë shkresat e lëndës Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, në mënyrë që e njëjta të vendosë për kamatën për shkak se ankesa tani duhet të konsiderohet si kërkesë për plotësimin e aktgjykimit.*

*Gjykata e Apelit, kthimin e shkresave të lëndës në gjykatën e shkallës së parë e bën në kuptim të dispozitës së nenit 189 paragrafi 2, i LPK-së, me udhëzim që gjykata e shkallës së parë pas pranimit të shkresave të lëndës, të veprojë në kuptim të dispozitave nga neni 164 i LPK-së, e pastaj lënda t’i kthehet Gjykatës së Apelit që të vendoset sipas ankesave.*

## **Akt për kthimin e lëndës, AC.nr.4903/15, i datës 29.07.2016**

### **Arsyetimi**

*Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, nga Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, me datë 24.12.2015, ka pranuar lëndën C.nr.203/12, tani AC.nr.4903/15.*

*Pas pranimit të shkresave të lëndës, Gjykata e Apelit me datë 13.07.2016, ka pranuar një parashtrësë nga paditësit R. V., nga fshati Dubravë, Komuna e Kaçanikut, me të cilën i njëjti e njofton Gjykatën e Apelit se nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e gjithashtu nuk e ka pranuar as ankesën e të paditurës për të dhënë përgjigje në të, për çka ka kërkuar që shkresat e lëndës t’i kthehen gjykatës së shkallës së parë në mënyrë që e njëjta t’ia dorëzojë paditësit aktgjykimin dhe ankesën.*

*Gjykata e Apelit, pas shikimit të shkresave të lëndës konstatoi se gjykata e shkallës së parë, shqyrtimin kryesor e ka përfunduar me datën 26.10.2015, duke vendosur në mënyrë meritorë për kërkesë-padinë e paditësit sipas aktgjykimit C.nr.203/12, i datës 26.10.2015, të cilin ua ka dërguar palëve ndërgjyqësore, mirëpo paditësi nuk e ka pranuar aktgjykimin, sepse sipas fletë- kthesës së datës 11.11.2015, konstatohet se i njëjti ishte jashtë vendit. Edhe ankesën e të paditurës, paditësi nuk e ka pranuar për përgjigje, pasi që edhe në fletë-kthesën e datës 09.09.2015, i njëjti ishte jashtë vendit.*

*Sipas dispozitës së nenit 116 paragrafi 1 përcaktohet se “Në qoftë se pala ose përfaqësuesi i saj, gjatë zhvillimit të procedurës ose para se të kalojë afati prej 6 muajsh pas përfundimit të procedurës me vendim të formës së prerë, e ndërrojnë adresën në të cilën bëhet dorëzimi i shkresave kanë për detyrë që për këtë gjë ta njoftojnë menjëherë gjykatën”, ndërsa me dispozitën e paragrafit 5 të nenit të njëjtë përcaktohet se: “Në qoftë se pala ose përfaqësuesi i saj nuk e njoftojnë gjykatën menjëherë për ndryshimin e adresës, gjykata do të urdhërojë që dërgimet e mëtejme të shkresave të bëhen me anë të afishimit të tyre në*

*tabelën e shpalljeve në gjykatë. Kjo mënyrë e komunikimit bëhet deri sa pala apo përfaqësuesi i saj ta njoftojë gjykatën për adresën e saj të re”.*

*Në kuptim të dispozitave të sipër cituara, Gjykata e Apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë nuk e ka zbatuar procedurën e kërkuar për dorëzimin e shkresave palës paditëse, prandaj me anë të këtij akti shkresat e lëndës i kthehen gjykatës së shkallës së parë në mënyrë që e njëjta t’i ndërmarrë veprimet e duhura për dorëzimin e shkresave paditësit dhe pas zbatimit të procedurës se kërkuar, shkresat e lëndës t’i kthehen përsëri gjykatës së Apelit, në mënyrë që e njëjta të vendosë në procedurën sipas ankesës.*

*Veprimin e kthimit të shkresave të lëndës në gjykatën e shkallës së parë, Gjykata e Apelit e mbështet në dispozitën e nenit 189 paragrafi 2 i LPK-së.*

## **1.10 SIGURIMI I KËRKESË-PADISË**

*Neni 297.1, i Ligjit për Procedurën Kontestimore përcakton se: “Masa e sigurimit mund të caktohet:*

- a. në qoftë se propozuesi i sigurimit e bën të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, si dhe*
- b. në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër me të cilën do të ndryshonte gjendja ekzistuese e gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”.*

*Neni 297.2. i LPK-së, përcakton se: “Nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, gjykata e cakton masën e sigurimit vetëm nën kushtet që propozuesi i sigurimit, brenda afatit të caktuar nga gjykata, ashtu siç parashihet me Ligjin mbi Procedurën Përmbarimore, jep garanci në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t’i shkaktohet palës kundërshtare me caktimin dhe ekzekutimin e masës së sigurimit”.*

### **1.10.1 Koment i shkurtër**

Këto kushte të përcaktuara me dispozitat e sipër cituara duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

Në lidhje me kushtin e parë, mendohet se propozuesi i sigurimit, duhet ta dëshmojë atë përmes ndonjë vendimi të mëhershëm të gjykatës apo të ndonjë organi administrativ, testamenti, kontrate, ndonjë dokumenti përmbarimor, respektivisht ndonjë titulli tjetër juridik.

Ndërsa sa i përket kushtit të dytë, nënkuptohet se ky kusht plotësohet në rastet kur ekziston rreziku që pala kundërshtare do të mund të bënte tjetërsimin e pasurisë së vet, ta fsheh atë, ta vë në ngarkim qoftë me peng apo nën hipotekë etj.

Sa i përket garancionit, si kusht i tretë i cili duhet të plotësohet në mënyrë kumulative së bashku me dy kushtet tjera, është përcaktuar se në rast se nuk është përcaktuar ndryshe me

ligj, është e paraparë që gjykata mund ta caktojë masën e sigurimit vetëm në kushtet kur, propozuesi i sigurimit brenda afatit të caktuar nga gjykata paguan shumën e caktuar të garancionit në masën dhe llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet palës kundërshtare me caktimin dhe përmbarimin e asaj mase.

Në këto raste garacioni paguhet në para të gatshme, por gjykata në pajtim me dispozitat e LPP-së mund të lejojë që dhënia e garacionit të bëhet në formë të:

- a) letrave me vlerë;
- b) sendeve të çmueshme, apo edhe
- c) garancive bankare,

Në garacionin e deponuar në këtë mënyrë, pala kundërshtare e fiton të drejtën e pengut ligjor.

Sidoqoftë, me dispozita ligjore është e paraparë që me kërkesën e propozuesit gjykata mund ta lirojë atë nga detyrimi i dhënies së garancisë, po që në bazë të provave përkatëse të cilat ai ia ofron gjykatës konstatohet se ai nuk ka mundësi financiare për një gjë të tillë.

Në rast se propozuesi nuk e paguan garacionin në masën dhe afatin e caktuar nga gjykata, kjo e fundit do ta refuzojë propozimin për caktimin e masës së propozuar të sigurimit. Ngjashëm do të vepronet edhe në rastet kur fillimisht gjykata e ka caktuar masën e përkohshme, e pastaj duke vepruar sipas kundërshtimit të të paditurit – kundërshtarit të masës së propozuar ndaj aktvendimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, e cakton seancën dëgjimore për caktimin e tani masës së sigurisë, nëse paditësi – propozuesi i masës së sigurisë, sipas urdhërit të gjykatës, nuk e deponon shumën e garacionit përkatës për, tani masën e sigurisë.

Bashkësitë e pushtetit lokal, respektivisht të gjithë personat juridik të së drejtës publike janë të përjashtuar nga detyrimi i pagesës së garacionit. Një gjë e tillë është e paraparë edhe me dispozitat e LPP-së së re.

Bashkësitë e pushtetit lokal, respektivisht të gjithë personat juridik të së drejtës publike janë të përjashtuar nga detyrimi i pagesës së garacionit. Një gjë e tillë në mënyrë eksplicite është e paraparë me nenin 297.4 të LPK-së, si dhe me dispozitat e LPP-së re.

Shuma e të hollave e paguar në emër të garancisë sipas nenit 297 të LPK-së, i kthehet personit që e ka paguar brenda afatit 7 ditor nga dita në të cilën shuhet masa e sigurimit. Nëse ndërkohë propozuesi i sigurimit parashtron padi ndaj të paditurit edhe për kompensimin e dëmit, gjykata kompetente për gjykimin sipas padisë do të vendosë për lënien në fuqi të masës përkatëse të sigurimit.

### **1.10.2 Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit nuk janë të pakta rastet kur konstatohen të meta në vendimet e gjykatave të shkallës së parë, në procedurën e sigurimit të kërkesë-padisë. Situatat më të shpeshta shfaqen si të meta që rezultojnë se, gjykatat dështojnë ta vlerësojnë plotësimin e kushteve për sigurimin e kërkesë-padisë në mënyrë kumulative, e pastaj paraqiten edhe rastet kur gjykatat kanë vlerësuar gabimisht se plotësohen kushtet për

plotësimin e kërkesë-padisë, duke e marrë për bazë njërin nga kushtet për caktimin e masave të sigurimit (neni 297 paragrafi 1 pika a), dhe b).

Po ashtu ekzistojnë edhe situata, kur vendimet e gjykatës së shkallës së parë janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 300 paragrafi 3 i LPK-së, për shkak se në disa raste me vendimin mbi sigurimin e kërkesë-padisë përfshihet në tërësi kërkesa apo pjesa më e madhe e kërkesës. Ashtu siç është theksuar te komentet për zbatimin e dispozitave nga neni 297 të LPK-së, ritheksohet nevoja që gjyqtarët e shkallës së parë, t'ia kushtojnë vëmendjen e duhur kërkesave që rrjedhin nga dispozitat e LPK-së, për sigurimin e kërkesë-padisë lidhur me kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative. Përveç përcaktimit me dispozita ligjore lidhur me kushtet që duhet të plotësohen për sigurimin e kërkesë-padisë, edhe praktika gjyqësore tani është unike lidhur me faktin se kushtet që kanë të bëjnë me sigurimin e kërkesë-padisë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe atë: besueshmëria e ekzistimit të kërkesës apo të së drejtës subjektive, dhe rreziku se pa caktimin e masës se këtillë do të pamundësohet apo do të vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës dhe garancioni.

### **1.10.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

**Aktvendimi AC.nr.4318/15, i datës 08.03.2016**

#### **Arsyetimi**

*Në arsyetim të aktvendimit nuk janë paraqitur arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat do të provonin se plotësohen kushtet e kërkuara me dispozitat e nenit 297 paragrafi 1 pika (a) dhe (b) e LPK-së, për besueshmërinë e kërkesës apo të së drejtës subjektive, dhe ekzistimit të rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës së paditësit.*

*Gjykata nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare sidomos sa i përket vlerësimit se paditësi-propozuesi i sigurimit e ka bërë të besueshme kërkesën e tij. Në mungesë të arsyeve të mjaftueshme për besueshmërinë e kërkesës përveç dispozitës së nenit 182 paragrafi 2 pika (n) të LPK-së, është shkelur edhe dispozita e nenit 297 paragrafi 1 pika (a) e LPK-së.*

**Aktvendimi AC.nr.436/16, i datës 08.03.2016**

#### **Arsyetimi**

*Në këtë rast aktvendimi i atakuar është i përfshirë edhe në shkëlqje të dispozitave nga neni 182 paragrafi 1, e lidhur me nenin 297 të LPK-së. Deri te shkëlqja e kësaj dispozite ka ardhur për faktin se, për t'i vlerësuar gjykata në mënyrë të duhur kushtet për caktimin e masës së sigurimit e njëjta duhet ta zbatojë procedurën e caktuar me dispozitat e nenit 305 të LPK-së. Gjykata e shkallës së parë, nuk i ka dërguar kundërshtares së sigurimit paraprakisht njoftimin se mund të paraqes përgjigje lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit, përkatësisht nuk i ka dorëzuar në mënyrë të kërkuar me dispozitat e LPK-së propozimin për masë.*

*Me dispozitën e nenit 305 paragrafi 1 përcaktohet se: “përveç në rastet e përcaktuara me këtë ligj, masa e sigurimit nuk mund të caktohet në rast se kundërshtari i sigurimit nuk ka pasur mundësi të deklarohet për propozimin e caktimit të saj”, ndërsa me dispozitën e nenit 305 paragraf 2 të LPK-së përcaktohet se: “propozimin për caktimin e masave të sigurimit gjykata bashkë me shkresat që i janë bashkangjitur, ia dërgon kundërshtarit të sigurimit me njoftim se mund të paraqesë përgjigje të shkruar brenda afatit shtatë (7) ditor”.*

*Nga shkresat e lëndës nuk provohet se gjykata e shkallës së parë i ka dorëzuar në mënyrë të rregullt kundërshtares së sigurimit njoftimin lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit.*

*Gjykata e shkallës së parë duke mos vepruar sipas detyrimit që përcakton dispozita e nenit 305 e LPK-së, për njoftimin e palës kundërshtare të sigurimit lidhur me propozimin e propozuesit të sigurimit ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 305 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, të cilat kanë ndikuar që aktvendimi i atakuar të merret me shkelje nga neni 182 paragrafi 1, e lidhur me nenin 297 të LPK-së.*

*Gjykata e shkallës së parë nuk i ka dhënë të drejtë ankese kundërshtares së sigurimit ndaj aktvendimit mbi caktimin e masës së sigurimit, duke iu referuar dispozitës së nenit 310 paragrafi 5 të LPK-së, e cila i referohet masës së përkohshme të sigurimit, çka paraqet kundërhënie, pasi që po të vlerësohej se me aktvendimin e atakuar është caktuar masa e përkohshme e sigurimit atëherë gjykata e shkallës së parë është dashur të veprojë në kuptim të dispozitës së nenit 306 paragrafi 2 të LPK-së, me të cilin përcaktohet se kundërshtari i sigurimit mund ta kundërshtojë masën e përkohshme të sigurimit, e pastaj në bazë të kundërshtimit gjykata brenda 3 ditëve të ardhshme duhet ta caktojë seancën për ta vlerësuar masën e përkohshme të sigurimit.*

*Në kuptim të të cekurave, Gjykata e Apelit e udhëzon gjykatën e shkallës së parë, që në riprocedurë ta bëjë eliminimin e shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore në atë mënyrë që në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, nëse gjykata vendosë për masën e përkohshme të sigurimit duhet t'i japë mundësi palës kundërshtare që ta kundërshtojë aktvendimin për masën e përkohshme e pastaj në bazë të kundërshtimit ta caktojë seancën për vlerësimin e masës së përkohshme, ndërsa në rast se vendosë sipas propozimit për masën e sigurimit pa vendosur paraprakisht për masën e përkohshme të sigurimit, gjykata duhet të veprojë në kuptim të dispozitës së nenit 305 paragrafi 2 të LPK-së, e më pastaj të vendosë për bazueshmërinë e propozimit për masën e sigurisë. Në çdo rast vendimi për masën e sigurimit duhet të përmbajë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që gjykata të nxjerrë një përfundim të ligjshëm, dhe në mënyrë specifike të arsyetojë kushtet për caktimin e masës së sigurisë në kuptim të dispozitës së nenit 297 të LPK-së.*

**Aktvendimi AC.nr.4011/15, i datës 12.11.2015**

### **Arsyetimi**

*Gjykata e Apelit, duke e vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestuese nga ana e gjykatës së shkallës së parë, gjen se një përfundim i tillë është i pa bazuar dhe nuk ka mbështetje ligjore. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, nuk ia ka dërguar paraprakisht të paditurës-kundërshtarit të sigurimit njoftimin se mund të paraqesë*

përgjigje lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Me dispozitën e nenit 305 par.1 përcaktohet se: “përveç në rastet e përcaktuara me këtë ligj, masa e sigurimit nuk mund të caktohet, nëse kundërshtari i sigurimit nuk ka pasur mundësi të deklarohet për propozimin e caktimit të saj”, ndërsa me dispozitën e nenit 305 paragrafi 2 të LPK-së përcaktohet se: “propozimin për caktimin e masave të sigurimit gjykata bashkë me shkresat që i janë bashkangjitur, ia dërgon kundërshtarit të sigurimit me njoftimin se mund të paraqesë përgjigje të shkruar brenda afatit 7 ditor”.

Gjykata e shkallës së parë duke mos vepruar sipas detyrimit që përcakton dispozita e nenit 305 për njoftimin e palës kundërshtare të sigurimit lidhur me propozimin e propozuesit të sigurimit ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 305 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së.

Përveç kësaj shkeljeje, e cila kualifikohet si shkelje nga neni 182 paragrafi 1 lidhur me nenin 305 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika (n) e LPK-së, pasi që në rastin konkret dispozitivi i aktvendimit është në kundërshtim me arsyet e aktvendimit dhe rrjedhimisht për faktet vendimtare nuk janë paraqitur fare arsyet.

Gjykata e shkallës së parë, është mjaftuar me konstatimin në arsyetim të aktvendimit të atakuar se paditësja-propozuesi i sigurimit e ka bërë të besueshëm propozimin për caktimin e masës së sigurimit në atë masë që gjykata të vendosë si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar duke e aprovuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Një arsyetim i tillë është i pa mjaftueshëm dhe në kundërshtim me dispozitën e nenit 297 paragrafi 1 pika (a) dhe (b) të LPK-së, sipas të cilave kërkohet që propozuesi i sigurimit ta bëjë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive të tij, dhe në mënyrë komulative ta bëjë të besueshëm faktin se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së sigurisë pala kundërshtare do ta pamundësonte, apo do ta vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Mbi këtë bazë, Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se, gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme me të cilat do ta arsyetonte vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, sidomos sa i përket besueshmërisë për ekzistimin e kërkesës përkatësisht të së drejtës subjektive të paditëses.

Gjykata e shkallës së parë duhet që t'i vlerësojë të gjitha faktet e çështjes kontestuese në mënyrë të argumentuar, sipas provave të propozuara lidhur me plotësimin e kushteve të kërkuara nga Ligji i Procedurës Kontestimore për caktimin e masës së sigurisë, të cilat kushte i referohen besueshmërisë së kërkesës apo të drejtës subjektive të palës paditëse dhe ekzistimit të rrezikut se pa caktimin e masës së tillë pala kundërshtare do të mund dukshëm ta pamundësonte apo ta vështirësonte realizimin e kërkesës nga pala paditëse.

## 2. PROCEDURA PËRMBARIMORE

### 2.1 PROPOZIMI PËR PËRMBARIM

Ligji për Procedurën Përmbarrimore nr.04/L-139 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.3, i dt. 31.01.2013, Prishtinë), me dispozitën e nenit 38 ka përcaktuar përmbajtjen e propozimit të përmbarrimit me përmbajtje si në vijim.

*Neni 38 Propozimi për përmbarrim*

- “1. Propozimi për përmbarrim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopja e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të së cilit kërkohet përmbarrimi, kërkuesi i përmbarrimit dhe debitorit, adresa e vendbanimit – vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet të cilit duhet të kryhet përmbarrimi, objekti i përmbarrimit nëse është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit.*
- 2. Në rast se propozimi për përmbarrim nga paragrafi 1 i këtij neni nuk i përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues, apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarrues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.*
- 3. Në rast se bashkë me propozimin për përmbarrim është bërë edhe kërkesa për konstatimin e pasurisë së debitorit, për rezultatit e konstatimit të tillë organi përmbarrues do ta njoftojë kreditorin duke i lënë afat që ta rregullojë propozimin e paraqitur, respektivisht që ta ndryshojë apo ta plotësojë atë. Propozimi i ndryshuar dorëzohet brenda dhjetë ditëve, pasi që organi përmbarrues t’ia dërgojë kreditorit deklaratën e pasurive të debitorit. Megjithatë nëse kreditori kërkon aneks të deklaratës, siç përshkruhet në paragrafin 9 nenin 45 të këtij ligji, brenda afatit kohor të lejuar, koha e lejuar për përmbarrim të propozimit të ndryshuar për përmbarrim llogaritet nga data në të cilën shtojca e dorëzuar nga debitorit i dërgohet kreditorit”.*

#### 2.1.1 Koment i shkurtër

Procedura përmbarrimore fillohet me propozimin e kreditorit si dhe sipas detyrës zyrtare kur me ligj parashihet një gjë e tillë. Pas datës 30 qershor 2014 kreditorët mund t’i drejtohen gjykatave vetëm për çështjet që janë kompetente t’i kryejnë gjykatat, ndërsa për çështje tjera duhet t’i drejtohen përmbarruesve privat.

Kërkesa duhet të jetë provuar në atë mënyrë që të jetë e besueshme dhe të evitohet çdo mundësi dyshimi në ekzistimin dhe besueshmërinë e saj.

Në procedurën përmbarrimore vlen parimi i disponimit të palës, që është një ndër parimet themelore të procedurës kontestimore. Pra iniciimi i kësaj procedure varet nga dëshira e kreditorit, po ashtu edhe zhvillimi i mëtejshëm i kësaj procedure varet nga vullneti i kreditorit, sepse kreditori pa pëlqimin e debitorit gjatë zhvillimit të procedurës mund të tërhiqet nga propozimi përmbarrimor në tërësi apo pjesërisht dhe të përfundohet procedura, dhe se propozimi pas tërheqjes mund të paraqitet prapë në gjykatë.

Nga ana formale LPP nuk parasheh ndonjë formë të veçantë për propozimin për përmbardim, por megjithatë ka paraparë se çka duhet të përmbajë propozimi, si dhe nëse nuk i përmban shënimet e kërkuara ka paraparë edhe pasojat në rast se nuk veprohet për plotësimin e tyre.

## **2.1.2 Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit janë paraqitur raste kur këto dispozita nuk janë zbatuar në mënyrë të drejtë.

Organi përmbardues duke vlerësuar gabimisht procedurën e shqyrtimit të propozimit përmbardimor lejon përmbardimin në bazë të dokumentit përmbardimor apo dokumentit të besueshëm, duke mos u plotësuar kriteret e kërkuara nga ligji. Nga praktika gjyqësore vërehen raste të shumta kur përmbardimi është caktuar në bazë të kopjes së dokumentit përmbardimor apo të dokumentit të besueshëm.

Bazuar në nenin 38.1 të LPP-së, propozimi për përmbardim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbardim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbardimor origjinal apo kopja e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të së cilit kërkohet përmbardimi, kërkuesi i përmbardimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet të së cilit duhet të kryhet përmbardimi, objekti i përmbardimit nëse është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbardimit.

Nëse propozimi për përmbardim nuk përmban shënimet e kërkuara, organi përmbardues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Shqetësimi më i madh qëndron në faktin e moseliminimit të këtyre parregullsive nga gjykata e shkallës së parë, edhe pas paraqitjes së prapësimit nga ana e debitorëve.

Në rastet e paraqitjes së ankesës për kundërshtimin ndaj urdhërit të përmbardueshmërisë së nxjerrë nga përmbarduesi privat, gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbardimit, rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhëri nga përmbarduesi privat. Nëse gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhërit për përmbardim nga përmbarduesi privat, shfuqizon urdhërin me vendim (shih nenin 43 të LPP-së).

Në procedurën përmbardimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër.

Sipas neni 22 par.1 pika 1.9 të LPP-së, si dokument përmbardues parashihet edhe dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përmbardues.

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit është konstatuar se organi përmbardues e ka lejuar përmbardimin në bazë të dokumenteve përmbarduese që parashihen sipas ligjeve tjera pa u plotësuar kriteret ligjore. Shkeljet janë evidentuar sidomos kur përmbardimi është caktuar në bazë të kontratës së pengut, duke mos u respektuar dispozitat ligjore të nenit 162 dhe 163 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, sepse pengu nuk është regjistruar në zyrën për regjistrimin e pengut, dhe kështu nuk prodhon efekt juridik, apo kur pengu është regjistruar dhe kanë kaluar më shumë se tre vite, e drejta e pengut pa posedim e



humb efektin e saj ndaj personave të tretë, përveç kur vazhdohet regjistrimi ose kur pengu pa posedim shndërrohet në peng posedimor.

Aktualisht me rastin e shkrimit të këtij punimi ka hyrë në fuqi edhe Ligji nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, ku listës së dokumenteve përmbartuese i është shtuar edhe kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut (shih nenin 5 të këtij ligji).

### **2.1.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

#### **Aktvendimi AC.nr.2237/2015, i datës 10.10.2016**

##### **Arsyetim**

*Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktvendimin E.nr.858/12 të dt.10.04.2015, e ka refuzuar kundërshtimin e debitorëve – garantuesve, penglënës A.A, kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbartimit E.nr.858/2012 të dt. 13.10.2014, si të pa bazuar.*

*Gjykata e Apelit, vlerëson se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të LPK-së, nga neni 182.1 të LPK-së, si dhe nenit 38 të LPP-ës dhe nenit 162 dhe 163 të Ligjit për Pronësinë dhe për të Drejta Tjera Sendore, ku gjykata nuk ka zbatuar drejt dispozitat ligjore dhe kjo ka pasur ndikim në nxjerrjen e vendimit të ligjshëm.*

*Në rastin konkret kreditori ka ushtruar propozim për përmbartim në bazë të kopjes së dokumentit përmbartimor – marrëveshjes mbi pengun nr.K0710/975 të dt.06.06.2011, si dhe marrëveshjet garantuese të dt. 06.06.2011, ku nuk janë plotësuar kriteret ligjore të dispozitës nga neni 38.1 të LPP-ës, ku citohet “Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit nëse është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit” dhe 38.2 ku citohet se “Në rast se propozimi për përmbartim nga paragrafin 1 i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuesit dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbartues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.*

*Këto dispozita janë në përputhshmëri edhe me dispozitat e nenit 37.1 të LPP në fuqi në kohën e dorëzimit të propozimit ku parashihet “Në qoftë se propozimi për përmbartim paraqitet në gjykatën që nuk ka vendosur në shkallë të parë për kërkesë-padinë, bashkë me propozimin paraqitet edhe dokumenti përmbartimor, në origjinal apo kopje të vërtetuar, në të cilën është vënë vërtetimi për përmbartueshmërinë”.*

*Po ashtu aktvendimi i atakuar është marrë edhe me shkelje të dispozitës së nenit 162 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejta Tjera Sendore, sepse pengu nuk është regjistruar sipas këtij ligji. Neni 162 i këtij ligji përcakton: “Regjistrimi i së drejtës së pengut pa posedim në regjistrin e pengut prodhon efekt me regjistrimin e njoftimit të pengut në zyrën për regjistrimin e pengut. Një peng konsiderohet të jetë i regjistruar në regjistrin e pengut,*

*atëherë kur njoftimi i pengut të ketë arritur në zyrën për regjistrimin e pengut në formën e parashikuar dhe duke e paguar taksën e parashikuar. Me kalimin e afatit tre (3) vjeçar, e drejta e pengut pa posedim e humb efektin e saj ndaj personave të tretë, përveç kur vazhdohet regjistrimi ose kur pengu pa posedim shndërrohet në peng posedimor”.*

## **2.2 BAZAT JURIDIKE PËR CAKTIMIN E PËRMBARIMIT**

*Ligji për Procedurën Përmbaremore nr.04/L-139 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.3, i dt. 31.01.2013, Prishtinë), në nenin 21 të LPP-së, ka paraparë bazat juridike për caktimin e përmbaremit me përmbajtje si në vijim:*

*Neni 21 Bazat juridike për caktimin e përmbaremit*

*Organi përmbareues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbareimin vetëm në bazë të dokumentit përmbareues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, në rast se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.*

### **2.2.1 Koment i shkurtër**

Organi përmbareues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbareimin vetëm në bazë të dokumentit përmbareues dhe dokumentit të besueshëm, përpos nëse me Ligjin e Procedurës Përmbaremore nuk është parashikuar diçka tjetër. Nga kjo rrjedh se përmbareimi nuk mund të caktohet nëse nuk ka titull përmbareimor, apo të lejohet përmbareimi mbi bazën e një dokumenti përmbareimor e të përcaktohen që të ndërmerren veprime tjera që nuk janë paraparë në atë dokument.

### **2.2.2 Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit**

Harmonizimi i ligjeve me ato të BE-së, vërehet te titujt ekzekutiv që parasheh legjislacioni ynë e që në masë të madhe përmbush kriteret e udhëzimit për zbatim më të mirë të rekomandimeve ekzistuese të Këshillit mbi Përmbareimin të Komisionit Evropian për Efikasitet të Drejtësisë (CEPEJ) ku te dokumenti i pambarueshëm lidhur me përkufizimin dhe formën e dokumentit citohet:

“Korniza legjislative shtetërore duhet të përmbajë përkufizim të qartë të asaj se çka konsiderohet dokument i përmbareueshëm dhe kushtet e përmbareimit të tij. Dokumentet e përmbareimit duhet të hartohen në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke mos lënë hapësirë për keqinterpretim”.

Mirëpo përkundër kësaj në praktikë vërehen vështirësi në përmbareim p.sh. sa i përket dokumentit noterial për shkak se nuk përpilohen nga noterët në pajtim me nenin 3 dhe 32 të Ligjit mbi Noterinë.

Sipas dispozitave të ligjit të përmbareimit në fuqi, dokument përmbareimor parashihet vendimi përmbareues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi, që në praktikë sjell dilemën se a mund të përmbareohet secili vendim i dhënë në procedure administrative edhe pse kjo është në kolizion me dispozitën e nenit 1 të këtij ligji ku citohet: “Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbareimin e vendimit të marrë në procedurë administrative dhe

për kundërvajtje, me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përbarimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër”.

Përbarimi nuk i nënshtrohet të gjitha vendimeve gjyqësore apo administrative, por vetëm atyre vendimeve që kanë të bëjnë me detyrimin për të dhënë, vepruar ose mos vepruar. Dokumentet përbaruese duhet të jenë të përbarueshme dhe të përshtatshme për përbarim.

LPP ka përcaktuar qartë se cilat janë dokumente përbaruese, dhe cilat janë dokumente të besueshme.

Sipas nenit 22 të LPP-së, dokumente përbaruese janë:

- vendimi përbarues i gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përbaruese;
- vendimi përbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktajtimi (më tej: ujdia);
- dokumenti noterial i përbarueshëm në pajtim me ligjin për noterinë;
- marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi Ndërmjetësimin pas aprovimit të gjykatës;
- aktvendimet, aktet dhe memorandumet për ujditë gjyqësore të gjykatave të huaja si dhe vendimet e gjykatave të huaja të arbitrazhit, dhe ujditë e arritura para gjykatave të tilla në raste të arbitrazhit, të cilat janë pranuar për përbarim brenda territorit të Republikës së Kosovës;
- vendimet dhe marrëveshjet përbaruese të arbitrazhit në Republikën e Kosovës të shpallura të ekzekutueshme nga gjykata;
- kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe të regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit;
- vendimi gjyqësor i vërtetuar si urdhër përbarues evropian;
- dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përbarues.

Gjykata e Apelit vëren se, duke mos u vlerësuar drejt bazat juridike dhe dokumentet përbaruese që parashihen me ligje tjera si dokument përbarues, organi përbarues ka refuzuar propozimin përbarimor duke mos e trajtuar kontratën e lizingut si dokument përbarimor. Në nenin 22.2 të Ligjit për Lizingun (ligji nr. 03/L-103) parashihet “Nëse lizingdhënësi procedon me veprim gjyqësor, ai duhet të parashtojë një kërkesë në gjykatën e juridiksionit kompetent duke kërkuar një urdhër, ex parte dhe pa paralajmërim tek lizingmarrësi ose ndonjë person tjetër, duke autorizuar lizingdhënësin ose agjentin e autorizuar të tij të riposëdoj Asetin Objekt Lizingu dhe t'i dorëzohet lizingdhënësit. Kjo parashtrësë do të vendoset nga gjykata jo më vonë se tri (3) ditë pune pas datës së dorëzimit të kërkesës”.

*Ndërsa sipas neni 29 dokumentet e besueshme janë:*

- *kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthjese, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës;*
- *ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave;*
- *faturat;*
- *dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike;*
- *llogaritja e kamatës konsiderohet si pjesë e dokumentit të besueshëm.*

Dilemat më të mëdha në praktikë janë sa i përket faturës si dokument i besueshëm se çka duhet të përmbajë një faturë për t'u trajtuar si dokument i besueshëm, a mjafton që të përmbushen vetëm elementet nga neni 29 parag.3 i LPP-së që “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Nëse me rastin e shqyrtimit të propozimit në bazë të këtij dokumenti plotësohen kriteret e lartcekura atëherë aprovohet propozimi dhe lejohet përmbarimi. Një fakt tjetër që ka sjellë dilemë është se a duhet faturat të jenë të nënshkuara në rastet kur paraqiten palë në procedurë subjektet juridike? ose më saktë a duhet të jenë të pranuar nga debitori? Fillimisht faturat duhet të lëshohen nga një subjekt që zhvillon një veprimtari afariste-biznesore dhe në momentin e arritshmërisë së kërkesës i dërgohen debitorit, në mënyrë që të pranohen nga ai për përmbushje të detyrimit.

Nëse nga dokumenti i besueshëm nuk shihet se a është bërë e kërkueshme kredia, atëherë përmbarimi caktohet vetëm në qoftë se kreditori paraqet deklaratë me shkrim, se kredia e tij është bërë e kërkueshme duke u treguar edhe dita për një gjë të tillë. Deri më tani në praktikë kjo nuk është aplikuar asnjëherë nga organi përmbarues, ku më vonë këto dilema janë eliminuar pas parashtrimit të mjeteve juridike, (shih nenin 30 të LPP-së).

### **2.2.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

#### **Aktvendimi AC.nr.787/2015, i datës 12.07.2016**

##### **Arsyetim**

*Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e atakuar, Ep.nr.4/2015, të datës 27.01.2015, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit A.A nga Peja, i ushtruar kundër urdhërit për përmbarim P.nr.975/14 i datës 12.12.2014 i përmbaruesve privat V.B. dhe I. G. nga Prishtina, si dhe është anuluar urdhëri për përmbarim P.nr.975/14 i datës 12.12.2014.*

*Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë ka vlerësuar përfundimin e këtillë të gjykatës së shkallës së parë dhe aktvendimin e atakuar si dhe të gjitha shkresat e lëndës, dhe ka gjetur se një aktvendim i tillë është i pabazuar dhe se nuk ka mbështetje ligjore dhe as mbështetje në shkresat e lëndës.*

*Gjykata e Apelit, vlerëson se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të LPK-së, nga neni 182.1, 182.2 pika n) të LPK-së, ku dispozitivi i aktvendimit të atakuar është në kundërshtim me arsyetimin kontradiktor me vetete, nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare dhe ato që janë dhënë janë të paqarta, ku gjykata nuk ka zbatuar drejt dispozitatat ligjore dhe kjo ka pasur ndikim në nxjerrjen e vendimit të ligjshëm, si dhe të neneve 36, 38 të LPP-ës dhe nenit 22.2 të Ligjit për Lizingun (ligji nr. 03/L-103).*

*Kjo gjykatë vlerëson se, aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarimore nga neni 36.1 të LPP-ës ku përcaktohet “Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti i përmbarueshmërisë, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”. Vërtetimin respektivisht klauzolën e përmbarueshmërisë e jep gjykata apo organi administrativ që ka vendosur në shkallë të parë. Ku në rastin konkret kreditori, propozimit përmbarimor nuk i ka bashkangjitur edhe dokumentin përmbarimor i*

*cili theksohet në propozim, si dhe nenit 38.1 të LPP-ës, ku citohet “Propozimi për përmbarrim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të së cilit kërkohet përmbarrimi, kërkuesi i përmbarrimit dhe debitorit, adresa e vendbarrimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet të cilit duhet kryer përmbarrimi, objekti i përmbarrimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit” dhe 38.2 ku citohet se “Në rast se propozimi për përmbarrim nga paragrafi 1 i këtij neni nuk i përmban shënimet e kërkua dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarrues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.*

*Në nenin 22.2 të Ligjit për Lizingun (ligji nr. 03/L-103) parashihet “Nëse lizingdhënësi procedon me veprim gjyqësor, ai duhet të parashtrrojë një kërkesë në gjykatën e juridiksionit kompetent duke kërkuar një urdhër, ex parte dhe pa paralajmërim tek lizingmarrësi ose ndonjë person tjetër, duke autorizuar lizingdhënësin ose agjentin e autorizuar të tij ta riposedojë Asetin Objekt Lizingu dhe t’i dorëzohet lizingdhënësit. Kjo parashtrresë do të vendoset nga gjykata jo më vonë se tri (3) ditë pune pas datës së dorëzimit të kërkesës”.*

*Gjithashtu edhe neni 22 pika 1.9 e Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, parashihet se dokument përmbarrues është edhe “dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përmbarrues”.*

#### **Aktvendimi AC.nr.4335/2015, i datës 20.07.2016**

*Pas shqyrtimit të prapësimit të debitorit, Gjykata Themelore në Pejë, me aktvendimin Ep.nr.82/15 i dt.02.10.2015, e ka shfuqizuar urdhërin e përmbarruesit privat P.nr.129/2015, i dt.19.05.2015, në çështjen përmbarrimore të kreditorit KS S....., me seli në Prishtinë, ndaj debitorit NTT “K....-E.....”, me seli në Pejë, dhe i ka anuluar të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra nga përmbarruesi privat, lidhur me urdhërin e sipër theksuar për shkak se dokumenti në bazë të cilit është urdhëri përmbarrues nuk ka titull ekzekutiv.*

*Gjykata e Apelit, vlerëson se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 par.2 pika n) e LPK-së, e lidhur me nenin 17, 21 dhe 29 par. 1 nënpar. 1.3 dhe par.3 të LPP-së, duke rënë në kundërshtim me vetveten. Paqartësia e këtij aktvendimi qëndron në atë se, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është i paqartë dhe jo në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë.*

*Përmbarrimi caktohet mbi bazën e një dokumenti përmbarrues sipas nenit 21 të LPP-së, e lidhur me nenin 22, si dhe në bazë të dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 të po këtij ligji.*

*Gjykata e Apelit nuk mund ta pranojë qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, kur vlerësoi se baza juridike e borxhit duhet të jetë detyrim sipas kontratës për sigurime 3930005/2011 i dt.31.05.2011, por në të cilën kontratë nuk janë të përfshira elementet esenciale, andaj si e tillë nuk mund të konsiderohet si dokument përmbarrimor për arsye se propozimi për përmbarrim është parashtruar mbi bazën e një dokumenti të besueshëm-faturës, e jo në bazë të kontratës dhe se detyrë e gjykatës së shkallës së parë është ta bëjë vlerësimin se a*

*plotësohen kriteret për lejimin e përmbarrimit në bazë të dokumentit të besueshëm mbi bazën e të cilit është marrë urdhëri se ky dokument a është dokument i paraparë në nenin 29 të LPP-së, dhe a është i përshatshëm për përmbarrim sipas par. 3 të këtij ligji ku ceket se “dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”.*

## **2.3 KUFIJTË E PËRMBARRIMIT**

*Ligji për Procedurën Përmbarrimore nr.04/L-139 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.3, i dt. 31.01.2013, Prishtinë), me dispozitën e nenit 49 ka përcaktuar kufijtë e kryerjes së përmbarrimit me përmbajtje si në vijim.*

*Neni 49 i LPP - Përmbarrimi kryhet brenda kufijve të caktuar në aktvendimin për përmbarrimin apo urdhërin për përmbarrim.*

### **2.3.1 Koment i shkurtër**

Organi përmbarrues (gjykata ose përmbarruesi privat) e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues dhe dokumentit të besueshëm.

Përmbarrimi kryhet brenda kufijve të caktuar në aktvendimin për përmbarrimin apo urdhërin për përmbarrim i cili është marrë mbi bazën e një dokumenti përmbarrimor, duke përcaktuar detyrimet ashtu siç përcaktohen në atë titull.

Si urdhëri për përmbarrim ashtu edhe aktvendimi duhet të kenë përmbajtje të njëjtë. Në aktvendimin për përmbarrimin dhe urdhërin për përmbarrim në bazë të titullit përmbarrues duhet të tregohet dokumenti përmbarrues, kreditori dhe debitori i përmbarrimit, kredia që duhet të realizohet, mjeti dhe objekti i përmbarrimit, si dhe të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit.

### **2.3.2 Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit**

Meqenëse rastet më problematike janë sa i përket kthimit të punëtorëve në punë vërehet se gjykatat lejojnë përmbarrimin për kthimin e punëtorit në punë, duke mos paraparë në aktvendimin për lejimin e përmbarrimit edhe mënyrën e zbatimit të përmbarrimit që është përmes gjobave.

Në raste tjera, gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar gabimisht procedurën e shqyrtimit të propozimit përmbarrimor lejon përmbarrimin në bazë të dokumentit përmbarrimor për kthimin e punëtorit në punë. Pastaj në fazën e zbatimit të përmbarrimit ndërmerr veprime lidhur me kompensimin e pagave duke kaluar kufijtë e përmbarrimit të aktvendimit me të cilin është lejuar përmbarrimi, apo kur gjykatat lejojnë përmbarrimin për kthimin e punëtorit në punë, dhe kompensimin e pagave edhe kur në dokumentin përmbarrimor është paraparë vetëm kthimi i punëtorit në punë por jo edhe kompensimi i pagave. Në këto raste ka tejkalim të kufijve të përmbarrimit në fazën e parë të lejimit të përmbarrimit.

Gjykatat pas shqyrtimit të validitetit të prapësimit në seancë dëgjimore, vlerësojnë në mënyrë jo të drejtë duke detyruar debitorin, që kreditorin ta kthejë në vendin e punës, edhe pse ky detyrim sipas dokumentit përmbarimor ka qenë deri sa autoriteti punëdhënësi-debitori ta përsërisë konkursin dhe tërë procedurën e intervistimit dhe ta zgjedhë kandidatin në bazë të meritës. Debitori në këto raste edhe pse e ka përmbushur detyrimin e vet, gjykata e refuzon prapësimin e debitorit dhe e detyron debitorin ta kthejë kreditorin në punë, duke i tejkaluar kufijtë e përmbarimit të përcaktuar sipas aktvendimit për përmbarim.

### 2.3.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit

#### Aktvendimi AC.nr.1953/2016, i datës 22.11.2016

##### Arsyetim

*Gjykata Themelore në Ferizaj me aktvendimin E.nr.03/2016 të dt.08.04.2016, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Kaçanikut-Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, i ushtruar kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit E.nr.03/16, i datës 22.01.2016 dhe detyrohet debitori Komuna e Kaçanikut, Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, që kreditorin, ta kthejë në vendin e punës sipas vendimit Nr.794/09, të datës 21.04.2009, derisa nuk përfundon procedura intervistuese, në bazë të meritës, për pozitën Drejtor në Qendrën e Konkurrimit dhe Arsimin Parashkollor "A....." në Kaçanik, edhe pse ka përfunduar procedura intervistuese, në bazë të meritës, për pozitën Drejtor, si dhe kompensimin e pagave me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, nga muaji shtator 2013, e deri në kthimin në vendin e punës.*

*Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë ka vlerësuar përfundimin e këtillë të gjykatës së shkallës së parë dhe aktvendimin e atakuar si dhe të gjitha shkresat e lëndës dhe ka gjetur se një aktvendim i tillë është i pabazuar dhe se nuk ka mbështetje ligjore dhe as mbështetje në shkresat e lëndës, dhe se është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të LPK-së, nga neni 182.1, 182.2 pika n) dhe i) të LPK-së, e lidhur nenin 17 dhe 49 të LPP-së, ku dispozitivi i aktvendimit të atakuar është në kundërshtim me arsyetimin, kontradiktor me vetvete, nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare dhe ato që janë dhënë janë të paqarta, ku gjykata nuk ka zbatuar drejt dispozitat ligjore dhe kjo ka pasur ndikim në nxjerrjen e vendimit të ligjshëm.*

*Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar shkresat e lëndës dhe provat e ofruara, si dhe pas shqyrtimit të validitetit të prapësimit në seancën gjyqësore ka vlerësuar në mënyrë jo të drejtë, duke detyruar debitorin Komunën e Kaçanikut-Drejtorinë për Arsim dhe Kulturë, që Kreditorin ta kthejë në vendin e punës, derisa nga shkresat e lëndës del se në konkursin e fundit të shpallur më datë 02.07.2015, nga autoriteti punëdhënës i cili ka përsëritur konkursin dhe tërë procedurën e intervistimit të kandidatëve dhe në bazë të meritës është zgjedhur -----, si kandidat e suksesshme për pozitën Drejtor e Qendrës se Edukimit dhe Arsimin Parashkollor "A....." në Kaçanik, nga kjo rrjedh se debitori ka vepruar sipas vendimit të përmbarimit të lejuar në bazë të dokumentit përmbarimor vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me nr. Nr.794/09, i datës 21.04.2009 ku është obliguar Komuna e Kaçanikut, Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, për kthimin e kreditores në vendin e punës në pozitën e Drejtorit të Qendrës se Edukimit dhe Arsimin Parashkollor "A...." në Kaçanik, si dhe t'ia bëjë pagesat e të ardhurave personale*

*në mënyrë retroaktive prej datës 15.12.2012, derisa nuk përfundon procedura intervistuese dhe zgjedhja e kandidatit në bazë të meritës.*

*Bazuar në nenin 49 të LPP-së, përmbarimi kryhet brenda kufijve të caktuar në aktvendimin për përmbarimin apo urdhërin për përmbarim.*

### **Aktvendimi AC.nr.972/16, i datës 08.12.2016**

*Arsyetimi i aktvendimit të Gjykatës së Apelit, me të cilin pas aprovimit të pjesëshëm të ankesës së debitorit Komuna e Klinës - Drejtoria Komunale e Arsimit, ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë-dega në Klinë, CP.nr.58/15, i datës 08.12.2015, si në vijim “pjesërisht **aprovohet** propozimi i kreditorit për kthimin e tij në vendin e punës pas përfundimit të postit politik, apo në vendin që i përgjigjet kualifikimit të tij profesional. Përmbarimi zbatohet me anë të caktimit të gjobave në të holla kundër punëdhënësit dhe personit përgjegjës në të, sipas dispozitave të nenit 15 dhe 16 të LPP-së, **refuzohet** propozimi i kreditorit si i pabazuar në pjesën sa i përket pagimit të pagave”, mbetet i pandryshuar vendimi i atakuar sa i përket shpenzimeve procedurale rreth përmbarimit.*

*Gjykata e Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë kur prapësimin e debitorit e ka refuzuar si të pa bazuar në pjesën që ka të bëjë me detyrimin e debitorit për kthimin e tij në vendin e punës pas përfundimit të postit politik apo në vendin që i përgjigjet kualifikimit të tij profesional, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar, se vendimi i Ministrisë së Arsimit të Shkencës dhe Teknologjisë nr.10/1-5 të datës 05.11.2014 sektori i Inspeksionit të Arsimit në Pejë, i vërtetuar me vendimet e Ministrisë së Arsimit të Shkencës dhe Teknologjisë nr.10/9088 të datës 27.11.2014 dhe nr.2/470 të datës 04.02.2015 në rastin konkret është dokument përmbarues. Kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së e cila dispozitë përcakton se: “dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative” dhe përbën bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21 duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragrafi 3 dhe 27 paragrafi 1 të po këtij ligji ku përcaktohet se: “dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim, në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”.*

*Por kjo gjykatë, e ndryshoi vendimin e atakuar pjesërisht sa i përket mënyrës së zbatimit të përmbarimit për kthimin e punëtorit në punë, ku duhet të zbatohet me anë të caktimit të gjobave në të holla kundër punëdhënësit dhe personit përgjegjës në të, sipas dispozitave të nenit 15 dhe 16 të LPP-së, dhe në pjesën sa i përket pagimit të pagave, duke refuzuar pjesërisht propozimin e kreditorit si të pabazuar, sepse në dokumentin përmbarimor nuk është paraparë pagesa e pagave.*

## **2.4 PROCEDURA SIPAS PROPOZIMIT PËR KUNDËR-PËRMBARIM**

*Ligji për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.3, i datës 31.01.2013, Prishtinë), me dispozitat e nenit 55 ka rregulluar procedurën sipas propozimit për kundër-përmbarim me përmbajtje si në vijim.*



*Neni 55 - Procedura sipas propozimit për kundër-përmbarrim*

- 1. Propozimin për kundër-përmbarrim, gjykata ia dërgon kreditorit dhe kërkon nga ai që brenda afatit prej tre (3) ditësh nga dita e dorëzimit të deklarohet lidhur me propozimin e tillë.*
- 2. Nëse procedura e përmbarrimit kryhet para përmbarruesit privat, përmbarruesi privat, pa vonesë dërgon një kopje të dosjes tek gjykata kompetente dhe i njofton palët se procedura sa i përket propozimit për kundër përmbarrim vazhdon para gjykatës kompetente.*
- 3. Po qe se brenda afatit nga paragrafi 1 i këtij neni, kreditori e kundërshton propozimin për kundër-përmbarrim, atëherë gjykata për të vendosë pas mbajtjes së seancës gjyqësore.*
- 4. Me aktvendimin me të cilin miratohet propozimi për kundër-përmbarrim, gjykata e urdhëron kreditorin që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh t'ia kthejë debitorit, respektivisht personit të tretë atë që e ka marrë me anë të përmbarrimit.*
- 5. Aktvendim të kështillë gjykata nxjerrë edhe po qe se kreditori i përmbarrimit nuk deklarohet fare brenda afatit të caktuar, ose kur deklaron se nuk e kundërshton propozimin për kundër përmbarrim.*

#### **2.4.1 Koment i shkurtër**

Debitori ka të drejtë që në të njëjtën procedurë përmbarrimore edhe pasi të ketë përfunduar përmbarrimi, të kërkojë nga gjykata nxjerrjen e aktvendimit me të cilin i urdhërohet kreditorit që t'ia kthejë atë që e ka marrë në bazë të procedurës së përmbarrimit, nëse plotësohet një nga kriteret e parapara në nenin 54 të LPP-së. Në këtë rast ndryshojnë rolet e palëve në procedurë kreditori i mëhershëm kalon në cilësinë e debitorit ndërsa debitori në atë të kreditorit. Po qe se brenda afatit kreditori e kundërshton propozimin për kundër përmbarrim, atëherë për të vendos gjykata pas mbajtjes së seancës gjyqësore. Nëse kreditori e kundërshton propozimin për kundër përmbarrim, atëherë gjykata për të vendosë pas mbajtjes së seancës gjyqësore.

#### **2.4.2 Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit**

Edhe pse këto raste në numër janë të vogla, gjykatat me rastin e vlerësimit kanë bërë një varg shkeljesh duke mos përcaktuar rolin e palëve lidhur me faktin se në procedurën e kundër përmbarrimit ndërrohen rolet e palëve dhe kreditori bëhet debitor kurse debitori merr rolin e kreditorit, ndërsa gjykatat lejojnë kundër përmbarrimin dhe nuk dihet kush është kreditor apo debitor, duke mos kërkuar nga pala që ta rregullojë parashtrësën-propozimin me njoftim lidhur me pasojat. Nga praktika gjyqësore vërehet se nëse kreditori e kundërshton propozimin për kundër-përmbarrim, atëherë gjykata për të vendosë pa mbajtur fare seancë gjyqësore, e dispozitat ligjore kërkojnë që të vendoset pas mbajtjes së seancës gjyqësore.

Po ashtu në praktikë, përmbarruesit privat në rastet kur përmbarrimi kryhet para tyre kanë vazhduar me procedurën ndërsa kërkesa nga ligji rrjedh se, "Nëse procedura e përmbarrimit kryhet para përmbarruesit privat, përmbarruesi privat, pa vonesë e dërgon një kopje të dosjes tek gjykata kompetente dhe i njofton palët se procedura sa i përket propozimit për kundër-përmbarrim vazhdon para gjykatës kompetente".

### 2.4.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit

**Aktvendimi AC.nr.3674/14, i datës 05.09.2016**

#### **Arsyetim**

*Në hyrje të aktvendimit të atakuar si dhe në arsyetim ceket se kreditor është KS “K.....R...”, në Prishtinë, të cilën e përfaqëson -----, kurse debitorë janë, që të gjithë nga f.sh. Morinë, komuna Gjakovë, ndërsa në dispozitiv të aktvendimit theksohet se prapësimi i debitorëve, i parashtruar kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë Cp.nr.31/14 i dt 16.01.2014, refuzohet si i pa bazuar, sipas kësaj në fuqi mbetet aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit ku kreditor janë ....., që të gjithë nga f.sh. Morinë, komuna Gjakovë, kurse debitor është KS “K..... R..”, në Prishtinë, pasi që aktvendimi është në kundërtënie me vetveten dhe i paqartë, se është e paqartë kush është kreditor dhe kush është debitor. Gjykata e shkallës së parë edhe përkundër njoftimit nga ana e përfaqësuesit të KS “K..... R..”, nuk ndërmerr veprime lidhur me rregullimin e aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit-kundër përmbarimit.*

*Gjykata e shkallës së parë është dashur që të veprojë konform nenit 17 të LPP-së, e lidhur me nenin 99 dhe 102 të LPK-së, lidhur me korigjimin dhe plotësimin e parashtrës-propozimit kur nuk është i kuptueshëm dhe jo i plotë.*

*Gjykata e shkallës së parë ka vendosur lidhur me prapësimin pa mbajtur seancë, e që ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 55 parg.3 të LPP-së, ku ceket se “në rast se brenda afatit, kreditori e kundërshton propozimin për kundër përmbarim, atëherë për të vendos gjykata pas mbajtjes së seancës gjyqësore”.*

*Në dispozitën e nenit 55 parg.2 të LPP-së përcaktohet “nëse procedura e përmbarimit kryhet para përmbaruesit privat, përmbaruesi privat pa vonesë e dërgon një kopje të dosjes tek gjykata kompetente dhe njofton palët se procedura sa i përket propozimit për kundër përmbarim vazhdon para gjykatës kompetente, andaj duke u bazuar në dispozitën e lartcekur, Gjykata e Apelit e anuloi konkluzionin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, Cp.nr.31/14, i dt 18.09.2014, për faktin se procedura e kundër përmbarimit ka filluar në gjykatë dhe duhet të përfundojë para Gjykatës Themelore në Gjakovë.*

### **2.5 DETYRIMI I VEPRIMIT QË MUND TË KRYHET VETËM NGA DEBITORI**

*Ligji për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.3, i dt. 31.01.2013, Prishtinë), me dispozitat e nenit 293 ka paraparë se si duhet të kryhet përmbarimi kur detyrimi i veprimit mund të kryhet vetëm nga debitori me përmbajtje si në vijim.*

*Neni 293 i LPP-së - Detyrimi i veprimit që mund të kryhet vetëm nga debitori*

- 1. Në qoftë se veprimin e caktuar në dokumentin përmbarues mund ta kryejë vetëm debitori, organi përmbarues me aktvendimin për përmbarimin ose urdhërin përmbarues do t'ia caktojë debitorit afatin për përmbushjen e detyrimit. Me aktvendimin ose urdhërin për përmbarim organi përmbarues njëherit i kërcënohet*

*debitorit, dhe eventualisht personave përgjegjës për debitorin që është person juridik, se do të gjobiten sipas nenit 15 dhe 16 të këtij ligji, nëse brenda afatit të caktuar nuk e përmbushin detyrimin.*

- 2. Në qoftë se debitori brenda afatit që ia ka caktuar organi përmbarues nuk e përmbushë detyrimin, gjykata sipas propozimit të kërkuesit të përmbarimit, do të veprojë më tutje sipas dispozitave të nenit 15 dhe 16 të këtij ligji.*
- 4. Në qoftë se veprimi të cilin mund ta kryejë vetëm debitori, nuk varet vetëm nga vullneti i tij (krijimi i veprës artistike muzikore, pamore, letrare, arkitektonike, etj.), atëherë kreditori nuk ka të drejtë ta kërkojë shpërblimin nga paragrafi 1. i këtij neni, por vetëm të drejtën që të kërkojë shpërblimin e dëmit të pësuar.*

### **2.5.1 Koment i shkurtër**

Në qoftë se veprimin e caktuar në dokumentin përmbarues mund ta kryejë vetëm debitori, organi përmbarues me aktvendimin për përmbarimin ose urdhërin përmbarues do t'ia caktojë debitorit afatin për përmbushjen e detyrimit dhe se ky detyrim duhet të jetë i qartë se cilat veprime duhet të kryhen.

### **2.5.2 Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit**

Nga Gjykata e Apelit me rastin e shqyrtimit të ankesave është konstatuar se në disa raste gjykatat e shkallës së parë kanë bërë shkelje të dispozitave ligjore në të dyja fazat e procedurës, ku në fazën e parë e kanë lejuar përmbarimin jo në përputhje të plotë me dokumentin përmbarimor. Shkeljet konsistojnë në faktin se përmbarimi është lejuar mbi bazën e një dokumenti përmbarimor, ku veprimin e caktuar sipas atij dokumenti mund ta kryejë vetëm debitori p.sh, shfuqizimi i një dokumenti, anulimi i një konkursi, ndërsa gjykata e urdhëron që ta kryejë një pjesë të atij detyrimi si dhe veprime të tjera që nuk janë paraparë në atë dokument.

Në fazën e dytë, atë të zbatimit të përmbarimit, nuk përcakton veprimet të cilat duhet ndërmarë nëse debitori brenda afatit që ia ka caktuar organi përmbarues nuk e përmbushë detyrimin, ku gjykata sipas propozimit të kërkuesit të përmbarimit, do të veprojë më tutje sipas dispozitave të nenit 15 dhe 16 të LPP-së. Në rast se veprimi të cilin mund ta kryejë vetëm debitori, nuk varet vetëm nga vullneti i tij, atëherë kreditori nuk ka të drejtë ta kërkojë shpërblimin, por vetëm të drejtën që ta kërkojë shpërblimin e dëmit të pësuar.

### **2.5.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

**Aktvendimi AC.nr.3283/2015, i datës 09.12.2016**

#### **Arsyetim**

*Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktvendimin e atakuar CP.nr.81/2015 të dt.16.07.2015, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" në Mitrovicë, i ushtruar kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit CP.nr.81/15, i datës 12.05.2015 si të pabazuar.*

*Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë e ka vlerësuar përfundimin e këtyllë të gjykatës së shkallës së parë, dhe aktvendimin e atakuar si dhe të gjitha shkresat e lëndës,*

dhe ka gjetur se një aktvendim i tillë është i pabazuar dhe se nuk ka mbështetje ligjore dhe as mbështetje në shkresat e lëndës dhe se është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të LPK-së, nga neni 182.1, 182.2 pika n) dhe i) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 49 të LPP-së, ku dispozitivi i aktvendimit të atakuar është në kundërshtim me arsyetimin, kontradiktor me vetveten, nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare, dhe ato që janë dhënë janë të paqarta, ku gjykata nuk i ka zbatuar drejt dispozitat ligjore dhe kjo ka pasur ndikim në nxjerrjen e vendimit të ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, duke i vlerësuar shkresat e lëndës dhe provat e ofruara ka vlerësuar në mënyrë jo të drejtë kur ka lejuar përbarimin, duke obliguar debitorin që në afat prej 15 ditësh ta rishpall konkursin në pajtim me autorizimin MAP/DASHC 02/75011275 si dhe në pajtim me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për arsye se kjo nuk është paraparë në dokumentin përbarimor sepse aty është paraparë shfuqizimi i vendimit nr. 1219 i datës 21.11.2014 i Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë, anulimin e procedurës së rekrutimit të shpallur me datë 30.07.2014 për vendet e lira të punës të përshkruara si në dokumentin përbarimor si dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit dhe se në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës, dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit ta caktojë dhe ta zbatojë përbarimin.

Bazuar në nenin 49 të LPP-së, përbarimi kryhet brenda kufijve të caktuar në aktvendimin për përbarimin apo urdhërin për përbarim.

### **Aktvendimi AC.nr.2206/16, i datës 25.11.2016**

#### **Arsyetim**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.415/16 i dt.24.05.2016, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e përfaqësuesit të debitorit të ushtruar kundër aktvendimit mbi lejimin e përbarimit E.nr.415/16 i dt.13.04.2016

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë e ka vlerësuar përfundimin e këtyre të gjykatës së shkallës së parë dhe aktvendimin e atakuar, si dhe të gjitha shkresat e lëndës dhe ka gjetur se një aktvendim i tillë është i pabazuar dhe se nuk ka mbështetje ligjore dhe as mbështetje në shkresat e lëndës dhe është marrë me shkelje esenciale të dispozitave nga neni 182.1, 182.2 nën i) dhe 99 dhe 102 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 293 të LPP-së, për çfarë është dashur që ky aktvendim të anulohet, sepse gjykata paraprakisht është dashur që të veprojë konform këtyre dispozitave dhe të kërkojë nga kreditori që ta plotësojë parashtrësën – propozimin, duke kërkuar përbarimin ashtu si është paraparë në dokumentin përbarimor që “Drejtoria Komunale e Arsimit në Ferizaj ta shqyrtojë rastin e kreditores për vendin e punës Drejtor shkollë në SHFMU “Muharrem Shemsedini” në Fshatin e vjetër.

Neni 293 i LPP-së parasheh “Në qoftë se veprimin e caktuar në dokumentin përbarues mund ta kryejë vetëm debitori, organi përbarues, me aktvendimin për përbarimin ose urdhërin përbarues do t’ia caktojë debitorit afatin për përmbushjen e detyrimit. Me aktvendimin ose urdhërin për përbarim organi përbarues njëherit i kërcënohet debitorit

*dhe eventualisht personave përgjegjës për debitorin që është person juridik, se do të gjobiten sipas nenit 15 dhe 16 të këtij ligji, nëse brenda afatit të caktuar nuk e përmbushin detyrimin.*

## **2.6 SEANCA PËR SHITJEN DHE SHITJA E PALUAJTSHMËRISË**

*Ligji për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.3, i dt. 31.01.2013, Prishtinë), në nenin 236 të LPP-së, i ka paraparë kushtet për mbajtjen e seancës për shitjen e paluajtshmërisë, me përmbajtje si në vijim:*

*Neni 236 - Seanca për shitjen dhe shitja e paluajtshmërisë*

- 1. Në qoftë se në ditën e mbajtjes së seancës, aktvendimi apo urdhëri për përmbarimin nuk është bërë i përmbarueshëm, organi përmbarues mund ta shtyjë mbajtjen e seancës për ankand dhe shitje, për më së shumti tridhjetë (30) ditë.*
- 2. Pasi të ketë konstatuar se janë përmbushur kushtet për mbajtjen e seancës për ankand, organi përmbarues shpall se fillon ankandit.*
- 4. Ankandit i shitjes përfundon pasi të kenë kaluar pesë minuta, pas paraqitjes së ofertës më të favorshme.*
- 5. Pas përfundimit të ankandit, organi përmbarues konstaton se cilët janë ofertuesit që kanë ofruar çmimin mbi minimumin dhe njëherit konstaton se paluajtshmëria i shitet ofertuesit më të favorshëm nga të gjithë të tjerët, nëse janë plotësuar kushtet e tjera.*
- 6. Në seancën e ankandit për shitjen e paluajtshmërisë mbahet procesverbal.*

### **2.6.1 Koment i shkurtër**

Në dispozitat e këtij neni është rregulluar situata se si të veprohet nga organi përmbarues kur aktvendimi apo urdhëri për përmbarimin nuk është bërë i përmbarueshëm ditën e mbajtjes së seancës, apo si të veprohet nëse procedura e përmbarimit zbatohet për pjesën në bashkëpronësi, në kohën kur përfundon ankandit i shitjes si dhe konstatimet e organit përmbarues pas përfundimit të ankandit të shitjes.

### **2.6.2 Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit janë paraqitur raste kur këto dispozita nuk janë zbatuar në mënyrë të drejtë.

Shkeljet më të shumta të këtyre dispozitave kanë të bëjnë me atë se nuk është konstatuar se a janë përmbushur kushtet për mbajtjen e seancës për ankand, pastaj në procesverbal nuk konstatohet koha se kur ka filluar ankandit, dhe a ka përfunduar pasi të kenë kaluar pesë minuta pas paraqitjes së ofertës më të favorshme.

Shkelje tjetër që evidentohet nga praktika gjyqësore është mosmbajtja e procesverbalit në seancën e shitjes.

### 2.6.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit

**Aktvendimi AC.nr.1692/2015, i datës 18.07.2017**

#### **Arsyetim**

*Me urdhërin e përbaruesit privat P.nr.122/2014, të datës 27.03.2015 konstatohet se blerës është Kreditori Raiffesen Bank Kosovë, me seli në Prishtinë, dhe i është shitur si ofertues më i favorshëm i cili ka ofruar shumën prej 18,000.00€, patundshmëria e lënë hipotekë në pronësi të debitorit A.A, ngastra kadastrale 365 në sipërfaqe prej \_\_\_m<sup>2</sup>, nr. Fletës poseduese 17 ZK \_\_\_\_\_, komuna Lipjan.*

*Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, ka vlerësuar përfundimin e këtillë të gjykatës së shkallës së parë dhe aktvendimin e atakuar si dhe të gjitha shkresat e lëndës, dhe ka gjetur se një aktvendim i tillë është i pabazuar dhe se nuk ka mbështetje ligjore dhe as mbështetje në shkresat e lëndës.*

*Aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të LPK-së, nga neni 182.1 të LPK-së, e lidhur nenin 17 dhe nenit 236 të LPP-së (Ligjit për Procedurën Përbarimore) ku nuk janë zbatuar drejt dispozitat ligjore dhe kjo ka pasur ndikim në nxjerrjen e vendimit të ligjshëm.*

*Shkeljet e dispozitave ligjore konsistojnë në faktin se nuk janë zbatuar drejt dispozitat nga neni 236 i LPP-së, ku në pikën 6 të këtij neni parashihet se “në seancën e ankandit për shitjen e paluajtshmërisë mbahet procesverbal”, ku në shkresat e lëndës nuk figuron se është mbajtur procesverbali, pastaj nga organi përbarues, nuk janë konstatuar se a janë përmbushur kushtet për mbajtjen e seancës për ankand, në mënyrë që të shpallet se ankandi fillon, ku duhet të përcaktohet koha e fillimit dhe kohëzgjatja e ankandit vetëm për 5 minuta pas ofertës më të favorshme.*

### **2.7 PARASHTRESAT, SEANCAT DHE DOSJET**

*Ligji për Procedurën Përbarimore nr.04/L-139 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.3, i dt. 31.01.2013, Prishtinë), në nenin 20 të LPP-së, ka paraparë kushtet për mbajtjen e seancës dëgjimore me përmbajtje si në vijim:*

*Neni 20 - Parashtrës, seancat dhe dosjet*

- 1. Në procedurën përbarimore organi përbarues vepron në bazë të parashtrësve të palëve dhe dëshmime tjera të dokumentuara.*
- 2. Organi përbarues e cakton seancën dëgjimore atëherë kur një gjë e tillë është paraparë me këtë ligj, ose kur mendon se një gjë e tillë është e dobishme.*
- 3. Për punën e kryer seancë, në vend të procesverbalit organi përbarues mund të përpilojë shënim zyrtar.*
- 4. Jashtë seancës dëgjimore organi përbarues e dëgjon palën apo pjesëmarrësin tjetër në procedurë, nëse një gjë e tillë është paraparë me këtë ligj, apo kur vlerëson se një gjë e tillë është e nevojshme për sqarimin e ndonjë çështjeje, apo për deklarimin lidhur me ndonjë propozim të palës.*

5. *Mungesa e njëjës apo e të dyja palëve, ose e pjesëmarrësit tjetër në procedurë nga seanca dëgjimore, apo mosveprimi sipas letërthirrjes së organit përmbaues me qëllim të dëgjimit të tyre, nuk e pengon organin përmbaues që të veprojë në seancë.*

### **2.7.1 Koment i shkurtër**

Si në procedurat tjera, edhe në procedurën përmbaimore vepohet në bazë të parashtrësave të palëve dhe dëshmimeve tjera të dokumentuara.

Seanca dëgjimore caktohet atëherë kur është paraparë me ligj si p.sh. seanca e ankandit për shitjen e paluajtshmërive, ose kur organi përmbaues mendon se një gjë e tillë është e dobishme.

### **2.7.2 Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit, janë paraqitur raste kur këto dispozita nuk janë zbatuar në mënyrë të drejtë, edhe pse organi përmbaues në shkallë të parë cakton shumë pak seanca përveç atyre që duhet të caktohen se janë të parapara me ligj.

Seancat dëgjimore caktohen sa herë që është e dobishme për sqarimin e ndonjë çështjeje p.sh seanca për shqyrtimin e validitetit të prapësimit, apo për deklarimin lidhur me ndonjë propozim të palës. Kjo nënkupton se në këto seanca vetëm dëgjohen palët për sqarimin e ndonjë çështjeje e jo për faktet që kanë të bëjnë me ligjshmërinë e dokumentit përmbaimator, sepse ato janë çështje të procedurës kontestimore.

Shkeljet që janë evidentuar nga praktika e Gjykatës së Apelit, fokusohen në raste të mungesës së palës kreditore në këto seanca, edhe përkundër letërthirrjes së organit përmbaues ku gjykatat e shkallës së parë, duke vlerësuar gabimisht e konsiderojnë propozimin të tërhequr.

Neni 20.5 ka paraparë se “Mungesa e njëjës apo e të dyja palëve, ose e pjesëmarrësit tjetër në procedurë nga seanca dëgjimore, apo mosveprimi sipas letërthirrjes së organit përmbaues me qëllim të dëgjimit të tyre, nuk e pengon organin përmbaues që të veprojë në seancë”.

### **2.7.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

**Aktvendimi AC.nr.4498/15, i datës 21.10.2016**

#### **Arsyetim**

*Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e atakuar, E.nr.79/13, të datës 22.10.2015, e ka konsideruar si të tërhequr propozimin për përmbaimit të kreditorit dhe ka lënë jashtë fuqie aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren E.nr.79/13, të datës 01.03.2013, me të cilin është lejuar përmbaimit.*

*Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë ka vlerësuar përfundimin e këtillë të gjykatës së shkallës së parë, dhe aktvendimin e atakuar, si dhe të gjitha shkresat e lëndës, dhe ka*

*gjetur se një aktvendim i tillë është i pabazuar dhe se nuk ka mbështetje ligjore dhe as mbështetje në shkresat e lëndës.*

*Gjykata e Apelit, vlerëson se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të LPK-së, nga neni 182.1, 182.2 pika n) dhe i) të LPK-së e lidhur me nenin 17 dhe 20 të LPP-së, ku dispozitivi i aktvendimit të atakuar është në kundërshtim me arsyetimin, kontradiktor me vetete nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare dhe ato që janë dhënë janë të paqarta, ku gjykata nuk i ka zbatuar drejt dispozitat ligjore dhe kjo ka pasur ndikim në nxjerrjen e vendimit të ligjshëm.*

*Gjykata e Apelit nuk mund ta pranojë qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, kur konstaton se konsiderohet i tërhequr propozimi për përmbarrim, për arsye se kreditori nuk ka marrë pjesë në seancë edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, sepse neni 20 par.5 i LPP-së parasheh që mungesa e njëres apo e të dyja palëve ose e pjesëmarrësit tjetër në procedurë nga seanca dëgjimore apo mosveprimi sipas letërthirrjes së organit përmbarrues me qëllim të dëgjimit të tyre, nuk e pengon organin përmbarrues që të veprojë në seancë, që do të thotë se organi përmbarrues vepron vet pa prezencën e palëve.*

## **2.8 PEZULLIMI I PROCEDURËS PËRMBARRIMORE**

*Ligji për Procedurën Përmbarrimore nr.04/L-139 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.3, i dt. 31.01.2013, Prishtinë), në nenin 65 të LPP-së, i ka paraparë rrethanat kur pezullohet përmbarrimi sipas detyrës zyrtare me përmbajtje si në vijim:*

*Neni 65 - Pezullimi i procedurës përmbarrimore*

- 1. Përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj, përmbarrimi pezullohet sipas detyrës zyrtare në këto rrethana:
  - 1.1 kur debitori apo pasuritë e tij nuk mund të gjenden për qëllime të njoftimit dhe sekuestrimit të pasurisë brenda tre (3) muajve nga fillimi i rastit të përmbarrimit, përkundër faktit se janë bërë së paku dy (2) tentime nga organi përmbarrues që ta gjejë atë person për qëllime të njoftimit apo sekuestrimit të pasurisë;*
  - 1.2 kur është tentuar nga organi përmbarrues që të zbatohet përmbarrimi i vendimit së paku dy (2) herë, pa arritur asnjë rezultat të synuar nga këto veprime;*
  - 1.3 kur adresa e debitorit e dhënë në propozimin për përmbarrim vërtetohet se është e pasaktë, ndërsa kreditori nuk mund të argumentojë para organit përmbarrues saktësinë e adresës.**
- 2. Procedura e pezulluar me konkluzion nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të vazhdojë nëse kreditori në afatin prej gjashtë (6) muajsh paraqet informata të reja lidhur me çështjen e pezulluar, në të kundërtën procedura konsiderohet e përfunduar.*

### **2.8.1 Koment i shkurtër**

*Me dispozitat e nenit 65, ligjvënësi e ka paraparë mundësinë që të arrihet sa më shpejtë tek përfundimi i procedurës përmbarrimore, duke përcaktuar detyrime shtesë për zyrtarët përmbarrimor siç është tentimi për qëllime njoftimi si dhe përcaktimi i afatit kohor për ndërmarrjen e veprimeve.*



Dërgimi i shkresave përmes zyrtarëve postar nuk ka qenë efikas dhe si pasojë e kësaj edhe procedurat gjyqësore kanë vazhduar përtej afateve ligjore. Sipas këtyre dispozitave, kur adresa e debitorit e dhënë në propozimin për përmbarrim vërtetohet se është e pasaktë, ndërsa kreditori nuk mund ta argumentojë para organit përmbarrues saktësinë e adresës apo kur debitori apo pasuritë e tij nuk mund të gjenden për qëllime të njoftimit dhe sekuestrimit të pasurisë brenda tre muajve nga fillimi i rastit të përmbarrimit, përkundër faktit se janë bërë së paku dy tentime nga organi përmbarrues që ta gjejë atë person për qëllime të njoftimit apo sekuestrimit të pasurisë, përmbarrimi pezullohet sipas detyrës zyrtare.

## **2.8.2 Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit**

Shkeljet që janë evidentuar në numër të konsiderueshëm janë si në rastet kur organi përmbarrues ka tentuar vetëm një herë ta gjejë debitorin për qëllime njoftimi dhe e ka pezulluar përmbarrimin, apo në rastet kur debitori e ka pranuar vendimin për përmbarrim, mirëpo organi përmbarrues nuk ka tentuar që të zbatohet përmbarrimi së paku dy herë.

Po ashtu nuk i është dhënë mundësia kreditorit që të deklarohet për saktësinë e adresës së debitorit ashtu siç rrjedhë kërkesa nga ligji në nenin 65 parg.1 pika 1.3, ku përcaktohet se përmbarrimi pezullohet sipas detyrës zyrtare “kur adresa e debitorit e dhënë në propozimin për përmbarrim vërtetohet se është e pasaktë, ndërsa kreditori nuk mund ta argumentojë saktësinë e adresës para organit përmbarrues”.

Në mënyrë që kërkesa e kreditorit të realizohet në të njëjtën procedurë pa parashtuar propozim të ri, dhe duke mos krijuar shpenzime procedurale shtesë, procedura e pezulluar mund të vazhdojë nëse kreditori në afatin prej gjashtë (6) muajsh paraqet informata të reja lidhur me çështjen e pezulluar, në të kundërtën procedura konsiderohet e përfunduar.

## **2.8.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

### **Aktvendimi AC.nr.1171/2015, i datës 23.11.2016**

#### **Arsyetim**

*Gjykata Themelore në Pejë-dega Istog, me aktvendimin, E.nr.422/2010, i datës 11.03.2015, ka pezulluar procedurën përmbarrimore në këtë çështje juridiko-civile.*

*Kjo gjykatë, e ka vlerësuar përfundimin e këtillë të gjykatës së shkallës së parë dhe aktvendimin e atakuar si dhe të gjitha shkresat e lëndës, dhe ka gjetur se një aktvendim i tillë është i pabazuar dhe se nuk ka mbështetje ligjore dhe as mbështetje në shkresat e lëndës.*

*Gjykata e Apelit, vlerëson se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të LPK-së, nga neni 182.1, 182.2 pika n) dhe i) të LPK-së e lidhur me nenin 17 e 65 të LPP-së, ku dispozitivi i aktvendimit të atakuar është në kundërshtim me arsyetimin, kontradiktor me vetete, nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare dhe ato që janë dhënë janë të paqarta, ku gjykata nuk i ka zbatuar drejt dispozitatat ligjore dhe kjo ka pasur ndikim në nxjerrjen e vendimit të ligjshëm.*

*Gjykata e shkallës së parë, nuk ka vepruar drejt kur e ka pezulluar procedurën përmbaremore, me arsytim se ka tentuar njëherë për regjistrimin dhe sekuestrimin e sendeve të debitorit, sepse është dashur që të tentojë dy herë.*

*Sipas nenit 65 të LPP-së, përmbaremi pezullohet sipas detyrës zyrtare në këto rrethana:*

- *kur debitori apo pasuritë e tij nuk mund të gjenden për qëllime të njoftimit dhe sekuestrimit të pasurisë brenda tre (3) muajve nga fillimi i rastit të përmbaremit, përkundër faktit se janë bërë së paku dy (2) tentime nga organi përmbareues që ta gjejë atë person për qëllime të njoftimit apo sekuestrimit të pasurisë;*
- *kur është tentuar nga organi përmbareues që të zbatohet përmbaremi i vendimit së paku dy (2) herë pa arritur asnjë rezultat të synuar nga këto veprime;*
- *kur adresa e debitorit e dhënë në propozimin për përmbaremi vërtetohet se është e pasaktë ndërsa kreditori nuk mund ta argumentojë para organit përmbareues saktësinë e adresës.*
- *Procedura e pezulluar me konkluzion nga paragrafi 1 i këtij neni mund të vazhdojë, nëse kreditori në afatin prej gjashtë (6) muajsh paraqet informata të reja lidhur me çështjen e pezulluar, në të kundërtën procedura konsiderohet e përfunduar.*

*Në bazë të shkresave të lëndës, konstatohet se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas dispozitave të lartcekura.*

## **2.9 RI-PENGIMI I POSEDIMIT**

*Ligji për Procedurën Përmbaremore nr.04/L-139 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.3, i dt. 31.01.2013, Prishtinë), në nenin 297 të LPP-së, ka rregulluar ri-pengimin e posedimit me përmbajtje si në vijim:*

*Neni 297 - Ri-pengimi i posedimit*

1. *Në qoftë se në bazë të dokumentit përmbaremi, të nxjerrë sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit, është kryer përmbaremi, apo në qoftë se debitori e ka përmbushur vullnetarisht detyrimin e vet, kurse pas kësaj përsëri e bënë pengimin e posedimit i cili në esencë nuk dallohet nga pengimi i mëparshëm, organi përmbareues me propozimin e kërkuarit të përmbaremit, në bazë të dokumentit përmbareues të njëjtë, do të nxjerrë aktvendim të ri për përmbaremin apo urdhërin përmbareues, me qëllim të rivendosjes së gjendjes së mëparshme nëse kjo është e nevojshme dhe do të kërcënohet debitori me gjobitje nëse përsëri kryen pengim posedimi. Në këtë rast në mënyrë të përshtatur zbatohen edhe dispozitat e nenit 290 të këtij ligji.*
2. *Propozimin për përmbaremin nga paragrafi 1 i këtij neni, kërkuari i përmbaremit mund ta parashtojë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita kur i është bërë i ditur fakti për ri-pengimin e posedimit, por jo më vonë se brenda një (1) viti nga pengimi i përsëritur.*

### **2.9.1 Koment i shkurtër**

*Këto dispozita e rregullojnë çështjen kur debitori e ka përmbushur detyrimin vullnetarisht sipas dokumentit përmbaremi, mirëpo pas një kohe e bën prapë pengimin e posedimit.*

Nëse ri-pengimi i posedimit është bërë brenda afateve sipas parag. 2 të nenit 297, atëherë kreditori në procedurë të shpejtë pa pasur nevojë që t'i drejtohet gjykatës me padi të re dhe pa kosto tjera të shpenzimeve procedurale, në bazë të të njëjtit dokument përmbarimor, mund ta kërkojë nga organi përmbarues nxjerrjen e vendimit të ri për rivendosjen e gjendjes së mëparshme.

## **2.9.2 Të gjeturat nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit**

Nga praktika gjyqësore është vërejtur se përmbarimi është lejuar për ripengimin e posedimit pas kalimit të afateve ligjore të përcaktuara të nenit 297.2 të LPP-së, ku është përcaktuar se “Propozimin për përmbarimin nga paragrafi 1. i këtij neni, kërkuesi i përmbarimit mund ta parashtrijë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita kur i është bërë i ditur fakti për ri-pengimin e posedimit, por jo më vonë se brenda një (1) viti nga pengimi i përsëritur, si dhe pa u përcaktuar mënyra e zbatimit nga organi përmbarues me qëllim të rivendosjes së gjendjes së mëparshme nëse kjo është e nevojshme, dhe do të kërcënohet debitori me gjobitje nëse përsëri kryen pengim posedimin.

## **2.9.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

**Aktvendimi AC.nr.66/15, i datës 06.09.2016**

### **Arsyetim**

*Me aktvendimin e atakuar E.nr.319/2011 i dt.08.12.2014, të gjykatës së shkallës së parë, është refuzuar propozimi i kreditorit A.A. nga Prishtina, për përshtatshmëri të titullit përmbarimor në kuptim të nenit 71 pika 1.2 të LPP-ës, dhe janë udhëzuar debitorët që të drejtën e tyre ta realizojnë në procedurë kontestimore.*

*Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës vërtetoi se gjykata e shkallës së parë në bazë të procesverbalit të datës 19.09.2012, ka konstatuar se përmbarimi në bazë të propozimit të parë të kreditorit në këtë çështje përmbarimore është kryer, ky procesverbal është nënshkruar edhe nga vet kreditori.*

*Gjykata po ashtu kishte nxjerrë aktvendim mbi përfundimin e procedurës me datë 27.09.2012 të cilin kreditori nuk e kishte kundërshtuar, sepse ai vendim kishte të bënte vetëm me përmbarimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore.*

*Bazuar në nenin 297 par.2 i LPP-së, propozimin për përmbarim për ripengimin e posedimit kërkuesi i përmbarimit mund ta parashtrijë brenda afatit prej 30 ditësh nga dita kur ka marrë dijeni për ripengimin e posedimit por jo më vonë se brenda një viti nga pengimi i përsëritur.*

*Nga shkresat e lëndës konfirmohet se përmbarimi është kryer me datë 19.09.2012, ndërsa debitorët e kanë përsëritur pengimin e posedimit me datë 01.11.2014 që ka kaluar më shumë se një vit nga pengimi i përsëritur andaj Gjykata e Apelit e hodhi poshtë propozimin e kreditorit si të paafatshëm.*

## 2.10 MËNYRA E ZBATIMIT TË PËRMBARIMIT ME RASTIN E DORËZIMIT TË FËMIJËS

*Ligji për Procedurën Përmbimore nr.04/L-139 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.3, i dt. 31.01.2013, Prishtinë), në nenin të LPP-së, ka paraparë mënyrën e zbatimit të përmbimit me rastin e dorëzimit të fëmijës me përmbajtje si në vijim:*

*Neni 320 - Mënyra e zbatimit të përmbimit*

- 1. Me rastin e zbatimit të përmbimit, gjykata sidomos kujdeset për nevojën që të mbrohen interesat e fëmijës në masën më të madhe të mundshme.*
- 2. Me aktvendimin për përmbimin, gjykata i cakton debitorit afat prej tri (3) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar aktvendimi, që fëmijën t'ia dorëzojë prindit, apo personit tjetër, respektivisht institucionit të cilit fëmija i është besuar në ruajtje dhe edukim, me kërcënim të shqiptimit të gjobës në të holla.*
- 3. Gjoha në të holla shqiptohet dhe përmbahet sipas dispozitave të këtij ligji, për kryerjen e veprimit që mund ta bëjë vetëm debitori.*
- 4. Në qoftë se përmbimi nuk ka mund të zbatohet me shqiptimin dhe përmbimin e vendimit për gjobën në të holla, përmbimi do të zbatohet me marrjen e fëmijës nga personi tek i cili ndodhet fëmija dhe dorëzimin e fëmijës prindit, ose personit tjetër apo institucionit të cilit fëmija i është besuar për ruajtje dhe edukim.*
- 5. Marrjen dhe dorëzimin e fëmijës sipas paragrafit 4 të këtij neni, mund ta bëjë vetëm gjykatësi në bashkëpunim me psikologun e organit të kujdestarisë, të shkollës, këshillimores së familjes, apo të institucionit tjetër të specializuar për ndërmjetësim në marrëdhëniet familjare.*

### 2.10.1 Koment i shkurtër

Përmbimi i vendimeve gjyqësore në rastet e dorëzimit dhe marrjes së fëmijës, në praktikë paraqet mënyrën më të vështirë dhe më të ndjeshme, sepse gjykata duhet të kujdeset për nevojën që të mbrohen interesat e fëmijës në masën më të madhe të mundshme. Mënyra e zbatimit është përcaktuar përmes gjobave nëse debitori nuk vepron në afat prej tre ditësh.

Në qoftë se përmbimi nuk ka mund të zbatohet me shqiptimin dhe përmbimin e vendimit për gjobën në të holla, përmbimi do të zbatohet me marrjen e fëmijës nga personi tek i cili ndodhet fëmija dhe dorëzimin e fëmijës prindit, ose personit tjetër apo institucionit të cilit fëmija i është besuar për ruajtje dhe edukim.

Duke e parë rëndësinë e këtij përmbimi ka mbetur në kompetencë ekskluzive të gjykatës dhe ndërmarrja e veprimeve i është besuar vetëm gjykatësit në bashkëpunim me psikologun e organit të kujdestarisë, të shkollës, këshillimores së familjes, apo të institucionit tjetër të specializuar për ndërmjetësim në marrëdhëniet familjare.

Në rastin në të cilin konstatohet se është rrezikuar jeta, shëndeti, ose zhvillimi psikofizik i fëmijës, gjykata do ta zbatojë përmbimin pa caktuar paraprakisht afat për dorëzimin e fëmijës dhe pa shqiptuar gjoba gjyqësore.

## 2.10.2 Të gjeturat nga praktika gjyqësore

Një dukuri shqetësuese është paraqitur kur fëmijët që ndodhen tek njëri prind sidomos tek babai, fillojnë të rezistojnë duke u kapur për këmbët e tij, duke qarë e duke u zvarritur dhe duke i kërkuar prindit që të mos i lë dhe në këtë mënyrë krijohen situata tronditëse ku psikologët kërkojnë që të ndërpritet procedura. Sipas opinionit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 29.08.2016 nr. 3 sqarohet se epilogun e zbatimit të përmbarimit nuk mund ta përcaktojë psikologu.

Si duhet të vepohet në këto situata i referohemi një pjese të arsytimit të opinionit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme të Kosovës.

*“Psikologu përkatës ka për detyrë që patjetër ta gjejë mënyrën psikologjike të përshtatshme për lehtësimin e zbatimit të këtij vendimi e jo ta përcaktojë në një mënyrë apo një tjetër epilogun e procedurës përmbaruese të një vendimi gjyqësor të tillë. Gjyqtarit të çështjes i mbetet të veprojë në tërësi konform dispozitave ligjore të nenit 320 të LPP.*

*Pavarësisht se me këto dispozita është rregulluar në mënyrë specifike çështja e përmbarimit të vendimeve gjyqësore kur kemi të bëjmë me dorëzimin e fëmijëve, (marrja e fëmijës/ve nga njëri prind), edhe në këto situata vlen standardi kryesor i procedurës përmbarimore se, nëse detyrimet e përcaktuara në vendimin gjyqësor nuk përmbushen vullnetarisht, ato përmbahen edhe me zbatimin e mjeteve detyruese (dhunës). Pa mekanizmin detyrues, në të shumtën e rasteve, vendimet do të mbeteshin të paekzekutuara, për më tepër kur ligdhënësi nuk e ka ndaluar me asnjë dispozitë përdorimin e dhunës me rastin e dorëzimit të fëmijës prindit tjetër, sipas vendimit gjyqësor.*

*Gjykata, me rastin e vendosjes për besimin e fëmijës, qëllim primar ka pasur interesin e tij dhe ky interes është shqyrtuar me rastin e marrjes së aktgjykimit. Përdorimi nga ligdhënësi i shprehjes “gjykata duhet të mbrojë interesat e fëmijës në masën më të madhe të mundshme, me rastin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor”, është bërë me qëllim që, me rastin e marrjes së fëmijës, mundësisht të shmanget marrja me dhunë e tij, (nëse kjo është e mundur), mirëpo kur janë shfrytëzuar të gjitha alternativat e parashikuara me ligj, por pa efekt në zbatimin e vendimit gjyqësor, duhet aplikuar edhe detyrimin për zbatimin e një vendimi të tillë. Përndryshe vendimet gjyqësore, në marrëdhënie të tilla të armiqësua midis bashkëshortëve të divorcuar, vështirë do të ekzekutoheshin, ngase ai prind që me vendim gjyqësor është i detyruar ta dorëzojë fëmijën tek prindi tjetër, qëllimisht me lloj-lloj veprimesh, do të ndikonin tek fëmija/ët duke krijuar skena të tilla të frikshme dhe duke i bërë obstrukcione procesit të dorëzimit të fëmijës, përkatësisht ekzekutimit të vendimit gjyqësor.*

*Interpretimi restriktiv i shprehjes “gjykata duhet t’i mbrojë interesat e fëmijës në masën më të madhe të mundshme, me rastin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor” se, nëse fëmija nuk do vullnetarisht të shkojë tek prindi tjetër, duhet të ndërpritet procedura e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, dhe kjo do të përbënte një mesazh jo të duhur për të gjithë debitorët që, në rastet e tilla, t’i bëjnë obstrukcione autoritetit të gjykatave në drejtim të moszbatimit të vendimeve gjyqësore”.*

### 3. DHUNA NË FAMILJE

#### 3.1 DHUNA NË FAMILJE

*Me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (LMDHF), është caktuar dhe përkufizuar kuptimi i dhunës në familje, masat mbrojtëse kundër dhunës në familje dhe mbrojtja gjyqësore tek rastet që kanë të bëjnë me dhunën në familje.*

*Qëllimi i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është parandalimi i dhunës në familje në të gjitha format e saj, ndaj pjesëtarëve të familjes të cilët mund të jenë viktimë e dhunës në familje, duke i kushtuar çdoherë rëndësi të posaçme fëmijëve, të moshuarve dhe personave më aftësi të kufizuara. Ky ligj po ashtu ka për qëllim edhe trajtimin e kryesve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave (neni 1 i LMDHF).*

*Për zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, tek rastet e dhunës në familje kur kryesi i dhunës, veprën apo lëshimet e qëllimshme ndaj palës së mbrojtur si anëtar i familjes së tij, e ka kryer apo ndërmarrë si shkak i ndonjë sëmundjeje psiko-fizike e cila ka ekzistuar tek ai në kohën e shkaktimit të dhunës në familje, apo duke qenë nën ndikimin e alkoolit dhe substancave psikotrope, gjykatat janë të obliguara që ta aplikojnë Udhëzimin Administrativ nr. 12/2012, për Përcaktimin e Vendit dhe Mënyrës së Trajtimin Psikosocial të Kryesit të Dhunës në Familje, dhe Udhëzimin Administrativ nr. 02/2013 për Mënyrën e Trajtimin të Kryesve të Dhunës në Familje, ndaj të cilëve është shqiptuar masa mbrojtëse e trajtimin të obligueshëm mjekësor nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotrope.*

*Gjykatat me rastin e vendosjes tek rastet e dhunës në familje, po ashtu mund të referohen edhe tek ligjet vendore siç janë Kodi Penal i Kosovës nr. 04/L-082, Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare nr. 02/L-17 i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-081, Ligji nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës etj., si dhe ligjet ndërkombëtare siç janë Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, e miratuar nga Asambleja e OKB-së, më 20.11.1989, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut etj.*

#### **3.1.1 Përmbledhje e shkurtër nga të gjeturat e përgjithshme nga praktika e Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit të Kosovës, sa i përket rasteve të dhunës në familje, është konstatuar se nga ana e gjykatave të instancës së parë përmes vendimeve të nxjerra nuk janë zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë si dhe vendimet janë përfshirë edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore.

Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në shumicën e rasteve qëndrojnë për shkakun se, gjykatat e shkallës së parë me rastin e nxjerrjes së vendimeve të tyre nuk i janë përmbajtur kërkesave ligjore nga neni 160 parag. 4 i LPK-së, pasi që dispozitivi i aktvendimit është në kundërshtim me arsyet e aktvendimit, respektivisht në arsyetim të aktvendimit nuk jepen fare arsyet për faktet vendimtare mbi bazën e të cilave gjykata ka vendosur lidhur me themelësinë e kërkesës, dhe ato arsye të cilat janë dhënë nga gjykata rezultojnë të jenë në kundërshtim me provat shkresore të cilat gjykata i ka

administruar gjatë shqyrtimit të mbajtur gjyqësor. Ka edhe raste kur gjykata në bazë të dispozitivit të aktvendimit del se pjesërisht e ka aprovuar kërkesën e palës së mbrojtur, duke i lëshuar disa prej masave mbrojtëse të propozuara, por në dispozitiv të vendimit nuk tregohet se cila pjesë i është refuzuar, ku një gjë e tillë nuk mund të kuptohet as nga arsyetimi i vendimit.

Rastet të cilat janë përfshirë me vërtetim jo të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, posaçërisht i referohen mosnxjerrjes së provave të duhura dhe adekuate nga ana e gjykatës për vendosje meritore, lidhur me themelësinë e kërkesës për lëshimin e masave mbrojtëse të propozuara. Këto masa mbrojtëse kryesisht kanë të bëjnë me lëshimin e masës mbrojtëse të trajtimit psiko-social ndaj kryesit të dhunës, masës mbrojtëse e ndalimit të afrimit të viktimës së dhunës në familje si dhe vartësve të tij, masës mbrojtëse të largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit, masës mbrojtëse të trajtimit mjekësor nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotrope, masës mbrojtëse me të cilën urdhërohet kryesi i dhunës që palës së mbrojtur t'ia paguajë qiranë e banesës, alimentacionin për fëmijë dhe palën e mbrojtur, etj. Kjo vjen nga shkakun se, gjykata edhe pa propozimin e palëve duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare nuk e bënë nxjerrjen e provave me ekspertim nga lëmia përkatëse, siç janë lëmia e psikitarisë etj., nuk del në vend shikim për t'i hetuar rrethanat të cilat kryesisht kanë të bëjnë me hapësirën dhe kushtet e banimit tek rastet kur banesën apo shtëpinë e përbashkët do ta shfrytëzojnë pala e mbrojtur dhe vartësit e saj (fëmijët etj.) dhe kryesi i dhunës, nuk kërkon të dhëna nga organet kompetente lidhur me të hyrat mujore të cilat i realizon kryesi i dhunës dhe të hyrat të cilat mund t'i realizojë pala e mbrojtur, por edhe të dhëna tjera të cilat në raste të caktuara, gjykata duhet t'i nxjerrë edhe pa propozimin e palëve duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare.

Shkeljet të cilat i referohen zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, kryesisht kanë të bëjnë me shkakun se gjykatat me rastin e nxjerrjes së vendimeve, në arsyetim fare nuk tregojnë se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e palës së mbrojtur për caktimin e masave mbrojtëse të propozuara, dhe dispozitat materiale në të cilat referohen dhe të cilat i zbatojnë, del se i kanë zbatuar në mënyrë të gabuar apo jo të drejtë.

Këto raste kanë të bëjnë me moszbatimin apo zbatimin e gabuar të nenit 2, 4 dhe 5 të LMDHF, e me theks të posaçëm dispozitës së nenit 6 të LMDHF që i referohet kujdestarisë së fëmijës dhe heqjes së përkohshme të së drejtës prindërore, kur pala e mbrojtur dhe kryesi i dhunës kanë fëmijë të përbashkët të mitur, pasi që gjykata në raste të caktuara edhe pse vërteton se pala e mbrojtur dhe kryesi i dhunës kanë fëmijë të përbashkët, me rastin e caktimit të masave mbrojtëse të propozuara nga pala e mbrojtur nuk vendos fare se kujt i caktohet kujdestaria e fëmijës dhe a i hiqet apo jo përkohësisht e drejta prindërore kryesit të dhunës.

Gjykatat në çdo rast kur konstatojnë se dhuna në familje e shkaktuar në mes të çifteve apo prindërve të fëmijëve të mitur, mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë apo edhe të tërthortë në zhvillimin e drejtë të tyre psikik dhe fizik, çdoherë kanë për detyrim ligjor që të kujdesen sipas detyrës zyrtare, që kujdestaria e fëmijës përkohësisht t'i besohet viktimës së dhunës në familje, ndërsa e drejta prindërore përkohësisht t'i hiqet kryesit të dhunës në familje, duke marrë për bazë parimin e mbrojtjes së interesit më të mirë të të miturve.

Zbatimi i gabuar i së drejtës materiale në shumicën e rasteve vjen edhe si shkak i vërtetimit jo të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, pasi që gjykata përkundër faktit se u referohet drejtë dispozitave të së drejtës materiale të cilën e ka zbatuar për caktimin e masave mbrojtëse të shqiptuara, masat e shqiptuara nuk korrespondojnë me gjendjen faktike të konstatuar nga vet gjykata dhe provat e nxjerra gjatë shqyrtimit kryesor, pasi që çdoherë faktet vendimtare duhet të provohen nga provat materiale shkresore, të cilat gjithashtu duhet të jenë në harmoni të plotë në mes vete.

### **3.1.2 Komente lidhur me zbatimin e dispozitave të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje**

*Neni 2 i LMDHF*

*Përkufizimet*

1. *Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:*
  - 1.1. *Marrëdhënie familjare konsiderohen personat nëse:*
    - 1.1.1. *janë të fejuar apo ishin të fejuar;*
    - 1.1.2. *janë të martuar apo ishin të martuar;*
    - 1.1.3. *janë në bashkësi jashtëmartesore apo ishin në bashkësi jashtëmartesore;*
    - 1.1.4. *bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët ose që bashkëjetuan në një ekonomi të tillë;*
    - 1.1.5. *përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesë, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit dhe motrat, hallat e tezet, xhaxhallarët e dajallarët ose kushërinjtë;*
    - 1.1.6. *janë prindër të një fëmije të përbashkët, janë palë procedurale në një kontest nga marrëdhëniet familjare;*
  - 1.2. *Dhunë në familje - një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër, me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, po nuk kufizohet në:*
    - 1.2.1. *përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes;*
    - 1.2.2. *çdo veprim tjetër i një anëtari të familjes që mund të shkaktojë apo të kanosë se do t'i shkaktojë dhimbje fizike dhe vuajtje psikike;*
    - 1.2.3. *shkaktim i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimit të dinjitetit;*
    - 1.2.4. *sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat;*
    - 1.2.5. *ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra tjera të shqetësimit të vrazhdë;*
    - 1.2.6. *përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve më qëllim të përuljes së personit tjetër;*
    - 1.2.7. *marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual;*
    - 1.2.8. *kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër;*
    - 1.2.9. *dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë;*
    - 1.2.10. *vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike;*
    - 1.2.11. *hyrja në apo largimi nga banesa e përbashkët apo banesa e personit tjetër;*
    - 1.2.12. *rrëmbimi;*



### **3.1.3 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës së nenit 2 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, pika 1.1.1-1.1.7 dhe nën paragrafi 1.2, pika 1.2.1-1.2.12 të LMDHF**

Në mbështetje të nenit 2 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1-1.1.7 dhe nënparagrafi 1.2, pika 1.2.1-1.2.12 të LMDHF, gjykatat me rastin e vlerësimit dhe vendosjes për kërkesat që kanë të bëjnë me rastet e dhunës në familje, çdoherë duhet të kenë parasysh se ky ligj mund të zbatohet vetëm për rastet kur konstatohet se dhuna në familje është shkaktuar në mes të personave të cilët janë në marrëdhënie familjare apo më herët kanë qenë në marrëdhënie familjare, dhe kryesi i dhunës ka kryer më shumë vepra apo ka ndërmarrë lëshime të qëllimshme ndaj personit tjetër, me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare.

Kushtet ligjore të sipër cituara çdoherë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, për shkakun se pa plotësimin e këtyre dy kushteve në mënyrë kumulative, ligjërisht nuk mund të konsiderohet se kemi të bëjmë me një rast i cili hyn në domenin e dhunës në familje, me çka gjykatat në asnjë rast nuk do të kenë mundësi që ta bien vendimin me të cilin do të lëshohet urdhëri mbrojtës apo urdhëri mbrojtës emergjent, duke caktuar masat mbrojtëse të cilat parashihen me dispozitat e LMDHF.

Është shumë me rëndësi për gjykatën që ta dijë se cilët persona mund të jenë në lidhje familjare konform këtij ligji, dhe në mes të të cilëve mund të shkaktohet dhunë që sipas ligjit konsiderohet dhunë në familje, pasi që në krahasim me Ligjin e Kosovës për Familjen i cili me nenin 271 ka përkufizuar se, *„Bashkësia familjare përfshinë bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve, personat tjerë të afërm të familjes si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji”*. Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje e ka zgjeruar konceptin e lidhjes familjare duke dhënë një përkufizim më të gjerë të familjes dhe lidhjes familjare, ku përveç të tjerëve si persona të cilët konsiderohen në marrëdhënie familjare ka përfshirë edhe të fejuarit apo ish të fejuarit, të martuarit apo ish të martuarit, ata që janë në bashkësi jashtëmartesore apo që kishin jetuar në bashkësi jashtëmartesore, personat që bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët ose që bashkëjetuan në një ekonomi të tillë, anëtarët e familjes së gjerë që jetojnë bashkërisht, prindërit e një fëmijë të përbashkët dhe palët procedurale në një kontest nga marrëdhënia familjare.<sup>4</sup>

Sipas përkufizimit që me nenin 2 paragrafi 1 të LMDHF i është bërë nocionit të marrëdhënies familjare, gjykatat me rastin e shqyrtimit të rasteve të dhunës në familje duhet të kenë parasysh që ky nocion i marrëdhënies familjare duhet të interpretohet në lidhshmëri të plotë me këtë dispozitë ligjore dhe shprehjet e përdorura sipas kësaj dispozite.

### **3.1.4 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit të Kosovës, janë paraqitur raste kur gjykatat e shkallës së parë vendimet e tyre i kanë marrë në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 2 paragrafi 1, pika 1.1 dhe 1.2 të LMDHF-së.

---

<sup>4</sup> Komentari i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Deri tek zbatimi i gabuar i kësaj dispozite ligjore ka ardhur për shkakun se, rastet e dhunës në familje për të cilat gjykatat e shkallës së parë kanë konstatuar se janë shkaktuar në mes të personave të cilët kanë qenë me herët të fejuar apo kanë bashkëjetuar në mes vete, nuk i kanë trajtuar si raste të cilat hyjnë në domenin e dhunës në familje, duke arsyetuar se pala e mbrojtur dhe kryesi i dhunës në familje në momentin e shkaktimit të dhunës nuk kanë jetuar në një bashkësi familjare me çka edhe nuk konsiderohen si persona që janë në marrëdhënie familjare, dhe me çka mbi bazën e një rrethane të tillë gjykatat e shkallës së parë i kanë refuzuar kërkesat e palëve të mbrojtura për lëshim të urdhërit mbrojtës.

Gjykata e Apelit e Kosovës për rastet e tilla ka vlerësuar se gjykatat e shkallës së parë gabimisht e kanë interpretuar dispozitën ligjore të nenit 2 parag. 1.1 të LMDHF, për faktin se sipas përkufizimit që Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje i ka bërë marrëdhëniet familjare, përveç të tjerëve si persona të cilët konsiderohen në marrëdhënie familjare, ka përfshirë edhe të fejuarit apo ish të fejuarit, të martuarit apo ish të martuarit, ata që janë në bashkësi jashtëmartesore apo që kishin jetuar në bashkësi jashtëmartesore, personat që bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët ose që bashkëjetuan në një ekonomi të tillë, anëtarët e familjes së gjerë që jetojnë bashkërisht, prindërit e një fëmije të përbashkët dhe palët procedurale në një kontest nga marrëdhëniet familjare, me çka për rastet e tilla kur para gjykatës si palë të mbrojtura dhe kryes të dhunës paraqiten këta persona, ligjërisht kemi të bëjmë me rastet e dhunës në familje dhe gjykata ka për detyrim që palës së mbrojtur t'i ofrojë mbrojtje gjyqësore në përputhje me dispozitat ligjore të LMDHF-së.

Është i parëndësishëm fakti se në momentin e shkaktimit të dhunës pala e mbrojtur dhe kryesi i dhunës nuk kanë qenë duke jetuar në një bashkësi familjare. Më rëndësi për gjykatën është vetëm konstatimi i faktit se ata më herët kanë qenë të fejuar apo kanë bashkëjetuar në mes vete, ku në çdo rast kur gjykata konstaton se këta persona më herët kanë qenë të fejuar apo kanë bashkëjetuar në mes vete, duhet të ketë parasysh se kemi të bëjmë me rastet e cili hyn në domenin e dhunës në familje dhe duhet trajtuar sipas dispozitave ligjore të LMDHF.

### **3.1.5 Referencë nga arsyetimi i aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës**

**Aktvendimi AC.nr.3933/17, i datës 14.09.2017**

#### **Arsyetim**

*Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë në zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, e për të cilat shkelje Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.*

*Lidhur me ndryshimin e aktvendimit të atakuar, sa i përket lëshimit të urdhërit për mbrojtje, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktvendimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 par.1 pika e), e lidhur me nenin 201 par. 1 pika d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, gabimisht është zbatuar e drejta materiale.*

*Gjykata e Apelit vlerëson se me vetë faktin e largimit nga shtëpia të palës së mbrojtur dhe moslejimit të shfrytëzimit të shtëpisë së përbashkët në të cilën deri më tani kanë jetuar së bashku me palën përgjegjëse, paraqet aktin e kryerjes së dhunës në familje nga ana e palës përgjegjëse e konform nenit 2 par. 1 nënpar. 1.2 pika 1.2.11 të LMDHF-së, e cila nuk ka qenë rrethanë kontestuese.*

*Sa i përket zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të LMDHF, përkatësisht të nenit 2 par.1, nënpar. 1.1, pikat. 1.1.1, deri në 1.1.7 të këtij ligji, sipas të cilit në mënyrë decisive theksohet se çka konsiderohet marrëdhënie familjare dhe cilët persona bëjnë pjesë në marrëdhënie familjare.*

*Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, sipas nenit 2 par. 1 të LMDHF, në marrëdhëniet familjare konsiderohen personat mes tjerash nëse: 1.1.3. janë në bashkësi jashtëmartesore apo ishin në bashkësi jashtëmartesore, nga çka vërtetohet fakti se pala e mbrojtur me palën përgjegjëse kanë qenë në marrëdhënie familjare që nga dt.01.06.2017, gjë që gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara nuk është bazuar në dispozitat e LMDHF, por në dispozitat e LFK dhe gabimisht i është referuar dispozitës së nenit 39 të LFK, për vërtetimin e ekzistimit të marrëdhënies familjare në mes të palëve, andaj e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e palës së mbrojtur për urdhër-mbrojtje.*

*Gjykata e Apelit, vlerëson se bazuar në nenin 2 par. 1 nënpar.1.1 pika 1.1.3, ka ekzistuar bashkësia jashtëmartesore në mes të palëve, dhe se ekzistojnë marrëdhëniet familjare me vet faktin kur pala përgjegjëse e ka marrë palën e mbrojtur për të jetuar tek ai, andaj edhe gjykata i ka aprovuar ankesën e palës së mbrojtur përkitazi me ekzistimin e marrëdhënies familjare dhe e ka ndryshuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, C.nr.372/2017, të datës 24.08.2017 dhe e ka aprovuar pjesërisht kërkesën e palës së mbrojtur për lëshimin e urdhër-mbrojtjes.*

*Po ashtu, për ta provuar aktin e kryerjes së dhunës në familje nga ana e palës përgjegjëse-kryesit të dhunës, me përmbajtje siç e ka përshkruar në arsyetim të aktvendimit, gjykata i është referuar provave si: deklarata e dëshmitares S.P., deklaratat e palës përgjegjëse, deklaratat e të dyshuarit L.J., raportet policore nr.2017BD864, deklaratat e palës së mbrojtur, raportin e gjinekologut me ultrazërin e bashkangjitur të datës 09.08.2017, dhe raportin mjekësor të datës 09.08.2017.*

*Lidhur me pretendimet e palës së mbrojtur, se aktvendimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore për shkak se ekzistojnë kundërthënie në mes të arsyetimit të aktvendimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, Gjykata e Apelit vlerëson se nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase gjykata e shkallës së parë gjatë procedimit të çështjes i ka respektuar dispozitat e LPK-së, por që nuk e ka zbatuar drejtë të drejtën materiale, ngase kemi të bëjmë me marrëdhënie familjare të parapara me nenin 2 të LMDHF.*

*Sa i përket pretendimeve për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimet e palës ankuese, pasi që në ankesë nuk paraqitet në mënyrë të specifikuar se cilat fakte të çështjes nuk janë provuar, e të cilat është dashur që të provohen, e rrjedhimisht nuk është arsyetuar as pjesa në të cilën ankuesi pretendon se konstatimi për gjendjen e fakteve është i gabuar.*

*Urdhërin për pagesën e qirasë së banesës së përkohshme të palës së mbrojtur dhe alimentacionin në lartësinë e cekur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, gjykata e caktoi konform nenit 11 par. 1.2 të LMDHF, e duke pasur parasysh se pala përgjegjëse është në marrëdhënie pune në Postë dhe Telekomunikacion dhe realizon të ardhura personale, gjë që vërtetohet nga deklaratat e tij e dhënë në polici e dt. 12.08.2017, ndërsa pala e mbrojtur është amvise dhe e papunë gjë që vërtetohet nga deklaratat e dhënë në polici e dt. 14.08.2017 dhe ka nevojë për mbajtje dhe pagesën e qirasë.*

*Gjykata e Apelit e aprovoi kërkesën e palës së mbrojtur për pagesën e qirasë së banesës së përkohshme dhe alimentacionin, duke vlerësuar se kjo alternativë është më e mirë për palën e mbrojtur, për shkak të marrëdhënieve të çrregulluara që janë krijuar në mes tyre dhe për shkak të mos shqetësimit të palës së mbrojtur në të ardhmen nga ana e palës përgjegjëse, ngase nëse do të jetonin në shtëpinë e përbashkët apo në një pjesë të saj, ekziston rreziku potencial i përsëritjes së dhunës në familje.*

*Gjykata e ka refuzuar pjesërisht kërkesën e palës së mbrojtur sa i përket pagesës së alimentacionit për fëmijë, meqenëse pala e mbrojtur është shtatzënë, por akoma nuk ka lindur, ndërsa sa i përket kërkesës për të jetuar në shtëpinë e përbashkët apo në një pjesë të saj, gjykata e refuzoi kërkesën në këtë pjesë, por ia aprovoi kërkesën për pagesën e qirasë së banesës së përkohshme.*

*Nga arsytet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike për pjesën e vërtetuar të aktvendimit, ndërsa në pjesën tjetër, aktvendimi është dashur të ndryshohet për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) dhe (c) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.*

### **3.2 NENI 4 I LMDHF - MASA MBROJTËSE E TRAJTIMIT PSIKOSOCIAL**

- 1. Masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial, mund t'i shqiptohet kryesit të dhunës në familje në kombinim me ndonjë masë tjetër parandaluese, më qëllim të evitimit të sjelljeve të dhunshme të kryesit, apo nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje.*
- 2. Kjo masë zgjatë derisa të përfundojnë shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar, por nuk mund të zgjasë më shumë se 6 muaj.*
- 3. Ministria përgjegjëse për mirëqenie sociale në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për Shëndetësi dhe institucionet përkatëse, e përgatisin dhe e propozojnë për aprovim në Qeveri aktin nën ligjor më të cilin përcaktohet mënyra dhe vendi i zbatimit të trajtimit psikosocial”.*

#### **3.2.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës së nenit 4 të LMDHF**

Për zbatimin e drejtë të kësaj dispozite ligjore, gjykatat çdoherë duhet të kenë parasysh se masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial ndaj kryesit të dhunës, mund të shqiptohet nëse në mënyrë kumulative plotësohen dy kushte ligjore:

- Nëse konstatohet se kryesi i dhunës ka kryer një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme ndaj personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 2 par. 1.2 të LMDHF; dhe

- Nëse konstatohet se kryesi i dhunës këto vepra apo lëshime të qëllimshme ndaj personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare, i ka ndërmarrë si shkak i gjendjes së rënduar psikike ose emocionale;

Për ta konstatuar faktin se veprimet e qëllimshme nga kryesi i dhunës kanë mundur të ndërmerren si shkak i gjendjes së rënduar psikike ose emocionale, gjykatat çdoherë duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare edhe pa propozim të palëve në procedurë kanë për detyrim ligjor që të nxjerrin prova me ekspertin përkatës nga lëmia e psikiatrisë, pasi që përmes vërtetimit të drejtë të këtij fakti, gjykata do të ketë mundësi objektive që të vlerësojë se a plotësohen kushtet ligjore për shqiptimin e masës mbrojtëse të trajtimit psikosocial, apo ndonjë masë tjetër mbrojtëse të paraparë me dispozitat ligjore të LMDHF.

Nëse gjykata gjatë seancës dëgjimore përmes provave të administruara, vlerëson se plotësohen kushtet ligjore për shqiptimin e masës së trajtimit psikosocial, përmes vendimit të nxjerrë, e në kuptim të Udhëzimit Administrativ nr. 12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të kryesit të dhunës në familje, duhet urdhëruar organin kompetent i cili ka për detyrim që ta zbatojë këtë masë të shqiptuar, që trajtimi i kryesit të dhunës të bëhet në përputhje me këtë udhëzim administrativ, dhe kohëzgjatja e masës së shqiptuar të vlejë derisa të përfundojnë shkaqet mbi bazën e të cilave i është shqiptuar kryesit të dhunës, por jo më shumë se 6 muaj.

Krahas kësaj mase mbrojtëse, gjykata mund të caktojë edhe masa tjera mbrojtëse të parapara me dispozitat ligjore të LMDHF, por në asnjë rast masat tjera mbrojtëse të shqiptuara nuk mund të shqiptohen në kohë më të gjatë sesa kohëzgjatja e urdhërit mbrojtës me të cilin kryesit të dhunës i është shqiptuar masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial.

### **3.2.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit të Kosovës, janë paraqitur raste kur nga pala e mbrojtur sipas kërkesës së ushtruar për urdhër-mbrojtje në gjykatën e shkallës së parë, është kërkuar që ndaj kryesit të dhunës krahas masave tjera mbrojtëse të propozuara, t'i shqiptohet edhe masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial, më arsyetimin se kryesi i dhunës veprimet e qëllimshme ndaj palës së mbrojtur i ka ndërmarrë si shkak i gjendjes së tij të rënduar psikike.

Gjykata përkundër faktit se para vetes ka pasur një kërkesë të tillë të palës së mbrojtur dhe ka pasur indikacione se kryesi i dhunës, veprimet e qëllimshme i ka ndërmarrë si shkak i gjendjes së tij të rënduar psikike, me rastin e vendosjes cakton masat mbrojtëse tjera të propozuara nga pala e mbrojtur, ndërsa nuk vendos fare lidhur më kërkesën e palës së mbrojtur sa i përket caktimit të masës së trajtimit psikosocial, duke mos dhënë fare arsye pse nuk ka vendosur për një kërkesë të tillë, edhe pse ligjërisht ka pasur për detyrim që të vendosë lidhur më të gjitha kërkesat e palës së mbrojtur, dhe të japë arsye për secilën masë të shqiptuar apo të refuzuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në situatat e tilla kur nga pala e mbrojtur kërkohet që ndaj kryesit të dhunës të caktohet masa mbrojtëse e trajtimit psikosocial, dhe gjykata në bazë të dëgjimit të palëve por edhe të nxjerrjes së provave tjera konstaton se kryesi i dhunës lëshimet apo veprat e qëllimshme ka mundur t'i kryejë si shkak i gjendjes së rënduar psikike apo emocionale, apo si shkak i ndonjë çrregullimi psikik të përkohshëm,

për ta hetuar këtë rrethanë gjykata domosdoshmërisht duhet që edhe pa propozimin e palëve, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare të nxjerrë provë me ekspertim nga lëmia përkatëse, ngase rrjedhimisht përmes nxjerrjes dhe vlerësimit të drejtë të kësaj prove, do të varet edhe mënyra e vendosjes së gjykatës lidhur me shqiptimin e masave tjera mbrojtëse të propozuara nga pala e mbrojtur dhe kohëzgjatjen e tyre.

### **3.2.3 Referencë nga arsyetimi i aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës**

**Aktvendimi AC.nr. 1637/17, i datës 24.01.2017**

#### **Arsyetim**

*Gjykata e Apelit e Kosovës duke e ekzaminuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të ankesës, gjen se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë lidhur me mënyrën e vendosjes sipas pikës II, III, IV, VI, VII, VIII dhe IX të dispozitivit të aktvendimit të ankimuar nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar në këtë pjesë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) dhe 0) e lidhur me nenin 160 të LPK-së, gjendja faktike në këtë pjesë nuk është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, me çka ka ardhur edhe deri tek zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.*

*Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë për shkakun se aktvendimi i ankimuar në këtë pjesë ka të meta të atilla si shkak i të cilave nuk mund të ekzaminohet, ngase dispozitivi i aktvendimit del të jetë i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten, arsyetimin dhe në kundërshtim me provat përkatësisht dokumentet nga shkresat e lëndës. Përveç kësaj, gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato arsye të cilat janë dhënë deri diku janë te paqarta, kundërrthënëse dhe pjesërisht edhe në kundërshtim me kërkesën e palës mbrojtëse për caktimin e masave mbrojtëse.*

*Në rast se i referohemi kërkesës për urdhër-mbrojtje të parashtruar nga pala e mbrojtur, rezulton se e njëjta ka kërkuar që gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës dëgjimore dhe administrimit të provave, të bie aktvendim më të cilin do të caktohen masat mbrojtëse nga neni 6 pika 2 të LMDHF caktimi i kujdestarisë së përkohshme ndaj fëmijës të përbashkët –të miturit D. palës se mbrojtur dhe heqja e përkohshme e të drejtës prindërore kryesit të dhunës, neni 5 pika 1 dhe 2 të LMDHF ndalimi i kryesit të dhunës që t'i afrohet palës së mbrojtur në rrugë dhe në vendin e saj të punës në distancë prej 50 metrash, neni 4 pika 1, 2 dhe 3 të LMDHF trajtimi psikosocial i kryesit të dhunës dhe masat mbrojtëse të parapara me nenin 2 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2, 1.2.3 dhe 1.2.5, nenin 6.1, nenin 8 dhe nenin paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të LMDHF.*

*Gjykata e shkallës së parë përkundër faktit se para vetes ka pasur një kërkesë të qartë të palës së mbrojtur, pranë së cilës kërkesë pala e mbrojtur ka mbetur në tërësi edhe në seancën e mbajtur dëgjimore, gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes nuk vendos lidhur kërkesën e palës së mbrojtur që kryesit të dhunës t'i ndalohet afrimi palës së mbrojtur në rrugë dhe në vendin e saj të punës në distancë prej 50 metrash dhe masën e trajtimit psikosocial të kryesit të dhunës, edhe pse ligjërisht e ka pasur për detyrim që të vendosë lidhur me të gjitha kërkesat e palës së mbrojtur.*

*Sipas vlerësimit të gjykatës ankimore në rastin konkret sikurse gjykata e shkallës së parë ta vlerësonte masën e trajtimit psikosocial të kryesit të dhunës e cila është kërkuar nga pala e mbrojtur, pastaj varësisht prej bazueshmërisë së kësaj mase të propozuar, vendimi i gjykatës së shkallës së parë rrjedhimisht do të ishte me ndikim edhe për vendosjen lidhur me masat tjera të propozuara nga pala e mbrojtur.*

*Përveç kësaj, edhe masat tjera të cilat janë propozuar nga pala e mbrojtur dhe janë aprovuar nga gjykata e shkallës së parë, rezulton të jenë deri diku të paqarta, kundërthënëse dhe pa mbështetje në ligj. Deri te një përfundim i tillë kjo gjykatë vjen nga shkaku se nëse vlerësojmë pikën II të dispozitivit të aktvendimit të ankimuar nuk mund të kuptohet qartë se cilat masa mbrojtëse saktësisht janë caktuar ndaj kryesit të dhunës, aq me tepër kur nga kjo pikë e dispozitivit gjykata kryesit të dhunës i ka përcaktuar ndalimin e dhunës fizike ndaj palës së mbrojtur, për të cilin lloj të dhunës me provat nga shkresat e lëndës, e veçmas deklarimit të bërë nga pala e mbrojtur është vërtetuar se kryesi i dhunës nuk e ka ushtruar asnjëherë ndaj palës së mbrojtur.*

*Aktvendimi i ankimuar në pikat e dispozitivit në të cilat gjykata ankimore ka gjetur se duhet prishur, është përfshirë edhe me shkelje të ligjit material e cila ka ardhur si shkak i vërtetimit jo të plotë dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, pasi që gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të kujdestarisë për fëmijun e mitur palës së mbrojtur, del të mos ketë pasur dëshmi konkrete, se i mituri D. në regjistrin civil të të lindurve është i regjistruar si fëmijë i lindur nga pala e mbrojtur dhe kryesi i dhunës, dhe se cili është mbiemri i saktë i fëmijut të mitur, pasi që pala e mbrojtur dhe kryesi i dhunës nga shkresat e lëndës rezultojnë të mos e kenë të njëjtin mbiemër.*

*Vendosja nga gjykata e shkallës së parë lidhur me kujdestarinë e përkohshme të të miturit dhe caktimin e kontaktit, del të jetë marrë po ashtu në kundërshtim të plotë me dispozitën ligjore të nenit 6 paragrafi 2 të LMDHF, pasi që në kuptim të kësaj dispozite ligjore e cila është e karakterit obligues për gjykatën, çdoherë tek rastet e dhunës në familje kur pala e mbrojtur dhe kryesi i dhunës rezulton të kenë fëmijë të përbashkët, kujdestaria e fëmijës përkohësisht duhet t'i besohet palës së mbrojtur apo viktimës së dhunës në familje, ndërsa e drejta prindërore përkohësisht i hiqet kryesit të dhunës në familje.*

*Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka interpretuar këtë dispozitë ligjore pasi që e njëjta përveç çështjes së kujdestarisë së përkohshme lidhur më të miturin është dashur që të vendos edhe lidhur me çështjen e privimit të përkohshëm të së drejtës prindërore sa i përket kryesit të dhunës, duke pasur parasysh gjithashtu se për situata të tilla kur vendoset për kujdestari të përkohshme dhe privim të përkohshëm nga e drejta prindërore të kryesit të dhunës nuk mund të caktohet kurrfarë kontakti në mes të fëmijëve të mitur dhe kryesit të dhunës, pasi që kjo bie ndesh me dispozitën e nenit 6 paragrafi 2 të LMDHF.*

*Gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktvendimit të ankimuar, gjithashtu si shkak i vërtetimit jo të drejtë dhe jo të plotë të gjendjes faktike sa i përket hetimit të rrethanës nëse i mituri D. është i regjistruar si fëmijë i përbashkët i palës së mbrojtur dhe kryesit të dhunës dhe cili është mbiemri i saktë i tij, nuk ka pasur mundësi që të vendosë drejtë edhe lidhur më çështjen e alimentacionit të gjykuar për fëmijun e mitur në shumën mujore prej 100 euro me pagesën e të cilave e ka obliguar kryesin e dhunës, pasi që vetëm*

*përcaktimi që t'i paguhet kjo shumë të miturit D. pa u ditur mbiemri i saktë i tij, ligjërisht këtë pjesë të vendimit e bënë të pa përmbarueshëm.*

*Gjykata e shkallës së parë del të mos ketë vendosur drejtë edhe sa i përket çështjes së alimentacionit për të miturin, pasi që paraprkishtë para se të vendoste lidhur me lartësinë e alimentacionit të kërkuar në emër të të miturit, është dashur që edhe pa propozim të palëve duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare të sigurojë prova konkrete rreth të hyrave mujore që realizojnë pala e mbrojtur dhe kryesi i dhunës, si dhe t'i vlerësojë drejtë shpenzimet që mund t'i ketë i mituri në këtë moshë për zhvillimin, rritjen dhe edukimin e tij në kushte dhe rrethana normale. Nga një rrethanë e tillë, aktvendimi i ankimuar bëhet i kundërligjshëm edhe në pjesën e dispozitivit më të cilën është refuzuar një pjesë e kërkesës së palës mbrojtëse për caktim të alimentacionit për të miturin, e që ka të bëjë më shumë prej 200 euro.*

*Gjendja faktike nga gjykata e shkallës së parë ka mbetur pa u vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë edhe sa i përket pjesës refuzuese, që kishte të bënte më kërkesën e palës së mbrojtur që kryesi i dhunës të detyrohej në pagesën e qirasë mujore të banesës në lartësi prej 120 euro, pasi që gjykata nuk i ka vërtetuar dhe sqaruar saktësisht faktet nëse pala e mbrojtur është duke jetuar në shtëpinë e prindërve të saj, në banesën në të cilën kishte jetuar edhe më herët me kryesin e dhunës apo ka marrë ndonjë banesë tjetër me qira.*

*Në shkresat e lëndës, gjykata ankimore ka konstatuar se gjendet një kontratë mbi qiranë e banesës e lidhur me datë 28.12.2016 në mes të palës së mbrojtur si qiramarrëse dhe personit F.K si qiradhënë, nga e cila rezulton se pala e mbrojtur nga ky person ka marrë me qira një banesë e cila gjendet në Klinë, ku qiraja mujore është 120 euro, e cila kontratë nga i autorizuari i palës së mbrojtur kësaj gjykate i është dorëzuar së bashku me ankesën e paraqitur, me çka nga një rrethanë e tillë nuk mund të kuptohet nëse gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes sipas aktvendimit të ankimuar ka qenë e njoftuar me këtë kontratë apo jo, që të kishte mundësi që ta vlerësonte në lidhshmëri edhe me provat tjera nga shkresat e lëndës, dhe pastaj të kishte mundësi që të vendoste drejtë edhe lidhur me kërkesën e palës së mbrojtur për caktimin e masës mbrojtëse me të cilën do t'i urdhërohej kryesit të dhunës që ta paguante qiranë mujore në lartësinë e kërkuar.*

*Të gjitha këto të gjetura të bëra si më lartë nga gjykata ankimore, aktvendimin e ankimuar në pikën II, III, IV, VI, VII, VIII dhe IX të dispozitivit, e bëjnë jo të drejtë dhe pa mbështetje në ligj, me çka i njëjti aktvendim në këtë pjesë është dashur të prishej dhe lënda t'i kthehej në rigjykim gjykatës së shkallës së parë, pasi që nuk pati kushte që aktvendimi i ankimuar në këtë pjesë të ndryshohej.*

### **3.2.4 Neni 6 i LMDHF**

#### **Masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit të personave të ekspozuar dhunës**

- 1. Masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit në përputhshmëri me përkufizimin e dhënë me nenin 2 nën paragrafi 1.2 të këtij ligji, mund t'i shqiptohet kryesit të dhunës në familje, nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje.*
- 2. Kujdestaria e fëmijës përkohësisht i besohet viktimës së dhunës në familje, ndërsa e drejta prindërore përkohësisht i hiqet kryesit të dhunës.*



### 3.2.5 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës së nenit 6 të LMDHF

Sipas përkufizimit ligjor të bërë me dispozitën e nenit 6 të LMDHF, rrjedh se kjo masë mbrojtëse mund t'i shqiptohet kryesit të dhunës në familje në të gjitha rastet kur konstatohet se i njëjti ndaj personit më të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare, ka ndërmarrë veprime apo lëshime të qëllimshme, të cilat shprehimisht janë përcaktuar me dispozitën e nenit 2 nën-paragrafi 1.2 të LMDHF.

Kjo dispozitë ligjore përmban një kombinim të masave, atë të ndalimit të shqetësimit të personave që i ekspozohen dhunës dhe masën e përkujdesjes se përkohshme për fëmijë që do t'i besohen viktimës. Kjo masë shqiptohet pasi që personi i është ekspozuar ndonjë forme të dhunës në familje dhe ekziston rreziku i përsëritjes së çfarëdo forme të saj, ku përmes kësaj mase çdoherë tentohet të evitohet mundësia që në të ardhmen të përsëritet dhuna në familje. Mbajtja larg e kryesit të dhunës nga viktimat ose personat nën mbikëqyrjen e tij është një masë parandaluese.<sup>5</sup>

Në kuadër të dispozitës ligjore me të cilën është parashikuar masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit të personave të ekspozuar dhunës, me paragrafin 2 të këtij neni është rregulluar edhe besimi përkohësisht i fëmijës njërit nga prindërit, në rastet kur dhuna në familje është kryer ndaj njërit nga prindërit e fëmijës. Në këto raste, gjykata vendos që kujdestaria e fëmijës përkohësisht t'i besohet viktimës së dhunës në familje, ndërsa e drejta prindërore përkohësisht i hiqet kryesit të dhunës në familje.

Më anë të kësaj dispozite ligjore nuk është paraparë afati kohor rreth kujdestarisë së përkohshme të fëmijës, viktimës së dhunës në familje dhe heqjes së të drejtës prindërore ndaj kryesit të dhunës, me çka në situatat e tilla gjykatat duhet të referohen në dispozitën ligjore të nenit 11 parag. 3 të LMDHF, më të cilën shprehimisht parashihet se, *„Masat mbrojtëse të parapara me nenet 4,5,6,7,8,9,10 dhe 11 shqiptohen në pajtim me kohëzgjatjen e urdhërit mbrojtës“* dhe masën e shqiptuar mbrojtëse të paraparë me nenin 6 të këtij ligji, gjykatat duhet ta shqiptojnë në pajtim me kohëzgjatjen e urdhërit mbrojtës të caktuar.

Edhe pse paragrafi 2 i nenit 6 të LMDHF, për nga përmbajtja e tij del të jetë dispozitë ligjore e karakterit imperativ, me interpretimin e së cilës mund të kuptohet se gjykata në çdo rast kur konstaton dhe gjen se duhet të caktohet masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit personave të ekspozuar dhunës sipas përkufizimit të dhënë me nenin 2 nën-paragrafi 1.2 të LMDHF, ka për obligim ligjor që duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare fëmijën apo fëmijët e mitur të cilët i kanë pala e mbrojtur dhe kryesi i dhunës, t'ia besojë në kujdestari të përkohshme viktimës së dhunës në familje, ndërsa e drejta prindërore t'i hiqet përkohësisht kryesit të dhunës në familje. Sipas mendimit të Gjykatës së Apelit, çdoherë gjykata para se të vendosë lidhur më një gjë të tillë duhet të vlerësojë në mënyrë të drejtë dhe objektive nëse fëmijët e mitur i janë ekspozuar dhe a mund t'i ekspozohen në të ardhmen qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë dhunës së shkaktuar në mes prindërve të tyre, e cila do të kishte ndikim negativ në rritjen dhe zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik të tyre në të ardhmen.

Në çdo rast kur gjykata vlerëson se është e nevojshme që ndaj kryesit të dhunës të shqiptohet masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit të personave të ekspozuar ndaj dhunës,

---

<sup>5</sup> Komentari i Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.

dhe fëmijët i janë ekspozuar dhunës së shkaktuar dhe mund t'i ekspozohen edhe në të ardhmen, atëherë varësisht edhe prej masave tjera mbrojtëse të cilat mund t'i shqiptojë, detyrimisht duhet të vendos edhe lidhur me besimin e kujdestarisë së përkohshme të fëmijëve njërit prind dhe heqjen e së drejtës së përkohshme prindit tjetër, ashtu siç edhe kërkohet me paragrafin 2 të nenit 6 të LMDHF-së, ngase çdoherë duhet të merret interesi më i mirë i të miturit në rritjen dhe zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik të tij në të ardhmen.

Mirëpo, gjykatat në çdo rast kur fëmijun e mitur përkohësisht në kujdestari ia besojnë njërit prind, ndërsa të drejtën prindërore ia heqin përkohësisht prindit tjetër, duhet të kenë parasysh se nuk mund të lejohet kontakti i fëmijut të mitur me prindin të cilit përkohësisht ju ka hequr e drejta prindërore, sepse kjo masë e shqiptuar është e karakterit të përkohshëm dhe zgjat aq sa zgjat urdhëri mbrojtës i caktuar nga gjykata. Kjo masë e shqiptuar ka për qëllim që edhe kryesi i dhunës t'i ndjejë pasojat e dëmshme dhe jo të këndshme të cilat kanë ardhur si shkak i veprës apo lëshimeve të tij të qëllimshme të ndërmarra ndaj anëtarit tjetër të familjes, të cilat në një formë apo formë tjetër tek i njëjti do ta ngrisin ndërjegjen për veprimet të cilat mund t'i ndër marrë në të ardhmen apo ato të cilat tashmë i ka ndër marrë.

Caktimi i masës nga neni 6 parag. 2 të LMDHF, po ashtu nuk ka asnjë ndikim në të drejtat e palëve që ata përmes padisë në procedurën kontestimore të kërkojnë që të vendoset lidhur me besimin e fëmijëve njërit apo tjetrit prind, kontaktin, alimentacionin por edhe ndonjë kërkesë tjetër, pasi që masat të cilat caktohen nga gjykata sipas dispozitave të parapara me LMDHF janë të karakterit të përkohshëm, qëllimi i të cilave është ruajta e një gjendjeje ekzistuese dhe lehtësimi i pasojave të dëmshme të cilat janë shkaktuar apo mund të shkaktohen si shkak i veprave apo lëshimeve të qëllimshme që një anëtar i familjes i ka ndër marrë ndaj anëtarit tjetër.

### **3.2.6 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit të Kosovës vërehet se në disa raste gjykatat e shkallës së parë përkundër faktit se sipas kërkesës së palës së mbrojtur ndaj kryesit kanë caktuar masën mbrojtëse të ndalimit të shqetësimit të personave të ekspozuar ndaj dhunës, (neni 6 parag. 1 të LMDHF) dhe me rastin e vendosjes së çështjes kanë qenë në dijeni të faktit se pala e mbrojtur dhe kryesi i dhunës kanë fëmijë të përbashkët të cilët jetojnë në një shtëpi apo banesë me prindërit e tyre, nuk kanë vendosur fare se gjatë kohës sa zgjat urdhëri mbrojtës i caktuar nën kujdestarinë e kujt do të mbesin fëmijët e mitur dhe a plotësohen apo jo kushtet ligjore që prindit tjetër i cili ka kryer dhunë në familje t'i merret përkohësisht e drejta prindërore.

Në disa raste vërehet se gjykata me rastin e shqiptimit të masës mbrojtëse të ndalimit të shqetësimit të personave të ekspozuar dhunës, ka vendosur që fëmijë i përbashkët i palës së mbrojtur dhe kryesit të dhunës t'i besohet përkohësisht nën kujdestari palës së mbrojtur si viktimë e dhunës në familje dhe e drejta prindërore përkohësisht t'i hiqet kryesit të dhunës, por krahas kësaj ka caktuar edhe kontaktin e të miturit me kryesin e dhunës.

Ka pasur edhe raste kur gjykata me rastin e shqiptimit të masës mbrojtëse të ndalimit të shqetësimit të personave të ekspozuar ndaj dhunës, ka vendosur që fëmijë i përbashkët i palës së mbrojtur dhe kryesit të dhunës t'i besohet përkohësisht nën kujdestari palës së mbrojtur si viktimë e dhunës në familje dhe e drejta prindërore përkohësisht t'i hiqet kryesit

të dhunës, por në shkresa të lëndës nuk ka pasur prova për identitetin e plotë të të miturit, emrin dhe mbiemrin, ditëlindjen, vendlindjen etj, e çka është më e rëndësishmja nuk ka pasur dëshmi se i mituri është fëmijë i përbashkët i palës së mbrojtur dhe kryesit të dhunës.

Gjykatat e shkallës së parë në çdo rast pa përjashtim, kur konstatojnë se plotësohen kushtet ligjore për caktimin e masës mbrojtëse të ndalimit të shqetësimit të personave të ekspozuar ndaj dhunës, dhe në ato raste vërtetohet se pala e mbrojtur dhe kryesi i dhunës kanë fëmijë të përbashkët, kanë për detyrim ligjor që duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare të vendosin edhe lidhur me kujdestarinë e përkohshme të fëmijut të mitur njërit prind dhe heqjen e së drejtës prindërore prindit tjetër.

Nëse me provat e nxjerra nga gjykata vlerësohet se fëmijët e mitur në çfarëdo forme i janë ekspozuar dhunës së shkaktuar në mes prindërve të tyre dhe mund t'i ekspozohen edhe në të ardhmen, e cila do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin psikik dhe fizik të tyre, atëherë në rastet e tilla parimisht duke pasur për bazë dispozitën e nenit 6 parag. 2 të LMDHF, fëmijët e mitur duhet besuar përkohësisht në kujdestari të viktimës së dhunës në familje, ndërsa kryesit të dhunës duhet t'i hiqet e drejta prindërore, më përjashtim kur nga rrethanat e rastit vlerësohet se është e pamundur apo nuk është në interesin më të mirë të të miturit që i njëjti t'i besohet nën kujdestari palës së mbrojtur.

Mirëpo parapakisht para se gjykata të vendosë lidhur me kujdestarinë e përkohshme të të miturit, gjykata duhet të ketë prova lidhur me identitetin e plotë të të miturit, emrin, mbiemrin, ditëlindjen, vendlindjen, por edhe të dhënat tjera të nevojshme lidhur me identitetin e prindërve të tij, për shkakun se edhe në këtë procedurë nuk mund të vendoset për interesin më të mirë të një të mituri, nëse nuk kemi të dhëna të mjaftueshme lidhur me identitetin e plotë të tij, që rrjedhimisht vendimi gjyqësor në këtë pjesë të mund të ishte i përmbarueshëm.

Në asnjë rrethanë, në rastet kur fëmijë i mitur përkohësisht i besohet në kujdestari njërit prind, ndërsa e drejta prindërore i hiqet përkohësisht prindit tjetër, gjykatat nuk duhet ta caktojnë kontaktin e fëmijut të mitur me prindin të cilit përkohësisht i është hequr e drejta prindërore, sepse masa e shqiptuar ka karakter të përkohshëm e cila zgjat aq sa zgjat urdhëri mbrojtës i caktuar nga gjykata dhe gjatë kohës sa zgjat kjo masë mbrojtëse prindi të cilit i është hequr e drejta prindërore ligjërisht nuk mund ta realizojë asnjë të drejtë mbi fëmijun e tij, duke përfshirë edhe kontaktin me të njëjtin.

### **3.2.7 Referencë nga arsyetimi i Aktvendimit të Gjykatës së Apelit**

**Aktvendimi AC.nr.115/17 i datës 19.01.2017**

#### **Arsyetimi**

*Gjykata e Apelit e Kosovës duke e ekzaminuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të ankesës, gjen se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë lidhur më mënyrën e vendosjes sipas pikës III të dispozitivit të aktvendimit të ankimit nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar në këtë pjesë është marrë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.*

Aktivendimi është i përfshirë në shkelje nga dispozita e nenit 182 paragrafi 2 pika (n) pasi që dispozitivi i aktivendimit është në kundërtënie me vetveten dhe me arsyet e aktivendimit (në pjesën e atakuar me ankesë). Deri te shkelja e kësaj dispozite nga neni 182 paragrafi 2, pika (n) e LPK-së, ka ardhur për arsye se gjykata nuk i është përmbajtur kërkesave të LPK-së, sa i përket përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Me dispozitën e nenit 160 paragrafi 5, përcaktohet se: “gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve,.....”. Në këtë rast gjykata nuk e ka arsyetuar fare se si i ka zbatuar dispozitat e së drejtës materiale në përputhje me të gjeturat faktike, specifikisht sa i përket mënyrës së vendosjes si në pikën III (tre) të dispozitivit të aktivendimit të atakuar.

Aktivendimi i atakuar është në kundërtënie me vetveten pasi që gjykata në njërën anë i heqë përkohësisht të drejtën prindërore kryesit të dhunës, ndërsa në anën tjetër i cakton kontaktin me fëmijën e mitur. Përveç kësaj, gjykata nuk ka dhënë asnjë arsye, përkatësisht arsyetim se si ka ardhur deri tek ky përfundim për të vendosur si në pikën III (tre).

Gjykata e Apelit, nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për tejkalim të kërkesës sepse në çdo procedurë gjyqësore ku përfshihen të miturit, gjykata zyrtarisht duhet të kujdeset që parim mbizotërues në procedurë të jetë interesi më i mirë i të miturit, prandaj çfarëdo mase që aplikon gjykata për t'i mbrojtur të drejtat përkatësisht interesat e të miturve në procedurë edhe kur nuk ka kërkesë nga kujdestarët e të miturve, nuk mund të konsiderohet tejkalim i kërkesës.

Lidhur me zbatimin e së drejtës materiale duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, Gjykata e Apelit, vlerëson se dispozita e nenit 6 paragrafi 2, i LDHMF-së, është zbatuar gabimisht për arsye se heqja e së drejtës prindërore përkohësisht për kryesin e dhunës dhe caktimi i kontaktit për të njëjtin me fëmijën e mitur nuk mund të vendosen njëkohësisht. Gjykata duhet sipas propozimeve të palëve por edhe zyrtarisht t'i hetojë rrethanat e çështjes nëse është e nevojshme heqja e së drejtës prindërore përkohësisht, dhe nëse konstaton se duhet t'i hiqet e drejta prindërore kryesit të dhunës, atëherë për të njëjtin nuk mund të caktohet kontakti, por nëse gjen se nuk është e nevojshme heqja e së drejtës prindërore atëherë mund të caktohet kontakti. Përveç tjerave gjykata duhet ta marrë në konsideratë se çdo fëmijë ka të drejtë të rritet me të dy prindërit, ndërsa në rastet kur kjo është e pamundur kjo e drejtë realizohet përmes kontaktit, por në asnjë rast nuk mund të justifikohet kontakti si e drejtë duke e rrezikuar fëmijën apo kujdestarin/en e fëmijës.

Nën këto rrethana, gjykata e shkallës së dytë gjeti se vendimi i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë duhej prishur në pikën III (tre), më qëllim që në riprocedurë gjykata e shkallës së parë t'i evitojë shkeljet e dispozitave të sipër theksuara, në atë mënyrë që në procedurën sipas kërkesës për urdhër-mbrojtje të kujdeset për specifikat e procedurës duke i hetuar të gjitha rrethanat sipas së cilave gjykata mund ta sjell një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Gjykata duhet të ketë një vlerësim specifik për nevojën e kujdestarisë së përkohshme, për heqjen eventuale të së drejtës prindërore dhe për caktimin apo moscaktimin e kontaktit në mes të fëmijës së mitur dhe palës përgjegjëse, gjithsesi duke respektuar dispozitat e së drejtës materiale.

*Lidhur me arsyetimin e vendimit duhet t'i përmbahet kërkesave që i përcaktojnë dispozitat nga neni 160 i LPK-së.*

### **3.2.8 Referencë nga arsyetimi i aktvendimit të Gjykatës së Apelit**

**Aktvendimi AC.nr.4189/16, i datës 29.11.2016**

#### **Arsyetim**

*Pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, gjykata e shkallës së dytë nuk mund t'i përkrahë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktvendimi i atakuar është marrë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.*

*Aktvendimi është i përfshirë në shkelje nga dispozita e nenit 182 paragrafi 2 pika (n) pasi që dispozitivi i aktvendimit është në kundërtënie me arsyet e aktvendimit. Deri te shkelja e kësaj dispozite nga neni 182 paragrafi 2, pika (n) e LPK-së, ka ardhur për arsye se gjykata nuk i është përmbajtur kërkesave të LPK-së, sa i përket përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Me dispozitën e nenit 160 paragrafi 5, përcaktohet se: “gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve.....”. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar fare se si i ka zbatuar dispozitat e së drejtës materiale në përputhje me të gjeturat faktike, posaçërisht sa i përket mënyrës së vendosjes si në pikën dy (II) të dispozitivit të aktvendimit të atakuar. Për të vendosur si në pikën dy (II) të dispozitivit të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitës së nenit 6 paragrafi 2, i LDHMF-së, me të cilën përcaktohet se: “kujdestaria e fëmijës përkohësisht i besohet viktimës së dhunës në familje, ndërsa e drejta prindërore përkohësisht i hiqet kryesisht të dhunës në familje”. Minimalisht gjykata do të duhej të arsyetonte se si e ka interpretuar këtë dispozitë kur ka vendosur që fëmijët e mitur të mbesin nën përkujdesjen e përkohshme të atit B. H., nga Prizreni. Nga shkresat e lëndës nuk rezulton se B. H. është viktimë e dhunës në familje.*

*Me qenë se gjykata i është referuar dispozitës së nenit 6 paragrafi 2, i LMDHF-së, rezulton se vendosjen si në pikën dy (II) të dispozitivit të aktvendimit të atakuar e ka trajtuar si vendosje për masën mbrojtëse, por gjykata do të duhej ta kishte një vlerësim paraprak nëse mund të vendosen masat mbrojtëse në qoftë se nuk lëshohet/caktohet urdhëri për mbrojtje. Me dispozitën e nenit 3 paragrafi 5, i LMDHF-së, përcaktohet se: “ gjykata kompetente, me urdhër-mbrojtje apo me urdhër-mbrojtje emergjente mund të shqiptojë një apo më tepër masa mbrojtëse”. Nga interpretimi i kësaj dispozite rezulton se masat mbrojtëse një apo më shumë mund të lëshohen nga gjykata kompetente me urdhër-mbrojtje.*

*Gjykata e Apelit nuk është lëshuar në vlerësime tjera sipas pretendimeve ankimore pasi që konstatoi se aktvendimi i atakuar ishte i përfshirë në shkeljet e sipër theksuara të cilat duhet të eliminohen në riprocedurë.*

*Nën këto rrethana, gjykata e shkallës së dytë gjeti se vendimi i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë duhet prishur, më qëllim që në riprocedurë gjykata e shkallës së parë t'i evitohet shkeljet e dispozitave të sipër theksuara, në atë mënyrë që në procedurën sipas kërkesës për urdhër-mbrojtje të kujdeset për specifikat e procedurës duke vendosur brenda kufijve të lejuar sipas kërkesës për urdhër-mbrojtje. Në procedurën e shqyrtimit gjykata*

*duhet të kufizohet në të provuarit e rrethanave që i referohen dhunës dhe masave mbrojtëse që duhet të caktohen nëse provohet dhuna, ndërsa nëse nuk provohet dhuna në asnjërën nga mënyrat/format e paraqitjes, atëherë duhet të vlerësojë nëse mund të caktohet ndonjëra nga masat e parapara me LMDHF-në, nëse nuk ka kushte për caktimin e urdhërit-mbrojtës.*

## 4. KONTESTET FAMILJARE

### 4.1 VENDIMI I GJYKATËS PËR USHTRIMIN E TË DREJTAVE DHE DETYRAVE PRINDËRORE

Me dispozitën ligjore të nenit 140 të Ligjit për Familjen të Kosovës, (më tej LFK) është përcaktuar që: *“Kur gjykata kompetente në kontestin martesor e merr aktgjykimin me të cilin zgjidhet ose anulohet martesa me atë aktgjykim gjykata do të vendosë për ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve të mitur.*

*Nëse prindërit nuk janë marrë vesh për rastin e cekur në paragrafin 1, ose marrëveshja e tyre nuk u përgjigjet interesave të fëmijëve, gjykata, pasi ta marrë mendimin dhe propozimin e Organit të Kujdestarisë, dhe t'i hetojë të gjitha rrethanat, do të vendos: Që të gjithë fëmijët të mbesin për ruajtje dhe edukim tek njëri prind, që disa të mbesin tek nëna, kurse disa tek i ati, që të gjithë ose disa fëmijë t'i besohen ndonjë personi të tretë. Mendimi i fëmijës, i cili është i aftë t'i japë pikëpamjet e tij/saj, do të merret parasysh nga gjykata në çdo procedurë që i përket atij. Mendimit të tij do t'i jepet pesha e duhur në pajtim me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.”*

#### 4.1.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me besimin e fëmijëve në kujdes prindëror me rastin e zgjidhjes ose anulimit të martesës

Nga këto dispozita ligjore rezulton se: kur martesa është shuar me **anulim** ose **shkurorëzim**, ndërsa prindërit:

- nuk janë marrë vesh për kujdesin prindëror ndaj fëmijëve, ose
- marrëveshja e tyre nuk u përgjigjet interesave më të mira të fëmijës/ve.

Gjykata sipas detyrës zyrtare, pasi që ta marrë mendimin dhe propozimin e organit të kujdestarisë, dhe t'i hetojë të gjitha rrethanat përfshirë edhe mendimin e fëmijës, i cili është i aftë t'i japë pikëpamjet e tij/saj, do të vendosë edhe për kujdesin prindëror ndaj fëmijëve.

Në këtë drejtim praktika gjyqësore është unike, pra nuk ka dilema rreth detyrimit ligjor të gjykatës që me rastin e shuarjes së martesës në njërën nga format e lartë cekura, gjykata e shkallës së parë për kujdesin prindëror të vendosë sipas detyrës zyrtare, për besimin e kujdesit prindëror.

Me nenin 144 të LFK, është përcaktuar se: *“Gjykata ose organi i kujdestarisë, i cili merr vendimin mbi besimin e fëmijës për ruajtje dhe edukim, ka për detyrë që në mënyrë të përshtatshme t'i hetojë të gjitha rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik dhe për edukimin e fëmijës. Në rast së fëmija është me moshë mbi 10 vjeç, gjykata do t'i marrë parasysh, posaçërisht nevojat emocionale dhe dëshirat e fëmijës. Nëse e mendon të nevojshme, gjykata do ta marrë parasysh mendimin e ekspertëve.”*

Pra, nga kjo dispozitë ligjore rezulton se gjykata kompetente me rastin e vendimmarrjes lidhur me besimin e fëmijës për ruajtje dhe edukim, ka për detyrë që në mënyrë të përshtatshme, t'i hetojë të gjitha rrethanat që janë me ndikim në zhvillimin e drejtë psiko-fizik, si dhe në edukimin e fëmijës, duke marrë për bazë emocionet dhe dëshirat e fëmijës së moshës mbi 10 vjeç, sipas nevojës ta marrë edhe mendimin e ekspertëve përkatës.

Kjo dispozitë ligjore i referohet provave të cilat gjykata duhet t'i marrë me rastin e vendimmarrjes për besimin e fëmijës në ruajtje dhe edukim qoftë njërit prind, të dy prindërve ose personit të tretë, por gjithnjë, duke e marrë parasysh interesin më të mirë të fëmijës për zhvillimin psikik dhe fizik si dhe për edukim.

#### 4.1.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, me rastin e procedimit të lëndëve në procedurë sipas ankesës, ka konstatuar në disa raste se nuk është zbatuar drejtë dispozita ligjore e nenit 140 lidhur me nenin 6.4 dhe 80 të LFK, sepse sipas paragrafit 4 të nenit 6 të LFK, organi i kujdestarisë është pjesëmarrës në procedurë, për mbrojtjen e interesave më të mira të fëmijës, në kontestet kur zgjidhet martesë me shkurorëzim ose anulohet.

Ky organ në raste të tilla *zhvillon paraprakisht procedurën e pajtimit* në mes të bashkëshortëve dhe në rast të dështimit të pajtimit, organi i kujdestarisë *jep mendim dhe propozim profesional* lidhur me besimin e kujdesit prindëror për fëmijët jomadhör.

Në kuptim të paragrafit 4 të nenit 6 të LFK, *gjykata është e obliguar ta ftojë në gjyq organin e kujdestarisë në të gjitha seancat gjyqësore dhe t'ia dorëzojë atij të gjitha vendimet.*

Gjykatat e shkallës së parë, në disa raste kanë dështuar që ta thërrasin Organin e kujdestarisë në seancë gjyqësore, kur është marrë mendimi i fëmijëve të moshës jo madhore sepse nuk ka qenë i pranishëm përfaqësuesi i Organit të kujdestarisë dhe nuk ka prova se i njëjti është ftuar në mënyrë të rregullt.

Me një veprim të këtillë gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 k) të LPK, lidhur me nenin 6 par. 4 të LFK, *sepse fëmijët nuk janë përfaqësuar nga organi kompetent.* Në prani të kësaj shkeljeje procedurale aktgjykimi ankimor si i tillë nuk mund të qëndrojë dhe duhet të priset.

*Gjithashtu, gjykatat nuk i hetojnë të gjitha rrethanat* që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik dhe për edukimin e fëmijës; pra ato nuk e marrin mendimin e fëmijës i cili i ka mbushur 10 vjet.

Marrja e deklaratës së fëmijës në këtë rast sipas paragrafit 2 të nenit 144 të LFK, ka për qëllim që të merren parasysh dëshirat e fëmijës se me cilin prind dëshiron të jetojë, duke ruajtur edhe lidhjen emocionale me prindin me të cilin ndjen afërsi më të madhe.

Pra, ndjenjat e fëmijës përveç fakteve tjera janë të rëndësishme gjatë procedurës së vendosjes për besimin e fëmijëve në kujdes prindëror, sepse ndikojnë në mirërritjen e fëmijës nëse ato respektohen.

Mirëpo, ky mendim nuk është fakt i vetëm vendimtar sepse fëmija mund të jetë në rrethana të ndryshme emocionale të momentit dhe mendimi i tij duhet të shqyrtohet duke hetuar fakte dhe prova të tjera, siç janë marrja e mendimit të ekspertit psikolog dhe sociolog, si dhe ekspertizën që e ofron Organi i kujdestarisë, në mënyrë që me rastin e besimit të fëmijës të kihet parasysh interesi i tij më i mirë.



Gjykatat e shkallës së parë, dështojnë ta marrin mendimin e ekspertëve kompetent, andaj rezultojnë se me rastin e vendimmarrjes lidhur me besimin e fëmijës, nuk i hetojnë të gjitha faktet dhe rrethanat vendimtare për vendimmarrje të ligjshme dhe të drejtë në zgjidhjen e këtyre kontesteve.

## 4.2 MBAJTJA FINANCIARE E FËMIJËVE

Mbajtja financiare e fëmijëve është e rregulluar me dispozitat ligjore të neneve 290, 291, 292 dhe 293 të Ligjit për Familjen i Kosovës, nr.34/2002 i dt. 20 janar 2006, i cili ka hyrë në fuqi nga data 16 shkurt 2006 (në tej LFK).

*Me nenin 290 të LFK është përcaktuar:*

- 1) *“Prindërit janë të detyruar të ofrojnë mbajtje financiare për fëmijët e tyre të mitur.*
- 2) *Nëse fëmija nuk e ka përfunduar shkollimin deri në moshën madhore, prindërit kanë detyrim t’ia ofrojnë mbështetjen e nevojshme për ta siguruar shkollimin, respektivisht edukimin në fakultet deri sa fëmija ta arrijë moshën 26 vjeç”.*

*Me nenin 291 të LFK, është përcaktuar: Mbajtja e fëmijës së mitur në rastet e veçanta:*

*Nëse fëmija i moshës madhore nuk është në gjendje të punojë për shkak të sëmundjes, të metave fizike dhe mentale, dhe i cili nuk ka sasi të mjaftueshme të mjeteve financiare për shpenzimet e tij financiare, prindërit e kanë për detyrim t’ia sigurojnë ndihmën financiare deri sa një situatë e tillë të mbarojë.*

*Me nenin 293 të LFK, është përcaktuar: Prindit të cilit i është hequr kujdesi prindëror nuk lirohet nga detyrat për t’i mbajtur fëmijët e tij.*

*Si përjashtim nga detyrimi ligjor i prindërve për mbajtje financiare të fëmijës i paraparë me dispozitat ligjore të neneve 290, 291 e 293, të LFK, është neni 292 i të njëjti ligj me të cilin është përcaktuar që:*

*Detyrimi i fëmijës nga mosha 15 vjeçare e tutje, fëmija i cili fiton të ardhura me punën e tij, është i detyruar që financiarisht të kontribuojë për mbajtjen e tij dhe nëse e kërkon nevoja edhe për kontribut të arsyeshëm për mbajtjen e familjes me të cilën jeton.*

### 4.2.1 Koment i shkurtër i dispozitave ligjore të nenit 290 të LFK

Nga dispozitat ligjore të nenit 290 të LFK, rezultojnë se mbajtja financiare e fëmijëve është detyrim ligjor i prindërve, deri sa fëmijët ta arrijnë moshën madhore e nëse ata janë në shkollim respektivisht edukim në fakultet, deri sa fëmija të arrijë moshën 26 vjeçare.

Sipas kësaj dispozite ligjore rezultojnë se mbajtja financiare të cilën duhet ta sigurojnë prindërit për fëmijët e tyre të mitur dhe në shkollim e edukim deri në moshën 26 vjeçare, është detyrim ligjor, pa marrë parasysh se cilit nga prindërit i është besuar kujdesi prindëror, pra, përfshirë edhe rastin kur prindit i është hequr e drejta prindërore.

Mbajtja financiare, përfshinë sigurimin e mjeteve të nevojshme për mirëqenien e fëmijës që përfshinë mirërritjen dhe aftësimin e fëmijës. Ky obligim ekziston edhe në rastet kur prindërit jetojnë bashkërisht me fëmijën dhe kur fëmija për shkaqet e parapara me ligj nuk jeton me prindërit e tij. Ky obligim ekziston edhe kur prindërit nuk janë në marrëdhënie pune, pra, duke marrë parasysh gjithnjë mundësitë reale të prindërve kur krijojnë të ardhura nga burimet tjera përveç marrëdhënies së punës. Pra, përderi sa ata kanë mjete për vete duhet të sigurojnë mjete financiare për fëmijët e tyre.

#### **4.2.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Gjykata e Apelit, me rastin e procedimit të lëndëve në procedurë sipas ankesës, në disa raste, ka konstatuar se gjykatat e shkallës së parë nuk hapin shqyrtim rreth fakteve vendimtare kontestuese lidhur me caktimin e mbajtjes financiare, dhe atë:

*Se cilat janë mundësitë financiare të ndërgjyqësve për përmbushjen e detyrimit ndaj fëmijëve të tyre të përbashkët për mbajtje financiare, cilat janë ato nevoja dhe kostoja e tyre, pra në këtë rast gjykatat duhet t'i shfrytëzojnë të gjitha mjetet provuese për konstatimin e plotë dhe të drejtë të fakteve vendimtare, si kusht ligjor për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale dhe vendimmarrje të ligjshme dhe të drejtë në zgjidhjen e kontesteve të tilla, duke mos përjashtuar mundësinë edhe me marrjen e provës me konstatimin dhe mendimin e ekspertit kompetent.*

#### **4.2.3 Kontakti i fëmijës me prindin të cilit nuk i është besuar kujdesi prindëror**

*Me nenin 125 të LFK, janë përcaktuar parimet për mbrojtjen e fëmijëve.*

*Me parimin 2 të dispozitës së lartcekur është përcaktuar që: “Fëmijët kanë të drejtë të rriten në familje me prindër. Fëmijët që nuk jetojnë bashkë me të dy prindërit kanë të drejtë t'i takojnë rregullisht prindërit me të cilët nuk jetojnë;”*

*Me nenin 140.3 të LFK, është përcaktuar që: “Nëse prindi i cili ushtron kujdesin prindëror pengon kontaktet personale të fëmijës me prindin tjetër, gjykata me aktgjykim do ta rregullojë edhe mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të fëmijës me prindin, i cili nuk e ushtron kujdesin prindëror, nëse vlerësimi i të gjitha rrethanave të rastit tregon se kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e fëmijës.”*

*Me nenin 145 të LFK, është përcaktuar që: “Nëse fëmija jeton vetëm me njërin prind ose me personin e tretë ose në institucion, prindërit do të merren vesh për mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale me fëmijën. Në rast të kontestit, vendimin lidhur me këtë gjë e merr gjykata kompetente. Gjykata kompetente përsëri mund ta rregullojë mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të prindërve me fëmijët, nëse këtë gjë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara.”*

#### **4.2.4 Koment i shkurtër i dispozitave ligjore për rregullimin e kontakteve personale të fëmijës**

Me dispozitën ligjore të nenit 145 të LFK, janë përcaktuar rregullat se prindërit me marrëveshje mund ta caktojnë mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale me fëmijën, i cili jeton vetëm me njërin prind ose me personin e tretë ose në institucion. Një formë e tillë

e rregullimit të kontaktit me marrëveshje, është e lejuar përderisa gjykata, nuk konstaton se marrëveshja e tillë është në kundërshtim me interesat e fëmijës.

Nëse prindërit e fëmijës, kontaktin personal të fëmijës me prindin me të cilin nuk jeton, ose i cili jeton me personin e tretë ose në institucion, nuk mund ta rregullojnë me marrëveshje, vendimin lidhur me këtë çështje e merr gjykata kompetente.

Gjykata mund ta ndryshojë vendimin e saj me të cilin ka përcaktuar mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të fëmijës me prindin, në rast kur ndryshojnë rrethanat të cilat kushtëzojnë ndryshimin e vendimit përkatës, ashtu që fëmija i besohet prindit tjetër, ose njëri prind i pengon kontaktet personale të fëmijës ndërsa procedura e tillë inicohet me kërkesën e prindit ose organit të kujdestarisë.

Njëra nga rrethanat për ndryshimin e vendimit për kontaktin e fëmijës është kur për shkak të rrethanave të ndryshuara, duhet ndryshuar vendimi mbi besimin e kujdesit prindëror, ashtu që fëmija i besohet në kujdes prindëror prindit tjetër ose personit të tretë. Pra, në këtë rast duhet të ndryshohet edhe vendimi i kontakteve personale të fëmijës, duke caktuar kontaktet me prindin të cilit tani i merret kujdesi prindëror. Ndërsa kur bëhet fjalë për rastet kur njëri prind i humb zotësia e veprimit ose i kufizohet apo i merret e drejta prindërore, vendimi i gjykatës do të ndryshohet në kuptimin se si do të realizohen kontaktet personale me këtë prind.

Rrethanë tjetër është edhe kur prindi të cilit i është besuar kujdesi prindëror e pengon prindin tjetër për mbajtjen e kontakteve personale ashtu siç është parashikuar me vendim të gjykatës, ose në marrëveshjen e prindërve. Në këtë rast gjykata kompetente mund ta ndryshojë vendimin për kontakte personale të fëmijës duke ia besuar fëmijën prindit tjetër në përkujdesje, ose duke i specifikuar rrethanat tjera që kontakti personal i fëmijës me prindin të cilit nuk i është besuar kujdesi prindëror, të zhvillohet nën mbikëqyrjen e organit të kujdestarisë.

#### **4.2.5 Gjetjet nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit**

Në Gjykatën e Apelit, gjatë procedimit të çështjeve në shkallë të dytë, janë paraqitur raste kur dispozitat ligjore të nenit 140.3 të LFK, nuk janë zbatuar si duhet, sepse gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes për besimin e kujdesit prindëror të fëmijës, njërit prind (nënës së tij), nuk ka vendosur fare lidhur me kontaktin personal të fëmijës me prindin të cilit nuk i është besuar kujdesi prindëror, edhe pse prindërit paraprakisht me marrëveshje nuk e kishin rregulluar këtë kontakt.

Në disa raste tjera gjykata e shkallës së parë nuk e ka caktuar mënyrën e realizimit të kujdesit prindëror, sepse nuk e ka përcaktuar kohën dhe vendin e dorëzimit-pranimit të fëmijës, edhe pse ky fakt ishte kontestues.

Gjykata e shkallës së parë në një rast, duke mos ndryshuar aktgjykimin tjetër të të njëjtës gjykate, me të cilin është rregulluar kontakti personal i fëmijës me prindin të cilit nuk i është besuar kujdesi prindëror, ka dhënë aktgjykim tjetër sipas të cilit e ka rregulluar kontaktin personal të fëmijës me babain e tij dy herë në muaj. Pra, vendimet gjyqësore të shkallës së parë në këtë rast janë të ndryshme nga njëra tjetra dhe që paraqesin tituj përmbarrimor kontradiktor.

## 4.2.6 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit

**Aktvendimi AC.nr.4133/2015 i datës 22.08.2016**

### **Arsyetim**

*Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka hapur shqyrtim për të gjitha faktet kontestuese rreth kërkesave për mbajtje financiare të palës së paditur dhe të fëmijëve të moshës jo madhore që janë nën përkujdesjen e saj, fakte këto që janë të specifikuara në dispozitat ligjore të neneve 290 dhe 297 e 298 të LFK, e që aktgjykimin e bën të përfshirë me shkelle thelbësore dispozita e procedurës kontestimore nga neni 197 c) i LPK në prani të të cilave aktgjykimi ankimor nuk mund të qëndrojë dhe si i tillë duhet prishur.*

*Me këtë dispozitë ligjore është përcaktuar se, gjykata e shkallës së dytë në seancën e kolegjit me aktvendim e prish aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështjen ia kthen në rigjykim të njëjtës gjykatë të shkallës së parë, nëse e ka dhënë aktgjykimin pa e bërë shqyrtimin kryesor të çështjes juridike.*

*Në shkresat e lëndës në procesverbalin për shqyrtimin kryesor të çështjes, nuk ka prova se gjykata e shkallës së parë ka hapur shqyrtim për faktet kontestuese se cilat janë mundësitë financiare të ndërgjyqësve për përmbushjen e detyrimit ndaj fëmijëve të tyre të përbashkët për mbajtje financiare, cilat janë ato nevoja dhe cila është kostoja e tyre. Gjithashtu, nuk janë shqyrtuar dhe provuar faktet kontestuese për gjendjen financiare të të paditurës, aftësia e saj punuese, mundësia e saj për punësim, si dhe mundësitë financiare të paditësit për t'i përmbushur detyrimet e tij për mbajtje financiare të ish bashkëshortes, në bazë të kritereve të përcaktuara me nenin 298 lidhur me nenin 299 të LFK.*

*Kolegji vlerëson se në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes duhet të shqyrtohen të gjitha faktet relevante kontestuese për vendosjen meritorë të çështjes, seanca nuk nënkupton një tubim formal, por mundësi reale që palët procedurale çështjen e tyre ta parashtrojnë plotësisht dhe të shqyrtohet në tërësi nga gjykata kompetente.*

*Sa i përket pretendimeve ankimore për konstatimin e gabuar të gjendjes faktike:*

*Me nenin 290 të Ligjit për Familjen të Kosovës nr. 2004/32 është përcaktuar që: “Prindërit janë të detyruar të ofrojnë mbajtje financiare për fëmijët e tyre të mitur. Nëse fëmija nuk e ka përfunduar shkollimin deri në moshën madhore, prindërit kanë detyrim ta ofrojnë mbështetjen e nevojshme për ta siguruar shkollimin, respektivisht edukimin në fakultet derisa fëmija të arrijë moshën 26 vjeçare.”*

*Nga kjo dispozitë ligjore rezulton se mbajtja financiare duhet të jetë adekuate për rritjen dhe aftësimin e fëmijës për punësim. Mbajtja financiare si e tillë përfaqëson obligim prindëror si në rastet kur prindërit jetojnë bashkërisht me fëmijën ashtu edhe kur fëmija jeton ndaras nga njëri ose nga të dy prindërit.*

*Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se gjykata ka detyrë ligjore që sipas detyrës zyrtare t'i vërtetojë edhe faktet dhe t'i marrë provat që janë me rëndësi relevante për vërtetimin e mundësive materiale të të dy prindërve e në këtë rast të paditurit që ta*

*paguajë shumën adekuate me mundësitë e tij materiale, për mbajtjen financiare të fëmijëve të tij të mitur.*

*Gjykata e shkallës së parë në riprocedurë ka për detyrë që t'i evitojë shkeljet e lartcekura procedurale, ta zbatojë drejtë ligjin procedural, ta konstatojë drejtë dhe plotësisht gjendjen faktike dhe ta zbatojë drejtë të drejtën materiale. Këto parakushte vlejnë për një vendim-marrje të ligjshme dhe të drejtë në këtë çështje e posaçërisht të marrë prova adekuate që të vërtetohet gjendja pasurore e ndërgjyqësve, e që do të ishte bazë për ta caktuar një shumë adekuate, pra të nevojshme për mbajtjen financiare të fëmijëve të tij të mitur, të cilët janë nën përkujdesje të nënës së tyre, si dhe mbajtjen financiare të të paditurës.*

*Vendimi mbi shpenzimet procedurale është prishur, pasi që ai duhet t'i përfshijë edhe shpenzimet e krijuara me rastin e paraqitjes së ankesës dhe e drejta për kompensim në këto shpenzime, bazohet në suksesin që palët e arrijnë në këtë kontest për çështjen në rigjykim ashtu siç është përcaktuar me dispozitat përkatëse ligjore (nenet 449-473) të LPK lidhur me nenin 347 të LFK.*

#### **Aktvendimi CA.nr.2992/2014 i datës 13.01.2015**

##### **Arsyetim**

*Sa i përket pretendimeve për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore:*

*Në këtë çështje juridike në kuptim të nenit 6.4 dhe 80 të Ligjit për Familjen të Kosovës, (më tej LFK) Organi i kujdestarisë, është pjesëmarrës në procedurë në të gjitha rastet e proceseve gjyqësore për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim, kur bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët të moshës jo madhore. Ky organ në raste të tilla e zhvillon paraprakisht procedurën e pajtimit në mes të bashkëshortëve dhe në rast të dështimit jep mendim profesional lidhur me besimin e kujdesit prindëror për fëmijët.*

*Në kuptim të paragrafit 4 të nenit 6 të LFK, gjykata është e obliguar të ftojë në gjyq organin e kujdestarisë në të gjitha seancat gjyqësore dhe t'ia dorëzojë atij të gjitha vendimet.*

*Në shkresat e lëndës nuk ka prova se në seancën gjyqësore të dt.---kur është marrë mendimi i fëmijëve të moshës jo madhore ka qenë i pranishëm përfaqësuesi i Organit të kujdestarisë e as prova se i njëjti është ftuar në mënyrë të rregullt.*

*Me një veprim të këtyllë gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 i) të LPK, lidhur me nenin 6 par. 4 të LFK, në prani të kësaj shkeljeje procedurale aktgjykimi ankimor si i tillë nuk mund të qëndrojë dhe duhet prishur.*

*Sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim jo të plotë dhe jo të drejtë të gjendjes faktike:*

*Me nenin 144 të LFK, është përcaktuar:*

- 1. Gjykata ose Organi i Kujdestarisë, i cili merr vendimin mbi besimin e fëmijës për ruajtje dhe edukim, ka për detyrë që në mënyrë të përshtatshme t'i hetojë të gjitha*

rrethanat që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik dhe fizik dhe për edukimin e fëmijës.

2. Në rast se fëmija është me moshë mbi 10 vjeç, gjykata do të marrë parasysh posaçërisht nevojat emocionale dhe dëshirat e fëmijës. Nëse e mendon të nevojshme, gjykata do të marrë parasysh mendimin e ekspertëve.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk i ka hetuar të gjitha faktet vendimtare që janë me ndikim për zhvillimin psikik, fizik dhe edukimin e fëmijëve, pasi që ajo nuk kishte marrë, paraprakisht mendimin e ekspertëve: psikologut dhe sociologut.

Kolegji, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke mos i vërtetuar drejtë dhe plotësisht të gjitha faktet dhe rrethanat në mënyrë të përshtatshme që janë me ndikim vendimtar me rastin e vendosjes për besimin e fëmijëve, në këtë rast nuk mund të përfundohet se është zbatuar drejtë edhe e drejta materiale, për çka gjykata e shkallës së dytë në procedurë sipas ankesës, kujdeset sipas detyrës zyrtare (neni 194 i LPK).

Paragrafi i fundit i aktgjykimit ankimor që ka të bëjë me hedhjen poshtë të kërkesë-padisë së paditëses për besimin e fëmijëve, është i kundërligjshëm sepse kërkesë-padia nuk mund të hedhet poshtë, por, lidhur me kërkesë-padinë gjykata duhet të vendosë në mënyrë meritore.

#### **Aktvendimi AC.nr.4195/2015 i datës 16.12.2015**

##### **Arsyetim**

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin ankimor ka vendosur që të "...Miratohet kërkesë-padia e të paditurës-kundër paditëses... dhe fëmija i mitur i besohet në përkujdesje dhe edukim. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale".

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes lidhur me besimin e fëmijës, nuk e ka zbatuar dispozitën e nenit 145 të LFK, sa i përket kontaktit personal, ngase kjo dispozitë parashihet: Nëse fëmija jeton vetëm me një prind ose me personin e tretë ose në institucion, prindërit do të merren vesh për mënyrën e kontakteve personale me fëmijën. Në rast të kontestit, vendimin lidhur me kontaktin personal me fëmijën e mitur, e merr gjykata kompetente. Që do të thotë se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes meritore fare nuk ka vendosur lidhur me kontaktin personal të fëmijës me prindin të cilit nuk i është besuar fëmija në ruajtje dhe përkujdesje.

Pra, përpos shkaqeve tjera në këtë rast aktgjykimi ankimor është prishur nga gjykata e shkallës së dytë me sugjerim që sërish të merret mendimi i Organit të kujdestarisë si dhe mendimi i psikologut dhe pasi gjykata të vendosë për besimin e kujdesit prindëror, të cilin duhet ta ushtrojë njëri prind,... mund të vendosë lidhur me kontaktin e fëmijës me prindin të cilit nuk i është besuar kujdesi prindëror.

#### **Aktvendimi AC.nr.3889/2015 i datës 02.10.2015**

##### **Arsyetim**

Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ka të bëjë me shkelje nga neni 182 par.2 n) të LFK, që konsiston në faktin se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i pa

*kuptueshëm, kontradiktor me vetveten, ky aktgjykim nuk përmban as arsye mbi faktet vendimtare, ato arsye që janë dhënë janë të paqarta, pastaj ka kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsyeve të të dhënave, të cilat janë në kundërthënie edhe me përmbajtjen e provave të cilat gjenden në shkresë të lëndës.*

*Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar nuk e ka ndryshuar fare aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.806/2013 të dt.14.05.2014, me të cilin është rregulluar kontakti personal i të paditurit, atje paditës, këtu me fëmijën e tyre të përbashkët, duke krijuar kështu gabimisht dy tituj të ndryshëm ekzekutiv për të njëjtën çështje që ka të bëjë me kontaktin me fëmijën e mitur, e që këta tituj bien ndesh me njëri-tjetrin. Kjo paraqet shkelje nga neni 182.2 o) të LPK, nga fakti se nuk është vendosur brenda kufijve të kërkesës së të paditurit në këtë çështje ashtu siç e obligon neni 2.1 i LPK, pra është anashkaluar vendosja për ndryshimin e aktgjykimit të shkallës së parë.*

### **4.3 NDARJA E PASURISË SË PËRBASHKËT TË BASHKËSHORTËVE**

Ligji për Familjen i Kosovës në nenin 47 ka përcaktuar atë që quhet pasuria e përbashkët e bashkëshortëve, me përmbajtje si në vijim:

*Neni 47. Pasuria e përbashkët*

- 1. Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë;*
- 2. Pasuria e përbashkët mund të përfshijë gjithashtu të drejtat sendore dhe të detyrimeve;*
- 3. Pasuria e bashkëshortëve e fituar bashkërisht përmes lojërave të fatit konsiderohet pasuri e përbashkët.*
- 4. Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse nuk janë marrë vesh ndryshe.*

*Neni 54. Vlerësimi i pasurisë së përbashkët në rast të mosmarrëveshjes*

- 1. Nëse nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke i marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar ndaj bashkëshortit tjetër, si kujdesit për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.*
- 2. Gjykata kompetente vendos po ashtu në rast të mosmarrëveshjes lidhur me pjesët e pasurisë së bashkëshortëve të paraparë sipas këtij neni.*

#### **4.3.1 Koment i shkurtër**

Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve duhet të dallohet nga pasuria e veçantë. Përderisa për pasurinë e veçantë vlejnë rregullat e së drejtës civile, për pronësinë e përbashkët involvohen rregullat e ligjit të familjes. Paragrafi 1 i nenit 47, shprehimisht përcakton se si pronësi e përbashkët e bashkëshortëve në radhë të parë është pasuria e fituar me punë. Që të krijohet

pronësia e përbashkët duhet të plotësohen dy kushte. Kushti i parë është ekzistimi i martesës dhe fitimi i pronësisë me punë të përbashkët gjatë martesës.

Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve mund të fitohet vetëm gjatë ekzistimit të martesës, respektivisht nga momenti i themelimit të martesës deri në momentin e ndërprerjes së saj. Ekzistimi i martesës nuk nënkupton vetëm ekzistimin formal të saj, por duhet të ekzistojë edhe jetesa e përbashkët e bashkëshortëve që për qëllim ka funksionin e familjes apo ruajtjen e familjes. Me qëllim të krijimit të pronësisë së përbashkët, në bazë të marrëveshjes midis bashkëshortëve nuk përjashtohet mundësia që duke e ruajtur martesën edhe në vende të ndryshme pune të krijojnë pronësi të përbashkët bashkëshortore. Këtë e kushtëzon dinamika e jetës dhe vendi i punës në qytete apo shtete të ndryshme. Në këto raste duhet që të ekzistojë qëllimi i krijimit të pasurisë së përbashkët që i nënshtrohet regjimit juridik të pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve e rregulluar me LFK. Nëse bashkëshortët nuk kanë jetesë të përbashkët dhe kanë vënë në dijeni njëri tjetrin se nuk duan që të jetojnë së bashku, atëherë edhe pse ekziston kurora kjo pasuri e krijuar në këto rrethana konsiderohet pasuri e veçantë. Andaj, me këtë pasuri secili nga bashkëshortët ka të drejtë që të disponojë lirshëm ndërsa me pasurinë që është krijuar gjatë jetës së përbashkët bashkëshortët nuk mund të disponojnë lirshëm, sepse kërkohet pëlqimi reciprok për administrimin dhe disponimin e lirë të saj. Kushti i dytë që ka ndikim të drejtpërdrejtë në krijimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve është puna e përbashkët ose e ndarë e bashkëshortëve gjatë ekzistimit të martesës. Duhet të theksohet se me punë nuk duhet kuptuar vetëm aktivitetet që sjellin vlera pasurore, por edhe veprimet dhe aktivitetet e tjera që ndikojnë në plotësimin e nevojave familjare siç janë mirëmbajtja e shtëpisë, kujdesi dhe edukimi i fëmijëve, kujdesi dhe ruajtja e pasurisë etj. (neni 54 i LFK).

Në rastet kur nuk arrihet marrëveshja në kohën kur pjesa e secilit prej bashkëshortëve i takon pasurisë së përbashkët, ajo duhet të vendoset nga gjykata. Vendimi duhet të bazohet në kontributin e bashkëshortëve, përmes vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe jo duke marrë parasysh vetëm të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, si kujdesi për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët. Gjykata kompetente vendos po ashtu në rast të mosmarrëveshjes lidhur me pjesët e pasurisë së bashkëshortëve të paraparë sipas nenit 54 të LFK.

#### **4.3.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Lidhur me ndarjen e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve në procedurën para gjykatave të shkallës së parë, ka praktika nga më të ndryshmet. Nga paditë e parashtruara në gjykatat e shkallës së parë, e që sipas ankesës kërkohet që të vendoset nga Gjykata e Apelit, shihet se forma më e shpeshtë e kërimit me kërkesë-padi është pagesa e kontributit të dhënë nga bashkëshorti, për krijimin e pasurisë së përbashkët.

Nga aktgjykimet e shkallës së parë që kanë arritur në Gjykatën e Apelit, e që janë marrë si objekt shqyrtimi për nevojat e këtij punimi, vërehet se gjykatat e shkallës së parë vendosin lidhur me kontributin e bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët, pa e vërtetuar më parë faktin se, cila pasuri e përbashkët është krijuar gjatë bashkësisë martesore, pastaj sa



është vlera e kontributit të secilit bashkëshort veç e veç në krijimin e pasurisë së përbashkët, nuk bëhet dallimi në mes të pasurisë së veçantë dhe pasurisë së përbashkët etj.

Nga praktika e Gjykatës së Apelit, shihet gjithashtu se, mënyra e vendosjes, në dispozitivin e aktgjykimeve të gjykatave të shkallës së parë, lidhur me pjesën miratuese shfaqet e pa caktuar dhe nuk dihet se çfarë është miratuar nga kërkesë-padia dhe çfarë është refuzuar njëkohësisht. Për të hequr të gjitha dilemat që paraqiten në vendosjen para gjykatave të shkallës së parë, praktika gjyqësore në Gjykatën e Apelit e ka dhënë vlerësimin dhe zgjidhjen për rastet e paraqitura. Kjo praktikë vlerëson se, që të bëhet fjalë për pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve dhe madhësinë e saj që do të duhej t'i takonte secilit nga bashkëshortët me rastin e ndarjes së kësaj pasurie, duhet që së pari të ekzistojë pasuria e përbashkët e bashkëshortëve. Pa ekzistimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve nuk mund të bëhet fjalë për ndarjen e pasurisë së përbashkët e aq më tepër për lartësinë e kontributit të secilit bashkëshort në krijimin e kësaj pasurie.

Pas identifikimit të pasurisë së përbashkët dhe madhësisë së kësaj pasurie, mund që të bëhet vërtetimi i kontributit të secilit nga bashkëshortët në administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët, dhe këto janë fakte relevante juridike për zgjidhjen sa më të drejtë të kontesteve të kësaj natyre. Kontributi i bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët, përcakton madhësinë e pjesës së përbashkët, e cila do t'i takonte secilit prej bashkëshortëve, me rastin e ndarjes së kësaj pasurie, nëse bashkëshortët nuk merren vesh lidhur me ndarjen e kësaj pasurie.

Vlen të theksohet se në praktikë, ka padi me të cilat kërkohet që të vlerësohet kontributi i bashkëshortit gjatë jetës së përbashkët të bashkëshortëve në familjet e mëdha. Ndonëse në Ligjin për Familjen nuk ka dispozita të posaçme që e rregullojnë një gjë të tillë, vlerësojmë se kjo do të duhej që të bëhej në analogji me nenin 54 të LFK dhe në përpjesëtim me madhësinë e pasurisë që do të duhej t'i takonte bashkëshortit me rastin e ndarjes së pasurisë në familjet e mëdha.

### 4.3.3 Referenca nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit

#### **Aktvendimi AC.nr. 4256/14, i datës 29.07.2016**

*“Paditësja me padi ka kërkuar që të detyrohet i padituri, që paditëses në emër të kontributit të saj në bashkësinë martesore me të paditurin, për shtimin e pasurisë, punët tjera familjare dhe të bujqësisë, kujdesin për të paditurin dhe fëmijët e tyre, nga viti 1994 gjer në muajin korrik 2009, t’ia paguajë shumën prej gjithsej 50.000 €.*

*Nga shkresat e lëndës shihet se paditësja me paditësin kanë qenë bashkëshort dhe kanë jetuar 15 vite së bashku gjer në muajin korrik të vitit 2009. Gjatë jetës së përbashkët martesore ndërgjyqësve iu lind një vajzë të cilën e kanë pagëzuar me emrin V, e cila pas ndarjes së ndërgjyqësve i është besuar paditëses në ruajtje edukim dhe mbajtje. Raportet mes ndërgjyqësve kishin filluar të acaroheshin gjithnjë e më shumë e sidomos pas përfundimit të luftës dhe në muajin korrik të vitit 2009 definitivisht ndahen në mes veti. Në kohën kur paditësja ishte martuar me të paditurin, i padituri i kishte edhe dy fëmijë të moshës së mitur nga martesa e mëparshme me një grua e cila i kishte vdekur. Paditësja pretendon se është kujdesur për këta dy fëmijë dhe me punën e saj gjithnjë ka kontribuar në*

shtëpinë e të paditurit dhe të familjes së tij, gjatë gjithë jetës së tyre të përbashkët martesore.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se gjykata ka bërë aprovimin e kërkesë-padisë duke vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë. Nga shkresat e lëndës gjithashtu rezulton se i padituri pretendon se nuk posedon pasuri të paluajtshme e cila është evidentuar në emër të tij, si dhe paditësja në atë kohë nuk ka punuar dhe nuk mund të qëndrojë e dhëna se ka kontribuar ashtu siç thotë eksperti 74.750 € bruto apo 59.350 €, pasi që paditësja në atë kohë nuk kishte qenë e punësuar.

Nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit për procedurën kontestimore nga neni 182.2, pika n) lidhur me nenin 183 dhe 184 të LPK-së.

Shkeljet nga neni 182.2 pika n), konsistojnë në atë se në arsyetim të aktgjykimit mungojnë fare arsyet mbi faktet vendimtare. Paqartësitë në këtë çështje, së pari shprehen lidhur me pjesën e kërkesë-padisë që ka të bëjë me pagesën e kontributit për shtimin e pasurisë gjatë jetës së përbashkët martesore. Gjykata e shkallës së parë e ka miratuar kërkesë-padinë dhe ka detyruar të paditurin që në emër të kontributit lidhur me shtimin e pasurisë, punëve të tjera familjare dhe të bujqësisë, kujdesin për të paditurin dhe fëmijët e tyre nga viti 1994 e gjerë në korrikun e vitit 2009 t'ia paguajë shumën prej 50.000 €. Në aktgjykimin me të cilin është miratuar kërkesë-padia nuk janë dhënë fare arsye mbi faktet vendimtare. Gjykata e shkallës së parë në një anë flet për kontributin në shtimin e pasurisë, ndërkaq me asnjë fakt nuk e ka vërtetuar nëse ekziston shtimi i pasurisë së krijuar nga bashkëshortët. Bazuar në nenin 47 të Ligjit për Familjen të Kosovës (LFK), pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë.

Kjo pasuri mund t'i përfshijë gjithashtu të drejtat sendore dhe të detyrimeve. Gjykata e shkallës së parë është dashur që ta vërtetojë të dhënë nëse ka pasur shtim të pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, cila është kjo pasuri dhe sa është kontributi i paditëses në shtimin e kësaj pasurie.

Gjykata e shkallës së parë, nuk ka vërtetuar fare se nga çfarë përbëhet dhe kush e përbënë pasurinë që tani e posedojnë të dy bashkëshortët apo vetëm njëri prej tyre – në këtë rast i padituri, dhe se a paraqet kjo pasuri, pasuri të përbashkët apo pasuri të veçantë të bashkëshortëve.

Gjatë procedurës së zhvilluar gjykata ka dalë në vend me ekspertin e ndërtimtarisë, ka bërë vlerësimin e shtëpisë në të cilën kanë jetuar bashkëshortët, mirëpo gjykata nuk ka vërtetuar se kur është ndërtuar shtëpia, a përkon ndërtimi i kësaj shtëpie me kohën kur kanë jetuar së bashku bashkëshortët dhe cili ka qenë kontributi i paditëses në ndërtimin e kësaj shtëpie. Gjykata në fjalë nuk ka vërtetuar se si ka qenë i shprehur ky kontribut i paditëses (ka kontribuar me punë fizike, me pastrimin e saj gjatë dhe pas ndërtimit, me përgatitjen e ushqimit dhe servimin e tij për ndërtimtarët dhe personelin ndihmës etj). Gjatë këtij ekspertimi gjithashtu nuk është vërtetuar nëse këtë shtëpi e kanë ndërtuar vetëm bashkëshortët, apo kanë jetuar në bashkësi më të gjerë familjare edhe me persona të tjerë. Nëse është kështu atëherë ka qenë dashur që të vërtetohet përsëri se cili është kontributi i paditëses në ndërtimin e shtëpisë. Me rastin e marrjes së kësaj prove, nuk është

*argumentuar fakti tjetër se kush e mban në posedim shtëpinë e ndërtuar, apo nëse është siç pretendon i padituri, se shtëpia është ndërtuar së bashku me vëllain e tij, cila është madhësia e pjesës faktike të cilën e mban në posedim i padituri dhe nëse kjo do të përbënte pjesë të pasurisë të cilën i njëjti e mban në posedim.*

*Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë as arsye se çfarë ka vërtetuar me kryerjen e ekspertizës së gjeodezisë. Gjykata nuk ka vërtetuar se kush i ka në posedim ngastrat që janë marrë për ekspertim dhe se këto ngastra a përbëjnë pjesë faktike të madhësisë së pasurisë trashëgimore të të paditurit, a përbëjnë pjesë të pasurisë trashëgimore në të cilat i padituri do të mund të thirrej në trashëgimi dhe cila do të ishte pjesa tani faktike e cila do të mund t'i takonte të paditurit me rastin e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore, pas vdekjes së trashëgimlënësit të tij.*

*Kolegji vlerëson se në procedurën para gjykatës së shkallës së parë gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë. Gjykata e ka marrë provën me nxjerrjen e ekspertizës financiare në bazë të së cilës e ka caktuar lartësinë e detyrimit të të paditurit ndaj paditëses në vlerën prej 50.000 €, në mënyrën siç është përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë. Është vlerësimi i kolegjit se kjo ekspertizë financiare paraqitet e ndarë në vete nga provat e tjera të nxjerra.*

*Bazuar në nenin 91 të Ligjit për Familjen të Kosovës, pagesa në para bëhet në rast se pjesa e njërit bashkëshort në pasurinë e përbashkët është jo proporcionalisht, më e vogël se pjesa e bashkëshortit tjetër. Gjykata në këtë rast me kërkesën e njërit nga bashkëshortët, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat dhe vlerën e pasurisë së tij, atij bashkëshorti mund t'ia caktojë shpërblimin në të holla sipas vlerës së pjesës së tij. Gjykata e shkallës së parë, së pari është dashur që t'i vërtetojë të dhënat e cekura më lartë në mënyrë që ta vërtetojë ekzistimin e pasurisë së përbashkët, shtimin eventual të saj, pjesën e pasurisë së paluajtshme, gjegjësisht ngastrave që i ka në posedim paditësi dhe vlerën e tyre, pjesën e shtëpisë që e mban në posedim paditësi dhe vlerën e saj dhe pas kësaj nëse ndarja e pasurisë së përbashkët nuk do të mund të bëhej në ndonjë mënyrë tjetër ta caktojë lartësinë e kontributit të paditëses në shtimin e kësaj pasurie të përbashkët. Kolegji vlerëson se ekspertiza financiare do të duhej që ta paraqiste një sintetizim të të gjitha fakteve të vërtetuara të shprehura në mënyrë monetare dhe më pastaj në mënyrën më të drejtë të caktohej kontributi i paditëses me këtë rast.*

*Kolegji vlerëson gjithashtu se si rezultat i të gjitha këtyre që u thanë më lartë është bërë në mënyrë të gabuar edhe aplikimi i së drejtës materiale. Gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj i ka aplikuar nenet 89 dhe 95 të LFK të cilat nene flasin për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët, ndërkohë që nuk është vërtetuar nëse kjo pasuri ekziston, në mënyrën si u paraqitura më lartë.*

*Nga të gjitha arsyet e paraqitura, Kolegji ka ardhur në përfundim se qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur dhe për të cilat kolegji ka vendosur që ta prishë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe çështjen ta kthejë në procedim të sërishëm.*

*Në procedurë të sërishme, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që ta bëjë eliminimin e të metave si më lartë duke u mbështetur në udhëzimet që janë dhënë nga ana e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë, të marrë në shqyrtim edhe prova tjera të nevojshme, për sqarimin e plotë të çështjes, dhe në këtë mënyrë ta bëjë vërtetimin e plotë të gjendjes faktike*

*dhe aplikimin e drejtë të së drejtës materiale dhe në këtë mënyrë ta marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje kontestimore”.*

### **Aktvendimi AC.nr. 3419/2016, i datës 29.12.2016**

*“Palët ndërgjyqëse kanë krijuar bashkësi faktike martesore në vitin 2001. Në këtë martesë u kanë lindur 2 (dy) fëmijë. Kjo martesë është zgjidhur në bazë të aktgjykimit të Gjykatës së Themelore në Prishtinë - Dega në Glllogoc C.nr.168/13 të datës 18.07.2013. Gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike ka kryer ekspertizë financiare. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur që ta aprovojë kërkesë-padinë ndërsa aktgjykimin nuk e ka mbështetur në ndonjë dispozitë ligjore.*

*Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se, përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që duke e ekzaminuar aktgjykimin e atakuar sipas pretendimeve ankimore dhe ex officio për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, gjeti se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika i) e LPK-së, në vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe zbatim i gabueshëm i së drejtës materiale nga neni 184 të LPK-së.*

*Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e me rastin e dërgimit të ftesës për shqyrtimin kryesor të datës 04.08.2016, si dhe ekspertizës së ekspertit A. B., nuk i janë dërguar personalisht, ky fakt vërtetohet nga fletë-dorëzimi për seancën e datës 04.08.2016, vërtetohet se dorëzimi është bërë me datë 26.07.2016, duke i lënë ftesën personit G., ftesa i është lënë në kundërshtim me nenin 121 dhe 110, par.1 dhe 2,të LPK-së, ku përcaktohet se “në qoftë se personi të cilit duhet t’i dorëzohet personalisht shkresa, nuk gjendet atje ku duhet bërë dorëzimi, dorëzuesi do të njoftohet se kur dhe ku do të mund ta gjejë këtë person dhe do t’ia lë ndonjë personi të theksuar me nenin 111 par. 1 dhe 2, të këtij ligji, njoftimin me shkrim që për marrjen e shkresës të jetë në ditën dhe në orën e caktuar në banesën e vet, përkatësisht në vendin e tij të punës”, që paraqet shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika i) e LPK-së.*

*Gjykata e shkallës së parë ndonëse ka vendosur me aktgjykimin e atakuar, lidhur me kontributin e paditëses gjatë martesës, nuk është vërtetuar fakti vendimtar se cila pasuri e përbashkët është krijuar gjatë bashkësisë martesore. Për të ekzistuar kontributi martesor duhet të ekzistojë bashkësia martesore apo bashkësia jashtëmartesore dhe krijimi i pasurisë së përbashkët gjatë kësaj bashkësie, siç është përcaktuar me Ligjin e familjes të Kosovës (LIGJI NR. 2004/32) i cili i rregullon marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, e edhe pjesëtimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, në rastin kur bashkëshortët nuk arrijnë marrëveshje për pjesëtim, vjen në shprehje ndarja dhe pjesëtimi përmes procedurave gjyqësore dhe llogaritja e kontributit të secilit bashkëshort në krijimin e asaj pasurie pjesëtimi i së cilës kërkohet, andaj mos identifikimi i pasurisë së përbashkët të krijuar gjatë martesës paraqet shkelje nga neni 183.1 të LPK-së, ku përcaktohet se “Ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare”.*

*Gjykata e shkallës së parë nuk e ka aplikuar asnjë dispozitë të ligjit material me rastin e arsyetimit dhe vendosjes si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, që paraqet shkelje nga neni 160 par. 5. të LPK-së, ku përcaktohet që “Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve.*

*Kur është nevoja gjykata deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë me herët gjatë procesit gjyqësor, si dhe paraqet po ashtu shkelje nga neni 184 i LPK-së.*

*Andaj nga arsyet e lartcekura, aktgjykimi i atakuar është dashur të priset, dhe çështja të kthehet në rigjykim. Gjatë riprocedurës gjykata e shkallës së parë të marrë parasysh vërejtjet e lartë theksuara, ta kthejë padinë e palës paditëse në plotësim dhe përmirësim, ashtu që e njëjta duhet ta përmbajë kërkesën se cila është pasuria e përbashkët e krijuar gjatë ekzistimit të bashkësisë martesore për të cilën kërkohet pjesëtimi, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit mbi Familjen të Kosovës, pas plotësimit dhe përmirësimit të padisë, ta bëjë administrimin e provave të nevojshme për vërtetimin e gjendjes faktike, varësisht nga vërtetimi i gjendjes faktike, të marrë aktgjykim të drejtë dhe të ligjshëm”.*

#### **Aktvendimi AC.nr.2208/14, i datës 10.03.2017**

*“Pala paditëse ka ushtruar padi ndaj të paditurit për ndarjen e pronës së përbashkët pas zgjidhjes së martesës. Paditësi ka pretenduar që si pasuri të përbashkët të krijuar gjatë martesës ka qenë shuma prej 70,000.00DM, e deponuar në KASABANK, në Prishtinë, me datë 21.12.2001, duke pretenduar se kjo shumë ka qenë deponim i përbashkët nga kursimet e tyre gjatë martesës dhe se gjysma e kësaj shume i takon atij. E paditura në përgjigje në padi si dhe gjatë tërë procedurës e ka kundërshtuar kërkesë-padinë e paditësit, duke theksuar se pasuria për të cilën paditësi sipas padisë kërkon ndarjen, shuma prej 70,000.00DM, është pasurie saj e veçantë.*

*Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës kryesore dhe administrimit të provave vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 47 të Ligjit mbi Familjen të Kosovës, sa i përket shpenzimeve bazuar në nenin 449 dhe 450 të LPK-së.*

*Gjykata e Apelit nuk mund ta pranojë vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshme, për arsye se, aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) dhe 182.1 lidhur me nenin 199 të LPK-së, vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe aplikim i gabuar i të drejtës materiale nga neni 184 të LPK-së, andaj është dashur që aktgjykimi i atakuar të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim.*

*Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, nuk ka dhënë arsye lidhur me atë mënyrë të vendosjes, nuk ka dhënë arsye se në bazë të të cilave prova ka vendosur ta aprovojë kërkesë-padinë, kjo është në kundërshtim me nenin 160 paragrafi 4, të LPK-së, pasi është detyrë e gjykatës që në arsyetim të japë arsye lidhur me kërkesat e palëve, me faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e nëse i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato që nuk janë arsyetuar në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, të cilin e bën kontradiktor me vetveten dhe arsyet e*

aktgjykimit, për arsye se nuk janë arsyetuar faktet vendimtare, gjë që paraqet shkelje thelbësore nga neni 182.2 pika n) të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë në riprocedurë, nuk i ka vërtetuar faktet vendimtare, nëse shuma prej 70,000.00DM, e deponuar nga e paditura në KASABANK, në Prishtinë, me datë 21.12.2001, është pasuri e saj e veçantë, apo është pasuri e përbashkët e krijuar gjatë martesës, ndonëse ka qenë një nga udhëzimet e Gjykatës së Apelit në aktvendimin Ac.nr.995/2009, të datës 13.12.2011, për ta vërtetuar këtë rrethanë, që paraqet shkelje të dispozitave të procedurës nga neni 182.1, lidhur me nenin 199, të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të arsyeve të dhëna në aktgjykimin e atakuar, si dhe pretendimeve të paraqitura nga palët, veçanërisht ajo e paditur, të cilat nuk janë marrë parasysh nga gjykata e shkallës së parë dhe nuk janë vlerësuar, andaj konsiderojmë se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë. Nga arsyetimi i dhënë në aktgjykimin e atakuar, nuk mund të konkludohet se sa është vlera e kontributeve të secilit bashkëshort veç e veç, deri më datën 21.12.2001, kur është deponuar shuma prej 70,000.00DM, e cila është objekt i kontestit, ndonëse paditësi ka pretendime të ndryshme gjatë deklaramit të tij në seancë në cilësinë e palës dhe gjatë deklaramive të tij në parashtrësia të dorëzuara në gjykatë, lidhur me kontributin e tij dhe të palës së paditur. Nga arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë, rrjedh se paditësi ka realizuar shumën 19,000.00 DM, për periudhën kohore 1999-2001, ndërsa ia aprovon kërkesëpadinë në shumën prej 17,500.00 Euro, apo shprehur në marka gjermane shumën prej 35,000.00DM, që e bën vendosjen si në dispozitiv të aktgjykimit kontradiktor, dhe gjendjen faktike të pavërtetuar.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar faktet vendimtare, nëse shuma prej 70,000.00DM, është pasuri e veçantë e të paditurës, apo pasuri e përbashkët, nëse është pasuri e përbashkët sa është kontributi i secilit në krijimin e saj, pasi që në shkresat e lëndës i kemi listat e pagave për paditësin, ndërsa nuk kemi prova se sa kanë qenë të ardhurat e të paditurës, në shkresat e lëndës janë disa kontrata të të paditurës në gjuhën franceze dhe angleze, të papërkthyer në gjuhën shqipe, ashtu që gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë, e që paraqet arsye të mjaftueshme që aktgjykimi i atakuar të priset konform nenit 183 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë, po ashtu ka bërë aplikim të gabuar të dispozitës së nenit 47 par.4, të Ligjit mbi Familjen të Kosovës, pasi që me këtë dispozitë është përcaktuar se “Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse nuk janë marrë vesh ndryshe” por kjo është për kohën sa ekziston martesa dhe nëse nuk kontestohet nga asnjëri prej bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës gjatë ndarjes së pasurisë së përbashkët. Në rastin kur kemi kontest, siç është në rastin konkret gjykata për pasurinë e përbashkët duhet t'i aplikojë dispozitat 54 dhe 55 të Ligjit mbi Familjen të Kosovës, për ta përcaktuar kontributin e secilit bashkëshort, aplikimi i gabuar i së drejtës materiale është edhe rezultat i mosvërtetimit në tërësi të gjendjes faktike.

Gjykata e shkallës së parë në riprocedurë duhet që t'i eliminojë të metat e lartcekura, t'i marrë parasysh pretendimet e palëve, ta vërtetojë gjendjen faktike në mënyrë të plotë, t'i administrojë provat të cilat i konsideron si të nevojshme për ta vërtetuar gjendjen faktike, pas administrimit të provave ta bëjë çmuarjen veç e veç dhe të gjitha së bashku, varësisht nga gjendja faktike e vërtetuar të marrë vendim të drejtë dhe të ligjshëm”.

**Aktvendimi AC.nr. 1761/13, i datës 10.03.2017**

*“Pala paditëse ka ushtruar padi ndaj të paditurit për vërtetuar se paditësja është pronare e 2/3 pjesë ideale të shtëpisë së banimit P+1 me sipërfaqe prej 133 m<sup>2</sup>, që gjendet në Pejë, Rr. “M. Popoviç”, të evidentuar në ngastër kadastrale nr. UL.7161071-05773 (nr. i njësisë 02157-2) ZK-Pejë, me çka i padituri B.B. nga Peja, detyrohet që t’ia pranojë dhe t’ia dorëzojë me anë të ndarjes fizike paditëses në posedim të madhësisë së saktësuar të liruar nga njerëzit në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës kryesore dhe administrimit të provave vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar duke u bazuar në nenin 47 dhe 54 të Ligjit mbi Familjen të Kosovës, sa i përket shpenzimeve bazuar në nenin 452 të LPK-së.*

*Gjykata e Apelit nuk mund ta pranojë vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkëlqje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së, vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 të LPK-së, andaj është dashur që aktgjykimi i atakuar të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim.*

*Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, nuk ka dhënë arsye lidhur me atë mënyrë të vendosjes, nuk ka arsye se në bazë të të cilave prova ka vendosur në pjesën aprovuese dhe në pjesën refuzuese, kjo është në kundërshtim me nenin 160 paragrafi 4 të LPK-së, pasi që është detyrë e gjykatës që në arsyetim t’i japë arsyet lidhur me kërkesat e palëve, me faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato, që nuk janë arsyetuar në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, të cilin e bën kontradiktor me vetveten dhe arsyet e aktgjykimit, për arsye se nuk janë arsyetuar faktet vendimtare. Po ashtu nga dispozitivi nuk mund të konkludojmë se cila pjesë e kërkesë-padisë së paditëses është refuzuar, andaj aktgjykimi është prishur në tërësi, formulimi “refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesë-padisë mbi pjesën e gjykuar siç është e përshkruar në paragrafin një të këtij dispozitivi të aktgjykimit” që është në kundërshtim me nenin 160 par.3, të LPK-së, që paraqet shkëlqje thelbësore nga neni 182.2 pika n) të LPK-së.*

*Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të arsyeve të dhëna në aktgjykimin e atakuar, si dhe pretendimeve të paraqitura nga palët, veçanërisht nga ajo e paditura, të cilat nuk janë marrë parasysh nga gjykata e shkallës së parë dhe nuk janë vlerësuar, andaj konsiderojmë se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë. Nga arsyetimi i dhënë në aktgjykimin e atakuar, nuk mund të konkludojmë sa është vlera e shtëpisë, në mënyrë që të ketë një gjendje të qartë sa është investuar në këtë shtëpi e cila është objekt i kërkesë-padisë, prej secilës nga palët. Nga ekspertiza financiare e ekspertit U. S., të dt.03.01.2013, nuk është vërtetuar se sa është kontributi i secilës nga palët, në bazë të kësaj ekspertize nuk mund të arrihet në përfundim sa ka qenë kontributi i secilës nga palët, pasi që palët kanë dështuar të ofrojnë prova të mjaftueshme për ta vërtetuar kontributin e tyre, nga afarizmi i tyre rrjedh se të dyja palët kanë afuar me humbje, ndërsa paratë nga kreditë edhe nën supozimin se janë investuar në shtëpinë e ndërtaur, të njëjtat kredi është dashur të kthehen. Pala paditëse në deklarinimin e saj ka pasur një deklarinim kontradiktor deklaroi se “kam punua tërë kohën dhe kam palue pare” ndërsa në pyetjen sa ka qenë fitimi mujor, e njëjta ka deklaruar “fitimi ka qenë 200 deri 250 euro dita” ndërsa*

*në pyetjen tjetër se sa para i ka dhënë të paditurit për ndërtimin e shtëpisë është deklaruar “se ekziston pasqyra e bankës sa kam kursye si dhe kreditin që kam marrë” andaj në bazë të kësaj nuk kemi pasqyrë të qartë të gjendjes faktike, sa është pretendimi i shprehur në para se paditësja ka investuar dhe kontribuar në ndërtimin e shtëpisë, sipas padisë që e bën që gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë, e që paraqet arsye të mjaftuar që aktgjykimi i atakuar të priset konform nenit 183 të LPK-së.*

*Gjykata po ashtu ka bërë aplikim të gabuar të dispozitës së nenit 54 të Ligjit mbi Familjen të Kosovës, pasi që këtë dispozitë e ka aplikuar pa e vërtetuar në tërësi gjendjen faktike dhe kontributin e paditësës dhe të të paditurit në ndërtimin e shtëpisë, sipas padisë për të cilën kërkohet vërtetimi i kontributit të paditësës.*

*Gjykata e shkallës së parë në riprocedurë duhet që t'i eliminojë të metat e lartcekura, t'i marrë parasysh pretendimet e palëve, ta vërtetojë gjendjen faktike në mënyrë të plotë ashtu që ta caktojë ekspertin e ndërtimtarisë për ta vlerësuar vlerën e investimeve të përgjithshme në shtëpinë e ndërtuar, dhe në bazë të kësaj të arrijë në konkludim se sa janë kontributet e palës paditëse në ndërtimin e shtëpisë, si dhe të administrojë edhe prova të tjera të cilat i konsideron si të nevojshme për ta vërtetuar gjendjen faktike, pas administrimit të provave ta bëjë çmuarjen e tyre veç e veç dhe të të gjithave së bashku, varësisht nga gjendja faktike e vërtetuar ta marrë vendimin e drejtë dhe të ligjshëm”.*

#### **Aktvendimi AC.nr. 3439/15 i datës 06.04.2017**

*“Paditësja me padi ka kërkuar që të njihet e drejta e pronësisë në bazë të kontributit të përbashkët në bashkëshortësi, në ½ pjesë dhe atë: të shtëpisë me dy hyrje, dykatëshe, me nën kulm dhe garazh, në sipërfaqe, prej 200 metra katrorë, e cila gjendet në Gjilan, rruga “R.Sadiku”, II-VII, nr.22, banesën në Gjilan në rrugën “Bojana” kati përdhesë, banesa në sipërfaqe prej 40m2, banesa në Gjilan lagja “Kamnik” III, rruga “Iliria” nr.17 në sipërfaqe prej 45m2, truallit në Gjilan afër parkut të qytetit në sipërfaqe prej 200m2 si dhe ka kërkuar që kjo e drejtë t'i njihet edhe në gjësende të luajtshme më tutje të përshkruara si pikën e) të petitumit të padisë së parashtruar me dt. 27.09.2000.*

*Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka aprovuar pjesërisht kërkesë-padinë e paditësës si në pikën e I., të dispozitivit të aktgjykimit, duke ia njohur të drejtën e pronësisë shprehur në përqindje prej 33.85% të pjesës së shtëpisë që aktualisht paditësja e shfrytëzon me fëmijët e përbashkët në Gjilan, në pjesën “B” të përcaktuar si hyrje e veçantë nga ana e ekspertit të ndërtimtarisë. Në pikën e II-të, të dispozitivit të aktgjykimit e refuzoi si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesë-padisë për vërtetimin e të drejtës së pronësisë nga ½ e pjesës ideale të paluajtshmërive të përshkruara më për së afërmi në pikën e I-rë dhe të II-të dispozitivit të vendimit, si e pabazuar në ligjin që ka të bëjë me vërtetimin e të drejtës së pronësisë së paditësës nga ½ e pjesëve ideale të shtëpisë dhe oborrit të përcaktuara më detalisht në pikën e parë të dispozitivit të aktgjykimit, pastaj pjesa tjetër e kërkesë-padisë me të cilën paditësja ka kërkuar ½ e pjesës ideale të banesës që gjendet në Gjilan në rr.”Bojana” kati përdhesë, banesa nr.1, në sipërfaqe prej 40m2, pastaj ½ të pjesës së banesës që gjendet në Gjilan në lagjen “Kamnik” III, rr. “Iliria” nr.17, në sipërfaqe prej 45m2 dhe nga ½ e ngastrës kadastrale P-70403013-04431-0, që gjendet në rr.”M.Tito” me shfrytëzim aktual të përgjithshëm prej 197m<sup>2</sup>, e evidentuar tek DGJKP-ja në Gjilan sipas njësies kadastrale P-70403013-04431-0 dhe me numër të lëndës 4807-2013, në emër të të paditurit R. M. nga Gjilani, meqë siç u cek më lartë kontributi i*



*paditëses sipas gjykatës nuk ka qenë në atë masë sa që t'i njihet e drejta e pronësisë nga ½ e pjesëve ideale dhe për shkak të mungesës së provave.*

*Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e vendimit të saj ka theksuar se e ka bërë refuzimin e pjesës tjetër të kërkesë-padisë së paditëses si në pikën III., të dispozitivit të aktgjykimit atakuar me ankesë lidhur me fitimin e pronësisë së sendeve të luajtshme nga ½ e pjesëve ideale dhe atë të mjeteve shtëpiake të përshkuara më për së afërmi në pikën III., të dispozitivit të aktgjykimit, meqenëse gjykata nuk ka pasur prova se vërtet këto mjete kanë ekzistuar në kohën e shkëputjes së bashkësisë martesore, meqë për ta pasur bazë për vendosje në lidhje me këto mjete shtëpiake, është dashur që në fillim të shkëputjes së bashkësisë martesore paditësja ta ketë kërkuar sigurimin e provave nga ana e gjykatës me regjistrimin e tyre me procesverbal të gjykatës me shenja, mostra, marka dhe tipe të tyre, në mënyrë që nëse nuk është i mundur kthimi i tyre të kompensohet vlera e tyre në të holla.*

*Vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë, Kolegji i Gjykatës së Apelit, tani nuk e ka miratuar pasi që aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkëlqe esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) të LPK-së, nuk është bërë vërtetimi i plotë dhe i drejtë i gjendjes faktike dhe është bërë aplikimi i gabuar i së drejtës materiale. Shkeljet nga neni 182.2 pika n), konsistojnë në atë se dispozitivi i aktgjykimit ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, dhe që dispozitivin e bëjnë të pa kuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten edhe arsyet e aktgjykimit. Nga dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar shihet se gjykata e shkallës së parë ka miratuar pjesërisht kërkesë-padinë e paditëses. Kolegji i gjykatës së shkallës së dytë gjen se pjesa e miratuar e kërkesë-padisë e shprehur në dispozitivin e aktgjykimit ankimor, është e pa caktuar, çka do të thotë se nuk e ka të caktuar sipërfaqen e saktë dhe se nga çfarë përbëhet pjesa e miratuar e pronësisë në shtëpinë kontestuese. Kështu nga dispozitivi i aktgjykimit të dhënë, mbetet e paqartë nëse sipërfaqja e miratuar në shtëpinë kontestuese është 170 m<sup>2</sup> apo 213,20 m<sup>2</sup>. Paqartësia e dispozitivit më tutje shprehet në atë se në cilën anë të shtëpisë gjendet dhe në çka konsiston sipërfaqja e miratuar, më saktësisht se sa është përdhese, është njëkatëshe, dykatëshe, apo nën kulm, sa është sipërfaqja për secilën nga këto pjesë dhe në këtë mënyrë do të duhej të nxjerrej sipërfaqja e përgjithshme e pjesës miratuese. Kolegji vlerëson se kjo do të duhej të bëhej me plotësimin e ekspertizës apo marrjen e sqarimeve të nevojshme nga eksperti i ndërtimtarisë, duke pasur parasysh edhe funksionalitetin e pjesës së objektit në të cilën kërkohet vërtetimi i pronësisë.*

*Kolegji gjen se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar me ankesë mbetet i paqartë edhe sa i përket pjesës miratuese të sipërfaqes së oborrit. Kjo sipërfaqe duhet të jetë e caktuar qartë se sa është pjesa e sipërfaqes së miratuar, kjo sipërfaqe e miratuar a është ngastër e plotë apo pjesë e ndonjë ngastre tjetër dhe nëse është pjesë në cilën pjesë të ngastres gjendet. Kolegji vlerëson se kjo çështje do të duhej që të vërtetohej duke u nxjerrë ekspertiza e gjeodezisë, në të cilën do të shikoheshin edhe mundësitë e funksionalitetit të oborrit për nevojat e pjesës së objektit në të cilin është bërë miratimi i së drejtës së pronësisë. Për shkaqet që u thanë më lartë Kolegji gjen se duke i pasur këto mangësi, dispozitivi i aktgjykimit bëhet i pa përmbarueshëm.*

*Për këto arsye kolegji ka vlerësuar se qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse, dhe ka vendosur që çështja të priset dhe të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Kolegji i Apelit vlerëson se në riprocedurë gjykata e shkallës së parë duhet që t'i eliminojë të metat e cekura si më lartë, ashtu që ta caktojë shqyrtimin gjyqësor, t'i nxjerrë*

*provat e nevojshme, t'i ketë parasysh edhe pretendimet ankimore, ta vërtetojë drejtë gjendjen faktike e me aplikimin e drejtë të së drejtës materiale ta nxjerrë një aktgjykim të drejtë të ligjshëm dhe që do të mund të ishte edhe i përmbarueshëm, në këtë çështje kontestimore”.*

## 5. KONTESTET E PUNËS

### 5.1 LLOGARITJA E AFATEVE PËR PARASHTRIMIN E PADISË KUNDËR VENDIMEVE NGA MARRËDHËNIA E PUNËS DHE KËRKESAVE NË PARA

Ligji i punës i Republikës së Kosovës Ligji nr. 03/L-212, me dispozitat e neneve 78, 79 dhe 87, i ka rregulluar procedurat për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës, përkatësisht mbrojtjen e të drejtave për të punësuarit, mbrojtjen e të punësuarit në gjykatë dhe afatin e parashkrimit për kërkesën nga marrëdhënia e punës në para.

*Neni 78*

*78.1*

*Parasheh që i punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqes kërkesë tek punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston bazë për realizimin e të drejtave të shkelura.*

*Neni 78.2*

*Parasheh që punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës –kundërshtimit të të punësuarit në afatin brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës-kundërshtimit.*

*Neni 79*

*Parasheh që çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78.2 të Ligjit të punës të Kosovës, në afatin vijues prej 30 ditësh, mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente.*

*Neni 87*

*Parasheh që të gjitha kërkesa nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.*

#### **5.1.1 Komenti i shkurtër për zbatimin e dispozitave për mbrojtjen e të drejtave për të punësuarit, mbrojtjen e të punësuarit në gjykatë dhe afatin e parashkrimit për kërkesat nga marrëdhënia e punës në para**

Fillimisht duhet cekur se e drejta në punë është kategori kushtetuese dhe e garantuar me konventat ndërkombëtare dhe me ligj. E drejta në punë që e implikon të drejtën në orar të caktuar të punës, pushim ditor, javor, pushim vjetor me pagesë, kompensim real për punën, mbrojtjen në rast të ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe të tjera, paraqet të drejtën themelore të njeriut të garantuar siç u cek edhe më lart.

Përkundër kësaj, jemi dëshmitar që shkeljet ligjore të dispozitave që rregullojnë të drejtën nga marrëdhënia e punës janë të shpeshta në shoqërinë tonë.

Në rastet kur e drejta e të punësuarit shkelet, përkatësisht i pamundësohet apo i rëndohet realizimi i tyre, Ligji ynë i punës, i jep në dispozicion mjetet e caktuara për mbrojtjen e tyre.

Të drejtat e të punësuarve nga marrëdhënia e punës mund të jenë individuale dhe kolektive. Individuale janë ato që i takojnë të punësuarit si individ dhe ato realizohen në mënyrë individuale dhe gjithashtu mbrohen individualisht. Kolektive janë ato që i takojnë grupit të punëtorëve dhe ato realizohen në mënyrë kolektive dhe gjithashtu mbrohen në mënyrë kolektive.

Hapi i parë në drejtim të realizimit të të drejtave të shkelura nga marrëdhënia e punës është parashtrimi i kërkesës, përkatësisht kundërshtimi për mbrojtjen e të drejtave. Nëse ndonjë e drejtë e të punësuarit nga marrëdhënia e punës është shkelur ka për detyrë që punonjësi ta parashtojë kërkesën për mbrojtjen e të drejtave, përkatësisht kundërshtimin duke e shprehur pakënaqësinë me vendimin e marrë nga punëdhënësi, ashtu që në rast të përgjigjes negative të punëdhënësit të mund ta realizojë të drejtën e tij përmes rrugës gjyqësore.

Dështimi i parashtrimit të kërkesës për mbrojtjen e së drejtës, përkatësisht kundërshtimit të vendimit të punëdhënësit ka pasoja të rënda për punonjësin. Kjo për faktin se punëdhënësi duhet që domosdo ta parashtojë kërkesën përkatësisht kundërshtimin sepse kjo paraqet çështje procedurale-juridike dhe është i natyrës prekluzive, çka nënkupton se të drejtën e shkelur, pranë gjykatës kompetente nuk mund ta realizojë punonjësi i cili paraprakisht punëdhënësit nuk ia ka parashtruar kërkesën për mbrojtjen e të drejtave të shkelura.

Për shkelje të të drejtave të punonjësit bëhet fjalë në rastet kur punëdhënësi nuk i përmbush detyrimet e marra sipas kontratës së punës, ligjit dhe akteve të tjera.

Rastet më të shpeshta janë:

- Nuk ia mundëson pushimin ditor, javor dhe vjetor;
- Ia ndërpret kontratën e punës në kundërshtim me ligjin;
- Nuk ia mundëson mungesën me pagesë nga puna;
- Nuk ia mundëson shfrytëzimin e pushimit të lehonisë;
- Nuk ia paguan pagën etj.

Nëse përgjigja lidhur me kërkesën e punonjësit është negative, përkatësisht refuzuese apo nëse fare nuk jepet përgjigje nga punëdhënësi në afat prej 15 ditësh, punonjësi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore në afatin vijues prej 30 ditësh, njësoj sikur punëdhënësi ta kishte refuzuar kërkesën e tij, përkatësisht kundërshtimin e tij.

Me keqardhje mund të konstatojmë se në rastet e shpeshta punëdhënësi gojarisht pa vendim të shkruar ia mohon ndonjë të drejtë punonjësit, mirëpo edhe në këto raste punonjësi duhet të kërkojë, përkatësisht të kundërshtojë, e pas saj nëse vendoset negativisht gjegjësisht refuzohet ose nuk jepet përgjigje atëherë siç u cek edhe më lart në afatin vijues prej 30 ditësh, mund të kërkojë mbrojtjen gjyqësore pranë gjykatës kompetente.

Tek mbrojtja gjyqësore është me rëndësi të theksohet se pa kërkesë për mbrojtje interne të të drejtave nuk mund të kërkohet mbrojtja gjyqësore, përpos në rastet e kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës. Pra, tek kërkesat materiale punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t'i drejtohet

punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë.

Ligji i Punës i Republikës së Kosovës - Ligji nr. 03/7-212 i cili është aktualisht në fuqi ka dispozitë prekluzive lidhur me kërkesat në para e cila thotë: të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës. Nga kjo dispozitë del pa mëdyshje se afati për ngritjen e padisë lidhur me kërkesat në të holla –para është afati 3 vjeçar dhe parashtrimi i padisë në gjykatë pas këtij afati është kërkesë e parashkruar.

### **5.1.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit janë paraqitur raste kur dispozitat e neneve 78, 79 dhe 87, të Ligjit të punës të Republikës së Kosovës nr. 03-7-212, në drejtim të llogaritjes së afatshmërisë së padisë, për kërkesat në të holla nuk janë zbatuar në mënyrë të drejtë.

Në disa raste vërehet se gjykata e shkallës së parë nuk u ka kushtuar vëmendje të duhur afateve që kanë të bëjnë me kërkesa në të holla, duke aplikuar gabimisht dispozitat e neneve 78 dhe 79 në llogaritjen e afateve. Këto dispozita kanë të bëjnë me llogaritjen e afateve lidhur me realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës, përkatësisht mbrojtjen e të drejtave për të punësuarin, e që kanë të bëjnë me kërkesa jo materiale, duke mos llogaritur afatin në kuptim të nenit 87 të Ligjit të punës të Republikës së Kosovës, e që ka të bëjë me kërkesa në të holla, përkatësisht kërkesa materiale, që në rastin konkret është afati 3 vjeçar. Këto lëshime, përkatësisht të gjetura nga Gjykata e Apelit janë shprehur më së shumti në kërkesat për kompensimin e diferencës së pagës prej një grade në një gradë tjetër dhe kërkesat tjera në të holla, duke hedhur padinë si të palejueshme, e duke vërtetuar gabimisht se padia është ushtruar pas kalimit të afatit ligjor nga neni 78 dhe 79 i Ligjit të punës të Republikës së Kosovës, duke llogaritur afatin 15+30=45 ditë duke mos zbatuar dispozitën e cila në këto raste duhet të zbatohet. Kjo dispozitë është neni 87 i Ligjit të punës të Republikës së Kosovës i cili parashih afatin 3 vjeçar për parashkrim të këtyre kërkesave në të holla-para, e që nënkupton se afati i parashtrimit të padisë në gjykatën kompetente është afati 3 vjeçar.

Në favor të këtij konstatimi dhe të të gjeturave të Gjykatës së Apelit janë edhe vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës. Në këto vendime thuhet se parashtrimet në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë me shkëlqje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga dispozitat e nenit 204 të LPK, pasi që nuk janë vlerësuar pretendimet në ankesë lidhur me afatshmërinë e padisë. Kjo gjykatë ka vlerësuar se parashtrimet e tilla nuk përmbajnë bazë të vlefshme juridike për marrjen e vendimit më të favorshëm për të paditurin për faktin se kërkesa kryesore e paditësit është realizimi i së drejtës në diferencën e pagës, në këtë rast paditësi nuk është vonuar me paraqitjen e padisë ngase kontesti kryesisht ka të bëjë me pagesën e diferencës së pagës për shkak të një vendimi arbitrar të kundërligjshëm të të paditurës për zvogëlimin e pagës për të cilën kërkesë në kuptim të nenit 87 të Ligjit të punës, afati i parashkrimit është 3 vite e jo siç pretendohet pa bazë në revizion se afati për paraqitjen e padisë për paditësin duhet të llogaritet në pajtim me nenin 78 dhe 79 të Ligjit të punës.

### 5.1.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit

#### Aktvendimi AC nr. 2940/14, i datës 05.08.2016

##### Arsyetimi

*“Gjykata e Apelit, duke e vlerësuar aktvendimin e atakuar në kuadër të kufijve të arsyeve të theksuara në ankesë, duke pasur kujdes sipas detyrës zyrtare për shkëljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika b), g), j), k) dhe m) dhe zbatimit të drejtë të së drejtës materiale ka gjetur se: aktvendimi i gjykatës të shkallës së parë është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk e ka zbatuar dispozitën e së drejtës materiale që është dashur ta zbatojë, përkatësisht i ka zbatuar gabimisht dispozitat e neneve 78 dhe 79 të Ligjit të punës, për sa i përket llogaritjes së afateve për parashtrimin e padisë pranë gjykatës.*

*Në këtë situatë gjykata e shkallës së parë ka dështuar që të vërtetojë se në rastin konkret kërkohet anulimi i aktvendimit që ka të bëjë me kompensimin e diferencës së pagës, e për të cilën nuk aplikohen dispozitat e neneve 78 dhe 79, sepse këto nene kanë të bëjnë me shkëljen e të drejtave nga marrëdhënia e punës e jo edhe lidhur me kompensimin e diferencës së pagave.*

*Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë është dashur ta ketë parasysh që kërkesa kryesore e paditësit është realizimi i së drejtës në diferencën e pagës dhe në këtë rast paditësi nuk është vonuar me paraqitjen e padisë e për të cilën kërkesë në kuptim të nenit 87 të Ligjit të punës, afati i parashkrimit është 3 vite, e jo siç është llogaritur dhe siç është vendosur me aktvendimin e atakuar duke llogaritur në pajtim me nenin 78,79 të Ligjit të punës”.*

#### Aktvendimi AC nr. 902/2017

##### Arsyetimi

*“Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes Gjykata e Apelit e Kosovës, tani për tani nuk mund ta pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm një qëndrim të tillë juridik të gjykatës të shkallës së parë, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të ligjit të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 1 dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.*

*Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk e ka zbatuar dispozitën e së drejtës materiale që është dashur ta zbatojë dhe kjo ka pasur ndikim në marrjen e vendimit të drejtë e të ligjshëm, përkatësisht i ka zbatuar gabimisht dispozitat e neneve 78 dhe 79 të Ligjit të punës për sa i përket llogaritjes së afateve për parashtrimin e padisë pranë gjykatës.*

*Në këtë situatë gjykata e shkallës së parë ka dështuar që të vërtetojë se në rastin konkret anulimi i aktvendimit që ka të bëjë me kompensimin e diferencës së pagave e për të cilën nuk aplikohen dispozitat e neneve 78 dhe 79 të Ligjit të punës, sepse këto nene kanë të bëjnë me shkëljet e të drejtave nga marrëdhënia e punës, e jo edhe lidhur me kompensimin e diferencës së pagave. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë është dashur ta ketë*

*parasysh që kërkesa kryesore e paditësit është realizimi i së drejtës në diferencën e pagës dhe në këtë rast paditësi nuk është vonuar me paraqitjen e padisë, e për të cilën kërkesë në kuptim të nenit 87 të Ligjit të punës, afati i parashkrimit është 3 vite, e jo siç është vendosur me aktvendimin e atakuar, duke e llogaritur në pajtim me nenin 78 e 79 të Ligjit të punës.*

*Në riprocedurë gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në kuptim të cekurave si më lart e pastaj pas administrimit dhe vlerësimit të provave do të vendos në kuptim të ligjit”.*

## **5.2 PARASHKRIMI NË KONTESTET NGA MARRËDHËNJA E PUNËS**

Me ligjin e ri të punës që është aktualisht në zbatim nuk ka dispozitë që e rregullon çështjen e parashkrimit për inicim të procedurës disiplinore e as të vendosjes lidhur me shqiptimin e masës disiplinore.

Ndërkaq shikuar në të kaluarën kjo lëmi i ka pasur dispozitat konkrete dhe atë duke filluar nga ligji i punës së bashkuar, ligji për marrëdhëniet e punës të KSA të Kosovës, viti 1989, Ligjit themelor për të drejtat nga marrëdhënia e punës dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27 për Ligjin themelor të Punës në Kosovë, të dt. 08.10.2001.

*Neni 106 par.1 të Ligjit të Punës së Bashkuar*

*Ka paraparë që inicimi i procedurës disiplinore parashkruhet me kalimin e 6-të muajve, nga dita kur është bërë e ditur shkelja e detyrës së punës, përkatësisht me kalimin e një viti nga dita ku është bërë shkelja.*

*Neni 109 i Ligjit mbi marrëdhënien e Punës të KSA të Kosovës viti 1989*

*Ka paraparë njësoj sikur Ligji i Punës së Bashkuar, ku inicimi i procedurës disiplinore parashkruhet me kalimin e 6-të muajve nga dita kur është bërë e ditur shkelja e detyrës së punës, përkatësisht me kalimin e një viti nga dita ku është bërë shkelja.*

*Neni 67 i Ligjit Themelor për të Drejtat nga Marrëdhënia e Punës*

*Ka paraparë të njëjtën dispozitë sikurse neni 106 par. 1 të Ligjit të Punës së Bashkuar dhe neni 109 i Ligjit mbi marrëdhëniet e Punës të KSA të Kosovës viti 1989, ku inicimi i procedurës disiplinore parashkruhet me kalimin e 6-të muajve nga kur është bërë e ditur shkelja e detyrës së punës, përkatësisht me kalimin e një viti nga dita ku është bërë shkelja.*

Njësoj është rregulluar edhe me Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27 të dt. 08.10.2001.

Ligji i ri i punës nuk ka dispozitë që e parasheh afatin e parashkrimit për inicim të procedurës disiplinore e as për shqiptim të masës disiplinore, pra me fjalë të tjera nuk ka paraparë afat të parashkrimit.

### 5.2.1 Komenti i shkurtër për dispozitat e lartcekura

Parashkrimi në procedurën disiplinore sipas dispozitave të lartcekura ka qenë e paraparë të arrihet pas kalimit të kohës së caktuar si në dispozitat e lartcekura dhe pas kalimit të kohës së caktuar sipas këtyre dispozitave nuk ka mundur të iniciohet procedura disiplinore e as të udhëhiqet e të shqiptohet masa disiplinore.

Nga të cekurat rezulton se procedura disiplinore para hyrjes në fuqi të ligjit të ri të punës të Republikës së Kosovës Ligji nr. 03/L-212, ka mundur të iniciohet në afatin 6-të mujor nga dita kur është bërë e ditur shkelja e detyrës së punës dhe kryesi e që ky afat na paraqitet si afat subjektiv dhe me kalimin e afatit një vjeçar nga dita e kryerjes së shkeljes së detyrës së punës pa marrë parasysh se kur është kuptuar për kryerjen e shkeljes dhe kryesin e që ky afat na paraqitet si afat objektiv.

Afati objektiv vjen në shprehje dhe zbatohet vetëm në rastet kur nuk dihet për shkeljen e detyrës së punës dhe kryesin, e në rastet e tjera vjen në shprehje afati subjektiv.

Ligji i ri i punës i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/7-212 dhe që është në fuqi, nuk parasheh asnjë dispozitë që ka të bëjë me parashkrimin e inicimit të procedurës disiplinore dhe afatin për përfundimin e procedurës disiplinore dhe shqiptimin e masës.

Konsiderojmë se nuk është e drejtë që dispozitat e mëparshme për parashkrim të inicimit dhe përfundimit të procedurës disiplinore janë hequr me Ligjin e ri të punës. Kjo për faktin se krijon një pasiguri juridike tek punonjësi se punëmarrësi në çdo kohë pa marrë parasysh kur është bërë shkelja e detyrës së punës mund t'ia ndërpres kontratën e punës, çka konsiderojmë se nuk është në rregull. Kjo aq më tepër për faktin se edhe me Kodin penal të Republikës së Kosovës që është në fuqi është paraparë parashkrimi i ndjekjes penale në nenin 106 dhe atë siç vijon: 30 vite nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burg të përjetshëm, 20 vite, nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim me më shumë se 10 vite burg, 10 vite nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim me më shumë se 5 vite, 5 vite nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim me më shumë se 3 vite, 3 vite nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim me më shumë se 1 vit dhe 2 vite nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në 1 vit burg ose dënim me gjobë.

Gjithashtu neni 108 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës parasheh parashkrimin e ekzekutimit të dënimeve me afate sikur në nenin 106 të Kodit Penal, ndërsa neni 110 pika 6 e Kodit Penal parasheh se ekzekutimi i dënimit ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

Edhe Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve nga neni 352 e deri në nenin 362 parasheh institutin e parashkrimit të kërkesave e që afati i përgjithshëm i parashkrimit është 5 vite në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit, e më tutje në nenet vijuese jepen konkretisht afatet për parashkrimin e kërkesave periodike 3 vite, dhe të drejtës nga e cila rrjedh kërkesa periodike 5 vite, kërkesa nga kontratat komerciale 3 vite, qirasë 3 vite, shpërblimit të dëmit 3 vite, shpërblimit të dëmit të shkaktuar me veprë penale, koha kur skadon afati i caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale, afati një vjeçar për furnizim me energji elektrike, termike, furnizim me gaz, ujë, shërbimi i mbledhjes së mbeturinave etj., më pastaj afati 10 vjeçar i parashkrimit të vendimeve të formës së prerë, kontratat për sigurinë për jetë 5 vite, të tjerët 3 vite.



Njësoj Ligji për Kundërvajtje i Republikës së Kosovës në nenin 42 flet për parashkrimin dhe theksohet se procedura e kundërvajtjes nuk mund të ndërmerret nëse kalon një vit nga dita kur është kryer kundërvajtja dhe neni 42 pika 4 flet për ndërprerjen e parashkrimit dhe se parashkrimi bëhet në çdo rast kur kalojnë dy vjet nga dita kur është kryer kundërvajtja. Njësoj parashihet parashkrimi edhe për ekzekutimin e sanksioneve të shqiptuara në procedurën e kundërvajtjes.

Në regjion ekziston një laramani e dispozitave sa i përket procedurës disiplinore përkatësisht inicimit të procedurës disiplinore dhe shqiptimit të masës. Ligji i Punës i Republikës së Serbisë neni 184, flet për afatin e parashkrimit dhe me këtë dispozitë është paraparë afati 6 mujor si afat subjektiv për inicimin e procedurës disiplinore dhe një vit si afat objektiv dhe ky afat vlen për kërkesat jo materiale.

Ligji i Punës i Republikës së Kroacisë dhe ai i Malit të Zi, nuk përmbajnë dispozitë konkrete për parashkrim sa i përket punonjësit, mirëpo kanë dispozitë me të cilën parashkruhet inicimi dhe përfundimi disiplinor për nëpunësit zyrtar përkatësisht shtetëror dhe ky afat është subjektiv për lëndime të lehta 3 muaj dhe objektiv 6 muaj, ndërsa për lëndime të rënda afati subjektiv 1 vit dhe afati objektiv 3 vite, siç është edhe në Mal të Zi.

Kodi i Punës së Shqipërisë, nuk ka ndonjë dispozitë me të cilën është rregulluar parashkrimi i inicimit dhe përfundimit të procedurës disiplinore por theksohet vetëm se masat disiplinore parashikohen në kontratën kolektive dhe asgjë më tepër.

Përfundimisht përkundër zgjidhjeve të ndryshme në regjion prapë se prapë për shkaqe të sigurisë së punonjësve jam i mendimit se duhet të ekzistojë dispozitë e cila do të ndalonte që punëdhënësi, do ta kufizonte afatin kohor përkatësisht deri kur mund ta ndërpresë kontratën e punës për shkak të ndonjë shkeljeje serioze nga ana e punëtorit e jo të mos përcaktohet afati duke lënë punonjësin nën ethe se mos rastësisht punëdhënësi kur i teket atij t'ia ndërpresë kontratën e punës për një shkelje që po supozojmë se e ka bërë para 5 viteve.

### **5.2.2 Të gjeturat e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit janë paraqitur rastet kur dispozitat e lartcekura të Ligjit të Punës së Bashkuar, Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës të KSA të Kosovës, Ligjit Themelor për të Drejtat nga Marrëdhënia e Punës, Ligjit Themelor të Punës në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 2001/27, dhe Ligjit të Punës në Kosovë Ligji nr. 03/L-212, janë zbatuar në mënyrë të gabuar për sa i përket parashkrimit të inicimit të procedurës disiplinore dhe përfundimit të procedurës disiplinore me shqiptim të masës disiplinore. Posaçërisht duke mos pasur kujdes në drejtimin se kur është bërë shkelja e detyrës së punës dhe kur apo në cilin afat është dashur të iniciohet kjo procedurë dhe të përfundojë, rrjedhimisht në këtë drejtim kanë dështuar për ta vërtetuar ekzistimin e parashkrimit.

## 5.2.3 Referencat nga arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Apelit

**Aktvendimi AC.nr. 183/2004, i datës 13.10.2016**

### **Arsyetimi**

*“Nga arsyetimi, Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë, qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë nuk e ka pranuar si të drejtë e të ligjshme, për faktin se aktgjykimi i atakuar është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me ç’rast edhe gjendja faktike ka mbetur e pavërtetuar në mënyrë të plotë. Nga shikimi në shkresat e lëndës pa mëdyshje rrjedh se procedura disiplinore është udhëhequr për një shkelje disiplinore e cila sipas provave në shkresat e lëndës është kryer sipas të paditurës me dt. 31.08.2007, dhe se procedura ka përfunduar me dt. 23.03.2012, me marrjen e vendimit mbi shkëputjen e kontratës së punës me paditësin. Pranë një situatë të tillë i autorizuari i paditësit që nga padia e në vazhdimësi në seancë, por edhe në ankesë ka parashtruar pyetjen se si mund të shqiptohet ndërprerja e marrëdhënies së punës, për një shkelje të supozuar që i vihet në barrë e kryer me dt. 31.08.2007, duke pretenduar se në këtë rast ekziston parashkrimi i ndjekjes dhe zhvillimit të procedurës disiplinore, ndërsa gjykata e shkallës së parë në këtë drejtim, pra në lidhje me parashkrimin, nuk e jep asnjë arsye.*

*Duke u nisur nga fakti se vendimet e të paditurës bazohen në rastin e pranimit teknik të njësorit të konsumatorit të dt. 31.08.2007, me ç’rast është pllombuar njëtori me pllombë, duke treguar se është lënë ura e tretë e tensionit e veshur me material të dyshimtë dhe kështu është pamundësuar regjistrimi i energjisë së shpenzuar elektrike dhe për këtë keqsjellje të paditësit të njëjtit i shkëputet kontrata e punës duke filluar prej dt. 23.03.2012. Prandaj, me të drejtë paditësi e ka theksuar gjatë tërë procedurës parashkrimin, e këtë edhe me të drejtë e potencon në ankesë, kjo për faktin se siç u cek më lart shkëputja e kontratës është bërë në vitin 2012 e për shkeljen e bërë në vitin 2007, e që konstatohet në vitin 2011. Përndryshe procedura disiplinore për shkelje disiplinore sipas nenit 106 par.1 të LPB, e parasheh që iniciimi i procedurës disiplinore parashkruhet me kalimin e 6-të muajve, nga dita kur është bërë e ditur shkelja e detyrës së punës, përkatësisht me kalimin e një viti nga dita kur është bërë shkelja. Të njëjtën dispozitë e ka edhe neni 109 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës të KSA të Kosovës të vitit 1989, si dhe neni 67 i Ligjit themelor për të drejtat nga marrëdhënia e punës. Ligji i ri i punës me hyrje në fuqi e ka shfuqizuar Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/27 të për ligjin themelor të punës në Kosovës të dt. 08.10.2011, Ligjit për marrëdhëniet e punës të KSA të Kosovës, dhe LPB të Jugosllavisë të vitit 1977, me amendamente përkatëse dhe ky ligj i ri i punës nuk ka fuqi retroaktive, prandaj në drejtim të pretendimeve për parashkrim nuk është dhënë asnjë arsye në aktgjykimin e atakuar, pra në këtë drejtim në mungesë të vlerësimit të pretendimeve për parashkrim, aktgjykimi i atakuar është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale me ç’rast edhe gjendja faktike ka mbetur e pavërtetuar në tërësi dhe për arsyet e cekura aktgjykimi i atakuar detyrimisht është dashur të priset.*

*Në riprocedurë gjykata e shkallës së parë do ta vlerësojë kundërshtimin materialo-juridik të të autorizuarit të paditësit se ekziston parashkrimi për iniciim të procedurës disiplinore e pastaj në lidhje me këtë çështje juridiko-kontestimore do ta marrë një vendim të drejtë e të ligjshëm”.*

#### 5.2.4 Afati për padi dhe vlerësimi i afatit si prezumin procedural

Ligji i procedurës kontestimore në kreun XV përmban dispozita lidhur me ngritjen e padisë, përmbajtjen e padisë. I njëjti ligj duke filluar nga neni 389 e deri në nenin 393 e ka rregulluar çështjen e shqyrtimit paraprak të padisë, e në kuadër të së cilës është paraparë edhe shqyrtimi i afatit për padi dhe vlerësimi i afatit si prezumim procedural. Ligji i punës në nenin 78 e ka paraparë mbrojtjen e të drejtave për të punësuarin, ndërsa në nenin 79 mbrojtjen e të punësuarit në gjykatë.

Neni 252

*Gjykimi i një çështjeje në gjykatë fillon me paraqitjen e kërkesë-padisë me shkrim.*

Neni 253

*Me këtë nen padia duhet të përmbajë:*

- a) *Kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore*
- b) *Faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën*
- c) *Provat me të cilat vërtetohen faktet e tilla*
- d) *Vlerën e kontestit*
- e) *Bazën juridike dhe*
- f) *Të dhënat e tjera që duhet t'i ketë çdo parashtrës (neni 99 i këtij ligji)*

Neni 389

*Parasheh që pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata mund t'i nxjerrë të gjitha aktvendimet e përmendura në nenin 392 të këtij ligji, përveç kur kemi të bëjmë me çështjet me të cilat për nga natyra e tyre, apo sipas dispozitave të këtij ligji, aktvendimi mund të jepet vetëm në fazën e mëtejme të procedurës kontestimore.*

Neni 390

*Nëse gjykata konstaton se padia është e pakuptueshme apo jo e plotë, apo se ekzistojnë mungesa që kanë të bëjnë me zotësinë e paditësit apo të paditurit që të bëhen palë ndërgjyqëse, apo me përfaqësim të tyre ligjor, apo mungesat që i përkasin autorizimit të përfaqësuesit që ta iniciojë procedurën kontestimore, kur autorizimi i tillë i ndërmeret masat e nevojshme të përcaktuara në këtë ligj (neni 79 dhe 102 i këtij ligji).*

Neni 391

*Pa shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme në rast se konstaton që:*

- a) *Çështja e ngritur me padi nuk hyn në kompetencën gjyqësore*
- b) *Palët kanë lidhur kontratë për zgjedhjen e kontestit të tyre nga arbitrazhi*
- c) *Për çështjen e ngritur në padi ekziston gjyqëvarësia (litispendenza)*
- d) *Çështja është e gjykuar (res iudicata)*
- e) *Për objektin e kontestit është lidhur ujdia gjyqësore, se paditësi në gjykatë ka hequr dorë nga kërkesë-padia, se nuk ekziston interesi juridik i paditësit për padi vërtetimi*

- f) *Padia është paraqitur pas skadimit të afatit, nëse me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj*
- g) *Paditësi brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk i ka hequr mungesat nga neni 79 dhe 102 i këtij ligji.*

*Neni 392*

*Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim shpallet jokompetente dhe lëndën ia kalon gjykatës për të cilën mendon se është kompetente për gjykimin e çështjes së ngritur me padi, nëse konstaton që:*

- a) *Nuk është e kompetencës territoriale për gjykimin e çështjes*
- b) *Nuk është e kompetencës lëndore për gjykimin e çështjes*

*Neni 393*

*Gjykata, në qoftë se konsideron se nuk ka material procedural të mjaftueshëm për dhënien e aktvendimit mbi ndonjë çështje që është paraqitur gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, do të vendosë në lidhje me të pasi që të arrijë përgjigje në padinë e të paditurit ose gjatë seancës përgatitore apo në seancën për shqyrtim kryesor të çështjes, në rast se nuk është mbajtur seanca përgatitore.*

*Neni 78*

*Ky nen i ligjit të punës parasheh që i punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës mund të paraqesë kërkesë tek punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit në afatin brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës dhe vendimi i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej 8 ditësh.*

*Neni 79*

*Parasheh që çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 par. 2 të këtij ligji, në afatin vijues prej 30 ditësh, mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente.*

### **5.2.5 Komenti i shkurtër për zbatimin e dispozitave të lartcekura**

Punonjësi me qëllim të realizimit të të drejtave të shkelura nga marrëdhënia e punës detyrimisht duhet të kërkojë mbrojtje interne. Kjo nënkupton që në kuptim të nenit 78 i punësuar do të paraqesë kërkesë tek punëdhënësi për realizimin e të drejtave të shkelura, e për të cilën punëdhënësi do të vendosë brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës. Nëse përgjigja e punëdhënësit është negative, përkatësisht refuzohet kërkesa e tij apo nuk jepet vendimi lidhur me kërkesën e punonjësit atëherë në kuptim të nenit 79, punonjësi mund t'i drejtohet gjykatës në afatin vijues prej 30 ditësh. Pra, afati lidhur me shkeljet e të drejtave nga marrëdhënia e punës është 15 + 30 që nënkupton 45 ditë. Punonjësi nuk mund ta kërkojë mbrojtjen e së drejtës nga marrëdhënia e punës pa kërkuar mbrojtje interne. Prandaj, dështimi i parashtrimit të kërkesës tek punëdhënësi ka si pasojë pamundësimin e realizimit të së drejtës pranë gjykatës.

Realizimi i të drejtave nga marrëdhënia e punës në gjykatë bëhet me parashtrimin e padisë. Pra, procedura kontestimore inicohet me kërkesë të personit të autorizuar, në këtë rast të paditësit me padi. Duhet theksuar se procedura kontestimore nuk inicohet sipas detyrës zyrtare, por parashtrimi, përkatësisht veprimi kontestimor është në dispozicion ekskluziv të palës së cilës i është cenuar ndonjë e drejtë apo ndonjë interes. Me parashtrimin e padisë pala orientohet në drejtimin nëse do të kërkojë apo jo mbrojtje gjyqësore sepse tek padia vjen në shprehje parimi i disponimit të palëve. Padia si veprim procedural me shkrim është parashtrësë dhe lidhur me padinë vlejnjë të gjitha dispozitat që vlejnjë edhe për parashtrësat. Mund të thuhet lirisht se padia sipas rregullit është parashtrësë përgatitore e palës me të cilën inicohet procedura kontestimore dhe shërben si bazë për përgatitjen e shqyrtimit. Me parashtrimin e padisë në gjykatë për palën prodhohen raporte të caktuara procedurale juridike dhe materialo-juridike.

Padia siç u cek edhe më lart duhet t'i përmbajë të gjitha ato që janë paraparë në dispozitën e nenit 253 të LPK-së. Padia duhet ta përmbajë emërtimin e gjykatës së cilës i drejtohet pala, pastaj emërtimin e paditësit dhe të të paditurit (emrin dhe mbiemrin, vendbanimin, adresën), përfaqësuesit, përkatësisht përfaqësuesin ligjor apo me prokurë, objektin e kontestit, përmbajtjen e deklaratës dhe firmën përkatësisht nënshkrimin e parashtruesit, pastaj kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore, faktet mbi të cilat vërtetohen faktet e tilla, vlerën e kontestit dhe bazën juridike. Padia mund t'i përmbajë edhe kërkesat aksesore siç janë kamata, shpenzimet procedurale e të tjera. Nëse padia nuk i përmban të cekurat si më lart, atëherë gjykata duhet ta zhvillojë procedurën e përmirësimit të padisë dhe nëse padia nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar do të konsiderohet se është tërhequr ajo padi, e nëse i kthehet pa u përmirësuar, përkatësisht pa u korrigjuar atëherë padia do të hedhet poshtë. Kërkesa e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore paraqet kërkesë-padinë e cila është kërkesa e palës paditëse për nxjerrjen e vendimit nga gjykata dhe kjo në një formë paraqet dispozitivin e vendimit të gjykatës.

Kërkesë-padia përfshinë kërkesën kryesore dhe kërkesat aksesore të theksuara si më lart. Në padi paditësi do t'i theksojë përkatësisht do t'i prezantojë edhe faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën e tij. Nëse nuk parashtrohen faktet dhe nuk korrigjohen atëherë do të vepohet njësoj si më lart e në kuptim të nenit 99 e 102 të LPK-së. Padia do të përmbajë edhe prova konkrete me të cilat mbështetet arsyeshmëria e kërkesë-padisë dhe në mungesë të provave gjykata nuk ka për obligim që ta marrë vendimin lidhur me përmirësimin e padisë, përkatësisht nuk do ta kërkojë korrigjimin në mungesë të provave. Padia duhet ta përmbajë edhe vlerën e kontestit dhe përcaktimi i kësaj vlere është me rëndësi, si dhe gjykata ka autorizim që nëse nuk është përcaktuar vlere e kontestit në kuptim të dispozitave të LPK-së vetë ta caktojë vlerën e kontestit, sepse kjo është e rëndësisë së veçantë lidhur me pagimin e taksave gjyqësore si dhe e rëndësisë së veçantë për ushtrimin e mjetit të jashtëzakonshëm juridik, pra të revizionit. Padia gjithashtu duhet ta përmbajë bazën juridike, pra duhet ta paraqesë dispozitën juridike në të cilën e bazon kërkesë-padinë e saj, mirëpo gjykata nuk është e lidhur për bazën juridike të kërkesë-padisë të përcaktuar në padi.

Gjykata fillimisht është e detyruar që ta bëjë shqyrtimin paraprak të padisë dhe nga ky shqyrtim i padisë varet rrjedha e mëtejme e kontestit dhe zbatimi i dispozitave të caktuara procedurale, nëse gjykata gjen se nuk ka pengesa procedurale për udhëheqjen e mëtejme të procedurës kontestimore do të kalojë në fazën vijuese duke e dërguar padinë në përgjigje e

pas kësaj edhe në fazat e tjera si në caktimin e shqyrtimit përgatitor dhe shqyrtimit kryesor. Pra, këto që u cekën si më lart janë prezumime procedurale.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë shikon a janë plotësuar prezumimet lidhur me: Palët (ekzistimi i palës, zotësia për të qenë palë në procedurë, zotësia procedurale, përfaqësimi i rregullt ligjor, përfaqësimi i personave juridik). Pastaj nëse çështja e ngritur me padi hyn në kompetencën gjyqësore, nëse palët kanë lidhur kontratë për zgjidhjen e kontestit të tyre nga arbitrazha, nëse ekziston gjyqvarësia - litispedencia, nëse bëhet fjalë për çështjen e gjykuar apo res iudicata, për objektin e kontestit nëse është lidhur ndonjë ujdj gjyqësore, nëse ka hequr paditësi dorë nga kërkesë-padia, nëse ekziston interesi juridik i paditësit për padi vërtetimi, padia që është paraqitur në gjykatë nëse është paraqitur pas skadimit të afatit dhe paditësi brenda afatit të caktuar nëse ka vepruar përkatësisht apo ka hequr mungesat nga neni 79 dhe 102 i këtij ligji.

Palë në procedurë mund të jetë çdo person fizik dhe juridik. Cilësinë e palës gjykata mund t'ua njohë edhe atyre formave të bashkimit që nuk kanë zotësinë për të qenë palë nëse vërtetohet se duke marrë parasysh objektin e kontestit në esencë i përbushin kushtet esenciale për fitimin e zotësisë për të qenë palë, e sidomos në qoftë se disponojnë me pasurinë në të cilën mund të kryhet procedura e përmbarimit. Aftësia juridike fitohet me lindje për personat fizik, ndërsa për personat juridik me regjistrim. Sa i përket zotësisë procedurale kjo nënkupton që vet t'i ndërmarrë në mënyrë të vlefshme veprimet procedurale, e kjo nënkupton që pala duhet të jetë plotësisht e aftë për të vepruar dhe këtë e arrin me moshën 18 vjeçare. Duhet dalluar zotësinë e kufizuar për të vepruar dhe në këtë kategori hyjnë personat që nuk i kanë mbushur 18 vjet, por e kanë themeluar marrëdhënien e punës dhe këta kanë zotësi brenda kufijve të mjeteve të realizuara përkatësisht që i fitojnë vet me punë. Palën e cila nuk ka zotësi procedurale e përfaqëson përfaqësuesi ligjor e që caktohet me ligj. Përfaqësuesi ligjor i personit fizik mund të jetë prindi, kujdestari, organi i kujdestarisë ose përfaqësuesi i përkohshëm ligjor. Palën mund ta përfaqësojë edhe përfaqësuesi me prokurë dhe veprimet që i ndërmerr përfaqësuesi me prokurë konsiderohen sikur ta ketë ndërmarrë vet.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme kur gjen se çështja nuk hyn në kompetencën gjyqësore, por të ndonjë organi tjetër, nëse palët kanë lidhur kontratë për zgjidhjen e kontestit të tyre në arbitrazh, kjo nga fakti që palët zgjidhjen e kontestit ia kanë besuar arbitrazhit, ekzistimit të gjyqvarësisë që nënkupton se përderisa kontesti zhvillohet nuk mund që në lidhje me të njëjtën kërkesë të iniciohet kontesti i ri në mes të së njëjtës palë. Çështja është gjë e gjykuar, pra për të njëjtën çështje është vendosur më parë me vendim të plotfuqishëm, është arritur ujdja gjyqësore e cila nënkupton se palët janë dakorduar pranë gjykatës për kontestin dhe kjo ujdj e ka efektin e aktgjykimit të plotfuqishëm. Ajo çka është më me rëndësi dhe që është temë është paraqitja e padisë pas skadimit të afatit. Siç u cek edhe më lart, pra padia në kontestet nga marrëdhënia e punës duhet detyrimisht të parashtrohet brenda afatit 30 ditor, nga dita e refuzimit të kërkesës, përkatësisht nëse nuk është dhënë përgjigja në kërkesë brenda afatit 15 ditor nga dita e parashtrimit të kërkesës. Në rastet e lartë cekura gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë qoftë jashtë seancës, qoftë në seancën përgatitore me aktvendim të posaçëm mund ta hedhë si të pasafatshme, kur padia është parashtruar pas afatit të cekur si më lartë pra pas afatit ligjor, ta hedhë padinë kur ajo kthehet e parregulluar, të shpallet jo kompetent kur vëren se gjykata nuk është kompetente por një organ tjetër dhe ta hedhë si të

palejuar nëse vërteton se duhet të vendoset në arbitrazh, ekziston gjyqvarësia, është gjë e gjykuar apo është lidhur ujdia gjyqësore.

### **5.2.6 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë në praktikën e saj ka vërejtur se dispozitat lidhur me afatin për ngritjen e padisë dhe lidhur me vlerësimin e afatit si prezumim procedural nuk janë zbatuar në mënyrë të drejtë.

Në disa raste vërehet se gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit paraprak të padisë nuk e ka bërë vlerësimin e duhur lidhur me afatin për padi si prezumim procedural dhe si pasojë e mosvlerësimit, vendimet e shkallës së parë janë marrë duke mos e llogaritur drejtë afatin se kur mund të ushtrohet padia për mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës në gjykatë. Nga praktika e Gjykatës së Apelit vërehet se gjykatat e shkallës së parë përkundër që kanë për detyrim t'i vlerësojnë të gjitha prezumimet procedurale nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor përfshirë edhe prezumimin që lidhet me afatin për paraqitjen e padisë në gjykatë, gabimisht e vlerësojnë afatin si dhe në rastet e tjera dështojnë për ta vlerësuar këtë dhe kjo ka për pasojë prishjen e vendimeve e në rastet e arsyeshme kur në kuptim të dispozitave ligjore lejohen ato edhe ndryshohen. Njëherit kjo gjykatë vëren nga praktikat e saj se gjykatat e shkallës së parë dështojnë për ta vlerësuar afatshmerinë me lëndët të cilat janë në punim para hyrjes në fuqi të Ligjit të punës nr. 03/L-2012.

### **5.2.7 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

#### **Aktgjykimi AC nr. 2659/13, i datës 10.05.2016**

##### **Arsyetimi**

*Gjykata e Apelit duke e ekzaminuar aktgjykimin e gjykatës të shkallës së parë gjen se përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika e) të LPK dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale sa i përket afatit për paraqitjen e padisë në gjykatë. Gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit paraprak të padisë është e detyruar t'i vlerësojë të gjitha prezumimet procedurale nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor përfshirë edhe prezumimin që lidhet me afatin për paraqitjen e padisë në gjykatë. Gjykata e apelit ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pavarësisht se gjykata e shkallës së parë nuk i ka eliminuar shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat ishte udhëzuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, që përveç tjerave ta vlerësojë edhe afatshmerinë e padisë, pasi që me dispozitën e nenit 190 par. 3 i LPK, përcaktohet detyrimi që gjykata e shkallës së dytë të vendos vet kur më parë në çështjet konkrete ishte anuluar dy herë vendimi i gjykatës së shkallës së parë.*

*Në përfundimin se duhet të priset aktgjykimi në pjesën e atakuar në ankesë nga e paditura dhe duhet të hedhet padia si e palejuar, gjykata e apelit erdhi duke vepruar në kuptim të dispozitës së nenit 391 pika f) të LPK, me referencë të dispozitave të Ligjit material që e përcakton afatin për ngritjen e padisë.*

*Sipas dispozitës së nenit 83 par. 1 të Ligjit për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës parashihet se punëtori i cili nuk është i kënaqur me vendimin definitiv të organit kompetent në organizatë ose në qoftë se ky organ nuk e merr vendimin brenda 30 ditëve, nga dita e paraqitjes së kërkesës përkatësisht kundërshtimit ka të drejtë që në afatin e ardhshëm prej 15 ditësh, ta kërkojë mbrojtjen e të drejtave të veta para gjykatës kompetente. Në kuptim të afatit që përcaktohet me këtë dispozitë rrjedh se padia e paditësit për anulimin e vendimit dhe kthimin në vendin e punës me të drejtat e tjera nga marrëdhënia e punës është e pasafatshme, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi padinë për kthim në vendin e punës në gjykatën e shkallës së parë e ka paraqitur me dt. 28.03.2007, ndërsa paditësi nga vendi i punës ishte larguar sipas njoftimit të datës 15.10.2003, pra padia është paraqitur pasi që ka kaluar afati ligjor për paraqitjen e padisë. Gjykata e apelit iu referua dispozitës së këtij neni duke marrë për bazë ligjin e aplikueshëm në kohën kur është larguar paditësi nga puna.*

### 5.3 DISKRIMINIMI

*Ligji i punës i Republikës së Kosovës nr. 03/L-212, në nenin 5, e parasheh ndalimin e të gjitha llojeve të diskriminimit, ndërsa në nenin 80 par. 1.2, parasheh autorizimet e gjykatës që nëse vërteton se largimi nga puna është i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, mund ta rikthejë të punësuarin në punë dhe ta urdhërojë kompensimin e të gjitha pagave.*

*Neni 5*

*Në paragrafin 1, parashihet që diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi. Në paragrafin 2, parashihet ndalimi i diskriminimit të drejtë për drejtë ose të tërthortë të personave me aftësi të kufizuara gjatë punësimit, avancimit në punë dhe avancimit profesional, nëse për atë vend pune është i aftë ta kryej punën në mënyrë adekuate. Në paragrafin 3, është paraparë që nuk konsiderohet diskriminim, çdo dallim, përjashtim ose dhënie e përparësisë përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune, në bazë të kritereve të caktuara që kërkohen për atë vend pune. Në paragrafin 4, punëdhënësi është i obliguar që me rastin e punësimit të punëtorëve, për të njëjtin vend pune të përcaktojë kritere dhe mundësi të barabarta si për femra ashtu edhe për meshkuj. Në paragrafin 5, është paraparë që dispozitat e ligjit nr. 2004/3, kundër diskriminimit do të zbatohen drejtpërdrejtë kur është në pyetje marrëdhënia e punës e lidhur në mes të të punësuarit dhe punëdhënësit.*

*Neni 80 par. 1 pika 1.2*

*Parasheh që nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, gjykata mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës dhe ta urdhërojë kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna.*



### 5.3.1 Koment i shkurtër i dispozitave të lartcekura

Ligji i punës siç u cek edhe më lart, me dispozitën e nenit 5 e ndalon diskriminimin e përshkruar më për së afërmi. Diskriminimi në punë mbrohet përveç me ligjin e punës edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, konkretisht me nenin 24 par. 2, ku thuhet që “askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare e shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal”.

Diskriminimi në punë mbrohet edhe me Ligjin kundër diskriminimit Ligji Nr.2004/3 dhe me Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi Nr. 05/-021.

Diskriminimi nënkupton çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë me çfarëdo baze të përcaktuar qoftë në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar, dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë, që ka për qëllim apo efekt ta zhvleftësojë ose ta cenojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet e tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës, pra edhe me ligjin e punës të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-212.

Llojet e diskriminimit janë siç vijon: diskriminimi i drejtpërdrejtë, i tërthortë, ngacmimi, nxitja për të diskriminuar, viktimizimi, segregacioni, në bazë të asociimit, mosdhënia e një përshtatjeje-akomodimi të arsyeshëm për persona me aftësi të kufizuara, në bazë të perceptimit dhe diskriminimi i shumëfishtë.

- Diskriminimi i drejtpërdrejtë nënkupton kur një person trajtohet në mënyrën më pak të favorshme se sa që trajtohet një person tjetër.
- Diskriminimi i tërthortë nënkupton kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme se sa që trajtohet një person tjetër në mënyrë të tërthortë.
- Ngacmimi nënkupton një sjellje të padëshirueshme e që ka për qëllim shkeljen e dinjitetit të personit dhe krijimin e ambientit frikësues, degradues, nënçmues, fyes apo armiqësor mbi bazat e përcaktuara në nenin 1 të Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi.
- Nxitja për të diskriminuar nënkupton promovimin e urrejtjes e cila bëhet me dashje.
- Viktimizimi nënkupton trajtimin e pafavorshëm apo me pasoja negative si reagim ndaj ankimit apo mosankimit apo veprimeve me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë ose në rastet kur personi i tillë ofron informacione, dëshmi apo ndihmë në lidhje me ankesën ose procedurën në rast të diskriminimit.
- Segregacioni nënkupton diskriminimin duke e përfshirë mbrojtjen e çdo personi që nuk merr pjesë në një ankim për diskriminim por që i cili mendohet ta ketë bërë atë, i cili ndodh në rastet kur një ose disa persona veçohen nga të tjerët përmes personave fizik, juridik ose me kombinimin e të dyjave, nga sektori publik, privat

apo nga të dy sektorët, dhe ky veçim bëhet mbi njërën prej bazave të përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji.

- Diskriminimi në bazë të asociimit nënkupton shenjëstrimin e personave që nuk i përkasin një grupi të caktuar por që janë palë të treta që asociohen me ato grupe.
- Mosdhënia e një përshtatjeje–akomodimi të arsyeshëm për persona me aftësi të kufizuara, dhe nënkupton mosdhënien e të cekurave në përputhje me nevojat e tyre specifike, përveç se kur është një barrë e paarsyeshme për personin që është i detyruar ta ofrojë dhe kjo nuk bie në kundërshtim me legjislacionin pozitiv përkatësisht në fuqi, duke marrë në konsideratë për këtë qëllim faktor të tillë si përdorimi i burimeve të disponueshme publike, pjesëmarrja në jetën sociale dhe publike dhe garantimi i qasjes në vendin e punës dhe kushtet e përshtatshme të punës.
- Diskriminimi në bazë të perceptimit, konsiderohet vendosja në objektiv jo e personave që i përkasin një grupi të caktuar, por personave të tretë që perceptohen se i përkasin grupit dhe
- Diskriminimi i shumëfishtë i cili ndodh në rastet kur diskriminimi është i bazuar në çfarëdo kombinimi mbi bazat e mbuluara me ligj.

Me Ligjin e punës është rregulluar ndalimi i diskriminimit në fushën e punës dhe nga marrëdhënia e punës. Është i ndaluar diskriminimi në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin me punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me Ligjin e punës dhe me ligjet e tjera në fuqi. Gjithashtu ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i personave me aftësi të kufizuara gjatë punësimit, avancimit në punë dhe avancimit profesional nëse për atë vend pune është i aftë ta kryejë punën në mënyrë adekuate, njëherit punëdhënësi është i obliguar që me rastin e punësimit të punëtorëve për të njëjtin vend pune të përcaktojë kritere dhe mundësi të barabarta si për femra ashtu edhe për meshkuj. Sipas Ligjit të punës nuk konsiderohet diskriminim, çdo dallim, përjashtim ose dhënie e përparësisë, përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune, në bazë të kriterëve të caktuara që kërkohen për atë vend pune. Gjithashtu nuk konsiderohet diskriminim edhe vënia në pozitë të pabarabartë dhe në rastet e diskriminimit pozitiv.

Përndryshe çështja e diskriminimit dhe mbrojtja përkatësisht ndalimi i diskriminimit është i rregulluar edhe me konventat ndërkombëtare dhe atë me:

- Deklaratën universale të të drejtave të njeriut
- Konventën ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike
- Konventën ndërkombëtare mbi të drejtat ekonomike sociale dhe kulturore
- Konventën ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor
- Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave
- Konventën mbi të drejtën e fëmijës
- Konventën mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara
- Konventën evropiane për të drejtat e njeriut me protokollet e saj
- Konventën për mbrojtjen e të drejtave të pakicave, etj.

Është me rëndësi të theksohet se të gjitha këto konventa të theksuara si më lartë janë të aplikueshme drejtpërsëdrejti në Kosovë, duke u bazuar në nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës, e të cilat i kanë prioritet rastet e konfliktit të dispozitave.

Në praktikë është mjaft e vështirë që të vërtetohet diskriminimi por sido qoftë barra e të provuarit për diskriminim bie mbi pretenduesin përkatësisht punonjësin i cili pretendon se i është bërë diskriminimi në punë nga ana e punëdhënësit, ndërsa punëdhënësi duhet ta provojë se nuk ka bërë diskriminim ndaj punonjësit.

Nëse në vendosje gjyqësore lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës, gjykata vlerëson se kjo ndërprerje është e paligjshme për shkak të diskriminimit mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës dhe njëkohësisht urdhëron që të bëhet kompensimi i të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së paligjshme dhe diskriminuese nga puna, e të cilin vendim punonjësi e ka për obligim që ta zbatojë në afatin e caktuar.

### **5.3.2 Të gjeturat nga praktika e gjykatës së Apelit të Kosovës**

Duhet theksuar se në praktikat e Gjykatës së Apelit ekzistojnë vendimet që janë marrë, duke vërtetuar se punëdhënësi e ka diskriminuar punonjësin në drejtim të realizimit të pagave, dhe të të drejtave të tjera nga marrëdhënia e punës, duke mos ia paguar të ardhurat për punët dhe detyrat e punës të cilat i kryen, si dhe duke ia mohuar të drejtat, duke zhvilluar procedura disiplinore në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret, e me qëllim të diskriminimit në punë. Në favor të theksimeve si më lartë, më poshtë do të jepen referencat nga disa vendime të Gjykatës së Apelit të Kosovës e që kanë pasur për pasojë shkeljen e nenit 5 paragrafi 1 të Ligjit të punës të Kosovës.

### **5.3.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

#### **Aktgjykimi AC.nr. 3533/13, i datës 12.05.2016**

#### **Arsyetimi**

*Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të fakteve të provuara në këtë çështje juridike kontestuese me të drejtë ka arritur në përfundimin se kërkesë-padia e paditëses është e bazuar, pasi që nga provat e administruara në mënyrë të pa kontestueshme është provuar fakti se paditësja i ka kryer punët dhe detyrat e punës si bashkëpunëtoare e filatelisë në kuadër të Departamentit të Filatelisë dhe atë me autorizim të menaxheres së këtij departamenti, për të cilën pozitë është caktuar grada 7, ndërsa e njëjta për këtë punë është kompensuar duke e realizuar pagën sipas gradës 4, të cilën pagë e realizonte sipas kontratës së punës për pozitën nëpunëse e këmbimeve postare. Komisioni i ankesave i të paditurës, lidhur me ankesën e paditëses për sistemim adekuat në vendin e punës, me vendimin e datës 17.03.2009, Nr.01-1077/09, e kishte vendosur aprovimin e ankesës së paditëses duke vendosur që paditësja të sistemohet në pozitën konform punëve që i kryen, të kompensohet në mënyrë retroaktive dhe në të ardhmen sipas gradës për vendin dhe detyrat e punës ku do të sistemohet. Ky vendim i të paditurës nuk është implementuar sa i përket kompensimit pavarësisht se nga provat e administruara rezulton se paditësja deri në pensionim i ka kryer punët dhe detyrat e punës si bashkëpunëtoare e filatelisë.*

*Në këtë kuptim Gjykata e Apelit vlerëson se veprimet e të paditurës për moskompensimin e paditëses edhe pse kishte një vendim të të paditurës kualifikohen në kuptim të dispozitës së nenit 5 paragrafi 1 të Ligjit të Punës me të cilën dispozitë përcaktohet se: "Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin,*

*promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe ligjet tjera në fuqi". Në këtë rast paditësja është diskriminuar lidhur me kompensimin pasi që për nevoja të të paditurës me kërkesën dhe autorizimin e të paditurës i ka kryer punët dhe detyrat e punës për të cilat duhet të jetë kompensuar sipas gradës 7.*

#### **Aktvendimi AC.nr. 287/13, i datës 09.11.2015**

##### **Arsyetimi**

*Gjykata e Apelit e Kosovës ka konstatuar se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të LPK, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as në ato në të cilat thirret ankesa. Njëherit edhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë si dhe pranë gjendjes faktike të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale.*

*Përfundimin e gjykatës së shkallës së parë kjo gjykatë në tërësi e pranon, për faktin se paditësja nuk ka vepruar në tërësi sipas kërkesës së gjykatës së shkallës së parë me aktvendimin për plotësim dhe korrigjim. Prandaj, meqenëse nuk është vepruar në tërësi sipas kërkesës së gjykatës së shkallës së parë edhe përkundër vërejtjes, atëherë gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale përkatësisht nenet 99, 102 dhe 387 të Ligjit të procedurës kontestimore, kur ka hedhur padinë e paditëses si të parregulluar sepse parashtrësja i është kthyer gjykatës pa u korrigjuar plotësisht, gjegjësisht pa u plotësuar si dhe parashtrësja përkatësisht dokumentet që i bashkëngjiten nuk janë dorëzuar në numrin e mjaftueshëm të ekzemplareve e të cilat i ka kërkuar gjykata e shkallës së parë dhe meqë nuk është vepruar sipas urdhërit të gjykatës, gjykata drejtë ka vepruar me hedhjen si të parregulluar të padisë.*

*Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë i ka vlerësuar pretendimet ankimore të të autorizuarës të paditëses dhe gjeti se janë të pabazuara dhe nuk ndikojnë në marrjen e vendimit ndryshe nga ajo të cilën e ka marrë gjykata e shkallës së parë.*

## 6. PENGIM POSEDIMI

### 6.1 PENGIM POSEDIMI

Ligji për pronësi dhe të drejtat tjera sendore me dispozitën e nenit 103 rregullon posedimin, me nenin 104 rregullon fitimin e posedimit, neni 105 rregullon çështjen e detentorit të posedimit, neni 106 rregullon çështjen e trashëgimisë së posedimit, neni 107 rregullon shuarjen e posedimit, neni 108 rregullon bashkë posedimin, neni 109 rregullon posedimin jo të drejtëpërdrejtë, neni 110 rregullon posedimin pronësor, neni 111 rregullon veprimet e kundërligjshme në posedim, neni 112 rregullon vet ndihmën e poseduesit, neni 113 rregullon kërkesat kundër pengimit në posedim dhe neni 114 rregullon shuarjen e kërkesës.

*Ligji i procedurës kontestimore rregullon procedurën në kontestet për shkak të pengimit të posedimit me nenet 478, 479, 480, 481, 482 dhe 483.*

*Neni 103 parasheh se personi i cili ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtëpërdrejtë.*

*Neni 104 parasheh që posedimi në një send fitohet me krijimin e pushtetit faktik mbi sendin. Marrëveshja e poseduesit të mëparshëm dhe e fituesit të posedimit është e mjaftueshme për fitimin e posedimit, nëse fituesi është në gjendje që ta ushtrojë pushtetin mbi sendin në momentin e marrëveshjes.*

*Neni 105 parasheh që në qoftë se një person ushtron pushtet faktik mbi një send për ndonjë person tjetër ose për biznesin e ndonjë personi tjetër apo në ndonjë raport të ngjashëm, në kuadër të të cilave personi duhet t'i përgjigjet udhëzimeve të tjetrit rreth sendit, atëherë ai nuk është posedues.*

*Neni 106 parasheh që me vdekjen e poseduesit, posedimi kalon tek trashëgimtari.*

*Neni 107. 1 parasheh se posedimi shuhet kur poseduesi heq dorë nga pushteti faktik mbi sendin ose në ndonjë mënyrë e humb pushtetin faktik.*

*Neni 107.2 parasheh që posedimi nuk shuhet si rezultat i moslejimit të poseduesit për ushtrimin e kontrollit mbi sendin në një kohë të përkohshme.*

*Neni 108 parasheh që nëse disa persona e kanë bashkë-posedimin në një send, e drejta e një personi për përdorimin e sendit në raport me të tjerët dhe mbrojtja individuale e poseduesit për posedimin e tij është kufizuar me të drejtën e personave të tjerë, për përdorimin e sendit ashtu siç është paraparë përdorimi.*

*Neni 109.1 parasheh që poseduesi jo i drejtëpërdrejtë është personi i cili e jep posedimin e një sendi bazuar në një peng, qira, depozitë, marrëveshje ose raporte juridike të ngjashme që i japin personit tjetër të drejtën e posedimit të sendit për një kohë të caktuar.*

*Neni 109.2 parasheh që nëse poseduesi jo i drejtëpërdrejtë e merr posedimin jo të drejtëpërdrejtë nga personi i tretë bazuar në marrëdhëniet juridike të parapara në paragrafin 1, atëherë personi i tretë është posedues i tërthortë.*

*Neni 110 parasheh që personi i cili e posedon një send që është pronë e tij, është posedues pronësor.*

*Neni 111.1 parasheh që personi i cili e privon nga posedimi poseduesin ose e pengon në posedim kundër vullnetit të poseduesit vepron kundërligjshëm, përveç nëse privimi ose pengimi lejohen shprehimisht me ligj.*

*Neni 111.2 parasheh që posedimi i fituar si rezultat i pengimit të kundërligjshëm është me të metë. Pasardhësi i posedimit të tillë do ta pranojë të metën e posedimit, nëse ai ishte në dijeni për të metën apo ai është trashëgimtar i poseduesit.*

*Neni 112.1 parasheh që poseduesi mund ta përdor forcën e arsyeshme për mbrojtje nga veprimet e paligjshme në pengimin e posedimit të tij, në qoftë se ndërhyrja është e atëçastshme dhe janë ndërmarrë masat adekuate (proporcionale) për mbrojtje, menjëherë me paraqitjen e ndërhyrjes (rrezikut).*

*Neni 112.2 parasheh që nëse një send i luajtshëm i merret poseduesit me pengim të kundërligjshëm, poseduesi mund të përdorë forcë të arsyeshme që ta heq sendin nga penguesi i cili është zënë në vepër ose ndiqet.*

*Neni 112.3 parasheh që të drejtat e cekura në paragrafet e sipërme për vet ndihmën e poseduesit mund të ushtrohen edhe nga detentori, sipas nenit 105 të këtij ligji.*

*Neni 113.1 parasheh nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme poseduesi mund ta kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës i cili në raport me poseduesin është në posedim me të meta.*

*Neni 113.2 parasheh që nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkojë nga poseduesi menjanimin e pengesave. Nëse pritet pengimi në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore.*

*Neni 113.3 parasheh që kërkesa kundër ndërhyrjes në posedim është e përjashtuar në qoftë se poseduesi e ka posedimin me të meta në raport me penguesin ose të drejtën e paraardhësit të penguesit.*

*Neni 114 parasheh që kërkesa mund të parashtrohet vetëm në afatin prej 30 ditësh, pasi që poseduesit i bëhet e ditur në lidhje me privimin apo pengimin e posedimit të tij. Kërkesa shuhet pas kalimit të një viti nga privimi ose pengimi i posedimit.*

*Neni 478 i LPK, parasheh që nëse në këtë kapitull nuk ekzistojnë dispozitat e posaçme, në kontestet për shkak të pengimit të posedimit zbatohen dispozitat tjera të këtij ligji.*

*Neni 479 i LPK, parasheh që me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjykata gjithmonë i kushton kujdes nevojës së zgjidhjes së ngutshme të kontesteve për shkak të pengimit të posedimit, por duke marrë parasysh natyrën e secilit rast konkret.*

*Neni 480 i LPK, parasheh që shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të*

*drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit. Përfundohet mundësia që në kontestet për shkak të pengimit të posedimit të parashtrahet kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është bërë pengimi i posedimit.*

*Neni 481. 1 i LPK, parasheh që afati për përbushjen e detyrimeve që u është caktuar palëve gjykata e cakton varësisht nga rrethanat e çdo rasti konkret. Sipas nenit 481.2, parashihet që afati për paraqitjen e ankesës është 7 ditor. Me nenin 481.3, parashihet që për shkaqet e rëndësishme gjykata mund të vendos që ankesa mos ta pengojë përmbarrimin e aktvendimit, ndërsa me nenin 481.4, parashihet që kundër aktvendimeve të dhëna në kontestet për shkak të pengimit të posedimit revizioni nuk është i lejuar.*

*Neni 482 i LPK, parasheh që paditësi e humb të drejtën që në procedurën përmbarruese ta përbushë detyrimin e aktvendimit me të cilin i padituri urdhërohet që ta përbushë detyrimin e caktuar në rast se nuk e ka iniciuar procedurën përmbarruese brenda afatit prej 30 ditësh, pas skadimit të afatit partitiv.*

*Neni 483 i LPK, parasheh që përsëritja e procedurës së përfunduar me vendim të formës së prerë në kontestet për shkak të pengimit të posedimit lejohet vetëm nga shkaqet e përcaktuara në nenin 232 pika a) dhe b) të këtij ligji dhe vetëm brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita në të cilën aktvendimi përfundimtar është bërë i formës së prerë.*

### **6.1.1 Komenti i shkurtër për zbatimin e dispozitave për pengim posedim**

Fillimisht duhet cekur që posedimi dhe pronësia dallohen. Posedimi është pushtet faktik mbi sendin, ndërsa pronësia pushtet juridik. Pra, posedimi në kuptim juridik të fjalës nënkupton pushtetin faktik mbi një send, pa marrë parasysh që personit që e ka në pushtet faktik i takon e drejta në të apo jo, edhe hajni është posedues.

Dallojmë posedimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Tek posedimi i drejtpërdrejtë poseduesi ka në posedim të drejtpërdrejtë dhe ushtron pushtetin faktik mbi një send drejtë për së drejti, ndërsa tërthortë ushtron pushtetin faktik mbi sendin nëpërmes tjetrit. Pushteti faktik i tij ndaj sendit është i lidhur me parakushtet që të ekzistojë puna juridike ndërmjet poseduesit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë si për shembull kontrata pengu, qira, depozitë, marrëveshje ose raport juridik të ngjashëm. Kushti tjetër është që të ekzistojë vullneti tek poseduesi i tërthortë që sendin ta mbajë për tjetrin dhe përfundimisht kusht i fundit është që poseduesi i drejtpërdrejtë ka të drejtë të kërkojë që të dorëzohet sendi që e mban poseduesi i tërthortë.

Ligji për pronësi dhe të drejtat e tjera sendore parasheh edhe posedimin pronësor e ky posedim është i ndërlidhur me një person i cili e posedon një send e që është pronar i tij, pra ky lloj i posedimit ndërlidhet me pronësinë mbi sendin edhe për këtë arsye është emërtuar edhe si posedim pronësor.

Ligji për pronësi dhe të drejtat e tjera sendore ka paraparë duke u nisur nga mundësia që më tepër persona mund të kenë posedimin mbi një send bashkë posedimin dhe kjo pra siç u cek ekziston në rastet kur disa persona e ushtrojnë përkatësisht kanë pushtetin faktik në një send dhe e drejta e një personi për përdorimin e sendit në raport me të tjerët dhe mbrojtja

individuale e poseduesit për posedimin e tij është e kufizuar me të drejtën e personave të tjerë për përdorimin e sendit ashtu siç është paraparë përdorimi.

Sa i përket trashëgimisë në të gjitha ligjet civile janë paraparë rregullat e veçanta për fitimin e posedimit nga ana e trashëgimtarit. Posedimin që ka pasur trashëgimlënësi kalon te trashëgimtari. Pra, trashëgimtari në momentin e vdekjes të trashëgimlënësit fiton të njëjtin lloj të posedimit të cilin e ka pasur trashëgimlënësi. Qëllimi i një dispozite të tillë është që trashëgimtari i cili më së shpeshti mungon në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit të sigurojë mbrojtjen e posedimit ndaj personave të tretë, të cilët para se të hyjë trashëgimlënësi në posedim e kanë marrë posedimin e tij dhe ndaj tyre të ushtrojë padi për pengim posedim dhe ta kërkojë kthimin e posedimit.

Nga posedimi duhet dalluar edhe detentorin e posedimit, përkatësisht detencionin, që në konceptonin objektiv të posedimit detentor është personi i cili në bazë të punës apo raportit të ngjashëm apo në amvisëri dhe mbi një send ka pushtetin faktik e për personin tjetër dhe në këtë drejtim ka për detyrim që të veprojë sipas këshillave të tjetrit mbi sendin. Sipas ligjit për pronësi dhe të drejtat tjera sendore në qoftë se një person e ushtron pushtetin faktik mbi një send si më lart ai nuk është posedues.

Fitimi i posedimit në një send arrihet me krijimin e pushtetit faktik mbi sendin. Marrëveshja e poseduesit të mëparshëm dhe e fituesit të posedimit është e mjaftueshme për fitimin e posedimit, nëse fituesi është në gjendje që të ushtrojë pushtetin mbi sendin në momentin e marrëveshjes, ndërsa shuarja e posedimit bëhet në rastet kur poseduesi heq dorë nga pushteti faktik mbi sendin ose në ndonjë mënyrë e humb pushtetin faktik. Duhet theksuar se ligji i vjetër pra LMTHPJ, nuk ka paraparë dispozitë përkatësisht nen që bën fjalë lidhur me fitimin e posedimit, por vetëm neni që bënë fjalë për humbjen e posedimit. Marrëveshja paraqet dakordimin që poseduesi i gjertanishëm gjendjen e posedimit të tij e bart në personin tjetër dhe kjo paraqet punë juridike.

Poseduesi e humb me vullnet pushtetin faktik mbi sendin me heqjen dorë nga pushteti faktik mbi atë send dhe poseduesi mund ta humb pushtetin faktik edhe kundër vullnetit të tij kur personi i tretë ia merr posedimin e sendit apo kur poseduesi e humb sendin të cilin deri atëherë e ka pasur në posedim. Posedimi nuk shuhet si rezultat i moslejimit të poseduesit për ushtrimin e kontrollit mbi sendin në një kohë të përkohshme, e që kjo nënkupton që ka ekzistuar pengesa e përkohshme për ta ushtruar pushtetin faktik mbi sendin dhe me këtë rast nuk e humb posedimin në send si për shembull mungesa e përkohshme e poseduesit, sëmundje e të tjera.

Çdo posedues i sendit ka të drejtë në mbrojtjen nga pengimi i posedimit i cili pengim mund të jetë shqetësim apo marrje e posedimit. Ligji për pronësi dhe të drejtat tjera sendore njeh dy mënyra të mbrojtjes së posedimit dhe atë: vet ndihma e poseduesit (vetëmbrojtja) dhe mbrojtja gjyqësore.

Vet ndihma e poseduesit (vetëmbrojtja) nënkupton që çdo posedues ka të drejtën në vetëmbrojtje ndaj atij i cili në mënyrë të paautorizuar shqetëson në posedim apo ia ka marrë nëse plotësohen këto kushte:

- Që veprimi të jetë i paligjshëm në pengimin e posedimit të tij.
- Që ndërhyrja të jetë e atëqas dhe të jenë ndërmarrë masat adekuate (proporcionale) për mbrojtje, menjëherë me paraqitjen e rrezikut. Tek vet ndihma



nëse merret posedimi, poseduesi mund të përdor vetëm forcë të arsyeshme që ta heq sendin nga penguesi i cili është zënë në vepër ose ndiqet. Njësoj mund të veprojë edhe detentori.

Mbrojtja gjyqësore mund të kërkohe në afat prej 30 ditësh, nga dita e të kuptuarit për pengim posedimin e bërë dhe kryesin e më së voni në afat një vjeçar nga dita e shkaktimit të pengim posedimit. Gjykata jep mbrojtje sipas gjendjes së fundit të posedimit dhe pengimit të shkaktuar, me ç'rast nuk është me rëndësi e drejta në posedim, baza juridike e posedimit, mirëbesimi, ndërgjegjshmëria, ndershmëria etj. Qëllimi është kthimi i posedimit prej personit ndërhyrës i cili në raport me poseduesin është në posedim me të meta, pra kthimi në gjendjen e mëparshme ashtu siç ka qenë para shkaktimit të pengim posedimit si dhe të kërkohe nga penguesi menjanimi i pengesave dhe që në të ardhmen të përmbahet nga pengimi i tillë apo i ngjashëm. Bashkë poseduesi gëzon mbrojtje në raport me personin e tretë si dhe në raportet e ndërsjella me bashkë poseduesit e tjerë, nëse njëri nga ata i pamundëson tjetrit në mënyrën e gjeratëhershme kryerjen të pushtetit faktik mbi sendin i cili është në posedimin e tyre.

Personi i cili e privon nga posedimi poseduesin ose e pengon në posedim kundër vullnetit të poseduesit vepron kundërligjshëm dhe këto trajtohen si veprime të kundërligjshme në posedim, përveç nëse privimi ose pengimi lejohet shprehimisht me ligj. Posedimi i fituar si rezultat i pengimit të kundërligjshëm përkatësisht me veprimet e kundërligjshme në posedim ky posedim është me të meta. Është paraparë që edhe pasardhësi i posedimit të tillë duhet të pranojë të metën e posedimit nëse ai është në dijeni për të metën apo ai është trashëgimtar i poseduesit.

Sipas Ligjit të procedurës kontestimore, në procedurën për pengim posedim është parashikuar detyrimi i gjykatës që të veprojë urgjentisht, duke shqyrtuar çështjen sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit dhe duke u kufizuar vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe pengimit të bërë. Gjykatës në këtë procedurë nuk i jepet mundësia që sipas kërkesës së palëve e as sipas detyrës zyrtare t'i vërtetojë faktet dhe të nxjerrë prova për të drejtën në posedim, për bazën juridike, ndërgjegjshmërinë apo mirëbesimin ose pandërgjegjshmërinë e posedimit e as lidhur me kërkesat për kompensimin e dëmit. Në këtë procedurë për kërkesë-padinë në drejtim të çështjes kryesore dhe shpenzimeve procedurale gjykata vendos me aktvendim. Afatin paritiv gjykata e vendos varësisht nga rrethanat e çdo rasti konkret (mund të jetë më gjatë apo më shkurt). Afati për paraqitjen e ankesës është 7 ditor, mirëpo për shkaqet e rëndësishme gjykata mund të vendosë që ankesa mos ta pengojë përmbardimin e aktvendimit. Kundër aktvendimeve të marra në kontestet për pengim posedim nuk është lejuar revizioni, ndërsa përsëritja e procedurës së përfunduar plotfuqishëm është e mundur për shkak të cenimit të dispozitës nga neni 232 pika a) dhe b) të LPK, që ka të bëjë me faktin që palës me veprimet e kundërligjshme, e sidomos në rast të mosthirrjes për në seancë nuk i jepet mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore dhe në qoftë se në procedurën e përfunduar ka marrë pjesë si paditës ose si i paditur personi që nuk mund të jetë palë ndërgjyqësore, apo në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose në rast se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor i saj, ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht përfaqësuesi me prokurë i palës, nuk ka pasur autorizim të duhur për ndjekjen e çështjes në gjykatë, apo për kryerjen e veprimeve procedurale të caktuara, në rast se ndjekja e çështjes në gjykatë, apo kryerja e veprimeve procedurale të caktuara nuk është lejuar më vonë nga

pala, dhe atë ky propozim për përsëritje të procedurës parashtrrohet në afat prej 30 ditësh nga dita në të cilën është bërë aktvendimi i formës së prerë. Në këto konteste pra të pengim posedimit, paditësi e humb të drejtën që ta kërkojë përmbarrimin e dhunshëm të aktvendimit me të cilin të paditurit i urdhërohet kryerja e një pune të caktuar, nëse të njëjtën nuk e ka kërkuar në afatin prej 30 ditësh, nga skadimi i afatit paritiv. Paditësi për shkak të lëshimit të afatit për parashtrim të padisë nuk mund ta kërkojë kthimin në gjendjen e mëparshme, për shkak se nuk bëhet fjalë për afatet procedurale por për afatin prekluziv të karakterit materialo –juridik.

### **6.1.2 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit janë paraqitur rastet kur janë bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe gabimisht janë aplikuar, përkatësisht është aplikuar gabimisht e drejta materiale. Zakonisht janë bërë lëshime si në dispozitiv ashtu edhe në arsyetim të aktvendimeve nga ana e gjykatës të shkallës së parë, duke mos vërtetuar pengim posedimin e bërë, më pastaj ka dështuar që ta urdhërojnë të paditurin që ta kthejë në gjendjen e mëparshme posedimin në mënyrën në të cilën e ka kërkuar paditësi, dhe urdhërin që në të ardhmen mos ta pengojë paditësin në posedimin e lirë dhe të qetë në mënyrën e kërkuar nga paditësi, apo të ngjashme nën kërcënim të përmbarrimit.

Gjithashtu, kjo gjykatë ka vërejtur se gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv e po ashtu edhe në arsyetim ka dështuar ta caktojë kohën e aktit të pengim posedimit, e kjo kohë është me rëndësi për faktin se duhet të vlerësohet që nëse padia është e afatshme apo jo si dhe njëherit ka dështuar për ta treguar mënyrën se si është kryer pengim posedimi. Pra, për të qenë një aktvendim i drejtë dhe i ligjshëm dhe të jetë i përmbarrueshëm duhet detyrimisht të vërtetohet kryerja e aktit të pengim posedimit, t'i jepet urdhëri të paditurit që në afat të caktuar ta ndërpresë pengimin e mëtejme të paditësit, përkatësisht ta kthejë në gjendjen e mëparshme dhe të përmbahet që në të ardhmen mos ta pengojë në mënyrën e përshkruar nga paditësi apo të ngjashme, mënyrën e kryerjes dhe datën përkatësisht kohën e kryerjes së aktit të pengim posedimit, e kjo edhe nga fakti që aktvendimi për pengim posedim të jetë i përmbarrueshëm.

### **6.1.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

**Aktvendimi AC nr. 3602/2014 i datës 18.02.2015**

#### **Nga arsyetimi**

*“Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, aktvendimi i atakuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat kjo gjykatë shikon sipas detyrës zyrtare dhe në të cilat me të drejtë tregon edhe ankesa nga neni 182 par 1 e 2 pika n) dhe si pasojë e kësaj gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale. Në fakt aktvendimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, sepse dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm dhe si i tillë edhe i përmbarrueshëm, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në rastin e marrjes së aktvendimit të atakuar në dispozitiv nuk ka konstatuar se ka vërtetuar se i padituri ka penguar në posedim në drejtim të shfrytëzimit të qetë dhe mënyrën e pengimit si dhe datën e shkaktimit të aktit të pengim posedimit. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë gjatë urdhërimit ka dështuar për ta cekur se në cilin*

*afat i padituri duhet ta kthejë gjendjen e mëparshme dhe çka nëse nuk vepron sipas aktvendimit të shkallës së parë si dhe detyrimi që të përmbahet në të ardhmen nga ky lloj i pengimit të posedimit apo të ngjashme, të gjitha nën kërcënim të përmbarrimit. Pra, nga të cekurat rezulton se ky dispozitiv kështu siç është i gjykatës së shkallës së parë mbetet i paekzekutueshëm, prandaj nga kjo rrjedh edhe konkludimi se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar edhe të drejtën materiale, prandaj aktvendimi i atakuar detyrimisht është dashur të priset.*

*Gjykata e shkallës së parë në riprocedurë do t'i eliminojë të cekurat si më lart, duke pasur parasysh edhe pretendimet ankimore të të autorizuarit të të paditurit, e pastaj do ta marrë një vendim të drejtë e të ligjshëm”.*

### **Aktvendimi AC. nr. 1523/2016, i datës 22.04.2016**

#### **Arsyetimi**

*“Sipas vlerësimit të Gjykatës të Apelit të Kosovës, aktvendimi i atakuar përmban shkelje thelbësore kontestimore nga neni 182 par. 1, pasi që gjatë procedurës në mënyrë jo të drejtë i ka zbatuar dispozitat e këtij ligji, kurse kjo ka pasur ndikim në nxjerrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë si dhe nga neni 182 par. 2 pika n) e lidhur me nenin 199 të LPK. Aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas vërejtjeve të gjykatës të shkallës së dytë përkatësisht sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac nr. 94/2014 të dt. 28.03.2014. Kjo aq më tepër kur edhe dispozitivi i aktvendimit të atakuar është në tërësi i pakuptimtë dhe i papërmbarrueshëm, sepse nuk mund të refuzohet pjesërisht kërkesë-padia e paditësit si e pabazuar, por është rregull që pjesërisht të aprovohet kërkesë-padia dhe nga ana tjetër gjykata ka për detyrë që në dispozitiv ta vërtetojë ekzistimin e pengim-poseidimit, kohën e pengimit, mënyrën e pengimit dhe urdhërin për të paditurin që ta kthejë në gjendjen e mëparshme posedimin në mënyrën në të cilën ka kërkuar paditësi dhe që në të ardhmen mos ta pengojë paditësin në posedimin e lirë dhe të qetë të paluajtshmërisë në këtë mënyrë apo të ngjashme, nën kërcënimin e përmbarrimit.*

*Prandaj, kjo gjykatë e përkujton gjykatën e shkallës së parë se kur priset vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë, është e detyruar që të veprojë, përkatësisht t'i ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale për të cilat është udhëzuar nga gjykata e shkallës së dytë. Gjykata e shkallës së parë megjë nuk ka vepruar sipas detyrimit që ka pasur në kuptim të nenit 199 të LPK, atëherë mbi këtë bazë ka autorizime që ta prishë vendimin e gjykatës së shkallës së parë.*

*Gjykata e shkallës së parë në riprocedurë do të veprojë detyrimisht sipas vërejtjeve të dhëna nga ana e gjykatës të shkallës së dytë me aktvendimin Ac nr. 94/2014 të dt. 28.03.2014, si dhe në pajtim me këtë aktvendim e pastaj do të vendosë për këtë çështje juridike civile në pajtim me ligjin, duke e pasur parasysh posaçërisht përmbajtjen e dispozitivit që ajo t'i përmbajë të gjitha ato që nevojiten sipas udhëzimeve të dhëna”.*

## **Aktvendimi AC nr. 395/2013, i datës 14.06.2013**

### **Arsyetimi**

*“Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, aktvendimi i atakuar nën I të dispozitivit përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat kjo gjykatë shikon sipas detyrës zyrtare nga neni 182 par. 1 e 2 dhe gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale. Në fakt aktvendimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, sepse dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë vetëm e aprovon kërkesë-padinë e paditësit nën I të dispozitivit të aktvendimit të atakuar, dhe e detyron të paditurin që mos ta pengojë paditësin në posedim dhe shfrytëzim të qetë të rrugës kontestuese, ashtu që i padituri duhet ta heq çdo pengesë nga rruga, të durojë dhe të mos veprojë ashtu që paditësin ta pengojë në posedimin dhe shfrytëzimin e rrugës, pa konstatuar në dispozitiv paraprakisht se është bërë akti i pengim-poseidimit, pa e konstatuar kohën, vendin dhe mënyrën e shkaktimit të pengim-poseidimi, çka ankesa me të drejtë tregon në këtë drejtim dhe thirret sepse gjykata nuk mund ta detyrojë të paditurin pa e vërtetuar ekzistimin e aktit të pengim-poseidimit, kohën e kryerjes së pengimit, vendin dhe mënyrën e pengimit të bërë. Kjo gjykatë gjen se tani për tani është e paqartë edhe situata me kundër-padinë e të paditurit të parë për faktin se në aktgjykimin e atakuar nuk është dhënë as një arsyetim lidhur me këtë, prandaj të cekurat si më lart paraqesin shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e të cilat si pasojë e kanë pasur edhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale për çka aktvendimi i atakuar detyrimisht është dashur të prishet.*

*Meqë gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka konsideruar të tërhequr padinë ndaj të paditurit të parë, atëherë kjo gjykatë ka gjetur se nën II i dispozitivit duhet të vërtetohet.*

*Pasi që është prishur aktvendimi nën I të dispozitivit atëherë është dashur detyrimisht të prishet edhe dispozitivi nën III i aktvendimit për sa i përket shpenzimeve të procedurës.*

*Gjykata e shkallës së parë në riprocedurë do t'i eliminojë të cekurat si më lart duke pasur parasysh edhe pretendimet ankimore të të autorizuarit të të paditurit, e pastaj do ta marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm”.*

## 7. SHPRONËSIMI DHE KOMPENSIMI I PRONËS SË SHPRONËSUAR

### 7.1 SHPRONËSIMI DHE KOMPENSIMI I PRONËS SË SHPRONËSUAR

E drejta e pronësisë është e drejtë reale (sendore) e cila në vete përmban autorizime të gjera që i referohen përdorimit, shfrytëzimit dhe disponimit të lirë me sendin e caktuar. Pronari ka autorizime që sendin e caktuar ta përdorë, shfrytëzojë dhe me të të disponojë lirshëm, ku nga kjo rrjedh se e drejta e pronësisë është absolute dhe e pacenueshme. Me nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, shprehimisht përcaktohet që, *„Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t'i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti“*

E drejta e pronësisë private si e drejtë subjektive e karakterit absolut që vepron ndaj të gjithëve, „erga omnes“ përveç që gëzon mbrojtje juridike me legjislacionin vendor, kjo e drejtë është e garantuar edhe me akte ndërkombëtare, pasi që konsiderohet si e drejtë e njeriut dhe në këtë kontekst është e pacenueshme dhe mund të kufizohet vetëm për interes publik dhe me kushtet e përcaktuara me ligj.

Me nenin 1 të protokollit 1 të KEMDNJ shprehimisht parashihet që *“Çdo person fizik dhe juridik ka të drejtën që t'i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara me ligj dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”*

Megjithatë nga parimi i cenimit të së drejtës së pronësisë private si një e drejtë e karakterit absolut që vepron ndaj të gjithëve, ka përjashtim për arsye se edhe më aktet ndërkombëtare por edhe me kushtetutën e shtetit tonë e cila është e harmonizuar me aktet dhe standardet ndërkombëtare, nuk preket e drejta e shtetit tonë që të nxjerrë ligje përmes të cilave pronarit të një paluajtshmërie edhe pa vullnetin e tij të lirë, mund t'i merret apo kufizohet e drejta e pronësisë përmes shpronësimit të pronës së tij, nëse një gjë e tillë i shërben interesit publik, e nën kushtet e parapara me ligj, gjithnjë duke iu gjykuar pronarit kompensim i drejtë. Një e drejtë e tillë, pronarit mund t'i kufizohet edhe për sigurimin e pagesës së taksave, kontributeve tjera ose gjobave.

Në kontekst të kësaj, ligjet vendore të cilat i përcaktojnë kushtet për kufizimin e pronësisë, çdoherë duhet të jenë të harmonizuara me standardet ndërkombëtare, dhe zbatimi i tyre po ashtu duhet të jetë në pajtim me praktikën e krijuar nga GJEMDNJ e cila është kompetente për të vendosur lidhur me të drejtat që burojnë nga KEMDNJ. Kjo do të thotë se nxjerrja e ligjeve për shpronësim është e drejtë e shteteve, por duhet të caktohen kushtet ligjore që nuk i cenojnë standardet ndërkombëtare.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e drejta e pronës është njëra nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Pikërisht neni 46 paragrafi 3, e rregullon dhe e garanton mbrojtjen e pronës nga çdo ndërhyrje arbitrare ku shprehimisht përcakton që, *„Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund ta bëjë ekspropriimin e pronës, nëse ky*

*eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilëve eksproprijohet*". Pra, me këtë dispozitë është garantuar e drejta e pronësisë private nga ndërhyrjet arbitrare të autoriteteve shtetërore – publike.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shpronësimi lejohet në këto kushte:

1. *për interes (qëllim) publik,*
2. *me një kompensim adekuat dhe*
3. *në kushtet dhe procedurat e parapara me Ligj të veçantë.*

Çështja e shpronësimit të pronës së paluajtshme dhe kompensimit të saj, në vendin tonë është e rregulluar me Ligjin nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme të datës 26 mars 2009, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-205 të datës 28 tetor 2010, i cili është ligj special, „lex speciale”. Me këtë ligj rregullohet vetëm shpronësimi dhe kufizimi i pronës së paluajtshme nga autoritetet publike (neni 3 par. 2), dhe i njëjti përmban dispozita materiale dhe procedurale për shpronësim, ndërsa është shfuqizuar Ligji për Eksproprijim i vitit 1978, (GZ e KSAK 21/78), me nenin 46.

Me Ligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme, në mënyrë specifike parashikohen këto faza të cilat duhet t'i zbatojnë autoritetet shtetërore:

1. *caktimi i interesit të përgjithshëm,*
2. *punët përgatitore,*
3. *procedura e shpronësimit dhe*
4. *vendimi i kompensimit.*

### **7.1.1 Përmbledhje e shkurtër nga të gjeturat e përgjithshme nga praktika e Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit të Kosovës sa i përket rasteve të shpronësimit dhe kompensimit të pronës së shpronësuar, është konstatuar se nga ana e gjykatave të instancës së parë përmes vendimeve të nxjerra, nuk aplikohen drejtë dispozitat e ligjit material, e cila në të shumtën e rasteve vjen si shkak i vërtetimit jo të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike. Vendimet po ashtu në të shumtën e rasteve përfshihen edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore.

Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në shumicën e rasteve qëndrojnë për shkakun se gjykatat e shkallës së parë me rastin e nxjerrjes së vendimeve të tyre nuk i janë përmbajtur kërkesave ligjore nga neni 160 par. 4 të LPK-së, pasi që në disa raste në arsyetim të aktvendimeve nuk jepen arsye për faktet vendimtare mbi bazën e të cilave gjykata ka vendosur lidhur me themelësinë e kërkesës. Në disa raste arsytet të cilat jipen del të jenë në kundërshtim me provat shkresore të cilat gjykata i ka administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Ka edhe shumë raste kur gjykata bën një përshkrim të fakteve të cilat i ka vërtetuar duke u referuar në prova konkrete të cilat i ka shfrytëzuar për vërtetimin e atij fakti, mirëpo nuk bën ndonjë analizë të mirëfilltë rreth vlerësimit të atyre provave.

Rastet të cilat janë përfshirë me vërtetim jo të plotë dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, posaçërisht i referohen mosnxjerrjes së provave të duhura dhe adekuate nga ana e gjykatës për vendosje meritore në lidhje me themelësinë e kërkesës, të cilat kryesisht kanë të bëjnë

me nxjerrjen e provave me ekspertim përkatës, qoftë sa i përket vlerësimit të lartësisë për pronën e shpronësuar, por edhe lartësisë së dëmit i cili ka mundur t'i shkaktohet pronarit të pronës gjatë kryerjes së punëve përgatitore rreth shpronësimit.

Në disa raste rezulton se edhe përkundër faktit se gjykata për caktimin e lartësisë rreth kompensimit të pronës së shpronësuar dhe dëmit i cili ka mundur t'i shkaktohet pronarit të pronës gjatë kryerjes së punëve përgatitore rreth shpronësimit, i ka caktuar ekspertët e lëmnive përkatëse, mendimet profesionale të dhëna nga ekspertët del të mos jenë shumë të qarta, të pa arsyetuara mjaftueshëm dhe të punuara jashtë parametrave dhe kritereve të cilat kërkohen sipas Ligjit mbi shpronësimin.

Në rastet kur ekspertizat nuk janë të punuara në mënyrë profesionale, janë të paqarta, jo të plota dhe ka edhe kundërthënie në mes të ekspertizave, vërehet se gjykatat e shkallës së parë në të shumtën e rasteve nuk i ftojnë ekspertët që t'i plotësojnë ekspertizat e tyre apo që të deklarohen dhe sqarohen lidhur me paqartësitë, dilemat apo kundërthëniet që ekzistojnë në mendimet e tyre profesionale.

Ka raste kur gjykatat me rastin e caktimit dhe nxjerrjes së provave me ekspertim nga lëmia përkatëse të cilat kryesisht del se caktohen për vërtetimin e lartësisë së kompensimit të drejtë për pronën e shpronësuar, ekspertit të caktuar, grupit të ekspertëve apo instituteve përkatëse të specializuara, të cilëve ua besojnë nxjerrjen e asaj prove, nuk ua japin detyrat e qarta lidhur me objektin e kontestit, vëllimin dhe lëndën e ekspertimit, e çka është më e rëndësishmja nuk i udhëzojnë që me rastin e dhënies së mendimit të tyre profesional, mendimin e tyre duhet ta japin duke i marrë për bazë parametrat dhe kriteret ligjore të Ligjit mbi shpronësimin e pronës së paluajtshme, të cilat u referohen rregullave themelore për përcaktimin e shumës së kompensimit.

Shkeljet të cilat i referohen zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, në shumicën e rasteve kanë të bëjnë me shkakun se gjer tek kjo shkelje vjen si pasojë e mosvërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike nga ana e gjykatës së shkallës së parë, por ka edhe raste kur gjykatat e shkallës së parë me rastin e vendosjes nuk i zbatojnë dispozitat e së drejtës materiale që është dashur që ta zbatojë, apo kur dispozitën e tillë nuk e zbatojnë në mënyrë të drejtë.

### **7.1.2 Komente lidhur me zbatimin e disa prej dispozitave të Ligjit nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-205**

*Neni 6*

*Kompensimi për dëmin e shkaktuar nga punët përgatitore*

- Çdo person i cili është pronar ose zotërues i një interesi në pronën e paluajtshme e cila është objekt i punëve përgatitore ka të drejtën e kompensimit për:
  - 1.1. humbjen e të drejtës për shfrytëzimin ose gëzimin e pronës ose cilësdo pjesë të saj gjatë kryerjes së punëve përgatitore; dhe*
  - 1.2 të gjitha dëmet tjera ndaj pronës ose personit të cilat janë shkaktuar si rezultat i punëve përgatitore.**
- Organi Shpronësues është përgjegjës për pagesën e menjëhershme të këtij kompensimi. Nëse është përcaktuar shprehimisht në vendimin për autorizimin e kryerjes së punëve*

*përgatitore ose në një kontratë, dhe vetëm deri në masën e përcaktuar në atë vendim ose kontratë, Organi Shpronësues ka të drejtë të kërkojë kompensim (rimbursim) nga autoriteti publik ose pala e tretë e autorizuar për kryerjen e punëve përgatitore.*

3. *Kompensimi i cili kërkohet sipas paragrafit 1. të këtij neni është i veçantë nga kompensimi i shpronësimit nëse prona bëhet objekt i një vendimi për shpronësim.*
4. *Nëse Organi Shpronësues dhe pronari ose zotëruesi i interesit nuk mund të pajtohen për shumën e kompensimit të paraparë në paragrafin 1. të këtij neni, pronari përkatës ose zotëruesi i interesit ka të drejtë të paraqesë padi për kompensim pranë gjykatës kompetente.*

### **7.1.3 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës ligjore lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar nga punët përgatitore**

Në çdo kohë para inicimit të procedurës së shpronësimit, Organi Shpronësues mund ta autorizojë kryerjen e punëve përgatitore për përcaktimin e përshtatshmërisë potenciale të një ose më shumë parcelave të pronës së paluajtshme për qëllimin përkatës publik. Për ta lehtësuar kryerjen profesionale të punëve përgatitore, Organi shpronësues mund t'ia delegojë autoritetin për kryerjen e këtyre punëve një Autoriteti tjetër publik ose një pale të tretë që e posedon ekspertizën e nevojshme.

Gjatë kryerjes së punëve përgatitore mund të ndodh që pronarit ose zotëruesit të një interesi në pronën e paluajtshme e cila është objekt i punëve përgatitore, t'i shkaktohet dëm i cili mund të vijë si shkak i humbjes të së drejtës për shfrytëzimin ose gëzimin e pronës ose cilësdo pjesë të saj ose t'i shkaktohet edhe lloji tjetër i dëmit, i cili ka mundur t'i shkaktohet si rezultat i këtyre punëve përgatitore.

Në të gjitha rastet kur pronarit ose zotëruesit të një interesi në pronën e paluajtshme e cila është objekt i punëve përgatitore, i shkaktohet çfarëdo lloj dëmi i cili ka ardhur si shkak i kryerjeve të punëve përgatitore, Organi shpronësues është përgjegjës për pagesën e menjëhershme të këtij kompensimi. Kompensimi i cili i bëhet pronarit ose zotëruesit të interesit juridik në emër të dëmit i cili ka mundur t'i shkaktohet gjatë kryerjes së punëve përgatitore, është kompensim i veçantë nga kompensimi i shpronësimit nëse prona e paluajtshme bëhet objekt i një vendimi mbi shpronësim.

Nëse organi shpronësues dhe pronari ose zotëruesi i interesit nuk mund të pajtohen për shumën e kompensimit të paraparë në emër të dëmit të shkaktuar gjatë kryerjes së punëve përgatitore, pronari përkatës ose zotëruesi i interesit ka të drejtë të ushtrojë padi për kompensim në gjykatën kompetente.

Në rastet kur para gjykatës kompetente nga pronari ose zotëruesi i interesit juridik, sipas rregullave të procedurës jokontestimore ushtrohet propozim për caktimin e lartësisë së dëmit të shkaktuar gjatë kryerjes së punëve përgatitore, gjykata për rastet e tilla çdoherë duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare ka për detyrim ligjor që propozimin e ushtruar ta trajtojë si padi të rregullt, dhe lëndën pastaj ta procedojë dhe ta vendosë sipas rregullave të procedurës kontestimore, e jo sipas rregullave të procedurës jokontestimore, pasi që ky lloji kompensimi është i veçantë nga kompensimi i shpronësimit në rastet kur prona bëhet objekt i një vendimi mbi shpronësimin, dhe mund të kërkohet vetëm përmes ushtrimit të padisë pranë gjykatës kompetente.



*Neni 15*

*Rregullat themelore për përcaktimin e shumës së kompensimit*

1. *Kompensimi bëhet në bazë të vlerës së tregut të pronës, e cila përcaktohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të miratuara në përputhje me paragrafin 6. të këtij neni.*
2. *Kompensimi përfshin kompensimin e drejtpërdrejtë të dëmit i cili mund të dëshmohet, i cili i shkaktohet personit të shpronësuar si pasojë e shpronësimit plus vlerën e pronës së paluajtshme të shpronësuar, duke përfshirë – nëse është e aplikueshme - pjesët aksesore dhe frutat e saj.*
3. *Pavarësisht nga dispozitat më sipër, shprehimisht përcaktohet se gjatë përcaktimit të shumës së kompensimit e cila duhet të paguhet, nuk do të merren parasysh siç vijon:*
  - 3.1. *kostoja ose vlera e çfarëdo përmirësimi të pronës, objekteve të ndërtuara ose të zgjeruara në pronë, ose e pemëve apo e bimëve të mbjellura në pronë pas datës në të cilën kushtet për shpallje të përcaktuara sipas paragrafit 8. të nenit 8 të këtij ligji janë përmeshur;*
  - 3.2. *çfarëdo ndryshimi në vlerën e pronës së paluajtshme që ka ndodhur pas cilësdo nga këto dy data që ndodhen më parë:*
    - 3.2.1. *data e miratimit të vendimit për autorizimin e kryerjes së punëve përgatitore në pronë; ose*
    - 3.2.2. *data e paraqitjes fillestare të kërkesës për shpronësim me të cilën kërkohet shpronësimi i pronës përkatëse; dhe*
  - 3.3. *çfarëdo ndryshimi në vlerën e tregut të pronës së paluajtshme i cili ndodh para ngjarjeve të përcaktuara në nën-paragrafin 3.2. të këtij paragrafi, nëse ky ndryshim në vlerë mund të dëshmohet se ka ardhur si rezultat i manipulimit të çmimit ose tregut ose spekulimeve që kanë të bëjnë me çmimin ose tregun nga personat ose të afërmit apo bashkëpunëtorët e tyre që kanë pasur informata mbi shpronësimin e pritshëm ose të mundshëm të pronës përkatëse para këtyre ngjarjeve.*
4. *Përveç siç është përcaktuar shprehimisht në paragrafin 5. të këtij neni, asnjë kompensim nuk do të paguhet për humbjen e cilësdo ndërtesë ose objekti tjetër (të çfarëdo lloji), nëse ndërtesa ose objekti:*
  - 4.1. *është ndërtuar në kundërshtim me cilindo ligj ose rregullore të aplikueshme; dhe*
  - 4.2. *nuk kanë qenë në gjendje që të legalizohen sipas ligjit të Kosovës të aplikueshëm në datën e nxjerrjes së Vendimit Përfundimtar për shpronësim. Nëse, në datën e nxjerrjes së Vendimit Përfundimtar për shpronësim, një ndërtesë ose objekt i ndërtuar në mënyrë të jashtëligjshme është në gjendje që të legalizohet, mirëpo nuk është legalizuar, kompensimi për humbjen e kësaj ndërtese ose këtij objekti do të kufizohet vetëm në shpenzimet e dokumentuara për ndërtimin e saj.*
5. *Si përjashtim ndaj paragrafit 4. të këtij neni, shprehimisht përcaktohet se kompensimi do të paguhet për objektet e shpronësuar të cilat janë ndërtuar në mënyrë ilegale në një pronë të paluajtshme private nga pronari i kësaj prone të paluajtshme nëse, dhe vetëm nëse:*
  - 5.1. *në datën e fillimit të aktiviteteve të ndërtimit, ka qenë e pamundshme që pronari ta marrë lejen e nevojshme të ndërtimit nga Autoriteti përkatës Komunal, për shkak se deri në atë datë nuk ishte nxjerrë ende një plan urbanistik ose hapësinor i cili e mbulon pronën e paluajtshme në fjalë; dhe*
  - 5.2. *në të gjitha aspektet tjera as objekti dhe as ndërtimi i tij nuk kanë qenë në kundërshtim me cilindo ligj ose rregullore të zbatueshme në atë kohë. Pronari i*

*këtij objekti është i detyruar ta dëshmojë datën në të cilën kanë filluar aktivitetet e ndërtimit dhe se që të dyja, objekti dhe ndërtimi i tij nuk kanë qenë në kundërshtim me cilindo ligj ose rregullore të zbatueshme në atë kohë.*

6. *Ministria e Ekonomisë dhe Financave do të miratojë akte nënligjore për përcaktimin e metodologjisë për llogaritjen e kompensimit për pronën e shpronësuar dhe dëmet që kanë të bëjnë me shpronësimin. Këto akte nënligjore duhet të jenë në përputhje me:*

*6.1. këtë nen 15,*

*6.2. vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe*

*6.3. parimet ose udhëzimet tjera për llogaritjen e kompensimit të cilat janë nxjerrë ose sugjeruar nga organizatat ndërkombëtare financiare. Aktet nënligjore të lartpërmendura gjithashtu do t'i marrin parasysh standardet e vlerësimit të miratuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në përputhje me paragrafin 1. të nenit 12 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 "për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme në Kosovë"*

#### **7.1.4 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës ligjore lidhur me rregullat themelore për përcaktimin e shumës së kompensimit**

Kushtetuta e Republikës së Kosovës me dispozitën e nenit 46.3 ka përcaktuar se: "Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose Autoriteti Publik i Republikës së Kosovës mund ta bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilëve eksproprijohet".

Në këtë rast me dispozita të përgjithshme kushtetuese është përcaktuar mbrojtja e pronës dhe është pamundësuar privimi në mënyrë arbitrare nga prona. Kjo dispozitë përcakton se një subjekti nuk mund t'i merret prona në mënyrë arbitrare dhe pa bazë juridike, por vetëm në mënyrë të bazuar dhe në procedurë që garanton mbrojtje nga arbitrariteti.

Si baza për marrjen e pronës me dispozitën e sipër cituar janë:

- baza e parë e shpronësimit është përshtatja e saj me ligj;
- baza e dytë është domosdoshmëria apo mënyra adekuate e formës së përmendur të kufizimit të së drejtës së pasurisë;
- baza e tretë është arritja e qëllimeve publike apo përkrahja e interesit të përgjithshëm;
- kufizimi i të drejtës së pronësisë, domethënë shpronësimi, lejohet vetëm me kusht që kjo t'i bëhet me kompensim të drejtë personit apo personave pasuria e të cilëve merret.

Është me rëndësi të theksohet se për shpronësimin duhet të plotësohen disa kushte komulativisht, procedurën ta zhvillojë organi i autorizuar nga ligji, shpronësimi të justifikohet me interesin publik dhe kompensimi i menjëhershëm dhe adekuat i personit të cilit i shpronësohet prona. Kjo dispozitë kushtetuese përveç të tjerave e garanton kompensimin adekuat dhe të menjëhershëm.

Konventa Evropiane, me dispozitën e nenit 1, të protokollit 1, përveç të tjerave garanton të drejtën e dëmshpërblimit të plotë në çdo rrethanë, në qoftë se qëllimet e ligjshme që lidhen

me “interesin publik” të tilla si reforma ekonomike apo synimi për një drejtësi më të madhe shoqërore kërkojnë pagesën në vlerën e plotë të tregut.

Me dispozitën e nenit 15 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme është rregulluar në mënyrë taksative edhe çështja e kompensimit të pronës së shpronësuar. Me rregullat themelore për përcaktimin e shumës së kompensimit të parapara më këtë dispozitë ligjore është përcaktuar se kompensimi duhet të bëhet në bazë të vlerës së tregut të pronës, e cila përcaktohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të miratuara në përputhje me paragrafin 6 të këtij neni. Ky përcaktim ligjor definon në mënyrë të qartë dhe të pakontestueshme se kompensimi i pronës së shpronësuar do të bëhet në bazë të vlerës së tregut.

Kompensimi përfshin kompensimin e drejtpërdrejtë të dëmit i cili mund të dëshmohet, i cili i shkaktohet personit të shpronësuar si pasojë e shpronësimit plus vlerën e pronës së paluajtshme të shpronësuar, duke e përfshirë-nëse është e aplikueshme-pjesën aksesore dhe frutat e saj. Pra, përveç vlerës reale të pronës personit të cilit i shpronësohet prona duhet t'i kompensohet edhe dëmi i cili mund të dëshmohet i shkaktuar si pasojë e shpronësimit.

Ligji e ka kufizuar në mënyrë taksative se nuk do të paguhet kostoja ose vlera e çfarëdo përmirësimi të pronës, objekteve të ndërtuara ose të zgjeruara në pronë, ose e pemëve apo e bimëve të mbjellura pas datës në të cilën kushtet për shpallje të përcaktuara sipas paragrafit 8 të nenit 8 të këtij ligji janë përmbushur. Në këtë rast është kufizuar mundësia e kompensimit për çfarëdo përmirësimi apo rritjeje të vlerës së pronës pas shpalljes në Gazetë Zyrtare dhe një gazete tjetër ditore të vendimit mbi pranimin e kërkesës për shpronësim.

Përveç kësaj është kufizuar edhe mundësia e pagesës për çfarëdo ndryshimi në vlerën e pronës së paluajtshme që ka ndodhur pas cilës do prej këtyre dy datave:

- data e miratimit të vendimit për autorizimin e kryerjes së punëve përgatitore në pronë, ose
- data e paraqitjes fillestare të kërkesës për shpronësim me të cilën kërkohet shpronësimi i pronës përkatëse, ose
- çfarëdo ndryshimi në vlerën e tregut të pronës së paluajtshme i cili ndodh para ngjarjeve të përcaktuara në nën-paragrafin 3.2. të këtij paragrafi, nëse ky ndryshim në vlerë mund të dëshmohet se ka ardhur si rezultat i manipulimit të çmimit ose tregut ose spekulimeve që kanë të bëjnë me çmimin ose tregun nga Personat ose të afërmit apo bashkëpunëtorët e tyre që kanë pasur informata mbi shpronësimin e pritshëm ose të mundshëm të pronës përkatëse para këtyre ngjarjeve.

Në lidhje me kompensimin e objekteve në pronën e shpronësuar është përcaktuar kufizimi i kompensimit edhe në rast të humbjes së cilësdo ndërtesë ose objekti tjetër, nëse është ndërtuar në kundërshtim me ligjin ose rregulloret e aplikueshme, nuk ka qenë në gjendje të legalizohet në datën e nxjerrjes së vendimit përfundimtar. Në rast se në ditën e nxjerrjes së vendimit përfundimtar ka qenë e mundshme të legalizohet një objekt i ndërtuar jashtëligjshëm, atëherë kompensimi do të kufizohet vetëm në shpenzimet e dokumentuara për ndërtimin e objektit të humbur, (përfashtohet vlera qarkulluese e tregut, duke u kufizuar në vlerën ndërtuese).

Ligji për Shpronësimin e ka përcaktuar si përjashtim kompensimin e objekteve të ndërtuara në mënyrë ilegale nëse plotësohen këto kushte:

- Në datën e fillimit të aktivitetit të ndërtimit, ka qenë e pamundshme marrja e lejes së ndërtimit në mungesë të një plani urbanistik apo hapësinor që mbulon pronën e shpronësuar, dhe
- Në të gjitha aspektet tjera as objekti dhe as ndërtimi nuk kanë qenë në kundërshtim me cilindo ligj apo rregullore. Pronari i objektit është i detyruar që ta dëshmojë datën kur e ka filluar aktivitetin e ndërtimit të objektit.

Në të gjitha rastet, kur në afatin ligjor para gjykatës kompetente nga pronari ose zotëruesi i interesit juridik i pronës së paluajtshme, e cila me vendim përfundimtar të organit shpronësues është shpronësuar qoftë në tërësi ose në një pjesë të saj, është ushtruar ankesë kundër vendimit përfundimtar, më të cilën kundërshtohet shuma e kompensimit të njohur sipas vendimit përfundimtar të organit shpronësues, gjykata ka për detyrim ligjor që në afatin e paraparë me ligj duke vepruar sipas rregullave të procedurës jokontestimore, ta caktojë seancën e shqyrtimit kryesor, në të cilën sipas propozimit të palëve por edhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare të nxjerrë dhe të administrojë prova në drejtim të vërtetimit dhe caktimit të drejtë të shumës së kompensimit. Ky kompensim përfshin kompensimin e drejtpërdrejtë të dëmit i cili ka mundur të shkaktohet si pasojë e shpronësimit, plus vlerën e pronës së paluajtshme të shpronësuar, duke i përfshirë nëse është e aplikueshme pjesët aksesore dhe frutat e saj.

Caktimi i drejtë i kompensimit të drejtë për vlerën e pronës së shpronësuar por edhe dëmin e drejtpërdrejtë i cili ka mundur të shkaktohet si pasojë e shpronësimit, çdoherë para gjykatës mund të provohet dhe vërtetohet përmes nxjerrjes së provave me ekspertim nga lëmitë përkatëse. Gjykatat me rastin e caktimit të ekspertëve përkatës detyrimisht duhet t'i njoftojnë për objektin e kontestit, vëllimin dhe lëndën e ekspertimit, duke i udhëzuar po ashtu qartë që kompensimi nga ana e tyre të llogaritet dhe të përcaktohet në përputhje me parametrat dhe kriteret që parashihen me këtë ligj si dhe Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Financave nr. 02/2015, për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

### **7.1.5 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit të Kosovës janë paraqitur raste kur gjykatat e shkallës së parë, me rastin e caktimit të ekspertëve nga lëmitë përkatëse, për llogaritjen e kompensimit të drejtpërdrejtë të dëmit, i cili pronarit të tokës i është shkaktuar si pasojë e shpronësimit si dhe vlerën e tregut të pronës e cila është shpronësuar, duke përfshirë edhe pjesët aksesore dhe frutat e saj, nuk i kanë njoftuar se llogaritja nga ana e tyre duhet të bëhet në përputhje me parametrat dhe kriteret që parashihen më këtë dispozitën e nenit 15 e lidhur me nenin 6 të këtij ligji, si dhe Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Financave nr. 02/2015, për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

Si shkak i mosnjoftimit nga ana e gjykatave të shkallës së parë, ekspertët e caktuar me rastin e llogaritjes së kompensimit të drejtë, mendimet e tyre nuk i kanë marrë duke u bazuar në parametrat dhe kriteret e këtij ligji si dhe Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Financave nr. 02/2015, por ato i kanë bazuar duke marrë për bazë disa kritere krahasuese të vlerës së çmimit në treg në atë zonë, e sipas kontratave të lidhura në mes të personave të

ndryshëm. Si shkak i kësaj ka rezultuar se mendimet e tyre profesionale nuk janë përputhur me kriteret dhe parametrat ligjor, me çka në këto raste ka ardhur deri tek zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, e si shkak i vërtetimit jo të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së parë në çdo rast pa përjashtim me rastin e caktimit të ekspertit apo grupit të ekspertëve nga lëmia përkatëse, ka për detyrim ligjor që t'i njoftojë për objektin e kontestit, vëllimin dhe lëndën e ekspertimit, duke i udhëzuar po ashtu qartë që kompensimi nga ana e tyre të llogaritet dhe të përcaktohet në përputhje me parametrat dhe kriteret që parashihen më këtë ligj si dhe Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Financave nr. 02/2015, për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin, duke i njoftuar gjithashtu se nuk kanë pengesa që me rastin e dhënies së mendimit të tyre profesional të marrin për bazë edhe kritere tjera krahasuese, si p.sh kontrata të shitblerjes të legalizuara tek noteri, vendime, ujd, marrëveshje etj.

Gjykatat po ashtu në çdo rast kur konstatojnë se ekspertizat e punuara nga ekspertët e lëmive përkatëse, nuk janë të plota, të qarta apo ka ndryshim mendimesh midis ekspertëve tëcaktuar, nuk do duhej të kishin pengesa ligjore që në kuptim të dispozitës së nenit 366 të LPK-së, të kërkojnë nga ekspertët sqarime plotësuese lidhur me mendimin e tyre të dhënë, të gjitha këto në drejtim të eliminimit të paqartësive dhe evitimit të nxjerrjes edhe të ndonjë ekspertimi tjetër të llojit të njëjtë.

Në disa raste gjykatat e shkallës së parë me rastin e nxjerrjes së vendimeve të tyre nuk i janë përmbajtur kërkesave ligjore nga neni 160 parg. 4 i LPK-së, pasi që dispozitivi i aktvendimit është në kundërshtim me arsyet e dhëna sipas të njëjtit aktvendim, respektivisht në arsyetim të aktvendimit nuk jepen fare arsyet për faktet vendimtare mbi bazën e të cilave gjykata e ka caktuar formën dhe vëllimin, përkatësisht lartësinë e kompensimit për paluajtshmërinë e shpronësuar, dhe ato arsye të cilat janë dhënë nga gjykata rezultojnë të jenë në kundërshtim apo në mospërputhje me provat shkresore të cilat gjykata i ka administruar gjatë shqyrtimit të mbajtur gjyqësor. Gjykatat e shkallës së parë po ashtu në arsyetimet e vendimeve nuk i arsyetojnë pretendimet e palëve të bëra gjatë shqyrtimit kryesor, qofshin ato të natyrës procedurale apo materiale.

Përveç kësaj edhe në ato raste kur gjykatat i nxjerrin provat e duhura dhe adekuate, e të cilat kryesisht kanë të bëjnë me nxjerrjen e ekspertizave të lëmive përkatëse lidhur me caktimin e lartësisë së kompensimit, gjykatat këtyre ekspertizave ua falin besimin e plotë edhe pse të njëjtat del se janë të paargumentuara, deri diku të paqarta dhe kontradiktore, dhe çka është më e rëndësishmja shumica prej tyre janë të nxjerra në kundërshtim me rregullat themelore për përcaktimin e shumës së kompensimit ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 15 të Ligjit për shpronësimin.

## 7.1.6 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës

**Aktvendimi AC.nr.4103/15, i datës 16.03.2017**

### **Arsyetim**

*Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, e si shkak i vërtetimit jo të plotë dhe jo të drejtë të gjendjes faktike. Po ashtu, i njëjti aktvendim është përfshirë edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e lidhur me nenin 160.4 të LPK-së dhe nenin 3 të LPJ-së..*

*Gjykata e Apelit e Kosovës tani për tani nuk mund t'i pranojë konstatimet faktike të bëra nga gjykata e shkallës së parë, të cilat sipas vlerësimit të gjykatës ankimore janë marrë duke u bazuar pikërisht në vlerësimin dhe mendimin e dhënë nga ana e ekspertit të lëmit të agronomisë-bujqësisë H. M., ekspertizës të së cilit ekspert gjykata e shkallës së parë ia ka falur në tërësi besimin, pasi që gjykata ankimore me vlerësimin e të njëjtës ekspertizë tani për tani nuk e pranon mënyrën se si është vlerësuar prona për të cilën kërkohet kompensimi nga ana e propozuesit, pasi që ekspertiza e punuar është e mangët dhe nuk përmban arsye bindëse, por edhe të dhëna të tjera të mjaftueshme se si i njëjti ekspert ka ardhur në përfundim lidhur me lartësinë e kompensimit, nga i cili rezulton se vlerësimi për 1 m<sup>2</sup> është 4.5 euro.*

*Në mendimin e tij të dhënë me shkrim eksperti nuk ka sqaruar se cilat metoda krahasuese apo parametra i ka marrë parasysh kur ka arritur në përfundimin se vlerësimi për 1 m<sup>2</sup> është 4.5 euro, apo në shumën e përgjithshme prej 15,673.50 euro, me çka gjykata ankimore të njëjtën ekspertizë për momentin nuk e pranon si të plotë dhe të qartë, pasi që e njëjta del se nuk është punuar në përputhje të plotë me nenin 15 paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit nr. 03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.0-3L/139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.*

*Me dispozitën e nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03-L/139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, përcaktohet se: "Kompensimi bëhet në bazë të vlerës së tregut të pronës, e cila përcaktohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të miratuara në përputhje me paragrafin 6. të këtij neni".*

*Në mungesë të një vlerësimi profesional dhe të argumentuar nga ana e ekspertit të agronomisë-bujqësisë, gjykatës ankimore i rezulton se gjendja faktike në këtë pjesë nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ku si pasojë ka ardhur edhe deri tek zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.*

*Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga 182 paragrafi 2, pika n) e lidhur me nenin 160.4 të LPK-së dhe nenin 3 të LPJ-së, qëndrojnë për faktin se në arsyetim të aktvendimit të ankimit gjykata nuk i ka treguar arsyet lidhur me faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe rrjedhimisht edhe vlerësimi që duhet të këtë gjykata për besueshmërinë e provave lidhur me ato fakte të cilat i ka vërtetuar.*

*Të gjitha këto të gjetura dhe shkelje të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, aktvendimin e ankimuar e bëjnë jo të drejtë dhe pa mbështetje në ligj, me çka si i tillë i njëjti aktvendim është dashur të prishet dhe lënda t'i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë, pasi që nuk pati kushte që i njëjti aktvendim eventualisht të mund të ndryshohej nga ana e kësaj gjykate.*

#### **Aktvendimi AC.nr.3185/15 i datës 20.02.2017**

##### **Arsyetim**

*Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (n) e LPK-së, gjendja faktike nuk është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe rrjedhimisht e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar.*

*Gjykata e Apelit e ka pranuar pretendimin ankimor të kundërpropozueses se aktvendimi i ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, pasi që dispozitivi i aktvendimit është në kundërshtim me arsyet e aktvendimit sepse arsyetimi i aktvendimit është tejet i mangët përkatësisht arsyet janë të paqarta. Në arsyetimin e aktvendimit mungojnë arsyet për vlerësimet e gjykatës lidhur me mënyrën se si i ka vërtetuar faktet dhe kur faktet i ka vërtetuar me prova, në çfarë mënyre i ka vlerësuar provat, sidomos për vlerën provuese të tyre. Nuk ka arsyetim fare për prapësimet e kundërpropozueses siç është prapësimi i parashkrimit, legjitimitetit të palëve e gjithashtu mungojnë arsyet për mënyrën se si gjykata i ka kualifikuar faktet e çështjes në raport me normat materialo-juridike. Duke qenë se gjykata u është referuar të dy ligjeve të shpronësimit dhe atë Ligjit për Shpronësimin e Pronës se Paluajtshme bashkë me ndryshim plotësimin dhe Ligjit mbi Eksproprijimin gjithashtu bashkë me plotësim ndryshimet. Mungojnë arsyet se cilat norma për cilat kërkesa përkatësisht vlerësimet i ka zbatuar.*

*Përveç kësaj nuk ka vlerësime fare për besueshmërinë e ekspertizës për vlerësimin e pronës së shpronësuar nga e cila pastaj rrjedhë edhe shkelja tjetër që i referohet konstatimit jo të drejtë të gjendjes faktike. Gjykata e shkallës së parë nuk ia ka përcaktuar detyrat në mënyrë të saktë ekspertit dhe rrjedhimisht rrethanat specifike që përcaktohen sipas ligjit të cilat duhet të merren në konsideratë me rastin e caktimit të pronës së shpronësuar. Gjykata me rastin e caktimit të ekspertit për vlerësimin e pronës së shpronësuar duhet t'ia përcaktojë në mënyrë të qartë ekspertit detyrat dhe rrethanat që duhet t'i marrë në vlerësim me rastin e caktimit të vlerës. Në çdo rast detyrat e ekspertit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e ligjit i cili e përcakton të drejtën e kompensimit dhe parametrat për vlerësimin e pronës.*

*Siç vërehet nga shkresat e lëndës gjykata ka pasur paqartësi se cili ligj duhet të zbatohet në këtë rast, prandaj edhe detyra e ekspertizës e rrjedhimisht edhe ekspertiza është paraqitur me të meta, të cilat të njëjtën e kualifikojnë tani për tani si të papranueshme për Gjykatën e Apelit.*

*Gjykata e Apelit, tani për tani nuk mund ta pranojë një përfundim të tillë për lartësinë e vlerës së pronës së shpronësuar sepse një ekspertizë e tillë nuk është e pranueshme duke*

*qenë se nuk është e punuar në përputhje me kërkesat ligjore që duhet të merren në konsideratë me rastin e vlerësimit.*

*Ekspertiza e punuar nga ana e ekspertit për vlerësimin e patundshmërive është shumë e mangët dhe nuk përmban fare të dhëna se si ka arritur eksperti në përfundimin për lartësinë e vlerës së pronës, përveç se i cek disa ekspertiza tjera të cilat nuk mund të shërbejnë si referencë.*

*Gjykata i është referuar Ligjit mbi Eksproprijimin dhe me dispozitat e nenit 28 dhe 29 të Ligjit mbi Eksproprijim, me ndryshim plotësime të nenit 13, janë përcaktuar disa parametra/kritere bazë të cilat duhet të merren në konsideratë me rastin e caktimit të vlerës së pronës së shpronësuar dhe në këtë rast njëri ndër kriteret kryesore do të duhej të ishte kultura e pronës bujqësore apo ndërtimore, dhe pastaj varësisht nga tipi/kultura e pronës të jepet vlerësimi duke iu përmbajtur parametrave/kritereve që përcakton Ligji mbi Eksproprijimin.*

*Siç mund të vërehet nga shkresat e lëndës ekspertiza e ekspertit për vlerësimin e patundshmërive është vetëm përfundim pa analizë të mirëfilltë për vlerën e pronës në gjendjen në të cilën është shpronësuar. Eksperti e ka vlerësuar pronën duke u nisur nga gjendja dhe vlera e tanishme e pronës (përfshirë gjendjen e ndërtimeve). Shirohet pyetja logjike po të ishte ndërtuar një fabrikë, aeroport apo termocentral në pronën e shpronësuar, çka do të vlerësonte eksperti?*

*Në këtë rast ekspertiza është në tërësi e papranueshme e rrjedhimisht edhe vlerësimi i gjykatës është i papranueshëm.*

*Në mungesë të një vlerësimi profesional dhe të argumentuar rezulton se gjendja faktike në këtë pjesë nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ka ardhur edhe deri tek zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.*

*Neni 36*

*Ankesat mbi shumën e kompensimit*

- 1 Nëse në përputhje me nenin 11 të këtij ligji, një Organ Shpronësues nxjerr një Vendim Përfundimtar, çdo Pronar ose Zotërues i Interesit në pronën dhe/ose të drejtat të cilat janë objekt i këtij vendimi mund të paraqesë ankesë pranë gjykatës kompetente për kundërshtimin e shumës së kompensimit dhe/ose dëmeve të cilat janë përcaktuar në vendim se do t'i paguhen atij Pronari dhe/ose Zotëruesi të Interesit..*
- 2. Nëse Organ Shpronësues është Organi Shpronësues i një Komune, ankesa duhet të paraqitet pranë gjykatës përkatëse komunale. Nëse Organi Shpronësues është Qeveria, ankesa duhet të paraqitet pranë Gjykatës Supreme të Kosovës.*
- 3. Çdo ankesë e lartpërmendur duhet të paraqitet jo më shumë se tridhjetë (30) ditë kalendarike pas hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar të përcaktuar në paragrafin 7. të nenit 11 të këtij ligji. Nëse ankesa paraqitet pas skadimit të kësaj periudhe tridhjetë (30) ditore, ajo do të refuzohet nga gjykata.*
- 4. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës, parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës Shpronësues. Nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf, gjykata e refuzon ankesën.*



5. *Organi Shpronësues ka në dispozicion tridhjetë (30) ditë kalendarike pas pranimit të kopjeve të përmendura në paragrafin 4. të këtij neni që ta dorëzojë përgjigjen e tij në gjykatë.*
6. *Nëse ankesa dorëzohet në përputhje me këtë nen në përputhje me këtë ligj, gjykata është e autorizuar ta bëjë rillogaritjen e shumës së kompensimit dhe/ose dëmeve të përcaktuara në vendimin e organit shpronësues. Nëse gjykata konstaton se shuma e kompensimit dhe/ose e dëmeve të përcaktuara në vendimin e organit shpronësues është më e ulët ose më e lartë se shuma e cila kërkohet sipas këtij ligji, gjykata nxjerr aktgjykim me të cilin e ndryshon Vendimin Përfundimtar të Organit Shpronësues dhe e rregullon shumën e kompensimit për shpronësim dhe/ose dëmeve.*
7. *Ndaj aktgjykimit të gjykatës sipas këtij neni mund të paraqitet apeli në përputhje me ligjin e aplikueshëm mbi këto apele.*
8. *As paraqitja e ankesës ndaj vendimit të organit të shpronësimit sipas këtij neni dhe as paraqitja e apelit ndaj aktgjykimit të gjykatës mbi atë ankesë nuk ndikon në vendimin përkatës ose të drejtën e Organit Shpronësues që ta vazhdojë zbatimin e vendimit përkatës Shuma e kompensimit dhe/ose dëmeve të përcaktuara në vendim paguhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë ligj; megjithatë, pagesa e kompensimit dhe/ose dëmeve nuk i cenon kompetencat e gjykatës sipas paragrafit 6. të këtij neni për ndryshimin e shumës së kompensimit dhe/ose dëmeve. Nëse gjykata e rrit shumën e kompensimit, Organi Shpronësuar duhet të paguajë (ose ta urdhërojë Subjektin Kërkuës apo Përfituesin që të paguajë) shumën e rritur. Nëse gjykata e zvogëlon shumën e kompensimit dhe/ose dëmeve, personat të cilët e kanë marrë kompensimin e tepërt urdhërohen që t'ia kthejnë shumën e tepërt palës e cila e ka paguar atë.*

### **7.1.7 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës lidhur me ankesat mbi shumën e kompensimit**

Sipas formulimit ligjor të bërë sipas dispozitës së nenit 36 parg. 3 të Ligjit për shpronësimin e pronës se paluajtshme, mund të konstatohet se tek rastet kur organi shpronësues ka nxjerrë vendimin përfundimtar për shpronësimin e një prone të paluajtshme ose një pjese të saj, në përputhje me dispozitën e nenit 11 të këtij ligji, ndërsa pronari ose zotëruesi i interesit të asaj prone nuk pajtohet me shumën e kompensimit që atij duhet t'i paguhet në bazë të vendimit përfundimtar, i njëjti ka të drejtë që brenda afatit kohor prej 30 ditësh pas hyrjes në fuqi të vendimit përfundimtar të përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 11 të këtij ligji, tek gjykata kompetente të paraqes ankesë përmes se cilës mund të kundërshton shumën e kompensimit.

Sipas paragrafit 7 të nenit 11 të këtij ligji parashihet se, *Vendimi përfundimtar hyn në fuqi pas shpalljes në përputhje me të gjitha kushtet e përcaktuara me paragrafin 6 të nenit 11 dhe nenin 43 të këtij ligji.*''

Me paragrafin 6 të nenit 11 shprehimisht parashihet që, *Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të vendimit përfundimtar, Organi Shpronësues e bën shpalljen e vendimit në gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë ''.*

Me nenin 43 të të njëjtit ligj shprehimisht parashihet që *''Nëse një dispozitë e këtij ligji kërkon nga Organi Shpronësues që ta bëjë shpalljen e një vendimi, njoftimi ose dokumenti tjetër në Gazetën Zyrtare të Kosovës, një gazetë dhe/ose publikim tjetër, Organi Shpronësues e bën shpalljen e atij vendimi, njoftimi ose dokumenti në të gjitha gjuhët*

*zyrtare të Kosovës. Versionet në gjuhët zyrtare të vendimit, njoftimit ose dokumentit duhet të shpallen njëkohësisht, në të njëjtin publikim dhe në të njëjtën mënyrë ''*

Kur analizohen me kujdes dispozitat ligjore të lartë cituara, mund të vihet në përfundimin se vendimi përfundimtar i nxjerrë nga Organi Shpronësues ligjërisht hyn në fuqi pas shpalljes së tij në Gazetën Zyrtare të Kosovës. Rrjedhimisht nga kjo i bie që edhe afati kohor ligjor prej 30 ditësh për paraqitje të ankesës nga pronari ose zotëruesi i interesit, i cili e kundërshton shumën e kompensimit të njohur sipas vendimit përfundimtar të Organit Shpronësues, fillon të rrjedhë nga dita kur Vendimi Përfundimtar ka marrë formën e prerë, apo thënë më mirë nga dita e nesërme kur Vendimi Përfundimtar nga Organi Shpronësues është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në bazë të dispozitave ligjore të lartë cituara mund të konstatohet se Vendimi Përfundimtar i Organit Shpronësues nuk është e nevojshme që t'i dorëzohet personalisht pronarit ose zotëruesit të interesit të cilit i është shpronësuar prona e paluajtshme, pasi që si dorëzim i rregullt konsiderohet dita kur Vendimi Përfundimtar është shpallur në Gazetën Zyrtare të Kosovës, ditë kjo kur i njëjti edhe hyn në fuqi.

Një rregullim i tillë ligjor del të jetë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe nenin 216 të Ligjit të procedurës Jokontestimore.

Me dispozitën e nenit 31 paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, garantohet mbrojtja e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organit tjetër shtetëror dhe bartësve të kompetencave publike. Ndërkaq me dispozitën e nenit 32 të Kushtetutës, garantohet se secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e tij, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Pastaj me nenin 54 të Kushtetutës po ashtu parashihet se çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes, mohimit të ndonjë të drejte me kushtetutë ose ligj si dhe të drejtat me mjetet efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se dorëzimi i vendimit përfundimtar për shpronësimin e paluajtshmërisë nëpërmes Gazetës Zyrtare të Kosovës, pronarëve ose zotëruesve të interesit të cilëve u është shpronësuar prona e paluajtshme, nuk paraqet trajtim të duhur dhe të barabartë të palëve, pasi që shkelet e drejta në gjykim të drejtë, e drejtë kjo që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Për vet faktin se pronari ose zotëruesi i interesit të cilit i është shpronësuar prona e paluajtshme nuk njoftohet personalisht me vendimin për caktimin e lartësisë së kompensimit për pronën e shpronësuar, konsiderohet se në këtë mënyrë është shkelur edhe neni 6.1 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, që përcakton se çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga gjykata e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj e cila duhet të vendosë për mosmarrëveshje në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile. Në një aspekt, parimi i gjykimit të drejtë nënkupton edhe barazinë e armëve, e cila shprehet në të drejtën e palëve e pasur njohuri dhe për t'i komentuar provat e paraqitura apo vërejtjet e parashtruara.

Sipas këtij rregullimi ligjor pronarit ose zotëruesit të interesit të cilit i është shpronësuar prona e paluajtshme, i shkelet edhe e drejta nga nenit 13 i Konventës e cila garanton të drejtën për mjet efektiv lidhur me çështjen që ka të bëjë me caktimin e lartësisë së kompensimit për pronën e paluajtshme.

Me dispozitën e nenit 216.1 të Ligjit për procedurën jo kontestimore shprehimisht parashihet që, *“ në qoftë se pjesëmarrësit në procedurë të eksproprijimit nuk arrijnë marrëveshje për kompensimin e pronës së paluajtshme të eksproprijuar (shpronësuar), brenda afatit prej 2 muajsh nga data në të cilën ka marrë formë të prerë aktvendimi për eksproprijim, organi kompetent administrativ e dërgon aktvendimin bashkë me të gjitha shkresat e lëndës dhe provat për pagesën e shumës së kompensimit në gjykatën kompetente në territorin e së cilës gjendet prona e paluajtshme e eksproprijuar, e këtë me qëllim të caktimit të kompensimit ”*

Në situatat e tilla kur në mes të pjesëmarrësve në procedurë nuk arrihet marrëveshja për kompensimin për pronën e eksproprijuar brenda afatit të caktuar ligjor, atëherë ky Organ Shpronësues ligjërisht ka për detyrim që t’ia dorëzojë vendimin përfundimtar brenda afatit prej 2 muajsh, gjykatës kompetente për caktimin e kompensimit, që e njëjta të ketë mundësi që duke vepruar sipas rregullave të procedurës jokontestimore ta caktojë seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën pas nxjerrjes së provave të nevojshme, bie aktvendimin më të cilin pronarit ose zotëruesit të interesit të cilit i është shpronësuar prona e paluajtshme t’i gjykojë kompensim të drejtë.

Prandaj në të gjitha rastet kur para gjykatave të shkallës së parë, nga pronari ose zotëruesi i interesit paraqitet ankesë kundër vendimit përfundimtar të organit të shpronësuar, me të cilën kundërshtohet shuma e kompensimit të njohur, gjykata çështjen e rrjedhjes së afatit kohor ligjor prej 30 ditësh për ushtrim të ankesës, duhet ta llogarisë nga dita kur pronarit të cilit i është shpronësuar prona e paluajtshme i është dorëzuar personalisht dhe në mënyrë të rregullt Vendimi Përfundimtar i nxjerrë nga Organi Shpronësues, apo nga dita kur i njëjti ka mësuar për një vendim të tillë, e jo nga dita kur Vendimi Përfundimtar është shpallur në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

### **7.1.8 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën e Gjykatës së Apelit janë paraqitur raste kur gjykatat e shkallës së parë, ankesën e ushtruar nga pronari i pronës të cilit i është shpronësuar prona e paluajtshme, përmes se cilës e ka kundërshtuar shumën e kompensimit të njohur sipas Vendimit Përfundimtar, e kanë hedhur poshtë si të palejuar më arsyetimin se e njëjta është paraqitur pas kalimit të afatit kohor ligjor prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita kur Vendimi Përfundimtar është shpallur në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

Edhe pse gjykatat e shkallës së parë nuk kanë pasur dëshmi se pronarit të pronës së paluajtshme në mënyrë të rregullt dhe personalisht i është dorëzuar ndonjëherë Vendimi Përfundimtar i nxjerrë nga Organi Shpronësues, që pastaj të mund të llogaritet edhe çështja e afatshmërisë së ushtrimit të ankesës, gjykatat e shkallës së parë fare nuk kanë vlerësuar një rrethanë të tillë, dhe vendimin e tyre e kanë marrë duke u referuar në dispozitën ligjore të nenit 11 paragrafi 6 dhe 7 dhe 43 të Ligjit për shpronësimin e pronës e paluajtshme, më të cilat dispozita ligjore afati për ushtrim të ankesës fillon të rrjedhë nga dita kur Vendimi Përfundimtar është shpallur në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

Një përfundim i tillë i gjykatave të shkallës së parë, kësaj gjykate i ka rezultuar si i gabuar për shkakun se në çdo rast afati për ushtrim të mjetit juridik, ligjërisht fillon të rrjedhë nga dita e nesërme, kur palës e cila ka të drejtë në ankesë i është dorëzuar vendimi ndaj të cilit i lejohet mjeti juridik.

Në situatat e tilla edhe tek rastet e shpronësimit, llogaritja e afatshmërisë së ankesës së ushtruar ndaj një Vendimi Përfundimtar të nxjerrë nga Organi Shpronësues, nga gjykatat e shkallës së parë duhet të bëhet nga dita kur vendimi i është dorëzuar personalisht dhe në mënyrë të rregullt palës ankuese, përkatësisht nga dita e nesërme pas pranimit të këtij vendimi, e jo nga dita kur i njëjti vendim është shpallur ne Gazetën Zyrtare të Kosovës.

Një përfundim i tillë në praktikën gjyqësore përveç vendimeve të lëshuara nga Gjykata e Apelit, është konfirmuar edhe me disa vendime të cilat janë lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, e cila e ka trajtuar çështjen e rrjedhjes së afatit për ushtrim të ankesës ndaj një Vendimi Përfundimtar i cili është nxjerrë nga Organi Shpronësues.

### **7.1.9 Referencë nga arsyetimi i aktvendimit të Gjykatës së Apelit**

#### **Aktvendimi AC.nr.2577/15 i datës 21.10.2015**

##### **Arsyetim**

*Gjykata e Apelit, në procedurën ankimore tani për tani nuk mund të pranojë një qëndrim juridik të gjykatës të shkallës së parë, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe për këtë shkak nuk ka kushte që aktvendimi i atakuar të ndryshohet, por i njëjti është dashur të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.*

*Me dispozitën e nenit 36 paragrafi 3, të Ligjit mbi Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-139, parashihet se “çdo ankesë kundër vendimit përfundimtar duhet të paraqitet brenda afatit prej 30 ditësh. Vendimi përfundimtar hyn në fuqi pas shpalljes sipas nenit 11.7 të të njëjtit ligj”, ndërsa sipas nenit 48 të Ligjit në fjalë thuhet se shpallja e tij bëhet në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, ose me publikim tjetër në të gjitha gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.*

*Në fakt propozuesi e konteston shumën e kompensimit që duhet ti paguhet atij si pronar i pronës së paluajtshme të shpronësuar dhe atë në bazë të vendimit përfundimtar.*

*Vlen të theksohet se me dispozitën e nenit 31 paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, garantohet mbrojtja e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organit tjetër shtetëror dhe bartësve të kompetencave publike. Ndërkaq, me dispozitën e nenit 32 të Kushtetutës, garantohet se secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e tij, në mënyrë e përcaktuar me ligj. Pastaj me nenin 54 të Kushtetutës po ashtu parashihet se çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes së mohimit të ndonjë të drejte me kushtetutë ose ligj si dhe të drejtat me mjetet efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.*

Gjykata e Apelit e Kosovës, gjatë vlerësimit të shkresave të lëndës vëren se konkludimi juridik i gjykatës të shkallës së parë, se ankesa kundër vendimit përfundimtar është paraqitur jashtë afatit prej 30 ditësh, pas shpalljes në Gazetën Zyrtare të Kosovës, është konkludim i pabazuar dhe i papranueshëm si dhe rrjedhimisht i kundërligjshëm ngase i njëjti bie ndesh edhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Gjykata e Apelit, duke u nisur nga arsyet e sipër cekura, vlerëson se dorëzimi i vendimit përfundimtar për shpronësimin e paluajtshmërisë së propozuesit nëpërmes Gazetës Zyrtare të Kosovës, në emër të propozuesit, në këtë procedurë, nuk paraqet trajtim të duhur, rrjedhimisht nuk paraqet trajtim në mënyrë të barabartë të palëve, andaj kjo gjykatë konsideron se është shkelur e drejta në gjykim të drejtë, e cila e drejtë garantohet me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Bazuar në faktin se propozuesi nuk është njoftuar personalisht me vendimin për caktimin e lartësisë së kompensimit për pronën e shpronësuar konsiderohet se në këtë mënyrë është shkelur neni 6.1 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, që përcakton se çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga gjykata e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj e cila duhet të vendosë për mosmarrëveshje në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile. Në një aspekt parimi i gjykimit të drejtë nënkupton edhe barazinë e armëve, e cila shprehet në të drejtën e palëve për të pasur njohuri dhe për t'i komentuar provat e paraqitura apo vërejtjet e parashtruara.

Në rastin konkret propozuesi nuk ka mund t'i ushtrojë të drejtat e tij, për gjykim të drejtë, pa iu dhënë mundësia që t'i dorëzohet personalisht vendimi përfundimtar me caktimin e kompensimit për pasurinë e tij të shpronësuar. Me këtë veprim juridik të gjykatës së shkallës së parë propozuesit i është bërë edhe shkelja tjetër e të drejtës, sipas nenit 13 të Konventës e cila garanton të drejtën për mjet efektiv lidhur me çështjen e propozuesit që ka të bëjë me caktimin e lartësisë së kompensimit për pronën e paluajtshme.

Sipas Gjykatës së Apelit, aktvendimi i atakuar është marrë edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 216.1 të Ligjit për procedurën jo kontestimore. Me këtë dispozitë ligjore parashihet se në qoftë se pjesëmarrësit në procedurë të eksproprijimit nuk arrijnë marrëveshje për kompensimin e pronës së paluajtshme të eksproprijuar (shpronësuar), brenda afatit prej 2 muajsh nga data në të cilën ka marrë formë të prerë aktvendimi për eksproprijim, organi kompetent administrativ e dërgon aktvendimin bashkë me të gjitha shkresat e lëndës dhe provat për pagimin e shumës së kompensimit në gjykatën kompetente në territorin e të cilës gjendet prona e paluajtshme e eksproprijuar, e këtë me qëllim të caktimit të kompensimit. Prandaj, në rastin konkret duke qenë se nuk është arritur marrëveshja për kompensimin për pronën e eksproprijuar brenda afatit të caktuar ligjor, atëherë ky organ është dashur t'ia dorëzojë vendimin përfundimtar brenda afatit prej 2 muajsh, gjykatës kompetente për caktimin e kompensimit.

Prandaj, duke u bazuar në një gjendje të tillë të çështjes pa mëdyshje dhe në mënyrë të sigurt rezulton konkludimi juridik se neni 36 paragrafi 3 i Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, jo vetëm që është jo preciz por i njëjti është në kolizion me nenin 1 të protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Me këtë dispozitë të Konventës parashihet se Ligji nacional i shpronësimit duhet të jetë i qasshëm dhe preciz dhe se ndërhyrja në të drejtat pronësore duhet të jetë e bazuar me ligj si dhe duhet të jetë masë e fundit për arritjen e qëllimit të paraparë. Përpos kësaj një

*ndër postulatet e protokollit 1 të Konventës është e drejta për gjykim të drejtë që në vete përfshinë edhe barazinë e armëve. Ky parim shprehet në faktin që secili që është palë në procedurë duhet të ketë mundësinë e arsyeshme për të paraqitur rastin e vet në kushtet që nuk i vënë atë në pozitë substanciale të pafavorshme përballë kundërshtarit të vet.*

*Duke u nisur nga fakti se vendimi përfundimtar mbi shpronësimin numër 9/128, i datës 11.06.2010, me të cilin është kundërshtuar shuma e kompensimit të caktuar, është dorëzuar me anë të publikimit në gazetën zyrtare të Kosovës, edhe pse është akt individual i cili detyrimisht dorëzohet në formë personale. Madje ky detyrim i dorëzimit personal është parashikuar edhe sipas të gjitha ligjeve procedurale. Kjo për më tepër ngase qytetarët dhe rrjedhimisht propozuesi nuk kanë qasje në gazetën zyrtare, madje në shumë gazeta të përditshme.*

*Prandaj, Gjykata e Apelit gjen se në këtë rast konkret është cenuar jo vetëm parimi i administrimit të drejtësisë, por edhe barazia e armëve që konsiston në pamundësinë e shfrytëzimit të ankesës në mënyrë efektive që është si pasojë e mosdorëzimit personal të vendimit të theksuar. Me dorëzim personal të vendimit preliminar propozuesi është vënë në pozitë substancialisht të pafavorshme përballë kundër propozuesit i cili vet e administron dhe boton gazeta zyrtare.*

*Lidhur me çështjen e afatshmërisë për rastet e paraqitjes së ankesës-propozimit me të cilin atakohet vendimi përfundimtar për shpronësim të paluajtshmërisë njëjtë vlerëson dhe vendos edhe Gjykata Supreme e Kosovës.*

*Megjënjëse aktvendimi i atakuar përmban të metat e paraqitura dhe tash për tash nuk mund të shqyrtohet nga aspekti i vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe zbatimit të drejtë të së drejtës materiale, për këtë arsye është prishur dhe çështja i kthehet në rigjykim, gjykatës së shkallës së parë.*

## **8. KOMPENSIMI I DËMIT**

### **8.1 AKTGJYKIMET NË RASTET E SHPËRBLIMIT TË DËMIT MATERIAL DHE JO MATERIAL**

Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (më tutje LMD)<sup>6</sup> me dispozitat e tij nga neni 136 deri në nenin 193, ka rregulluar marrëdhëniet e detyrimeve jashtë kontraktuese, respektivisht shkaktimin e dëmit dhe çështjet tjera që ndërlidhen më të. Ekzistojnë dy lloje të shpërblimit të dëmit, shpërblimi i dëmit material dhe shpërblimi i dëmit jo material.

Gjykatat në Republikën e Kosovës përballen me një numër të madh të lëndëve ku kërkesë është shpërblimi i dëmit material por edhe i dëmit jo material, sidomos dëmeve të shkaktuara nga aksidente në komunikacion, por nuk mungojnë edhe kërkesat për shpërblimin e dëmit për shkak të lëndimeve të marra në vendin e punës.

Në Republikën e Kosovës deri në janar të vitit 2013 kanë ekzistuar pesë Gjykata të Qarkut, ku ka pasur dallime sa i përket praktikave të trajtimit të çështjeve në përgjithësi, por edhe sa i përket vendosjes së çështjeve për shpërblimin e dëmit. Me fillimin e punës së gjykatës së Apelit praktikat e ndryshme në gjykatat themelore kanë vazhduar, dallime ka pasur sidomos në caktimin e vlerës së shpërblimit të dëmit veçanërisht të dëmit jo material. Synimi i Gjykatës së Apelit i Kosovës është që t'i unifikojë praktikat brenda kolegejeve të kësaj gjykate, e ky unifikim të shërbejë edhe për Gjykatat Themelore, me qëllim që dispozitat sa i përket shpërblimit të dëmit të aplikohen në mënyrë të drejtë për të gjithë ata që i drejtohen gjykatave me kërkesa për shpërblimin e dëmit.

Ndonëse Gjykata e Apelit deri tani ka shqyrtuar kryesisht rastet ku është aplikuar Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve i publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978, si ligj i aplikueshëm, e edhe rastet të cilat janë marrë si shembuj është aplikuar ky ligj. Qëllimi i këtij punimi është si të zbatohen dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës Ligji Nr. 04/L-077, Gazeta Zyrtare Nr.16, datë 19.06.2012, dhe i cili ka hyrë në fuqi më 20.12.2012, pasi edhe në aplikimin e këtij ligji ka pasur në shumë raste nga praktika aplikim të gabuar të së drejtës materiale, apo vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike. Është fakt që duhet konstatuar se dispozitat e ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978 dhe ligjit të për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës Ligji Nr. 04/L-077, Gazeta Zyrtare Nr.16, datë 19.06.2012, sa i përket dispozitave për shpërblimin e dëmit material dhe jo material kanë përmbajtje pothuaj identike, me përjashtim të disa risive të ligjit të ri, për marrëdhëniet e detyrimeve, ku risi janë neni 163 - përgjegjësia për zotëruesin e kafshës, neni 164 - përgjegjësia e zotëruesit të ndërtesës, neni 165 - përgjegjësia për shembjen e ndërtimit, dhe neni 187- shpërblimi në të holla për personin juridik.

Praktika gjyqësore është relativisht e zhvilluar lidhur me këtë temë, mirëpo numri i madh i rasteve nëpër Gjykatat e Kosovës, dinamika e rritjes së numrit të rasteve të paraqitura për shpërblimin e dëmit, ka ndikuar që të ketë dallime në praktikën gjyqësore sidomos sa i përket kriterëve për përcaktimin e lartësisë së dëmit, posaçërisht atij jomaterial, por edhe mënyra e vërtetimit të gjendjes faktike në këto raste shpesh ka të meta. Prandaj, më qëllim

---

<sup>6</sup> Ligji Nr. 04/L-077, për Marrëdhëniet e Detyrimeve i Kosovës, Gazeta Zyrtare Nr.16, datë 19.06.2012, dhe i cili ka hyrë në fuqi më 20.12.2012.

të unifikimit të praktikës gjyqësore dhe rritjes së cilësisë së arsytimit të vendimeve gjyqësore, arsyetohet nevoja e trajtimit të kësaj teme, në mënyrë të fokusuar sa i përket shpërblimit të dëmit material dhe jo material që shfaqen si pasojë e lëndimeve në aksidente komunikacioni dhe në vend të punës dhe përgjegjësia për dëmin nga sendi i rrezikshëm ose nga veprimtaria e rrezikshme.

## 8.2 SHPËRBLIMI I DËMIT MATERIAL

*Dispozitat e Aplikueshme (në rastet më të shpeshta) me koment të shkurtër*

*Bazat e përgjegjësive, neni 136 të LMD-së<sup>7</sup>,*

1. *Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.*
2. *Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji.*
3. *Për dëmin, pavarësisht nga faji mbahet përgjegjësia edhe në rastet tjera të parashikuara me ligj.*

Sipas kësaj dispozite ligjvënësi ka përcaktuar bazat e përgjegjësive për dëmin e shkaktuar, në paragrafin 1. Ka përcaktuar obligimin e secilit që të përgjigjet për dëmin që e shkakton, që do të thotë se fajësia për dëmin supozohet për dëmtuesin, dhe duhet të vërtetohet e kundërta, përndryshe nuk mund të lirohet nga përgjegjësia. Sipas kësaj dispozite barra e të provuarit se kush e ka shkaktuar dëmin, i takon atij që pretendon se i është shkaktuar dëm, ndërsa personi përgjegjës për dëmin e ka barrën e të provuarit se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Në paragrafin 2, të këtij neni, për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin, nuk kërkohet fajësia, por përgjegjës për dëmin është zotëruesi i sendit apo personi që merret me këtë veprimtari. Ndërsa paragrafi 3, i këtij neni ligjvënësi ka pasur parasysh përgjegjësinë pavarësisht nga faji, në rastet tjera, të cilin ky ligj e ka paraparë p.sh. përgjegjësisë së prindërve për fëmijët, e kujdestarit për të miturin, etj. Nga kjo rrjedhë së LMD si baza të përgjegjësive e ka përcaktuar përgjegjësinë sipas fajit (përgjegjësia subjektive) dhe përgjegjësinë objektive (baza e përgjegjësive pa faj ose sipas fajit të supozuar).

### 8.2.1 Dëmi

*Neni 137, i LMD-së<sup>8</sup>*

*Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fëtimi i humbur), si dhe shkaktimi ndaj tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).*

---

<sup>7</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978, e ka rregulluar me nenin 154.

<sup>8</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978, e ka rregulluar me nenin 155.



Sipas definimit të dëmit sipas kësaj dispozite të ligjit, kur është fjala për kompensimin e dëmit material, duhet të ekzistojë dëmi real, apo zvogëlimi i pasurisë së dikujt, dhe forma tjetër është pengimi i rritjes së pasurisë, që nënkupton fitimin e humbur. Tek dëmi real apo i zakonshëm vlen parimi i kthimit në gjendje të mëparme, ashtu siç parashihet tek kompensimi i dëmit material. Ndërsa te fitimi i humbur duhet të vlerësohet se sa do të rritej ajo pasuri nëse nuk do të paraqitej pengesa. Ndërsa sipas definimit të kësaj dispozite, tek shpërblimi i dëmit jo material nuk është i mundur kthimi në gjendje të mëparme, mirëpo me këtë synohet që të bëhet kthimi në gjendje të mëparme i gjendjes shpirtërore të çrregulluar me rastin e pësimit të dëmit jo material.

### 8.2.2 Ekzistimi i fajësisë

*Neni 140 i LMD-së<sup>9</sup>,*

*Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.*

Me këtë definim sipas kësaj dispozite kërkohet që veprimet apo mosveprimet e kryesit të dëmit në raport me dëmin e shkaktuar të jenë me dashje apo nga pakujdesia. Dashja nënkupton se dëmi është shkaktuar në mënyrë të qëllimshme apo thënë ndryshe kur dëmtuesi i dëshiron pasojat, ndërsa pakujdesia ekziston kur kryesi nuk ka qenë i kujdesshëm në ndërmarrjen e veprimeve të tij apo nuk ka vepruar, ndonëse është dashur të veprojë. Në praktikat e krijuara nga gjykatat shpesh herë ka mungesë të vërtetimit të gjendjes faktike sa i përket ekzistimit të fajësisë, ndonëse për ekzistimin e shpërblimit të dëmit të shkaktuar duhet të ekzistojë fajësia.

### 8.2.3 Përgjegjësia në rast aksidenti të shkaktuar nga mjetet motorike në lëvizje

*Neni 159 LMD-së<sup>10</sup>*

1. *Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit.*
2. *Në qoftë se ekziston fjaji i dyanshëm, secili zotërues i mjetit motorik përgjigjet për dëmin e tërësishëm që e kanë pësuar ata përpjesëtimisht me shkallën e fajit të tyre.*
3. *Në qoftë se nuk ka fajësi në asnjërën anë, zotëruesi i mjetit motorik përgjigjet në pjesë të barabarta, në qoftë se rregullat e drejtshëmrisë nuk kërkojnë diçka tjetër.*
4. *Për dëmin që e pësojnë personat e tretë zotëruesit e mjeteve motorike përgjigjen solidarisht.*

Me këtë dispozitë është përcaktuar përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga mjetet motorike në rast aksidenti, për shkak të vet specifikave se ky lloj i dëmit në të shumtën e herëve shkaktohet me fajin e dy pjesëmarrësve ndonëse me paragrafin 1, është përcaktuar parimi i fajësisë për dëmin e shkaktuar. Në paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar që secili zotërues i mjetit motorik përgjigjet për dëmin e tërësishëm që e kanë pësuar përpjesëtimisht me shkallën e fajit të tyre, që do të thotë se sipas kësaj dispozite i mbetet gjykatave që me

---

<sup>9</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978, e ka rregulluar me nenin 158.

<sup>10</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978, e ka rregulluar me nenin 178.

rastin e vendosjes ta vërtetojnë shkallën e fajësisë dhe në bazë të shkallës së fajësisë të vendosin edhe për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar.

#### **8.2.4 Shpërblimi i dëmit material - Rivendosja e gjendjes së mëparshme dhe shpërblimi në të holla**

*Neni 169 LMD-së<sup>11</sup>,*

1. *Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi.*
2. *Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit ta japë shpërblimin në të holla.*
3. *Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit.*
4. *Gjykata do t'ia gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme.*

Me këtë dispozitë ligjore për shpërblimin e dëmit, fillimisht parashihet detyrimi i personit përgjegjës për rivendosjen e gjendjes e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi, pra qëllim primar i shpërblimit të dëmit është rivendosja e gjendjes para shkaktimit të dëmit. Pastaj nëse kjo nuk është e mundur, e që zakonisht është e pamundur të bëhet rikthimi i plotë i gjendjes së mëparshme, atëherë personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblim në të holla. Pra siç shihet LMD përparësi i ka dhënë shpërblimit të dëmit në natyrë e pastaj shpërblimit të dëmit në të holla edhe pse në praktikën gjyqësore shumë më shumë zbatohet shpërblimi i dëmit në të holla. Në praktikë nuk ka raste ku kërkohet kthimi në gjendjen e më parme, por kryesisht kërkesat kanë të bëjnë me shpërblim në të holla. Gjykata me rastin e vendosjes është e kufizuar me kërkesën sipas padisë, andaj duhet të vendosë sipas kërkesëpadisë kur kërkesa është e shprehur në të holla, ndonëse sipas rrethanave të rastit shpërblimi i dëmit mund të bëhet në natyrë, duke e vendosur gjendjen e mëparshme, por duhet që shpërblimi të ketë qëllim vetëm kthimin në gjendjen e mëparshme.

#### **8.2.5 Kur arrin për pagesë detyrimi i shpërblimit**

*Neni 170, LMD-së<sup>12</sup>*

*Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit.*

---

<sup>11</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978, e ka rregulluar me nenin 185.

<sup>12</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978, e ka rregulluar me nenin 186.

Kjo dispozitë përcakton arritshmërinë e kërkesës për pagesën e shpërblimit të dëmit, që ka rendësi sidomos me rastin e llogaritjes së kamatës, pasi nga dita e arritjes së detyrimit të shpërblimit të dëmit duhet të llogaritet edhe kamata. Përjashtim nga kjo dispozitë bënë praktika e krijuar në Gjykatat e vendit tonë ku llogaritja e kamatës për dëmin jo material llogaritet nga data e nxjerrjes së aktgjykimit, apo nga data e nxjerrjes së ekspertizës, nëse këto data janë të përafërta njëra me tjetrën.

## 8.2.6 Shpërblimi në formë të rentës në të holla

*Neni 172 LMD-së<sup>13</sup>*

1. *Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet, sipas rregullës, në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar.*
2. *Renta në të holla e gjykuar në emër të shpërblimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diçka tjetër.*
3. *Kreditori ka të drejtë të kërkojë sigurim të nevojshëm për pagimin e rentës, përveç nëse kjo sipas rrethanave të rastit nuk do të ishte e arsyeshme.*
4. *Në qoftë se debitori nuk e jep sigurimin të cilin e cakton gjykata, kreditori ka të drejtë të kërkojë që në vend të rentës t'i paguhet një shumë e përgjithshme, lartësia e të cilës do të caktohet sipas lartësisë së rentës dhe kohëzgjatjes së mundshme të jetës së kreditorit, me zbritje të kamatave përkatëse.*
5. *Për shkaqe serioze kreditori mund edhe në raste të tjera të kërkojë menjëherë ose më vonë, që në vend të rentës t'i paguhet një shumë e përgjithshme.*

Me këtë dispozitë, duke marrë parasysh që dëmi i shkaktuar, në disa raste krijon pasoja të vazhdueshme për një kohë të caktuar, e në disa raste edhe pasoja të përhershme. Në këto raste e drejta jonë pozitive ka paraparë një formë të shpërblimit që quhet shpërblimi i dëmit në formë të rentës në të holla. Kjo vjen në shprehje në rastet e vdekjes apo edhe rastet e lëndimeve me pasoja afatgjata, apo të përhershme. Për këtë lloj të dëmit as që mund të bëhet fjalë për rikthimin e gjendjes së mëparshme e po ashtu për shpërblimin e dëmit në të holla në një shumë të tërësishme. Në rast të vdekjes, lëndimit trupor, shpërblimi caktohet në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar. Veprohet kështu sepse pasojat kanë të bëjnë me dëmtimin trupor, humbjen apo zvogëlimin e aftësisë punuese, humbjen ose zvogëlimin e të ardhurave etj. Të gjitha këto e vështirësojnë jetën e të dëmtuarit, e renta në këtë rast caktohet me qëllim të sigurimit të ekzistencës së të dëmtuarit. Me paragrafin 4, të këtij neni është paraparë mundësia që nëse debitori nuk e jep sigurimin të cilin e cakton gjykata, kreditori ka të drejtë të kërkojë që në vend të rentës t'i paguhet një shumë e përgjithshme, lartësia e të cilit do të caktohet sipas lartësisë së rentës dhe kohëzgjatjes së mundshme të jetës së kreditorit, me zbritje të kamatave përkatëse. Ndërsa në paragrafin 5, që për shkaqe serioze kreditori mundet edhe në raste të tjera të kërkojë menjëherë ose më vonë, që në vend të rentës t'i paguhet një shumë e përgjithshme. Këto dispozita janë përjashtim dhe aplikohen vetëm nëse ekziston rreziku që më vonë nuk mund ta realizojë kërkesën kreditori. Në gjykatat e shkallës së parë kemi raste të shpeshta që këto dispozita aplikohen në mënyrë të gabuar, duke gjykuar rentën në formë të kapitalizuar, pa plotësimin e kushteve sipas kësaj dispozite.

<sup>13</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978, e ka rregulluar me nenin 188.

### 8.2.7 Dëmi real dhe fitimi i humbur

*Neni 173, i LMD-së<sup>14</sup>*

1. *I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur.*
2. *Lartësia e shpërblimit të dëmit caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse me ligj parashihet diçka tjetër.*
3. *Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që ta ndër marrë veprimin.*
4. *Kur sendi është shkatërruar ose dëmtuar me vepër penale të kryer me dashje, gjykata mund ta caktojë lartësinë e shpërblimit sipas vlerave që ka pasur sendi për të dëmtuarin.*

Sipas kësaj dispozite lartësia e dëmit caktohet duke pasur parasysh kriterin objektiv dhe subjektiv. Kriteri objektiv ka të bëjë me vlerësimin e dëmshpërblimit sipas vlerës reale në treg të të mirës së dëmtuar në momentin e nxjerrjes së aktgjykimit, kurse kriteri subjektiv gjen shprehje tek rastet kur dëmi material është shkaktuar me vepër penale me dashje, në këtë rast gjykata mund të caktojë lartësinë e dëmshpërblimit sipas vlerës që ka pasur sendi për të dëmtuarin. Nëse vlerësimi i dëmit bëhet sipas kriterit subjektiv atëherë sigurisht se lartësia e dëmshpërblimit do të jetë më e madhe se çmimi real i tregut që do të kishte dëmshpërblimi eventual.

### 8.2.8 Shpërblimi i plotë

*Neni 174, i LMD-së<sup>15</sup>*

*Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të silllet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim.*

Me këtë dispozitë ligjvënësi në mënyrë të përgjithësuar ka përcaktuar obligimin e gjykatave që me rastin e marrjes së vendimit të kenë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret për të marrë një vendim që gjendja materiale e të dëmtuarit të silllet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim. Gjykatat në vërtetimin e kësaj gjendjeje duhet t'u kushtojnë më shumë vëmendje provave materiale, dhe t'i detyrojnë palët që pretendimet të cilat i kanë t'i mbështesin në prova konkrete, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet deri tek realizimi i kësaj dispozite.

---

<sup>14</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978, e ka rregulluar me nenin 189.

<sup>15</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978, e ka rregulluar me nenin 190.

### 8.2.9 Përgjegjësia e ndarë

*Neni 176, i LMD-së<sup>16</sup>*

1. *I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar.*
2. *Për paragrafin paraprak vihen përshatshmërisht në zbatim dispozitat për përgjegjësinë për përfaqësuesin ligjor dhe ndihmësin.*
3. *Kur është e pamundur të vërtetohet se cila pjesë e dëmit rezulton nga veprimi i të dëmtuarit, gjykata do ta gjykojë shpërblimin duke pasur parasysh rrethanat e rastit.*
4. *Dëmtuesi dhe i dëmtuari e mbajnë barrën e provës për kontributin e atij tjetrit në shkaktimin dhe për kauzalitetin e këtij kontributi për dëmin dhe lartësinë e tij.*

Qëllimi i kësaj dispozite është që askush të mos përgjigjet jashtë përgjegjësisë së vet, por kur është e pamundur të vërtetohet se cila pjesë e dëmit rezulton nga veprimi i të dëmtuarit, gjykata do ta caktojë shpërblimin duke pasur parasysh rrethanat e rastit. Këto kritere vlejné edhe për përgjegjësinë e përfaqësuesit ligjor dhe ndihmësin. Dëmtuesi dhe i dëmtuari mbajnë barrën e provës për kontributin e tjetrit në shkaktimin dhe për kauzalitetin e këtij kontributi për dëmin dhe lartësinë e tij, që do të thotë se të njëjtit në një formë duhet ta vërtetojnë pafajësinë e tyre, apo kontributin e tyre sa më të vogël në shkaktimin e dëmit, si dhe të provojnë se dëmi është shkaktuar me fajësinë e tjetrit, apo se pikërisht veprimet apo mosveprimet e tjetrit i kanë sjellë pasojat e dëmshme, nga të cilat është shkaktuar dëmi.

### 8.2.10 Humbja e fitimit dhe shpenzimet e mjekimit dhe të varrosjes

*Neni 177 i LMD-së<sup>17</sup>*

- 1 *Kush shkakton vdekjen e ndokujt ka për detyrë që t'i shpërblejë shpenzimet e zakonshme të varrimit të tij.*
2. *Ai ka për detyrë t'i shpërblejë edhe shpenzimet e mjekimit të tij nga lëndimet e marra dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me mjekimin dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë.*

Kjo dispozitë ka për qëllim që të dëmtuarve t'ua sigurojë dëmshpërblimin për shpenzimet e zakonshme të varrimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme, e që gjen zbatim të shpeshtë në praktikë, sidomos në rastet e aksidenteve me fatalitet, të cilat për fat të keq janë në numër të madh. Ligjvënësi ka përdorur fjalën “shpenzimet e zakonshme të varrimit” dhe shpenzimet e tjera të nevojshme” dhe gjykatat kanë për obligim që me rastin e aplikimit të kësaj dispozite të vlerësojnë çka përbën të zakonshmen dhe çka përbën të nevojshmen në secilin rast konkret, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, siç janë përmbushja e riteve fetare dhe zakonore, etj, për këtë formë të dëmit vendimi i gjykatës duhet të bazohet në prova konkrete, se shpenzimet janë kryer, veçanërisht kur është fjala për shpenzimet e mjekimit, pasi që në shumë raste këto shpenzime aprovohen edhe pa e vërtetuar me prova se shpenzimet janë kryer.

---

<sup>16</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978, e ka rregulluar me nenin 192.

<sup>17</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978, e ka rregulluar me nenin 193.

### **8.2.11 E drejta e personit të cilin e ka ushqyer i vdekuri**

*Neni 178, i LMD-së<sup>18</sup>*

1. *Personi, të cilin e ka ushqyer ose e ka ndihmuar rregullisht personi që i është shkaktuar vdekja si dhe ai që sipas ligjit ka pasur të drejtë të kërkojë ushqim nga personi, të cilit i është shkaktuar vdekja ka të drejtë të shpërblimit të dëmit që pëson nga humbja e ushqimit ose e ndihmës.*
2. *Ky dëm shpërblehet me pagesën e rentës në të holla, shuma e së cilës caktohet duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, e që nuk mund të jetë më e madhe nga ajo që do të fitonte i dëmtuari nga personi të cilit i është shkaktuar vdekja po të mbetej gjallë.*

Qëllimi i kësaj dispozite është që personat që kanë përfituar mbajtje dhe ndihmë nga i vdekuri, të vazhdojnë që këtë ta përfitojnë sikur vdekja të mos ishte shkaktuar. Por pas vdekjes së mbajtësit, sipas kësaj dispozite, ky obligim i takon shkaktarit të dëmit. Gjykatat me rastin e gjykimit të këtyre kërkesave duhet të kenë kujdes se kush mund të jetë palë në procedurë dhe legjitimitetin duhet ta provojnë paditësit përmes provave, pasi në shumë raste nuk është e kontestueshme ndoshta që paditësit janë fëmijët e të vdekurit, por të njëjtit duhet të kenë moshën e mitur, apo t'i vazhdojnë studimet për të gëzuar të drejtën sipas kësaj dispozite.

### **8.2.12 Shpërblimi i dëmit në rast të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit**

*Neni 179 LMD-së<sup>19</sup>*

1. *Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë t'i shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.*
2. *Në qoftë se i lënduari për shkak të paaftësisë së plotë ose të pjesshme për punë e humb fitimin, ose nevojat janë shtuar vazhdimisht, ose mundësitë e zhvillimit dhe të përparimit të tij të mëtejshëm janë zhdukur ose janë pakësuar, personi përgjegjës ka për detyrë t'ia paguajë të lënduarit rentën e caktuar në të holla, si shpërblim për këtë dëm.*

Me këtë dispozitë ligjvënësi ka për qëllim që ta sigurojë të dëmtuarin që dëmi i shkaktuar t'i shpërblehet në tërësi, duke përfshirë përveç dëmit material tjetër edhe shpenzimet e mjekimit dhe në rast se për shkak të lëndimeve i dëmtuari nuk është në gjendje të punojë qoftë për një periudhë të caktuar apo të përhershme, t'i paguhet rentë varësisht nga shkalla e paaftësisë për punë. Gjykatat duhet me rastin e zbatimit të kësaj dispozite të kenë kujdes veçanërisht që me rastin e vendosjes sa i përket kërkesave për rentë të marrin mendimin e ekspertëve mjekësor kompetent për ta dhënë mendimin, dhe ekspertit të mbrojtjes në punë, në mënyrë që mendimi të jetë i plotë. Me rastin e nxjerrjes së ekspertizës financiare për ta përcaktuar shumën e rentës, duhet t'i kushtohet kujdes se cili ka qenë profesioni i të

---

<sup>18</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978, e ka rregulluar me nenin 194.

<sup>19</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978, e ka rregulluar me nenin 195.

vdekurit, sa ka realizuar të ardhura para vdekjes, dhe sa do të mund të realizonte po të ishte gjallë. Po ashtu, aktgjykimi sa i përket shpenzimeve të mjekimit duhet të mbështetet në prova – fatura, se shpenzimet e mjekimit vërtet kanë ndodhur. Ta marrë vlerësimin e ekspertit mjekësor me rastin e dëgjimit nëse faturat e prezantuara, kanë të bëjnë me barnat dhe përkojnë me lëndimet e marra nga aksidenti.

### 8.2.13 Ndryshimi i shpërblimit të gjykuar

*Neni 180, i LMD-së<sup>20</sup>*

*Gjykata mund me kërkesë të të dëmtuarit, që për të ardhmen ta rritë rentën, por mund me kërkesë të dëmtuesit ta zvogëlojë ose ta heq, në qoftë se kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme rrethanat të cilat gjykata i ka pasur parasysh me rastin e nxjerrjes së vendimit të mëparshëm.*

Bazuar në këtë dispozitë edhe i dëmtuari por edhe dëmtuesit kanë mundësinë të parashtrojnë kërkesën që të rishqyrtohet kërkesa për rentë, ndonëse çështja ka përfunduar me aktgjykim të formës së prerë, me rastin e parashtrimit të kërkesës pala pretenduese duhet të ofroj prova “*se kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme rrethanat të cilat gjykata i ka pasur parasysh me rastin e nxjerrjes së vendimit të mëparshëm*”. Çka përbën rrethanë të konsiderueshme të ndryshuar gjykata duhet në secilin rast konkret ta vlerësojë në bazë të provave të ofruara dhe varësisht nga besueshmëria e tyre të marrë edhe mendimin e ekspertëve që në mënyrë të plotë të vërtetojë nëse kemi të bëjmë me rrethanë të konsiderueshme të ndryshuar. Se cilat prova do të konsideroheshin relevante apo do ta bënin të besueshme varet prej rastit konkret, p.sh. nëse gjykatës i ofrohen prova me të cilat pretendohet se shkalla e pa aftësisë për punë është u rritur ashtu që kemi të bëjmë me pa aftësi të plotë të punës, ndonëse me aktgjykimin paraprak ka qenë vetëm e pjesshme pa aftësia për punë, në këtë rast gjykata përmes ekspertëve mjekësor varësisht nga natyra e lëndimeve, duhet të vërtetojë nëse kërkesa e paditësit është e bazuar.

## 8.3 SHPËRBLIMI I DËMIT JOMATERIAL

### 8.3.1 Shpërblimi në të holla

*Neni 183 i LMD-së<sup>21</sup>*

- 1. Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.*

---

<sup>20</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978, e ka rregulluar me nenin 196.

<sup>21</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978, e ka rregulluar me nenin 200.

2. *Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.*

Me këtë dispozitë ligjvënësi ka përfshirë po thuaj të gjitha format e shpërblimit të dëmit jo material që mund të shkaktohen, dhe për të ekzistuar bazueshmëria e kërkesës nuk kërkohet të ketë ekzistuar edhe dëmi material por pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material, si dhe nga mungesa e dëmit material. Kështu edhe LMD ka paraparë shpërblimin e dëmit ndaj personave fizik, përveç kur i cenohen të drejtat e karakterit pronësor, edhe me rastin e cenimit të vlerave personale. Kërkesat për këto forma të dëmit në gjykatat tona janë të shpeshta. Kjo dispozitë në shumë raste nuk zbatohet në mënyrë të drejtë, kryesisht për shkak të vërtetimit të gabuar por edhe jo të plotë të gjendjes faktike. Gjykata me rastin e shqyrtimit të kërkesave për shpërblimin e dëmit për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, duhet ta marrë parasysh intensitetin e dhimbjeve dhe frikës, si dhe kohëzgjatjes së tyre, të marrë parasysh vuajtjet e përjetuara, duke i vlerësuar të gjitha rrethanat e rastit konkret, për ta vlerësuar natyrën e lëndimeve të marra, intensitetin dhe kohëzgjatjen, shkallën e lëndimit apo shëmtimit, duhet të merret vlerësimi i ekspertit përkatës mjekësor.

### **8.3.2 Personat që kanë të drejtë shpërblimi në të holla në rast vdekjeje ose invaliditeti të rëndë**

*Neni 184 të LMD-së<sup>22</sup>*

1. *Në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t'ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve) shpërblimin e drejtë në të holla për dhembjen e tyre shpirtërore.*
2. *Ky shpërblim mund t'ua caktohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftë se ndërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme.*
3. *Në rast të invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimit në shkallë të lartë të ndonjë personi, gjykata mund t'ia caktojë bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve shpërblimin e drejtë në të holla për dhembjet e tyre shpirtërore.*
4. *Shpërblimi nga paragrafi 1. dhe 3. i këtij neni mund t'i caktohet edhe bashkëshortit jashtë martesor, nëse ndërmjet tij dhe të vdekurit, përkatësisht të lënduarit ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme.*

Me këtë dispozitë është përcaktuar obligimi i dëmtuesit që përveç personit të cilit i shkaktohet dëmi të shpërblehen edhe anëtarët e familjes. Për bashkëshortin, fëmijët dhe prindërit nuk kërkohet ndonjë kusht në rastin e vdekjes së të afërmit të tyre, apo të invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimit në shkallë të lartë të ndonjë personi, ndërsa për vëllezërit dhe motrat kërkohet të vërtetohet që ndërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme. Çka nën kupton me bashkësi të vazhdueshme LMD nuk jep ndonjë sqarim, por nëse i marrim parasysh dispozitat e ligjit për familjen duhet të ekzistoj bashkësia faktike, të jetojnë në një bashkësi të përbashkët familjare.

---

<sup>22</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978, e ka rregulluar me nenin 201.



### 8.3.3 Trashëgimi dhe cedimi i kërkesës së shpërblimit të dëmit jo material

*Neni LMD-së<sup>23</sup>*

1. *Kërkesa e shpërblimit të dëmit jo material i kalon trashëgimitarit vetëm në qoftë se është caktuar me aktgjykim të formës së prerë ose me marrëveshje me shkrim.*
2. *Nën kushte të njëjta kjo kërkesë mund të jetë objekt cedimi, kompensimi dhe i përbarimit të dhunshëm.*

Bazuar në këtë dispozitë, për të kaluar një kërkesë e shpërblimit të dëmit jo material te trashëgimtarët, duhet të jetë e gjykuar me aktgjykim të formës së prerë ose me marrëveshje me shkrim. Kjo do të thotë, se në rastin kur aktgjykimi nuk ka marrë formën e prerë apo nuk ka marrëveshje me shkrim për shpërblimin e dëmit, kërkesat për shpërblimin e dëmit jo material nuk mund të barten te trashëgimtarët. Nëse gjatë procedurës apo pa filluar procedura vdes i dëmtuari, trashëgimtarët nuk mund të vazhdojnë procedurën apo të parashtrajnë padi për shpërblimin e dëmit jo material. Mirëpo nga përmbajtja e së njëjtës dispozitë ligjore rezulton edhe e drejta e trashëgimtarit të dëmtuarit, si e drejtë e pa cenueshme e trashëgimit dhe realizimit të saj edhe në procedurë përbaruese, të shpërblimit të dëmit jo material, vetëm atëherë kur në momentin e vdekjes së të dëmtuarit, lidhur me këtë të drejtë, shpërblimi është vendosur me aktgjykim të formës së prerë ose me marrëveshje me shkrim të arritur ndërmjet të dëmtuarit dhe personit përgjegjës për shpërblimin e dëmit.

### 8.3.4 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit në zbatimin e dispozitave për nxjerrjen e aktgjyqimeve për shpërblimin e dëmit material dhe jo material

Me vetë faktin se të dëmtuarit i shkaktohet dëmi, krijohet marrëdhënia e detyrimit dhe më këtë rast krijohet detyrimi i dëmtuesit për shpërblimin e dëmit ndaj të dëmtuarit dhe e drejta e të dëmtuarit për kërkesën për shpërblim. LMD në nenin 137 ka dhënë definicionin e dëmit, ku është përcaktuar “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi ndaj tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”.

Në shumicën e rasteve shkaktimi i dëmit bëhet me veprim ose mosveprim. Por, ekzistojnë raste kur një person ka shkakuar dëmin, e për atë përgjigjet ndonjë person tjetër, këto janë rastet e përgjegjësisë për të tjerët (prindërit për të miturit, personat juridik për organet e veta apo punëtorët e vet). Po ashtu, dëmin mund ta shkaktojnë edhe sendet, për këtë lloj dëmi përgjigjet përdoruesi apo pronari i sendeve.

Gjatë gjykimit të çështjeve për shpërblimin e dëmit material dhe jo material shpesh hasim në aktgjyqime të cilat janë nxjerrë me shkelje esenciale të ligjit të procedurës kontestimore, me vërtetim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe me aplikim të gabuar të drejtës materiale. Ne do të fokusohemi te vërtetimi i gjendjes faktike në kontestet për shpërblimin e dëmit material dhe jo material, kryesisht tek mënyra e të provuarit, nxjerrja e ekspertizës, zbatimi i së drejtës materiale kryesisht tek caktimi i lartësisë së shpërblimit të dëmit.

---

<sup>23</sup> Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978, e ka rregulluar me nenin 204.

**Vërtetimi i gjendjes faktike** - Gjykata e Apelit gjatë praktikës së saj ka hasur në shumë raste kur me rastin e shqyrtimit të kërkesave për shpërblimin e dëmit, në të cilat gjatë procedurës në gjykatat e shkallës së parë nuk e kanë vërtetuar në tërësi gjendjen faktike. Mosvërtetimi i gjendjes faktike kryesisht konsiston në mosvërtetimin e fakteve vendimtare të cilat kanë të bëjnë me vërtetimin e përgjegjësisë së palës së paditur për shpërblimin e dëmit. Në disa raste gjykatat e shkallës së parë kanë vendosur lidhur me kërkesë-padinë, ndonëse pala e paditur ka kontestuar bazën e kërkesë-padisë, dhe përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar, pa nxjerrjen e provave me të cilat vërtetohet baza e kërkesë-padisë, apo nëse nga provat nuk mund të vërtetohet në mënyrë të padyshimtë, të nxjerret prova përmes ekspertizës përkatëse. Në shumë raste është anuluar aktgjykimi i shkallës së parë pikërisht për faktin, se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në tërësi gjendjen faktike, lidhur me përgjegjësinë e të paditurës për shpërblimin e dëmit.

Secili paditës ka për obligim që me rastin e parashtrimit të padisë, të parashtrojë faktet dhe provat që i mbështesin këto fakte, të cilat e bëjnë të bazuar bazën e kërkesë-padisë. Në rastin kur palët pretendojnë të drejtën e tyre në prova, por të njëjtat nuk i ofrojnë gjykatës, është obligim i gjyqtarit që ta obligojë që të njëjtat t'i sigurojë për gjykatën dhe palën kundërshtare. Kjo me qëllim që gjendja faktike të vërtetohet në mënyrë të tërësishme, mendimi i shprehur, dhe që dominon tek shumë gjyqtarë që gjykata nuk mund të ketë rol aktiv, dhe se në rastin e marrjes së rolit aktiv gjykata e shkel parimin e paanësisë. Ky mendim nuk mund të qëndrojë, në rastet kur palët i propozojnë provat por nuk i prezantojnë apo edhe e pretendojnë ndonjë fakt duke aluduar në ndonjë provë, por pa e prezantuar provën dhe pa e propozuar për administrim, por që ka rëndësi për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike. Në këto raste gjyqtari ka obligim që ta detyrojë palën që ta sigurojë të njëjtën provë, pasi edhe qëllimi i gjithë procedurës gjyqësore është gjetja e së vërtetës, apo aplikimi i drejtë i së drejtës materiale, e drejta materiale mund të aplikohet drejt vetëm kur gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë.

Mosvërtetimi i plotë i gjendjes faktike në rastet e shpërblimit të dëmit material, kryesisht konsiston në mosvërtetimin e bazës së kërkesë-padisë, apo në atë nëse i padituri është përgjegjës për dëmin e shkaktuar, baza e përgjegjësisë, është përcaktuar me nenin 136 të LMD. Ndërsa në rastet kur kemi të bëjmë me përgjegjësinë e ndarë të fajësisë lidhur me dëmin e shkaktuar, duhet të aplikohet neni 176, i LMD-së, apo neni 159 LMD-së, në rastet kur kemi të bëjmë me përgjegjësinë në rastet e aksidentit të shkaktuar nga mjetet motorike në lëvizje. Por në këto raste në aktgjykime nuk kemi vlerësim dhe arsyetim, se si është aplikuar e drejta materiale, respektivisht mungon arsyetimi sa i përket ndarjes së përgjegjësisë dhe kontributit të secilit pjesëmarrës në shkaktimin e dëmit, me rastin e vendosjes nuk arsyetohet nëse gjykata e ka vlerësuar kontributin e paditësit në shkaktimin e dëmit dhe nëse ky kontribut është llogaritur me rastin e aprovimit të kërkesë-padisë dhe gjykimin të lartësisë së dëmit.

### **8.3.5 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

**Aktvendimi AC.nr.1731/2013, i datës 27.10.2016**

#### **Arsyetimi**

*Gjykata e Apelit nuk mund ta pranojë vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshme, për arsye se, aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje*

*thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1, lidhur me nenin 8 të LPK-së, nenin 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së, vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe aplikim i gabuar i së drejtës materiale nga neni 184 të LPK-së, lidhur me nenin 185 të LMD-së.*

*Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit dhe administrimit të provave ka bërë edhe dëgjimin e dëshmitarëve Q\_\_\_ Sh\_\_\_ dhe V\_\_\_ Sh\_\_\_, në seancën e datës 07.03.2013, por të njëjtat deklarata në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar nuk janë arsyetuar dhe vlerësuar veç e veç apo të gjitha së bashku siç e përcakton neni 8 i LPK-së, që paraqet shkelje nga neni 182 paragrafi 1 të LPK-së.*

*Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar nuk ka dhënë arsye lidhur me atë mënyrën e vendosjes, nuk ka arsyetuar me asnjë fjalë të vetme pretendimet e palës së paditur. Kjo është në kundërshtim me nenin 160 paragrafi 4 të LPK-së, pasi është detyrë e gjykatës që në arsyetim të japë arsye lidhur me kërkesat e palëve, me faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po qe se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato, që nuk janë arsyetuar në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, të cilin e bën kontradiktor me vetveten dhe arsyet e aktgjykimit, për arsye se nuk janë arsyetuar faktet vendimtare që paraqet shkelje thelbësore nga neni 182.2 pika n) të LPK-së.*

*Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të arsyeve të dhëna në aktgjykimin e atakuar, si dhe pretendimeve të paraqitura nga palët, veçanërisht ajo e paditur, të cilat nuk janë marrë parasysh nga gjykata e shkallës së parë dhe nuk janë vlerësuar, konsideron se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë. Nga arsyetimi i dhënë në aktgjykimin e atakuar nuk mund të konkludojmë nëse objekti i rrënuar-garazha kishte karakter të përkohshëm apo të përhershëm, nëse paditësi ishte njoftuar se garazha e tij do të rrënohet dhe nëse i njëjti e kishte mundësinë që ta rrëronte në mënyrë vullnetare, brenda afatit të caktuar nga e paditura, po ashtu nga shkresat e lëndës nuk mund të konstatojmë nëse paditësi ka filluar ndonjë procedurë administrative për kundërshtimin e rrënimit të objektit-garazhës, që e bën që gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë, e që paraqet arsye të mjaftuar që aktgjykimi i atakuar të priset konform nenit 183 të LPK-së.*

*Gjykata po ashtu ka bërë aplikim të gabuar të dispozitës së nenit 185 të LMD-së<sup>24</sup>, në bazë të cilës ka obliguar të paditurën që t'ia kompensoj dëmin paditësit si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, pasi aplikimi i kësaj dispozite është bërë pa e vërtetuar përgjegjësinë e palës së paditur për dëmin e pretenduar, respektivisht gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar përgjegjësinë e të paditurës për dëmin, nuk ka vërtetuar faktin nëse e paditura dëmin e ka shkaktuar duke vepruar brenda përgjegjësisë dhe autorizimeve të saj të përcaktuara me norma ligjore, që nëse të njëjtin e ka rrënuar brenda autorizimeve dhe normave nuk kemi të bëjmë me përgjegjësi të paditurës. Në rast të kundërt, nëse e paditura nuk ka vepruar në përputhje me normat në fuqi dhe në kuadër të autorizimeve, por në kundërshtim me normat dhe autorizimet që ka pasur mund të lind përgjegjësia për kompensim të dëmit të shkaktuar me veprimet e saj të paligjshme, por nga shkresat e lëndës*

---

<sup>24</sup> LMD-së-ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978.

*dhe provat e administruara nuk mund të vërtetohet ky fakt. Nga arsytet e dhëna me lartë është dashur që aktgjykimi i atakuar të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim.*

**Ekspertiza si formë e të provuarit** - Në momentin e kontestimit të bazës së kërkesë-padisë, e nga provat të cilat janë propozuar apo administruar, nuk del themelësia e kërkesë-padisë, ndërsa themelësia e kërkesë-padisë, duhet të provohet përmes ekspertizës. Gjykata në këto raste edhe sipas detyrës zyrtare duhet të caktojë ekspertizën si formë të të provuarit të gjendjes faktike (është obligim ligjor). Në këto raste duhet të obligohet pala paditëse që të deponojë shumën e mjeteve monetare të cilat do të shërbenin për mbulimin e shpenzimeve të ekspertizës, në rast se pala paditëse apo pala e cila është obliguar ta deponojë shumën, nuk vepron sipas urdhërit të gjykatës për deponimin e mjeteve, gjykata do ta konsiderojë se pala ka hequr dorë nga administrimi i provës përmes nxjerrjes së ekspertizës, dhe me rastin e vlerësimit të provave, do të vlerësohet edhe kjo rrethanë, ashtu që nëse themelësia e kërkesë-padisë nuk mund të vërtetohet nga provat tjera, kërkesë-padia do të refuzohet, kjo vlen sidomos në rastet kur kemi të bëjmë me rastet kur ndoshta mund të vërtetohet ekzistimi i përgjegjësisë së palës së paditur, për shpërblimin e dëmit, por me asnjë provë nuk është provuar lartësia e dëmit, apo është provuar me fatura të lëshuara nga personat e tretë, të cilat kontestohen nga pala e paditur, në momentin e kontestimit faturat nuk mund të paraqesin provë në të cilat mund të mbështetet vendosja në aktgjykim, përveç nëse vërtetësia e të njëjtave provohet me prova tjera.

Në shumë raste në gjykata vendoset për shpërblimin e dëmit, për dëmin e pësuar në aksident të komunikacionit, edhe pse nuk ka pasur një ekspertizë të komunikacionit me të cilën do të përcaktohej nëse i siguruari tek e paditura është përgjegjës për shkaktimin e aksidentit - dëmit, nga e cila edhe do të rrjedhë edhe obligimi për shpërblimin e dëmit për të paditurën, në këto raste edhe nëse ekziston aktgjykimi i formës së prerë në çështjen penale, ku është shpallur fajtorë i siguruari te i padituri, por i padituri konteston përgjegjësinë ekskluzive të të siguarit të saj, për shkaktimin e aksidentit dhe thirret në përgjegjësinë e ndarë në shkaktimin e aksidentit, gjykata ka obligim që ta caktojë nxjerrjen e provës përmes ekspertizës edhe nëse këtë nuk e ka propozuar pala e paditur, me rastin e caktimit të ekspertizës në këto raste shpenzimet i bartë pala e paditur, dhe në rast se njëjta nuk e bën deponimin e mjeteve monetare sipas urdhërit të gjykatës, do të konsiderohet se ka hequr dorë nga administrimi i kësaj prove.

Të provuarit përmes ekspertizës duhet ta ketë qëllimin e vërtetimit të plotë të fakteve për të cilat është caktuar ekspertiza. Ekspertizat në shumë raste edhe kur caktohen shpeshherë janë të mangëta, nuk sqarohen faktet vendimtare, nuk kanë arsye bindëse, ekspertët nuk ftohen në seancë për t'ua mundësuar palëve që drejtpërdrejt të parashtrajnë pyetje dhe të kërkojnë sqarime, madje edhe në raste ku ka paqartësi në ekspertizat e nxjerra, po ashtu gjyqtarët me rastin e dhënies së detyrës së ekspertizës nuk marrin aktvendim të veçantë për caktimin e ekspertit përkatës gjë që është detyra e ekspertit me rastin e përgatitjes së ekspertizës, nuk i tërhiqet vërejtja për detyrimet ligjore të ekspertit.

Gjyqtarët me rastin e caktimit të ekspertit kanë obligim që t'i caktojnë në mënyrë të saktë gjë që është detyra e ekspertit, sa herë konstatojnë që ekspertiza nuk është e plotë ta kthejnë të njëjtën në plotësim dhe përmirësim, me rastin e dëgjimit të ekspertit në seancë të kenë rol aktiv duke i parashtruar pyetje dhe duke kërkuar sqarime, se ku i mbështesin të dhënat apo përfundimet si në ekspertizë. Gjyqtari në rast se ekspertiza nuk është e plotë dhe nuk mund të plotësohet nga eksperti i caktuar, ashtu që gjendja faktike ka mbetur e pa vërtetuar, edhe

sipas detyrës zyrtare ka për obligim që të caktojë ekspert tjetër apo grup ekspertësh, me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, lidhur me shpenzimet të cilat krijohen lidhur me këtë ekspertizë, ta obligojë që paraprakisht t'i paguajë paditësi, nëse paditësi nuk i paguan konsiderohet se ka hequr dorë nga administrimi i kësaj prove dhe kjo rrethanë vlerësohet në dëmin e tij.

Gjithashtu me rastin e caktimit të ekspertëve duhet të merret parasysh, fakti se çka është objekt i ekspertimit, dhe të caktohet eksperti kompetent për ta dhënë mendimin, shpeshherë sidomos te ekspertizat mjekësore në rastet e shpërblimit të dëmit jo material, caktohen ortopedi dhe psikiatri për dhënien e mendimit, por që në raste të caktuara ortopedi nuk është i thirrur të japë mendimin për disa lloje të lëndimeve, pasi që kjo shkon përtej dijes së tij profesionale, në këto raste nëse gjyqtari ka dilema nëse mund ta japë mendimin ortopedi për të gjitha natyrat e lëndimeve, mund të kërkoj edhe nga vetë eksperti që të deklarohet nëse i njëjti është i thirrur apo kush mund të japë mendimin për llojin e caktuar të lëndimit. Gjithashtu mendimi i ekspertëve mjekësor duhet të merret edhe sa i përket faturave të ofruara nga pala, sa i përket shpenzimeve mjekësore apo të ushqimit të përforcuar, dhe nëse të njëjtat fatura kanë të bëjnë me shpenzimet e mjekimit apo ushqimit të përforcuar, sa i përket trajtimit të lëndimeve të marra për të cilat udhëhiqet procedura për shpërblimin e dëmit.

**Aktvendimi AC.nr. 1817/2013, i datës 16.01.2017**

### **Arsyetimi**

*Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit e Kosovës tani për tani nuk mund të pranojë një qëndrim të tillë juridik të gjykatës së shkallës së parë, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate rezulton se aktgjykimi i ankimuar si shkak i vërtetimit jo të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike është marrë me aplikim të gabuar të së drejtës materiale, si dhe është përfshirë edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) të LPK-së, për të cilat arsye në rastin konkret nuk ka kushte që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet nga kjo gjykatë, prandaj është dashur që i njëjti aktgjykim të prishet dhe çështja të kthehet në rivendosje të sërishme.*

*Në rast se i referohemi mendimit profesional të dhënë më datë 05.03.2011 nga ana e ekspertëve mjekësor nga lëmi i ortopedisë dhe psikiatrisë, punuar nga Dr. Fahri Drevinja, psikiatër dhe Dr. Gani Jashanica, ortoped si dhe mendimit profesional të dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur më datë 20.06.2011 nga ana e ekspertit të okulistikës, Dr. Agim Xhafa, mendimit të të cilëve ekspertë gjykata e shkallës së parë ua ka falur në tërësi besimin sa i përket vërtetimit të lartësisë së kërkesë-padisë rreth natyrës së lëndimeve trupore, frikës dhe shëmtimit-dëmtimit të shqisës së shikimit të cilat i kishte pësuar paditësi në aksidentin e ndodhur, qartë konstatohet se këta ekspertë mjekësor mendimin e tyre profesional të dhënë e kanë bazuar vetëm në dokumentacionin mjekësor nga shkresat e lëndës të cilin paditësi e kishte bashkangjitur me rastin e ushtrimit të padisë, pa pasur mundësi që ata personalisht të bëjnë ekzaminimin klinik-fizik të paditësit, për të cilin në bazë të shkresave të lëndës rezulton se momentalisht jeton jashtë vendit.*

*Qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me faljen e besimit në tërësi mendimit të dhënë nga ana e ekspertëve mjekësor nga lëmi i ortopedisë, psikiatrisë dhe okulistikës, tani për tani nuk e përkrah si të rregullt gjykata ankimore, pasi që kjo gjykatë vlerëson se pa*

ekzaminimin e drejtpërdrejtë klinik-fizik të paditësit nga ana e ekspertëve mjekësor, ka qenë e pamundur që të vërtetohet saktë dhe në mënyrë të drejtë dhe objektive natyra e lëndimeve të cilat i kishte pësuar paditësi në aksidentin e ndodhur, frika e përjetuar dhe natyra e lëndimit të tij sa i përket dëmtimit të shqisës së shikimit, aq me shumë kur kihet edhe parasysh fakti se në rastin konkret mendimin nga lëmi i okulistikës lidhur me natyrën e lëndimit të shqisës së shikimit e ka dhënë i njëjti ekspert për të cilin në bazë të shkresave të lëndës rezultoi ta ketë mjekuar paditësin më herët lidhur me këtë natyrë të lëndimit, me çka mendimi i tij në aspektin ligjor për palët ne procedurë por edhe për gjykatën do të trajtohej si jo objektiv. Mbi bazën e një rrethane të tillë sipas vlerësimit të kësaj gjykate kemi të bëjmë më vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ku si shkak ka pasur edhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale më rastin e marrjes se aktgjykimit të ankimuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Aktgjykimi i ankimuar gjithashtu rezultoi te jetë përfshirë edhe me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) të LPK-së, për faktin se arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar është në kundërshtim me dokumentet dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Në rast se i referohemi mendimit profesional të dhënë më datë 05.03.2011, nga ana e ekspertëve mjekësor nga lëmi i ortopedisë dhe psikiatrisë, punuar nga Dr. Fahri Drevinja, psikiatër dhe Dr. Gani Jashanica, ortoped si dhe mendimit profesional të dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur më datë 20.06.2011 nga ana e ekspertit të okulistikës, Dr. Agim Xhafa, qartë konstatohet se këta ekspert mjekësor mendimin e tyre profesional e kanë dhënë duke u bazuar vetëm në dokumentacionin mjekësor nga shkresat e lëndës pa bërë ekzaminimin klinik-fizik të paditësit. Ndërsa gjykata përkundër një fakti të tillë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, faqja e dytë pasusi i fundit duke iu referuar mendimit të ekspertëve mjekësor për vërtetimin e lartësisë së kërkesë-padisë ka theksuar, citoj “Të njëjtit pas ekzaminimit të paditëses kanë ardhur në përfundim se paditësja në aksidentin e komunikacionit të datës 21.04.2006 ka pësuar lëndime të lehta trupore shoqëruar më dëmtim të përkohshëm të shëndetit” me çka sipas vlerësimit të kësaj gjykate një konstatim i tillë bërë nga gjykata e shkallës së parë është në kundërshtim të plotë më vet atë çka kanë theksuar dhe potencuar ekspertët mjekësor në mendimin e tyre profesional të dhënë me shkrim, me çka mbi bazën e një të metë të tillë aktgjykimi i ankimuar në vetvete bëhet i pa ekzaminueshëm dhe kontradiktor.

## **Aktvendimi AC.nr.1894/2013, i datës 11.11.2016**

### **Arsyetimi**

Gjykata e Apelit ka ardhur në përfundim të tillë, se vendosja si në aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, kjo gjykatë tani për tani nuk mund ta pranojë, si të drejtë pasi që aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 lidhur me nenin 356 të LPK-së, kjo konsiston në faktin se gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesë-padinë e paditëses si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar dhe pjesën tjetër përtej asaj të gjykuar e ka refuzuar si të pabazuar, pa e vërtetuar bazën e kërkesë-padisë-pa e kryer ekspertizën nga ana e ekspertit të komunikacionit, e cila është paraparë në dispozitivin e nenit 356 të LPK-së në të cilën parashihet, “gjykata me propozimin e palëve mund të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes”, e duke e komentuar këtë

*dispozitë ligjore gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes, ka vendosur në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore.*

*Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në riprocedurë të evitojë të metat e sipërpërmendura, ashtu që e njëjta duhet të veprojë konformë dispozitës së nenit 356 të LPK-së, gjegjësisht duhet ta kryejë ekspertizën nga ana e ekspertit të komunikacionit, pasi që edhe është pretendim ankimor i palës së paditur, ashtu që pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, të fakteve dhe rrethanave të sipërpërmendura të marrë vendim të drejtë, meritohet dhe të bazuar në ligj.*

### **Aktvendimi AC. nr.1635/2013 i datës 03.11.2016**

#### **Arsyetimi**

*Kolegji në bazë të gjendjes në shkresa të lëndës, konstaton se në pjesën ndryshuese dhe vërtetuese të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë gjatë zbatimit të procedurës kontestimore, nuk ka bërë shkelje thelbësore, të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 par.2 nën par. b),g),j),k) dhe m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as shkelje tjera procedurale të specifikuar në nenin 197 të LPK.*

*Nga shkresat në lëndë rezulton se gjykata e shkallës së parë për vërtetimin e gjendjes faktike në seancat për shqyrtimin kryesor të çështjes i kishte marrë provat e përshkruara në procesverbalet e seancave gjyqësore për shqyrtimin e çështjes, dhe ka konstatuar gjendjen faktike të përmbajtur në arsyetimin e aktgjykimit ankimor, si vijon:*

*Me dt. 03.07.2010 në rrugën magjistrale Prishtinë – Ferizaj, në fshatin Përlez i Jerlive, kishte ndodhur një aksident komunikacioni, si pasojë e të cilit ka humbur jetën familjari i paditësve, tani i ndjeri E.... G..... Prokuroria Publike e Qarkut, më dt. 31.08.2010, kishte ngritur aktakuzën PP.nr. 402-3/2010 ndaj të sigurvearit të të paditurës, i cili ditën kritike drejtonte automjetin transportues Mercedes Benz 308, duke mos iu përshtatur rregullave të komunikacionit dhe kushteve të vështirësuar të rrugës, ashtu që godet automjetit VW Passat, si dhe familjarin tani të ndjerë të paditësve. Pra, aksidenti ishte shkaktuar me fajin e të sigurvearit të të paditurës.*

*Paditësit, me të ndjerin kanë qenë në raporte familjare (nënë, bashkëshorte, fëmijë, vëlla) dhe si pasojë e humbjes së familjarit të tyre, kanë pësuar dhembje shpirtërore si dhe dëme materiale. Gjykata kishte caktuar shumat për kompensim ndaj paditësve të cilat e paditura ishte detyruar që t'ua kompensoj, duke vlerësuar se janë përmbushur kërkesat ligjore nga neni 201 par.1 e 2 të LMD. Ndërsa sa i përket shpërblimit të dëmit material gjykata ka gjykuar shumat për kompensim në emër të shpenzimeve për varrim si dhe për ngritjen e përmendores.*

*Pretendimet ankimore: Përfaqësuesi i të paditurës F..... M., në ankesën e paraqitur ka pohuar se procedura penale nuk ka përfunduar ndaj shkaktuesve të aksidentit në komunikacion, gjykata e shkallës së parë është dashur të ndërpresë procedurën kontestimore deri në përfundimin e procedurës penale me vendim të formës së prerë. Shumat e gjykuara në emër të shpërblimit të dëmit jo material janë të larta dhe*

*përfaqësojnë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, nuk janë në përputhje me praktikën gjyqësore.*

*Gjithashtu ka pohuar se kompensimi material në emër të mbajtjes së caktuar në formë të rentës së kapitalizuar në këtë rast nuk është i bazuar në ligj, duke pohuar se paditësja, bashkëshortja e të ndjerit, nuk ka dëshmuar se është e paaftë për punë. Gjykata nuk ka konstatuar me fakte dhe prova se cili ishte kontributi i të ndjerit në buxhetin familjar para aksidentit, por kontributi është caktuar në mënyrë paushallë.*

*Përfaqësuesi i të paditurës, në ankesën e paraqitur nuk ka paraqitur fakte e as prova të reja.*

*Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe plotësisht ka konstatuar gjendjen faktike për faktet relevante se: paditësja F..... A.....nga Ferizaj, ishte në bashkësi jashtë martesore me tani të ndjerin, ndërsa paditësit D..., E..... dhe E..... G..... ishin fëmijët e tani të ndjerit, ndërsa paditësja Z.... G..... ishte nëna e të ndjerit.*

*Paditësit D....., A..... dhe E..... G..... ishin vëllezërit përkatësisht motra e tani të ndjerit, të cilët kishin bashkëjetesë të vazhdueshme me vëllain e tyre tani të ndjerë. Paditësit si pasojë e humbjes së familjarit të tyre, kishin përjetuar dhembje shpirtërore, si pasojë e shuarjes së marrëdhënieve prindërore dhe familjare, e që për pasojë kanë shkëlqen e të drejtave jo pasurore që lidhen me personalitetin e paditësve, cilësia e jetës, paprekshmëria e familjes dhe solidariteti reciprok.*

*Pretendimet ankimore të përfaqësuesit të paditësve: Në raport me shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material në këtë rast janë pjesërisht të bazuara sepse gjykata e shkallës së parë ka gjykuar për kompensim shuma më të ulëta në krahasim me praktikën gjyqësore të krijuar me rastin e gjykimit të rasteve të tilla, e që aktgjykimi ankimor në këtë rast është dhënë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.*

*Andaj, kolegji ka vlerësuar se janë krijuar kushtet ligjore nga neni 201 d) i LPK që aktgjykimi ankimor të ndryshohet për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe vendosi si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë, duke vlerësuar se shumat e gjykuara për kompensimin e dëmit jo material, të cilat e paditura ka për detyrë t'ua paguaj paditësve, janë në përputhje me dispozitën ligjore të nenit 201 par 1 e 2 të LMD si dhe me praktikën gjyqësore dhe se ato përfaqësojnë satisfaksion adekuat që paditësit më lehtë t'i përjetojnë dhembjet shpirtërore për vdekjen tragjike të familjarit të tyre, ndërsa baza ligjore e kompensimit të dëmit material në këtë rast buron nga neni 193 i LMD.*

*Legjitimiteti pasiv i të paditurës në këtë rast buron nga neni 919 i LMD me të cilin është përcaktuar: “Kur të ketë ndodhur rasti i siguruar, siguruasi ka për detyrë që ta paguajë shpërblimin ose shumën e caktuar...”*

*Pretendimi ankimor i përfaqësuesit të të paditurës se gjykata e shkallës së parë është dashur që në këtë rast të ndërpresë procedurën kontestimore, deri në përfundimin e procedurës penale, nuk është ligjërisht i detyrueshëm për gjykatën e shkallës së parë, gjatë procedimit të çështjes në procedurë kontestimore, por ajo ishte si mundësi ligjore. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka konstatuar*



*gjendjen faktike, duke marrë prova relevante të besueshme dhe të mjaftueshme, dhe ka konstatuar se kemi të bëjmë me përgjegjësi solidare të pjesëmarrësve në ngjarje aksidentale për dëmin që kanë pësuar personat e tretë, pra tani paditësit.*

*Kjo formë e përgjegjesisë është rregulluar me nenin 178 par 4 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (“Gazeta Zyrtare e ish RSFJ” Nr. 29/78), me të cilën është përcaktuar: “Për dëmin që kanë pësuar personat e tretë, zotëruesit e automjetit përgjigjen solidarisht”, por pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me sigurim të detyrueshëm nga auto përgjegjësia, ndërsa i siguruari i të paditurës ishte njëri nga shkaktarët e ngjarjes aksidentale, atëherë vijnë në shprehje rregullat e përgjegjesisë sipas sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia, përkatësisht neni 919 i LMD.*

*Ndërsa sa i përket vendimit të gjykatës së shkallës së parë, të dhënë në aktgjykimin ankimor që ka të bëjë me caktimin e kompensimit të dëmit në emër të mbajtjes për bashkëshorten, dhe fëmijët e të ndjerit, gjykata e shkallës së parë vendimin në këtë pjesë e ka dhënë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, sepse ka gjykuar shumën e kapitalizuar në emër të rentës pa hapur shqyrtim për të gjitha faktet vendimtare të cilat përcaktohen me Ligjin për Familjen, gjithashtu ka gjykuar shumën e kapitalizuar pa i vërtetuar faktet relevante në kuptim të nenit 188 par.3, 4 e 5 të LMD.*

*Pra, në këtë pjesë aktgjykimi ankimor është përfshirë me shkelje të dispozitave ligjore të nenit 197 h) të LPK, në prani të së cilës aktgjykimi ankimor në këtë pjesë duhet prishur dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.*

### **8.3.6 Caktimi i lartësisë së dëmit material**

Me rastin e gjykimit të lartësisë së dëmit material, gjykata duhet të marrë parasysh nenin 169 të LMD-së, në bazë të cilit shpërblimi i dëmit material duhet të ketë synim rivendosjen e gjendjes së mëparshme, ashtu që personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla, në ato raste kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t’ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. Gjykata do t’i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme. Në të shumtën e rasteve kërkesat për shpërblimin e dëmit paraqiten me kërkesën e shpërblimit në të holla, andaj edhe gjykatat janë të lidhura me kërkesën e palës, por nëse kemi ofertën e palës së paditur që dëmin ta mënjanoj duke ri vendos gjendjen e mëparshme, dhe kjo sipas rrethanave të rastit është e mundur, atëherë gjykata mund të urdhërojë vetëm kthimin në gjendjen e mëparshme, pasi qëllimi i shpërblimit të dëmit është eliminimi në tërësi i pasojave të dëmit të shkaktuar. Lartësia e shpërblimit të dëmit caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse me ligj parashihet diçka tjetër, që do të thotë se vlerësimi i lartësisë së dëmit dhe sendit të dëmtuar duhet të llogaritet në momentin e nxjerrjes së aktgjykimit. Përjashtim nga rregulla për dëmin material dhe qëllimin e kthimit në gjendjen e më parme, është rasti kur sendi është shkatërruar ose dëmtuar me vepër penale të kryer me dashje, gjykata mund të caktojë lartësinë e shpërblimit sipas vlerave që ka pasur sendi për të dëmtuarin, duke ikur nga parimi i kthimit në gjendjen e mëparshme. Çka paraqet vlerë që

ka pasur sendi për të dëmtuarin, është më shumë vlerësim i aspektit të lidhjes emocionale të pronarit me sendin e dëmtuar, andaj edhe në secilin rast vlerësohet në mënyrë të veçantë, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit.

Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmerret veprimin, çka paraqet pritje e bazuar sipas rrjedhës së rregullt të gjërave, duhet të vlerësohet në secilin rast konkret, për shembull nëse kemi të bëjmë me dëmtimin e një prone bujqësore, dhe pamundësimi i mbjelljes me kultura bujqësore, dëmi duhet të vlerësohet në bazë të asaj se sa do të prodhonte po të mbillej me kulturën bujqësore që është mbjellë zakonisht, natyrisht pasi të zbriten shpenzimet të cilat krijohen deri në produktin final.

Në praktikën gjyqësore të gjykatave specifike të veçantë paraqesin rastet e shpërblimit të dëmit sipas nenit 172 të LMD-së, ku janë paraparë shpërblimi në formë të rentës në të holla, në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit. Në këto raste shpërblimi caktohet, sipas rregullës, pagesa bëhet në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar, renta si rregull paguhet në të holla e gjykuar në emër të shpërblimit të dëmit dhe paguhet për çdo muaj përpara, në rastet kur ekziston rreziku i pamundësisë së realizimit të shpërblimit të dëmit në formë të rentës, kreditori ka të drejtë të kërkojë sigurim të nevojshëm për pagimin e rentës, përveç nëse kjo sipas rrethanave të rastit nuk do të ishte e arsyeshme. Në qoftë se debitori nuk e jep sigurimin të cilin e cakton gjykata, kreditori ka të drejtë të kërkojë që në vend të rentës t'i paguhet një shumë e përgjithshme, lartësia e të cilit do të caktohet sipas lartësisë së rentës dhe kohëzgjatjes së mundshme të jetës së kreditorit, me zbritje të kamatave përkatëse, apo renta e kapitalizuar, për shkaqe serioze kreditori mundet edhe në raste të tjera të kërkojë menjëherë ose më vonë, që në vend të rentës t'i paguhet një shumë e përgjithshme, kur themi shkaqe serioze duhet të mendohet në rrezikun evident-konkret që i kanoset kreditorit që atij i pamundëson realizimin e rentës, p.sh. siç është procedura para falimentimit e të paditurit. Renta e kapitalizuar duhet të jetë përjashtim, pos nëse arrihet marrëveshja për rentën e kapitalizuar. Në shumë raste gjykatat në mënyrë të gabuar gjykojnë rentën e kapitalizuar, për çka çështjet duhet të kthehen në rigjykim.

Zakonisht në kontestet e shpërblimit të dëmit në formë të rentës, problem paraqet caktimi i shumës së rentës, pasi sa i përket vërtetimit të përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit, vlejné të njëjtat dispozita sa i përket fajësisë për dëmin në përgjithësi.

Caktimi i lartësisë së rentës zakonisht përcaktohet përmes nxjerrjes së provës me ekspertizë, ekspertiza duhet të bazohet në faktin se cilat kanë qenë të ardhurat e personit të dëmtuar para aksidentit, nëse nuk ka qenë i punësuar para aksidentit duhet të merret parasysh përgatitja e tij profesionale, të ardhurat të cilat do të realizonte po të mos ndodhte aksidenti, në rastet kur i dëmtuari nuk është i punësuar as nuk ka pasur ndonjë përgatitje profesionale, duhet të llogaritet renta duke marrë parasysh të ardhurat mesatare për punëtorët e pa kualifikuar në vendin tonë, duke shfrytëzuar gjithmonë të dhënat zyrtare, siç janë të dhënat statistikore nga Enti i Statistikave, apo edhe të dhënat tjera zyrtare siç janë vendimi i Qeverisë për pagën minimale, etj.

Caktimi i shpërblimit të dëmit humbja e fitimit dhe shpenzimet e mjekimit dhe të varrosjes, siç i ka përcaktuar neni 177 i LMD-së, duhet të bëhet në bazë të faturave sa i përket shpenzimeve të mjekimit, kur kjo është e mundur edhe sa i përket shpenzimeve të varrosjes, Ligjvënësi ka përdorur fjalën “shpenzimet e zakonshme të varrimit” dhe shpenzimet e tjera të nevojshme” dhe gjykatat kanë për obligim që me rastin e aplikimit të kësaj dispozite të vlerësojnë çka përbën të zakonshmen dhe çka përbën të nevojshmen në secilin rast konkret, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, siç janë përmbushja e riteve fetare dhe zakonore, etj. Ndërsa sa i përket fitimit të humbur shpesh herë caktimi i lartësisë së shpërblimit të kësaj forme të dëmit është më i vështirë dhe nëse me anë të provave të pa kontestueshme, nuk mund të arrihet të provohet me saktësi sa është vlera e shpërblimit për fitimin e humbur, duhet të provohet përmes nxjerrjes së ekspertizës përkatëse varësisht nga ajo se çka është objekt i ekspertimit, caktohet edhe eksperti kompetent për vlerësim. Po kjo vlen edhe me rastin e shpërblimit të dëmit në rast të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, neni 179 LMD-së.

### **Aktgjykimi AC.nr.798/2013, i datës 09.08.2016**

#### **Arsyetimi**

*Gjykata e Apelit nuk e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar. Në këtë pjesë aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n), si dhe neni 183 të LPK-së, pasi dispozitivi është kontradiktor me arsyet e dhëna si në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, ku nuk është vërtetuar në tërësi gjendja faktike.*

*Gjykata e Apelit vlerëson sa i përket vendosjes si në pikën III të dispozitivit, ku është refuzuar kërkesë-padia së paditësit, me të cilën është kërkuar ti kompensohet dëmi material për shpenzimet e shërimit në të ardhmen në lartësi prej 4.700.00€, në emër të kujdesit të huaj në lartësi prej 900.00€ dhe për ushqim të përforcuar në lartësi prej 1,800€. Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye lidhur me refuzimin, por vetëm është deklaruar se paditësi me asnjë provë materiale nuk e ka dëshmuar lartësinë e shpenzimeve lidhur me marrjen e ushqimit vitaminoz, kujdesin e huaj dhe periudhën kohore sa ka zgjatuar kujdesi si dhe shpenzimet për operacione në të ardhmen.*

*Ndonëse nga shkresat e lëndës, në bazë të super ekspertizës të datës 19.11.2010, të punuar nga Dr. Xhemajl Selmani, Dr. Fatime Haxholli dhe Dr. Bujar Kastrati, të cilët në mendimin e tyre të dhënë kanë konstatuar se ndihma e huaj ka qenë e nevojshme për 6 muaj si dhe ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 12 muaj, për të cilin mendim nuk ka dhënë ndonjë arsye gjykata e shkallës së parë e cila nuk e ka marrë parasysh mundësinë ligjore në bazë të neni 323 të LPK-së, ku është përcaktuar: “po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që ti shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo një gjë e tillë do të mund të bëhet me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendos sipas çmuarjes së lirë”, që do të thotë se gjykata ka për obligim që të ftoj palët që të sigurojnë prova për dëmin e pësuar, por në rast se provat e tilla për shkak të natyrës dhe rrethanave është vështirë të sigurohen, gjykata dëmin mund ta vlerësojë në bazë të çmuarjes së lirë dhe praktikave të krijuara.*

Po ashtu gjykata e shkallës së parë me rastin e refuzimit të shpenzimeve të shërimin në lartësi prej 4.700 euro, nuk ka dhënë ndonjë arsye, ndërsa nga pretendimi ankimor i palës paditëse se nuk janë administruar provat nr. 19, 20, 48, 49, 50, 51 dhe 52, për të cilat aludon se kanë të bëjnë me ri operimin e bërë, të cilat prova gjykata e shkallës së dytë për shkak se janë cekur me numra, nuk e ka pasur të qartë se për cilat prova është fjala, si dhe nëse të njëjtat janë administruar apo jo në shkallën e parë, ndonëse gjenden në shkresat e lëndës, por për gjykatën nuk është e kjashtë të njëjtat kanë qenë me rastin e shqyrtimit dhe mbajtjes së seancës kryesore nga gjykata e shkallës së parë apo të njëjtat janë bashkëngjitur sipas ankesës, pasi për ta vërtetuar këtë fakt vështirësohet edhe nga fakti se si janë radhitur shkresat e lëndës dhe provat në shkresat e lëndës, andaj nga këto arsye çështja lidhur me këto forma të dëmit material është kthyer në rishqyrtim dhe rigjykim.

Gjykata e Apelit duke vendosur sipas pretendimeve ankimore të palës paditëse ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë në pikën I, që ka të bëjë me kërkesëçpadinë e paditësit për zvogëlimin e përgjithshëm të aktivitetit jetësor, ku sipas aktgjykimit të shkallës së parë paditësit i është njohur e drejta në shumën prej 8.000 euro, ndërsa është refuzuar në shumën prej 4.500 euro. Gjykata e Apelit duke vlerësuar të gjitha rrethanat ka vendosur që sa i përket zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, ka vendosur që ta pranojë në tërësi kërkesën e palës në shumën prej 12.500.00 euro, pasi nga super ekspertiza e datës 19.11.2010, të punuar nga Dr. Xhemajl Selmani, Dr. Fatime Haxholli dhe Dr. Bujar Kastrati, kemi të bëjmë me zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë me 62.5%, i cili zvogëlim konsiston në zvogëlim mjaft të lartë të aktivitetit jetësor dhe që realisht do të përfshinte pamundësimin e ushtrimit të shumë aktiviteteve të rregullta jetësore. Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes si në pikën dy të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën prej 12,500.00 euro, ka marr parasysh të mirën e dëmtuar, praktikën e krijuara lidhur me kompensimet e dëmeve, duke vendosur në bazë të nenit 323 të LPK-së, lidhur me nenin 178, 190 dhe 200 të LMD-së<sup>25</sup>.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.461/12 të datës 24.01.2013, si në pikën I. ku detyrohet e paditura K.S. "Insig", që paditësit H.....B....., në emër të dëmit jo material të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit të dt.26.02.2007, në fshatin Vojtesh, Komuna e Skenderajt, ti paguaj:- për dhembjet e përjetuara fizike, për të gjitha shkallët e intensitetit në shumën prej 4,900.00€, - për friken e përjetuar për të gjitha shkallët e intensitetit në shumën prej 2,400.00€ dhe - shëmtimin 2,000.00€. Si në pikën II. ku obligohet e paditura, që paditësit t'ia kompensoj dëmin material të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit të dt.26.02.2007, në fshatin Vojtesh, Komuna e Skenderajt, dhe atë:- shpenzimet e mjekimit dhe transportit në lartësi prej 346.00€, - shpenzimet e rehabilitimit klimatik në shumë prej 2.730.00€, - shpenzimet materiale lidhur me shërimin e mëtejshëm sipas faturave, në lartësi prej 3.618€, - fitimin e humbur (rentës) të arritur së bashku me kumatën në shumën prej 5,166.07€, duke llogaritur edhe kumatën prej 3.5%, nga data 26.02.2007, si datë e aksidentit të komunikacionit, e deri me datë 30.04.2011, si datë e përpilimit të ekspertizës aktuaristike.- Në emër të fitimit të humbur (rentës) në të ardhmen, shumën e të hollave nga 96.40€ në muaj, për periudhën kohore nga data 01.05.2011, e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, respektivisht deri me datë 02.12.2025, kur paditësi do të duhej të pensionohej sipas fuqisë ligjore, me mbushjen e moshës 65 vjeçare. Si në pikën III. ku detyrohet e paditura K.S. "Insig", që paditësit në emër të shpenzimeve kontestimore t'ua paguajnë shumën prej

---

<sup>25</sup> LMD-së-ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978.

2,089.00€. Si në pikën I. ku Refuzohet kërkesëpadia e paditësit H... B....., që paditura K.S. "Insig", si e pa bazuar, që në emër të dëmit jo material të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit të dt.26.02.2007, në fshatin Vojtesh, Komuna e Skenderajt ti paguaj:- për dhembjet e përjetuara fizike, për të gjitha shkallët e intensitetit në shumën prej 1,200.00€, - për friken e përjetuar për të gjitha shkallët e intensitetit në shumën prej 800.00€, vendimin i gjykatës së shkallës së parë në këtë pjesë të vërtetuar, nuk është përfshirë në shkëlqje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduar nga palët si dhe sipas nenit 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së dhe nuk kemi të bëjmë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale si dhe kemi të bëjmë me vërtetim të plotë të gjendjes faktike.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes duke i njohur paditësit për dhimbjet e përjetuara për të gjitha shkallët e intensitetit shumen prej 4.900 euro dhe refuzuar shumën prej 1.200 euro, ka vendosur në mënyrë të drejtë duke marr parasysh lëndimet e pësuar të paditësit në aksidentin e komunikacionit, të cilat lëndime sipas super ekspertizës mjekësore të datës 19.11.2010, të punuar nga Dr. Xhemajl Selmani, Dr. Fatime Haxholli dhe Dr. Bujar Kastrati, është vërtetuar fakti se lëndimet kanë qenë të rënda të cilat janë karakterizuar me ndrydhje të legenit, me thyerje të qafës së kockës së çapokut të djathtë dhe nxjerrje traumatike të nyjës së kërdhokullës së majtë e shoqëruar me thyerje në shumë fragmente të filgjanit të kofshës së majtë dhe thyerje të gazhdares së gjurit të djathtë si dhe ndrydhje të krahut të majtë, e si pasojë e këtyre lëndimeve paditësi ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 4 ore, të intensitetit të rëndë 10 ditë, të intensitetit të mesëm 60 ditë dhe të intensitetit të ulët në mënyrë të vazhdueshme, varësisht nga sforcimet fizike dhe ndërrimet e kushteve klimatike, në këtë ekspertizë nuk ka pasur ndonjë vërejtje nga palët ndërgjyqëse, andaj Gjykata e Apelit konsideron se vendosja sipas kësaj kërkesë nga ana e gjykatës së parë është një satisfaksion për paditësin për dhimbjet e përjetuara.

Gjykata e Apelit ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket kërkesës lidhur me frikën, ku për të gjitha shkallët e intensitetit të frikës paditësit i është aprovuar shuma prej 2.400 euro, ndërsa i është refuzuar shuma prej 800 euro, si vendosje e drejtë, duke marr parasysh lëndimet e marra të paditësit si dhe mendimin e dhënë nga eksperti Dr. Shkëlzen Kadriu, psikiatër-neurolog, të datës 21.11.2012, paditësi ka pësuar frikë primare të intensitetit të lartë 12 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm prej 3 muaj, frikë të intensitetit të lehtë në vazhdimësi, të cilën ekspertizë Gjykata e Apelit nuk e pranon sa i përket frikës primare në kohëzgjatje për 12 orë, pasi frika primare mund të ekzistoj në sekonda, por jo në një kohëzgjatje prej 12 orë, por duke marr se ka ekzistuar frika primare për disa sekonda, frika sekondare për 3 muaj dhe frika e intensitetit të ulët në mënyrë të vazhduar, vlerësojmë se vendosja nga gjykata e shkallës së parë ka qenë e drejtë.

Gjykata e shkallës së dytë ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë sa i përket kërkesës së palës paditëse lidhur me shëmtimin, ku është aprovuar kërkesa në shumën prej 2.000 euro, pasi duke marr për bazë super ekspertizën mjekësore të datës 19.11.2010, të punuar nga Dr. Xhemajl Selmani, Dr. Fatime Haxholli dhe Dr. Bujar Kastrati, në bazë të së cilës paditësi ka shëmtim trupor të shkallës së mesme, për shkak të vrazjës operate në kofshën e djathtë me gjatësi prej 17 cm, çalimit dhe ecjes me shkop si pasojë e dhimbjeve gjatë ecjes dhe kufizimit të lëvizjeve të kërdhokullave dhe hypotrofisë muskulare, është vlerësim i drejtë dhe një kompensim real për dëmin e pësuar.

*Gjykata e Apelit vlerëson se duke marr parasysh nenin 323 të LPK-së, si dhe nenet 178, 190 dhe 200 të LMD-së<sup>26</sup>, gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes për kompensimin e dëmit jo material ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe ka marr parasysh rëndësinë e shkëljes së të mirës dhe qëllimit që i shërben kompensimi. Sa i përket pretendimeve të palës paditëse lidhur me vlerat e vogla të aprovuara kjo gjykatë i konsideron si të pabazuara, të njëjtat pretendime nuk janë të argumentuara, po ashtu të pabazuara janë edhe pretendimet e palës së paditur se lartësia e dëmit të kompensuar është shumë e lartë, nga arsyet si më lartë.*

*Gjykata e Apelit me rastin e vërtetimit të aktgjykimit të shkallës së parë si në pikën II, lidhur me shpenzimet e mjekimit dhe transportit në lartësi prej 346.00€, shpenzimet e rehabilitimit klimatik në shumë prej 2.730.00€, shpenzimet materiale lidhur me shërimin e mëtejshëm sipas faturave, në lartësi prej 3.618€, ka vlerësuar se vendosja është e mbështetur në provat materiale-faturat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, lidhur me të cilat nuk ka pasur ndonjë kundërshtim as nga pala e paditur.*

*Gjykata e Apelit ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë sa i përket fitimit të humbur-rentës së arritur së bashku me kamatën në shumën prej 5,166.07€, duke llogaritur edhe kamatën prej 3.5%, nga data 26.02.2007, si datë e aksidentit të komunikacionit, e deri me datë 30.04.2011, si datë e përpilimit të ekspertizës aktuaristike, si dhe në emër të fitimit të humbur (rentës) në të ardhmen, shumën e të hollave nga 96.40€ në muaj, për periudhën kohore nga data 01.05.2011, e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, respektivisht deri me datë 02.12.2025, kur paditësi do të duhej të pensionohej sipas fuqisë ligjore, me mbushjen e moshës 65 vjeçare, pasi konsideron se ekspertiza aktuaristike e datës 18.04.2011, e punuar nga eksperti Aziz Berisha, është e plotë, ka marr për bazë të gjithë parametrat, faktin se aftësia punuese paditësit i është reduktuar në shkallën prej 35 %, faktet se i njëjti ka të kryer Fakultetin Ekonomik dhe në momentin e aksidentit ka qenë i punësuar në “Kompakt Group” shpk në Gjilan, si menaxher i marketingut, me pagë mujore bruto prej 300 euro, ndaj të njëjtës ekspertizë nuk ka pasur ndonjë vërejtje nga pala e paditur, e cila vërejtje do të vinte në dyshim validitetin e saj.*

*Gjykata e Apelit vlerëson se është i pabazuar pretendimi ankimor i palës paditëse se duhet të paguhet renta e kapitalizuar në forme të menjëhershme në shumë prej 11,167.00 euro, pasi për këtë nuk ekzistojnë arsyet nga neni 188 paragrafi 4 të LMD-së<sup>27</sup>, ndërsa pretendimi i palës së paditur se është aplikuar dhe njohur paditësit renta e kapitalizuar, është i pa bazuar pasi të njëjtit i është njohur vetëm renta e arritur deri në momentin e kryerjes së ekspertizës së aktuaristikës si dhe për të ardhmen në shumat mujore prej 96.40 euro.*

*Gjykata në lartësinë e aprovuar të shpërblimit të dëmit jo-material, paditësit ia ka njohur të drejtën në kamatën, si për mjetet e afatizuara në bankat komerciale në R. e Kosovës, për një vit pa destinim të caktuar, nga datë 24.01.2013, deri në pagesën përfundimtare, në kuptim të nenit 277 paragrafi 1 të LMD-së<sup>28</sup>.*

---

<sup>26</sup> LMD-së-ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978.

<sup>27</sup> LMD-së-ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978.

<sup>28</sup> Njejtë.

*Gjykata e Apelit ka vërtetuar vendimin e shkallës së parë, sa i përket shpenzimeve të procedurës, ku detyrohet e paditura K.S. "Insig", që paditësit në emër të shpenzimeve kontestimore t'ua paguaj shumën prej 2,089.00 €, konform nenit 452.1 të LPK-së, pasi nga shkresat e lëndës arsyetohen shpenzimet procedurale të krijuara, ndërsa e paditura nuk ka paraqitur ndonjë pretendim ankimor lidhur me shpenzimet procedurale.*

*Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të palës së paditur, veçanërisht pretendimi se gjykata e shkallës së parë nuk i ka marrë në shqyrtim të gjitha faktet që e paditura i ka theksuar, të cilat do të kishin qenë fundamentale në marrjen e vendimit, konsiderohet si i pa bazuar, për faktin se nuk ka ndonjë pretendim konkret se cilin fakt apo provë të propozuar nga pala e paditur nuk e ka marrë në shqyrtim apo vlerësuar gjykata e shkallës së parë, që do të kishte ndikim në nxjerrjen dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të atakuar, andaj nga sa u tha më lartë ankesa e të paditurës është refuzuar si e pa themeltë.*

### **Aktgjykimi AC.nr.2040/2013, i datës 12.07.2016**

#### **Arsyetimi**

*Duke u nisur nga gjendja faktike e konstatuar dhe e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë sipas aktgjykimit të ankimuar, Gjykata e Apelit e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, e cila ka mbështetje në provat nga shkresat e lëndës, drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesë-padia e paditësit është e bazuar në pjesën aprovuese të kërkesë-padisë lidhur me kompensimin e dëmit jo material për dhimbjet trupore-fizike, frikën e shkaktuar, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, dhe dëmin material për bartjen e veturës, ngase edhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit shumat e gjykuara ndaj paditësit për dëmin jo material të pësuar janë në përputhje të plotë me natyrën e shpërblimit, duke pasur parasysh rëndësinë e shkallës së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben, duke mos favorizuar synimet që nuk përkojnë me natyrën dhe qëllimet për të cilat shërben ky shpërblim. Kompensimi në të holla i gjykuar ndaj paditësit për këtë kategori të dëmit do t'i shërbejë edhe si një lloj satisfakcioni moral për zbutjen e pasojave të cilat i ka pësuar nga aksidenti i ndodhur, veçmas kur kihet parasysh natyra e lëndimeve të pësuar nga paditësi, intensiteti dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike dhe frikës së pësuar dhe përqindja e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor. Ndërsa dëmi material i gjykuar për bartjen e veturës ka mbështetje në faturën nr. 0630 të datës 22.08.2010 të lëshuar nga N.T.SH., Selimi ", në bazë të së cilës konstatohet se paditësi për bartjen e veturës së tij pas aksidentit të ndodhur ka paguar shumën prej 19.50 euro.*

*Gjykata e Apelit e Kosovës, nuk ka mundur ta pranojë si të rregullt dhe të ligjshëm mënyrën e vendosjes së gjykatës së shkallës së parë, lidhur me pjesën aprovuese të kërkesë-padisë së paditësit rreth kompensimit të dëmit material, në emër të fitimit të humbur për shkak të zvogëlimit të aktivitetit punues në formë të rentës së kapitalizuar, për shkak se kjo pjesë e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës nga neni 182.2 pika n) të LPK-së, si pasojë e të cilave ka ardhur edhe gjer tek zbatimi i gabuar i së drejtës materiale, për faktin se dispozitivi i aktgjykimit në këtë pjesë është në kundërshtim me arsyetimin e aktgjykimit dhe me provat nga shkresat e lëndës, e po ashtu nuk janë dhënë arsye bindëse rreth fakteve vendimtare lidhur me një mënyrë të tillë të vendosjes. Në dispozitiv të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë paditësit në emër të fitimit të humbur për shkak të zvogëlimit të aktivitetit punues në formë të rentës së kapitalizuar ia*

ka gjykuar shumën prej 785.50 euro, ndërsa në arsyetim të aktgjykimit iu ka referuar shumës prej 7.850.50 euro, me çka mbetet e paqartë se cila është shuma e saktë të cilën gjykata e shkallës së parë ia ka gjykuar paditësit për këtë lloji dëmi, aq më shumë kur shuma e gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar nuk përkon me shumën e cila është potencuar nga eksperti financiar i caktuar Aziz Berisha. Gjykata e shkallës së parë po ashtu lidhur me këtë lloji dëmi, rezulton se vendimin e saj e ka bazuar në mendimin profesional të dhënë gjatë shqyrtimit kryesor nga ekspertët ortoped-traumatolog, me çka sipas gjykatës ankimore të njëjtit ekspert nuk është dashur apo nuk kanë pasur përgatitjen e duhur profesionale që të deklarohen për këtë kategori të dëmit material, pasi që për këtë mund të deklarohet vetëm eksperti përkatës i punës i cili ka përgatitje profesionale adekuate nga lëmia e punës. Sa i përket zvogëlimit të aktivitetit punues gjykata e shkallës së parë po ashtu rezulton se nuk ka dhënë arsye bindëse pse në rastin konkret është e nevojshme që paditësit në emër të fitimit të humbur për shkak të zvogëlimit të aktivitetit punues ti gjykohej renta në formë të kapitalizuar, e jo renta mujore ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 188 paragrafi 2 të LMD, aq më shumë kur kihet parasysh fakti se në rastin konkret palë e paditur është Byroja Kosovare e Sigurimit, për të cilën është fakt notor se çdoherë disponon me mjete financiare, dhe realisht paditësit në të ardhmen vështirë se do të mund t'i rrezikohet realizimi apo ekzekutimi i rentës mujore. Mbi këtë bazë aktgjykimi i ankimuar në këtë pjesë është dashur që të prishej dhe lënda t'i kthehej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, ka prishur edhe pjesën lidhur me shpenzimet e procedurës të njohura paditësit, pa u lëshuar fare në ligjshmërinë e kësaj pjesë të aktgjykimit të ankimuar, për faktin se kjo lëndë kontestimore në një pjesë është dashur që të priset dhe gjykatës së shkallës së parë t'i kthehet në rigjykim, me çka pranë asaj gjykate ne procedurën e rigjykimit do të krijohen edhe shpenzime tjera procedurale, për të cilat gjykata e shkallës së parë duhet të vendosë me rastin e marrjes së vendimit përfundimtar, duke pasur suksesin e palëve në procedurë dhe kush u ka dhënë shkas krijimit të shpenzimeve procedurale.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK ka konstatuar se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje nga neni 182.2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK për të cilat gjykata e ankimit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimi ankimor i palës së paditur se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë vërtetimin e plotë të gjendjes faktike kur ka obliguar të paditurën në kompensimin e dëmit palës paditëse, për faktin se e njëjta gjykatë nuk ka vepruar sipas propozimit të të autorizuarit të palës së paditur për sigurimin e shkresave penale lidhur me fajësinë e shkaktarit të aksidentit dhe ekspertizën e komunikacionit të nxjerrë gjatë procedurës penale, për vërtetimin e kontributit të secilit pjesëmarrës në komunikacion në aksidentin e ndodhur, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pa themelë dhe në kundërshtim me provat nga shkresat e lëndës, për faktin se në bazë të shkresave të lëndës qartë konstatohet se Gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit kryesor të mbajtur ka siguruar dhe ka administruar si prova aktgjykimin penal të Gjykatës Komunale në Lipjan P-nr. 217/2011 i datës 28.05.2011, në bazë të së cilit rezulton se shkaktari i aksidentit I. Sh. për aksidentin e ndodhur më datë 22.08.2010 në të cilin kishte pësuar lëndime trupore paditësi S. S. është shpallur fajtor dhe dënuar për veprë penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 paragrafi 3 lidhur me paragrafi 1 të KPK. Si provë e njëjta gjykatë ka administruar edhe ekspertizën e komunikacionit të nxjerrë në procedurën penale nën nr. GJPP.32/2011 dhe PP.nr. 6/2011,



*e punuar nga eksperti i komunikacionit rrugor Xhelal Musa, në bazë të së cilës ka rezultuar se deri te aksidenti i ndodhur ka ardhur më lëshimet e vetme të shkaktarit të aksidentit I. Sh., i cili ditën e aksidentit ka qenë duke e vozitur automjetin transportues Daimler Benz 1422.*

*Lidhur me këto dy prova të administruara nga gjykata e shkallës së parë rezulton se të njëjtat i janë siguruar dhe dorëzuar me kohë nga gjykata e shkallës së parë të paditurës, dhe lidhur me to janë deklaruar të autorizuarit e palës së paditur në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur më datë 07.03.2013 dhe datë 19.04.2013, ku vërejtje nuk kanë fare në aktgjykimin penal P-nr.217/2011, ndërsa vërejtje pjesërisht kanë bërë në ekspertizën e komunikacionit të punuar nga eksperti Xhelal Musa, pa u deklaruar decidivisht se në cilën pjesë të kësaj ekspertize bëjnë vërejtje, me çka mbi bazën e këtyre provave të administruara është bërë jokontestuese për gjykatën e shkallës së parë baza e kërkesëpadisë së paditësit, qëndrim ky të cilin e përkrah edhe Gjykata e Apelit.*

*Gjykata e Apelit më rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka pasur parasyshe edhe te gjitha pretendimet ankimore të palës së paditur përmes ankesës së ushtruar, ku me aprovimin e pjeshëm të tyre në një pjesë ka prishur aktgjykimin e ankimuar duke vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndërsa për pjesën tjetër të pretendimeve ankimore të palës së paditur të cilat nuk janë marrë parasyshe nga Gjykata e Apelit, kjo gjykatë ka gjetur se janë te pathemelta dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe.*

*Pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar fare me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, pasi që kjo pjesë nuk është atakuar nga e paditura përmes ankesës së ushtruar.*

### **Aktvendimi AC.nr. 3954/2013, i datës 28.1.2016**

#### **Arsyetimi**

*Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi logjik dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë, ngase aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika n) i LPK-së, me vërtetimin jo të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike që ka rezultuar edhe me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, prandaj rezultojnë si të bazuara pretendimet ankimore të të paditurës, për çka aktgjykimi i atakuar duhet të prishet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.*

*Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika n) e LPK-së, në të cilën është thirrur e paditura në pretendimet e saj ankimore, konsiston në faktin se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i pa kuptueshëm, është kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit, i cili as nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, dhe ato arsye që janë dhënë janë të paqarta dhe të pakuptueshme, të cilat janë në kundërtënie edhe me përmbajtjen e provave që gjenden në shkresat e lëndës.*

*Ka mbetur pa u vërtetuar në mënyrë të padyshimtë edhe gjendja faktike që ndërlihet me shkakun e vdekjes së të ndjerit M..... Z....., gjë që ka rezultuar edhe me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, për të cilën kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, kujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.*

*Lidhur me çështjen e njëjtë juridike, por sipas padisë së pesë paditësve tjerë E....., B..... A....., B..... dhe F..... Z..... nga Podujeva, familjarë të tani të ndjerit M..... Z....., është zhvilluar procedura kontestimore në Gjykatën Komunale në Podujevë në lëndën C.nr. 613/2009, ku është vendosur me aktgjykimin C.nr. 613/2009, i datës 27.9.2010, i cili është prishur me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr. 2122/2012, i datës 29.10.2014, dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje. Kjo për arsyen kryesore që të vërtetohet baza juridike e kërkesë-padisë së paditësve me emra si më lart, e që ka të bëjë me kompensimin e dëmit jo material, përkatësisht për dhimbje shpirtërore për shkak të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes M..... Z....., në këtë rast, si pasojë e aksidentit të komunikacionit të shkaktuar me kontributin kryesor të të siguarit të të paditurës, dhe kompensimin e dëmit material për ngritjen e lapidarit dhe shpenzimet e varrimit.*

*Gjykata e Apelit me këtë aktvendim të saj (Ac.nr. 2122/2012, i datës 29.10.2014), ka sugjeruar që të vërtetohet në mënyrë të pa dyshimtë baza juridike e kërkesë-padisë së pesë paditësve, duke u zgjidhur dilema se a ka pasur lidhje kauzale në mes të lëndimeve të të ndjerit M....., të pësuar në aksidentin e datës 29.8.2009, dhe vdekjes së tij me datë 7.1.2010 për shkak të moshës së shtyer (i lindur në vitin 1935), përmes dëgjimit të ekspertëve mjekësor të cilët, për nevojat e lëndës C.nr. 613/2009, e kanë bërë më herët ekspertizën mjekësore, pikërisht lidhur me shkaqet e vdekjes së të njëjtit, duke sugjeruar që të sigurohen edhe prova për dëmin material të cilin e kanë kërkuar paditësit.*

*Për të njëjtat arsye, edhe kolegji tjetër i Gjykatës së Apelit, i cili me këtë rast vlerëson rregullsinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit tjetër të atakuar të gjykatës së shkallës së parë C.nr. 572/2010, i datës 26.8.2013, ku është vendosur sipas padisë së dy paditësve të tjerë Sh... dhe F..... Z..... nga Podujeva, po ashtu, familjar të ndjerit M....., që ka të bëjë me kompensim të dëmit jo material dhe material, si pasojë e vdekjes së këtij të fundit, vlerëson se edhe ky aktgjykim duhet të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, e cila duhet të bashkohet me lëndën tjetër sipas padisë së paditësve E....., B....., A....., B..... dhe F..... Z..... nga Podujeva (e kthyer në rigjykim nga gjykata e shkallës së dytë), në rast se ende nuk është rivendosur në të njëjtën. Nëse, çështja aty ka marr një epilog ligjor, atëherë gjykata e shkallës së parë duhet ta ketë parasysh atë aktgjykim, me rastin e vendosjes sipas padisë së paditësës F.....Z..... nga Podujeva, sa i përket kompensimit të dëmit jo material, ngase për dëmin material ajo ka siguruar prova materiale (fatura të shumta), pasi që baza juridike e kërkesëpadisë së gjithë këtyre paditësve – është e njëjtë.*

*Për paditësin S..... Z....., nuk ka nevojë të vendos, nga se është konstatuar tërheqja e kërkesëpadisë së tij e bërë nga i autorizuari i tij, prandaj, edhe as nuk ka pasur nevojë që të bëhet ndërprerja e procedurës në këtë kontest, ashtu siç ka pretenduar e paditura në gjykatën e shkallës së parë, sikurse edhe në pretendimet e saj ankimore në gjykatën e shkallës së dytë, për faktin se çështja ka pasur të bëjë me të drejtë që nuk trashëgohet në kuptim të nenin 204 të LMD-së, prandaj, as procedurën nuk do të kishin pasur mundësi ta ndërmerren trashëgimtarët e tani të ndjerit S....., i vdekur më datë 25.1.2013, tani më kur nuk ka fare kërkesëpadi të këtij paditësi.*

### **8.3.7 Caktimi i lartësisë së dëmit jo material**

Gjykata e Apelit në shumë raste gjatë praktikës së saj, në rastet e gjykimit të rasteve të shpërblimit të dëmit jo material ka vlerësuar se nuk janë aplikuar dispozitat e Ligjit mbi

marrëdhëniet e detyrimeve në mënyrë të drejtë, ashtu që në shumë raste është dashur që aktgjykimet e shkallës së parë të ndryshohen, sidomos sa i përket vlerave të gjykuara nga shkalla e parë, apo edhe të prishen për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike që si rrjedhojë ka pasur edhe aplikimin e së drejtës materiale.

Në vendimet e gjykatave të shkallës së parë shpesh kemi raste kur në vendosjen për kërkesë-padinë për shpërblimin e dëmit jo material, aprovohen shumë pjesërisht, ndërsa në pjesën refuzuese nuk përcaktohet se cilat shuma janë refuzuar, por vetëm thuhet mbi shumat e aprovuara refuzohen, çka e bën aktgjykimin kontradiktor në dispozitivin e tij. Aktgjykimet në shumë raste iu mungon arsytimi i veçantë për format e dëmit të vendosura sipas aktgjyimit, por vetëm arsytohen në formë të përgjithësuar, sikur të vendosej vetëm për një kërkesë, ndërsa secila kërkesë e shpërblimit të dëmit jo material paraqet kërkesë të veçantë andaj edhe duhet të arsyetohet në pjesën e aprovuar dhe të refuzuar të saj, duke dhënë arsye për vendosjen si në dispozitiv të aktgjyimit.

Gjykatat me rastin e gjykitimit të kërkesave për shpërblimin e dëmit jo material, në të shumtën e herëve edhe po t'i pranohen të lënduarit në tërësi kërkesat e kërkuara për shpërblimit e dëmit jo material, nuk sanojnë dhe nuk e kthejnë në gjendje të më parme ekuilibrin psikik të çrregulluar të dëmtuarit, mirëpo, prapëseprapë, pranimi i një shume të të hollave në emër të këtij shpërblimi, deri diku shëron dhimbjet shpirtërore të tij. Mirëpo problem i cili përcjell në vazhdimësi praktikën gjyqësore është identifikimi dhe caktimi i këtyre kriterëve sipas të cilave caktohet lartësia e këtij shpërblimi. Si kriter për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material, sipas nenit 173.2 të LMD janë çmimet në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse me ligj parashihet diçka tjetër. Ky kriter është i aplikueshëm si për caktimin e dëmit material, po ashtu edhe për dëmin jo material. Kjo dispozitë, gjykatën e obligon që me rastin e caktimit të shumës së zhdëmtimit jo material, të ketë parasysh në një mënyrë apo tjetër standardin jetësor të popullatës në vendin ku i dëmtuari jeton, në mënyrë që kjo shumë të jetë në përputhje me koston e jetës së popullatës në atë vend. Po ashtu me nenin 176 të LMD është paraparë përgjegjësia e ndarë si kriter për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material, në të cilën dispozitë, në pikën 1, parashihet *që në përpjesëtim me kontributin e të dëmtuarit në shkaktimin e dëmit*, të dëmtuarit ti pranohet shuma e shpërblimit të dëmit material. Kur është e pa mundur të vërtetohet se cila pjesë e dëmit rezulton nga veprimi i të dëmtuarit, *gjykata do të caktojë shpërblimin duke pasur parasysh rrethanat e rastit*. Gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror, Me shpërblimin në të holla nuk mund të mënjanohet cenimi i ndjenjave, dhimbjeve fizike, dhimbjeve shpirtërore të çfarëdo lloji qofshin ato, prandaj shpërblimi i drejtë në të holla përfaqëson vetëm një satisfaksion për të dëmtuarin. Me rastin e vendosjes nëse do të caktojë a jo këtë kompensim, gjykata duhet të kujdeset për rëndësinë e së mirës së cenuar dhe për qëllimin të cilit i shërben ky shpërblim. Shpërblimi në të holla i dëmit jo material nuk është qëllim i zhdëmtimit, ai është mjet me të cilin i dëmtuari, duke kënaqur nevojat të cilat nuk do të mund t'i plotësonte, ia lehtëson vetes jetën dhe, duke e bërë atë të durueshme, i lehtëson dhimbjet shpirtërore që i përjeton.

Gjykimi i shpërblimit të dëmit jo material për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëndetit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit dhe caktimi i shumës së shpërblimit për këto forma të dëmit, duhet të bëhet konform me natyrën e lëndimeve, nëse

lëndimet janë të lehta apo të rënda, ku janë shkaktuar këto lëndime, cilat janë pasojat e lëndimeve, sa ka zgjatur intensiteti i dhimbjeve, dhe frikës, ndonëse përjetimi i dhimbjeve dhe vuajtjeve shpirtërore mund të ketë ndryshime nga personi në person se si i përjeton, për këtë arsye është e nevojshme që këto rrethana t'i ketë parasysh gjyqtari me rastin e marrjes së mendimit të ekspertëve përkatës mjekësorë, si dhe me rastin e vendosjes për shumat e gjykuara për shpërblimin për këto forma të dëmit. Me rastin e marrjes së mendimit të ekspertëve mjekësor, gjyqtari duhet ta marrë rolin aktiv dhe duke i parashtruar para ekspertëve të gjitha dilemat që mund të rrjedhin në rastin konkret dhe duke sqaruar të gjitha rrethanat të cilat i nevojiten për vendosjen e drejtë dhe në mënyrë meritore të çështjes. Edhe pse dhimbjet fizike për kah kohëzgjatja e tyre janë të intensitetit të ndryshme, në praktikë gjyqësore është e pranueshme që për këtë formë të dhimbjeve shpirtërore pranohet një shumë e përgjithshme e shpërblimit, e jo siç e vërejmë në disa aktgjykime një shumë pranohet për këtë intensitet të dhimbjeve fizike e një shumë tjetër për intensitet tjetër të dhimbjeve fizike, sepse dëmshpërblimi jo material në këtë rast nënkupton dhimbjet shpirtërore për të gjitha llojet e dhimbjeve fizike që i lënduari i ka pësuar

Edhe me rastin e caktimit të shpërblimit për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, duhet pasur parasysh disa kritere të rëndësishme që ndikojnë në atë që ky shpërblim të jetë i drejtë, më i lartë apo më i ultë, varësisht nga rasti konkret, ndonëse një nga kriteret kryesore për vlerësim është përqindja e shkallës së zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, prapë se prapë nuk është i vetmi kriter për caktimin e kësaj lartësie, por pa tjetër duhet vlerësuar edhe kritere tjera siç është moshja e të lënduarit, e cila është e rëndësishme për atë se dikush ndoshta pjesën dërmuese të jetës aktivitetin jetësor do ta ketë të zvogëluar, e ndokush ndoshta vetëm në pjesën e fundit të jetës pasi është i shtyrë në moshë. Mandej duhet pasur parasysh, që eksperti mjeko ligjor patjetër të deklarohej se për shembull tek i lënduari zvogëlimi i aktivitetit jetësor a lidhet fare me moshën e tij të shtyrë, me sëmundjet e tij paraprake, apo është rezultat i drejtpërdrejtë i lëndimeve të marra.

Duke marrë parasysh edhe intensitetin e frikës dhe kohëzgjatjen e saj, gjykata të lënduarit do t'i pranojë një shpërblim të drejtë në të holla pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Edhe tek caktimi i shpërblimit për dhimbje shpirtërore për frikën e përjetuar, si kriter duhet të jetë intensiteti i frikës së përjetuar dhe kohëzgjatja e saj. Se çfarë intensiteti dhe në çfarë kohëzgjatje frika nga lëndimet e marra është manifestuar tek i lënduari, gjykata do ta vërtetojë në secilin rast, në bazë të mendimit e konstatimit mjekësor.

Me rastin e caktimit të shpërblimit të drejtë në të holla për dhimbje fizike në emër të shëmtimit trupor kriteret që duhet veçuar marrë parasysh janë shkalla e shëmtimit se a është shëmtim i rëndë, i mesëm apo i lehtë trupor, moshën e të lënduarit, vendin dhe dukjen e shëmtimit, si dhe profesionin dhe personalitetin e të lënduarit. Nuk mund të jetë shpërblimi i njëjtë sikur për të lënduarin i cili ka ngelur pa një dorë tërë jetën, apo me një gjymtyrë më të shkurtër apo të shtrembëruar, me shpërblimin për shëmtim tek i lënduari, i cili do ta ketë shëmtimin një pjesë të trupit e cila vazhdimisht është e mbuluar me rrobe të njeriut, apo me një vragë jo shumë të dukshme edhe në pjesën që shihet, po ashtu shëmtimet trupore, nuk shkaktojnë dhimbje shpirtërore të njëjta te personat e ndryshëm, p.sh. te një artist apo person publik, ashtu edhe te ndonjë person që nuk është i tillë. Thjeshtë sipas mendimit tim, në secilin rast konkret, duhet vlerësuar kriteret e lartpërmendura dhe të lënduarit ti pranohet shpërblimi i drejtë në të holla, i cili shpërblim për të lënduarin të paraqet një satisfacion për këto shëmtime që i ka pësuar.

Shpërblimi dëmit për shkak të dhimbjeve shpirtërore me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes së ngushtë nuk është i njëjtë tek të gjithë anëtarët e familjes, edhe shumata e pranuar në emër të këtij shpërblimi nuk mund të jenë gjithmonë të njëjta, kështu për shembull, prindërit përjetojnë dhimbje shpirtërore më të larta për humbjen e fëmijës së tyre se sa vëllai për motër apo motra për vëlla, kështu që edhe shumata e pranuar duhet të jenë të ndryshme. Në praktikë, pranohet se bashkëshortja me fëmijë përjetojnë dhimbje shpirtërore afërsisht të njëjta për humbjen e bashkëshortit respektivisht prindit të tyre, dhe të njëjtëve po iu pranohen shumata të njëjta. Për vëllezërit dhe motrat kërkohet që ndërmjet tyre dhe personit të vdekur të ketë ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme. Çka nënkupton me bashkësi të vazhdueshme LMD nuk jep ndonjë sqarim, por nëse i marrim parasysh dispozitat e ligjit për familjen duhet të ekzistoj bashkësia faktike, të jetojnë në një bashkësi të përbashkët familjare, ndonëse ky qëndrim mund të mos jetë human, prapëseprapë është zgjidhje ligjore që duhet respektuar.

### **Aktgjykimi AC.nr.890/2013, i datës 20.07.2016**

#### **Arsyetimi**

*Duke u nisur nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, Gjykata e shkallës së parë ka gjetur së kërkesë-padia e paditëses për dëmin jo material të kërkuar është pjesërisht e bazuar, ndërsa lidhur me dëmin material të kërkuar ka gjetur se është tërësisht e pa bazuar, ku edhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar. Mënyrën e vendosjes lidhur me dëmin jo material të gjykuar paditëses Gjykata e shkallës së parë e ka bazuar duke ia falur besimin mendimit profesional të dhënë nga ana e ekspertëve mjekësorë dhe provave tjera nga shkresat e lëndës, e duke u mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 154, 155, 158, 178 paragrafi 1, 201 dhe 201 të LMD e lidhur me nenin 323 të LPK, vendimin për kamatën e gjykuar e ka mbështetur në dispozitën e nenit 186 dhe 277 të LMD, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës kontestimore e ka mbështetur në dispozitën e nenit 449, 452 dhe 463 të LPK.*

*Lidhur me pjesën refuzuese të kërkesë-padisë rreth dëmit material të kërkuar nga paditësja, në emër të kujdesit të personit të huaj, ushqimit të përforcuar dhe dëmtimit të veshmbathjes, Gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar se këtë pjesë të kërkesë-padisë e ka refuzuar për faktin se paditësja me asnjë provë nuk e ka argumentuar kërkesën e saj që i referohet kësaj kategorie të dëmit, edhe pse në kuptim të nenit 7 të LPK ka qenë detyrë e paditësit që t'iparaqes të gjitha faktet mbi të cilat i mbështet kërkesat e veta dhe të propozoj prova më të cilat konstatohen ato fakte.*

*Gjykata e Apelit të Kosovës, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK ka konstatuar se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje nga neni 182.2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe nuk përmban as shkelje tjera procedurale sipas pretendimeve ankimore të palës së paditur përmes ankesës së ushtruar.*

*Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesë-padia e paditësit është e bazuar në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e dëmit jo material, për frikën e përjetuar dhe vuajtjet e përjetuara për shëmtim, ngase shumata e gjykuara sipas Gjykatës ankimore janë në përputhje të plotë me natyrën e*

shpërblimit kur kihet parasysh rëndësia e shkallës së të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim siç është paraparë me dispozitën e nenit 200 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (LMD). Shpërblimi në të holla i dëmit jo material nuk është qëllim, por mjet më të cilin të dëmtuarit deri diku ia zbut pasojat e dhimbjeve fizike dhe frikës së përjetuar, të cilat sigurisht që përbëjnë një përjetim të pakëndshëm, me çka shpërblimi në të holla paditësit do t'i shërbejë si satisfaksion moral dhe si një përjetim i këndshëm, për zbutjen e pasojave duke i kënaqur disa nevoja të caktuara jetësore.

Ndërsa sa i përket kompensimit të dëmit jo material për dhimbjet fizike dhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të shumave të gjykuara për këtë lloji dëmi gabimisht ka zbatuar apo aplikuar nenin 200 të LMD.

Shuma e gjykuar për dhimbje fizike sipas Gjykatës ankimore është e ulët dhe jo adekuate me intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike të cilat i ka pasur paditësja dhe natyrën e lëndimeve të pësuar, veçmas kur kihet parasysh se natyra e lëndimeve tek paditësja në bazë të ekspertizës mjekësore është konstatuar se ka qenë e rëndë dhe e rrezikshme për jetë në momentin e shkaktimit dhe dhimbja fizike e intensitetit të ulët është konstatuar se e ka përcjellë paditësen edhe një vit pas ndodhjes së aksidentit kur e njëjta është ekzaminuar fizikisht nga ana e ekspertëve mjekësor. Në një rrethanë të tillë, e duke pasur parasysh se zhdëmtimi në të holla gjithnjë shërben si një satisfaksion moral për të dëmtuarin për zbutjen e pasojave të pakëndshme të përjetuara. Gjykata ankimore në këtë pjesë aktgjykimin e ankimuar e ka ndryshuar duke i gjykuar paditësit në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 8.000,00 euro, për të cilën shumë konsideron se është në përputhje të plotë më të mirën e cenuar dhe qëllimin të cilën shërben shpërblimi në të holla.

Gjykata ankimore aktgjykimin e ankimuar e ka ndryshuar edhe sa i përket dëmit jo material të gjykuar nga Gjykata e shkallës së parë, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, për faktin se përcaktimi i kompensimit (satisfaksionit) sipas Gjykatës ankimore nuk përkon më rëndësinë e të mirës së cenuar dhe qëllimin të cilit i shërben ky kompensim ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 200 paragrafi 1 dhe 2 të LMD, me çka paditëses për këtë lloji dëmi kjo Gjykatë ia gjykoj shumë prej 27.550,00 euro, për të cilën shumë kjo Gjykatë vlerëson se paditëses do të ia mundësojë që të plotësojë disa nevoja të përditshme duke ia bërë deri diku më të lehtë jetën e saj dhe duke harruar përjetimin e pakëndshëm të cilin e ka pësuar si pasojë e lëndimeve të marra nga aksidenti, ku lidhur më lartësinë e kompensimit për këtë lloji dëmi jo material kjo Gjykatë mori parasysh edhe praktikën gjyqësore duke u siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësen, duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh më qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimin të ankimuar, gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesë-padia e paditëses është jo e bazuar lidhur me pjesën e kërkesë-padisë rreth kompensimit të dëmit material, për ndihmën e personit të tretë, ushqimin e përforcuar dhe dëmtimin e veshmbathjes, ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, në kuptim të nenit 195 paragrafi 1 të LMD më të cilën dispozitë shprehimisht parashihet, Kush i shkakton tjetrit lezionim trupor ose ia prish shëndetin ka për detyrë t'i kompensojë shpenzimet e mjekimit dhe shpenzimet e tjera te nevojshme lidhur më këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit 'paditëses i takon e drejta në kompensimin e këtij lloji të dëmit material.

*Në bazë të ekspertizës së ekspertëve mjekësor qartë është konstatuar se paditësja si pasojë e lëndimeve të marra nga aksidenti ka pasur nevojë për ndihmë të huaj gjatë 4 muajve, ndërsa ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 2 vite, që sipas Gjykatës ankimore edhe kanë rezultuar me humbje materiale të paditëses, pa marrë parasysh se përkujdesjen ndaj saj ka mundur ta ushtrojë ndonjë familjar i tij apo edhe person tjetër jashtë familjes së tij i cili më kompensim është angazhuar që të përkujdeset për paditësin gjatë kësaj periudhe 4 mujore. Humbje materiale paditësja ka pasur edhe sa i përket ushqimit të përforcuar i cili ka qenë i nevojshëm për 2 vite, me çka kur merret parasysh natyra e lëndimeve të cilat i ka pësuar paditësja, cili lloji i ushqimit shtesë përveç ushqimit të zakonshëm çdo ditë i është nevojitur paditësit, koston e çmimeve ushqimore në Kosovë dhe praktikën e gjertanishme të Gjykatave të Kosovës rreth kompensimit për këtë lloj dëmi, kësaj Gjykata i ka rezultuar se kërkesë-padia e paditësit për këtë kategori të dëmit material duke përfshirë edhe kërkesën për kompensim rreth dëmtimit të veshmbathjes, është tërësisht e bazuar me çka Gjykata ankimore aktgjykimin e ankimuar e ka ndryshuar edhe për këtë pjesë, dhe paditëses ia ka gjykuar shumat e kërkuara sipas kërkesë-padisë së ushtruar, të cilën për së fundi herë e ka precizuar i autorizuari i saj me parashtrësën e datës 17.12.2012, për të cilat shumat të gjykuara kjo Gjykatë gjen se janë në përputhje më dëmin material të shkaktuar ndaj paditëses.*

*Gjykata e Apelit më rastin e vendosjes për dëmin material të gjykuar ndaj paditëses, në emër të kujdesit nga personi i huaj, ushqimit të përforcuar dhe dëmtimit të veshmbathjes, përkundër asaj faktit se paditësja për këtë kategori të dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale, kjo Gjykatë duke u nisur nga praktika e gjertanishme e Gjykatave të Kosovës në bazë të së cilës është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloji dëmi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshin ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete, ka gjetur se në rastin konkret paditëses duke pasur parasysh faktin se paditësja ka pasur nevojë për ndihmë të huaj gjatë 4 muajve, ndërsa ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 2 vite, të njëjtës ligjërishi i takon ky lloji dëmi i kërkuar në shumat e gjykuara, pasi që edhe më vet kriteret e caktuara nga Kompanitë e Sigurimeve në Kosovë, të cilat nuk janë obliguese për Gjykatat me rastin e vendosjes, por mund të merren si kritere orientuese, rezulton se censorët e tyre në rastet e aksidenteve të komunikacioneve të dëmtuarve ua njohin deri në 100 euro në muaj për ushqim të përforcuar, 100 euro në muaj për kujdes nga personi i tretë dhe deri në 1500 euro për dëmtim të veshmbathjes.*

*Lidhur me kamatën vjetore në shumat e gjykuara ndaj paditëses, për të cilën Gjykata e Apelit me pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi ka ndryshuar aktgjykimin e ankimuar, duke i gjykuar paditëses kamatën vjetore të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimin nga Gjykata e shkallës së parë e gjer në pagesën definitive, kjo Gjykatë ka vendosur në kuptim të nenit 277 parag. 1 të LMD.*

*Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, i ka pasur parasysh të gjitha pretendimet ankimore të të autorizuarit të paditësit dhe të paditurës përmes ankesave të ushtruara, për të cilat ka konstatuar se kryesisht i referohen zbatimi të gabuar të së drejtës materiale që ka të bëjë më lartësinë e shumave të gjykuara ndaj paditësit në emër të dëmit jo material dhe material si dhe kamatës së gjykuar nga ana e Gjykatës së shkallës së parë*

*sipas aktgjykimit të ankimuar, ku me aprovimin e pjesshëm të pretendimeve të tyre ankimore, kjo Gjykatë edhe ka ndryshuar aktgjykimin e ankimuar duke vendosur si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndërsa për atë pjesë të pretendimeve ankimore të ndërgjygjësve të cilat nuk janë marrë parasysh nga Gjykata e Apelit e Kosovës për të cilat kjo Gjykatë nuk e ka parë të arsyeshme t'i elaborojë secilën veç e veç, ka gjetur se janë të pathemelta dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe siç ka vendosur kjo Gjykatë më anë të këtij aktgjykimi.*

## **Aktgjykimi AC.nr. 927/12, i datës 20.02.2017**

### **Arsyetimi**

*Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.*

*Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, rrjedhimisht edhe i përmbarueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.*

*Nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës për vërtetimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike pasi që në procedurën e të provuarit gjykata ka administruar provat edhe për përgjegjësin e të paditurës por edhe për lartësinë e kërkesë-padisë. Për ta vërtetuar kontributin e pjesëmarrësve në aksident është nxjerrë ekspertiza e komunikacionit e punuar nga eksperti Yll Koshi, për të cilën eksperti është sqaruar edhe në seancën e datës 21.02.2013, nga e cila ka rezultuar se shkaktar i aksidentit është ekskluzivisht i siguruari te e paditura.*

*Lidhur me natyrën dhe pasojat e lëndimeve gjykata në cilësinë e provës ka administruar ekspertizën mjekësore të punuar nga ekspertet Dr.Xhemajl Selmani Ortoped-traumatolog dhe Dr.Mimoza Shahini-psikiatre, të cilët kanë dhen mendimin e tyre profesional për natyrën dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi si pasojë e aksidentit. Kjo ekspertizë është vlerësuar edhe nga gjykata e shkallës së dytë si profesionale dhe e argumentuar mjaftueshëm për të provuar fakte për të cilat gjykata nuk ka njohjen profesionale.*

*Edhe për pjesën tjetër të kërkesë-padisë që i referohet dëmit material për shpenzimet e shërimit, ndihmën e personit të tretë dhe ushqimit të përforcuar, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë sepse ekspertët përkatës mjekësor kanë konstatuar nevojën e paditësit për shpenzimet e shërimit, për ndihmë e personit të tretë dhe për ushqimin e përforcuar si dhe kohëzgjatjen e tyre.*

*Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit, gjendja faktike është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, prandaj nuk janë pranuar pretendimet ankimore të t'paditurës lidhur me këtë bazë ankimore.*



*Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar për dëmin jo material sa i përket kompensimit për shkak të frikës, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale për këtë kategori të dëmit.*

*Gjykata e Apelit vendosi si në pikën një të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për kompensimin lidhur me frikën, pasi që e vlerësoi se shumata e gjykuara nuk ishin në përputhje me qëllimin të cilit i shërben kompensimit. Në çdo rast për dëmin jo material gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi t'u shkojë përshtati synimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarin. Mbi këtë bazë gjykata duke e pasur parasysh llojin dhe intensitetin e frikës si dhe mënyrën se si është manifestuar frika, si dhe rrethanat tjera si moshën e paditëses dhe praktikën e mirë gjyqësore për këto lloje të dëmit, vendosi për pjesën e aprovuar për këtë kategori të dëmit.*

*Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë për këtë kategori të dëmit Gjykata e Apelit vlerëson se shumata e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë nuk ishe në harmoni me pasojat e krijuara dhe me qëllimin të cilit i shërben kompensimi.*

*Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me dëmin jo material për dhembjet fizike dhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor Gjykata e Apelit, vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë për këto kategori të dëmit në atë mënyrë që shumata e gjykuara janë në ekuivalencë më të mirën e shkelur/cenuar, duke siguruar që kompensimit të shërbej si satisfaksion për paditësin.*

*Gjykata e ka pasur në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim dhe është kujdesur që kompensimi t'u shkojë përshtati synimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarin. Mbi këtë bazë gjykata duke e pasur parasysh natyrën e rëndë të lëndimeve që ka pësuar paditësi, llojin, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike, shkallë e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, mënyrën se si manifestohet zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor, si dhe rrethanat tjera si moshën e paditësit, praktiken e mirë gjyqësore për këto lloje të dëmit ka nxjerr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.*

*Lidhur me dëmin material për shpenzimet e shërimit (gabimisht është shënuar shpenzimet gjyqësore) gjykata ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme sepse shumata e aprovuar në shumë prej 48 Euro është provuar me provat e prezantuara nga paditësi.*

*Kamata është gjykata në pajtim me dispozita e LMD-së, nga nenit 277.*

*Gjykata e Apelit ka vendosur që të mos e shqyrtoj aktgjykimin e atakuar në pjesën e kërkesë-padisë si në pikën III (tre) të dispozitivit sepse ankesa e të paditurës nuk i sheh e drejtuar ndaj aktgjykimit në atë pjesë.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpengimeve dhe në pajtim me dispozita e LPK-së.*

*Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e) e lidhur 201 pika (d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

## 9. FITIMI I PRONËSISË ME MBAJTJE

### 9.1 FITIMI I PRONËSISË ME MBAJTJE

E drejta e pronësisë është e drejtë themelore e njeriut, e cila është e garantuar me konventat ndërkombëtare, si dhe me të drejtën kombëtare.

*Me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, është përcaktuar: “Çdo person fizik ose juridik gëzon të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga pasuria e tij përveç se në interesin publik dhe në varësi të kushteve të parashikuara me ligj dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.*

*Me paragrafin 1 të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është përcaktuar: “E drejta e pronës është e garantuar.”*

*Me nenin 18 të Ligjit për Pronësi dhe të Drejtat tjera Sendore, i publikuar në (“Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës” nr.57/2009) i cili ka hyrë në fuqi me dt. 19.08.2009, është përcaktuar:*

*“Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t’i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të tretë”.*

Pra me këtë dispozitë ligjore është përcaktuar përmbytja e së drejtës së pronësisë, si e drejtë e tërësishme mbi një send, të cilin pronari mund ta disponoj, ta posedoj dhe ta përdorë, duke përjashtuar të tjerët nga çdo ndikim, me përjashtim kur kjo e drejtë nuk kufizohet me ligj, ose me të drejtën e personit të tretë.

*Me nenin 7 të të njëjtit ligj është përcaktuar: “Të drejtat sendore nuk parashkruhen, përveç ashtu si përcaktohet me ligj.”*

Fitimi i pronësisë me mbajtje është mënyrë origjinale e fitimit të të drejtës së pronësisë, me posedimin e sendit në një kohë të caktuar me ligj.

Instituti juridik i fitimit të pronësisë me mbajtje për sendet e luajtshme është rregulluar me nenin 28, ndërsa për sendet e paluajtshme me nenin 40 të LPDS.

*Me nenin 28 të LPDS, është përcaktuar: “Një person i cili ka në posedim pronësor një send të luajtshëm për 10 vite, pa ndërprerje e fiton pronësinë mbi këtë send me përfundimin e kohës prej 10 viteve, në qoftë se në fillim dhe gjatë kohës prej 10 viteve, ai nuk ishte në dijeni se nuk i takonte e drejta e pronësisë.”*

*Me nenin 40 të LPDS, është përcaktuar: “Personi i cili me mirëbesim e ka 20 vite në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të.”*

*Personi i cili e ka 10 vite në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri dhe nëse ai është regjistruar si posedues pronësor në kadastër e fiton pronësinë në paluajtshmërinë ose në ndonjë pjesë të saj, në qoftë se brenda këtij afati nuk është regjistruar ndonjë kundërshtim lidhur me regjistrimin.”*

Pra, nga këto dispozita ligjore rezultojnë se drejta e pronësisë me mbajtje fitohet kur:

1. *Poseduesi me mirëbesim i sendit të luajtshëm e fiton pronësinë pas kalimit të afatit prej 10 vitesh.*
2. *Poseduesi me mirëbesim, i cili e ka 20 vjet posedimin e pa ndërprerë në një send të paluajtshëm ose në një pjesë të tij, e fiton pronësinë në të.*
3. *Poseduesi pronësor, i cili e ka 10 vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri, dhe nëse ai është i regjistruar si posedues pronësor në kadastër e fiton pronësinë në paluajtshmërinë ose pjesën e saj, në qoftë se brenda këtij afati, nuk është regjistruar ndonjë kundërshtim lidhur me regjistrimin.*

Ligji për marrëdhëniet themelore juridike-pronësore “Gazeta Zyrtare e ish RSFJ-së nr.6/80, më tej (LMTHJP) të drejtën e pronësisë me mbajtje e kualifikonte sipas dy formave të posedimit:

- a) Mbajtës me mirëbesim dhe i ligjshëm si dhe
- b) Mbajtës me mirëbesim.

Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm sipas paragrafit 1 dhe 2 të nenit 28 të LMTHJP, e fitonte pronësinë mbi sendin e luajtshëm në të cilin tjetri e kishte të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues me kalimin e kohës prej 3 vjetësh, ndërsa mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm mbi të cilin tjetri e ka të drejtën e pronësisë fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 10 vjetësh.

Ndërsa mbajtësi me mirëbesim i sendit të luajtshëm sipas paragrafëve 3 dhe 4 mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrim fitues me kalimin e kohës prej 10 vjetësh. Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh.

Pra, LPDS, për dallim nga LMTHJP, ka përcaktuar fitimin e pronësisë me mbajtje vetëm të poseduesit pronësor me mirëbesim, por nuk ka përcaktuar edhe poseduesin e ligjshëm.

Sipas ligjit të vjetër mbajtësi është posedues i ligjshëm nëse mbajtja bazohet:

- a) Në bazën juridike e cila është e nevojshme për fitimin e së drejtës së pronësisë (kontrata për shitë-blerje, për dhuratën, për ndërrimin etj.) dhe
- b) Posedimi të jetë i ligjshëm, të mos jetë fituar me forcë, me mashtrim ose keqpërdorim e besimit, pra, posedimi të mos jetë me të meta, (neni 72 i Ligjit të vitit 1980). Sipas kësaj dispozite ligjore (neni 72) mirë besueshmëria e posedimit supozohet.

Posedimi është me mirëbesim në rast se mbajtësi nuk di ose nuk mund të dijë se sendi që e mban nuk është i tij.

Pra, për fitimin e pronësisë mbi sendin në bazë të mbajtjes së ligjshme dhe me mirëbesim, duhet të plotësohen kumulativisht tri kushte:

1. që posedimi të jetë i ligjshëm;
2. me mirëbesim dhe
3. të kalojë koha e paraparë me ligj.

LPDS, me nenin 28.1 posedimin me mirëbesim e ka përkufizuar si posedim pronësor mbi një send të luajtshëm për të cilin poseduesi nuk ishte në dijeni se nuk i takon e drejta e pronësisë.

Pra, mund të përfundojmë se LPDS, dhe LMTHJP, e njohin fitimin e pronësisë me mbajtje si formë origjinare, në kushtet e parapara me dispozitat përkatëse ligjore.

Në këtë drejtim është shprehur edhe praktika gjyqësore e zhvilluar në sistemin gjyqësor të ish RSFJ, përfshirë edhe sistemin gjyqësor të Kosovës.

## **9.2 KOMENT I SHKURTËR I ZBATIMIT TË DISPOZITAVE LIGJORE TË NENEVE 28 DHE 40 TË LPDS**

Në doktrinën juridike, legjislatore, si dhe në praktikë gjyqësore nuk është kontestuese se pronësia mund të fitohet me mbajtje në sendet e luajtshme dhe të paluajtshme nën kushtet e parapara me ligj.

Pra, koha si fakt juridik prodhon pasoja juridike, jo vetëm në të drejtën e detyrimeve, (Kreu 4 nenet 341 deri 363 të LMD) te instituti i parashkrimit të kërkesës, por edhe në të drejtën sendore, te instituti i mbajtjes (Nenet 28 e 40 të LPDS).

Sipas dispozitave ligjore të nenit 28 të LPDS, personi i cili e ka posedimin pronësor mbi një send të luajtshëm për 10 vjet pa ndërprerje, e fiton pronësinë mbi atë send, me përfundimin e kohës prej 10 viteve, në qoftë se në fillimin dhe gjatë kohës prej 10 viteve ai nuk ishte në dijeni se nuk i takonte e drejta e pronësisë. Parashkrimi përjashtohet nëse personi gjatë fitimit dhe kohëzgjatjes së posedimit pronësor nuk ka qenë me mirëbesim, ose nëse ai gjatë periudhës 10 vjeçare, e kupton se nuk ka të drejtë në pasurinë e luajtshme.

Pra, sipas kësaj dispozite ligjore duhet kumulativisht të plotësohen kushtet:

1. Posedimi pronësor i sendit në kohëzgjatje prej 10 vitesh pa ndërprerje;
2. Mirëbesimi duhet të ekzistojë nga momenti i fitimit të posedimit e deri në skadimin e afatit 10 vjeçar.

Parashkrimi ndërpritet nëse personi gjatë fitimit dhe kohëzgjatjes së posedimit pronësor nuk ka qenë me mirëbesim, ose nëse ai gjatë periudhës 10 vjeçare e kupton se nuk ka të drejtë pronësie në sendin e luajtshëm.

Pra, gjykatat me rastin e shqyrtimit të këtyre kontesteve pronësore duhet t'i vërtetojnë drejtë dhe plotësisht sipas barrës së provës, faktet relevante kur ato janë kontestuese e që kanë të bëjnë me:

1. Natyrën e posedimit (pronësor ose jo pronësor);
2. Ekzistimin e mirëbesimit, (i cili ka ekzistuar ose jo gjatë kohës së posedimit)
3. Afati kohor i posedimit, i përcaktuar me ligj.

Pra, sipas dispozitës së nenit 28 të LPDS, këto tri fakte relevante duhet të plotësohen kumulativisht për fitimin e pronësisë me mbajtje mbi një send të luajtshëm i cili mund të jetë objekt i pronësisë.

LPDS, me nenin 288 ka përcaktuar se: *“Nuk mund të fitohet pronësia përmes parashkrimit fitues në paluajtshmëritë, pronarët e të cilëve në kohën në mes të 23. Marsit 1989, dhe hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë humbur posedimin direkt dhe indirekt kundër vullnetit të tyre”*.

Pra, sipas kësaj dispozite ligjore, gjykatat duhet të kenë kujdes gjatë vendimmarrjes, me rastin e shqyrtimit të kontesteve pronësore, sipas mënyrës së fitimit të pronësisë me mbajtje mbi sendin e paluajtshëm, kur paditësi-it, pretendojnë se të drejtën e pronësisë e kanë fituar me mbajtje gjatë afatit kohor prej 23.03.1989 dhe datës 19.08.2009, kur ka hy në fuqi LPDS.

Pra, në këtë rast gjykatat duhet të vërtetojnë faktin vendimtar se pronarët të cilët në kohën prej 23. mars 1989 deri me 19.gusht 2009, e kanë humbur posedimin direkt dhe indirekt, se humbja e posedimit a është si rezultat i vullnetit të tyre apo jo.

Fitimi i pronësisë me mbajtje mbi sendin e paluajtshëm sipas nenit 40 të LPDS

Me nenin 40 par.1 të LPDS, është përcaktuar: *“Personi i cili me mirëbesim e ka njëzet (20) vjet, në posedim të pandërprerë në paluajtshëmëri ose një pjesë të saj e fiton pronësinë në të”*.

Pra sipas kësaj dispozite ligjore rezulton se personi i cili e ka në posedim një send të paluajtshëm, e fiton pronësinë mbi të me mbajtje nëse plotësohen kumulativisht këto kushte ligjore:

1. Posedimi duhet të jetë pronësor, pra poseduesi gjatë posedimit duhet ta ketë pozitën e pronarit gjatë gjithë posedimit,
2. Të jetë me mirëbesim dhe
3. Posedimi i pandërprerë dhe me mirëbesim të jetë në kohëzgjatje prej 20 vitesh.

LPDS me nenin 104 ka përcaktuar se: *“Posedimi në një send fitohet me krijimin e pushtetit faktik mbi sendin. Marrëveshja e poseduesit të mëparshëm dhe e fituesit të posedimit është e mjaftueshme për fitimin e posedimit, nëse fituesi është në gjendje që të ushtrojë pushtetin mbi sendin në momentin e marrëveshjes”*.

Pra, sipas fjalisë së parë të nenit 104 të LPDS, rezulton se: Posedimi mbi një send fitohet me krijimin e pushtetit faktik mbi sendin. Me fjalinë e dytë të të njëjtës dispozite ligjore është përcaktuar se posedimi fitohet me marrëveshje në mes të poseduesit të mëparshëm dhe fituesit të posedimit, nëse fituesi është në gjendje që të ushtrojë pushtetin mbi sendin në momentin e marrëveshjes.

Nga kjo dispozite ligjore rezulton se për fitimin e posedimit duhet të plotësohen kumulativisht dy kushte:

1. Ekzistimi i marrëveshjes në mes të poseduesit të mëparshëm dhe fituesit të posedimit, dhe

2. Fituesi i posedimit të jetë në gjendje që të ushtrojë pushtetin faktik mbi sendin në momentin e marrëveshjes.

Pra posedimi me mirëbesim duhet të bazohet në marrëveshje e jo me përdorimin e forcës, mashtrimin, apo keqpërdorimit të besimit dhe duhet të ekzistojë gjatë gjithë afatit, nga momenti i fitimit e deri në momentin e përfundimit të afatit të paraparë ligjor.

Për dallim nga LMTHJP, (neni 28 par.1 e 2) i cili kërkonte që posedimi si bazë e fitimit të pronësisë në mbajtje të jetë i ligjshëm, pra të bazohet në ndonjë titull pronësor për fitimin e pronësisë, LPDS, nuk e ka paraparë një formë të tillë të posedimit, si bazë për fitimin e pronësisë, por vetëm posedimin me mirëbesim.

LPDS, ka përcaktuar fitimin e pronësisë me mbajtje sipas afatit absolut të parashkrimit për sendet e luajtshme dhe të paluajtshme, e jo afatin e rregullt të parashkrimit, të cilin kishte paraparë LMTHJP, i cili bazohej në posedimin e ligjshëm dhe me mirëbesim që poseduesi e ushtronte mbi sendin përkatës brenda afatit të paraparë me ligj.

Koha e mbajtjes fillon nga momenti kur poseduesi ka hyrë në posedim të sendit (të luajtshëm apo të paluajtshëm), dhe përfundon me kalimin e ditës së fundit të kohës së paraparë me ligj. Në kohën e posedimit llogaritet edhe koha e posedimit mbi sendin, nga paraardhësit e mbajtësit.

Për dallim nga LMTHJP, sipas të cilit mbajtësi duhej të provonte se në momentin e fitimit, posedimin e kishte me mirëbesim si dhe në momentin e kalimit të kohës së paraparë me ligj të mbajtjes, LPDS, në paragrafin 2 të nenit 28 ka përcaktuar: Se parashkrimi përjashtohet nëse personi gjatë fitimit të kohëzgjatjes së posedimit pronësor nuk ka qenë me mirëbesim ose nëse ai gjatë periudhës 10 vjeçare e kupton se nuk ka të drejtë pronësie në pasurinë e paluajtshme.

Karakteristikë tjetër e LPDS, të fitimi i pronësisë me mbajtje është edhe paragrafi 2 i nenit 40 sipas të cilit personi i cili e ka dhjetë (10) vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri dhe nëse ai është regjistruar si posedues pronësor në kadastër e fiton pronësinë në paluajtshmërinë ose në ndonjë pjesë të saj, në qoftë se brenda këtij afati nuk është regjistruar ndonjë kundërshtim lidhur me regjistrimin.

Kjo dispozitë ligjore përfaqëson risi në krahasim me ligjin e mëparshëm, sepse sipas kësaj dispozite ligjore rezulton se poseduesi pronësor e fiton të drejtën e pronësisë me mbajtje mbi sendin e paluajtshëm, kur:

1. Një send të paluajtshëm ta ketë në posedim pa ndërprerë për 10 vite, dhe
2. Të jetë i regjistruar si posedues pronësor në kadastër dhe
3. Brenda këtij afati (10 vjeçar të posedimit dhe regjistrimit) të mos jetë paraqitur ndonjë kundërshtim lidhur me regjistrimin.

Fitimi i pronësisë me mbajtje krijon siguri juridike, sepse në jetën e përditshme qarkullimi juridik, nuk përputhet me qarkullimin ekonomik, kështu që gjendja faktike nën kushtet e parapara me ligj krijohet në gjendje juridike pra, mbajtësi me mirëbesim, nën kushtet e parapara me ligj bëhet pronar i sendit përkatës.

Sipas institutit juridik të mbajtjes si mënyrë e fitimit të pronësisë, pronari nuk ka për detyrë të provojë bazën më të fortë juridike të fitimit të pronësisë, por vetëm posedimin e pandërprerë, me mirëbesim dhe afatin kohor të paraparë me ligj.

### **9.3 GJETJET E GJYKATËS SË APELIT, ME RASTIN E EKZAMINIMIT TË VENDIMEVE TË GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË NË PROCEDURË SIPAS ANKESËS (SHKAQET E ANULIMIT TË AKTGJYKIMEVE)**

#### **9.3.1 Gjykatat e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të këtyre kontesteve, nuk vendosin brenda kërkesë-padisë**

Me nenin 2.1 të LPK është përcaktuar: “Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët”.

Një rast i tillë është gjykuar në njërën nga Gjykatat Themelore të Kosovës (Aktgjykimi C nr.282/11) i cili është prishur me aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 817/13.

*Paditësi përmes përfaqësuesit të tij e në bazë të ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë, në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes të mbajtur me 30.01.2013, kishte precizuar (ndryshuar kërkesë-padinë), duke kërkuar që paditësit t'i njihet e drejta e pronësisë në ngastrën nr. 2203/1, ZK..., e cila evidentohet në emër të personit tjetër e jo në emër të të paditurit, ndërsa gjykata e shkallës së parë edhe përkundër këtij precizimi kishte vendosur që paditësit t'i njihet e drejta e pronësisë në parcelën kadastrale nr. 1716/3.*

*Pra, në këtë rast gjykata e shkallës së parë aktgjykimin ankimor e kishte dhënë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 o) të LPK, e cila konsistonte në faktin se me rastin vendimmarrjes e kishte tejkualuar kërkesë-padinë e precizuar. Aktgjykimi i tillë sipas dispozitës së nenit 202 të LPK-së, do të duhej të prishej dhe çështja t'i kthehet gjykatës të shkallës së parë në procedurë të sërishme,.*

*Gjykata e shkallës së parë, duke bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, me rastin e tejkualimit të kërkesë-padisë së paditësit, kundër të paditurit, rezulton se nuk e ka vërtetuar drejtë dhe plotësisht gjendjen faktike, dhe nuk mund të përfundohet se drejtë është zbatuar e drejta materiale, për çka gjykata e shkallës së dytë në procedurë sipas ankesës e në bazë të nenit 194 të LPK, kujdeset sipas detyrës zyrtare.*

#### **9.3.2 Gjykatat e shkallës së parë vërtetojnë faktet e pohuara nga palët dhe konstatojnë gjendje tjetër faktike**

*Në një rast tjetër Gjykata Themelore, me aktgjykimin e saj C nr. 268/2010, kishte vendosur si vijon: vërtetohet se paditësit janë pronar të pronës së paluajtshme në nga 3/16 etj. të ngastrave kadastrale, të përshkruar si në dispozitiv,... duke detyruar të paditurin që këtë të drejtë t'ua njoh paditësve dhe t'ua dorëzojë në posedim, si dhe të paguajë shpenzimet procedurale. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit janë vëllezër dhe trashëgimtar të radhës së parë të babait të tyre të ndjerë dhe se e drejta e pronësisë u takon sipas trashëgimisë. Kanë pohuar se të paditurin e kanë djalë të axhës.*



*Të dy vëllezërit, paraardhësit e ndërgjyqësve, e kishin shkëputur bashkësinë familjare në vitin 1975, duke bërë ndarjen fizike të patundshmërisë sipas marrëveshjes së përshkruar, por patundshmëria ishte regjistruar në emër të babait të paditurit.*

*I padituri kishte kërkuar shqyrtimin e pasurisë trashëgimore pas vdekjes së babait të tij, duke e trashëguar gjithë pasurinë e patundshme sipas aktvendimit T.nr.15/2010, të gjykatës të shkallës së parë - për kundër faktit se gjithmonë e ka ditur se e njëjta nuk i takon vetëm atij, fakt të cilin i padituri e kishte pranuar edhe gjatë seancave të mbajtura në gjykatën e shkallës së parë, duke mos u mohuar paditësve të drejtën e pronësisë, e as ndarjen fizike, por i njëjti kishte shprehur pakënaqësi lidhur me vendosjen e antenës Vala 900, pa pëlqimin e tij në njërën nga paluajtshmëritë e cila evidentohet në emrin e tij, dhe nga vendosja e kësaj antene materialisht përfitonin vetëm paditësit e jo edhe i padituri.*

*Përkundër këtyre fakteve se paditësit dhe i padituri kishin hyrë në posedim dhe shfrytëzim të pjesëve të ngastrave kadastrale ashtu sipas ndarjes fizike që e kishin kryer paraardhësit e tyre në vitin 1975 dhe të cilën e shfrytëzonin pa kurrfarë kontesti në mes tyre e as nga personat e tretë, gjykata e shkallës së parë kishte vendosur në dispozitiv të aktgjykimit ankimor, pa e konstatuar drejtë dhe plotësisht gjendjen faktike, duke e anashkaluar këtë gjendje faktike, duke krijuar situatë të re e cila nuk përkon as me gjendjen faktike në terren, e cila sipas ndërgjyqësve është e njëjta si para më shumë se 30 vitesh.*

*Pra, gjykata e shkallës së parë në këtë rast nuk ka vlerësuar ekzistimin e posedimit të ligjshëm dhe me mirëbesim të ndërgjyqësve në pjesët e patundshmërive përkatëse të cilat i posedojnë dhe shfrytëzojnë si prona të veta, fillimisht paraardhësit e tyre dhe pastaj vet ndërgjyqësit.*

*Gjykata e shkallës së parë në këtë rast aktgjykimin e ka dhënë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 o) të LPK, e cila konsiston në tejkalimin e kërkesë-padisë së paditësve.*

*Gjykata në procedurë kontestimore nuk ka nevojë t'i provojë faktet të cilat pala/palët i kanë pohuar gjatë procesit gjyqësor (par. 2 i nenit 321 të LPK), andaj në këtë rast gjykata e shkallës së parë është dashur të provojë gjendjen faktike të posedimit në ngastrat përkatëse kadastrale, sipas gjendjes faktike në terren, e cila nuk ishte kontestuese për palët-ndërgjyqësit, e jo të veprojnë në të kundërtën.*

*Pra, në këtë rast gjykata e shkallës së parë, në bazë të gjendjes faktike jo kontestuese, do të duhej të merrte provën me identifikimin e gjendjes faktike përmes ekspertit të gjeodezisë, duke identifikuar saktë për secilin ndërgjyqës se cilën pjesë të pronës dhe të cilave përmasa, e ka në posedim dhe shfrytëzim gjatë afatit kohor përkatës dhe do të vlerësonte se a janë përmbushur kërkesat ligjore të nenit 28 par. 2 LMTHJP, për fitimin e së drejtës së pronësisë me mbajtje.*

### **9.3.3 Gjykatat e shkallës së parë nuk vërtetojnë drejtë dhe plotësisht ekzistimin e mirëbesimit si njërin prej kushteve ligjore për fitimin e pronësisë me mbajtje**

Mbajtës me mirëbesim i sendit të paluajtshëm mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, konsiderohet personi i cili nga hyrja në posedim mbi atë send në kohëzgjatje prej 20 vitesh, nuk ka ditur dhe as nuk ka mund të dijë se sendin që e ka në posedim nuk është pronë e tij. (Paragrafi 4 i nenit 28 të LMTHJP përkatësisht paragrafi 1 i nenit 40 të LPDS)

*Në një rast, një Gjykatë Themelore, me aktgjykimin e saj C.nr.336/08 kishte vendosur se paditësit janë pronar të ngastrave kadastrale, të përshkruara në dispozitivin e aktgjykimit përkatës, si trashëgimtar të paraardhësit të tyre tani të ndjerë, në bazë të parashkrimit fitues, si mbajtës me mirëbesim.*

*Me paragrafin 2 të të njëjtit aktgjykim kishte obliguar të paditurit që paditësve t'ua njohin të drejtën e pronësisë në ngastrat e lartshënuara dhe Drejtoria për Kadastër e Komunës, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, të bëjë ndryshimin në regjistrat kadastrale në patundshmëri. Paditësit kishin pohuar se këtë të drejtë e kishte fituar babai i tyre i ndjerë, në bazë të kontratës gojore për shitblerjen e paluajtshmërisë, e lidhur në vitin 1974, me të paditurit, me pretendimin se marrëveshja ishte përmbushur në tërësi.*

*Më tej paditësit kishin theksuar në padi se para 10 viteve, në patundshmërinë kontestuese në themelet e objekteve të vjetra, ata (paditësit) kanë ndërtuar shtëpinë e banimit dhe se paraardhësi i paditësve në bazë ligjore me punë të vlefshme juridike e ka fituar të drejtën e pronësisë dhe prej kohës së shitblerjes këtë paluajtshmëri e kanë shfrytëzuar dhe mbajtur me mirëbesim pa u penguar nga askush.*

*Meqenëse të paditurit si ish banor të Prishtinës, janë me adresa të panjohura të vendbanimit përkatësisht vendqëndrimin, gjykata, atyre ua ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm (avokatin).*

*Pas marrjes së provave gjykata e shkallës së parë, (sipas dëshmisë së një dëshmitari) se paraardhësi i paditësve para 40 viteve ka blerë disa shtëpiza të vogla në një lagje të Prishtinës, (e emërtuar) dhe të paditurve u ka paguar çmimin e shitblerjes dhe ka hyrë në posedim të saj (pronës) mirëpo ndërrimi i pronarëve në librat kadastrale nuk është bërë, dëshmitari tjetër kishte pohuar se paditësit nuk kanë qenë të penguar nga askush në atë ndërtim dhe nuk ka njohuri nëse paditësit e kanë rindërtuar shtëpinë në tokën e Vakëfit. Në mënyrë identike me dëshmitarin e parë kishte dëshmuar edhe paditësja.*

*Gjykata e shkallës së parë në bazë të këtyre dëshmime kishte ardhur në përfundim se: “Bazë më e fortë për aprovimin e kërkesë-padisë së paditësve është fitimi i pronësisë me parashkrim fitues duke theksuar se paditësit 40 vite më parë kanë hyrë në posedim të patundshmërisë të përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit dhe të njëjtën e kanë shfrytëzuar në mënyrë të ndërgjegjshme të qetë dhe të papenguar. Në vitin 1999 paditësit kanë bërë rindërtimin e shtëpisë dhe lokaleve për të cilat po ashtu nuk janë penguar nga personat e tretë, por as nga të paditurit, që tani janë në adresë të panjohur e as nga e paditura”.*

*Pra, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në këtë rast janë përmbushur kërkesat ligjore të paragrafit 1 të nenit 40 të LPDS.*

*Gjykata e Apelit me aktvendimin e saj Ac.nr.3976 /2013 e ka prishur aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe çështjen ia ka kthyer të njëjtës gjykatë të shkallës së parë në rigjykim, me arsyetim se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i paqartë, sepse nuk dihet se këtë sipërfaqe (304 m<sup>2</sup>.) e përbëjnë të gjitha ngastrat si pjesë e ngastrës 3527-1, cilat janë përkufizimet e saj dhe sipërfaqja reale.*

*Pra, ka vlerësuar se aktgjykimi ankimor është i përfshirë me shkëlje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 n) të LPK, e që aktgjykimin e bëjnë me të meta për shkak të cilit nuk mund të ekzaminohet.*

*Gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë dhe plotësisht sepse paluajtshmëria e cila figuron në emër të të paditurës, si në fletën poseduese ashtu edhe në ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë, emërtohet pasuri shoqërore e cila nuk mund të tjetërsohet pa kontratë të nënshkruar apo vërtetuar në gjykatë, përkatësisht tani të noteri, sepse kemi të bëjmë me pronën shoqërore.*

*Në shkresat e lëndës ekziston përgjigja në padinë e të paditurës, e cila ka kërkuar nga gjykata që të konsiderohet si kundërpadi. Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e saj, nuk ka vendosur për kundërpadinë e të paditurës përkatësisht nuk ka dhënë arsye lidhur me kundërpadinë.*

*Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se e drejta materiale gabimisht është zbatuar sepse e drejta e pronësisë në pronën shoqërore nuk mund të fitohet me parashkrim fitues. Eksperti i gjeodezisë është dashur të thirret në seancë gjyqësore, sipas bazës ligjore të nenit 362 par.1 të LPK.*

*Pra, sipas gjetjeve të gjykatës së shkallës së dytë në këtë rast gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin ankimor e ka dhënë me shkëlje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, duke vlerësuar se janë përmbushur kërkesat ligjore të nenit 195.1 c) të LPK, për të vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.<sup>29</sup>*

**Në një rast tjetër:** *Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e saj C.nr.2681/08 kishte vendosur si vijon: Vërtetohet se paditësit-kundër të paditurit janë pronar në nga 1/2 pjesë ideale të ngastrës kadastrale nr.-në sipërfaqe prej- fleta poseduese-, ZK, kurse në paragrafin II e ka detyruar të paditurën- kundër paditësen që paditësve t'ua njoh të drejtën e pronësisë dhe të lejoj regjistrimin në librat kadastrale. Në paragrafin III e ka refuzuar kundërpadinë e paditurës – kundër paditëses.*

*Në arsyetimin e aktgjykimit konstatohet se paditësit- kundër të paditurit kishin kërkuar të drejtën e pronës në patundshmërinë e përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit ankimor, sipas bazës së mbajtjes, në bazë të kontratës gojore të lidhur në mes të paraardhësve juridik të ndërgjyqësve, e cila me pretendim se kontrata është përmbushur në tërësi dhe paditësit janë vendosur në patundshmërinë kontestuese me mirëbesim dhe të njëjtën e posedojnë dhe e shfrytëzojnë pa kurrfarë pengese që nga viti 1960, në të njëjtën kanë ndërtuar objekte banimi.*

---

<sup>29</sup> Gjykata e shkallës së parë në një rast, ka vendosur se ekziston mbajtja me mirëbesim, edhe për kundër faktit se në mes të palëve procedurale ishte zhvilluar procedura kontestimore, me të cilën ishte vërtetuar ekzistimi i shitblerjes, por blerësit tani paditësit, ishin detyruar të paguajnë çmimin e kontraktuar të pronës përkatëse, ndërsa paditësit nuk kanë dëshmuar se e kanë përmbushur detyrimin monetar-çmimin blerës, sipas kontratës gojore të shitblerjes, përkatësisht detyrimin sipas aktgjykimit.

*Kishin theksuar se sipas aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, është vërtetuar se është bërë shitblerja e pasurisë kontestuese dhe se prej asaj kohe paditësit gjenden në posedim dhe shfrytëzim ku baza juridike është e ligjshme dhe kërkesë-padia është e bazuar.*

*E paditura – kundër paditësja e kishte kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësve me arsyetim se marrëveshja gojore e vitit 1969 e bërë në mes të paraardhësve juridik të ndërgjyqësve, asnjëherë nuk është zbatuar, përkatësisht paraardhësit e tyre asnjëherë deri më tani nuk e kanë paguar çmimin kontraktues.*

*Aktgjykimin në lidhje me çështjen C.nr.675/70, i Gjykatës së Qarkut, nuk është zbatuar. Gjykata e shkallës së parë i kishte marrë provat e përshkruara në arsyetimin e aktgjykimit përkatës, ka vlerësuar se janë përmbushur kërkesat ligjore, për të vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor.*

*Gjykata e Apelit, me aktvendimin e saj Ac.nr.1213/13, e ka prishur aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, me arsyetim se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë faktet vendimtare të përcaktuara me nenin 28 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, ku parashihet se mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrim fitues me kalimin e kohës prej 20 vitesh: "... për faktin se nga ana e të paditurve gjegjësisht të paraardhësve të paditurës në vitin 1971, është paraqitur në Gjykatën Komunale në Prishtinë, propozimi përmbarimor për përmbarimin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr.675/70 i dt. ... nga kjo rrjedh se në këtë situatë nuk ekziston mbajtja me mirëbesim e paluajtshmërisë, qetësisht e pa ndërprerje për një periudhë kohore prej 20 vjet.*

*Pra, në këtë rast gjykata e shkallës së parë, sipas gjetjeve të gjykatës së shkallës së dytë, nuk ka vërtetuar faktet vendimtare se paditësit kanë hyrë në posedim të pronës kontestuese, me mirëbesim, në kohëzgjatje prej 20 vitesh pa e ditur ose pa pasur mundësi të dinë se patundshmëria përkatëse nuk është pronë e tyre, sepse ata nuk kanë dëshmuar se kanë përmbushur detyrimin kontraktues.*

*Sipas praktikës gjyqësore, e cila bazohej në qëndrimet juridike të Gjykatave Supreme të ish RSFJ-së, konsiderohej se mbajtësi është posedues i ligjshëm dhe me mirëbesim, i sendit të paluajtshëm, sipas kontratës gojore të shitblerjes nëse kontrata e tillë, të cilës i mungon forma e shkruar, është përmbushur në tërësi nga palët kontraktuese, ose në pjesën dominuese. Pra, që blerësi të ketë paguar në tërësi ose pjesën më të madhe të çmimit blerës të pronës, ndërsa shitësi t'ia ketë dorëzuar pronën në posedim blerësit. Pra, në këtë rast konsiderohej se janë përmbushur kërkesa ligjore të paragrafit 2 të nenit 28 të LMTHJP, lidhur me nenin 73 të LMDS.*

## 10. KONFLIKTI ADMINISTRATIV

### 10.1 VLERËSIMI I RREGULLSISË SË PADISË

Ligji për Konfliktet Administrative (LKA) me dispozitën e nenit 33, ka rregulluar vlerësimin e rregullsisë së padisë.

*Neni 33 i Ligjit për Konfliktet Administrative*

- 33.1. Nëse padia nuk është e plotë, është e pakuptueshme ose ka të meta, kryetari i kolegjit do të ftojë paditësin që brenda afatit prej 8 ditëve, t'i mënjanojë të metat e padisë. Në ftesë duhet të ceken Udhëzimet për të mënjeluar të metat e padisë dhe paralajmërimi për pasojat që do të lindin nëse nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës.
- 33.2. Nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedh poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm.

#### 10.1.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës së nenit 33 par.2 të LKA-së

Neni 33 I LKA-së, vlerëson-rregullsinë e padisë, që d.m.th se cilat parakushte duhet t'i plotësojë padia që të mund të veprohet sipas saj. Gjykata që të mund të veprojë sipas padisë, padia duhet të jetë: a) e kuptueshme dhe b) t'i përmbajë të gjitha elementet e parapara me Ligjin për Konfliktet Administrative. Padia e tillë është (quhet) e rregullt.

1. Padia është e kuptueshme kur nga ajo në mënyrë të qartë del se çka paditësi me padi konteston, në cilin vëllim, për çfarë shkak dhe se çfarë vendimi kërkohet nga gjykata që të nxjerrë.
2. Se çka duhet të përfshihet në padi, në mënyrë të qartë është paraparë me Ligjin për Konfliktet Administrative përkatësisht neni 30. Prandaj, "padi të rregullt" duhet konsideruar çdo padi të kuptueshme që përmban të gjitha elementet e parapara me LKA.

Nëse padia nuk përmban disa nga pjesët obligative të theksuara ose shtesave ose është e pakuptueshme, gjykata një padi të tillë nuk mund thjeshtë ta hedhë poshtë por duhet të veprojë si në vështirim të nenit 33 par.1 të LKA-së. Mirëpo edhe përkundër asaj, duhet të interpretohet *in favore padia* e paditësit dhe të obligohet gjykata që të veprojë edhe sipas padisë së pa rregullt nëse të metat e padisë nuk pengojnë punën e gjykatës në kontest sepse Konflikti Administrativ konsiderohet i filluar me dorëzimin e padisë organit të paditur, që do të thotë se edhe për kundër thirrjes së paditësit që t'i mënjanojë të metat dhe afatin që i është dhënë për këtë nga gjykata, kontesti konsiderohet i filluar me ditën e dorëzimit të padisë në gjykatë. Shkak i tillë është mbrojtja e paditësit.

#### 10.1.2 Të gjetura nga praktika e Gjykatës së Apelit

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit – Departamentit për Çështje Administrative janë paraqitur raste kur dispozitat e LKA-së, nga neni 33 par.2 nuk janë zbatuar në mënyrë të drejtë.

Në disa raste vërehet se gjykata nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur parakushteve të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për nxjerrjen e një aktvendimi të tillë për hedhjen poshtë të padisë. Pra, gjykata nuk duhet të mjaftohet vetëm me rrethana se pala e paditur nuk i'a ka dorëzuar gjykatës aktin administrativ kontestues në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit të gjykatës për plotësimin e padisë, duke iu referuar nenit 30 lidhur me nenin 33 par.2 të LKA-së.

Në këtë kontest Gjykata e Apelit-Departamenti për Çështje Administrative vlerëson se më së shumti paqartësi për nxjerrjen e këtij aktvendimi janë paraqitur tek plotësimi i parakushteve që kanë të bëjnë me rregullsinë e padisë (neni 33 par.2 të LKA-së), sepse gjykata nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë nëse rregullsia e padisë del nga faktet e treguara në padi, për selinë e të paditurit dhe aktin administrativ kundër të cilit është drejtuar padia, arsyet pse ngritet padia, si dhe në cilin drejtim dhe vëllim propozohet anulimi i aktit administrativ.

### 10.1.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit

#### Aktvendimi AA.nr. 428/2016 i datës 10.05.2017

##### Arsyetimi

*"Gjykata e Apelit - Departamenti për Çështje Administrative duke ekzaminuar aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të ankesës, gjen se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë në këtë çështje juridike kontestuese nuk është i pranueshëm, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkëlqje thelbësore të dispozitave të Procedurës Kontestimore nga neni 182 par.1 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, sepse në kundërshtim me dispozitat e nenit 33 të LKA-së, gjykata ka nxjerr aktvendim për hedhjen poshtë të padisë.*

*Meqë nga shkresat e lëndës rezulton se në rastin konkret paditësi, me datë 07.04.2015, ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për anulimin e aktvendimit të të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë nr. 07.3/91 të datës 10.03.2015 duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm, sepse është shpallur përgjegjës dhe është dënuar me gjobë në të holla, prej 1.932.00 Euro, për kundërvajtje doganore dhe i është konfiskuar malli i cili ka qenë objekt i kundërvajtjes.*

*Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit, paraqitur kundër aktvendimit të paditurës nr.07.3/91 të datës 10.03.2015 e ka hedhë poshtë padinë e paditësit N.T.P Barnatorja "Guri" me seli në Prizren, si të pa rregullt. Me arsyetim se paditësi nuk ia ka dorëzuar gjykatës aktin administrativ kontestues nr. 07.3/91 të datës 10.03.2015 në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit të gjykatës për plotësimin e padisë, duke iu referuar nenit 30 lidhur me nenin 33 par.2 të LKA-së.*

*Kolegji i kësaj gjykate pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore dhe aktvendimit të kontestuar, vlerëson si jo të drejtë dhe të pabazuar këtë qëndrim juridik të dhënë në aktvendimin e ankimuar. Sepse, sipas dispozitës së nenit 33 par.2 të LKA-së, parashihet se "nëse paditësi, brenda afatit të cekur, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedh poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm".*

*Pra, për zbatimin e kësaj dispozite ligjore duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dy parakushte, që paditësi nuk ka evituar të metat në padi në afatin e përcaktuar dhe të bëhet fjalë për të meta të atilla që pamundësojnë zhvillimin e procedurës gjyqësore.*

*Në rastin konkret e meta e padisë i përket pas plotësimit të saj, dhe kjo e metë sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate nuk pamundëson punën e gjykatës, sepse në bazë të shënimeve në padi gjykata ka mund të marrë shkresën e organit administrativ në të cilin akti administrativ është marrë dhe më tutje të veprojë sipas padisë.*

*Bazuar në faktet se padia e paditësit ka shënime për selinë e të paditurit dhe aktin administrativ kundër të cilit është drejtuar padia, arsyet pse ngrihet padia, si dhe në cilin drejtim dhe vëllim propozohet anulimi i aktit administrativ, vërtetohet se padia i plotëson kushtet për të vepruar sipas saj.*

*Prandaj, nuk mund të konsiderohet se padia përmban të meta që e pengojnë punën e gjykatës nëse në padi është shënuar emri i organit të paditur që e ka nxjerrë aktin administrativ të kontestuar, datën e nxjerrjes së aktit administrativ dhe numrin nën të cilin akti administrativ është nxjerrë, pa marrë parasysh atë se akti administrativ nuk iu ka bashkangjitur padisë.*

*Andaj, kolegji i Gjykatës së Apelit, është dashur që ta miratojë ankesën e paditësit, e aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të prishet, dhe lënda t'i kthehet gjykatës së njëjtë në procedim të mëtutjeshëm, për vazhdim të procedurës, sepse nuk janë plotësuar parakushtet për hedhje poshtë të padisë”.*

## **10.2 HYRJA E PALIGJSHME DHE QËNDRIMI I PALIGJSHËM NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

Ligji për të Huajt me dispozitën e nenit 33, ka rregulluar vlerësimin e hyrjes së paligjshme në Republikën e Kosovës. Ndërsa, me dispozitën e nenit 95 të drejtën e ankesës dhe hapjes së konfliktit administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë.

*Neni 33 i Ligjit për të Huajt*

1. *Hyrja e paligjshme në Republikën e Kosovës konsiderohet kur i huaji:*
  - 1.1. *Kalon kufirin jashtë vendit apo kohës së caktuar për kalimin e kufirit Shtetëror.*
  - 1.2. *I shmanget kontrollit kufitar të përcaktuar me Ligjin për Kontrollin e Kufirit Shtetëror.*
  - 1.3. *Hyn në Territorin e Republikës së Kosovës, për derisa ka ndalesë për hyrje dhe qëndrim në Republikën e Kosovës.*
  - 1.4. *Ka konsumuar afatin tre (3) mujor të qëndrimit brenda 6 muajve;*
  - 1.5. *Ka hyrë në bazë të një dokumenti të udhëtimit, vize apo leje qëndrimi të falsifikuar, ndryshuar apo të dikujt tjetër.*

### *Neni 95 i Ligjit për të Huaj*

*I huaji i cili është subjekt i urdhër largimit, ka të drejtë ankese, brenda tetë (8) ditëve, nga dita e marrjes së Urdhër largimit pranë komisionit për ankesa. Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e pranimit të ankesës.*

*Në rastet kur i huaji është i pakënaqur me vendimin e komisionit të ankesave, atëherë mund të hap konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore, brenda tetë (8) ditëve, nga marrja e vendimit. Gjykata duhet ta zgjidh çështjen nga ky paragraf brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve, nga dita e pranimit të padisë.*

*Ankesa kundër urdhër largimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.*

### **10.2.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës së nenit 33 par. 1 nenpar.1.4 dhe neni 95 par.2 i Ligjit për të Huaj**

Neni 33 i Ligjit për të Huaj, vlerëson se kur konsiderohet hyrja e paligjshme në Republikën e Kosovës, nga i huaji, që d.m.th. se cilat kushte duhet të plotësohen që i huaji të konsiderohet se ka hyrë dhe qëndron në mënyrë të paligjshme në Republikën e Kosovës.

Është me rëndësi të theksohet për praktikën gjyqësore se ky lloj i aktgjykimit duhet të merret brenda afateve të përcaktuara ligjore si në vështrim të nenit 95 par.2 të Ligjit për të Huaj.

Kushtet e lartë cituara nga ana e gjykatës duhet të vlerësohen në mënyrë bindëse dhe të argumentuar, e posaçërisht kur kemi të bëjmë me rastet e zbatimit të dispozitës së nenit 33 par.1 nën.par.1.4 kur bëhet fjalë për konsumimin e afatit 3 mujor, të qëndrimit brenda 6 muajve.

Në disa raste vërehet se gjykata nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur këtyre kushteve të cilat duhet të plotësohen për nxjerrjen e një vendimi të drejtë dhe ligjor. Pra gjykata nuk duhet të mjaftohet vetëm me theksime të palës së paditur por duhet që ato fakte të argumentohen me prova bindëse. Në këtë kontest Gjykata e Apelit –Departamenti për Çështje Administrative, vlerëson se më së shumti paqartësi për nxjerrjen e këtij aktgjykimi janë paraqitur tek plotësimi i kushteve që kanë të bëjnë me atë se paditësi a ka konsumuar dhe tejkalar afatin tre (3) mujor, të qëndrimit brenda gjashtë (6) muajve, (neni 33 par.1 nën.par.1.4 i Ligjit për të Huaj). Sepse gjykata nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë faktet e treguara në padi për paditësin se a ka konsumuar dhe tejkalar afatin 3 mujor të qëndrimit brenda 6 muajve.

### **10.2.2 Të gjetura nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit – Departamentit për Çështje Administrative i janë paraqitur raste kur dispozitat e nenit 33 par.1 nenpar.1.4 dhe neni 95 par.2 i Ligjit për të Huaj, nuk janë përfillur dhe zbatuar në mënyrë të drejtë.

Në disa raste vërehet se gjykata nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur kushteve dhe afateve të cilat duhet të plotësohen për nxjerrjen e një aktgjykimi të drejtë dhe ligjor, për të mos bërë shkelje të dispozitave të procedurës së konfliktit administrativ dhe legjislacionit në



fuqi. Pra, gjykata nuk duhet të mjaftohet vetëm me thëniet e palës së paditur, por duhet vërtetuar bazën faktike duke u bazuar në prova konkrete për nxjerrjen e një vendimi të ligjshëm, duke vepruar në përputhje me ligjin për ta zgjedhur çështjen brenda afatit.

Në këtë kontest Gjykata e Apelit- Departamenti për Çështje Administrative vlerëson se më së shumti paqartësi për shkelje të dispozitave procedurale juridike janë paraqitur për shkak të mos shqyrtimit me prioritet të këtyre rasteve dhe se nuk është vërtetuar baza faktike e nxjerrjes së vendimit të ligjshëm të bazuar në prova, sepse gjykata nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe nuk ka përfill afatet kohore për ta zgjidhur çështjen.

### **10.2.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

#### **Aktgjykimi AA.nr.373/2016 i datës 07.03.2017**

##### **Arsyetimi**

*"Gjykata e Apelit - Departamenti për Çështje Administrative, duke e ekzaminuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, brenda kufijve të ankesës, gjen se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, në këtë çështje juridike kontestuese nuk është i pranueshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 nënpar.n) dhe nga neni 183 i LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, se është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe arsyetimin e tij, dhe si i tillë është jo i plotë edhe në vërtetimin e gjendjes faktike.*

*Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.594/2016, të datës 29.11.2016, është refuzuar si e pa bazuar kërkesë-padia e paditësit A.Z me vendbanim në rr. Bulevardi Zogu i parë në Tiranë, Republika e Shqipërisë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit me nr.11/2016 të datës 05.04.2016 të Ministrisë së Punëve të Brendshme-Komisioni për Ankesa të Huajve.*

*Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë paditësi A. Z., përmes përfaqësuesit të autorizuar avokat Tomë Gashi nga Prishtina, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës së konfliktit administrativ dhe legjisllacionit në fuqi, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Duke pohuar se gjykata nuk ka vepruar në përputhje me ligjin për ta zgjidhur çështjen brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e pranimit të padisë, të paraparë me nenin 95 paragrafi 2 të Ligjit për të Huaj, por ka vendosur vetëm pas dyqind e njëzet e tetë (228) ditëve. Andaj, ka shkelur dispozitat procedurale juridike në dëm të paditësit. Në këtë kuptim ka shkelur të drejtën themelore të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, respektivisht nenit 31 paragrafi 2 si dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Po ashtu gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktgjykim në dëm të paditësit pa i dëgjuar palët, duke ekzistuar mundësia e caktimit të një seancë tjetër, në kuptim të një gjykimi të drejtë. Në arsyetimin e aktgjykimit nuk është konstatuar fare fakti procedural se a e ka përmbushur pala e paditur detyrimin nga neni 37 paragrafi 3 i LKA-së, për t'i dërguar gjykatës të gjitha shkresat që kanë të bëjnë me lëndën.*

*Pastaj se gjykata ka përfshirë në procedurën e administrimit të provave vetëm tri prova që janë parashtruar nga paditësi, kështu që nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, për shkak*

se nuk janë vërtetuar faktet relevante për të ardhur deri të konstatimi i drejtë për zbatim të drejtë të së drejtës materiale, se vendimi i të paditurës nuk është mbështetur në prova konkrete. Për këto arsye duke marrë për bazë standardin ligjor të përcaktuar me nenin 43 paragrafi 1 të LKA, se gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative, e pikërisht për këtë ka parashtruar padinë se nuk është vërtetuar baza faktike e nxjerrjes së një vendimi të ligjshëm të bazuar në prova. Ngase hyrja e paligjshme në territorin e Kosovës, dhe qëndrimi përtej afatit ligjor për qëndrim të huajve janë rrethana faktike që duhet vërtetuar. Andaj, duke u mbështetur në pretendimet e lartcekura, propozon që ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe të prishet aktgjykimi i ankimuar, e të anulohet vendimi Nr.ref.11/2016, i Komisionit të Ankesave për të Huajt për shkak të pavlefshmërisë absolute, dhe të udhëzohet pala paditëse që kërkesat pasurore juridike t'i realizojë në procedurën kontestimore.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se: Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.594/2016 të datës 29.11.2016, është refuzuar kërkesëpadija e paditësit A. Z, e ushtruar kundër të paditurës Ministrisë së Punëve të Brendshme-Komisioni për Ankesa të Huajve, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit me nr.11/2016 të datës 05.04.2016, si e pabazuar, me arsyetim se paditësi me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e tij, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, bazuar në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të aktgjykimin e duke i pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, vlerëson se, pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë tani për tani nuk mund t'i përkrah si të drejta dhe ligjore. Kolegji gjen se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkëlqje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 nenpar. n), dhe nga neni 183 i LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, se është juridikisht i paqartë dhe kundërtënë me vetveten dhe me arsyetimin e tij, dhe si i tillë është jo i plotë edhe në vërtetimin e gjendjes faktike, për çka në mënyrë të bazuar në ankesë theksohet, se ekzistojnë kundërtënie në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimin, e kjo si pasojë se nuk janë administruar të gjitha provat. Nga një arsyetim i tillë i aktgjykimin të kontestuar nuk është e qartë se prej cilës datë paditësi ka hyr në territorin e Republikës së Kosovës dhe deri në cilën datë paditësi ka konsumuar dhe tejkaluar afatin tre (3) mujor të qëndrimit brenda gjashtë (6) muajve afat ky i parashikuar me Ligjin për të Huajt që hyjnë pa vizë, meqë nuk janë prezantuar prova lidhur me këtë.

Prandaj, aktgjykimi i kontestuar është juridikisht i paqartë dhe kundërtënë me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Ngase janë përdorur formulime të përgjithësuara në lidhje me vlerësimin e thënieve të paditësit në padi, siç janë se pretendimet e paditësit në padi janë të pa bazuara, sepse janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me shkresat e lëndës. Pastaj, se paditësi i ka konsumuar të drejtat të cilat i garantohen me ligj dhe se edhe më tutje nuk ka poseduar leje qëndrim të vlefshëm për qëndrim, pa administruar provat lidhur me këto konstatime. Prandaj paditësi në ankesë në mënyrë të bazuar pretendon se gjykata me rastin e refuzimit të padisë, nuk ka

*dhënë vlerësime as sqarime lidhur me pretendimet e kërkesëpadiisë së paditësit, me të cilat e konteston vendimin refuzues të urdhër largimit vullnetar të lëshuar nga DSHAM dhe mbetjes në fuqi të ndalimit të hyrjes në territorin e Republikës së Kosovës, për një periudhë prej 2 muajve.*

*Në këto pretendime të kërkesë-padiisë, të cilat edhe sipas mendimit të kolegjit të Gjykatës së Apelit, janë vendimtare e që kanë të bëjnë me urdhër për largim vullnetarë nga Republika e Kosovës. Vlerësimin e saj nuk e kanë dhënë organet administrative me arsytim të formuluar qartë, duke përfshirë shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike si në vështrim të nenit 86 par.1 të LPA-së, lidhur me qëndrimin e tij të saktë për sa kohë ai qëndron në Kosovë. Ndërsa, gjykata e shkallës së parë nuk ka administruar asnjë provë lidhur me këtë, edhe pse e paditura duhet të posedon regjistrin nga Policia e Kosovës, për lëvizjen e paditësit në kalimet kufitare. Prandaj, aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelle esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n), dhe nga neni 183 i LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, së është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Për arsye se, i njëjti nuk mund të ekzaminohet si i tillë, se është jo i plotë, sepse gjendja faktike e çështjes në shqyrtim, sipas pretendimeve në padi të paditësit, rezulton se nuk është shqyrtuar.*

*Duke mos administruar provat vendimtare, që kanë pasur ndikim në marrjen e vendimit, nga të cilat varet zbatimi i të drejtës materiale dhe procedurale, dhe me lënien mënjane të pretendimeve vendimtare të padiisë, gjykata me aktgjykimin e tillë shkakton shkelle të rregullave procedurale në konfliktet administrative, për çka ankesa është dashtë doemos që të aprovohet dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, ashtu që në procedurë e përsëritur, gjykata e shkallës së parë ti ndërmarr të gjitha veprimet procedurale dhe ti mënjanoj të metat e sipër përmendura.*

*Andaj, gjykata e shkallës së parë duhet të kujdeset që çështja kontestuese të shqyrtohet në tersi, ngase ky kontest nuk mund të shqyrtohet pa i bashkangjitur provat në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative se ato në pikat kyçe nuk janë vërtetuar në mënyrë të plotë, se kontestues është fakti i qëndrimit të tij të vërtetë në territorin e Republikës së Kosovës. Pra, të konstatohet Konkretisht nga regjistri për kalime kufitare për paditësin se a ka konsumuar dhe tejkaluar afatin 3 mujor të qëndrimit brenda 6 muajve afat ky i parashikuar me nenin 33 paragrafi 1.4 të Ligjit për të Huaj. Meqë komisioni i të paditurës duke u bazuar në të dhënat BMS, dhe pas numërimit të hyrjeve - daljeve pretendon se i njëjti ka qëndruar 96 ditë në territorin e Republikës së Kosovës, që është në kundërshtim me dispozitën e lartcekur të Ligjit për të Huaj.*

*Meqë palët janë të obliguara të paraqesin të gjitha faktet në të cilat i bazojnë kërkesat e tyre, të propozojnë provat e nevojshme për vërtetimin e tyre dhe të deklarohen për pohimet faktike dhe provat e propozuara të palëve tjera. Gjykata mundet të kërkoj deklarim për çështje të caktuara të cilat kanë të bëjnë me faktet dhe propozimin e provave që vërtetojnë pohimet e tij. Për ketë qëllim gjykata nga pala mund të kërkojë që në afat të caktuar t'i plotësojë dhe arsyetojë parashitresat dhe pohimet e tij, duke i dorëzuar dokumentet të cilat mund të shërbejnë si dëshmi në kontest. Nga shkresat nuk mund të konstatohet se në cilat prova relevante paditësi i bazon pretendimet e tij, në mënyrë që të sqarohen dhe vërtetohen të gjitha faktet e nevojshme dhe rrethanat që janë me ndikim për zgjidhjen e kontestit, duke i pasur parasysh edhe rrethanat tjera, ashtu që theksimet jo të plota të*

*palëve të plotësohen me prova e dëshmi dhe deklarata të tyre etj. Pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë ka mundësi të bie aktgjykim të drejt në kuptim të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative”.*

### **10.3 PERSONI I INTERESUAR**

Ligji për Konfliktet Administrative (LKA) me dispozitën e nenit 21, ka rregulluar se kush ka pozitën e palës së interesuar në Konfliktin Administrativ.

*Neni 21 i Ligjit për Konfliktet Administrative*

*Pozitën e palës në Konfliktin Administrativ e ka edhe personi, të cilit, anulimi i aktit administrativ të kontestuar, do t'i sillte dëm të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.*

#### **10.3.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës së nenit 21 të LKA-së**

Neni 21 I LKA-së përcakton se kush e ka pozitën e palës së interesuar në konfliktin administrativ. Rrethi i personave të interesuar në konfliktin administrativ është zgjeruar duke e lënë konceptin me të cilin pozita e palës së interesuar i është njohur vetëm atyre personave të cilëve akti administrativ i anuluar drejtpërdrejt u ka sjell dëm.

Pozitën e palës së interesuar e ka:

1. Çdo person që anulimi, ndryshimi ose nxjerrja e aktit administrativ, veprimi ose mos veprimi i organit publik përkatësisht lidhja, revokimi ose ekzekutimi i kontratës administrative do të cenon të drejtën e saj ose interesin juridik.
2. Organi publik që konsideron se vendimi gjyqësor mund të ketë ndikim me të drejtat dhe interesat juridike që ai organ publik i mbron në bazë të ligjit.

Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Administrative sipas detyrës zyrtare ose me propozimin e palës do ta ftojë personin e interesuar që të marr pjesë në kontest. Ai person mund të inkuadrohet në kontest në çdo moment. Pala e interesuar është e autorizuar, si dhe paditësi, që vetë t'i marrë të gjitha veprimet në procedurë në supozimin që është i aftë të veprojë. Në emër të saj në procedurë mund të marrë veprime dhe personi i autorizuar për përfaqësimin e saj - përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi i përbashkët. Mirëpo, gjykata mundet që personin e interesuar ta ftojë edhe personalisht të deklarohet për faktet e caktuara.

#### **10.3.2 Të gjetura nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit - Departamentit për Çështje Administrative janë paraqitur raste kur dispozitat e LKA-së, nga neni 21, nuk janë zbatuar në mënyrë të drejtë.

Në disa raste vërehet se gjykata nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të nenit 21, 37 par.1 dhe nenit 39 par.1 të LKA-së, së personit të interesuar nuk i është ofruar mundësia për të marrë pjesë në Konfliktin Administrativ me të drejta të palës në atë konflikt. Ndërsa, gjykata ka për detyrë që t'ia dërgojë një kopje të padisë personit të interesuar e jo vetëm organit të paditur dhe në këtë mënyrë realizohet parimi i kontradiktoritetit dhe drejtpërdrejtëshmerisë. Personi i interesuar ka të drejtë të njohet me

përmbajtjen e padisë, prandaj për këtë arsye edhe duhet ti dërgohet edhe kopja e padisë me anekset, në mënyrë që të ketë mundësi ti mbrojë të drejtat dhe interesat e veta ligjore.

Në këtë kontest Gjykata e Apelit- Departamenti për Çështje Administrative vlerëson se më së shumti paqartësi nga gjykata e shkallës së parë janë paraqitur në atë se gjykata nuk i ka njohur këto të drejta palës së interesuar nga dispozitat e lartë cekura të LKA-së. Sepse gjykata nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë se kush e ka pozitën e palës së interesuar në konfliktin administrativ. Meqë rrethi i personave të interesuar me Ligjin për Konfliktet Administrative është zgjeruar duke ia njohur këtë të drejtë edhe personave që akti administrativ i anuluar do ti sillte dëm të tërthortë.

### **10.3.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

**Aktvendimi AA.nr. 182/2016, i datës 05.01.2017**

#### **Arsyetimi**

*“Gjykata e Apelit-Departamenti për Çështje Administrative duke ekzaminuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të ankesës, gjen se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë në këtë çështje juridike kontestuese nuk është i pranueshëm, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 21, 37 dhe 39 të Ligjit për Konfliktet Administrative, sepse aktvendimi është në kundërshtim me dispozitat e LKA-së, ngase gjykata nuk u ka njohur të drejtat që i takojnë palës së interesuar.*

*Meqë, nga shkresat e lëndës rezulton se personi i interesuar Agjencia Kosovare e Privatizimit me datën 31.05.2016 në cilësinë e ndërhyrësit në anën e të paditurës në këtë lëndë, ka parashtruar parashtrësën me propozim për ndërhyrjen e AKP-së në procedurën administrative të hapur sipas padisë së paditësit në konfliktin administrativ duke pohuar se ka interes juridik me qenë palë ndërhyrëse në anën e të paditurës në këtë procedurë të konfliktit administrativ, se nuk ka qenë në dijeni për zhvillimin e një procedure të tillë lidhur me kundërshtimin e regjistrimit të të drejtave pronësore të cilat burojnë nga vendimi i Bordit të AKP-së Ref.BD-47/3 të datës 31.05.2012 për anulimin e marrëveshjes së zotimeve me numër 587/2005 të datës 10.09.2006 të lidhur në mes të ish Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) dhe Ndërmarrjes së Re Grand Hotel SHPK dhe Ndërmarrjes NTP “Union Commerce”. Me tej pohon se AKP ka fituar kontestin civil të hapur sipas padisë së paditësit për çështje meritorë dhe se e drejta e AKP-së për anulimin e marrëveshjes së theksuar më lartë është e drejtë dhe e ligjshme, ngase është paraparë me ligj dhe në vet marrëveshjen “që eventualisht për mos përbushjen e zotimeve do t'i merren aksionet”.*

*Këto veprime të ndërmarra nga AKP janë kontestuar nga paditësjja në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme si gjykatë kompetente e cila ka vendosur në të gjitha instancat deri në plotfuqishmëri duke refuzuar kërkesëpadinë e paditëses. Prandaj AKP ka interes juridik që të vërtetohet edhe në procedurën e konfliktit administrativ vendimi i kontestuar. Propozon që të pranohet propozimi i propozueses AKP, për ndërhyrjen në procedurën e konfliktit administrativ në anën e të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe të aprovohet ankesa e AKK në tërësi si e bazuar dhe të priset aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.*

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, propozimin për ndërhyrjen e AKP-së në procedurë në anën e të paditurës, parashtresën e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit për kundërshtimin e propozimit të AKP-së për ndërhyrje në procedurën administrative, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se: ankesa është e bazuar.

Kolegji i kësaj gjykate duke pasur parasysh pretendimet ankimore dhe theksimet në parashtresën e AKP-së me propozim për ndërhyrje në procedurë, se ka interes juridik me qenë palë ndërhyrëse, vlerëson së aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë, ngase përmban shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 21, 37, dhe 39 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Me dispozitën e nenit 21 të LKA-së, përcaktohet, pozita e palës në konfliktin administrativ e ka edhe personi, të cilit anulimi i aktit administrativ të kontestuar, do ti sillte dëm të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Në rastin konkret ky presupozim është plotësuar. Ngase pala e interesuar AKP nuk ka qenë i përfshirë dhe nuk iu ka dhënë mundësia që të jetë palë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë, të cilat bëjnë shkelje esenciale të dispozitave të lartcekura që ky aktgjykim të mos mund të ekzaminohet, si i tillë se është jo i plotë për faktin se nuk janë dhënë arsye përkritazi me faktet vendimtare. Sepse në këtë çështje juridike, nuk ka qenë i përfshirë pala e interesuar, dhe nuk janë administruar në tërësi provat e nevojshme për faktet kontestuese, për t'u vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike dhe për tu aplikuar drejtë dispozitat juridike materiale.

Ndërsa, me dispozitën e nenit 37 par. 1 të LKA-së përcaktohet se: nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë, sipas paragrafit 2 të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji ose nuk e anulon aktin administrativ sipas nenit 35 të këtij ligji gjykata do t'ia dërgojë nga një kopje të padisë dhe të dokumenteve të bashkangjitura në përgjigje palës së paditur dhe personave të interesuar. Kurse me dispozitën e nenit 39 par. 1 të LKA-së përcaktohet se gjyqtari mbikëqyrës e cakton ditën e shqyrtimit dhe në shqyrtim do të ftojë palët dhe personat e interesuar. Prandaj, në rastin konkret nga shkresat e lëndës rrjedh se Agjencia Kosovare e Privatizimit duhet të jetë në cilësinë e palës së interesuar, meqenëse me vendimet e organeve administrative vendosej e drejta për regjistrimin e pronës për ngastrën Kadastrale, e që njëra nga pjesëmarrëset doemos është dashur të jetë AKP si palë e interesuar konform dispozitave ligjore të lartcekura të LKA-së. Ngase rikthimi i së drejtës së pronësisë së paluajtshme në emër të ish pronarit e cila administrohet nga AKP është bërë sipas vendimit të AKP-së me numër nr. Ref.BD-47-3 të datës 31.05.2012, e cila në pajtim me dispozitat ligjore i ka bartë të drejtën e shfrytëzimit dhe posedimit.

Gjykata e shkallës së parë, siç rezulton nga shkresat e lëndës dhe arsyetimi i aktgjykimit nuk ka ftuar palën e interesuar për shqyrtimin e kontestit edhe pse shihet qartë interesi i tij për pjesëmarrje në kontest, pasi ka të drejtë në pjesëmarrje për të mbrojtur interesat të cilat i janë përcaktuar me ligj. Pala e interesuar në konfliktin administrativ është palë, që do të thotë se gjykata e shkallës së parë është e obliguar që t'ia dërgoj padinë në përgjigje, ajo ka të drejtë që të propozoj nxjerrjen e provave dhe të ndër marr veprime të tjera në kontest, ka të drejtë që të marr pjesë në shqyrtimin verbal, të deklarohet për të gjitha faktet dhe çështjet juridike, dhe duhet t'i dërgohet vendimi gjyqësor. Pala e interesuar gjithashtu ka të drejtë të shfrytëzimit të gjitha mjeteve juridike në konfliktin administrativ. Ajo është e autorizuar, si dhe paditësi, që në mënyrë të pavarur të ndërmarrë të gjitha veprimet në kontest nën supozimin se është plotësisht e aftë për ndërmarrjen e veprimeve në kufijtë e

*aftësive të veprimit. Në emër të tij veprime në kontest mund të ndërmarr edhe personi i autorizuar për përfaqësime i palës së interesuar. Prandaj, nga shkresat e lëndës del se gjykata e shkallës së parë nuk i ka njohur këto të drejta palës së interesuar. Meqë në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë për këtë, dhe as arsyetim se për çfarë arsye nuk ju kanë njohur këto të drejta dhe dhëne mundësia që të jetë palë në procedurë.*

*Prandaj, edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht.*

*Si pasojë e këtyre të metave të cekura me lartë, e që janë të tilla, që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, dhe shkeljeve thelbësore të procedurës rezulton se edhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë jo të plotë, dhe në një gjendje të tillë faktike e drejta materiale nuk është zbatuar drejtë”.*

## **10.4 EFEKTI SHTYRËS I PADISË**

Ligji për Konfliktet Administrative (LKA) me dispozitën e nenit 22 par.2 dhe 6, ka rregulluar efektin shtyrës së padisë.

*Neni 22 par.2 dhe 6 i Ligjit për Konfliktet Administrative*

*Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendim definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.*

*Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrative deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni.*

### **10.4.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës së nenit 22 par.2 dhe 6 të LKA-së**

Me dispozitën e nenit 22 par.2 të LKA-së, përcaktohet se masa e përkohshme mund të jepet vetëm me kërkesën e palës dhe vetëm atëherë kur kjo është e domosdoshme për t'u evituar dëmi i cili vështirë do të riparohej. Propozuesi i masës së përkohshme është i detyruar që me propozim të bëjë të besueshëm ekzistimin e ndonjë kërkesë dhe rrezikun se pa ndërmarrjen e ndonjë mase të përkohshme realizimi i kërkesës do të jetë dukshëm i vështirësuar. Meqenëse gjykata mund të vendosë që padia të ketë efekt shtyrës nëse me ekzekutimin e vendimit paditësit do t'i shkaktohej dëm i cili vështirë do të riparohej. Masën e përkohshme gjykata mund ta zbatojë në rend të parë në kontestet lidhur me padi që kërkohet veprim që i padituri në pajtim me dispozitat ose vendimi eventual është i obliguar ta ekzekutojë.

Ligji nuk ka përcaktuar se cilat masa të përkohshme mund të jepen, por gjykatat kanë liri të madhe në zbatimin e nenit 22 të LKA-së. Në çdo rast masat e përkohshme duhet të jenë ato me të cilat arrihet në mënyrë me të mirë qëllimi.

Padia në Procedurën Administrative Gjyqësore, si rregull nuk ka efekt suspensiv, d.m.th. nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur.

Mirëpo, me qëllim të mbrojtjes së interesave të palës, LKA lejon mundësinë që akti administrativ i cili ekzekutohet, përkatësisht gjykata duhet ta shtyjë ekzekutimin e aktit administrativ në lidhje me padinë e paraqitur. Pra sipas LKA-së, i janë dhënë autorizime gjykatës e cila vendos me rastin e padisë për anulimin e aktit kontestues, që ta shtyjë ekzekutimin e aktit të tillë. Mirëpo, me kërkesën e paditësit gjykata mund ta shtyjë ekzekutimin e aktit administrativ deri në nxjerrjen e vendimit definitiv gjyqësorë në këto raste:

1. Në qoftë se ekzekutimi do t'i shkaktonte dëme paditësit i cili vështirë do të riparohej.
2. Kur shtyrja ekzekutimit nuk është në kundërshtim me interesin publik.
3. Se me shtyrjen e ekzekutimit do t'i shkaktohej dëm i madh palës kundërshtare.
4. Se me shtyrjen e ekzekutimit do t'i shkaktohej dëm i madh personit të interesuar.

Paditësi bashkë me kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit duhej paraqitur provën që të tregon se padia i është parashtruar gjykatës kompetente me të cilën ka filluar konflikti administrativ. Po ashtu, duhet të paraqesë provën mbi lartësinë e dëmit që është shkaktuar me rastin e ekzekutimit të aktit administrativ kontestues.

Në rastin kur gjykata refuzon kërkesën për masë të përkohshme për shkak se shtyrja e ekzekutimit i kundërvihet interesit publik është e detyruar të theksoi se në çka konsiston (qëndron) kundërshtimi i interesit publik. Po ashtu, nëse kërkesën e refuzon për shkak se me shtyrjen e ekzekutimit do ti shkaktohej palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar dëm i madh i pa kompensueshëm, duhet t'i theksojë të dhënat nga të cilat do të shihet se në çka qëndron ai dëm, dhe se ai dëm është i njëjtë ose ma i madh se dëmi që do t'i shkaktohej paditësit me ekzekutimin e aktit administrativ, ose në të vërtetë është i pa kompensueshëm ai dëm. Këto kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

#### **10.4.2 Të gjetura nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit – Departamentit për Çështje Administrative i janë paraqitur raste kur dispozitat e LKA-së, nga neni 22 par. 2 dhe 6 nuk janë zbatuar në mënyrë të drejtë.

Në disa raste vërehet se gjykata nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur parakushteve të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për nxjerrjen e një aktvendimi të tillë për miratimin e kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor sipas kushteve të parapara në par.2 të nenit 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Pra, gjykata me rastin e vendosjes duhet të vlerësojë se a janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit si në vështrim të nenit 22 par.2 të LKA-së, meqë argumentet në të cilat bazohet duhet argumentuar.

#### **10.4.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

**Aktvendimi AA.nr. 382/2016 i datës 01.12.2016**

##### **Arsyetimi**

*“Gjykata e Apelit-Departamenti për Çështje Administrative duke ekzaminuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të ankesës, gjen se qëndrimi dhe përfundimi*



juridik i gjykatës së shkallës së parë në këtë çështje juridike kontestuese nuk është i pranueshëm, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, sepse në kundërshtim me dispozitat e nenit 22 par.2 të LKA-së, gjykata ka nxjerr aktvendim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar të paditurës.

Meqë duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së të paditurës, kolegji i kësaj gjykate, gjen se gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit, për shtyrje e ekzekutimit të vendimit nr.97/2016 të datës 08.09.2016, të MPMS-TEIP në Prishtinë, me të cilin ka aprovuar si të bazuar propozimin për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit. Gjykata e shkallës së parë, ka pasur për detyrë që në kuadër të nevojës për zgjedhje të ngutshme, të vlerësojë se a janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet e parapara me nenin 22 par.2 të LKA-së për rastin konkret, duke marrë parasysh natyrën specifike të rastit, ngase është fjala për vendim me të cilin është refuzuar si e pabazuar ankesa e subjektit në procedurë Gazeta Online "Insider" me seli në Prishtinë, ndërsa është vërtetuar vendimi i organit të shkallës së parë të IP me nr.56-47/2016A2, për shqiptimin e gjobës në shumë prej 1.500 (njëmijë e pesëqind) euro.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pas shqyrtimit të ankesës se të paditurës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës të Kosovës nr.97/2016 të datës 08.09.2016, qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nuk mund ta përkrahë si të drejtë dhe të ligjshëm. Ngase sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Meqë argumentet në të cilat bazohet gjykata e shkallës së parë, nuk janë të dëshmuara me asgjë, se me ekzekutimin e vendimit të paditurës, paditësit do t'i shkaktojë një dëm i cili vështirë mund të riparohet, kështu që sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës së Apelit, nuk janë plotësuar kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Sepse me dispozitën ligjore të nenit 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, përcaktohet se shtyrja e ekzekutimit mund të bëhet deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohet, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Në mënyrë të bazuar e paditura-ankuesja MPMS-TEIP, kundërshton që lënda e kërkesëpadisë "është më e gjerë" se propozimi për caktimin e masës së përkohshme në rastin konkret. Ngase mos ekzekutimi i vendimeve të ekzekutueshme do t'i sjell dëm palës së paditur, se TEIP-in si institucion që mbikëqyrë zbatimin e ligjeve, do e sjell në precedent edhe subjektet tjera që nuk e zbatojnë ligjin në fuqi. Andaj konsideron se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të drejtës materiale, kur ka treguar rastin prima facie, meqë nuk ka marrë për bazë gjendjen faktike, dhe nuk e ka bërë vlerësimin e ligjshmërisë në mënyrë të drejtë. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, propozuesi nuk ka paraqitur ndonjë argument, se pse masa e përkohshme është e nevojshme për të evituar dëme të riparueshme, ose nëse vendosja e kësaj mase të përkohshme është në interes publik, ashtu siç kërkohet me nenin 22 par.2 të LKA-së. Ngase kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme duhet argumentuar mbi baza reale të shkakut të dëmit të riparueshëm, vlera e të cilit është e pa kompensueshme në kuptimin material dhe

*monetar. Kështu që një qëndrim i tillë i gjykatës së shkallës së parë, tani për tani nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm.*

*Për shkak të qëndrimit të gabuar juridik, gjykata e shkallës së parë ka lëshuar të vërtetojë faktet qenësore në mënyrë të plotë dhe bindëse për t'u aprovuar propozimi dhe për t'u lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, deri në vendosje sipas padisë së paditësit. Sepse nuk është dëshmuar se paditësit do t'i shkaktohet dëm i cili vështirë do të riparohej, dhe se vlerësimi i këtij kolegjii është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar, siç parashihet me nenin 22 par.2 të LKA-së.*

*Sepse një nga kriteret për garantimin për aprovimin e kërkesës, për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësorë të masës së përkohshme është, nëse do të shkaktohen dëme të riparueshme.*

*Prandaj, nëse Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me rastin e vendosjes sipas padisë, gjen se vendimi i të paditurës është i paligjshëm, atëherë çfarëdo dëmi i shkaktuar ndaj paditësit mund të llogaritet dhe mund të kompensohet. Andaj, nuk ka asgjë të riparueshëm në rastin konkret, për çka ankesa është dashur që të miratohet dhe të anulohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, duke refuzuar propozimin e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të MPMS-TEIP, deri në marrjen e vendimit lidhur me kërkesë-padinë e paditësit. Ngase, nga kjo bazë nuk mund të argumentohet caktimi i masës së përkohshme të kërkuar.*

*Prandaj, kolegjii Gjykatës së Apelit, pa paragjykim ndaj vendimi të mëtejme, që do të nxirret nga gjykata e shkallës së parë, për kërkesë-padinë e paditësit, konstaton se kërkesa për masë të përkohshme, duhet të refuzohet si e pabazuar”.*

## **10.5 GJUHA NË PROCEDURË**

### **10.5.1 Procedura në konfliktin administrativ zhvillohet në gjuhën që është në përdorim zyrtar në gjykatë**

Ligji për Procedurën Kontestimore me dispozitën e nenit 96 par.1 dhe neni 97 të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka rregulluar përdorimin e gjuhës në Procedurën Administrative- Gjyqësore.

*Neni 96 par.1 dhe neni 97 i Ligjit për Procedurën Kontestimore.*

*Neni 96 par.1 i LPK-së, palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë kanë të drejtë që në procedurë para gjykatës të përdorin gjuhën e vet apo gjuhën të cilën e kuptojnë.*

*Neni 97 i LPK-së, letërthirrjet, vendimet dhe shkresat e tjera gjyqësore, u dërgohen palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë në gjuhën që është në përdorim zyrtar në gjykatë. në procedurën për konfliktet administrative, zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, nëse ligji nuk përmban dispozita për procedurë në konflikt administrativ.*

### **10.5.2 Koment i shkurtër për përdorimin e gjuhës në procedurën administrative-gjyqësore**

Pala në procedure administrative gjyqësore mund të shërbehët me gjuhën e vetë. Nëse, procedura administrative gjyqësore nuk zhvillohet në gjuhën e palës, organi me anë të interpretit duhet t'ia mundësojë ndjekjen e rrjedhjes së procedurës në gjuhën e vetë.

Rregullat mbi përdorimin e gjuhës në procedurën gjyqësore dhe në procedura tjera ligjore (administrative, kundërvajtëse, kontestimore etj.), vlejné edhe për procedurë administrative-gjyqësore. Lëshimi që palës me pjesëmarrjen e interpretit t'ia sigurojë mundësinë e përdorimit të gjuhës së vet është shkelje esenciale e rregullave të procedurës, e cila ka mundur të ketë ndikim në vendosjen e çështjes.

### **10.5.3 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit – Departamentit për Çështje Administrative i janë paraqitur raste kur dispozitat e LKA-së, nga neni 96 par.1 dhe 97 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, nuk janë zbatuar në mënyrë të drejtë.

Në disa raste vërehet se gjykata nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur parimit të përdorimit të gjuhës së vet në procedurën administrative- gjyqësore. Pra, çështja e përdorimit të gjuhës në një proces si e drejt elementare dhe fundamentale e njeriut është kategori kushtetuese dhe si e tillë mbrohet me KEDNJ dhe KRK. E drejta e përdorimit të gjuhës është e rregulluar edhe me nenin 6 të LPK dhe Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

Në këtë kontest Gjykata e Apelit- Departamenti për Çështje Administrative vlerëson se më së shumti paqartësi janë paraqitur në procedurën administrative gjyqësore meqë gjykata nuk ka vepruar në tërësi sipas Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, i cili duhet të zbatohet në mënyrë të plotë, për të mundësuar barazinë e komuniteteve para ligjit.

### **10.5.4 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

**Aktvendimi AA.nr393/2014, i datës 09.12.2014**

#### **Arsyetimi**

*“Gjykata e Apelit - Departamenti për Çështje Administrative duke ekzaminuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të ankesës, gjen se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë në këtë çështje juridike kontestuese nuk është i pranueshëm, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 nënpar. j) të LPK-së dhe neni 14 të Ligjit nr.02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së.*

*Kolegj, pasi që i shqyrtoi thëniet në ankesë, aktvendimin e ankimuar dhe shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat konsistojnë në atë se, paditësit u kanë dorëzuar vërejtjet për pagesën e taksës gjyqësore në gjuhën të cilën ai nuk e kupton, meqë nga procesverbali për shqyrtimin kryesor, konstatohet se është marrë në pyetje në gjuhën serbe përmes përkthyesit të gjykatës, dhe se është deklaruar se nuk e kupton gjuhën shqipe.*

*Meqë nga procesverbali për shqyrtimin kryesor i datës 03.04.2014, shihet se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar në tërësi sipas Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, i cili duhet të zbatohet në mënyrë të plotë, për të mundësuar barazinë e komuniteteve para ligjit, se në asnjë rast nuk bënë të shkelet e drejta e paditësit (pjesëtarit të komunitetit jo shumicë) që t'i sigurohet përkthimi i vendimeve dhe shkresave në gjuhën të cilën ai e përdor në procedurë.*

*Pra, në këtë rast, nuk është zbatuar në masë të mjaftueshme zbatimi i nenit 14 të Ligjit nr.02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, që gjykatat kanë për detyrë të lëshojnë dokumentet të cilat kanë të bëjnë me procedurat në gjuhën zyrtare të zgjedhur për procedurë dhe në gjuhë të tjera zyrtare, nëse kërkohet nga cilado palë në procedurë, siç është në këtë rast, që ka kërkuar paditësi. Meqë edhe me nenin 96 të LPK-së, parashihet se pala ka të drejtë që në procedurën para gjykatës të përdor gjuhën e vet apo gjuhën të cilën e kupton, ndërsa sipas nenit 97, të ligjit të njëjtë, rezulton se pala ka të drejtë të kërkojë që shkresat zyrtare t'i dorëzohen në njërën nga gjuhët zyrtare, që janë në përdorim në gjykatë, që e ka zgjedhur vet. Me qenë se gjykata nuk ka vepruar sipas ligjit lidhur me shkresat për vërejtjet e pagesës së taksës gjyqësore në këtë kontest, nuk ka pasur vend për marrjen e aktvendimit të atakuar me të cilin janë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 nënpar. j) të LPK-së dhe nenit 14 të Ligjit nr.02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së.*

*Andaj, për këto arsye, Gjykata e Apelit ka vendosur që ankesa është e bazuar, dhe vendosi që aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së njëjtë në procedim të mëtejme, në mënyrë që në riprocedurë të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna më sipër, vërejtjet për pagesën e taksës gjyqësore t'i përkthejë e t'ia dorëzojë palës, në atë mënyrë që të shmanget shkelja ligjore e theksuar”.*

## **10.6 NDRYSHIMI DHE ANULIMI I AKTIT ADMINISTRATIV NGA ANA E ORGANIT TË PADITUR**

Ligji për Konfliktet Administrative në dispozitën e nenit 36 ka rregulluar vlerësimin e ndryshimit dhe anulimit të aktit administrativ nga ana e organit të paditur.

*Neni 36*

- 1. Nëse organi gjatë kohës së procedurës gjyqësore nxjerrë aktin tjetër me të cilin revokohet ose shfuqizohet akti administrativ kundër të cilit është ngritur Konflikti Administrativ, si dhe në rastin nga neni 29 i këtij Ligji, nxjerrë më vonë aktin administrativ, ky organ, përpos paditësit, do ta njoftoj edhe gjykatën.*
- 2. Në këtë rast gjykata do ta ftojë paditësin që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, të deklarohet nëse me aktin administrativ të nxjerr në afatin e mëvonshëm:*
  - 2.1. është i kënaqur;*
  - 2.2. nuk heq dorë nga padia;*
  - 2.3. pjesërisht heq dorë nga padia;*
  - 2.4. ai/ajo padinë e zgjeron edhe në aktin tjetër.*
- 3. Nëse paditësi deklaron se me aktin e nxjerrë në afatin e mëvonshëm është i kënaqur apo nëse nuk jep deklaratën brenda afatit nga paragrafi 2 i këtij neni, gjykata do të nxjerrë vendimin mbi pezullimin e procedurës.*

4. Nëse paditësi deklaron se me aktin e ri nuk është ai/ajo, i kënaqur, gjykata do ta vazhdojë procedurën.

#### **10.6.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës së nenit 36 të LKA-së**

Me nenin 36 të LKA-së, është paraparë që organi kundër aktit të të cilit në afatin e caktuar është hapur konflikt administrativ, mund deri në përfundimin e këtij konflikti, në rast se i plotëson të gjitha kërkesat e padisë, të nxjerrë aktin tjetër me të cilin do të anulonte ose do ta ndryshonte vendimin e vetë, për ato shkaqe për të cilat gjykata do të mund ta anulonte vendimin e tillë. Organi i paditur mund ta anulojë dhe ndryshojë vendimin e vetë nëse në këtë rast nuk shkelet e drejta e palës ose personit të tretë.

Organi i paditur nëse ndryshon dhe anulon aktin administrativ të kontestuar në padi, duhet përpos paditësit, ta njoftojë njëkohësisht edhe gjykatën para së cilës është ngritur konflikti administrativ.

Gjykata atëherë do ta ftojë paditësin që në afatin prej 15 ditësh të deklarojë nëse me aktin e nxjerrë më vonë është i kënaqur, apo mbetet pranë padisë dhe në cilin vëllim, përkatësisht nëse zgjeron padinë edhe në vendimin e nxjerrë më vonë.

Në qoftë se paditësi deklaron se me aktin e nxjerrë më vonë është i kënaqur ose në afatin e caktuar nuk e jep deklaratën (brenda 15 ditësh), gjykata do të nxjerrë aktvendimin mbi pezullimin e procedurës administrative-gjyqësore.

Në rast se paditësi deklaron se me aktin e ri nuk është i kënaqur gjykata do ta vazhdojë procedurën administrative gjyqësore.

Deklaratën paditësi duhet të ia dorëzoi gjykatës në afatin e caktuar (15 ditëve) në mënyrën e njëjtë, sikurse padinë për fillimin e konfliktit administrativ, do të thotë deklaratën duhet t'ia dorëzojë drejtpërdrejtë gjykatës, t'ia dërgojë asaj me anë të postës së thjeshtë, ose t'ia dorëzojë me postë rekomande. Deklaratën e tillë paditësi mund ta paraqesë edhe në procesverbal tek gjykata.

#### **10.6.2 Të gjetura nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit – Departamentit për Çështje Administrative janë paraqitur raste kur dispozitat e LKA-së, nga neni 36, nuk janë zbatuar në mënyrë të drejtë.

Në disa raste vërehet se gjykata nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur rasteve kur organi i paditur ka ndryshuar ose ka anuluar aktin administrativ të kontestuar me padi. Pra, ka marrë aktvendim në kundërshtim me dispozitat e neni 36 të LKA-së, duke e hedhur poshtë padinë e paditësit si të palejuar me arsyetim se ndaj objektit të kërkesë-padisë së paditësit nuk mund të zhvillohet konflikt administrativ.

Në këtë kontest Gjykata e Apelit, Departamenti për Çështje Administrative vlerëson se më së shumti paqartësi janë paraqitur në procedurën administrative gjyqësore meqë gjykata nuk ka vepruar në tërësi sipas dispozitës së nenit 36 par.2 dhe 3 të LKA-së, i cili duhet të zbatohet në mënyrë të plotë, për të vendosur në mënyrë të drejtë dhe ligjore.

### 10.6.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit

**Aktvendimi AA.nr.406/2014, i datës 09.12.2014**

#### **Arsyetimi**

*“Gjykata e Apelit, Departamenti për Çështje Administrative duke ekzaminuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të ankesës, gjen se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë në këtë çështje juridike kontestuese nuk është i pranueshëm, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje të dispozitave nga neni 36 i LKA-së.*

*Kolegji i Gjykatës së Apelit, Departamenti për Çështje Administrative duke e vlerësuar ankesën e parashtruar nga paditësi, aktvendimin e kundërshtuar si dhe shkresat e tjera nga lënda, konstaton se në këtë rast paditësi ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, me bazë juridike heshtje administrative.*

*Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative me aktvendimin A.nr.854/2010 të datës 11.02.2014, e ka hedhur poshtë si të palejuar padinë e paditësit, në këtë çështje të konfliktit administrativ, duke ju referuar nenit 13 dhe 14, lidhur me nenin 34 par.1 pika 1.5 të LKA-së, me arsyetim se ndaj objektit të kërkesë-padisë së paditësit, nuk mund të zhvillohet konflikt administrativ.*

*Për rastin konkret me vështrim në shkresat e lëndës konstatohet se paditësi, e ka ushtruar padinë kundër Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, për heshtje administrative, pas ofrimit të vendimit me të cilën është vendosur lidhur me ankesën e paditësit me të cilin vendim është aprovuar ankesa dhe lënda është kthyer në riprocedim organit të shkallës së parë, gjykata ka shtyrë seancën duke i ofruar paditësit mundësinë që të bëjë precizimin e padisë në drejtim të vendimit të paditurit të datës 30.09.2010, meqë ka vlerësuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me heshtje të organit të paditur. Në seancën e shqyrtimit kryesor paditësi ka mbetur në tersi pranë padisë dhe kërkesë-padisë mbi bazën e heshtjes së organit të paditur dhe nuk ka kërkuar vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të mëvonshëm të së paditurës. Mirëpo gjykata e shkallës së parë duke mos vepruar në tersi si në vështrim të nenit 36 të LKA-së, ka marrë aktvendim, dhe padinë e paditësit e ka hedhur poshtë si të palejuar, me arsyetim se ndaj objektit të kërkesë-padisë së padisë nuk mund të zhvillohet konflikt administrativ.*

*Sipas dispozitës se nenit 36 par.2 e 3 të LKA-së, gjykata e shkallës së parë është dashur që ta ftojë paditësin që brenda 15 ditësh të deklarojë nëse me aktin administrativ të nxjerrë në afatin e mëvonshëm: është i kënaqur, nuk heqë dorë nga padia, pjesërisht heqë dorë nga padia, ai padinë e zgjeron edhe në aktin tjetër, me paralajmërim për pasojat që do të lindin nëse nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës, gjykata do të nxjerrë vendim për pezullimin e procedurës. Prandaj pas vlerësimit të kësaj çështjeje juridiko-administrative është dashtë që të aprovohet ankesa e paditësit dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të priset, dhe lënda t’i kthehet gjykatës se njëjtë në procedim të mëtejshëm për vazhdimin e procedurës”.*

## **10.7 DISPOZITIVI I PAKUPTUESHËM I AKTGJYKIMIT DHE EKSPERTIZA NË PROCEDURËN PËR KONFLIKTET ADMINISTRATIVE**

Ligji për Procedurën Kontestimore me dispozitën e nenit 369, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka paraparë se si mund të veprojë gjykata në rast se ka dallime në mendimet dhe konstatimet e ekspertëve.

*Neni 369 i Ligjit për Procedurën Kontestimore*

*Neni 369 par.1 i LPK-së, kur janë caktuar më tepër se një ekspert, të gjithë ata mund të paraqesin konstatimin dhe mendimin e përbashkët, në rast se nuk ka dallime midis tyre. Në qoftë së ekzistojnë dallime në konstatimet dhe mendimet e tyre, atëherë secili nga ata paraqet konstatim dhe mendim të veçantë.*

*Neni 369 par.2 i LPK-së, në qoftë se të dhënat e ekspertëve në konstatimin e ekspertëve dallohen esencialisht, apo nëse konstatimi i tyre është i paqartë, jo i plotë apo kontradiktor me vetveten apo me rrethana të shqyrtuara, e këto të meta nuk mund të evitohen me dëgjimin e përsëritur të ekspertëve, do të përsëritet ekspertimi me ekspertë të njëjtë apo me ekspertë të tjerë.*

### **10.7.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitës së nenit 369 par.2 të LPK-së**

Në rastet ku të dhënat e ekspertëve për konstatimin e tyre dallojnë esencialisht ku konstatimi i njërit apo më shumë ekspertëve është i paqartë, jo i plotë kur është në kundërshtim me vetveten ose me rrethanat e shqyrtuara, kurse gjykata vlerëson se me dëgjimin e sërishëm të ekspertëve, nuk do të mund të eliminohen këto dallime dhe të meta do të përsërisë ekspertimin me të njëjtët ekspertë apo me ekspertë tjerë. Shkak dhe arsye për përsëritjen e ekspertimit, mund të jenë vetëm dallimet dhe mangësitë qenësore në konstatimet dhe mendimet e ekspertëve.

Gjykata në çdo rast, sipas rrethanave konkrete, do të vlerësojë nëse ekzistojnë shkaqet për përsëritjen e ekspertimit. Në qoftë se gjykata vendos, që ekspertimi të përsëritet, ajo njëkohësisht do të vendosë përsëritjen e ekspertimit me të njëjtët ekspertë apo me ekspert të tjerë. Konstatimi dhe mendimi i njërit apo më shumë ekspertëve, mund të jetë i paqartë dhe jo i plotë dhe kontradiktor me vetveten. Në rastet kur ekspertizat dukshëm ndryshojnë në lidhje me faktet vendimtare dhe ekspertët nuk mund t'i harmonizojnë mendimet e tyre, gjykata mund të veprojë sipas dispozitave të këtij neni. Pra së pari duhet të bëhet tentimi për harmonizimin e mendimeve të eksperteve mjekësorë, të cilët duhet të arsyetojnë para gjykatës konstatimet e ekspertimit të tyre. Nganjëherë edhe dispozitat materiale përcaktojnë se me cilat mjete provuese vërtetohet ndonjë fakt. Kështu për shembull Ligji Nr.2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë në mënyrë decisive parasheh se Komisionet Mjekësore do të vlerësojnë gjendjen shëndetësore të parashtruesve të kërkesave për pensionet e aftësisë së kufizuar, pra aftësia e kufizuar mund të vlerësohet vetëm në bazë të konstatimit dhe mendimit të eksperteve të autorizuar (neni 3 i Ligjit Nr.2003/23).

### **10.7.2 Të gjetura nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit, Departamentit për Çështje Administrative i janë paraqitur raste kur dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm në rastet kur gjykata

ka vendosur në mënyrë meritore. Po ashtu, edhe kur nuk është vepruar në tërësi sipas dispozitës së nenit 369 par.2 të LPK-së, kur ekzistojnë dallime në konstatimet dhe mendimet e ekspertëve.

Në disa raste vërehet se gjykata nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur formulimit të dispozitivit që duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i plotë. Ngase kjo pjesë është ajo pjesë e aktgjykimit nga e cila duhet të shihet qartë se si ka vendosur gjykata kompetente për çështjen e cila ka qenë objekt i procedimit. Sepse dispozitivi i aktgjykimit nuk është i qartë kur brendia e tij duhet të nxjerrret në mënyrë të tërthortë nga arsyetimi i aktgjykimit. Pra, gjykata ka marrë aktgjykim në kundërshtim me dispozitat e nenit 182 par.2 pika n) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Po ashtu, në disa raste vërehet se gjykata nuk i ka kushtuar vëmendjen e duhur edhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, kur ekzistojnë dallime në konstatimet dhe mendimet e ekspertëve. Në këtë kontest, Gjykata e Apelit vlerëson se më së shumti paqartësi për nxjerrjen e një aktgjykimi të drejtë dhe ligjor janë paraqitur me zbatimin e nenit 369 par. 2 të LPK-së, sepse gjykata nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë rastet kur konstatimet e ekspertëve dallohen esencialisht, dhe nuk arsyetojnë para gjykatës konstatimet e ekspertimit të tyre. Ato fakte gjykata mund t'i rishqyrtojë, ashtu që do ta përsërisë ekspertizën nëse gjen ndonjë kundërhënie në konstatimin dhe mendimin e ekspertëve të dhënë në procedurën administrative, ose nëse ato konstatime dhe mendime janë të paqarta ose në kundërshtim me provat tjera.

Në këtë kontest Gjykata e Apelit, Departamenti për Çështje Administrative vlerëson se më së shumti paqartësi janë paraqitur në procedurën administrative gjyqësore kur gjykata nuk ka vepruar në tërësi sipas dispozitës së nenit 369 par.2 të LPK-së, e cila jep mundësinë që të vërtetohet gjendja faktike në mënyrë të plotë, për të vendosur në mënyrë të drejtë dhe ligjore.

### **10.7.3 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

#### **Aktgjykimi AA.nr.80/2017, i datës 31.05.2017**

##### **Arsyetimi**

*“Gjykata e Apelit- Departamenti për Çështje Administrative duke ekzaminuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të ankesës, gjen se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë në këtë çështje juridike kontestuese nuk është i pranueshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave nga neni 182 par.2 pika n) dhe nga neni 183 i LPK-së, i aplikueshëm sipas dispozitës së nenit 63 të LKA-së.*

*Aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) të LPK-së, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, në kundërshtim me arsyet e aktgjykimit e po ashtu edhe arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare të çështjes janë të mangëta dhe të paqarta.*

*Meqenëse, nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.5088905 të datës 07.07.2014, të MPMS- DAP, është refuzuar si e pabazuar ankesa e L. B. nr.5088905 e datës 21.02.2013, për njohjen e të drejtës në pension të personave me aftësi të kufizuar si*



*e pabazuar, dhe vërtetohet vendimi i komisionit mjekësor i shkallës së parë si plotësisht i bazuar në Ligjin 2003/23. Me arsyetim se nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme mjekësore që dëshmon se ekziston paaftësi mbi 90%, dhe është konstatuar se nuk i ka përmbushur kriteret e parashikuara me nenin 3 të Ligjit nr.2003/23 të Ligjit për personat me aftësi të kufizuara.*

*Paditësja e pakënaqur me aktvendimin e MPMS –DAP, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditëses paraqitur kundër aktvendimit të lartcekur, në seancën e shqyrtimit kryesor pas administrimit të provave vendimin e saj e bazon në mendimin e ekspertëve mjekësor të caktuar nga QKUK të cilëve u falë besimin e plotë dhe vendos si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Me arsyetim se pretendimet e paditëses janë të bazuara, dhe si rrjedhojë e kësaj e detyron të paditurën që të bëjë kompensimin e mjeteve paditëses për pension si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.*

*Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke i pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, gjen se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) dhe nga neni 183 i LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative se është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij dhe si i tillë është jo i plotë në vërtetimin e gjendjes faktike, për çka në mënyrë të bazuar në ankesë theksohet.*

*Në dispozitiv të aktgjykimit, nën pikën I të dispozitivit thuhet se aprovohet kërkesë-padia e paditëses, dhe anulohet aktvendimi i të paditurës MPMS – DAP, me nr.5088905 i datës 07.07.2014. Ndërtimi i tillë i dispozitivit të aktgjykimit, aktgjykimin e kontestuar e bënë të paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Nga një dispozitiv i tillë i aktgjykimit të kontestuar ku është vendosur me aktgjykim në juridiksion të plotë për konfliktin administrativ sipas nenit 43 par.3 dhe 46 par.2 dhe 5 të LKA-së, kur gjykata në shqyrtimin e çështjes vërteton gjendje tjetër faktike, në krahasim me gjendjen faktike të vërtetuar në procedurën administrative dhe i eviton shkeljet e rregullave procedurale, anulon aktin administrativ të kontestuar, dhe aktin administrativ të organit të shkallës së parë nëse edhe ai i ka përmbajtur të njëjtat të meta, dhe vetë e zgjedhë çështjen administrative, dhe sipas nenit 46 par.2, 4 dhe 5 të LKA-së, nëse gjykata e anulon aktin administrativ dhe nëse natyra e çështjes këtë e lejon dhe nëse rezultatet e procedurës ofrojnë bazë të sigurt për këtë, mund me aktgjykim të vendosë çështjen administrative dhe atëherë aktgjykimi në tërësi e zëvendëson aktin administrativ të anuluar. Në rastin konkret është e qartë, se gjykata e shkallës së parë nuk e ka anuluar aktin administrativ të organit të shkallës së parë, pasi që komisioni mjekësor për rishqyrtime e ka refuzuar kërkesën e saj për pensionin e personave me aftësi të kufizuara, ndërsa komisioni i shkallës së dytë, është pajtuar me vlerësimin e komisionit të shkallës së parë, gjë që kontestohet me aktvendimin e kontestuar të paditurës.*

*Prandaj, aktgjykimi i kontestuar është, juridikisht, i paqartë, nga se dispozitivi i aktgjykimit duhet të jetë i shkurtër dhe konkret dhe nga ajo pjesë duhet me padyshim të kuptohet se për çfarë dhe në që kuptim është vendosur për çështjen e cila është objekt i procedurës. Kjo është e rëndësishme për realizimin e aktgjykimit respektivisht për ekzekutimin e tij.*

*Dispozitivi i aktgjykimit duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i plotë, ngase kjo pjesë është ajo pjesë e aktgjykimit nga e cila duhet të shihet qartë se si ka vendosur gjykata kompetente për çështjen e cila ka qenë objekt i procedimit. Dispozitivi i aktgjykimit nuk është i qartë kur brendia e tij duhet të nxjerret në mënyrë të tërthortë nga arsyetimi i aktgjykimit.*

*Nga dispozitivi i aktgjykimit të atakuar kuptohet se kërkesë-padia e paditëses është aprovuar, por nuk mund të kuptohet se çfarë është bërë me aktin administrativ të organit të shkallës së parë, se nuk theksohet se është anuluar edhe ky akt administrativ. Prandaj, kjo gjykatë tani për tani nuk mund të pranojë si të drejtë një konstatim të tillë të paraqitur në aktgjykimin e ankimuar, sepse ka të meta për të cilat nuk mund të ekzaminohet.*

*Aktgjykimi i kontestuar është juridikisht i paqartë dhe i paqëndrueshëm, sepse nuk janë përmbledhur faktet vendimtare të çështjes në shqyrtim, nuk janë shqyrtuar dhe administruar provat sipas pretendimeve të palëve në procedurë, sipas objektit të shqyrtimit. Në arsyetim të aktgjykimit nuk janë dhënë arsyet e mjaftueshme për pretendimet e të paditurës, se paditësja nga tri instancat e vendimmarrjes të të paditurës me ekspert mjekësorë, ka konstatuar se nuk i plotëson kushtet / kriteret për të gëzuar të drejtën në pension për persona me aftësi të kufizuara.*

*Pra, gjatë shqyrtimit të çështjes juridike nuk janë marrë parasysh faktet e rëndësishme për zgjidhjen e çështjes, se bëhet fjalë për mendime të ndryshme të ekspertëve, gjykata e shkallës së parë, i ka dëgjuar ekspertët mjekësor të caktuar me vendim të QKUK-së për dhënien e ekspertizës konform aktvendimit të gjykatës në seancën e datës 07.12.2016. Mirëpo siç shihet nuk i ka ftuar ekspertët mjekësorë të MPMS-DAP, në tentim për t'i harmonizuar mendimet meqenëse janë plotësisht të kundërta, sepse ekspertët mjekësor në tri instanca në komisionet mjekësore të autorizuar nga MPMS-DAP, kanë vlerësuar, se te paditësja nuk ekziston paaftësi e plotë dhe e përhershme.*

*Ndërsa ekspertët mjekësor të caktuar me vendim të QKUK-së kanë vlerësuar se e njëjta është e pa aftë për punë. Gjykata e shkallës së parë, ka përfunduar seancën e shqyrtimit kryesor, dhe vendimin e saj e ka bazuar në mendimin e ekspertëve mjekësor të caktuar nga QKUK, të cilëve u ka falur besimin e plotë, dhe me këtë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 lidhur me nenin 369 par.2 të LPK-së. Sepse në rastin kur ekspertizat dukshëm ndryshojnë në lidhje me faktet vendimtare dhe ekspertët nuk mund t'i harmonizojnë mendimet e tyre, gjykata e shkallës së parë, është e obliguar të veprojë sipas nenit 369 par. 2 LPK-së, dhe të kërkojë mendimin e ekspertëve tjerë. Pra, në rastin konkret së pari duhet të bëhet tentimi për harmonizim të mendimeve të eksperteve mjekësor përmes ballafaqimit në mes tyre, pasi që konstatimet e tyre dallohen esencialisht, të cilët duhet të arsyetojnë para gjykatës konstatimet e ekspertimit të tyre. Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo gjykatë tani për tani nuk mund të pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm një aktgjykim të tillë, ngase është përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) lidhur me nenin 183 të LPK.*

*Për arsyet e lartcekura, aktgjykimi i kundërshtuar është dashur të priset dhe çështja është dashur t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim. Ashtu që do të tentohet të harmonizohen mendimet e ekspertëve mjekësor dhe të sqarohen dhe vërtetohen të gjitha faktet relevante dhe dallimet e shfaqura në konstatimet po ashtu edhe në mendimet e dhëna nga ekspertët mjekësor që janë me ndikim për zgjedhjen e kontestit përmes sqarimeve*

*plotësuese nga ballafaqimi i ekspertëve. Në riprocedurë, gjykata e shkallës së parë duhet t'i mënjanojë të metat e përmendura më sipër dhe të vërtetojë faktet dhe provat që lidhen me pretendimet e paraqitura në ankesë, se konstatimet dhe mendimet e ekspertëve dallohen esencialisht dhe janë plotësisht të kundërta. Pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, dhe mënjanimi të shkeljeve esenciale të lartë cekura gjykata e shkallës së parë, ka mundësi të bie aktgjykim të drejtë dhe të ligjshëm në kuptim të Ligjit për Konfliktet Administrative”.*

## **10.8 OBJEKTI I KONFLIKTIT ADMINISTRATIV**

### **10.8.1 Shqyrtimi i ligjshmërisë së aktit përfundimtar administrativ nga gjykata në procedurë të konfliktit administrativ**

*Neni 9 dhe 44 i Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së aktit përfundimtar administrativ ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 84,85,dhe 86 të Ligjit për Procedurën Administrative.*

*Neni 9 i Ligjit për Konflikte Administrative*

*Gjykata në konflikt administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative me të cilët organet e administratës në ushtrimin e autorizimeve publike vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave juridik dhe fizikë në çështjet administrative.*

*Neni 44 i Ligjit për Konflikte Administrative*

*44.1 Ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë.*

*44.2. Për nulitetin e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.*

*Akti administrativ i atakuar me padi duhet të jetë i nxjerrë sipas formës shkresore ashtu si parashihet në nenin 83 të LPA-së, të jetë përmbajtësor ashtu siç parashihet në nenin 84, dhe arsyetimi dhe mënyra e arsyetimit të jenë ashtu siç parashihet në nenin 85, dhe 86 të LPA-së.*

*Neni 84 - Përmbajtja e aktit administrativ*

*84.1. Në çdo rast aktet administrative duhet të tregojnë qëllimin e tyre.*

*84.2. Akti administrativ duhet patjetër të përmbajë informacionin e mëposhtëm:*

- a) emrin e organit të administratës publike që nxjerr aktin, numrin, datën e nxjerrjes së aktit si dhe çdo delegim kompetencash, në bazë të të cilit është nxjerrë akti;*
- b) identitetin e palëve të cilave iu drejtohet akti;*
- c) një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar vetëm në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata;*
- d) një deklaram të bazës ligjore në të cilën bazohet akti;*
- e) një shpjegim të pasojave praktike të aktit për palët në procedimin administrativ;*
- f) një kujtesë për palët që ato kanë të drejtë të kërkojnë rishqyrtimin e çështjes;*

- g) një kujtesë për palët që ato kanë të drejtë të apelojnë kundër vendimit në rrugë administrative ose gjyqësore;
- h) një kujtesë për afatet kohore që palët duhet t'i kenë parasysh për dorëzimin e kërkesës për rishqyrtim ose të ankimit administrativ apo gjyqësor;
- i) datën kur akti hyn në fuqi;
- j) nënshkrimin e udhëheqësit të organit të administratës publike që e nxjerrë aktin ose të drejtuesit të organit kolektiv.

#### Neni 85 - Arsyetimi i aktit

- 85.1. Përveç rasteve kur ligji vetë parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdomërisht arsyet për të gjitha ato akte të cilat pjesërisht ose tërësisht:
- a) mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në ndonjë mënyrë tjetër të drejta dhe interesa ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime
  - b) përbëjnë vendim në lidhje me kërkesat për rishqyrtim apo ankimet;
  - c) përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar;
  - d) përbëjnë devijim nga praktika e ndjekur për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme
  - e) shkaktojnë revokimin, shfuqizimin, modifikimin ose pezullimin e një akti të mëparshëm. 85.2.

Me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, aktet që ratifikojnë vendimet e nxjerra nga bordet, juritë apo komisionet e ngritura nga administrata, si dhe urdhrat e udhëheqësve, që kanë të bëjnë me çështje të brendshme, nuk kanë nevojë të arsyetohen.

#### Neni 86 - Mënyrat e arsyetimit

- 86.1. Arsyetimi duhet të formulohet qartë dhe të përfshijë shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike të aktit.
- 86.2. Kur arsyetimi është bërë në informacionet apo propozimet e mëparshme, mund të mjaftojë si arsyetim pranimi i tyre nga organi përgjegjës për marrjen e vendimit përfundimtar. Në këto raste informacionet dhe propozimet e mëparshme janë pjesë përbërëse e aktit.
- 86.3. Arsyetimi me të dhëna të paqarta, kontradiktore ose të pasakta, është i barasvlershëm me mungesën e arsyetimit. 86.4. Në rastet e çështjeve analoge mund të përdoren arsyetimet e bëra në çështjet e mëparshme, me kusht që të mos rëndohet pozita e palëve të interesuara.

Nuk do të lëshohem në komentimin e dispozitave të cituara si më lart të Ligjit për Procedurën Administrative, sepse komentimi i tyre do të rezultojë si mjaftë i plotë dhe përmbajtësor nga të gjeturat dhe praktika e gjykatës së Apelit, gjatë shqyrtimit dhe vendosjes së lëndëve, sipas ankesave të palëve në procedurë.

#### 10.8.2 Koment i shkurtër lidhur me zbatimin e dispozitave të lartë cekura gjatë shqyrtimit dhe vendosjes për ligjshmërinë e aktit përfundimtar administrativ

Parimisht konflikti administrativ mund të zhvillohet kundër çdo akti juridik i cili ka karakteristika të aktit përfundimtar administrativ, prandaj dhe vlerësimi i ligjshmërisë së aktit administrativ që kontestohet me padi, i cili është nxjerrë gjatë vendosjes në ndonjë

çështjeje administrative. Pra, konflikti administrativ mund të fillohet vetëm kundër akteve individuale që krijojnë pasoja juridike në raste individuale dhe kolektive të cilat shkaktojnë pasoja juridike për dy e më shumë persona fizik apo juridik, e jo kundër akteve me karakter rregullativ, akteve që rregullojnë organizimin e brendshëm të organeve të administratës publike dhe akteve të përgjithshme, pasi që aktet e përgjithshme mund të jenë objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së tyre nga Gjykata Kushtetuese.

Konflikti administrativ mund të zhvillohet jo vetëm kundër akteve administrative të organeve të administratës shtetërore, por edhe kundër akteve administrative të organizatave të cilat ushtrojnë autorizime publike kur me to vendosin mbi ndonjë të drejtë, detyrim ose interes juridik të individit të caktuar ose organizatës së caktuar.

Objekti i konfliktit administrativ sipas dispozitave të cituara si më lartë neni 9 dhe 44 i Ligjit për Konfliktet Administrative, është vlerësimi i ligjshmërisë së aktit administrativ të nxjerrë në procedurë administrative sipas formës, pra rregullave procedurale e po ashtu edhe në pikëpamje të zbatimit të së drejtës materiale, sipas objektit të çështjes së vendosur me akt. Konflikti administrativ mund të fillohet dhe objekt shqyrtimi të ketë edhe aktin administrativ të organit të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankesa nuk është e lejuar. Por gjithnjë duhet pasur parasysh që konflikti administrativ nuk mund të fillohet nëse në procedurë administrative ndaj aktit i cili kontestohet nuk është shfrytëzuar e drejta e ankesës (pra, nëse ka qenë e lejuar ankesa por nuk është ushtruar). Nëse ushtrohet padi në gjykatë kundër vendimit të shkallës së parë, i cili nuk është atakuar me ankesë në organin e shkallës së dytë, ose është ushtruar pas afatit, gjykata do ta hedhë poshtë padinë për shkak të mosshfrytëzimit të mjeteve juridike në procedurë administrative.

Konflikti administrativ mund të fillohet edhe për shkak të mosnxjerrjes së vendimit nga organi i administratës publike që me këtë mosveprim mund të pengohet e drejta e palës për zhvillimin e konfliktit administrativ, prandaj me LKA është e rregulluar ashtu siç parashihet në nenin 14 dhe 29 të LKA-së, fillimi i procedurës gjyqësore pa ekzistimin e aktit përfundimtar, kur organi kompetent nuk vendos sipas kërkesës apo ankesës së palës dhe nuk nxjerrë aktin në afatin e caktuar administrativ.

Për të dhënë sqarime më adekuate lidhur me rastet konkrete se cila është ligjshmëria e akteve përfundimtare administrative të cilat i nxjerrin organet e administratës prej nga do të nxirret baza juridike e vlerësimit të ligjshmërisë, apo prej nga mund të konkludohet në procedurë gjyqësore se një vendim i organit administrativ është ligjor apo i pa ligjshëm ashtu si u shtjellua më lartë si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, patjetër duhet t'i referohemi dhe të bazohemi në dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative të cilat dispozita i zbatojnë të gjitha organet e administratës publike gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre nëpërmjet akteve individuale dhe kolektive se a është akti i ligjshëm i nxjerrë ashtu siç parashihet me dispozitat e LPA-së, dhe të Ligjit material me të cilat ligje krijohen pasoja juridike në raste individuale ashtu siç parashihet në nenin 2 par.2 të LPA-së.

Për të vendosur për ligjshmërinë e akteve administrative, gjykata e shqyrtton çështjen brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë, pra gjykata e bënë shqyrtimin e çështjes në bazë të fakteve të vërtetuara në shqyrtimin verbal si në vështrim të nenit 38 dhe fakteve të vërtetuara në procedurë administrative ashtu siç parashihet në nenin 43 të LKA-së. Sipas nenit 44.2 të LKA-së, kur është në pyetje nuliteti i

akteve administrative gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare. Pra vlefshmëria e aktit administrativ absolut dhe relativ rregullohet me nenin 91-94 të LPA-së.

### **10.8.3 Koment i shkurtër lidhur me rastet kur Gjykata e Apelit ka vendosur në mënyrë meritore**

Gjykata e shkallës së parë në procedurë të vendosjes pas administrimit të provave me aktgjykimin e saj e anulon vendimin e organit të paditur, dhe çështjen ia kthen në rivendosje të paditurit, sipas vlerësimit se; Vendimi nuk është përmbajtësor, i përfshirë me të meta për shkak të cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij duke e vlerësuar se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me nenin 84 të LPA-së, sepse nuk ka përmbledhje të konstatimeve faktike të çështjes në shqyrtim, bazuar në provat e administruara gjatë procedimit administrativ, apo deklarim të bazës ligjore në të cilat bazohet akti, se akti nuk është i arsyetuar ashtu siç parashihet në nenin 85 dhe 86 të LPA-së, etj.

Kolegji i Gjykatës së Apelit në disa raste të këtilla të ngjashme gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës së aktgjykimit të ankimuar, vendimit të organit të paditur si objekt i çështjes në shqyrtim sipas padisë dhe ankesës, duke i vlerësuar ndryshe shkresat e lëndës dhe vendimin e organit të paditur, gjithnjë sipas përmbajtjes së tij, theksimeve në ankesë, dhe kur faktet kanë qenë bindëse dhe gjithëpërfshirëse dhe kur nuk ka pasur dilema lidhur me gjendjen faktike të çështjes, ka vendosur në mënyrë meritore duke e anuluar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe duke e lënë në fuqi vendimin e organit të paditur, gjithnjë duke dhënë arsye të plota dhe të argumentuara lidhur me mënyrën e vendosjes, sipas përmbajtjes së vendimit të organit të paditur dhe ka gjetur se i njëjti është ligjor dhe i drejtë i nxjerrë sipas formës dhe dispozitave ligjore nga neni 84,85,dhe 86 të LPA-së.

### **10.8.4 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit lidhur me përmbajtjen e akteve administrative, arsyetimit të aktit, ashtu siç parashihet në nenin 84,85,dhe 86 të LPA-së, në disa raste, (si në referencën I.), është gjetur se gjykata e shkallës së parë gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit përfundimtar të organit të paditur ashtu siç parashihet në nenin 9 dhe 44 të LKA-së,ka rezultuar se nuk i ka vërtetuar faktet qenësore të çështjes me mënyrën e vendosjes si në aktgjykimin e saj. Aktgjykimi si i tillë ka rezultuar i përfshirë me të meta qenësore nga neni 182.2 pika n) dhe 183, të LPK-së, si juridikisht i pa qartë kundërthënës me veten duke mos i vërtetuar faktet sipas arsyeve si në aktgjykim, duke u bazuar në fakte jo të qëndrueshme dhe përmbajtësore as në vendimin përfundimtar të organit të paditur, prej nga ka rezultuar se edhe vendimi i organit administrativ të paditur, është po ashtu jo përmbajtësor, juridikisht i pa qartë kundërthënës dispozitivi me arsyetimin e tij i nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore ashtu si parashihet në nenin 84, 85 dhe 86 të LPA-as dhe për shkak të metave të tilla nuk ka mundur të shqyrtohet ligjshmëria e tij.

Gjykata e shkallës së parë si në referencën pasuese nuk arrin gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur si akt përfundimtar ti mënjanojë apo evidentojë të metat e vendimit administrativ, apo të njëjtin ta anulojë gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë-procedurë gjyqësore me përfaqësuesit e palëve në procedurë por vendimin e vet e mbështet edhe në fakte të pa vërtetuara në mënyrë të plotë në organin administrativ si në vendimin e saj. Në këtë rast Gjykata e Apelit por edhe në disa raste të tjera të ngjashme, ka vendosur me aktgjykim, ashtu siç parashihet në nenin 46, të LKA-së e jo me aktvendim, me të cilin

është aprovuar ankesa e të paditurit, është anuluar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë po ashtu edhe Vendimi i organit të paditur dhe çështja i është kthyer të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në disa raste të tjera të gjeturat e Gjykatës së Apelit si në referencën II dhe III, të këtij punimi nga arsyetimi i aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit, lidhur me përmbajtjen e vendimeve të organit të paditur ashtu siç parashihet si në kuptim të nenit 84, 85 dhe 86 të LPA-së, është gjetur se gjykata e shkallës së parë, nuk ka vendosur në baza ligjore kur e ka anuluar vendimin përfundimtar të organit të paditur si jo ligjor dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në organin e paditur. Në këto raste kolegji i gjykatës së Apelit e ka aprovuar ankesën e të paditurit, është ndryshuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu që kërkesë padia e paditësit është refuzuar si jo e bazuar, ndërsa është lënë në fuqi Vendimi i organit të paditur, administrativ, si i drejtë dhe ligjor. Sipas arsyeve në arsyetim se gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të organit të paditur nuk i ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore nga nenet 84, 85 dhe 86 të LPA-së, kur e anulon vendimin organit të paditur, sepse nga përmbajtja e vendimit të organit të paditur i nxjerrë në procedurë përfundimtare, nga kolegji duke i vlerësuar ndryshe shkresat e lëndës dhe vendimin e organit të paditur, vërtetohet se është i drejtë dhe ligjor sipas gjendjes faktike nga objekti i shqyrtimit, dhe i nxjerrë sipas përmbajtjes dhe formës në harmoni me dispozitat ligjore të LPA-së, të cekura si më lartë nga nenet 84, 85, dhe 86, të LPA-së.

### **10.8.5 Referencë nga arsyetimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit**

#### **Aktgjykimi A.A. 158/2016, i datës 20.12.2016**

##### **Arsyetimi**

*Gjykata e Apelit vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-122, si dhe nenit 194 të LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA), në drejtim të theksimeve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se;*

*Ankesa është e bazuar.*

*Nga shkresat e lëndës rezulton se me Vendimin e ATK-së, -Departamenti për ankesa, (DA), nr.000/2014, të dt.17.11.2014, në para. I., është aprovuar pjesërisht ankesa e subjektit "N.N."- Përfaqësia në Kosovë, në mbështetje të nenit 136/c të Ligjit nr.02/L-28 për procedurën administrative në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit nr.03/L-222, për administratën tatimore dhe procedura, në par. II., është ndryshuar njoftim rivlerësimi për pagesën e tatimit shtesë për periudhën ..... për tatim në të ardhurat e korporatave (TAK), dhe në par. III., procedura e ankesës nuk ndërpreu sanksionet për mospërmbushje të interesit për ndonjë lloj tatimi, sipas Ligjit nr.03/L-222, për administratën tatimore dhe procedurat.*

*Kundër aktvendimit të ATK-së, nr.000/2014, të dt....., paditësi me datë ....., me ankesë-padi fillon konflikt administrativ në procedurë gjyqësore. Gjykata Themelore në Prishtinë pas mbajtjes së seancës publike, në prani të të autorizuarve të palës paditëse, në mungesë të*

*përfaqësueses ligjore të të paditurës dhe administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, të datë, bien aktgjykimin e atakuar me ankesë me të cilin e aprovon kërkesë padinë e paditësit si të bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të cituar si më lartë, në par. I., të arsyetimit të këtij aktgjykimi.*

*Kolegji i Gjykatës së Apelit duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes duke i shqyrtuar pretendimet ankimore ndaj aktgjykimit të shkallës së parë, vendimin e të paditurës ATK, si dhe shkresave tjera të lëndës gjen se; Aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me të meta thelbësore nga neni 182.2 pika (n) dhe neni 183 të LPK-së, sepse arsyet në të cilat bazohet për faktet vendimtare nuk janë të qëndrueshme, aktgjykimi është juridikisht i paqartë, jo i plotë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, për çka në mënyrë të bazuar theksohet edhe në ankesë. Andaj kolegji i gjykatës së apelit pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, nuk mund t'i përkrah si të rregullta dhe ligjore, sepse argumentet në të cilat bazohet për faktet vendimtare, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, nuk janë të bazuara në gjendjen e fakteve të administruara në baza ligjore si në vendimin e kontestuar.*

*Gjykata e shkallës së parë gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së Vendimit, si akt përfundimtar i ATK-së si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, nuk i ka përmbledhur faktet vendimtare të çështjes nuk i ka shqyrtuar dhe administruar provat sipas pretendimeve të palëve në procedurë dhe fakteve të cilat i përmban vendimi i organit të paditur, i nxjerrë në procedurë të rishqyrtimit, bazuar edhe në vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna si në aktvendimin e BPR-së. Organi i paditur në vendimin e saj konkludimet i mbështet në faktet se ankuesi, "N.N. ", ka kryer transaksione me tatim pagues jo ekzistues, nuk ka pasur transaksione blerjeje apo shitjeje të evidentuara e që kjo është në kundërshtim me udhëzimin, për faturat fiktive të datës ....., andaj këto transaksione nuk i janë pranuar si të rregullta. Po ashtu e paditura, vendos të korrigjojë të hyrat shtesë në vlerë prej ..... €, sipas njoftim rivlerësimit për TAK për periudhën ....., sepse sipas informatave shtesë të pranuar nga KEK-u, lidhur me përmbushjen e kontratës së dt. 00.000.2009,e lidhur në shumë prej .....€, konstaton se tatimpaguesi-paditësi ka qenë i penalizuar, me 00%, të vlerës së kontratës, ndërsa nuk ka të evidentuar faturë e që nënkupton që nuk kanë bërë pagesë duke mos e deklaruar vlerën e tërësishme të kontratës, ndërsa penalizimi është bërë për moskryerjen e punëve në afatin e paraparë sipas kontratës me XXX, andaj për vlerën e pa deklaruar në shumën e cekur si më lartë e paditura e ka ngarkuar, me tatim shtesë për periudhën 00/09, për tatim mbi vlerën e shtuar, bazuar në nenin 22 dhe 12 të Ligjit, nr.03/L-146, ndërsa është ndryshuar njoftim rivlerësimi për pagesë tatimit shtesë për periudhën ... për TAK.*

*Kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë edhe përkundër faktit, se për vërtetimin e gjendjes faktike dhe juridike në këtë çështje bazohet edhe në ekspertizën e ekspertit të angazhuar, por që prapë kanë mbetur të pa sqaruara faktet kryesore të çështjes të cilat mbesin kontradiktore me faktet dhe provat në të cilat bazohet vendimi i të paditurës ATK-së, të cilin e anulon gjykata e shkallës së parë dhe e liron paditësin nga pagesa e tatimit shtesë TVSH për muajin qershor, në shumë prej ....€, dhe ia njeht TVSH-në e zbritshëm për faturat e muajit maj dhe shtator të vitit 20... Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë me mënyrë të këqillë të vendosjes meritore të çështjes, nuk i ka vërtetuar faktet qenësore në mënyrë bindëse kur paditësit ia pranon si valide faturat-transaksionet e lëshuara nga subjektet në vitin 20..., të cilat e paditura i ka vlerësuar si jo valide sepse subjektet-bizneset e tilla i ka konsideruar si fiktive,(biznese jo ekzistuese, apo tatim pagues fiktiv, kështu*



figuron në arsyetimin e vendimit të organit të paditur), ndërsa gjykata e shkallës së parë bazuar edhe në ekspertizë i pranon faturat e tilla si valide e që kjo është në kundërshtim të plotë me faktet e vërtetuara nga e paditura. Kjo çështje nuk është sqaruar në gjykatën e shkallës së parë duke i ballafaquar provat dhe argumentet e palëve në procedurë. Po ashtu gjykata e shkallës së parë vlerëson se nuk ka bazë ligjore që paditësi të tatohet për vlerën e shumës prej ....€, sepse nuk ekziston faturë e lëshuar për këtë shumë dhe nuk mund të ngarkohet me tatim për të hyra të pa realizuara, por nga vendimi i organit të paditur si dhe theksimeve tani në ankesë theksohet se vlera e pa deklaruar me kontratën e lidhur me XXX është ajo e cekur si më lartë, ndërsa edhe për këtë ka qenë i panelizuar nga XXX, për mos përmbushje të kontratës. Gjykata e shkallës së parë nuk lëshohet në vërtetimin e faktit se kjo shumë ishte apo nuk ishte deklaruar si në vlerën e kontratës të lidhur me KEK, ndërsa edhe për këtë shumë ishte penalizuar për mos përmbushje të kontratës me KEK.

Andaj nga një gjendje e tillë e vërtetuar kolegji gjen se Gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar gjendjen faktike, nuk i ka shqyrtuar dhe përmbledhur faktet vendimtare, në mënyrë të argumentuar nga pretendimet e palëve ndërgjyqëse, duke i ballafaquar argumentet e palëve ndërgjyqëse sipas të gjeturave dhe fakteve si në Vendimin e të paditurës të cekura si më lartë dhe tani si në ankesën e saj.

Kolegji duke e shqyrtuar Vendimin e organit të paditur, nr.000/2010, të datës ....., i cili është objekti i çështjes, për vlerësimin e ligjshmërisë së tij si akt përfundimtar, vlerëson se i njëjti është i përfshirë me të meta ligjore dhe procedurale, të cilat nuk është arritur që të evitohen gjatë shqyrtimit në gjykatën e shkallës së parë, andaj nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij në procedurë gjyqësore ashtu siç parashihet në nenin 9 dhe 44 të LKA.

Vendimi i organit të paditur nuk është përmbajtësor ashtu siç parashihet në nenin 77 të LPA-së, sepse nuk ka vendosur në tërësi dhe duke i paraqitur qartë provat dhe faktet në të cilat e bazon mënyrën e vendosjes. DA i ATK-së, ka qenë e obliguar si në vështrim të nenit 101.3 të LPA, duke vendosur sipas ankesës së subjektit në lidhje me njoftimin e rivlerësimit, si organ kompetent që shqyrton ankimin e palëve, të nxjerrë vendim në pajtim me nenet 83,84,85,dhe 86 të LPA, e në veçanti të arsyetojë vendimin, si në vështrim të nenit, 85.1, të këtij ligji pasi që me këtë akt janë vënë detyrime dhe ndëshkime ndaj subjektit. ATK nuk ka paraqitur të dhëna të plota, se ka shqyrtuar çështjen në tërësi sipas pretendimeve ankimore të paditësit dhe sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve si në vendimin e BPR,me të cilin është anuluar vendimi i saj i mëparmë dhe lënda i është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje, lidhur me mos pranimin e transaksioneve-faturave për qëllime tatimore të cilat i konsideron si fiktive, ndërsa tatim paguesit që kanë lëshuar këto fatura i konsideron jo ekzistues, apo “tatim pagues fiktiv”, duke konkluduar se në periudhën e kontrollit tek tatim paguesi, nuk ka pasur blerje apo shitje të evidentuara e që është në kundërshtim me Udhëzimin për faturat fiktive të dt..... me subjektet.

Pra në këtë drejtim në vendimin e organit të paditur nuk është sqaruar se janë apo nuk janë inekzistente subjektet e cekura dhe faturat e lëshuara nga ata. Po ashtu në vendimin e saj, nuk i cek faktet, lidhur me faturat kontestuese, sipas rekomandimit të BPR siç është vepruar në raste të tjera, sipas vendimeve të saj DA nr. ...., të dt..... dhe nr.....,dt....., dhe sipas kritereve unike të përcaktuara nga drejtori i përgjithshëm i ATK të dt.....,lidhur me transaksionet e realizuara para datës .....Nuk janë qartësuar dhe paraqitur faktet lidhur me ngarkesën me tatim shtesë për pjesën e shumës së kontratës, në shumë prej .....€, siç theksohet nga ATK të pa deklaruar, sepse nuk provohet me dëshmi konkrete valide, se

*mjetet a janë apo jo të hyra të realizuara dhe a ekziston faturë për pagesën e bërë për këtë shumë. Nga gjendja e tillë e çështjes kolegji gjen se organi i paditur në mungesë të arsyesimit të qartë për faktet vendimtare për mënyrën e vendosjes si në vendimin e saj, vendimi si i tillë është i barasvlershëm me mungesë të arsyesimit ashtu siç parashihet në nenin 86.3 të LPA-së.*

*Për shkak të të metave të cekura të Vendimit të organit të paditur, në pamundësi të vendosjes meritore të çështjes për shkak të fakteve jo të vërtetuara dhe ekzistimit të kontradiktave në akte-prova të paraqitura nga paditësi dhe e paditura, bazuar në nenin 43.2 të LKA, i njëjti anulohet si jo i drejtë dhe ligjor, i nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore si në vështrim të nenit 84,85,86 dhe 101.3 të LPA. Gjithashtu nga faktet e vërtetuara nga gjykata e shkallës së parë në këtë çështje është nxjerrë konkludim jo i drejtë dhe ligjor, andaj nga këto shkaqe po ashtu edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë anulohet.*

*Pasi që me këtë aktgjykim është anuluar Vendimi i organit të paditur, organi i paditur obligohet, ashtu siç parashihet në nenin 43.2 dhe 65 të LKA-së, që në afat jo më vonë se 30 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në vend të vendimit të anuluar të nxjerrë vendim të ri. Organi kompetent obligohet që në procedurë të rishqyrtimit t'i vërtetojë faktet në baza ligjore, lidhur me procedurën dhe gjendjen faktike të çështjes edhe sipas pikëpamjeve juridike, vërejtjeve dhe sugjerimeve të Gjykatës së Apelit të cekura si në këtë aktgjykim.*

### **Aktgjykimi A.A.nr.288/2016, i datës 05.10.2016**

#### **Arsyetimi**

*Gjykata e Apelit shqyrtoi pretendimet në ankesë, Aktgjykimin e ankimuar, Vendimin e organit të paditur si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49, par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194, i Ligjit për procedurën kontestimore, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjen se;*

*Ankesa është e bazuar.*

*Nga shkresat e lëndës rezulton se; me Vendimin e organit të paditur xxxx-panelit shqyrtues të prokurimit, PSH, nr.... të dt....., i nxjerrë gjatë vendosjes së ankesës së paditësit lidhur me aktivitetin e prokurimit, në parag.1 është refuzuar ankesa si jo e bazuar e paditësit lidhur me aktivitetin e prokurimit për tenderin "xxxxxx, me nr. prot....., të iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna XXXX, në parag. II. Aprovohet Vendimi i AK, i dt.,mbi njoftimin e dhënies së kontratës lidhur me Aktivitetin e prokurimit për tenderin në fjalë me nr. të cekur si më lartë.*

*Paditësi kundër Vendimit të OSHP, parashtron padi në Gjykatë Themelore me të cilën e konteston të njëjtin si jo i drejtë dhe ligjor, me propozim që padia të aprovohet si e bazuar, të anulohet vendimi i organit të paditur.*

*Gjykata Themelore në Prishtinë, pas mbajtjes së seancës publike në praninë e palëve, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, bie aktgjykimin e atakuar me ankesë me të cilin e aprovon kërkesë-padinë e paditësit si të bazuar, e anulon vendimin e organit të paditur dhe çështjen ai kthen në rivendosje të paditurës, sipas konkludimeve se;*

vendimi i kontestuar përmban të meta thelbësore të dispozitave të LPA nga nenet 84, 85, dhe 86, të LPA, për shkak të të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij, se është juridikisht i paqartë nuk ka përmbledhje të konstatimeve faktike, në arsyetim nuk janë dhënë arsyet për faktet vendimtare, nuk është bërë arsyetim thelbësor, si në vështrim të nenit 85 të LPA, kur me akt pjesërisht ose tërësisht mohojnë shuajnë kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, tutje citon arsyetimin e vendimit të organit të paditur, duke i aprovuar si të faktuara të gjeturat e ekspertit dhe të paditurit,” se paditësi nuk i ka shlyer detyrimet tatimore ndaj ATK-së dhe se i njëjti në ofertën e tij nuk e ka shënuar afatin e vlefshmërisë së tenderit prej ....ditë, por ka dështuar të provojë para gjykatës, se operatori ekonomik fitues XXXX, sh.p.k, se i ka plotësuar të gjitha kushtet e kërkuara nga dosja e tenderit në këtë aktivitet ekonomik”. Nga gjendja e tillë vlerëson se në organin e paditur nuk është vërtetuar gjendja faktike e çështjes. Gjykata e shkallës së parë si në vështrim të nenit 65, të LKA e obligon të paditurin që në afat prej 30 ditë, në riprocedurë të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në aktgjykim dhe pastaj ta marrë vendimin e drejtë dhe ligjor.

Kolegji i Gjykatës së Apelit duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes duke e shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, Vendimin e të paditurit, të OSHP-së, dhe shkresave tjera të lëndës, si në vështrim të nenit 194 dhe 201.1 b), të LPK-së, gjen se; aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me të meta thelbësore nga neni 182.2 pika n), dhe neni 183, të LPK-së, sepse faktet vendimtare në të cilat bazohet për mënyrën e vendosjes, rreth përmbajtjes së aktit të organit të paditur, nuk janë të qëndrueshme. Andaj pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë nuk mund t'i përkrahë si të rregullta dhe të ligjshme, sepse nga përmbajtja e vendimit të organit të paditur, i nxjerrë duke vendosur sipas ankesës së OE-paditësit, nuk ka qenë objekt i shqyrtimit dhe vendosjes se a i ka plotësuar operatori tjetër ekonomik kushtet për të qenë fitues i tenderit, por i njëjti ka pretenduar se i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore të tenderit sepse ka qenë ofertuesi më i lirë. Të njëjtat pretendime theksohen edhe në përmbajtjen e padisë dhe në procesverbalin e seancës kryesore të gjykatës së shkallës së parë, ku paditësi pretendon se i ka plotësuar kushtet sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Gjykata e shkallës së parë pa dyshim i vërteton faktet e njëjta si në vendimin e organit të paditur se paditësi nuk i ka plotësuar kushtet për të qenë i përgjegjshëm, sepse i njëjti nuk i ka shlyer detyrimet tatimore komunale për vitin XXXX, dhe në ofertën e tij nuk ka shënuar afatin e vlefshmërisë së tenderit sipas dosjes së tenderit pikës 4. fakte këto që paditësi nuk arrin t'i kontestojë me argumente, as në procedurë gjyqësore.

Kolegji vlerëson se sipas përmbajtjes së vendimit të organit të paditur, të OSHP, -panelit shqyrtues PSH nr. XXXXX, të dt. xxxxx, i cili bazohet në ekspertizën së ekspertit, pretendimet ankimore të ankuesit OP, “xxxx”, dosjes së tenderit, dhe mendimit të ekspertit, gjendja faktike e çështjes vërtetohet në mënyrë të plotë dhe të drejtë, se paditësi nuk i ka plotësuar kushtet sipas dosjes së tenderit, i ka munguar xxx, periudha e vlefshmërisë së tenderit dhe për këtë është shpallur i pa përgjegjshëm e po ashtu edhe për faktin tjetër se ka pasur detyrime të pa shlyera në ATK për vitin xxxxx, vërtetuar nga vërtetimi i dt. xxxx, me nr. prot. xxx.

Këto fakte në mënyrë të plotë vërtetohen edhe nga gjykata e shkallës së parë si në aktgjykimin e saj, e cila në këtë drejtim vendimin e organit të paditur e vlerëson si të drejtë, por kolegji si u cek edhe më lartë nuk e pranon si të drejtë vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë kur thekson se, e paditura ka dështuar të dëshmojë nëse OE ekonomik fitues i ka

*plotësuar kushtet dhe kriteret e kërkuara nga dosja e tenderit, sepse kjo çështje paraqitet si çështje e cila nuk ka qenë objekt i çështjes, nuk është shqyrtuar në gjykatën e shkallës së parë dhe nuk ka qenë e atakuar as në procedurë ankimore në organin administrativ përfundimtar-OSHP, gjer sa edhe në procedurë gjyqësore si në vendimin e organit të paditur dëshmohej se paditësi nuk i ka plotësuar kushtet sipas kërkesë nga dosja e tenderit, kurse OSHP, bazuar në dëshmitë e theksuara si në ankesë, ka konstatuar se OE fituesi i tenderit është regjistruar si biznes në vitin xxx, dhe ka qenë i përgjegjshëm në procedurën e tenderit sipas kushteve të parapara.*

*Kolegji i Gjykatës së Apelit nga gjendja e tillë e vërtetuar e çështjes, sipas pretendimeve ankimore dhe detyrës zyrtare, konstaton në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendje faktike tjetër nga ajo e vërtetuar me aktgjykimin e shkallës së parë, duke bërë vlerësimin ndryshe të shkresave të lëndës sipas përmbajtjes së tyre dhe vlerëson se Vendimi i OSHP, është i drejtë dhe ligjor, juridikisht i qartë i nxjerrë sipas formës së aktit administrativ si në nenin 83 të LPA-së, përmbajtësor ashtu siç parashihet me nenin 84, ka hyrje, përmbledhjen e konstatimeve faktike, bazën ligjore në të cilën bazohet, dhe po ashtu është i arsyetuar si në vështrim të nenit 85 dhe 86 të LPA, në bazë të fakteve të vërtetuara sipas gjendjes faktike dhe pretendimeve ankimore të ankuesit-paditësit. Andaj nga kjo gjendje e vërtetuar aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës Themelore në Prishtinë, ndryshohet, ashtu që kërkesë-padia e paditësit refuzohet si jo e bazuar, ndërsa mbetet në fuqi Vendimi i organit të paditur, i OSHP, nr. xxxxx, i dt. xxxxx.*

*Nga të lartë cekurat e në vështrim të nenit 49 të LKA-së, dhe nenit 195.1 e), lidhur me nenin, 201 (b), i LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.S*

### **Aktgjykimi A.A.nr.50/2016, i dt. 01.04.2016**

#### **Arsyetimi**

*Gjykata e Apelit shqyrtoi pretendimet në ankesë, aktgjykimin e ankimuar, Vendimet e organit të paditur dhe shkresat e tjera të lëndës, e pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49, par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194 i Ligjit për procedurën kontestimore, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjen se;*

*Ankesa është e bazuar.*

*Nga shkresat e lëndës rezulton se; me Vendimin nr.454-2/11, të komisionit disiplinor të shqyrtimit të OAK, i nxjerrë nga seanca e mbajtur në praninë e palëve me dt.10.11.2011, është refuzuar ankesa e paraqitësit-tani paditësit N.N. dhe është vërtetuar Vendimi i Komisionit disiplinor hetimor KDH-nr.454-1/11, sepse nuk ka shkelje të rregullave të Etikës profesionale të Avokatëve nga av. X.X., me arsyetim se; Komisioni disiplinor i shqyrtimit pas vlerësimit të provave në mënyrë të gjithanshme dhe deklarimit të palëve para komisionit disiplinor të shqyrtimit dhe pas administrimit të provave si në vendimin e saj, vërteton se i paraqituri nuk ka vepruar në kundërshtim me kodin e etikës profesionale të avokatit andaj lirohet nga përgjegjësia.*

*OAK-Komisioni për ankesa, me vendimin e saj përfundimtar në procedurë administrative, nr.xxx-1/12, të dt. 02.03.2011, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të njëjtën e refuzon ndërsa e vërteton Vendimin e Komisionit disiplinor të shqyrtimit të OAK*

*nr.xxx-2/11, sipas arsyetimit se; komisioni disiplinor i shqyrtimit të OAK pas dëgjimit të palëve dhe shqyrtimit të çështjes ka vërtetuar se av. X.X. nuk është përgjegjës dhe nuk ka bërë shkelje të kodit të etikës.*

*Paditësi kundër Vendimit përfundimtar të OAK, parashtron padi në Gjykatë duke e kontestuar të njëjtin si jo i drejtë dhe ligjor duke pretenduar se ekzistojnë shkelje të kodit të etikës nga ana e ish avokatit të tij X.X. dhe propozon që të anulohet nga gjykata vendimi i të paditurës dhe çështja të kthehet në rishqyrtim ose i njëjti të ndryshohet dhe të merren masa disiplinore ndaj të njëjtit.*

*Gjykata Themelore në Prishtinë, pas mbajtjes së seancës publike në praninë e përfaqësuesit të të paditurës e në mungesë të paditësit i thirrur në mënyrë të rregullt, dhe administrimit të provave si në procesverbal të seancës, kryesore të mbajtur me dt. 05.11.2015, bien aktgjykimin e atakuar me ankesë me të cilin e aprovon kërkesë-padinë e paditësit si të bazuar, e anulon vendimin e organit të paditur dhe çështjen ai kthen në rivendosje të paditurës, sipas konkludimeve se; vendimi i kontestuar përmban të meta thelbësore të dispozitave të LPA nga nenet 84,85,dhe 86,të LPA, për shkak të të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij, se është juridikisht i pa qartë në arsyetim nuk janë dhënë arsytet për faktet vendimtare, nuk është bërë arsyetim thelbësor, si në vështrim të nenit 85 të LPA, kur me akt pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, tutje citon arsyetimin e vendimit të organit të paditur, mandej konkludon se gjykata si rregull në procedurë të konfliktit administrativ vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative. Gjykata e shkallës së parë si në vështrim të nenit 65, të LKA e obligon të paditurin që në afat prej 30 ditësh në riprocedurë të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në aktgjykim dhe pastaj ta marrë vendimin e drejtë dhe ligjor.*

*Kolegji i Gjykatës së Apelit duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes duke e shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, Vendimet e të paditurit, të OAK-komisionit për ankesa nr.xxx-1/12,të dt.00.00.2012, të vendimit të komisionit disiplinor hetimor (KDH),nr.xxx-1/11 të dt.00.00.2011, dhe vendimit të Komisionit disiplinor të shqyrtimit të OAK nr.xx-2/11,nga shqyrtimi i mbajtur me palët me dt. 00.00.2011, dhe shkresave tjera të lëndës, si në vështrim të nenit 194 dhe 201.1 b),të LPK-së, gjen se; aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me të meta thelbësore nga neni 182.2 pika n),dhe neni 183, të LPK-së, andaj pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë nuk mund t'i përkrahë si të rregullta dhe të ligjshme për arsye se, arsyet në të cilat bazohen për faktet vendimtare, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së Vendimit të organit të paditur, janë të paqëndrueshme dhe të pajustificueshme rreth përmbajtjes së dokumentit. Çështja nuk është vendosur me aktgjykim sipas objektit të shqyrtimit dhe gjendjes faktike të vërtetuar në seancën kryesore të shqyrtimit në gjykatë sipas përmbajtjes së procesverbalit nga thëniet e dhëna në procedurë, ku përfaqësuesi i palës së paditur i ka dhënë arsytet për mënyrën e vendosjes dhe shkaqet e refuzimit të ankesave të paditësit si jo të bazuara përkatësisht arsyet e vendosjes si në vendimet e saj, të shqyrtuar në tri shkallëshmëri, sipas ankesave të paditësit në OAK si në vendimet e cekura si më lartë, ku çështja është e qartësuar, në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe është vërtetuar gjendja faktike e çështjes sipas objektit të shqyrtimit.*

*Kolegji vlerëson se sipas vendimit të organit të paditur,.....- komisionit disiplinor të shqyrtimit, nr.V.KDSH-nr.000-2/11, gjendja faktike vërtetohet në mënyrë të plotë, në bazë*

të provave të administruara në seancën e mbajtur me dt. 10.00.2011, gjatë shqyrtimit të ankesës së paditësit ndaj avokatit, ku janë administruar dhe ballafaquar në mënyrë të tërësishme argumentet e palëve në procedurë, të ankuesit –paditësit dhe të paraqiturit av. x.x., dhe ky komision si organi i shkallës së dytë ka nxjerrë vendimin me të cilin ankesa e paditësit është refuzuar si jo e bazuar ndërsa është vërtetuar vendimi i Komisionit disiplinor hetimor, nr. 000-1/11 i dt. 00.00.2011, sepse nuk janë gjetur shkelje të kodit dhe të rregullave të etikës profesionale për avokat nga avokati i paraqitur, e gjer sa ky vendim është vërtetuar si i drejtë dhe ligjor me vendimin përfundimtar të nr.00-1/00, të dt. 02.03.2012, të Komisionit për ankesa të OAK. Gjithashtu gjendja e tillë faktike e çështjes vërtetohet edhe nga shkresat e tjera të lëndës e në veçanti nga Kontrata për ofrimin e ndihmës juridike të komisionit për ndihmë juridike, e dt.0.00.2010, ku i paraqituri av. X.X., është kontraktuar nga komisioni për ndihmë juridike për përfaqësimin e paditësit për lëndën konkrete civile e jo penale, andaj sipas kontratës ka mundur t'i ofrojë ndihmë juridike falas vetëm në çështje juridike civile e jo edhe për çështje-lëndë penale, andaj nga këto fakte është vërtetuar se i paraqituri nuk ka bërë shkelje të kodit të etikës së avokatëve dhe është liruar nga përgjegjësia, nga komisionet shqyrtuese të të paditurës OAK.

Kolegji gjithashtu i aprovon si të bazuara pretendimet ankimore të të paditurit në drejtim të arsyetimit të vendimit të tyre përfundimtar si në vështrim të nenit 85.2 të LKA, ku parashihet se “me përjashtim kur me ligj parashihet ndryshe aktet që ratifikojnë vendimet e nxjerra nga bordet- juritë apo komisionet e ngritura nga administrata si dhe urdhrat e udhëheqësve që kanë të bëjnë me çështje të brendshme nuk ka nevojë të arsyetohen”. Kolegji duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore si dhe duke pasur parasysh se çështja është arsyetuar në dy instanca më të ulëta në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë, e gjithashtu duke pasur parasysh se çështja sipas objektit të kërkesë-padisë së paditësit është, shqiptimi i masës disiplinore ndaj të paraqiturit e gjer sa me vendim nuk është në shqyrtim çështja sipas objektit ashtu siç parashihet në nenin 85.1,pika,(a) të LPA, vendimin e organit të paditur e aprovon si të drejtë dhe të nxjerrë në pajtim me dispozita ligjore të LPA.

Kolegji i Gjykatës së Apelit nga gjendja e tillë e vërtetuar e çështjes, sipas pretendimeve ankimore dhe detyrës zyrtare, konstaton në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike në mënyrë tjetër nga ajo e vërtetuar me aktgjykimin e shkallës së parë, duke bërë vlerësimin ndryshe të shkresave të lëndës në mënyrë të drejtë dhe në baza ligjore dhe vlerëson se Vendimi i OAK, është ligjor, juridikisht i qartë i nxjerrë sipas formës së aktit administrativ si në nenin 83 të LPA, është përmbajtësor ashtu siç parashihet me nenin 84, ka hyrjen, përmbledhjen e konstatimeve faktike, bazën ligjore në të cilën bazohet, dhe po ashtu është i arsyetuar si në vështrim të nenit 85.2 të LPA, në bazë të fakteve të vërtetuara sipas gjendjes faktike nga organi i shkallës së parë dhe të dytë të shqyrtimit në komisionet kompetente të OAK. Andaj aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës Themelore në Prishtinë, ndryshohet, ashtu që kërkesë-padia e paditësit refuzohet si jo e bazuar, ndërsa mbetet në fuqi Vendimi i organit të paditur, i OAK, nr.101-1/0000, i dt.02.00.201.....

Nga të lartë cekurat e në vështrim të nenit dhe 49 të LKA-së, dhe neni 201 (b),itë LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## 11. E DREJTA EKONOMIKE

### 11.1 DISPOZITIVI I AKTGJYKIMIT NË KONTESTET EKONOMIKE

Ligji për Procedurën Kontestimore (LPK) me dispozitat e Nenit 160, përcakton pjesët e aktgjykimit dhe përmbajtjen e tyre. Këto dispozita sipas Nenit 175 vlejné edhe për aktvendimet.

Dispozitat e sipër cekura përcaktojnë si në vijim:

#### *Neni 160*

- 160.1 Aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet ta ketë: pjesën hyrëse, dispozitivin, arsyetimin dhe udhëzimin mbi të drejtën e ankimit kundër aktgjykimit.
- 160.2 Pjesa hyrëse e aktgjykimit përmban: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit, emrin dhe mbiemrin, vendbanimin, gjegejësisht vendqëndrimin e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor dhe me prokurë, tregimin e shkurtër të objektit të kontestit dhe vlerën e tij, ditën e përfundimit të shqyrtimit kryesor, tregimin e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor dhe me prokurë që kanë qenë të pranishëm në seancën për shqyrtimin e tillë si dhe ditën kur është dhënë aktgjykimi.
- 160.3 Dispozitivi i aktgjykimit përmban: vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore, vendimin për ekzistimin apo mosekzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesë-padinë si dhe vendimin mbi shpenzimet procedurale.
- 160.4 Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.
- 160.5 Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsytetime të vendimeve që i ka dhënë me herët gjatë procesit gjyqësor.
- 160.6 Në pjesën arsyetuese të aktgjykimit kontumacional, aktgjykimit në bazë të pohimit, aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesë-padia, apo të aktgjykimit për shkak të mungesës, jepen vetëm arsytet që e justifikojné dhënien e aktgjykimeve të këtilla.

#### *Neni 175*

Dispozitat e neneve 146, 153, 160 dhe 169 paragrafi 2 të këtij ligji në mënyrë të përshtatshme aplikohen edhe kur kemi të bëjmë me aktvendimet.

#### **11.1.1 Koment i shkurtër për zbatimin e dispozitave për përpilimin e aktgjykimit me theks të veçantë në dispozitivin e aktgjykimit si pjesa kryesore e tij**

Përpilimi i aktgjykimit përbën një prej pjesëve më të rëndësishme të procedurës kontestimore sepse me të finalizohet procedura gjyqësore dhe jepet vendimi meritor i gjykatës për çështjen e cila shqyrtohet para saj. Prandaj përpilimi i duhur i aktgjykimit është

i rëndësisë së veçantë dhe duhet kushtuar kujdes maksimal nga gjyqtarët, sidomos të dispozitivit të tij.

Respektimi i plotë i rregullave gjatë përpilimit të dispozitivit të aktgjykimit është i rëndësisë së veçantë në kontestet ekonomike, ku në pjesën më të madhe të rasteve kërkesë-padia nuk përfshin vetëm një kërkesë, por përfshin kërkesa alternative, kumulative, pastaj kërkesë-padia përveç kërkesës kryesore përfshin edhe disa kërkesa aksesore. Po ashtu, për shkak të kompleksitetit të raporteve afariste shpesh numri i palëve është mjaft i madh si në anën e palës paditëse ashtu edhe palës së paditur, si p.sh. kontraktor – nën kontraktor, sigurues –ri sigurues, shitës – transportues – sigurues – bankë – blerës, etj. Prandaj gjatë përpilimit të dispozitivit në këto raste duhet pasur kujdes të shtuar dhe njohuri të mjaftueshme që dispozitivi t'i përfshijë të gjitha kërkesat e parashtruara si me padi ashtu edhe me kundërpadi.

Sipas dispozitave të LPK-së, gjykata në dispozitiv të aktgjykimit vendos për pranimin ose refuzimin kërkesave të veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore vendimin për ekzistimin apo mosekzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesë-padinë si dhe vendimin mbi shpenzimet procedurale. Me shpalljen e aktgjykimit gjykata është e detyruar të vendosë për të gjitha pretendimet e ngritura gjatë rrjedhës së diskutimit, domethënë si për kërkesat kryesore ashtu edhe kërkesat aksesore që rrjedhin nga padia dhe kundërpadia.

Dispozitivi është pjesa kryesore e aktgjykimit që prodhon pasoja materiale-juridike dhe pasoja procedurale ligjore të çështjes së gjykuar (*res-judicata*). Në fakt, i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm bëhet vetëm dispozitivi, ndërsa arsytimi shërben vetëm për t'u identifikuar marrëdhënia juridike që gjykata ka vendosur.

Dispozitivi i aktgjykimit duhet të jetë i qartë, i përcaktuar dhe i detajuar në masën që të jetë e qartë mbrojtja gjyqësore të cilën gjykata e ka dhënë për shkelje të ligjit, apo refuzimi i kësaj mbrojtjeje për shkak të mungesës së një baze ligjore, në kontestin konkret ndërmjet palëve.

Gjykata duhet të formulojë dispozitivin e aktgjykimit në atë mënyrë që është plotësisht e qartë se për cilën kërkesë është vendosur. Aktgjykimi është përgjigja e gjykatës ndaj kërkesës së palës dhe përmbajtja e tij bëhet ligj për palët. Gjykata duhet të vendosë për meritat e kërkesës respektivisht bazën juridike të kërkesë-padisë, e jo për palët.

Përmes autoritetit shtetëror gjykata përcakton përmbajtjen e marrëdhënies juridike dhe i urdhëron të paditurit që të veprojnë, të durojnë ose me vendimin e saj gjykata e ndryshon përmbajtjen e marrëdhënies juridike ndërmjet palëve.

Nëse gjykata e bën përmbajtjen e dispozitivit në mënyrën e duhur, në procedurën e ekzekutimit të një aktgjykimi nuk duhet të ketë vështirësi dhe as nuk duhet të kërkohet asnjë informacion shtesë nga palët. Në raste të tilla, kryerja e procedurës civile dhe lëshimi i aktgjykimit do të kishte kuptim dhe justifikim, sepse përmbajtja e mbrojtjes ligjore nga aktgjykimi i shpallur do të ekzekutohet në procedurën e ekzekutimit, nëse i pandehuri nuk e përmbush atë vullnetarisht.



Formulimi i dispozitivit të aktgjykimit nuk mund të jetë identik në të gjitha rastet, sepse përmbajtja e tij varet nga një mosmarrëveshje e veçantë ndërmjet palëve. Kjo varet nga rasti konkret p.sh. në rast se kërkohet transferimi i posedimit të një sendi të caktuar, kompensimi për dëmet nga një ngjarje e caktuar, pagesa e një kërkesë monetare, përcaktimin e pronësisë mbi të gjithë pronën ose vetëm një pjesë e saj, përcaktimin e kontratës, përmbushjen e detyrimit ligjor të mirëmbajtjes së personave të tjerë, etj.

Në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata do të shënojë vetëm të dhënat e përcaktuara në paragrafin 160 par. 3 të LPK\_së. Nuk është e nevojshme në dispozitiv të aktgjykimit të përsëritet emri, mbiemri dhe adresa e palëve, sepse ky informacion, sipas dispozitave ligjore, gjykata është e detyruar ta deklarojë në hyrje të vendimit të tij.

Gjithashtu është e panevojshme të theksohen faktet e vërtetuara, shpjegimet e caktuara në aktgjykim, dispozita e zbatuar e normës juridike materiale dhe provave e administruara, sepse këto gjykata duhet t'i theksojë në arsyetimin e aktgjykimit.

Në rastet kur detyrimi konsiston në pagesën e shumës së caktuar monetare, kjo shumë përveç shënimit me numra duhet të shënohen edhe me shkronja. Megjithatë, në praktikën gjyqësore, gjykatat në shumicën e rasteve detyrimet monetare i shënojnë vetëm me numra ndërsa shënimi vetëm me numra krijon mundësi të keqpërdorimit dhe shpesh për shkak të një gabimi teknik mund të shkaktojë paqartësi të dispozitivit dhe vështirësi në ekzekutimin e të njëjtit.

Në praktikë na paraqiten raste kur gjykata urdhëron përmbushjen e një detyrimi të caktuar pa caktuar afatin për përmbushje (15 ditë në kontestet civile – 7 ditë në kontestet ekonomike) dhe kjo paraqet vështirësi në ekzekutimin e tij

Po ashtu, në dispozitivin e aktgjykimit detyruet, gjykata shpesh thekson se i padituri është i detyruar të përmbushë dënimin në një periudhë të caktuar kohore "nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë". Termi "nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë" është i panevojshëm për tu theksuar në aktgjykim sepse është e mjaftueshme që gjykata të përcaktojë afatin për përmbushjen vullnetare të detyrimit. Nëse ai nuk e përmbush detyrimin vullnetarisht brenda këtij afati, paditësi mund të kërkojë përmbarimin në bazë të Ligjit për procedurën përmbarimore.

Është plotësisht e panevojshme që në dispozitivin e aktgjykimit të theksohet se aprovohet kërkesë-padia e paditësit, e pas kësaj të shënohet vendimi i gjykatës për kërkesë-padinë. Aq më tepër kur ky pasus përpilohet si pikë e veçantë e dispozitivit sepse dispozitivi duhet të përmbajë urdhra që duhet të zbatohen ndërsa në raste të tilla si do të zbatohet pika e parë e dispozitivit kur nuk përmban asnjë urdhër? Është e drejtë që dispozitivi i aktgjykimit detyruet të fillojë me fjalinë "detyrohet i padituri".

Gjykata është e autorizuar të riformulojë kërkesën nëse paditësi e ka ngarkuar atë me të dhëna të panevojshme apo të përsëritura, por kjo duhet të bëhet me kujdes, pa ndryshuar kuptimin e tij dhe në kufijtë e mbrojtjes së kërkuar ligjore.

Gjykata gjithmonë duhet pasur parasysh se dispozitivi i aktgjykimit ka karakterin e normës imperative ligjore andaj edhe duhet të përpilohet në formë të tillë. Andaj, dispozitivi i aktgjykimit përmban urdhërin/vendimin konkret të shtetit në situatën e caktuar jetësore.

Në praktiken gjyqësore, hasim në aktgjykime të cilat nuk i përmbushin në tërësi kërkesat rregullat e sipër cekura për përmbajtjen dhe përpilimin e dispozitivit të aktgjykimit/aktvendimit, si në vijim:

### **Shembulli I**

#### **AKTGJYKIM**

- I. Aprovohet pjesërisht kërkesë-padia e paditësit N.T.P “XX” me seli në “.....” dhe Detyrohet e paditura Ndërmarrja “NN” që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në lokalit afarist të paditësit me datë 02.10.2010, t’ia paguaj shumën prej 855 €, në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit.*
- II. Refuzohet kërkesë-padia e paditësit mbi shumën e aprovuar në shumën prej 1.500 €.*
- III. Detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguaj paditësit shumën prej 260 €<sup>30</sup>.*

### **Pjesë nga arsyetimi**

Ky vendim është prishur me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në arsyetimin e të cilit ndër të tjera është theksuar se:

*Gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 182 par. 2 pikat i) dhe n), për arsye se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet. Dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe arsyet e aktgjykimit. Nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktgjykimit dhe procesverbaleve për thëniet në procedurë. Nga dispozitivi i aktgjykimit në pikën II të nuk është e qartë nëse është refuzuar kërkesë-padia e paditësit në shumë prej 1.500 € apo vetëm diferenca ndërmjet shumës së kërkuar dhe shumës së aprovuar dhe cila është ajo diferencë.*

Në dispozitivin e sipërcituar pa nevojë janë përsëritur të dhënat për palët sepse ato ekzistojnë në hyrjen e aktgjykimit. Në pikën II të dispozitivit nuk është formuluar qartë pjesa e kërkesë-padisë së refuzuar<sup>31</sup>.

### **Shembulli II**

#### **AKTGJYKIM**

*Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesë-padia e paditësit N.P.T. “XX” me seli në (.....)*

- I. Detyrohet e paditura KS “NN” që paditëses t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 16,220.00 €, në emër të borxhit kryesor për kompensimin e dëmit material të pësuar në automjetin e aksidentuar shumën prej 6,600.00 € dhe në emër të fitimit të munguar*

---

<sup>30</sup> Shih: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, I.C.nr.421/2014, i datës 26.06.20015.

<sup>31</sup> Nga Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës: Ae. nr. 114/2015.

*shumën prej 9,620.62 €, me kamatë ligjore nga data e paraqitjes së padisë dt. 27.03.2013 deri në pagesën përfundimtare.*

- II. *Refuzohet kërkesë-padia e paditëses lidhur me llogaritjen e pagesës prej 300.64 €, për periudhën kohore prej datës 01.03.2015 e deri në pagesën definitive me kamatë prej 12%.*
- III. *Detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,951.00 €<sup>32</sup>.*

### **Pjesë nga arsyetimi**

Ky vendim është prishur me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në arsyetimin e të cilit ndër të tjera është theksuar se:

*Në dispozitivin e aktgjykimit detyrohet i padituri ta paguajë kompensimin e dëmit material për automjetin e aksidentuar, por nuk theksohet fare se për cilin aksident urdhërohet kompensimi dhe për cilin automjet. Po ashtu në dispozitiv është detyruar e paditura që t'ia paguajë paditëses kompensimin e fütimit të munguar por nuk theksohet se në çfarë forme është shkaktuar ky dëm dhe për cilën periudhë<sup>33</sup>.*

Në dispozitivin e sipërcituar pika e parë është plotësisht e panevojshme sepse nuk krijon asnjë efekt juridik. Përveç vërejtjeve nga vendimi i sipërcituar i Gjykatës së Apelit, nuk është përcaktuar norma e kamatës për vonesë. Më pikën II nuk është e qartë për çfarë pagese është refuzuar kërkesë-padia. Të metat e tilla e bëjnë aktgjykimin të paekzekutueshëm dhe njëkohësisht çështjen ndërmjet palëve nuk e bën çështje të gjykuar (res judicata) pasi nuk dihet saktësisht për cilën kërkesë të paditësit është vendosur, andaj lihet hapësirë që për të njëjtën çështje paditësi të mund të ushtrojë padi tjetër.

### **Shembulli III**

#### **AKTGJYKIM**

- I. *Vërtetohet se i padituri NTP "NN", me seli në Prishtinë, ka shkelur markën tregtare të paditësit me nr.10485, nr. i Aplikimit KS/M/2008/7381, të datës 18.11.2008, të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Agjensioni për Pronësi Industriale duke vendosur në qarkullim të lirë produktin e kafesë me emrin "X Caffè", në formë paketimi 100 gram, 500 gram dhe paketime tjera.*
- II. *I ndalohet të paditurit çdo aktivitet me të cilin i shkelet paditësit marka tregtare me nr. 10485, posaçërisht vendosja në qarkullim të mallrave të cekura në dispozitivin I të aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.*
- III. *Detyrohet e paditura që të tërheqë nga tregu të gjitha produktet që shkelin markën tregtare figurative të cilat janë në qarkullim, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.*

---

<sup>32</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, C.nr. 151/2013, i datës 07.08.20015.

<sup>33</sup> Nga Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës: Ae. nr. 182/2015 dt.12.10.2016.

*IV. Detyrohet i padituri që t'ia paguajë paditësit të gjitha shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë prej 509,20€, nga data e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim<sup>34</sup>*

### **Pjesë nga arsyetimi**

Ky vendim është prishur me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në arsyetimi e të cilit ndër të tjera është theksuar se:

*Gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 182 par. 2 pika n), për arsye se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit, nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare respektivisht arsyet e dhëna janë të paqarta, ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktgjykimit dhe dokumenteve të administruara si prova.*

*Nga dispozitivi i aktgjykimit nuk është e qartë se me cilin produkt e paditura ka shkelur markën tregtare të paditësit, sepse në dispozitiv nuk theksohet fare ky produkt respektivisht nuk përshkruhet paketimi i cili shkel markën tregtare të paditësit dhe i cili ndalohet të vihet në treg. Nga shkresat e lëndës rrjedh se gjykatës i janë prezantuar dy produkte të së paditurës, respektivisht i njëjti produkt me dy lloj paketimesh ndërsa gjykata nuk e precizon se me cilin paketim është shkelur marka tregtare e paditësit. Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka marrë për bazë deklaratën e të paditurit se produkti është tërhequr nga tregu ndërsa në pikën II të dispozitivit e detyron të paditurin që të tërheqë nga tregu të gjitha produktet të cilat janë në qarkullim e që e shkelin markën tregtare figurative, në afatin kohor prej 15 ditëve, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm, përsëri pa e precizuar produktin dhe pa arsyetim të duhur<sup>35</sup>.*

Në dispozitivin e sipërcituar përveç vërejtjeve të theksuara lidhur me dy aktgjykimet e mëparshme, pa nevojë është përdorur termi "nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë" sepse është e mjaftueshme që gjykata të përcaktojë afatin për përmbushjen vullnetare të detyrimit e dënimit. Nëse ai nuk e përmbush detyrimin vullnetarisht brenda këtij afati, paditësi mund të kërkojë përmbarrimin në bazë të Ligjit për procedurën përmbarrimore.

### **Shembulli IV**

#### **AKTGJYKIM**

*Aprovohet pjesërisht kërkesë-padia e paditësit N.T.SH. "ABA"*

*I. Detyrohet e paditura-kundërpaditësi N.T.N "XY" me seli në Prishtinë, që t'ia paguajë palës paditëse, shumën e përgjithshme prej 7,984.00 €, në emër të kompensimit të dëmit, për shkak të shkatërrimit të infrastrukturës së vendosur në ngastrat kadastrale n.1080 (pronë e KK Prishtinë) dhe 1081 (pronë e bashkëpronarëve Arben Arbeni, Shaban Shabani dhe Rame Rama) Prishtina, zona Kadastrale Prishtinë, në afatin*

---

<sup>34</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, Enk.nr.239/2016, i datës 25.07.2016.

<sup>35</sup> Nga Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës: Ae. nr. 195/2016 me datë 06.10.2016.

*paritiv prej shtatë ditësh, duke llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive të detyrimit, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.*

- II. Refuzohet si e pabazuar kërkesë-padia e paditësit lidhur me fitimin e humbur dhe humbjen lidhur me pagesën e qirasë për katër pronarët e banesave.
- III. Refuzohet në tërësi si e pabazuar kundërpadia e parashtruar e N.T.N Tregtia, me seli në Prishtinë.
- IV. Secila palë t'i bartë shpenzimet procedurale<sup>36</sup>.

## **Pjesë nga arsyetimi**

Ky vendim është prishur me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në arsyetimin e të cilit ndër të tjera është theksuar se:

*Gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 182 par. 2 pika n), për arsye se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit, nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare respektivisht arsyet e dhëna janë të paqarta, ekzistojnë kundërtënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktgjykimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës.*

*Në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar nuk është e qartë se pse i është aprovuar kompensimi për paditësin, kur në këtë pikë të dispozitivit theksohet se infrastruktura ka qenë e vendosur në ngastrat kadastrale n.1080 (pronë e KK Prishtinë) dhe 1081 (pronë e bashkëpronarëve Arben Hajdini, Shaban Krasniqi dhe Bedri Prishtina, zona Kadastrale Prishtinë andaj nuk është e qartë se kush është i dëmtuar, cili është roli i pronarëve të paluajtshmërive, kompensimi i aprovuar cilat dëme specifike i përfshin, etj. Po ashtu në të njëjtën pikë, pas urdhërit për pagesën e detyrimit në afatin paritiv prej 7 ditëve, vazhdon fjalia “duke llogaritur .....” por nuk është e qartë kujt i referohet kjo llogaritje, sepse gjykata nuk ka aprovuar ndonjë kamatë?. Në pikën II të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesë-padia e paditësit lidhur me fitimin e humbur dhe humbjen lidhur me pagesën e qirasë për katër pronarët e banesave, por nuk është e qartë së për çfarë fitimi të humbur, për çfarë qira dhe kush janë këta 4 persona. Për këtë çështje nuk jepen të dhëna fare as në arsyetimin e aktgjykimit, çka e bën këtë pikë plotësisht të paqartë, se për çka ka vendosur gjykata? Në pikën e tretë të dispozitivit (e shënuar me II) është refuzuar në tërësi si e pabazuar kundërpadia e parashtruar e N.T.N Tregtia, me seli në Prishtinë, por nuk precizohet se çka konkretisht është refuzuar respektivisht cila kërkesë e paditësit, gjë që e bën këtë pikë konfuze.*

*Bazuar në të sipërcekurat, Gjykata e Apelit ka gjetur se dispozitivi i aktgjykimit ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit dhe njëkohësisht i pa ekzekutueshëm<sup>37</sup>.*

---

<sup>36</sup> Aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike C.nr.338/2013, të datës 20.05.2015.

<sup>37</sup> Nga Aktvendimi I Gjykatës së Apelit të Kosovës: Ae.nr.115/2015 datë 25.01.2017.

Në dispozitivin e sipërcituar përveç vërejtjeve të theksuara nga aktvendimi i Gjykatës së Apelit si dhe vërejtjeve lidhur me pikën e parë të dispozitivit, pjesën më problematike përbën pika II e dispozitivit me të cilën refuzohet kundërpadija e paditësit pa theksuar fare se çka përmban kjo kërkesë-padi. Një formulim i tillë është plotësisht i palejueshëm sepse nuk është e qartë se për çka është vendosur dhe nuk e bën vendimin meritë, e rrjedhimisht edhe çështje të gjykuar.

## **Shembulli V**

### **AKTVENDIM**

- I. Aprovohet si i bazuar propozimi i palës propozuese N.T.P “AA”, për caktimin e masës së sigurisë, ndaj kundërshtarit të sigurimit N.H “BB”, lidhur me kërkesën për ndalimin e menjëhershëm të prodhimit, shpërndarjes, shitjes dhe vënies në qarkullim të produktit ushqimor - lloqum, me paketimet që janë të deponuara si prova të lëndës (paketimi 1A, paketimi 1B dhe paketimi 1C) dhe tërheqjen e menjëhershme nga pikat e shitjes të produkteve të tilla që aktualisht gjenden në treg.*
- II. Ky aktvendim mbi caktimin e masës së sigurisë mbetet në fuqi deri në vendimin e ardhshëm gjyqësor.*
- III. Për nevoja të ekzekutimit me të lehte të aktvendimit provat e lëndës paketimi 1A, paketimi 1B dhe paketimi 1C i bashkëngjiten këtij aktvendimi si pjesë përbërëse e tij<sup>38</sup>.*

### **Pjesë nga arsyetimi**

Ky vendim është prishur me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në arsyetimi e të cilit ndër të tjera është theksuar se:

*Në këtë gjendje të çështjes juridike, Gjykata e Apelit ka gjetur se aktvendimi i atakuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2, pika n) e që përbejnë arsye për prishjen e këtij aktvendimi. Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në atë se aktvendimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm ndërsa në arsyetim nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare<sup>39</sup>.*

Në dispozitivin e sipërcituar problematikat paraqiten në pikat I dhe III të dispozitivit. Pika I e dispozitivit përbën dispozitiv “descriptiv” sepse vetëm përshkruan propozimin e propozuesit por nuk përmban asnjë urdhër konkret të gjykatës ndaj kundërshtarit të sigurimit andaj ekzekutimi i tij mund të jetë problematik. Ndërsa pika më e papranueshme në këtë dispozitiv përbën pika III me të cilin gjykata vendos që provat e lëndës t’i bashkëngjiten aktvendimin dhe të behen pjesë përbërëse e tij. Kjo pikë përveç formulimit të papranueshëm dhe jo profesional bie në kundërshtim me të gjitha dispozitat ligjore që rregullojnë aktvendimin respektivisht aktgjykimin. Ky aktvendim i përpiluar në këtë mënyrë është i pa ekzekutueshëm sepse në asnjë rast provat e lëndës respektivisht “paketimet” nuk përbejnë titull ekzekutiv ndërsa i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm bëhet vetëm dispozitivi i vendimit, e jo pjesët të cilat mund t’i bashkëngjiten atij.

---

<sup>38</sup> Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, I.C.nr. 478/2016, i datës 04.11.2016.

<sup>39</sup> Nga Aktvendimi I Gjykatës së Apelit të Kosovës: Ae.nr.282/2016, me dt.30.01.2017.

## Shembulli VI

### AKTVENDIM

- I. *Miratohet propozimi i propozuesit të sigurimit "XX Banka" A.S, me seli në ....*
  - 1.1 *Shpallet NULE gjithë procedura e shpërbërjes vullnetare të shoqërisë tregtare "X Group" Sh.p.k. e zhvilluar konform vendimit të pronarëve të saj të datës 21.03.2015, dhe*
  - 1.2 *Detyrohen bankat që operojnë në Kosovë që të bëjnë bllokimin e llogarive bankare të kundërshtarit të sigurimit " X Group" Sh.p.k. dhe pronarëve të tij Agim Agimi, Avni Agimi dhe Driton Agimi, deri në shumën prej 1,364,527.00 €*
  - 1.3 *I ndalohet "X Group" Sh.p.k., organeve menaxhuese të tij dhe pronarëve të tij, tjetërsimi, fshehja, ngarkimi dhe disponimi me pasuritë e kësaj shoqërie tregtare.*
  - 1.4 *Ndalohen të gjitha veprimet që rezultojnë me ndryshimin e statusit të kundërshtarëve të sigurimit Agim Agimi, Avni Agimi dhe Driton Agimi, si pronarë të të paditurit të parë.*
- II. *Refuzohet propozimi për caktimin e masës së sigurimit ndaj kundërshtarit të sigurimit "Y Group" Sh.p.k. me të cilën është propozuar bllokimi i llogarive bankare të saj, ndalimi i tjetërsimit dhe disponimit të pasurisë së saj, dhe ndalimi i ndryshimit të statusit ligjor të saj<sup>40</sup>.*

### Pjesë nga arsyetimi

Ky vendim është prishur me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në arsyetimin e të cilit ndër të tjera është theksuar se:

*Gjykata e Apelit ka gjetur se aktvendimi i atakuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2, pika, b), d), dhe n), e që përbëjnë arsye për prishjen e këtij aktvendimi. Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në atë se aktvendimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm ndërsa në arsyetim nuk janë dhënë arsyet për faktet vendimtare respektivisht arsyet e dhëna janë të paqarta, ekzistojnë kundërtënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktgjyqimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës. Për më tepër gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar fare se si e ka krijuar bindjen dhe cila është baza ligjore për caktimin e masës së sigurimit ndaj kundër propozuesve për të cilët është caktuar masa e sigurimit.*

*Me aktvendimin e atakuar gjykata e shkallës së parë e ka shpallur nule gjithë procedurën e shpërbërjes vullnetare të shoqërisë tregtare dhe kjo përbën shkelje të dispozitës së nenit 300.3 të LPK-së, i cili përcakton se masa e sigurimit nuk guxon ta përfshijë kërkesën që sigurohet me anë të masës andaj rrjedhimisht gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur që me aktvendim për masën e sigurimit të vendos për çështjen kryesore respektivisht të vendos për kërkesëpadinë e paditësit. Për më tepër gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar fare nëse propozuesi i ka respektuar procedurat ligjore për realizimin e të drejtës në procedurë administrative, para se t'i drejtohet gjykatës.*

---

<sup>40</sup> Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, I.C.nr.273/2016, i datës 30.06.2016.

*Në paragrafin e fundit të pikës I të dispozitivit të Aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë i ka ndaluar të gjitha veprimet që rezultojnë me ndryshimin e statusit të kundërshtarëve të sigurimit Agim Agimi, Avni Agimi dhe Driton Agimi, si pronarë të të paditurit të parë. Ky paragraf është i pakuptueshëm dhe i pa-ekzekutueshëm, sepse nuk është e qartë se për çfarë statusi të kundërshtarëve të sigurimit është caktuar ndalimi. Kjo përbën shkelje të shkelje thelbësore të dispozitës të procedurës kontestimore nga neni 182.2, pika, n), e që përbën arsye për prishjen e këtij aktvendimi<sup>41</sup>.*

Në dispozitivin e sipërcituar përveç vërejtjeve të theksuara nga aktvendimi i Gjykatës së Apelit, në pikën 1.4 me formulimin “veprimet që rezultojnë me ndryshimin e statusit të kundërshtarëve” shfaqet rasti me klasik i një dispozitivi abstrakt respektivisht një urdhëri të padefinuar të gjykatës, i cili nuk krijon efekte dhe nuk mund të përmbarohet.

## **Shembulli VII**

### **AKTVENDIM**

- I. *Miratohet propozimi i propozuesit të sigurimit “XXXXX” me seli në ..... Ashtu që detyrohet kundërshtari i sigurimit “YYYYY” me seli në ..... që në qeverisjen e kompanisë t’iu përmbahet kritereve si në vijim:*
  - 1.1 .....
  - 1.2 .....
  - 1.3 .....
  - 1.4 *T’i respektoj të drejtat e paditësit, si aksionar i kompanisë.*
  - 1.5 .....
- II. *Refuzohet si i pabazuar propozimi për caktimin e masës së sigurimit, lidhur me pikat e tjera të tij, siç është parashtruar përmes parashtrësës së datës 15.06.2017*

### **Pjesë nga arsyetimi**

Ky vendim është prishur me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në arsyetimin e të cilit ndër të tjera është theksuar se:

*Në këtë gjendje të çështjes juridike, Gjykata e Apelit ka gjetur se aktvendimi i atakuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2, pika n), e që përbejnë arsye për prishjen e këtij aktvendimi. Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në atë se dispozitivi i aktvendimit është i paqartë, kontradiktor me vetveten, abstrakt, i mangët dhe rrjedhimisht i paekzekutueshëm dhe në kundërshtim me arsyetimin e tij, nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare dhe ato që janë dhënë janë kontradiktore,*

[.....]

*Në rastin konkret kundërshtari i sigurimit është subjekt juridik dhe masa është lëshuar kundër subjektit juridik andaj logjikisht është e pamundur që subjekti të ndërmerr veprime që do të mund të pamundësonin apo vështirësonin realizimin e kërkesës në të ardhmen, ndërsa me aktvendimin e atakuar nuk është detyruar asnjë person i caktuar në çfarëdo*

---

<sup>41</sup> Nga Aktvendimi I Gjykatës së Apelit të Kosovës: Ae.nr.167/2016, me dt.16.08.2016.



*cilësie apo ndonjë strukturë menaxhuese për t'u rezervuar nga ndërmarrja e ndonjë veprimi. Poashtu me masë janë përcaktuar detyrimet ligjore dhe ato që rrjedhin vet nga statuti i ndërmarrjes "YYYYYYY" sh.p.k, andaj është plotësisht e panevojshme dhe në kundërshtim me dispozitat e Kreu XXI të LPK-së, caktimi i masës për përmbushjen e këtyre detyrimeve.*

[.....]

*Po ashtu aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje të Nenit 160.3 të LPK-së, sepse në pikën II të dispozitivit, pa u precizuar se çka refuzohet. Gjykata e shkallës së parë ka refuzuar si të pabazuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit, lidhur me pikat e tjera, siç është parashtruar përmes parashtrësës së datës 15.06.2017, po një vendim i tillë në dispozitiv nuk është i lejueshëm sepse parashtrësat e palëve nuk mund të marrin formë përfundimtare dhe të plotfuqishme andaj çështja mbetet e hapur dhe vendimi nuk mund të bëhet i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm.*

Në dispozitivin paraqitur më sipër mospërputhjet shfaqen në pikën I pika 1.4, ku gjykata e detyron palën për respektimin e të drejtave të përcaktuara me ligj, pa i definuar konkretisht detyrimet e palës qka e ben këtë pikë të panevojshme, abstrakte dhe të pa ekzekutueshme.

Problemi më i madh në këtë dispozitiv paraqitet në pikën II ku "refuzohet si i pabazuar propozimi për caktimin e masës së sigurimit, lidhur me pikat e tjera te tij, siç është parashtruar përmes parashtrësës së datës 15.06.2017".

Siç është cekur më lartë gjykata në dispozitiv të aktgjykimit vendos për pranimin ose refuzimin kërkesave të veçanta. Ajo vendos si për kërkesat kryesore ashtu edhe kërkesat aksesore që rrjedhin nga padia dhe kundërpadia. Dispozitivi i aktgjykimit duhet të jetë i qartë, i përcaktuar dhe i detajuar në masën që të jetë e qartë mbrojtja gjyqësore të cilën gjykata e ka dhënë për shkelje të ligjit, apo refuzimin e kësaj mbrojtje për shkak të mungesës së bazës ligjore.

Gjykata duhet të formulojë dispozitivin e aktgjykimit në atë mënyrë që është plotësisht e qartë se për cilën kërkesë është vendosur dhe për cilën është refuzuar. Gjykata duhet të vendosë për meritat e kërkesës respektivisht bazën juridike të kërkesëpadisë, e jo për palët.

Bazuar në të sipër cekurat formulimi i tillë i gjykatës nga pika 1.4 e dispozitivit është e papranueshme dhe nuk përbën vendim. Gjykatat është dashur që të precizojë qartë se cilat kërkesa i refuzon ashtu që vendimi për ato kërkesa të bëhet e plotfuqishëm dhe çështje e gjykuar.

## **11.2 FORMA ME SHKRIM E KONTRATËS SË NDËRTIMIT (Punët urgjente, punimet shtesë/të ndryshuara)**

### **11.2.1 Forma e shkruar**

Kontrata e ndërtimit duhet të lidhet në formë të shkruar dhe në parim forma përbën kusht të ekzistimit të kontratës dhe krijimit të efekteve juridike. Sipas këtij parimi kontrata e lidhur verbalisht nuk krijon efekte juridike.

Ky parim përcaktohet me dispozitën e Nenet 645 par. 2 të LMD-së, i cili përcakton se: *“kontrata për ndërtim duhet të jetë e lidhur me shkrim”*

Po ashtu forma me shkrim kërkohet dhe për të gjitha ndryshimet e nevojshme dhe plotësimet e kontratës së ndërtimit.

Në këtë drejtim dispozita e neni 648 të LMD-së parasheh:

1. *Për çdo shmangie nga projekti i ndërtimit respektivisht nga punimet e kontraktuara, kryerësi duhet të ketë pëlqimin me shkrim të porositesit.*
2. *Ai nuk mund të kërkojë ngritje të çmimit të kontraktuar për punimet që i ka kryer pa pëlqimin e këtillë.*

Megjithatë, Neni 645 i LMD-së nuk mund të interpretohet në kuptimin e ngushtë, ashtu që vetëm mungesa e formës së kontratës me njërën palë të përfshirë në raportin kontraktues, të jetë bazë e mjaftueshme për mohimin e pagesës së punëve të realizuara nga punë kryesi. Te kontrata e ndërtimit si edhe te çdo kontratë tjetër veprimet e palëve kontraktuese duhet vlerësuar në bazë të qëllimit të tyre për lidhjen e kontratës andaj ne rastet kur punë kryesi i kryen punët ndërtimore sipas kontratës së lidhur të ndërtimit, kërkesave të porositesit respektivisht në marrëveshje me të krijohet detyrimi për kompensimin e punëve të kryera, nëse kryerja e punëve është bërë me qëllim të realizimit të projektit i cili ka qene edhe qëllim i porositesit dhe në interes të tyre.

Neni 15 i LMD-së kërkon ekuivalencë të prestimeve te kontratat e dyanshme detyruese. Nëse kryesi nuk do të kompensohej për punët e kryera, vetëm për shkak të mungesës së një kontrate formale me porositesin nuk do ta lironte porositesin plotësisht nga detyrimi i kompensimit por do të krijonte detyrimin për kompensimin e vlerës së përfituar për shkak të fitimit të pabazuar, të parapare me Neni 194 të LMD-së<sup>42</sup>.

Për më tepër, në kuptim të Nenet 58 të LMD-së, kontrata për të cilën kërkohet forma shkresore quhet e plotfuqishme megjithëse nuk është lidhur në atë formë, në qoftë se palët kontraktuese i kanë zbatuar në tërësi apo në pjesën pre dominuese detyrimet që dalin nga ajo, ndërsa sipas Nenet 51.3 të LMD-së edhe marrëveshjet verbale mbi pikat sekondare kontraktuese konsiderohen të vlefshme nëse janë në përputhje me përmbajtjen e kontratës kryesore<sup>43</sup>. Po ashtu Neni 57 par 4. i LMD-së përcakton se: *Kërkesa e formës me shkrim është e përbushur, në qoftë se palët këmbëjnë letra ose merren vesh me ndonjë mjet tjetër që bënë të mundur që me siguri të përcaktohet përmbajtja dhe personi, i cili e ka dhënë deklaratën”*.

Forma me shkrim të kontratat e ndërtimit është paraparë për krijimin e sigurisë në punët investive të ndërtimit, në interes të shoqërisë. Megjithatë në kuptim të Nenet 58 të LMD-së konsiderohet se mungesa e formës me shkrim konvalidohet nëse marrëveshja me shkrim është përbushur në tërësi apo në pjesën pre dominuese. Kjo zgjidhje rrjedh nga qëllimi i kontratës sepse në të kundërtën kryesi i punëve do të lirohej nga përgjegjësia si për punët e dukshme ashtu edhe për ato të fshehta (Neni 656 lidhur me Neni 629 dhe 630 të LMD), si dhe nga përgjegjësia solidarë për ndërtesën (Neni 658-661 LMD), sepse raportet ndërmjet

---

<sup>42</sup> Shih: Aktgjykimet e Gjykatës Supreme te Republikës së Kroacisë: Rev-x 1750/09-2.

<sup>43</sup> Shih: Aktgjykimet e Gjykatës Supreme te Republikës së Kroacisë: Rev-x 1013/13-2; Rev-x 888/14-2; <https://sudskapraksa.vsrh.hr/home>

palëve do të duhej të rregulloheshin sipas rregullave të pasurimit të pabazë (Neni 194 LMD).<sup>44</sup>

Çfarë pasoja juridike ka lidhja e kontratës të rastet kur nuk i ka paraprirë procedura e paraparë ligjore e ofertimit publik apo mbledhjes së ofertave. Në këtë rast të lidhjes së kontratës së ndërtimit pa ofertim publik respektivisht pa mbledhje të ofertave është i ndaluar vetëm për porositësin, për të cilët zbatohen rregulloret e përkatëse, përderisa organizatave zbatuese nuk iu ndalohet lidhja e kontratave të cilave nuk i ka paraprirë procedura e paraparë ligjore. Meqenëse ligjet përkatëse nuk e parashohin nulimin e kontratave të lidhura, të cilave nuk i ka paraprirë procedura e paraparë ligjore, por shkelja e rregullave përbën delikt ekonomik, andaj në kuptim të Nenit 89 par. 2 të LMD-së, këto kontrata mbeten në fuqi.<sup>45</sup>

Përfundimisht shtrohet pyetja, a është e vlefshme kontrata e lidhur me personin i cili nuk ka pasur ofertën me të volitshme. Meqenëse edhe në këtë rast kemi të bëjmë me lidhje të kontratës e cila është e ndaluar dhe përbën delikt ekonomik, vetëm për porositësin, ajo kontratë mbetet në fuqi.<sup>46</sup>

Mungesa e formës të kontratat formale përbën lidhje të kontratës nën kushtin suspenziv i cili përmbushet nëse krijohen dokumente të shkruara apo zbatohen në tërësi apo në pjesën predominuese detyrimet që dalin nga ajo, kushti suspenziv përmbushet dhe krijohen efektet juridike të marrëveshjes verbale<sup>47</sup>.

### 11.2.2 Largimi nga projekti – punët shtese

Sipas Nenit 633 (Neni 648 i LMD Ligji Rr.04/L-077) për *çdo largim nga projekti i ndërtimeve, respektivisht nga punimet e kontraktuara zbatuesi duhet të ketë, pëlqimin shkresor të porositësit.*

*Ai nuk mund të kërkojë asnjë ngritje të shpërblimit të kontraktuar për punimet që i ka kryer pa pëlqimin e këtillë.*

Pavarësisht dispozitës së sipër cekur në praktikën juridike është krijuar qëndrimi se kjo dispozitë vlen vetëm në rastet kur vet punë kryesi dëshiron të largohet nga projekti i kontraktuar por kjo nuk vlen kur shmangia nga projekti kryesor është sipas kërkesës respektivisht në marrëveshje me porositësin e punëve. Prandaj pëlqimi me shkrim i porositësit nuk është element i domosdoshëm i kërkesës për rritjen e çmimit të punëve për të cilat kryesi i ka kryer me kërkesë të porositësit dhe me ato e ka tejkaluar projektin. Në këtë rast porositësi ka për detyrim të i paguaj punët shtese pa marrë parasysh se nuk ka pasur urdhër-porosi me shkrim për punët respektivisht aneks-kontratë dhe nuk ka pasur marrëveshje për çmimin e punëve<sup>48</sup>.

---

<sup>44</sup> Borislav T. Blagojevic, Komentar Zakona O Obligacionim Odnosima II, fq. 630, Savremena Administracija, 1980 Beograd.

<sup>45</sup> Po aty.

<sup>46</sup> Po aty.

<sup>47</sup> Borislav T. Blagojevic, Komentar Zakona O Obligacionim Odnosima I, fq. 220, Savremena Administracija, 1980 Beograd.

<sup>48</sup> Shih: Aktgjykimin e Gjykatës së Lartë Tregtare te Republikës së Kroacisë:70. Pz-6471/11-4; <https://sudskapraksa.vsrh.hr/home>

Me vet faktin se punët e kryera janë evidentuar në librin ndërtimor, se porositësi objektet ndërtimore i ka pranuar dhe i ka futur në funksion, se porositësi situatën finale nuk e ka korrigjuar, ashtu që gjatë procedurës nuk ka paraqit prova që kundërshtojnë vëllimin e punëve të kryera, krijohet obligimi për pagesën e punëve shtesë<sup>49</sup>.

### 11.2.3 Punimet urgjente të paparashikuara

Punimet urgjente të paparashikuara janë objekt i rregullimit të nenit 649 të LMD-së. Sipas Ligjit, punime të paparashikuara janë ato punë ndërmarrja e të cilave ka qenë e domosdoshme për shkak të stabilitetit të objektit apo për parandalimin e shkakimit të dëmit e që janë shkaktuar nga natyra e papritur e rëndë e tokës, me paraqitjen e papritur të ujit ose nga ndonjë ngjarje tjetër që është e jashtëzakonshme dhe e papritur.

Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve i Kosovës i ofron të drejtën kryerësit (parag. 1 i nenit 649 që t'i kryejë punimet e paparashikuara edhe pa pëlqimin paraprak të porositësit, kur në rastin konkret për shkak të urgjencës së tyre nuk ka pasur mundësi ta merr këtë pëlqim. Nëse paraqiten këto fenomene të lartpërmendura kryerësi ka për detyrë që pa vonesë ta njoftojë porositësin për këto fenomene. Kryerësit i takon e drejta për shpërblim të drejtë për punimet e paparashikueshme që është dashur të kryhen. Në këtë pikëpamje në mënyrë analoge mund të zbatohen dispozitat juridike për zgjidhjen e kontratës për shkak të ndryshimit të rrethanave. Kjo bëhet për arsye se punët e paparashikuara paraqesin rrethana të ndryshuara të cilat palët kontraktues nuk i kanë paraparë me rastin e lidhjes së kontratës për ndërtimin.

Porositësi mund të zgjidhë kontratën në qoftë se për shkaqe të këtyre punimeve, çmimi kontraktues do të duhej të shtohet konsiderueshëm për të cilën gjë ka për detyrë pa shtyrje – menjëherë ta njoftojë kryerësin e punimeve. Për çdo shmangie nga projekti i ndërtimit, përkatësisht nga punimet e kontraktuara, kryerësi duhet të ketë pëlqimin me shkrim të porositësit. Ai nuk mund të kërkojë ngritjen e çmimit të kontraktuar për punimet që i ka kryer pa pëlqimin e këtillë (neni 648 i LMD).

### 11.2.4 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit

Në praktikën gjyqësore aktuale vërehet tendenca e fokusimit të vlerësimit të gjykatave të shkallës së parë vetëm në faktin e ekzistimit apo mos-ekzistimit të aneks-kontratës ndërmjet palëve si kusht thelbësor dhe i vetëm për kompensimin e punëve shtesë.

Një qëndrim i tillë, ku merret për bazë vetëm forma me shkrim respektivisht aneks-kontrata nuk është në harmoni me qëllimin e ligjit dhe bie ndesh me doktrinën dhe praktikën juridike të vendeve me jurisprudencë të zhvilluar.

Kontrata e ndërtimit është kontratë shumë komplekse andaj pothuajse është e pamundur që të gjitha punët e nevojshme për përfundimin e projektit sipas standardeve të ndërtimit të parashikohen në projektin kryesor. Prandaj duke pasur parasysh këtë, te kontratat e ndërtimit çmimet e punimeve përcaktohen për njësi sepse vëllimi i sakte i punëve që duhet të kryhen pothuajse është i pamundur që të caktohen në fillim të projektit.

---

<sup>49</sup> Shih: Aktgjykimin e Gjykatës së Lartë Tregtare të Republikës së Kroacisë:70. Pz-340/12-3; <https://sudskapraksa.vsrh.hr/home>

Qëllimi i dispozitës së Nenit 645 par. 2 të LMD-së, është vendosja e rregullit dhe sigurisë në fushën e ndërtimit, e jo penalizimi i punë kryesve për shkak të formës. Kjo dispozitë krijon detyrime parësore për punëdhënësit që të gjitha dokumentet ndërtimore duke përfshirë edhe kontratën, t'i përpilojnë në formën me shkrim por kjo në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet si mundësi e punëdhënësit për lirim nga pagesa e punëve për të cilat nuk ka marrëveshje me shkrim apo të cilat nuk janë përfshirë në kontratë.

Prandaj gjatë vlerësimit të punëve të cilat nuk janë paraparë në kontratë duhet pasur kujdes të shtuar sepse këto punë mund të kenë natyra të ndryshme dhe kategorizohen në kategori të ndryshme për të cilat vlejnjë dispozita të veçanta.

Nëse punët e tilla hyjnë në kategorinë e “punëve urgjente të paparashikueshme” janë objekt i rregullimit të nenit 649 të LMD-së, dhe në këtë rast nuk ka asnjë kufizim sa i përket vëllimit të tyre. Punëdhënësi obligohet t'ia paguaj punë kryesit të gjitha punët e kryera të kësaj natyre, pavarësisht sa janë, me kusht që ta njoftojë porositesin.

Po ashtu, gjatë vlerësimit të punëve shtesë respektivisht largimit nga projekti, duhet vlerësuar me kujdes të veçante nëse këto punë janë “punë të ndryshuara në kuadër të projektit” apo përbëjnë “punë shtesë që tejkalojnë projektin.”

Në rastin e parë kur punët ndryshohen për shkak të ndryshimit të projektit nga ana e porositesit apo sipas udhëzimeve të mbikëqyrësit për shkak të ndryshimit të gjendjes në terren dhe vëllimi i punëve nuk tejkalon vlerën e përgjithshme të kompensimit të përcaktuar me kontratë, këto punë nuk konsiderohen punë shtesë por punë të kontraktuara dhe duhet të kompensohen pa asnjë kufizim.

Ndërsa në rastin e dytë kur vëllimi i punëve të kryera tejkalon shumën e kontraktuar, sipas Nenit 648 të LMD-së parashihet se *kryerësi duhet të ketë pëlqimin me shkrim të porositesit*. Në këtë rast diskutabile është se çka nënkupton pëlqimi me shkrim. A nënkupton kjo domosdoshmërisht lidhjen e Aneks-kontratës?

Në kohën e sotme të zhvillimit të teknologjisë dhe intensifikimit të raporteve afariste shumica e kontratave lidhen përmes komunikimit elektronik andaj gjatë interpretimit të kësaj kërkesë ligjore duhet dalur nga stereotipet e interpretimit të ngushtë respektivisht që pëlqimi domosdo duhet të jepet në formë të aneks-kontratës. Në këtë drejtim edhe dispozita e Neni 57 par 4. i LMD-së përcakton se, kërkesa për formë me shkrim përmbushet, në qoftë se palët këmbëjnë letra ose merren vesh me ndonjë mjet tjetër që bënë të mundur që me siguri të përcaktohet përmbajtja dhe personi, i cili e ka dhënë deklaratën apo pëlqimin. Andaj gjykatat gjatë vlerësimit të kësaj çështje duhet ta vërtetojnë nëse është dhënë pëlqimi në çfarëdo forme, e jo vetëm të fokusohen nëse ka apo jo aneks-kontratë.

Në praktikën gjyqësore<sup>50</sup> konsiderohet se është dhënë pëlqimi për punët shtesë, me vet faktin se punët e kryera janë evidentuar në librin ndërtimor, se porositesit objektet ndërtimore i ka pranuar dhe i ka futur në funksion dhe se porositesit situatën finale nuk e ka korrigjuar.

---

<sup>50</sup> Shih shpjegimin nga paragrafi 3 te faqes 3 të këtij punimi.

## 11.2.5 Referenca nga arsyetimet e vendimeve të Gjykatës së Apelit

### Aktgjykimi Ae.nr. 83/2015, dt. 18.03.2016

(i vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës E.Rev.nr.34/2016, dt.20.12.2016)

#### Arsyetimi

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelle thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale për shkak se, nga provat që gjenden në shkresat e lëndës nuk është kontestsuese se paditësi i ka kryer punët ndërtimore për të cilat është aprovuar shuma e kompensimit nga gjykata e shkallës së parë. Po ashtu, nuk është kontestsuese se të tri të paditurat kanë qenë të përfshira në raport kontraktues me paditësen dhe së të tri të paditurat në forma të ndryshme kanë qenë përfituese nga punët e kryera nga paditësja. Edhe pse e paditura e tretë pretendon se nuk ka pasuar kontratë të lidhur me paditësen andaj edhe nuk ka obligim ndaj saj, kjo gjykatë vlerëson se raporti detyrimor ndërmjet tyre është krijuar pasi që e paditura e tretë ka qenë mbikëqyrëse e punëve, ka përfitur shumën e tërë projektit nga Unioni Evropian respektivisht ka përfitur nga punët e kryera nga paditësi, sipas konstatimeve të ekspertit financiar ka kryer pjesën më të madhe të pagesave ndaj paditëses për punët e kryera ndërtimore edhe pse me te nuk ka lidhur kontratë, dhe ajo ia ka shkëputur kontratën e ndërtimit paditëses andaj kjo përbën tregues se qartë se e paditura me vetëdije të plotë dhe për interesa të saj ka hyrë në raport afarist me paditësen. Po ashtu e paditura e tretë ka nënshkruar kontratën për Cesionin të datës 28.10.2011, dhe është pajtuar që në emër të pagesës të punëve të kryera deri në atë moment, t'ia paguaj paditëses shumën prej 257,273.98€. Ndërsa me kontratën mbi cesionin të datës 12.08.2011, me të cilën e paditura e dytë, si kreditore e të paditurës së tretë, ka bartur të drejtën e kërkesës për punët e kryera ndaj të paditurës së tretë. Të gjitha faktet në mënyrë të pamohueshme vërtetojnë raportin afarist të paditurave dhe të paditurës.

Sipas nenit 630 të LMD-së, parashihet se kontrata për ndërtim duhet të bëhet në formë të shkruar ndërsa në rastin konkret ekziston kontrata e ndërtimit në bazë të së cilës paditësja i kryer punët ndërtimore, kontrata e datës 29.03.2011 e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës së parë. Gjykata vlerëson se Neni 630 i LMD-së nuk mund të interpretohen në kuptimin e ngushtë, ashtu që vetëm mungesa e formës së kontratës me njëjërën palë të përfshirë në raportin kontraktues, të jetë bazë e mjaftueshme për mohimin e pagesës së punëve të realizuara nga punë kryerësi. Te kontrata e ndërtimit si edhe te çdo kontratë tjetër veprimet e palëve kontraktuese duhet vlerësuar në bazë të qëllimit të tyre për lidhjen e kontratës andaj duke pasur parasysh se paditësja i kryer punët ndërtimore sipas kontratës së lidhur të ndërtimit si dhe kërkesave dhe në marrëveshje me të paditurat, është krijuar detyrimi i të paditurave për kompensimin e punëve të kryera, pasi që kryerja e punëve është bërë me qëllim të realizimit të projektit i cili ka qenë edhe qëllim i të paditurave dhe në

*interes të tyre. Neni 15 i LMD-së kërkon ekuivalencë të prestimeve të kontratat e dyanshme detyruese. Nëse paditësi nuk do të kompensohet për punët e kryera, vetëm për shkak të mungesës së një kontrate formale me të paditurën e tretë, nuk do t'i lironte të paditurat plotësisht nga detyrimi i kompensimit por do të krijonte detyrimin për kompensimin e vlerës së përfituar për shkak të fitimit të pabazuar, të parapare me Neni 210 të LMD-së.*

*Për më tepër, në kuptim të Nenit 73 të LMD-së, kontrata për të cilën kërkohet forma shkresore quhet e plotfuqishme megjithëse nuk është lidhur në atë formë, në qoftë se palët kontraktuese i kanë zbatuar në tërësi apo në pjesën pre dominuese detyrimet që dalin nga ajo, ndërsa sipas Nenit 71 të LMD-së edhe marrëveshjet verbale mbi pikat sekondare kontraktuese konsiderohen të vlefshme nëse janë në përputhje me përmbajtjen e kontratës kryesore. Në rastin konkret paditësi i ka kryer punët në përputhje të plotë me përmbajtjen e kontratës kryesore dhe me qëllimin për të cilin është lidhur ajo, ndërsa çështja e kompensimit është përcaktuar sipas marrëveshjeve verbale ndërmjet palëve dhe me kontratat e cesionit ku ka qenë e përfshirë e paditura e dytë dhe e paditura e tretë ndërsa vlefshmëria apo jo e kontratës së cesionit nuk ia mohon paditëses të drejtën e kompensimit por përcakton detyrimet e ndërsjella ndërmjet të paditurave.*

*Bazuar në të lartcekurat kjo gjykatë ka gjetur se, të paditurat me veprime të ndryshme [.....] i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm paditësit si në formë të fitimit të humbur ashtu edhe për shkak të vonesës së pagesave andaj kjo gjykatë duke u bazuar në dispozitat e Nenit 206 dhe 207 të LMD-së (1978), vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur ka vendosur që të detyrohen të paditurat solidarisht t'i përmbushin detyrimin paditëses. Ky qëndrim bazohet edhe në Neni 397 të LMD (Ligji Rr.04/L-077) i cili përcakton se kur ka disa debitorë në ndonjë detyrim të pjesëtueshëm të krijuar me kontratë në ekonomi ata i përgjigjen solidarisht kreditorit, përveç nëse kontraktuesit e kanë eliminuar shprehimisht përgjegjësinë solidare. Kjo dispozitë paraqet një mjet sigurie për realizimin e kërkesës të kontratat në ekonomi për shkak të natyrës dhe karakterit të këtyre kontratave. Te solidariteti pasiv të paraparë me këtë dispozitë kreditori mund të kërkojë pagimin e borxhit në tërësi nga çdo debitor. Ai e zgjedh debitorin dhe mund t'i drejtohet secilit prej tyre apo të gjithëve për pagesën e tërë borxhit në mënyrë solidare. Në rastin konkret vet debitorët kanë kontribuar për pamundësimin e përcaktimit të borxhit të saktë për secilin prej tyre, ndërsa të gjithë kanë qenë të përfshirë në raportin kontraktues andaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë i ka obliguar të paditurat që solidarisht t'ia paguajnë borxhin paditëses. Poashtu gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitën e Nenit 382 të LMD-së, kur ka aprovuar kamatën për vonesë sipas normës vjetore prej 8%.*

**Aktvendimi Ae.nr. 42/2016, datë 09.06.2017**

### **Arsyetimi**

*Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit lidhur me pretendimin e palës paditëse që t'i paguaj pala e paditur e shumën e përgjithshme prej 936.700,39 euro në emër të borxhit kryesor, me kamatë ligjore, [.....]*

*Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi me datë 21.09.2012 ka paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë lidhur me pagesën e borxhit, me të cilën padi ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura, Republika e Kosovës, Ministria e Administratës Publike,*

*që paditësit në emër të kthimit të borxhit nga mospagimi i punëve të kryera, t'ia kompensoj shumën në lartësi [.....]*

*Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave, bazuar në dispozitën e nenit 633 të LMD-së, ka marr aktgjykim me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se pala paditëse nuk i ka ofruar prova me të cilën do të vërtetohej se palët ndërgjygjëse kanë arritur pëlqimin paraprak për kryerjen e punëve shtesë e as që kanë lidhur ndonjë aneks kontratë për kryerjen e këtyre punimeve.*

[.....]

*Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes Gjykata e Apelit e Kosovës, i ka vlerësuar si të bazuara thëniet ankimore të së paditësit, nga se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e parashikuar nga neni 182 par.1 dhe 182.2 pika pika n) të LPK-së, për të cilin shkak duhet të priset. Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore qëndron në faktin se arsyetimi i aktgjykimit të atakuar nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare për marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm, ndërsa arsyet e dhëna janë të paqarta, kurse lidhur me faktet vendimtare eksitojnë kundërthënie midis asaj që thuhet në arsyet e aktgjykimit dhe përmbajtës së provave që gjendjen në shkrësat e lëndës.*

*Gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe aktgjykimin e atakuar e ka marrë me shkelje të nenit 8 të LPK-së, për arsye se nuk i ka vlerësuar me kujdes të veçantë secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, por në mënyrë të njëanshme duke ia falur besimin me tepër deklarimeve të palës së paditur se sa provave materiale ka ardhur deri të konstatimet e dhëna në arsyetimin e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar. Edhe pse paditësi i ka prezantuar gjykatës prova lidhur me pretendimet e tij për ekzistimin e borxhit, gjykata e shkallës së parë nuk i ka qartësuar këto prova respektivisht nuk ka nxjerrë prova tjera të cilat kanë mundur që ta vërtetojnë në mënyrë të plotë gjendjen faktike lidhur me borxhin e pretenduar.*

*Ne rastin konkret nuk ishte kontestuese fakti se në mes të palëve ka ekzistuar raporti kontraktues në bazë të kontratës me numër 82/2008 të datës 03.10.2008, për renovimin gjeneral të Pallatit XXXX në vlerë të përgjithshme prej 14,694,453.67 €, në bazë të së cilës paditësi i ka kryer punët ndërtimore. Pas përfundimit të punimeve e paditura ka refuzuar pranimin e tërë punëve të evidentuar në librat e punës pasi një pjesë të punëve i ka kontestuar. Si pasojë paditësi ka parashtruar padi me të cilën ka kërkuar kompensimin e tërë punëve të kryera me pretendim se punët janë kryer konform kontratës dhe se ato punë kane qenë të domosdoshme për shkak se gjendja reale e objektit në të cilin janë kryer punimet ka qenë shumë më e keqe se ajo e paraqitur në teren.*

*Gjykata e shkallës së parë ka anashkaluar në tërësi rrethanat vendimtare për të vendosur në këtë çështje juridike. Edhe pse në rastin konkret lidhur me punët kontestuese nuk ka pasur aneks-kontratë megjithatë gjykata e shkallës së parë është dashur ta konstatojë nëse punët e kryera, të konstatuara me ekspertizë, kanë qenë punë shtesë apo punë të paparashikueshme. Po ashtu gjykata e shkallës së parë është dashur të konstatojë nëse këto punë kanë qenë punë jashtë kontratës apo punë të ndryshuara në kuadër të kontratës, dhe në rast se është tejkualuar kontrata është dashur të vërtetohet sa është ky tejkalim respektivisht a e ka tejkualuar 10% të shumës së kontraktuar. Kjo nga shkakun se nga*



*pretendimet nga referati i padisë rrjedh se për punët për të cilat kërkohet kompensimi kanë pasur natyra të ndryshme respektivisht në disa pozicione me sugjerimin e organit mbikëqyrës janë ndryshuar materialet e përdorura respektivisht janë duplikuar materialet dhe punët, pastaj nga e paditura janë ndryshuar pozicionet e punëve, është dashur të kryhen punë të paparashikuara pasi objekti ka qenë në gjendje tjetër nga ajo e paraqitur në Ofertë ashtu që ka qenë e domosdoshme shtrimi i më shumë shtresave, etj.*

*Varësisht pre llojit të punëve, domosdoshmërisë së kryerjes së tyre dhe kategorisë në të cilën këto punë kategorizohen, zbatohen dispozita të veçanta të së drejtës materiale dhe procedurale pasi krijohen raporte të ndryshme detyimore, andaj gjykata e shkallës së parë ka qenë e obliguar që t'a vërtetojë në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe mbi këtë gjendje faktike të zbatojë dispozitat përkatëse të së drejtës materiale.*

*Në rastin konkret, me nënshkrimin e kontratës bazë, palët ndërëgjyqëse kanë pranuar kushtet e përgjithshme nga kontrata e cila ka qenë bazë për kryerjen e punimeve. Për të gjitha ndryshimet që ndodhin gjatë ndërtimit, kontraktuesi është i obliguar të njoftojë kontraktuesin tjetër për faktet të cilat janë paraqitur, siç janë punimet shtesë. Të gjitha informatat duhet të jenë në formë të shkruar. Sipas nenit 633 të LMD-së, parashikohet që për çdo ndryshim për punët e kontraktuara, kryesi i tyre duhet të ketë pëlqim me shkrim nga porositësi i punimeve, në këtë rast paditësi. Paditësi si kryes i punimeve është organizatë speciale për kontraktimin e punimeve ndërtimore dhe si të tillë qenë dashur të dijë, se pa pëlqim me shkrim nuk mund të kryhet asnjë punë e cila nuk është paraparë me kontratë. Aq më tepër që në rastin konkret kemi kontratë publike për të cilën zbatohet Ligji i Prokurimit Publik, i cili në dispozitën e Nenit 35 pika 2.4, në asnjë rast nuk lejon tejkalimin më shumë se 10% të shumës së kontraktuar dhe me kusht që të përmbushën të gjitha kriteret dhe procedurat e përcaktuara me këtë ligj, lidhur me punët shtesë të cilat paraqitën apo kryhen gjatë ndërtimit.*

*Nga provat e administruara gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar nëse e paditura ka porositur punë shtesë apo nëse ka përpiluar ndonjë dokumentacion teknik, dhe nëse janë respektuar procedurat ligjore për të vlerësuar nëse ndërmjet palëve është krijuar detyrimi respektivisht nëse e paditura e ka dhënë pëlqimin për punë shtesë, me të cilën do të ishin krijuar të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese. Sipas dispozitës së nenit 630 të LMD-së taksativisht parashikohet se kontrata për ndërtim duhet patjetër të bëhet në formë të shkruar, dhe e njëjta formë vjen edhe për ndryshimet e mëvonshme. Pra, nëse në rastin konkret janë kryer punë shtesë, paditësja nuk është dashur të ndërmarrë veprime pa urdhëresën me shkrim, përkatësisht pa pëlqimin paraprak të porositësit –autoritetit kontraktues, në të kundërtën për kryerjen e këtyre punimeve nga paditësja kanë për pasojë kryerjen e punimeve të pa kontraktuara të cilat nuk kanë efekt të vlefshëm juridik dhe nuk gëzojnë mbrojtje juridiko gjyqësore, respektivisht nuk ka bazë juridike të vlefshme për realizimin e shpërblimit të këtyre punimeve.*

*Përkundër të sipër cekurave lidhur me punët shtesë, megjithatë ndryshon situata nëse punët e kryera nga paditësi janë kryer me pëlqimin e paditësit dhe janë brenda kornizës prej 10% të shumës së kontraktuar, apo nëse këto punë janë punë të ndryshuara brenda kontratës, apo punë të paparashikueshme për të cilat nuk vlejnjë kufizimet ligjore të përcaktuara për punët shtesë.*

*Sipas neneve 15 dhe 17 të LMD-së, palët kontraktuese në marrëdhënie kontraktuese janë të obliguara t'i kryejnë obligimet e ndërsjella dhe janë përgjegjës lidhur me përmbushjen e tyre dhe se te kontratat dypalëshe pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke.*

*Edhe pse sipas nenit 630 të LMD-së, parashihet se kontrata për ndërtim duhet të bëhet në formë të shkruar ndërsa sipas nenit 633 të LMD-së, parashikohet që për çdo ndryshim për punët e kontraktuara, kryesi i tyre duhet të ketë pëlqim me shkrim nga porositësi i punimeve, dhe se ai nuk mund të kërkojë ngritjen e shpërblimit të kontraktuar për punimet që i ka kryer pa pëlqimin e këtillë, megjithatë gjykata duke iu referuar Nenit 634 par 4 të LMD-së, gjen se paditësi i takon e drejta e shpërblimit nëse paditësi konform paragrafit 3 të të njëjtit nen (nenit 634) e ka njoftuar me kohë të paditurën për ndryshimet e punëve respektivisht punët shtesë të paparashikuara duke i evidentuar në Ditarin e punës dhe Librin e Ndërtimit, e të cilat janë vërtetuar dhe nënshkruar nga Menaxheri i Projektit, si organ mbikëqyrës i të paditurës. Ky qëndrim mbështetet nga dispozita e Nenit 8 të Kontratës së lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse, në të cilën në Pikën 8.3 përcaktohet qartë obligimi i Menaxherit të Projektit që në bashkëpunim me autoritetin kontraktues të korrigjojnë dhe kompensojnë situatën. I vetmi detyrim i kontraktuesit në këtë rast, sipas Nenit 8.1 të kontratës, është njoftimi i Menaxherit të Projektit. Ndërsa sa i përket punëve urgjente dhe të paparapara me dispozitën e Nenit 8.4 të kontratës përcaktohet detyrimi i kontraktuesit që menjëherë të ndërmarrë masat për ekzekutimin e atyre punëve edhe pa pëlqimin me shkrim të punëdhënësit dhe ta informojë menaxherin e projektit. Nga Neni 21.1 i Kontratës rrjedh se person i autorizuar për aprovim të ndryshimit të punëve dhe rritjes së çmimit deri në 10%, mbi çmimin e kontraktuar është Menaxheri i projektit, ndërsa vetëm për tejkalimin e çmimit mbi 10% kërkohet lidhja e aneks-kontratës.*

*Kjo gjykatë vlerëson se Nenet 630 dhe 633 të LMD-së nuk mund të interpretohet në kuptimin e ngushtë, ashtu që vetëm mungesa e formës së kontratës apo tejkalimi i çmimit të kontraktuar të jetë bazë e mjaftueshme për mohimin e pagesës së punëve të realizuara nga punëkryerësi, sepse vetë natyra e punëve ndërtimore është mjaft komplekse dhe asnjëherë në mënyrë të saktë nuk mund të përcaktohet çmimi përfundimtar i punëve, andaj duke pasur parasysh kompleksitetin e punëve ndërtimore me Nenin 634 të LMD-së janë paraparë edhe punët e paparashikuara. Ky qëndrim mbështetet edhe në vet kontratën e lidhur ndërmjet palëve si dhe në Nenin 35 pika 2.4 (ii) të Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës (Ligji 2011/04-L-042), të cilat parashohin mundësinë e ndërrimit të çmimit përfundimtar nga ai fillestar në lartësi prej 10%.*

*Për më tepër, në kuptim të Nenit 73 të LMD-së, kontrata për të cilën kërkohet forma shkresore quhet e plotfuqishme megjithëse nuk është lidhur në atë formë, në qoftë se palët kontraktuese i kanë zbatuar në tërësi apo në pjesën pre dominuese detyrimet që dalin nga ajo, ndërsa sipas Nenit 71 të LMD-së edhe marrëveshjet verbale mbi pikat sekondare konsiderohen të vlefshme nëse janë në përputhje me përmbajtjen e kontratës kryesore. Në rastin konkret duhet të vërtetohet nëse paditësi i ka kryer punët sekondare në përputhje të plotë me përmbajtjen e kontratës kryesore dhe me qëllimin për të cilin është lidhur ajo, dhe nëse punët janë kryer në marrëveshje respektivisht sipas instruksioneve të Menaxherit të projektit, i cili ka qenë i autorizuar nga e paditura, për marrjen e vendimeve për ndryshimin e punëve. Në rastin konkret nëse vërtetohet se janë plotësuar kushtet ligjore të sipër cekura me kryerjen e punëve dhe me pranimin e tyre nga e paditura, bëhet*

*konvalidimi i kontratës joformale në kontratë të vlefshme juridike e cila krijon detyrime brenda kornizave ligjore.*

*Te kontrata e ndërtimit si edhe te çdo kontratë tjetër veprimet e palëve kontraktuese duhet vlerësuar në bazë të qëllimit të tyre për lidhjen e kontratës andaj duke pasur parasysh se paditësi nuk e ka kryer secilën punë të pjesëshme si qëllim në vete, por ato i ka kryer me qëllim të realizimit të projektit kryesor, ndryshimet e punëve dhe tejkalimi i punëve është bërë me qëllim të realizimit të projektit i cili ka qenë edhe qëllim i të paditurës dhe në interes të saj. Zmadhimi apo zvogëlimi i çmimit të kontraktuar në përputhje me vëllimin e punëve të kryera ndërtimore e ka bazën në Nenin 15 të LMD-së, i cili kërkon ekuivalencë të prestimeve të kontratat e dyanshme detyruese. Sipas neneve 15 dhe 17 të LMD-së, palët kontraktuese në marrëdhënie kontraktuese janë të obliguara t'i kryejnë obligimet e ndërsjella dhe janë përgjegjës lidhur me përmbushjen e tyre dhe se te kontratat dypalëshe pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke. Nëse çmimi i kontraktuar do të mbetet i njëjtë përkundër punëve shtesë të kryera, vetëm për shkak të mungesës së një aneks-kontrate formale, nuk do ta lironte të paditurën plotësisht nga detyrimi i kompensimit por do të krijonte detyrimin për kompensimin e vlerës së përfituar për shkak të fitimit të pabazuar, të paraparë me Nenin 210 të LMD-së, ndërsa sipas Nenit 153.2 të LPK-së gjykata nuk është e lidhur me bazën juridike të kërkesë-padisë.*

*Bazuar në të lartcekurat, Gjykata e Apelit ka gjetur se refuzimi i kërkesëpadisë së paditësit nga gjykata e shkallës së parë është bërë pa e vërtetuar nëse punët e kryera kanë qenë punë shtesë apo punë të pa-parashikueshme, nëse këto punë kanë qenë punë jashtë kontratës apo punë të ndryshuara në kuadër të kontratës dhe nëse është tejkalluar kontrata mbi 10% të shumës së kontraktuar, përbën vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike çka ka rezultuar edhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.*

### **11.3 MBROJTJA GJYQËSORE E MARKAVE TREGTARE**

Përdorimi i paautorizuar i një marke tregtare, si e drejtë ekskluzive e pronarit të saj sipas Nenit 8 të LMT-së, përbën shkelje të markës tregtare. Shkelja mund të kryhet ndaj markës së regjistruar por edhe gjatë procedurës së regjistrimit nëse regjistrimi rezulton i suksesshëm.

Me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-026 PËR MARKAT TREGTARE, përcaktohen të drejtat që rrjedhin nga markat tregtare, shkeljet e markës tregtare dhe mbrojtja juridike e tyre. Në këtë drejtim dispozitat e LMT-së parashohin:

*Neni 8*

*Të drejtat e fituara nga marka tregtare*

- 1. Marka e regjistruar është e drejtë ekskluzive e pronarit të saj. Pronari i markës tregtare të regjistruar ka të drejtën të ndalojë palët e treta të përdorin pa lejen e tij:
  - 1.1. çdo shenjë, që është identike me markën tregtare, për mallra ose shërbime që janë identike me ato për të cilat është regjistruar marka tregtare;*
  - 1.2. çdo shenjë që është identike ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëjlojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të**

*shkaktojnë konfuzion te publiku, ku përfshihet edhe mundësia e asociimit të shenjës me markën tregtare;*

- 1.3. *çdo shenjë, që është identike apo e ngjashme me markën tregtare për produktet dhe shërbime të ndryshme nga ato për të cilat është regjistruar marka tregtare, kur kjo e fundit ka reputacion në Republikën e Kosovës dhe nga përdorimi i shenjës, pa shkak të arsyeshëm, realizohet një përfitim i padrejtë ose dëmtohet natyra dalluese apo emri i njohur i markës.*
2. *Sipas paragrafit 1. të këtij neni pronari i markës gjithashtu mund të ndalojë këto veprime:*
  - 2.1. *vendosja e shenjës në mallra apo në paketimet e tyre;*
  - 2.2. *hedhja e mallrave në treg, ofrimi i tyre për shitje dhe ofrimi i shërbimeve duke përdorur këtë shenjë, ose magazinimi i tyre për këto qëllime;*
  - 2.3. *përdorimi i shenjës gjatë importimit apo eksportimit të mallrave;*
  - 2.4. *përdorimi i shenjës në shkresa zyrtare dhe në reklamim.*
3. *Të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi i markës kanë efekt mbi palët e treta që nga data e publikimit të regjistrimit të markës tregtare. Mund të kërkohet kompensim për shkeljen e markës që ndodhin pas datës së publikimit të aplikimit të markës tregtare, shkeljet te cilat pas publikimit të regjistrimit të markës tregtare duhet të ndalohen. Gjykata që ka në shqyrtim çështjen nuk mund të vendosë për këtë çështje derisa të publikohet regjistrimi.*

#### *Neni 101*

#### *Masat e përkohshme në rastet e shkeljes së markës tregtare*

1. *Me kërkesën e pronarit të markës tregtare i cili dëshmon se marka tregtare është shkelur apo tentohet të shkelet, gjykata mund të urdhërojë çfarëdo mase të përkohshme që përfshijn ndalimin apo parandalimin e shkeljes dhe në veçanti:*
  - 1.1. *të urdhërojë shkelësin e supozuar që t'i ndalojë dhe t'i ndërpresë veprimet që shkelin markën tregtare; gjykata po ashtu mund të lëshojë një urdhër ndalimi kundër ndërmjetësuesit shërbimet e të cilit i përdorin personat e tretë që shkelin markën tregtare.*
  - 1.2. *të urdhërojë konfiskimin apo largimin nga tregu të produkteve që pa të drejtë emërtohen si marka tregtare.*
2. *Me kërkesën e pronarit të markës i cili dëshmon se marka e tij është shkelur në veprimtari afariste me qëllim të sigurimit të përfitimit material dhe shkelja ka tentuar që t'i shkaktojë atij dëm të riparueshëm ose vështirë të riparueshëm, gjykata përveç masave të përkohshme të përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, mund të urdhërojë konfiskimin e pasurisë së tundshme dhe të patundshme të palës kundërshtuese, e cila nuk është drejtpërdrejt e lidhur me shkeljen, duke përfshirë edhe ngrirjen e llogarive të tij bankare.*
3. *Me qëllim të caktimit dhe ekzekutimit të masës së përkohshme sipas paragrafit 2. të këtij neni, gjykata kërkon nga pala kundërshtare ose personat e tjerë përkatës, paraqitjen e informacioneve bankare, financiare dhe informacioneve të tjera ekonomike, ose vënien në disponim të informacioneve dhe dokumenteve të tjerë në lidhje me to. Gjykata siguron mbrojtjen e konfidencialitetit të informacioneve të tilla dhe e ndalon shpërdorimin e tyre.*
4. *Në qoftë se një masë e përkohshme është urdhëruar pa e njoftuar palën kundërshtare, gjykata do të komunikojë vendimin për masën e përkohshme për palën kundërshtare, menjëherë pas zbatimit të tij.*

5. Në vendimin për masën e përkohshme, gjykata cakton kohëzgjatjen e masës së tillë dhe nëse është urdhëruar ndonjë masë para fillimit të procedurës, periudhën brenda së cilës paraqitësi i kërkesës për masën inicicion procedurë për të arsyetuar masën, në afat prej njëzet (20) ditë pune dhe jo më e gjatë se tridhjetenjë (31) ditë kalendarike, nga data e shqiptimit të masës së përkohshme.

Neni 102

Masat e përkohshme për ruajtjen e dëshmisë

1. Sipas kërkesës së pronarit të markës i cili pohon se i është shkelur e drejta ose ekziston rreziku të shkelet dhe ekziston mundësia që dëshmia e shkeljes ose rrezikut në fjalë nuk mund të merret ose bëhet e vështirë të merret, gjykata urdhëron marrjen e masës së përkohshme për ruajtjen e dëshmisë.
2. Me masën e përkohshme të cekur në paragrafin 1. të këtij neni, gjykata mund të urdhërojë:
  - 2.1. përgatitjen e një përkohshëm të hollësishëm të produkteve që rrezikojnë të shkelin një markë tregtare, me apo pa marrjen e mostrave;
  - 2.2. konfiskimin e mallrave që vërtetohet se ka shkelur një markë tregtare;
  - 2.3. konfiskimin e materialeve dhe mjeteve të përdorura në prodhimin dhe shpërndarjen e mallrave të cilat shkelin të drejtat e një markë tregtare dhe dokumentacionin lidhur me to.
3. Masa e përkohshme e cekur në këtë nen mund të urdhërohet edhe pa informuar palën tjetër, nëse kërkuesi i masave të përkohshme tregon qartë që ekziston rreziku që të dëmtohen dëshmitë apo do të ndodhë dëm i riparueshëm. Nëse urdhërohet një masë e përkohshme pa informuar palën tjetër, gjykata ia komunikon palës tjetër vendimin mbi masën e përkohshme menjëherë pasi që të zbatohet.

### **11.3.1 Komentim i shkurtër i dispozitave ligjore për mbrojtjen e markave tregtare në rast të shkeljes së tyre dhe kriteret e vlerësimit**

Markat Tregtare janë kategori e rëndësishme nga të Drejtat e Pronësisë Intelektuale (DPI) që luajnë rol të rëndësishëm në ekonominë e tregut, pasi që ndërmarrjet gjatë zhvillimit të afarizmit të tyre përdorin Markat Tregtare me qëllim të dallimit të produkteve dhe shërbimeve të tyre nga produktet dhe shërbimet e të tjerëve, si dhe për mbrojtjen e produkteve të tyre.

Edhe pse mbrojtja e markave tregtare garantohet si me Ligjin për Markat Tregtare ashtu edhe me Kodin Penal, si dhe me masa tjera administrative duke përfshirë edhe ato doganore, megjithatë në praktikën juridike hasen vështirësi të shumta në zbatimin e dispozitave ligjore. Këto vështirësi paraqiten si pasojë e paqartësive të ligjit, moskordinimit të organeve shtetërore që e mbulojnë këtë sferë, si dhe mungesës së përvojës së akterëve të kyçur në këtë aktivitet.

Poashtu, në praktikën juridike paraqiten konteste me elemente ndërkombëtare, që shfaqin nevojën e analizimit të përputhshmërisë së legjislacionit të brendshëm me rregullat ndërkombëtare, për t'u siguruar se gjatë zbatimit të dispozitave, interpretimi i tyre të jetë në përputhje me praktikën ndërkombëtare.

### 11.3.2 Karakteristikat Themelore të Markave Tregtare

Për t'i kuptuar dhe zbatuar drejtë dispozitat e LMT-së duhet pasur parasysh karakteristikat themelore të Markave tregtare dhe natyrën juridike të tyre.

Marka tregtare është e drejtë pronësore ekskluzive përmes së cilës mbrohet shenja me të cilën pronari i markës tregtare identifikon mallrat apo shërbimet e tij në qarkullimin tregtar, me qëllim të dallueshmërisë nga mallrat apo shërbimet e subjekteve tjera.

Në qarkullimin tregtar Marka tregtare barazohet me shenjë dalluese por në thelb marka tregtare është e drejtë pronësore e cila titullarit të së drejtës i jep të gjitha të drejtat që i gëzon edhe pronari i pronës së paluajtshme. Prandaj Marka tregtare në thelb nuk përbën shenjë dalluese, emër tregtar apo markë të produktit por në fakt Marka Tregtare përbën të drejtë subjektive të titullarit të saj.

Bartësi i së drejtës së Markës Tregtare ka të drejtën që t'i ndalojë të tjerët për përdorimin jo vetëm të markës së tij por edhe të markës së ngjashme e cila mund të shkaktojë konfuzion në lidhje me origjinën e mallit, mund ta licencojë, ta jap për shfrytëzim dhe të përfitojë nga kjo, ta bartë të drejtën e tij në persona tjerë, ta lë peng, të jetë objekt i ekzekutimit apo të përfshihet në procedurën e falimentimit. Pra Marka tregtare përbën pasuri të vlefshme për titullarin e saj dhe gëzon të gjitha të drejtat që i gëzon çdo pasuri tjetër.

Të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat janë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Me regjistrimin e një marke të caktuar me ZPI, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare.

Pra e drejta nga marka tregtare krijohet në momentin e regjistrimit respektivisht në momentin e lëshimit të vendimit nga ZPI dhe regjistrimit të saj në Buletinin Zyrtar. Efektet e markës tregtare llogariten nga data e paraqitjes së aplikimit për regjistrim, por ndaj palëve të treta krijon efekt vetëm nga data kur regjistrimi i asaj marke është publikuar në Buletinin Zyrtar të ZPI-së (Neni 8, paragrafi 3 i LMT).

Bartësi i markës së regjistruar tregtare gëzon një numër të drejtash me rastin e marrjes së vendimit për regjistrim të markës tregtare me ZPI. Kështu, sipas LMT, bartësi i markës së regjistruar tregtare ka të drejta të:

- *Ndalojë përdorimin e paautorizuar të markës së tij tregtare përmes mjeteve juridike në dispozicion (Nenet 8 – 13 i LMT)<sup>51</sup>;*
- *Të përdorë markën e regjistruar në tregun e Kosovës (Neni 14 i LMT), si dhe*
- *Të disponojë me markën e tij tregtare (Neni 15 – 22 i LMT).*

---

<sup>51</sup> Kjo e drejtë e përcaktuar me LMT rrjedh edhe nga Neni 16 pika I e Marrëveshjes TRIPS i cili përcakton se: Pronari i një marke tregtare do ta ketë të drejtën ekskluzive për të parandaluar të gjitha palët e treta të cilat nuk e kanë pëlqimin e pronarit, që të përdorin në treg, shenja identike ose të ngjashme për mallrat ose shërbimet të cilat janë identike ose të ngjashme me ato për të cilat marka tregtare është regjistruar, ku përdorimi i tillë do të mund të shkaktojë konfuzion. Në rast të përdorimit të një shenje identike për mallra ose shërbime identike, mundësia për konfuzion prezumohet. Të drejtat e përshkuara më sipër nuk do të paragjykojnë (ndikojnë) në të drejtat ekzistuese të mëparshme, as që do të ndikojë në mundësinë e anëtarëve për të bërë të drejtat e disponueshme në bazë të përdorimit.

### 11.3.3 Shkelja e Markave Tregtare dhe Kriteret e Vlerësimit

*LMT parashikon që parimet dhe kriteret e përgjithshme mbi të cilat bazohemi gjatë vlerësimit të ngjashmërisë së shenjave, janë:*

- *Parimi i parë i unitetit (specialitetit) të markës tregtare – Funkzioni identifikues/dallueshmërisë (shih Kapitulli I pikën 2.1.1 pika a) LMT*
- *Mundësia e dytë - e konfuzionit në treg,*
- *Njohuritë e publikut përkatës.*

### 11.3.4 Mundësia e shkaktimit të konfuzionit

Elementet bazë për vlerësimin e ngjashmërisë së shenjave është mundësia e krijimit të konfuzionit tek konsumatorët. Konfuzioni mund të shkaktohet duke përdorur shenjën që është identike ose e ngjashme me markën e regjistruar e një personi tjetër, por vetëm me kusht që kjo shenjë të përdoret për llojet e njëjta ose të ngjashme të mallrave ose shërbimeve.

Konfuzion mund të shkaktojë shenja e cila në kushte të rëndomta të tregut, tek konsumatorët krijojnë bindjen se është fjala për mallra apo shërbime të njëjta. Sipas Nenit 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2, i LMT-së, pronari i një marke të regjistruar nuk ka nevojë ta vërtetojë konfuzionin që faktikisht është krijuar nga përdorimi i markës identike ose të ngjashme, por vetëm mundësinë e krijimit të një konfuzioni tek konsumatorët.

Një qëndrim të njëjtë e përmban dhe Rregullorja e Këshillit të Bashkimit Evropian nr. 40/94, e vitit 1993 - për Markat Tregtare Komunitare, sipas të cilës "Për ekzistimin e ngjashmërisë nuk është e nevojshme që konfuzioni të krijohet por është e mjaftueshme ekzistimi i mundësisë së shkaktimit të konfuzionit tek konsumatorët".

Llojet e konfuzionit: Varësisht prej ndikimit në krijimin e bindjes tek konsumatorët, ekzistojnë dy mundësi të shkaktimit të konfuzionit;

Mundësia direkte për konfuzion shkaktohet kur konsumatorët ngatërrojnë markat tregtare respektivisht kur gabimisht besojnë se malli apo shërbimi është produkt i një subjekti i cili është titullar i një marke tregtare, e jo i subjektit i cili atë mall e ka vënë në qarkullim.

Mundësia e tërthortë për konfuzion ndodh kur konsumatori gabimisht beson se ndërmjet subjektit që është titullar i asaj marke tregtare dhe subjektit që e ka vënë në qarkullim produktin përkatës ekziston lidhja ekonomike apo organizative, p.sh. ekskluziviteti (frenchise) apo kontratë mbi licensën.

### 11.3.5 Vlerësimi i mundësisë për konfuzion

Gjatë vlerësimit të ngjashmërisë së markave ashtu edhe ngjashmërisë së produkteve apo shërbimeve aplikohet i ashtuquajti "test i mundësisë së krijimit të konfuzionit".

Nga praktika e GJED-it, rrjedh se gjatë vlerësimit të ngjashmërisë së mallrave dhe shërbimeve gjykatat duhet të marrin parasysh këta faktorë:

- Natyrën e mallrave dhe të shërbimeve;
- Perceptimin e konsumatorit mesatar;

- Faktin nëse këto dy ndërmarrje janë në konkurrencë me njëra tjetrën apo janë ekonomikisht të ndërlidhura.

Ndërsa, gjatë vlerësimit të shkallës së ngjashmërisë në mes të markave, gjykatat duhet t'i marrin parasysh këta faktorë:

**a) Shkallën e ngjashmërisë vizuale/pamore:**

- Në rast të dy markave në fjalë, duhet vlerësuar numri dhe radhitja e shkronjave, numri i fjalëve, struktura e shenjave;
- Në rast të markës në fjalë kundrejt një marke figurative, atëherë analizohet numri i shkronjave apo fjalëve të përbashkëta.
- Në rast të dy markave figurative, atëherë shqyrtohet nëse në to kanë edhe elemente fjalë – elemente të tjera identike ose të ngjashme, konturet etj. Një element identik është i mjaftueshëm për të konstatuar një ngjashmëri.
- në rast të dy markave ngjyrë, atëherë markat në diskutim janë të ngjashme nëse ndajnë hijezimet/nuancat e të njëjtës ngjyrë.

**b) Shkallën e ngjashmërisë aurale (në dëgjim):**

- Markat thjeshtë figurative nuk kanë ndonjë ngjashmëri fonetike,
- Markat fjalë mund të analizohen varësisht prej rrokjeve, sequenca e rrokjeve dhe theksi.
- Shkallën e ngjashmërisë konceptuale apo përmbajtësore:
- Përmbajtja e njëjtë ose e ngjashme;
- Koncepti i secilit element, përveç nëse shenja nuk ka ndonjë kuptim.
- Shenja që nuk ka ndonjë kuptim përmbajtësor, atëherë nuk ka ngjashmëri konceptuale.

E rëndësishme është që gjatë vlerësimit të ngjashmërisë midis markave duhet të bëhet një vlerësim objektiv i përgjithshëm. Shqyrtimi i ngjashmërisë nuk mund të reduktohet në konstatimin e pjesshëm të ngjashmërisë së njërit nga tri elementet e mësipërme, por duhet përqendruar në atë se çfarë është rezultati i përgjithshëm i të gjitha ngjashmërive dhe dallimeve në aspektin auditiv, vizual dhe konceptual. Përveç ngjashmërisë midis mallrave dhe markave në diskutim, faktorë të tjerë me rëndësi mund të paraqiten edhe dallueshmëria e markave në diskutim, vëmendja e konsumatorit relevant, imazhi jo-perfekt, familja e markave tregtare, incidente të konfuzionit etj.

### 11.3.6 Mbrojtja juridike e markave tregtare

Shkelja e markës tregtare mund të kryhet ndaj markës së regjistruar por edhe gjatë procedurës së regjistrimit nëse regjistrimi rezulton i suksesshëm.

Shkelja mund të bëhet me çdo veprim të ndërmarrë pa autorizimin e pronarit, me të cilin atakohet të paktën njëra prej të drejtave të pronarit të markës tregtare. Kjo shkelje mund të bëhet gjatë kohës së vlefshmërisë së markës tregtare, brenda territorit për të cilën ajo është e autorizuar.

Për shkelje nuk është e domosdoshme të shkaktohet konfuzioni në tregun përkatës por mjafton mundësia e shkakimit të konfuzionit. Shkelja mund të ndodhë edhe me një vënie të përkohshme të mallit në qarkullim. Pronari i markës tregtare gëzon mbrojtje juridike



pavarësisht nga cilësia dhe niveli i njohjes së mallit apo shërbimit të tij në treg, në raport me cilësinë dhe nivelin e mallit apo shërbimit me të cilin kryhet shkelja e markës së tij.

Shkelje e markës tregtare konsiderohet imitimi i saj, transkriptimi, transliterimi, si dhe kur shenjës i shtohen fjalët "Iloji", "mënyrë", "sipas" dhe të ngjashme.

- i. Imitimi - ekziston në qoftë se konsumatori mesatar i mallrave, pavarësisht nga Iloji i mallit apo shërbimit mund të vërejë dallimin vetëm duke i kushtuar vëmendje të veçantë. Imitimi paraqitet në rastet kur shenja e përdorur është përkthim i shenjës së mëhershme, nga një gjuhë e huaj në gjuhën e tregut përkatës, kur shenja e përdorur paraqitet me shkronja dhe kuptim të njëjtë por paraqitet në mënyrë tjetër (p.sh. në vend të shkronjave të vogla paraqitet me shkronja të mëdha, shkronjat stilizohen ndryshe, etj.).
- ii. Transkriptimi (kopjimi) është përshtatje e fjalëve të huaja në gjuhën e tregut përkatës dhe bartja e një shenjës nga një etiketë e mallit në tjetrën, duke marrë parasysh shqiptimin. Transkriptohen emrat me të njëjtat shkronja, përkatësisht nga një alfabet në tjetrin, apo fjalët e huaja përpunohen dhe përshtaten në kuptimin fonologjik, morfologjik dhe semantik (kuptim) në gjuhën dhe shkrimin në të cilin kryhet transkriptimi.
- iii. Transliterimi përbën transferimin e shenjave/personazheve nga një etiketë pavarësisht nga kuptimi.

### **11.3.7 Mjetet Juridike për Mbrojtjen e Markave Tregtare**

Instrumentet ndërkombëtare (Marrëveshja TRIPS dhe Direktivat e BE-së), parashohin obligimin e shteteve që të sigurojnë mjete juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga markat tregtare. Me mjete juridike efektive nënkuptohet jo vetëm dhënia e mundësisë ligjore për të kërkuar mbrojtjen gjyqësore por shtetet janë të obliguara që të krijojnë sistem të tillë që mjeti juridik duhet të jetë efektiv dhe i zbatueshëm shpejt.

LMT parasheh se në rast të një shkeljeje të markës tregtare, mbajtësit e markës tregtare dhe mbajtësi i licencës ekskluzive kanë të drejtë të iniciojnë procedurë civile kundër personave përgjegjës për shkeljen. Po ashtu edhe me ligjet tjera sikurse Ligji mbi Inspektoratin e Tregut, Ligji mbi Masat Doganore si dhe Kodi Penal i Republikës së Kosovës përmbajnë dispozita të cilat i autorizojnë bartësit e markës tregtare që mbrojtjen e tyre ta kërkojnë edhe në procedura tjera.

Titullari i një marke tregtare, mund të kërkojë mbrojtje si në procedurë administrative pranë ZPI, Inspektoratit të Tregut dhe Doganës së Kosovës, në procedurë penale pranë Gjykatës Themelore të juridiksionit të përgjithshëm, dhe në procedurë civile pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike.

### **11.3.8 Mbrojtja civilo - juridike, palët, mjetet juridike dhe procedurat**

Në rast të shkeljes së markës tregtare, titullari i saj mund të parashtrijë padi në gjykatë me të cilën inicion kontestin civil për mbrojtjen e të drejtave të tij që rrjedhin nga marka tregtare. Në bazë të Nenit 13 të Ligjit për Gjykatat e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-199), Gjykata

Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike është e kompetencës lëndorë për shqyrtimin e çështjeve lidhur me markat tregtare.

Para ngritjes së çështjes në gjykatë, titullari i markës tregtare i dërgon palës tjetër një të ashtuquajtur “Shkresë për Ndërprerje dhe Pushim” përmes së cilës pronari i kërkon palës tjetër ta ndërpresë shkeljen. Kjo shkresë shërben si dëshmi që paditësi ia ka tërhequr vërejtjen para ngritjes së padisë dhe është përpjekur ta arrijë një marrëveshje jashtë-gjyqësore. Kjo procedurë paraprake e arritjes së marrëveshjes jashtë gjyqësore nuk është obligative, por megjithatë praktikohet në praktikën juridike, si mjet për t'i ikur shpenzimeve të panevojshme gjyqësore.

Si rregull, gjykata pas marrjes së përgjigjes në padi nga pala e paditur cakton seancën përgatitore. Në këtë fazë, nëse e lejojnë rrethanat e rastit, gjykata u propozon palëve që çështjen e tyre ta zgjidhin në procedurën e ndërmjetësimit apo përmes pajtimit gjyqësor. Nëse nuk arrihet pajtim gjyqësor gjykata cakton seancën e shqyrtimit kryesor në të cilin administrohen provat dhe në bazë të fakteve të vërtetuara dhe ligjit material, gjykata bie vendimin meritor lidhur me çështjen.

Sa i përket barrës së provës, LMT nuk përmban dispozita që përcaktojnë se kujt i bie barra e të provuarit në kontestet për marka tregtare andaj aplikohen dispozitat e LPK-së, respektivisht Neni 319 i cili parashih se palët ndërgjyqëse kanë për detyrë t'i provojnë faktet mbi të cilat i bazojnë kërkesat e tyre. Pra, nëse pala paditëse pretendon se veprimet e palës tjetër paraqesin shkelje të markës tregtare, atëherë për një gjë të tillë paditësi duhet të dorëzojë dëshmi. Në anën tjetër, nëse pala e paditur pretendon se veprimet e saj janë të lejuara për ndonjë arsye ose tjetër, atëherë edhe kjo duhet të i provojë këto pretendime.

Megjithatë bazuar ne dispozitat procedurale gjykata mund edhe pa propozimin e palëve të nxjerrë prova për vërtetimin e gjendjes faktike apo ndonjë çështjeje paraprake, të rëndësishme për vendosjen e çështjes. P.sh. gjykata mund të kërkojë informata nga ZPI lidhur me procedurën e regjistrimit dhe validitetit të markës tregtare, apo vlerësimin e tyre për shkeljen e pretenduar të markës tregtare. Por vlerësimi i ZPI nuk e obligon gjykatën.

### **11.3.9 Kërkesë-padia e palës dhe mbrojtja gjyqësore**

Mbajtësi i markës tregtare mund të kërkojë nga gjykata kompetente ndërmarrjen e veprimeve të ndryshme. Paditësi mund të kërkojë nga gjykata vërtetimin e shkeljes dhe të urdhërojë ndalimin e veprimeve të ardhshme me të cilën shkelet e drejta e tij.

Po ashtu me padi mund të kërkohet nga gjykata që ta urdhërojë tërheqjen e mallrave nga tregu, konfiskimin dhe shkatërrimin e produkteve që përbëjnë shkelje, me shpenzime të shkelësit. Në këtë rast gjykata është e obliguar ta precizojë qartë në dispozitiv se me cilat produkte shkelet marka tregtare, e cilat duhet të tërhiqen nga tregu.

Paditësi mund të kërkojë edhe kompensimin e dëmit për përfitim pa bazë dhe fitim të humbur, publikimin e aktgjykimit ose kërkesën e gjykatës që të urdhërojë shkelësin e së drejtës për të informuar bartësin e markës me identitetin e personave të tretë të përfshirë në prodhimin dhe shpërndarjen e mallrave ose shërbimeve kundërvajtëse, si dhe të kanaleve të tyre të shpërndarjes.

### 11.3.10 Afati për paraqitjen e padisë

Padia mund të parashtrahet brenda afatit subjektiv 3 vjeçar nga data kur paditësi ka marrë njohuri për shkeljen e markës tregtare apo brenda 5 viteve nga data kur për herë të parë është kryer shkelja. Me kalimin e afateve të mësipërme pronari i markës tregtare e humb të drejtën për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.

Në këtë rast shfrytëzuesi jo-pronar i markës tregtare mund ta përdor atë krahas pronarit të markës tregtare. Kjo përbën rast specifik, i krijuar në bazë të gjendjes faktike nga përdorimi i dy palëve, e ashtuquajtura “e drejta e ndarë” apo “e drejta e përbashkët” në markën tregtare. Duhet theksuar se pronari i markës nuk e humb të drejtën markën në raport me personat e tretë mirëpo nuk mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore ndaj personit shfrytëzues të markës, ndaj të cilit nuk ka paraqitur padi brenda afateve ligjore.

### 11.3.11 Masat e përkohshme në rast të shkeljes së markës tregtare

LMT parasheh mundësinë që bartësi i markës tregtare mund të kërkojë nga gjykata caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, jo vetëm kur dëshmon se marka e tij është shkelur, por edhe në rast se dëshmon se marka e tij kërcënohet të shkelet respektivisht personi tjetër është duke u tentuar ta shkelë markën e tij.

*Sipas Nenit 101 të LMT, gjykata mund të caktojë ndonjërin prej masave:*

- të urdhërojë shkelësin e supozuar që t'i ndalojë veprimet që shkelin markën tregtare;
- të lëshojë një urdhër ndalimi kundër ndërmjetësuesit shërbimet e të cilit i përdorin personat e tretë që shkelin markën tregtare.
- të urdhërojë konfiskimin apo largimin nga tregu të produkteve që pa të drejtë emërtohen si marka tregtare.

LMT me Nenin 101, i jep të drejtë bartësit të së drejtës nga marka tregtare që në rastin e shkeljeve të kryera në veprimtari afariste, në qoftë se dëshmon se shkelja është kryer me qëllim të përfitimit material dhe shkelja ka tentuar t'i shkaktojë atij dëm të riparueshëm apo vështirë të riparueshëm, të kërkojë nga gjykata që përveç masave të mësipërme të urdhërojë bllokimin e përkohshëm të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të shkelësit të supozuar, përfshirë edhe bllokimin e llogarive të tij bankare dhe pasuritë e tjera. Në këtë rast bartësi duhet të provojë shkeljen apo tentativën e shkeljes, që shkelja të jetë kryer në afarizëm dhe për përfitime materiale, dhe që të dëshmojë se shkelja do t'i shkaktojë dëm të riparueshëm apo vështirë të riparueshëm.

Kërkesa për caktimin e masës së përkohshme në rast të shkeljes mund të paraqitet si para fillimit të procedurës së shkeljes, me kusht që brenda një afati të caktuar të iniciojë procedurën gjyqësore për shkak të shkeljes, ashtu edhe gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore për shkak të shkeljes. Kushtet dhe procedura për përcaktimin e masës së sigurimit përveç Nenit 101 të LMT-së, përcaktohen me Nenin 297 të LPK-së.

Masa e sigurimit në procedurë kontestimore dallon nga masa e sigurimit në procedurën për shkeljen e markës tregtare, për shkak të natyrës specifike të markave tregtare. Përderisa në procedurën kontestimore masa e sigurimit gjithmonë caktohet për sigurimin e kërkesë-

padisë në procedurën për shkelje të markës tregtare masa e sigurimit shërben si preventivë për ndalimin e shkeljes së markës tregtare, e në raste të caktuara si masë ndëshkuese me të cilën mund të urdhërohet konfiskimi i mallrave dhe ndalimi i veprimeve të cilat e cenojnë markën tregtare. Masa e sigurimit në kontestet për markat tregtare mund të caktohet edhe për kërkesa të cilat janë identike me kërkesë-padinë nga padia, gjë që nuk lejohet në kontestet tjera.

### **11.3.12 Masat e përkohshme për ruajtjen dhe sigurimin e dëshmive**

Ruajtja dhe sigurimi i dëshmive është procedurë përmes së cilës sigurohen dëshmitë për të cilat ekziston rreziku që më vonë nuk mund të sigurohen.

Këtë mundësi e parasheh Neni 102 i LMT i cili përcakton se, edhe para fillimit të procedurës kontestimore, me kërkesë të palës paditëse e cila ka paraqitur prova të njafueshme për të mbështetur pretendimet e tij se marka tregtare është shkelur apo rrezikohet të shkelet, gjykata mund të urdhërojë masa të përkohshme për të ruajtur dëshmitë që ndërlidhen me shkeljen e pretenduar të markës tregtare.

### **11.3.13 Të gjeturat nga praktika e Gjykatës së Apelit**

Në praktikën gjyqësore aktuale paraqiten probleme të natyrave të ndryshme gjatë procedimit të kontesteve që kanë të bëjnë me markat tregtare. Këto probleme kryesisht konsistojnë në faktin se gjykatat gjatë vlerësimit të shkeljes së markës tregtare nuk marrin parasysh kriteret adekuate për vlerësimin e dallueshmërisë respektivisht ngjashmërisë së shenjave të përdorura nga operatorët ekonomik në veprimtarinë e tyre. Në disa raste gjykatat vendimin e marrin duke marrë për bazë vetëm një element të markës pa bërë analizën e tërë elementeve të shenjës për të cilën mendohet se ka shkelur markën tregtare.

Po ashtu, në disa raste gjykatat gjatë caktimit të masave siguruese nuk i precizojnë qartë produktet për të cilat caktohet masa e sigurimit dhe kjo shkakton probleme të theksuara në zbatimin e atyre vendimeve ndërsa në anën tjetër me këto vendime mund të shkaktohen edhe dëme për palët sepse në rastet kur caktohet masa e përgjithësuar “urdhërohet tërheqja e të gjitha produkteve .....” ekziston rreziku që organet zbatuese të bllokojnë apo shkatërrojnë edhe produkte që nuk janë të përfshira në shkeljen e markës tregtare.

Problematikë tjetër në praktikën gjyqësore përbën mos-aplikimi nga ana e gjykatave i “masave të përkohshme për ruajtjen dhe sigurimin e dëshmive” të paraparë me Nenin 102 të LMT-së, dhe si pasojë gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore bëhet e pamundur vërtetimi i plotë i gjendjes faktike.

Megjithatë problematikë kryesore mbetet kohëzgjatja e procedurës në kontestet për markat tregtare. Edhe pse me Nenin 104 të LMT-së përcaktohet se: *procedura në lidhje me shkeljen e markës duhet të jetë e përshpejtuar*, gjykatat jo në të gjitha rastet këto konteste i procedojnë me urgjencë. Kjo përbën problem të madh për palët sepse në të shumtën e rasteve mallrat e tilla bllokohen nga Doganat apo Inspektorati përkatës andaj zgjatja e procedurës gjyqësore mund të shkaktojë dëme të pariparueshme sepse shumica e mallrave janë me afat të limituar të përdorimit dhe ekziston rreziku i shkatërrimit edhe të mallrave për të cilat në fund të procedurës gjyqësore rezultojnë se nuk e shkelin markën tregtare të tjetrit.

### 11.3.14 Referenca nga arsyetimet e vendimeve të Gjykatës së Apelit

**Aktgjykimi Ae.nr. 62/2016, i datës 14.03.2016**

#### **Arsyetimi**

*Me aktgjykimin e atakuar në pikën I të dispozitivit është miratuar kërkesa e paditësit, ashtu që është vërtetuar se e paditura përmes importimit të sprejit kundër ndryshkut, në sasi prej 1.269 shishe-kanaqe, me shenjë “XA-40” ka bërë shkelje të markës tregtare të paditësit “XY-40” ndërsa në pikën II është urdhëruar e paditura që të bëjë shkatërrimin e produktit si në pikën “I” të dispozitivit, me shpenzimet e veta, në afatin prej 30 ditëve nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë. Në pikën III i është ndaluar të paditurës që në të ardhmen të importojë, ruajë apo të shesë pa autorizim, mall me shenjë të njëjtë apo të ngjashme me Markën tregtare të paditësit “XY-40”. Në pikën IV të dispozitivit është detyruar e paditura që t’ia paguajë paditësit shumën prej 319.00 € për shpenzimet e procedurës kontestimore.*

[.....]

*Pas vlerësimit të këtyre fakteve Gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se produkti “WB-40” i importuar nga e paditura, nga forma e ambalazhit (paketimi), dukja vizuale, ngjyrat që përmban, dhe shkronjat e përdorura mund të shkaktojnë konfuzion te publiku dhe se konsumatorët mund ta ngatërrojnë mallrat e importuara nga i padituri me mallrat e paditësit të mbrojtura me markë tregtare të regjistruar me vendimet e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë – Zyrës për Pronësi Industriale Nr. 8401, dt. 10.10.2012 dhe Nr. 8402, dt.10.10.2012, me të cilat janë regjistruar si marka tregtare nga klasa 2 dhe 4, marka “XY-40” dhe marka figurative “XY-40” me ngjyrat e mbrojtura e “verdhe” dhe e “kaltër”. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, fakti se produktet shërbejnë për qëllime të njëjta dhe se janë të së njëjtës klasë, paraqet rrezikshmëri më të madhe të shkaktoimit të konfuzionit tek konsumatorët dhe ngatërrim të këtyre mallrave.*

[.....]

*Gjykata e Apelit ka vlerësuar përfundimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se një qëndrim i tillë juridik nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm sepse, sipas vlerësimit të kësaj gjykate mbi gjendjen e tillë faktike gabimisht është zbatuar e drejta materiale, kur gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesë-padia e paditësit është e bazuar. Gjykata e shkallës së parë gjatë vlerësimit të dallueshmërisë respektivisht ngjashmërisë së produktit të mbrojtur të paditësit me markë tregtare dhe produktit të së paditurës, ka marrë për bazë kriteret e gabueshme. Gjykata e shkallës së parë ka marrë për bazë formën e ambalazhit (paketimin), dukjen vizuale, dhe ngjyrat që përmban dhe ka ardhur në përfundim se mund të shkaktojë konfuzion te publiku, por ka neglizhuar elementet tjera thelbësore që duhet të vlerësohen me rastin vlerësimit të ngjashmërisë dhe dallimeve në mes të markave të ndryshme.*

*Gjatë vlerësimit të ngjashmërisë së mallrave dhe shërbimeve, gjykata duhet ta ketë parasysh: natyrën e mallrave dhe të shërbimeve, perceptimin e konsumatorit mesatar dhe faktin nëse këto dy ndërmarrje janë në konkurrencë me njëra tjetrën, por për vlerësimin e shkallës së ngjashmërisë në mes të markave duhet të merren parasysh: shkalla e*

*ngjashmërisë vizuale (në pamje), shkalla e ngjashmërisë aurale (në dëgjim), si dhe shkalla e ngjashmërisë konceptuale.*

*Nga fotot që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se produkti i paditëses dhe të paditurës të vetmen ngjashmëri ndërmjet tyre e kanë tek ngjyrat kaltër dhe verdhe të cilat gjenden tek të dyja produktet por edhe nuancat, dizajni, pjesëmarrja dhe kombinimi i këtyre ngjyrave në produkt dallojnë dukshëm. Ndërsa të gjitha elementet tjera të theksuara më lartë i kanë të ndryshme, mënyra e dizajnit të ambalazhit dallon dukshëm sepse produkti i të paditurës përmban përshkrime tjera, font tjetër të shkronjave, pamje tjetër të pjesës ballore të ambalazhit që nuk ka ngjashmëri me produktin e paditëses. Sipas Nenit 5 të Ligjit për Marka Tregtare, kusht për regjistrimin e markës tregtare është mundësia e paraqitjes grafike të markës ndërsa me Vendimin e MTI nr. 8401, marka tregtare e paditësit është regjistruar si kombinim i ngjyrave të mbrojtura kaltër dhe verdhe në dizajnin e caktuar dhe kjo markë tregtare gëzon mbrojtje vetëm në këtë dizajn të dhënë në vendim respektivisht në këtë kombinim sepse do të ishte jashtë çdo logjike që paditësi me vet faktin e regjistrimit dhe mbrojtjes së ngjyrave të caktuara t'ia mohojë çdo prodhuesi përdorimin e këtyre ngjyrave në çfarëdo forme dhe në çfarëdo kombinimi.*

*Prandaj, kjo gjykatë vlerëson se përdorimi i ngjyrave të njëjta në produktin e të paditurës, në dizajn dhe formë krejt tjetër dhe me kombinime tjera nuk shkelin markën tregtare të paditësit.*

*Kjo gjykatë vlerëson se ekzistojnë dallime të dukshme edhe në elementin “aural” sepse pavarësisht se shenja “XY-40” dhe “XA-40” kanë ngjashmëri në shqiptim, megjithatë shenja përbëhet vetëm nga dy shkronja andaj dallimi në një shkronjë është i mjaftueshëm që shenjat të trajtohen si të ndryshme. Për më tepër produkti i të paditurës emërtohet si “DARSA” dhe këtë shenjë e ka në plan të parë, ndërsa shenja “XA-40” përdoret si shenjë dytësore, në kuadër të tërësisë konceptuale të paraqitur grafikisht, për të treguar karakteristikë apo tipare të mallit, andaj edhe në këtë element produkti i të paditurës nuk mund të shkaktojë konfuzion tek publiku. Për vlerësimin e ngjashmërisë duhet krahasuar të gjitha elementet e markës tregtare: dukjen, shqiptimin dhe kuptimin e markës tregtare dhe me rastin e shqyrtimit të ngjashmërisë vlerësimi nuk mund të reduktohet në konstatimin e pjesshëm të ngjashmërisë të vetëm njërit prej elementeve të theksuara por duhet të bëhet vlerësim i përgjithshëm i të gjitha ngjashmërive dhe dallimeve të markës tregtare si tërësi. Në rastin konkret edhe pse kemi të bëjmë me mallra të ngjashme, marka tregtare e regjistruar e paditësit “XY-40” dhe marka e përdorur në produktet e të paditurës kanë dallime të mëdha në pamje, në shqiptimin e shenjes, si dhe në konceptin e tërësisë të paraqitjes së shenjave në dizajnin grafik.*

*Gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e ngjashmërive gabimisht e ka marrë si kriter formën e ambalazhit (paketimin) të njëjtë të produkteve dhe mbi këtë bazë ka konstatuar shkelje. Në rastin konkret forma e ambalazhit të produkteve përbën formë funksionale të vet produktit. Neni 6 par 1.5 i Ligjit për Markat Tregtare të Kosovës e ndalon mbrojtjen e shenjave të cilat përbëhen nga një trajtë e cila: 1) rezulton nga natyra e vetë mallit përkatës, 2) është e nevojshme për të arritur një rezultat teknik, ose 3) i jep vlerë thelbësore mallit në fjalë. Sipas kësaj dispozite një formë e cila është funksionale nuk mund të gëzojë mbrojtje. Nocioni i funksionalitetit është mekanizëm për parandalimin e monopolit mbi një formë të caktuar të mallit, e cila është e nevojshme të arrihet një rezultat i caktuar. Forma e ambalazhit të produkteve kontestuese përdoret tek të gjitha produktet e kësaj natyre andaj*

*përdorimi i kësaj forme nuk mund të ndalohet respektivisht përdorimi i kësaj forme nuk përbën shkelje të markës tregtare.*

*Për vlerësimin e drejtë të kësaj çështjeje, kjo gjykatë vlerësoi edhe “nivelelin e dijenisë së publikut për markën ose të njohjes së saj në sektorin publik përkatës” si një prej kritereve themelore të përcaktuara me “Rekomandimet e Përbashkëta” të miratuara nga Kuvendi i Unionit të Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe Kuvendi i Përgjithshëm të Organizatës Botërore për Pronësi Intelektuale (OBPI), lidhur me vlerësimin e shkeljes së markave tregtare. Në rastin konkret produkti i paditësit është produkt që nuk ka përdorim të përgjithshëm në jetën e përditshme dhe nuk e përdor secili qytetar i rëndomtë, por përbën produkt i cili përdoret në sektor të caktuar dhe ka përdorim specifik andaj nuk është produkt i njohur përgjithësisht nga publiku. Rrethi i konsumatorëve është i kufizuar dhe kryesisht janë profesionistë të profesioneve të caktuara të cilët e përdorin këtë produkt, e të cilët kanë njohuri të mjaftueshme për ta dalluar produktin e paditësit nga produktet tjera të ngjashme andaj edhe mundësia e shkaktimit të konfuzionit tek këta konsumatorë është shumë e vogël respektivisht e pamundur sepse të njëjtit me vëmendje të rëndomtë do ta dallonin produktin e paditëses nga produkti i të paditurës, për shkak se këto dy produkte kanë shenja të mjaftueshme dalluese ndërmjet tyre.*

*Marka Tregtare përbën një shenjë e cila përshkruan një produkt dhe bartë informacione tek konsumatori lidhur me prejardhjen e atij produkti. Funkzioni kryesor i markës tregtare është të shërbejë si identifikues burimi. Në rastin konkret produkti i të paditurës nuk përmban elemente të cilat kanë për qëllim që konsumatorin ta vënë në lajthim lidhur me burimin e produktit respektivisht të krijojnë përshtypjen se produkti i tij “XA-40” është prodhim i njëjtë apo produkt i prodhuesit të njëjtë të “DARSA – XA 40”, por përmban elemente dalluese të qarta nga të cilat lehtë mund të identifikohet prodhuesi, prejardhja dhe të gjitha informacionet tjera të nevojshme për produktin dhe burimin e tij.*

*Nga arsyet e sipër cekura dhe pas vlerësimit të të gjitha provave si dhe shkresave të lëndës, kjo gjykatë gjeti se në rastin konkret e paditura me produktin e saj “DARSA – XA 40” nuk e ka shkelur markën tregtare të paditësit andaj kërkesë-padia e paditësit është e pabazuar, ndërsa nga shkaku se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, është dashur që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe kërkesë-padia si e tillë të refuzohet.*

**Aktgjykimi Ae.nr. 246/2016, i datës 30.11.2016**

### **Arsyetimi**

*Me aktgjykimin e atakuar në pikën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesë-padia e paditësit “XX-lab INC”, e parashtruar kundër të paditurit N.SH.T “XX-lab”, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se i padituri me regjistrimin e shoqërisë tregtare N.SH.T “XX-lab” e ka shkelur markën tregtare të paditësit dhe t’ia ndalojë të paditurit përdorimin e emrit “XX-lab” në veprimtarinë e tij afariste dhe ta ndryshojë emrin e tij tregtar pranë ARBK-së. Në pikën II të dispozitivit, i është vendosur që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurale.*

[.....]

*Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi me datë 05.06.2015, ka ushtruar padi kundër së paditurës për shkak të shkeljes së markës tregtare, duke i propozuar gjykatës që ta aprovojë kërkesë-padinë e paditësit në tërësi si të bazuar dhe ta vërtetojë se i padituri me regjistrimin e shoqërisë tregtare N.SH.T “XX-lab” e ka shkelur markën tregtare të paditësit dhe t’ia ndalojë të paditurit përdorimin e emrit “XX-lab” në veprimtarinë e tij afariste dhe ta ndryshojë emrin e tij tregtar pranë ARBK-së. Gjykata e shkallës së parë ka mbajtur seancën gjyqësore dhe pas administrimit të provave, ka ardhur në përfundim se e paditura nuk ka bërë shkelje ligjore ndaj palës paditëse dhe nuk i ka cenuar të drejtat e saj përkitazi me emrin tregtar “XX-lab”, me arsyetimin se i padituri e ka regjistruar emrin e tij tregtar pranë ARBK-së, në përputhje me procedurat ligjore të përcaktuara me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, andaj i vetmi organ që mund ta bëjë ndryshimin e emrit të të paditurit është ARBK, e jo gjykata, dhe mbi këtë bazë e ka refuzuar kërkesë-padinë e paditësit.*

*Gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 182 par. 2 pika n) dhe o), për arsye se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit, nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare respektivisht arsyet e dhëna janë të paqarta, ekzistojnë kundërtënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktgjykimit dhe dokumenteve të administruara si prova.*

*Nga dispozitivi i aktgjykimit nuk është e qartë se në rastin konkret a zhvillohet kontesti lidhur me shkeljen e markës tregtare apo emrit tregtar. Kjo çështje është e rëndësishë së veçantë për shkak se marka tregtare dhe emri tregtar janë dy kategori të veçanta juridike andaj edhe trajtohen në procedura të ndryshme dhe rregullohen me dispozita materiale të ndryshme. Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi me padi ka kërkuar vërtetimin e shkeljes së markës tregtare ndërsa gjykata ka vendosur lidhur me emrin tregtar, çka përbën shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika o). Aktgjykimi i atakuar gjithashtu është marrë edhe me shkelje të dispozitës së nenin 160.5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, nuk ka cekur fare se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesën palëve, por në mënyrë të përgjithshme i është referuar Ligjit për Shoqëritë Tregtare.*

*Sipas Nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-026 Për Markat Tregtare, të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullari i markës tregtare mund t’i ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjë identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet e llojit të njëjtë ose të ngjashëm. Thelbi qëndron në funksionin themelor të markës - identifikimit të origjinës së produktit apo shërbimit.*

*Me regjistrimin e një marke të caktuar, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare. Pra e drejta nga marka tregtare krijohet në momentin e regjistrimit respektivisht në momentin e lëshimit të vendimit nga Zyra për Pronësi Industriale (ZPI) dhe regjistrimit të saj në Buletinin Zyrtar. Efektet e markës tregtare llogariten nga data e paraqitjes së aplikimit për regjistrim, ndërsa ndaj palëve të treta krijon efekt vetëm nga data kur regjistrimi i asaj marke është publikuar në Buletinin Zyrtar të ZPI-së (Neni 8, paragrafi 3 i LMT).*



Ligji nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare në nenin 21.4 thekson se: Asnjë person ose shoqëri tregtare nuk mund të shfrytëzojë ose regjistrojë një emër që është (i) i paligjshëm ose ngatërrues ose (ii) në pronësi ose kontroll të ligjshëm të një personi ose shoqërie tregtare përveç nëse ai person ose shoqëri tregtare e ka dhënë pëlqimin me shkrim. Ndërsa dispozita vijuese, neni 21.5 përcakton se: asgjë në këtë ligj nuk mund të interpretohet për t'i lejuar një personi ose shoqërie tregtare që të regjistrojë ose shfrytëzojë një emër, nëse ai emër paraqet – ose është shumë i ngjashëm – me një markë tregtare që është në pronësi ose kontroll të ligjshëm të një personi ose shoqërie tjetër tregtare, përveç nëse ai person ose shoqëri shprehimisht dhe me shkrim e autorizon regjistrimin ose shfrytëzimin e emrit. Çështjet që shfaqen në lidhje me përpjekjen për regjistrimin ose shfrytëzimin e emrit që përmban – ose është shumë i ngjashëm – me një markë tregtare, duhet të zgjidhet në pajtim me ligjin e Kosovës që rregullon dhe përcakton pronësinë e markave tregtare.

Instrumentet ndërkombëtare (Marrëveshja TRIPS dhe Direktivat e BE-së), parashohin obligimin e shteteve që të sigurojnë mjete juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga markat tregtare. Me mjete juridike efektive nënkuptohet jo vetëm dhënia e mundësisë ligjore për të kërkuar mbrojtjen gjyqësore por shtetet janë të obliguara që të krijojnë sistem të tillë që mjeti juridik duhet të jetë efektiv dhe i zbatueshëm shpejt. LMT ne Kreun XIII parasheh se në rast të një shkeljeje të markës tregtare, pronari dhe mbajtësi i markës tregtare kanë të drejtë të iniciojnë procedurë civile kundër personave përgjegjës për shkeljen.

Në rast të shkeljes së markës tregtare, titullari i saj mund të parashtrojë padi në gjykatë me të cilin inicion kontestin civil për mbrojtjen e të drejtave të tij që rrjedhin nga marka tregtare. Në bazë të Nenit 13 të Ligjit për Gjykatat e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-199), Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike është e kompetencës lëndore për shqyrtimin e çështjeve lidhur me markat tregtare.

Sa i përket barrës së provës, LMT nuk përmban dispozita që përcaktojnë se kujt i bie barra e të provuarit në kontestet për marka tregtare andaj aplikohen dispozitat e LPK-së, respektivisht Neni 319 i cili parasheh se palët ndërgjyqëse kanë për detyrë t'i provojnë faktet mbi të cilat i bazojnë kërkesat e tyre. Pra, nëse pala paditëse pretendon se veprimet e palës tjetër paraqesin shkelje të markës tregtare, atëherë për një gjë të tillë paditësi duhet të dorëzojë dëshmi. Në anën tjetër, nëse pala e paditur pretendon se veprimet e saj janë të lejuara për ndonjë arsye ose tjetër, atëherë edhe kjo duhet të i provojë këto pretendime. Megjithatë bazuar në dispozitat procedurale gjykata mundet edhe pa propozimin e palëve të nxjerrë prova për vërtetimin e gjendjes faktike apo ndonjë çështje paraprake, të rëndësishme për vendosjen e çështjes.

Bazuar në të sipërcekurat, Gjykata e Apelit ka gjetur së aktgjykimi i atakuar është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipërcituara. Gjykata e Apelit nuk e pranon qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, se gjykata nuk mund t'ia ndalojë të paditurit përdorimin e emrit "XX-lab" përderisa i njëjti emër është i regjistruar në ARBK dhe vetëm ARBK është kompetent për ndryshimin e emrit tregtar të të paditurit. Kjo nga shkakun se konstatimi nëse në rastin konkret kemi shkelje të markës tregtare bie në kompetencën e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Ekonomike, ndërsa vendimi lidhur me çështjen krijon bazën juridike për ARBK, për ndryshimin eventual të emrit tregtar të të paditurit. Edhe pse ndryshimi i emrit pranë ARBK-së përbën procedurë

*administrative megjithatë vlerësimi nëse kemi shkelje të markës tregtare bie në kompetencë të gjykatës dhe përbën çështje të ndarë nga procedura e ndryshimit të emrit.*

*Po ashtu, Gjykata e Apelit e vlerëson si të paqëndrueshëm dhe në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës, qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë se pala e paditur nuk ka bërë shkelje ligjore ndaj palës paditëse dhe nuk i ka cenuar të drejtat e saj përkitazi me emrin tregtar, sepse nga shkresat e lëndës rezulton se, paditësi në bazë të vendimit të ZPI, me Nr. regj. 3979/2011 dt. 06.06.2011 dhe 3979-1/2012, dt. 16.01.2012 e ka të regjistruar markën tregtare “XX-lab” nga data 26.09.2008 deri me datë 03.02.2019 dhe të njëjtit i takojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara me dispozitat e sipërcekura. Ndërsa i padituri e ka regjistruar biznesin e tij me emër tregtar identik me markën e regjistruar të paditësit “XX-lab” me datë 15.09.2011, gjatë periudhës kur marka tregtare e paditësit ka qenë e regjistruar dhe ka gëzuar mbrojtje juridike.*

*Shkeljet e tilla respektivisht paqartësitë dhe kontradiktat si në dispozitivin ashtu edhe në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktgjykimi i atakuar doemos është dashur të priset.*

#### **11.4 KOMPETENCAT E GJYKATAVE PËR SHQYRTIMIN E VENDIMEVE TË ARBITRAZHIT**

Procedura e arbitrazhit dhe procedura gjyqësore përbëjnë procedura të pavarura nga njëra tjetra, megjithatë në faza të caktuara ato ndërlihen ndërmjet vete dhe e plotësojnë njëra tjetrën.

Ndërlidhja më e theksuar ndërmjet arbitrazhit dhe gjykatave të rregullta paraqitet në rastin e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit.

#### **Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të Tribunalit të Arbitrazhit**

Ligjin për Arbitrazhin Nr. 02/L-75, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 26 janar 2007, në Kreun VIII (Neni 38 dhe 39), rregullon ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit.

Sipas Neneve 38 dhe 39 të këtij Ligji, nuk bëhet dallim ndërmjet vendimeve të arbitrazhit të nxjerra nga Tribunali i Arbitrazhit të Kosovës dhe Tribunalit të huaj dhe se vendimet e Tribunalit ekzekutohen nga gjykata, nëse vendimet e tilla shpallen të ekzekutueshëm nga gjykata.

Në këtë drejtim Neni 38.1 i Ligjit përcakton se “Vendimi i arbitrazhit i cili është nxjerrë nga një tribunal i arbitrazhit brenda Kosovës ekzekutohet pasi që të shpallet i ekzekutueshëm nga Gjykata”<sup>52</sup> ndërsa Neni 39.1 i Ligjit parasheh se: “Gjykatat e Kosovës i njohin vendimet e arbitrazhit të nxjerra jashtë Kosovës si të plotfuqishme dhe i ekzekutojnë ato nëse vendimet në fjalë janë njohur dhe janë shpallur të ekzekutueshme”<sup>53</sup>. Këto Nene

---

<sup>52</sup> Ligji për Arbitrazhin, neni 38, paragrafi 1.

<sup>53</sup> Po aty, neni 39, paragrafi 1.

njohin parimet e Konventës së Nju Jorkut të vitit 1958, mbi Njohjen dhe Përmbarrimin e Vendimeve të Arbitrazhit të huaj<sup>54</sup>.

*Neni 39.3 i ligjit parasheh se për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit, pala e interesuar duhet t'i paraqitet gjykatës me kërkesë, të cilës duhet t'ia bashkëngesë:*

- *origjinalin e vendimit ose një kopje të vërtetuar të vendimit;*
- *origjinalin e marrëveshjes së arbitrazhit ose një kopje të vërtetuar të saj; dhe*
- *një përkthim të certifikuar të marrëveshjes së arbitrazhit dhe të vendimit të*
- *arbitrazhit në njërën prej gjuhëve zyrtare të Kosovës, nëse marrëveshja ose vendimi*
- *nuk është përpiluar në njërën prej gjuhëve zyrtare të Kosovës<sup>55</sup>.*

Pas plotësimit të kushteve të përcaktuara me këtë Nen (39.3), gjykata në parim merr aktvendim me të cilin e njeh vendimin e Tribunalit të Arbitrazhit dhe e ekzekuton atë.

#### **11.4.1 Kontestimi i vendimeve të Tribunalit të Arbitrazhit në procedurën e njohjes dhe ekzekutimit**

Edhe pse në parim Ligji parasheh njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit, në Nenin 39.4 Ligji përcakton se “Kërkesa për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit refuzohet në bazë të kërkesës së palës tjetër, nëse ajo dëshmon se:

- njëra palë në marrëveshjen e arbitrazhit, sipas së drejtës kompetente për atë marrëveshje, nuk ka pasur zotësi për të vepruar; ose nëse marrëveshja e arbitrazhit nuk ka qenë e vlefshme sipas së drejtës së caktuar nga palët ose, në mungesë të një caktimi të tillë, sipas së drejtës në territorin ku është marrë vendimi;
- pala, ndaj së cilës kërkohet ekzekutimi i vendimit, nuk është njoftuar me rregull në lidhje me caktimin e një arbitri ose për procedurën e arbitrazhit, ose për arsye tjera nuk ka qenë në gjendje ta paraqesë rastin e saj;
- vendimi nuk ka të bëjë me çështjen e shqyrtuar nga tribunali i arbitrazhit ose ka të bëjë me një çështje e për të cilën nuk është kompetent tribunali i arbitrazhit, ose vendimi përfshin çështje për të cilat nuk është kompetent tribunali i arbitrazhit. Në këto raste, nëse vendimi mbi çështjet për të cilat është kompetent tribunali i arbitrazhit mund të ndahet nga çështjet tjera, atëherë kjo pjesë e vendimit mund të njihet dhe të ekzekutohet;
- përbërja e tribunalit të arbitrazhit ose procedura e arbitrazhit nuk ka qenë në pajtim me dispozitat e ligjit të zbatueshëm në atë rast;
- vendimi ende nuk është bërë i plotfuqishëm për palët, ose është shfuqizuar ose pezulluar nga një organ kompetent në territorin ku është nxjerrë vendimi, respektivisht sipas së drejtës në bazë të së cilës është nxjerrë vendimi; si dhe nëse
- sipas ligjit në fuqi në Kosovë, kontesti përkatës nuk mund të zgjidhet përmes arbitrazhit, ose njohja apo ekzekutimi i vendimit do të cenonte ose do të ishte në kundërshtim me rendin publik (ordre public) të Kosovës<sup>56</sup>.

---

<sup>54</sup> *Shih* Konventa mbi Njohjen dhe Përmbarrimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit, New York, 10 qershor 1958, e publikuar në United Nations Treaty Series, Vëllimi 330, Nr. 4739, Faqe, 3, e qasshme përmes linkut: [treaties.un.org/pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg\\_no=XXII-1&chapter=22&lang=en](https://treaties.un.org/pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=XXII-1&chapter=22&lang=en).

<sup>55</sup> Ligji për Arbitrazhin, neni 39, paragrafi 3.

<sup>56</sup> *Po aty*, neni 39, paragrafi 4.

Kushtet për shkak të të cilave mund të refuzohet njohja e ekzekutimit të aktvendimit të tribunalit të huaj, të përcaktuara me nenin e sipërcituar të Ligjit, janë në përputhje me nenet IV dhe V të Konventës së Nju Jorkut të vitit 1958, mbi Njohjen dhe Përmbarimin e Vendimeve të huaja të Arbitrazhit si dhe me nenin 36 të Ligjit model UNCITRAL mbi Arbitrazhin komercial ndërkombëtar<sup>57</sup>.

#### **11.4.2 Kontestimi i vendimeve të Tribunalit të Arbitrazhit dhe kërkesa për anulimin e tyre në procedurë gjyqësore**

Pavarësisht dispozitave ligjore të cilat parashohin mundësinë e kontestimit të vendimeve të arbitrazhit në procedurën e njohjes dhe ekzekutimit pranë gjykatës, Ligji për Arbitrazhin në Kreun VII, Neni 36, parashih mundësinë e kontestimit të vendimit të arbitrazhit, nën kushte të caktuara, edhe para fillimit të procedurës së njohjes dhe ekzekutimit, respektivisht brenda 90 ditëve nga data e marrjes së vendimit nga Tribunali.

Në këtë drejtim, Neni 36 i Ligjit parashih që, secila palë mund të kërkojë anulimin e vendimit pranë gjykatës dhe gjykata do ta anulojë atë, nëse plotësohen kushtet e caktuara të cilat i radhit në dy kategori:

- a) *Rrethanat të cilat duhet t'i dëshmojë pala paditëse e cila ka kërkuar anulimin e vendimit:*
  - *njëra palë në marrëveshjen e arbitrazhit nuk ka patur zotësinë për të vepruar;*
  - *marrëveshja e arbitrazhit nuk është e vlefshme sipas së drejtës së caktuar nga palët ose nga tribunali i arbitrazhit ose, në mungesë të një caktimi të tillë, sipas ligjit të zbatueshëm në Kosovë;*
  - *paditësi nuk është njoftuar me rregull në lidhje me emërimin e një arbitri ose mbi procedurën e arbitrazhit, ose për arsye tjera nuk ka qenë në gjendje të paraqesë rastin e tij;*
  - *vendimi nuk ka të bëjë me çështjen e shqyrtuar nga tribunali i arbitrazhit ose ka të bëjë me një çështje për të cilën nuk është kompetent tribunali i arbitrazhit, ose vendimi përfshin çështje për të cilat nuk është kompetent tribunali i arbitrazhit.*
  - *përbërja e tribunalit të arbitrazhit ose procedura e arbitrazhit nuk ka qenë në pajtim me dispozitat e këtij ligji ose me marrëveshjen e arbitrazhit, me kusht që mangësia e tillë të ketë patur ndikim në vendimin e tribunalit; dhe*
- b) *Rrethanat të cilat gjykata i vlerëson sipas detyrës zyrtare:*
  - *arbitrazhi në fjalë është i ndaluar me ligj; ose*
  - *ekzekutimi i vendimit do të cenonte ose do ishte në kundërshtim me rendin publik (ordre public)<sup>58</sup>.*

---

<sup>57</sup> Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Tregtare Ndërkombëtare, Ligji Model i UNCITRAL për Arbitrazhin Komercial Ndërkombëtar, 1985, sikurse është amendamentuar në vitin 2006, Vjenë, i qasshëm përmes linkut: [www.uncitral.org/uncitral/en/uncitral\\_texts/arbitration/1985Model\\_arbitration.html](http://www.uncitral.org/uncitral/en/uncitral_texts/arbitration/1985Model_arbitration.html).

<sup>58</sup> Ligji për Arbitrazhin, neni 36.

### 11.4.3 Kompetencat e gjykatës për shqyrtimin e vlefshmërisë së marrëveshjes së arbitrazhit

Kompetenca e gjykatës lidhur me shqyrtimin e vlefshmërisë së marrëveshjes së arbitrazhit është e rregulluar me nenet 7 dhe 14 të Ligjit të Kosovës për Arbitrazhin.

Bazuar në nenin 7 të Ligjit, gjykata është kompetente për të vlerësuar nëse marrëveshja mbi arbitrazhin është e pavlefshme ose që çështja kontestuese nuk mbulohet nga marrëveshja e arbitrazhit<sup>59</sup>.

Kjo i referohet rasteve kur marrëveshja e arbitrazhit mund të jetë e ndaluar me ligj apo kontesti ka të bëjë me çështje që sipas ligjeve në fuqi nuk mund të zgjidhen në procedurë të arbitrazhit (p.sh. çështjet familjare, statusore, etj.) si dhe rastet kur marrëveshja mund ta cenojë rendin publik (ordre public).

Përderisa dispozita e nenit 7 parasheh kompetencën e gjykatës për rastet e sipër cekura, neni 14.1 i ligjit parasheh kompetencën ekskluzive të Tribunalit të Arbitrazhit për të vendosur lidhur me *vlefshmërinë e klauzolës së arbitrazhit*<sup>60</sup>.

Shqyrtimi i vlefshmërisë së klauzolës së arbitrazhit nënkupton vlerësimin nëse marrëveshja respektivisht klauzola e arbitrazhit i përmbush kriteret e parapara ligjore apo elementet themelore (forma me shkrim, gjuha e arbitrazhit, vendi i arbitrazhit, miratimi i palëve për arbitrim, Institucioni dhe rregullat e arbitrazhit, etj.)

### 11.4.4 Kompetencat e gjykatës për shqyrtimin e ekzistencës së marrëveshjes së arbitrazhit

Nga shqyrtimi i vlefshmërisë së arbitrazhit duhet dalluar rastin kur ndonjëra nga palët kontraktuese pretendon se *klauzola për arbitrazh nuk ekziston*. Në këto raste bazuar në Nenin 14.5 të Ligjit për Arbitrazhin, gjykata ka juridiksion të vlerësojë ekzistimin apo mosekzistimin e klauzolës së arbitrazhit dhe mund të marrë vendim me të cilin e shpall jo-ekzistente klauzolën e tillë, nëse pala e cila ka kërkuar shqyrtimin e mosekzistencës së klauzolës së arbitrazhit argumenton se, klauzola është rezultat i mashtrimit, presionit, gabimit apo mosdijes dhe se nuk ka ekzistuar qëllimi i tij për të arbitruar<sup>61</sup>.

Kusht thelbësor për zgjidhjen e çështjes në arbitrazh është “pëlqimi” i palëve për zgjidhjen e çështjes së tyre në arbitrazh, ndërsa bazuar në dispozitat e sipër cekura, ekzistimi apo mosekzistimi i “pëlqimit” respektivisht “marrëveshjes” për arbitrazh bie në juridiksionin e gjykatës së rregullt, sipas ligjit të zbatueshëm në Kosovë<sup>62</sup>.

Pëlqimi i palëve konsiderohet se ekziston vetëm në rastet kur palët qartë dhe pa dyshim tregojnë qëllimin për të arbitruar, në të kundërtën nëse ky pëlqim nuk i plotëson kriteret e cekura çështja bie nën juridiksionin e gjykatave të rregullta<sup>63</sup>.

---

<sup>59</sup> *Po aty*, neni 7.

<sup>60</sup> *Po aty*, neni 14, paragrafi 1.

<sup>61</sup> Shih: Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.277/2016, dt.15.12.2016.

<sup>62</sup> *Po aty*.

<sup>63</sup> George A. Bermann. The “Gateway” Problem in International Commercial Arbitration, Winter, 2012 The Yale Journal of International Law, faqe 30-38

Pëlqimi i palëve përbën element esencial për përcaktimin e kompetencës së tribunalit, sepse vetëm palët në bazë të vullnetit të tyre të lirë mund ta bartin kompetencën për zgjidhjen e kontestit të tyre në arbitrazh. Ky qëndrim gjen mbështetje në faktin se klauzola e arbitrazhit përbën kontratë të veçantë ndërmjet palëve andaj për të krijuar kjo kontratë efekte juridike duhet t'i përmbushë të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara për lidhjen e kontratës. Këto kushte ndërliidhen me ofertën dhe pranimin e saj e rrjedhimisht me shprehjen e vullnetit të palëve për lidhjen e kontratës. Sipas Nenit 18.2 të LMD<sup>64</sup>-së, shprehja e vullnetit duhet të bëhet lirisht dhe seriozisht.

Prandaj, çështja e vlerësimit nëse ndërmjet palëve ka ekzistuar oferta për të arbitruar çështjen dhe pranimi i saj në bazë të vullnetit të lirë bie në kompetencën e gjykatës së rregull. Vetëm nëse konstatohet pa asnjë mëdyshje se palët kanë lidhur marrëveshje për të arbitruar në përputhje me kriteret ligjore konstituohet kompetenca e tribunalit të përzgjedhur të arbitrazhit. Nëse konstatohet se kjo marrëveshje nuk është lidhur fare apo është inekzistente sepse i mungojnë kushtet e përcaktuara ligjore, ajo nuk krijon efekte juridike dhe rrjedhimisht nuk krijohet kompetenca e arbitrazhit. Tribunali i arbitrazhit nuk mund të vlerësojë një çështje, e cila përbën çështje paraprake, ende pa u themeluar kompetenca e saj.

Kompetenca e gjykatës së rregullt për zgjidhjen e çështjes përkatëse derivon nga ligjet nacionale dhe kjo kompetencë mund t'u delegohet në tribunal të arbitrazhit vetëm në bazë të vullnetit të lirë palëve andaj përcaktimi i ekzistencës së këtij vullneti nga vet tribunalin i arbitrazhit dhe vendosja për konstituimin e kompetencës së tij, do të shfaqte dilema për legjitimitetin dhe objektivitetin e tribunalit.

Për më tepër tribunalet e arbitrazhit kanë kompetencë sekondare për zgjidhjen e kontesteve ndërmjet palëve sepse në çdo rast kompetencë primare kanë gjykatat e rregullta dhe kjo kompetencë mund të delegohet nga gjykatat e rregullta në arbitrazh vetëm përmes marrëveshjes së palëve. Por edhe ky delegim me marrëveshje nuk nënkupton delegim absolut të kompetencës sepse palët pavarësisht lidhjes së marrëveshjes për të arbitruar, mund ta parashtrajnë çështjen e tyre në gjykata nacionale të cilat kanë për detyrë ta procedojnë çështjen dhe nuk mund të shpallën jokompetente sipas detyrës zyrtare por vetëm nëse pala tjetër e konteston kompetencën e gjykatës së rregullt.

Kjo rrjedh nga dispozitat e Nenit 20 të LPK-së<sup>65</sup> dhe Nenit 7 të LA<sup>66</sup>-së, të cilat përcaktojnë se, nëse paraqitet në gjykatë padi për një çështje për të cilën ekziston marrëveshja e arbitrazhit, gjykata e hedh padinë si të palejueshme vetëm sipas prapësimit të palës së paditur. Prapësimin mund ta parashtrtojë i padituri më së voni me anë të përgjigjes në padi. Nëse nuk ka kundërshtim të palës deri në fillimin e shqyrtimit verbal, gjykata nuk mund ta refuzojë ofrimin e mbrojtjes gjyqësore dhe do të procedojë me çështjen, ndërsa i padituri nuk ka të drejtë ta kundërshtojë kompetencën e gjykatës së rregullt. Kur njëra palë parashtron padi në gjykatë të rregullt, pavarësisht ekzistimit të marrëveshjes së arbitrazhit,

---

Bermann†<https://litigationessentials.lexisnexis.com/webcd/app?action=DocumentDisplay&crawlid=1&doctype=cite&docid=37+Yale+J.+Int'l+L.+1&srctype=smi&srcid=3B15&key=90e8248770b0f75e1f552aa520ce880b>

<sup>64</sup> Ligji Nr. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE  
[http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji\\_për\\_marrëdhëniet\\_detyrimeve.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji_për_marrëdhëniet_detyrimeve.pdf)

<sup>65</sup> LIGJI NR. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE  
<https://gzk.rksgov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2583>

<sup>66</sup> LIGJI NR. 02/L-75 LIGJI PËR ARBITRAZHIN <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2579>

ajo palë e konsumon të drejtën e kundërshtimit të kompetencës së gjykatës në momentin e krijimit të gjyqvarësisë (litispencencës) dhe në rast të ushtrimit të kundërpadisë nga pala tjetër, pala paditëse nuk mund ta kundërshtojë kompetencën e gjykatës së rregullt për vendosjen e kundërpadisë<sup>67</sup>.

#### 11.4.5 Të gjeturat nga Praktika e Gjykatës së Apelit

Në praktikën gjyqësore aktuale në kontestet e arbitrazhit ka pasur praktika të ndryshme ndërmjet Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit kryesisht lidhur me dy çështje:

- Kompetencat e gjykatës për shqyrtimin e ekzistencës së marrëveshjes së arbitrazhit, dhe
- Të drejtën e Ankesës ndaj Aktvendimit për njohjen dhe shpalljen e ekzekutueshme të vendimit të arbitrazhit të huaj.

**Në vijim vendimet e gjykatave për rastet e vendosura për këto çështje:**

**Aktvendimi Ae.nr. 277/2016, i datës 15.12.2016**

#### **Nga Arsyetimi**

*Me aktvendimin e atakuar gjykata e shkallës së parë nën pikën I të dispozitivit ka konstatuar se nuk është kompetente për të vendosur për padinë e paditësit [...] të paraqitur me datë 06.11.2014, kundër të paditurave: [.....] më të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare e Arbitrazhit (ICA) me seli në Paris. Në pikën II të dispozitivit është hedhur padia e përshkruar në paragrafin "I" të dispozitivit, për shkak të mungesës së kompetencës së gjykatës së vendit për shqyrtim dhe vendosje në padinë për anulimin e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare e Arbitrazhit (ICA) me seli në Paris.*

[.....]

*Gjykata e shkallës së parë është shpallur jokompetente lëndore për të vendosur në çështjen juridike sipas padisë së paditësit dhe e ka hudhur padinë me arsyetim se procedura gjyqësore dhe kushtet ligjore për anulimin e vendimit të arbitrazhit janë të rregulluara me Ligjin për Arbitrazhin të vitit 2007, i cili ligj në Nenin 36 dhe 37 përcakton kushtet specifike për anulimin e vendimit të arbitrazhit. Bazuar në këto dispozita gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se gjykatat vendore mund të vendosin vetëm lidhur me vendimet e arbitrazhit vendor por jo edhe të vendimeve të arbitrazhit të huaj, pasi ligji nuk e përcakton decidivisht se a mund të bëhet anulimi i vendimit të arbitrazhit të huaj apo vetëm atij vendor dhe nga kjo paqartësi ka konkluduar se gjykatat vendore mund të vendosin vetëm për vendimet e arbitrazhit vendor.*

[.....]

*Gjykata e Apelit ka gjetur se aktvendimi i atakuar përmban shkelje të dispozitave të ligjit material, për arsye se në rastin konkret është kërkuar anulimi i vendimit të arbitrazhit,*

---

<sup>67</sup> Shih: Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr 156/2016, 24.04.2017.

*lidhur me kompetencën e arbitrazhit për të vendosur në kontestin ndërmjet palëve, e cila sipas Nenit 7 të Ligjit për Arbitrazhin bie në kompetencë të gjykatës respektivisht, sipas kësaj dispozite gjykata nuk mund ta hedh padinë si të palejuar në rast kur kërkohet anulimi i vendimit të arbitrazhit me pretendim se marrëveshja e arbitrazhit është e pavlefshme ose që çështja kontestuese nuk mbulohet nga marrëveshja e arbitrazhit.*

*Edhe pse në parim Ligji për Arbitrazhin siguron njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit, në Nenin 39.4 Ligji përcakton se “Kërkesa për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit refuzohet në bazë të kërkesës së palës tjetër, nën kushte të caktuara përfshirë edhe rastin kur ajo dëshmon se, marrëveshja e arbitrazhit nuk ka qenë e vlefshme sipas së drejtës së caktuar nga palët ose, në mungesë të një caktimi të tillë, sipas së drejtës në territorin ku është marrë vendimi. Kushtet për shkak të të cilave mund të refuzohet njohja e ekzekutimit të aktvendimit të tribunalit të huaj, të përcaktuara me Nenin e sipërcituar të Ligjit, janë në përputhje me Nenet IV dhe V të Konventës së Nju Jorkut të vitit 1958, mbi Njohjen dhe Përmbartimin e Vendimeve të Arbitrazhit të huaj, si dhe me Nenin 36 të Ligjit model UNCITRAL mbi Arbitrazhin komercial ndërkombëtar.*

*Pavarësisht dispozitave ligjore të cilat parashohim mundësinë e kontestimit të vendimeve të arbitrazhit në procedurën e njohjes dhe ekzekutimit pranë gjykatës, Ligji në Kreun VII, Neni 36, parasheh mundësinë e kontestimit të vendimit të arbitrazhit, nën kushte të caktuara, edhe para fillimit të procedurës së njohjes dhe ekzekutimit, respektivisht brenda 90 ditëve nga data e marrjes së vendimit nga Tribunali. Në këtë drejtim, Neni 36 i Ligjit parasheh që, secila palë mund të kërkojë anulimin e vendimit pranë gjykatës dhe gjykata do ta anulojë atë, nëse pala paditëse e cila ka kërkuar anulimin e vendimit dëshmon se janë plotësuar kushtet e përcaktuara ligjore përfshirë edhe rastin kur marrëveshja e arbitrazhit nuk është e vlefshme sipas së drejtës së caktuar nga palët, ose në mungesë të një caktimi të tillë, sipas ligjit të zbatueshëm në Kosovë, [neni 36.2 pika a) (ii)] apo nëse ekzistojnë rrethanat të cilat gjykata i vlerëson sipas detyrës zyrtare, kur: arbitrazhi në fjalë është i ndaluar me ligj, ose ekzekutimi i vendimit do të cenonte ose do ishte në kundërshtim me rendin publik (ordre public) [Neni 36.2 pika (b)].*

*Dispozita e Nenit 14.1 të Ligjit për Arbitrazhin parasheh kompetencën ekskluzive të Tribunalit të Arbitrazhit për të vendosur lidhur me “vlefshmërinë e klauzolës së arbitrazhit” që nënkupton vlerësimin nëse marrëveshja respektivisht klauzola e arbitrazhit i përmbush kriteret e parapara ligjore apo elementet themelore (forma me shkrim, gjuha e arbitrazhit, vendi i arbitrazhit, miratimi i palëve për arbitrim, Institucioni dhe rregullat e arbitrazhit, etj.). Por nga shqyrtimi i vlefshmërisë së arbitrazhit dallon rasti kur ndonjëra nga palët kontraktuese pretendon se “klauzola për arbitrazh nuk ekziston”, si në rastin konkret ku paditësi pretendon se nuk ka ekzistuar klauzola/marrëveshja e arbitrazhit. Në këto raste bazuar në Nenin 14.5 të Ligjit për Arbitrazhin, gjykata ka juridiksion të vlerësojë ekzistimin apo mosekzistimin e klauzolës së arbitrazhit dhe mund të marrë vendim me të cilin e shpall joekzistente klauzolën e tillë, nëse pala e cila ka kërkuar shqyrtimin e mosekzistencës së klauzolës së arbitrazhit argumenton se, klauzola është rezultat i mashtrimit, presionit, gabimit apo mosdijes apo nuk ka ekzistuar qëllimi i tij për të arbitruar. Kusht thelbësor për zgjidhjen e çështjes në arbitrazh është “pëlqimi” i palëve për zgjidhjen e çështjes së tyre në arbitrazh, ndërsa bazuar në dispozitat e sipërcekura, ekzistimi apo mosekzistimi i “pëlqimit” respektivisht “marrëveshjes” për arbitrazh bie në juridiksionin e gjykatës së rregullt, sipas ligjit të zbatueshëm në Kosovë.*



*Bazuar në të sipëcekurat Gjykata e Apelit vlerëson se Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike është kompetente për të vendosur në çështjen juridike konkrete pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se, parashtruesi i kërkesës/paditësi ka kërkuar nga gjykata vërtetimin e faktit se marrëveshje për arbitrazh ndërmjet palëve nuk ekziston dhe mbi këtë bazë ka kërkuar edhe anulimin e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICA), e jo vlerësimin e vlefshmërisë së klauzolës së arbitrazhit.*

*Si rezultat i kësaj, Gjykata e Apelit e vlerëson plotësisht të paqëndrueshëm dhe pa mbështetje ligjore qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë se “gjykatat vendore mund të vendosin vetëm lidhur me vendimet e arbitrazhit vendor por jo edhe të vendimeve të arbitrazhit të huaj, pasi që ligji nuk e përcakton decidivisht se a mund të bëhet anulimi i vendimit të arbitrazhit të huaj apo vetëm atij vendor” sepse Ligji i Kosovës për Arbitrazhin nuk bën asnjë dallim ndërmjet Arbitrazhit vendor dhe të huaj, ndërsa një interpretim i tillë i ligjit do të shkaktonte probleme edhe në procedurën e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit të huaj.*

**Aktvendimi Ae.nr. 171/2015, i datës 08.12.2015**

### **Nga Arsyetimi**

*Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar e ka shpallur të ekzekutueshëm vendimin e Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit, pranë Odës Ekonomike të Kosovës, nr. ARB 07/2014, i datës 23.04.2015, me të cilin është vendosur në mënyrë meritore në çështjen juridike kontestimore në mes të paditësit-kundërpaditurit [.....] dhe të paditurit – kundërpaditësit [.....].*

*Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë kundërshtari i propozimit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të Ligjit për Arbitrazhin dhe shkeljeve të dispozitave të ligjit material, me propozim që aktvendimi i atakuar të anulohet.*

*Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK gjeti se:*

*Ankesa është e pa lejueshme.*

*Nga shkresat e lëndës rrjedhë se me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike I.C.nr.244/2015, të datës 21.10.2015, është shpallur i ekzekutueshëm vendimin i Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit, pranë Odës Ekonomike të Kosovës, nr. ARB 07/2014, i datës 23.04.2015.*

*Me ankesë është atakuar aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë me pretendim se propozuesi i ka pasur kundërpropozuesit borxh në shumë prej 39,494.20 €, të cilin borxh ia kishte para se të merrej vendimi nga arbitrazhi. Nga vendimin i Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit, nr. ARB 07/2014, dt. 23.04.2015, me të cilin është vendosur në mënyrë meritore në çështjen juridike [.....] rezulton se borxhi kontestues ka qenë objekt shqyrtimi në procedurën e zhvilluar të arbitrazhit dhe Tribunali i Arbitrazhit ka vendosur edhe për këtë çështje.*

*Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të shkresave të lëndës ka gjetur se, ankesa e kundërshtarit të propozimit është e palejuar edhe pse gjykata e shkallës së parë në këshillën juridike të aktvendimit të atakuar, e ka udhëzuar gabimisht palën për të drejtën e ankesës. Dispozitat e Nenit 36.1, 36.3 dhe nenit 37.2 të Ligjit për Arbitrazhin (Ligji 02/L-75) përcaktojnë se, pala mund me padi ta kërkojë anulimin e vendimit të tribunalit të arbitrazhit, brenda 90 ditëve nga dita e pranimin të vendimit të arbitrazhit, për shkaqet e parapara me Nenit 36.2 të Ligjit. Kundër aktvendimit të gjykatës me të cilin vendoset lidhur me padinë për anulimin e vendimit të arbitrazhit, sipas Nenit 37.3 të Ligjit për Arbitrazhin, lejohet ankesa. Por e njëjta dispozitë përcakton se, për të gjitha aktvendimet tjera të nxjerra nga gjykata në pajtim me këtë ligj nuk lejohet ankesa. Në rastin konkret procedura në shkallë të parë nuk është zhvilluar sipas padisë për anulimin e vendimit të arbitrazhit por sipas propozimit për shpalljen e ekzekutueshme të vendimit të arbitrazhit konform Nenit 38.1 të Ligjit për Arbitrazhin andaj bazuar në dispozitën e lartëcituar (Neni 37.3) kundër vendimit të marrë nga gjykata në këtë procedurë nuk lejohet ankesa.*